

INSTITUVIONI I AVOKATIT TË POPULLIT



**PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE DREJTUAR
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE GJATË VITIT 2016**

Prishtinë, 2017

PËRMBLEDHJA E RAPORTEVE ME REKOMANDIME

I. RAPORTET EX OFFICIO.....	6
Ex officio nr. 757/2015	7
Raport lidhur me vendimet gjyqësore për heqjen dhe kthimin zotësisë për të vepruar, rezidentëve në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet	7
Ex officio nr. 239/2016	16
Raport lidhur me parashkrimin e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatave Themelore në rastet e kundërvajtjes.....	16
Ex officio nr. 488/2016	41
Raport lidhur me pushimin e hetimit të veprave penale të korrupsionit, sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 159	41
Ex officio nr. 415/2016	53
Raport lidhur me mohimin e së drejtës për qasje në drejtësi, respektivisht mungesën e qasjes në objektin e gjykatës në pjesën veriore të Mitrovicës	53
Ex officio nr. 421/2016	60
Raport lidhur me të drejtën për jetë në rastin B.R.....	60
Ex Officio nr. 425/2015	72
Raport në lidhje me mungesën e mjeteve juridike efektive	72
Ex officio nr. 563/2016	83
Raport përkritazi me procedurën e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës	83
Ex officio nr. 499/2016	93
Raport në lidhje me mosrespektimin e procedurave ligjore gjatë procesit të rekrutimit të personelit, sipas konkurseve të shpallura nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në Republikën e Kosovës	93
Ex officio nr. 382/2016	102
Raport në lidhje me cenimin e dinjitetit dhe së drejtës së pensionistëve për pensione.....	102
Ex officio nr. 894/2016	109
Raport në lidhje me Vlerësimin Nacional të të Drejtave të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues në Kosovë	109
II. RAPORTET E BAZUARA NË ANKESA.....	120
Ankesa nr: 322/2015	121
Raport me rekomandime lidhur me cenimin e të drejtës për mjedis jetësor	121
Ankesa nr. 348/2015.....	129
Raport lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike nga Komuna e Fushë Kosovës.....	129
Ankesa nr: 223/2015; 229/2015; 65/2016.....	135
Raport lidhur me lirimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore të shitura nga Agjencia Kosovare e Privatizimit nga shfrytëzuesit e paligjshëm	135

Ankesa nr. 185/2012	142
Raport lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në rastin C. nr. 3439/15 që ka të bëjë me ndarjen e pasurisë së fituar në bashkëpronësi	142
Ankesa nr. 431/2015	149
Raport lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi I. R., në lidhje me procedurën e dhënies granteve për ndërtimin e stallës, objekteve përcjellëse dhe mekanizëm bujqësor nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB).....	149
Ankesa nr. 291/2014	156
Raport në lidhje me zvarritjen procedurale nga Gjykatës Themelore në Prishtinë për vendosjen e lëndës P nr.42/15 të ankuesit Rr. B.....	156
Ankesa nr. 6/2016 dhe nr. 120/2016	162
Raport në lidhje me kontrollet e paautorizuara të KEDS-it në prona private	162
Ankesa nr. 113/2016	170
Raport me rekomandime lidhur me mos zbatimin e vendimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.....	170
Ankesa nr. 114/2016	177
Raport me rekomandime lidhur me mos zbatimin e vendimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.....	177
Ankesa nr. 303/2015	184
Raport lidhur me mos përmbarimit të Aktgjykimi të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren	184
Ankesa nr. 595/2015	201
Raport lidhur me detyrimet pozitive që burojnë nga neni 29 dhe neni 31, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nga neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut	201
Ankesa nr. 702/2015	214
Raport në lidhje me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike nga Komuna e Klllokotit	214
Ankesa nr. 733/2015	221
Raport me rekomandime lidhur me dështimin e MASHT-it, për shqyrtim në afatin ligjor të ankesës së parashtruar nga znj. F. G.	221
Ankesa nr. 160/2015	227
Raport përkitazi me shkeljen e të drejtave që dalin nga marrëdhënia e punës.....	227
Ankesa nr. 29/2016	241
Raport për lirim të pronës së uzurpuar publike komunale	241
Ankesa nr: 72/2015	246
Raport lidhur me mungesën e mjeteve efektive juridike	246
Ankesa nr. 564 /2016	256

Raport lidhur me të drejtat e të pandehurit në procedurë penale	256
III. OPINIONET E AVOKATIT TË POPULLIT.....	266
Opinoion nr. 25/2016	267
Opinion lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Grudić kundër Serbisë, Aplikimi Nr. 31925/08.....	267
Opinoion nr. 528/2016	280
Opinion në lidhje me procedurat e ankimimit të vendimeve administrative lidhur me çështjen e njohjes dhe verifikimit të statusit të veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës	280
Opinion nr. 280/2016	288
Opinion lidhur me gjendjen e krijuar në hapësirat në zonën e interesit të veçant ekonomik sipas Vendimit nr. 4/119, datë 3 nëntor 2004 dhe Vendimit 02/57, datë 13 mars 2009 të Qeverisë së Kosovës dhe propozimi për ndërmarrjen e masave efektive për zgjidhjen e çështjes	288
Opinion nr. 322/2015	292
Opinion për qartësimin e procedurave ligjore të cilat Komuna e Gjakovës duhet t'i ndërmerr në drejtim të zgjidhjes së problemeve mjedisore në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë	292
Opinion nr. 668/2016	298
Opinion në lidhje me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve, si dhe masat që duhet ndërmarrë institucionet përgjegjëse	298
IV. AVOKATI I POPULLIT NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)	304
Amicus Curiae nr. 2/2016.....	305
Mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me shkeljen e të drejtës së personave të privuar nga liria për trajtim adekuat mjekësor	305
Amicus Curiae nr. 440/2015	313
Mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me trajtimin e lëndës C-III-13/0514 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.....	313
Amicus Curiae nr. 406/ 2016, Nazmi Abazi dhe të tjerët	314
Mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me aktgjykimet e gjykatave për çështje të njëjta, por me përfundime të ndryshme	314
V. KËRKESAT PËR MASË TË PËRKOHSHME.....	319
Ankesa nr.568/2016 dhe nr. 569/2016.....	320
Kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për aplikimin e Masës së Përkohshme në zbatimin e vendimit me të cilin ishin rikthyer në vuajtje të dënimit të gjithë personat që ishin në trajtim mjekësor jashtë ambienteve të burgut.....	320
Ankesa nr. 6/2016.....	322
Kërkesë drejtuar KEDS-it për aplikimin e Masës së Përkohshme në lidhje me kontrollet brenda pronave private të qytetarëve	322

VI. LETËR REKOMANDIMET DREJTUAR AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE	324
Ankesa nr. 33/2016.....	325
Letër rekomandim.....	325
Ankesa nr. 441/2015.....	327
Letër rekomandim.....	327
Ankesa nr. 557/2015.....	330
Letër rekomandim.....	330
Ankesa nr. 320/2015.....	332
Letër rekomandim.....	332
Ankesa nr.398/2016.....	334
Letër rekomandim.....	334
Ex officio 625/2016	336
Letër rekomandim.....	336
Ankesa nr. 202/2016.....	340
Letër rekomandim.....	340

I. RAPORTET EX OFFICIO

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 757/2015

**Raport lidhur me vendimet gjyqësore për heqjen dhe kthimin zotësisë për të vepruar,
rezidentëve në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet**

Për

Z. Arban Abrashi, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Z. Enver Peci, kryetar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Znj. Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur
dhe Peticione

Prishtinë, më 4 shkurt 2016

Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i praktikave të mbajtjes së personave me ngecje në zhvillim mendor në institucionet rezidenciale dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së këtyre praktikave me ligjet e zbatueshme dhe të drejtat e njeriut.

Ky raport është i bazuar në hetimet *ex officio* dhe mbështetet në faktet dhe provat të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me mbajtjen e personave me ngecje në zhvillim mendor në institucione rezidenciale, pa dokumente personale dhe vendime gjyqësore për heqjen e zotësisë së veprimit, të cilat janë të përcaktuara si kritere sipas UA nr.11/2014 dhe ligjeve në fuqi për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore -ngecje në zhvillimin mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet. Gjithashtu shqetësimi kryesor ka të bëjë me kufizimin e lirisë së lëvizjes së personave sipas standardeve ndërkombëtare.

Baza ligjore

Sipas nenit 135, para. 3 të Kushtetutës “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”

Po ashtu, nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “*(..) Ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)*”.

Përshkrimi i rrethanave të çështjes

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, më 15 korrik 2015, ka filluar hetimet sipas detyrës zyrtare *ex officio*, lidhur me vendimet gjyqësore për heqjen dhe kthimin zotësisë personave me ngecje në zhvillim mendor, të cilët janë rezidentë në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet.
2. Institucionet e menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) janë: Instituti Special në Shtime (në tekstin e mëtutjeshëm: ISSH) dhe Shtëpia e Fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore (SHF) në Shtime. Shtëpitë me bazë në komunitet (në tekstin e mëtutjeshëm: SHK), deri më 31 dhjetor 2015, janë menaxhuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por nga 1 janar 2016, këto shtëpi janë në kompetenca të komunave përkatëse, përveç SHK Graçanicë, e cila më herët ka kaluar në menaxhim të komunës së Graçanicës.
3. Gjithsej janë shtatë SHK në: Shtime, Ferizaj, Kamenicë, Vushtrri, Deçan, Graçanicë, Shtëpia e Fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore (SHF) në Shtime, si dhe ISSH, ku rezidentë janë personat me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor, ndërkaq kriter për vendosje në ISSH dhe SHK është heqja e zotësisë së veprimit.
4. Pas realizimit të vizitave të zyrtarëve të Institucionit të Avokatit të Popullit në institucionet e lartpërmendura dhe analizës së raporteve zyrtare nga këto vizita rezultoi se nga gjithsej 124 rezidentë (në ISSH, SHK Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Deçan, Kamenicë, Graçanicë), 41 prej tyre nuk posedonin vendim gjykate, 12 prej tyre nuk posedonin asnjë dokument identifikimi, ndërsa 9 prej tyre ishin ende me letërnjoftime të UNMIKUT.

Përshkrimi i gjendjes

5. Në ISSH) banojnë 61 persona me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor. Moshë mesatare e tyre është 46 vjeç. Nga 61 rezidentë, dhjetë prej tyre nuk posedojnë dokumente

identifikimi ku përgjegjës janë QPS Lipjan për pesë raste; QPS Ferizaj për një rast; QPS Rahovec për një rast; QPS Novobërdë për një rast; QPS Podujevë për një rast dhe QPS Prishtinë për një rast.

Me vendime gjyqësore, gjithashtu, nuk janë të pajisur të gjithë rezidentët. Janë gjithsej 13 rezidentë pa vendime gjyqësore, katër prej tyre janë shtetas të huaj, ndërsa nëntë janë banorë të Republikës së Kosovës, ku pesë nga ta janë në procedurë gjyqësore.

Përfaqësuesit e ISSH deklaruan se momentalisht kanë problem vetëm me caktimin e kujdestarëve ligjor për rezidentët pas heqjes së zotësisë së veprimit, ngase sipas tyre përfaqësues të qendrave për punë sociale po hezitojnë dhe nuk po janë te gatshëm për caktimin e stafit nga QPS-të si kujdestarë ligjorë, mirëpo deklarohen se është duke punuar në këtë drejtim. Sipas tyre në dy raste të vendosjes për heqje të zotësisë së veprimit kujdestarë ligjorë janë caktuar punonjës të ISSH-së.

SHK në Shtime

6. Në SHK në Shtime janë të vendosur 13 rezidentë, ndërsa kapaciteti i objektit është për 10 rezidentë. Sa i përket vendimeve gjyqësore 10 rezidentë kishin vendime, 8 prej tyre iu është hequr plotësisht zotësia e veprimit, sipas kërkesave të iniciuara nga familja. Dy raste kishin vendime ku gjykata ka vendos për heqjen e pjesëshme të zotësisë së veprimit. Njërit rast më 2008 i është hequr pjesërisht zotësia e veprimit, mirëpo në vendim nuk është përcaktuar perioda kohore për të cilën është hequr zotësia e veprimit dhe rasti i dytë më 2006 i është hequr zotësia e veprimit pjesërisht, ku në vendim ceket “përkohësisht”, por duhet theksuar se nga viti 2006 nuk është iniciuar procedurë për rivlerësim për gjendjen.

SHK në Kamenicë

7. SHK në Kamenicë gjithsej janë të vendosur 10 rezidentë. Sipas dosjeve të tyre të gjithë rezidentët, posedonin aktvendim për heqjen e zotësisë së plotë të veprimit, aktvendim mbi caktimin e kujdestarit ligjor, ku sipas tyre 3 deri 4 herë në vit vizitohen nga kujdestarët e QPS-ve. Si problem i identifikuar në SHK Kamenicë është çështja e stafit, i cili përbëhet nga 5 punëtorë, prej tyre 3 infermierë, një ndihmës mjekësor dhe udhëheqësi i shtëpisë. Pra, ka mungesë të stafit për përkujdesje të rezidentëve, krahasuar me SHK të komunave të tjera, të cilat kanë nga dhjetë persona në staf (infermier dhe ndihmës mjekësorë).

SHK në Ferizaj

8. SHK në Ferizaj, vetëm 6 prej tyre kanë aktvendim mbi heqjen e zotësisë së veprimit nga Gjykata Komonale, 5 nga ta iu është hequr plotësisht zotësia e veprimit, ndërsa lidhur me një rast, gjykata ka vendosur që pjesërisht t’i hiqet zotësia e veprimit, nuk ceket se cilat veprime mund të ndërmarrë personi i cili është vënë nën kujdestari të përkohshme.

SHK në Deçan

9. Në SHK në Deçan janë të vendosur 10 rezidentë. Dosjet e tyre nuk përmbajnë pjesën më të madhe të dokumentacionit bazuar në udhëzimin administrativ nr.11/2014. 9 rezidentë janë të pajisur me letërnjoftime të UNMIK-ut, ndërsa vetëm një është i pajisur me letërnjoftim të Kosovës. Aktvendimin mbi heqjen e zotësisë së veprimit nga Gjykata Komonale në Deçan e kanë vetëm 6 rezidentë, ndërsa të tjerët nuk posedojnë aktvendimet për heqjen e zotësisë së veprimit.

SHK në Vushtrri

10. Në SHK në Vushtrri ishin të vendosur 10 rezidentë. Aktvendimin mbi heqjen e zotësisë së veprimit nga Gjykata Komonale në Vushtrri e kishin vetëm 4 rezidentë, prej tyre një të përhershëm dhe 3 të përkohshëm, ndërsa të tjerët nuk i kishin aktvendimet e heqjes së zotësisë së veprimit në dosjet e tyre.

SHK në Graçanicë

11. Në SHK në Graçanicë janë të vendosur 10 rezidentë. Dosjet e rezidentëve nuk i përmbajnë pjesën më të madhe të dokumentacionit bazuar në UA nr.11/2014. 5 rezidentë ishin të pajisur me letërnjoftime të Kosovës, 3 rezidentë ishin të pajisur me letërnjoftime të shtetit serb, ndërsa 2 nuk kanë asnjë dokument identifikimi. Aktvendimin mbi heqjen e zotësisë së veprimit nga gjykata nuk e kishte asnjëri nga rezidentët.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

Neni 21, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) përcakton: *“Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”* Kurse, paragrafi 3 thotë: *“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*

Neni 25, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton si në vijim: *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën”*. [...] Kurse neni 26 i Kushtetutës thotë se: *“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]”*.

Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 4 nëntor 1950 (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) thotë: *“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]”*

Neni 5, paragrafi 1 KEDNJ përcakton se: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”*. Ndërsa, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së garanton se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”*

KEDNJ në nenin 13 parasheh të drejtën për zgjidhje efektive sipas së cilës: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*

Ligji për Familjen, në nenin 215 përcakton parimet e kujdestarisë për të miturit dhe të rriturit ku thotë: (2) *“Qëllimi i kujdestarisë ndaj personave të moshës madhore është mbrojtja e personalitetit të tyre dhe do të manifestohet në radhë të parë me kujdesin personal, aftësim për jetë të pavarur dhe me mjekim.”* (3) *“Kujdestaria ka për qëllim gjithashtu sigurimin e të drejtave pasurore dhe të të drejtave të tjera dhe interesave të personave nën kujdesie”*. Kurse në nenin 223 parashihet heqjen e plotë apo e pjesshme e aftësisë së veprimit sipas së cilit: (1) *“Personit të moshës madhore që nuk është i aftë për të gjykuar normalisht (sëmundja psikike e diagnostikuar, ngecja psikike ose ndonjë shkak të ngjashëm) dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të kujdeset vetë për të drejtat dhe interesat e tij, duhet t’i hiqet aftësia për të vepruar”*. (2) *“Personit të moshës madhore që me veprimet e veta ashpërsisht i rrezikon të drejtat dhe interesat e tij ose të drejtat dhe interesat e personave të tjerë për shkak të sëmundjes psikike të diagnostikuar, të ngecjes psikike apo keqpërdorimit të alkoolit ose të mjeteve narkotike, të paaftësisë nga pleqëria duhet pjesërisht t’i hiqet aftësia për të vepruar”*.

Në neni 224 në Procedurat përcaktohet se: *“Personat të cilëve me vendimin e gjykatës pjesërisht ose plotësisht u është hequr aftësia e tyre për të vepruar, vihen nën kujdestari të Organit të Kujdestarisë.”*

“Gjykata brenda afatit dhjetë ditor duhet të përcjellë vendimin tek Organi kompetent i kujdestarisë i cili brenda 30 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit duhet të sigurojë kujdestarinë”

Gjithashtu ligji për procedurën jokontestimore, në kreun e dytë parasheh rregullimin gjendjeve personale ku në pikën 1 përcaktohet: *“Heqja dhe kthimi i zotësisë për të vepruar”*

Sipas nenit 31 parashihet që:

“31.1 Në procedurën e heqjes së zotësisë për të vepruar gjykata konstaton se a është personi i moshës madhore, për shkak të paaftësisë së plotë apo të pjesshme për të gjykuar, në gjendje të kujdeset për të drejtat dhe interesat e veta, dhe në pajtim me këtë plotësisht apo pjesërisht ia merr zotësinë për të vepruar”

31.2 Në procedurën e kthimit të zotësisë për të vepruar gjykata plotësisht apo pjesërisht ia kthen personit të moshës madhore zotësinë për të vepruar po qe se konstaton se kanë pushuar shkaqet të cilat kanë ndikuar për marrjen e saj plotësisht apo pjesërisht”.

31.3 Procedura nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përfundojë sa më parë që është e mundur e jo me vonë se 90 ditë, ndërsa procedura nga paragrafi 2 këtij neni duhet të përfundojë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën ka arritur në gjykatë propozimi për kthimin e zotësisë për të vepruar”.

Neni 32, përcakton procedurat për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar dhe fillohet sipas propozimit të: a) organit të kujdestarisë [...]

Neni 33 parasheh që *“Për zhvillimin e procedurës sipas propozimit të subjektit të autorizuar është kompetente gjykata komunale në territorin e së cilës e ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi të cilit i merret apo kthehet zotësia për të vepruar”.*

Kurse neni 38 thotë: *“Për heqjen ose kthimin e zotësisë për të vepruar gjykata vendosë në bazë të fakteve të vërtetuar në seanca gjyqësore”.*

“Në qoftë se personi të cilit i hiqet, respektivisht kthehet zotësia për të vepruar është i vendosur në institucionin që ushtron veprimtari shëndetësore, gjykata mund ta mbajë seancën gjyqësore në institucionin e tillë dhe ta dëgjojë personin e tillë”.

“Gjykata do të vlerësojë se a do ta marrë në pyetje personin ndaj të cilit zhvillohet procedura në praninë e mjekut që bënë mbikëqyrjen e gjendjes shëndetësore të tij derisa ai gjendet në institucionin shëndetësore”.

Sipas nenit 42: *“Kur vërteton se ekzistojnë shkaqet për heqjen e zotësisë për të vepruar, gjykata personit ndaj të cilit zhvillohet procedura do t’ia heqë zotësinë për të vepruar plotësisht ose pjesërisht”.*

“Në aktvendimin me të cilin personit i hiqet pjesërisht zotësia për të vepruar, gjykata në bazë të rezultatit të ekspertizës mjekësore mund ti caktojë veprimet konkrete juridike që ky person mund t’i kryejë në mënyrë të pavarur”.

Ndërsa neni 44 thotë: *“Kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat një personi i është hequr zotësia për të vepruar, gjykata sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të personave të autorizuar nga neni 32 të këtij ligji, do të zhvillojë procedurën dhe varësisht nga rezultati i saj do të jep vendimin me të cilin personit të tillë plotësisht apo pjesërisht i kthehet zotësia për të vepruar”.*

Neni 45 përcakton: *“Në procedurën për kthimin e zotësisë për të vepruar zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e këtij kreu sipas të cilave bëhet heqja e zotësisë për të vepruar”.*

Gjithashtu, neni 5 i UA nr.11/2014, për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillimin mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet përcakton se: *“Për strehim institucional në ISSH dhe në SHK, lënda e parashtruesit të kërkesës duhet të jetë e kompletuar me këto dokumente*

1.1 Letërnjoftimi ose ndonjë dokument tjetër identifikues

1.2 Certifikata e lindjes

1.3 *Certifikata e mjekut specialist-infektologut*

1.4 *Mendimi profesional I së paku tre specialistëve të repartit të psikiatrisë të QKUK apo të ndonjë reparti të psikiatrisë të spitaleve regjionale ku përcaktohet qartë diagnoza e klientit (shkalla e ngecjes në zhvillimin mendor)*

1.5 *Aktvendim mbi marrjen e aftësisë së veprimit nga Gjykata Themelore*

1.6 *Aktvendimi nga organi I kujdestarisë mbi caktimin e kujdestarit*

1.7 *Certifikata e gjendjes ekonomike*

1.8 *Dëshmi ligjore për menaxhimin e patundshmërisë për personin i cili kërkon strehim se kujt ia bart patundshmërinë (pasurinë) nëse ka, pasi që të kaloj në mbrojtje institucionale*

1.9 *Certifikata gjendjes familjare*

1.10 *Dy fotografi”.*

Derisa neni 10.3 thotë se “Asnjë klient-rezident nuk mund të vendoset në afat të pacaktuar dhe kjo e bën përgjegjës organin e kujdestarisë pranë Qendrës për Punë Sociale, që së paku një muaj para skadimit të afatit të qëndrimit në ISSH apo në shtëpitë e komunitetit, ta verifikojë gjendjen në origjinën e klientit dhe t’i vlerësojë rrethanat nëse janë krijuar kushtet për kthim, apo të propozojë vazhdimin e qëndrimit të mëtutjeshëm”.

Analiza ligjore e rastit

12. Avokati i Popullit që në fillim vëren se jo në të gjitha institucionet shtetërore, ku personat me ngecje psikike mbahen nën përkujdesje, i kanë të kompletuara dosjet me vendime për heqjen e përhershme apo përkohshme të zotësisë së veprimit. Është obligim ligjor që institucionet përgjegjëse në rastin e pranimit të personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillim mendor të zbatojnë legjislacionin në fuqi.
13. Për më tepër Avokati i Popullit thekson se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut prandaj, secili institucion duhet vepruar në pajtim me të. Po kështu Avokati i Popullit përkujton se Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë këtu institucionet përgjegjëse për përkujdesje të personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillim mendor si dhe sistemin gjyqësor të Kosovës.
14. Avokati i Popullit thekson se për të qenë në pajtueshmëri me nenin 5.1 të KEDNJ-së kufizimi i lirisë së lëvizjes duhet të jetë në përputhje me dy kërkesa madhore:

E para, duhet të jetë ligjore, sipas kuptimit të së drejtës së brendshme duke përfshirë respektimin e procedurës së pacaktuar me ligj. Në këtë drejtim Konventa i referohet përsëri në mënyrë primare ligjit kombëtar dhe përcakton detyrimin për të ju përmbajtur rregullave materiale dhe procedurale.

E dyta: sipas nenit 5 kërkon që çdo privim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, përkatësisht për të mbrojtur individët nga arbitrariteti (shih Creanga v. Romania GC, nr.29226/03, par.84, 23 shkurt 2012)
15. Avokati i Popullit vlerëson se afatet kohore për shqyrtim dhe vendosjen e lëndëve nga gjyqësori është e garantuar me nenin 6 të KEDNJ, sipas së cilës “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]” dhe drejtën për zgjidhje efektive të garantuar me nenin 13 sipas secilit “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e pacaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një

zgjdhjeje efektive para një organi kombëtar [...]. Zvarritja e procedurave për nxjerrjen e vendimeve për heqjen apo kthimin e të drejtës për të vepruar, për rezident në ISSH, SHK përbën shkelje të neneve në fjalë. (Shih rastin Stanev vs Bulgarya nr. 36760/06).

16. Për më tepër Avokati i Popullit konsideron se është obligim ligjor i shtetit që personat me aftësi të kufizuar mendore nën përkujdesje të institucioneve rezidenciale, të mbahen dhe të trajtohen në përputhje me legjislacionin vendor, duke i respektuar të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Shih rastin Keenan vs United Kingdom nr. 27229/95).
17. Avokati i Popullit thekson se gjykatat kanë obligim ligjor heqjen e zotësisë së veprimit, duke i respektuar procedurat e përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm përfshirë këtu edhe afatet e parapara ligjore. Situata e tillë duhet zbatuar edhe tek personat me aftësi të kufizuar mendore - ngecje në zhvillim mendor të cilët janë nën përkujdesje institucionale. Është me rëndësi të zbatohet në përpikëri Ligji për Familjen, i cili në nenin 224, thekson se *“Personat të cilëve me vendimin e gjykatës pjesërisht ose plotësisht u është hequr aftësia e tyre për të vepruar, vihen nën kujdestari të Organit të Kujdestarisë. Gjykata brenda afatit dhjetë ditor duhet të përcjellë vendimin tek Organi kompetent i kujdestarisë i cili brenda 30 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit duhet të sigurojë kujdestarinë”*.
18. Avokati i Popullit, gjithashtu, vëren se ka raste që gjykata me vendime gjyqësore për heqjen së zotësisë së veprimit përcakton kujdestar ligjor punonjës të ISSH. Kjo konsiderohet se është në kundërshtim me punën që ata bëjnë në ISSH dhe gjithashtu mund të konsiderohet se është konflikt interesi me natyrën dhe rolin e ISSH, duke pasur parasysh që kujdestari ka për obligim të kujdeset për personalitetin, kushtet e vendosjes, t’i mundësojë personit nën kujdesin e tij të jetojë jetë të pavarur dhe me dinjitet për aq sa është e mundshme, ndërsa personeli i ISSH ka për detyrë të përcjellë dhe të ndikojë në përparimin e rezidentëve në sferën e përkujdesjes vetanake.
19. Avokati i Popullit konstaton se ligji për procedurën jokontestimore, në nenin 31 garanton që *“Në procedurën e heqjes së zotësisë për të vepruar gjykata konstaton se a është personi i moshës madhore, për shkak të paaftësisë së plotë apo të pjesëshme për të gjykuar, në gjendje të kujdeset për të drejtat dhe interesat e veta, dhe në pajtim me këtë plotësisht apo pjesërisht ia merr zotësinë për të vepruar”*, mungesa e vendimeve gjyqësore për heqjen e zotësisë për të vepruar tek 41 rezident nga numri i përgjithshëm 124 rezidentë në ISSH, si dhe në SHK-të në Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Deçan, Kamenicë, Graçanicë, është treguesi se këta rezidentë nuk trajtohen në përputhje me këtë ligj.
20. Pa hyrë në analizën e vendimeve të gjykatave, Avokati i Popullit vëren se vendimet e gjykatës për heqjen e pjesëshme të zotësisë së veprimit, nuk i kanë respektuar procedurat e përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm. Në dispozitiv të vendimit nuk është i përcaktuar saktë nocioni *përkohësisht*, *përkatësisht*, periudha kohore për të cilën u hiqet zotësia e veprimit personave ndaj të cilëve zhvillohet procedura për heqjen e zotësisë së veprimit dhe se cilat veprime mund të ndërmerren personi i cili është vënë nën kujdestari të përkohshme e drejtë kjo e garantuar me nenin 42.1 të Ligjit për Procedurë Jokontestimore sipas së cilit *“Kur vërtetohet se ekzistojnë shkaqet për heqjen e zotësisë për të vepruar, gjykata personit ndaj të cilit zhvillohet procedura do t’ia heqë zotësinë për të vepruar plotësisht ose pjesërisht”* dhe nenin 42.2 *“Në aktvendimin me të cilin personit i hiqet pjesërisht zotësia për të vepruar, gjykata në bazë të rezultatit të ekspertizës mjekësore mund ti caktojë veprimet konkrete juridike që ky person mund t’i kryejë në mënyrë të pavarur”*.
21. Neni 44 i Ligjit për Procedurën Jokontestimore, garanton që *“Kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat një personi i është hequr zotësia për të vepruar, gjykata sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të personave të autorizuar nga neni 32 të këtij ligji, do të zhvillojë procedurën*

dhe varësisht nga rezultati i saj do të jep vendimin me të cilin personit të tillë plotësisht apo pjesërisht i kthehet zotësia për të vepruar. Avokati i Popullit nuk vëren se ky nen është i zbatueshëm tek personat me aftësi të kufizuara mendore nën përkujdesje të institucioneve rezidenciale.

22. Avokati i Popullit, gjithashtu vlerëson se bazuar në legjislacionin në fuqi vendimi duhet t'i përcillet organit kompetent të kujdestarisë konkretisht Qendrës për Punë Sociale, i cili pastaj brenda 30 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit duhet të caktojë kujdestarin dhe se vendimi pas plotfuqishmërisë t'i përcillet organit përkatës civil për të konstatuar gjendjen faktike në librat përkatës të të lindurve. Vendosja e rezidentëve në afat të pacaktuar në ISSH apo në SHK, pa u verifikuar nga ana e organit kompetent të kujdestarisë, Qendrës për Punë Sociale gjendjen në origjinën e klientit dhe duke mos vlerësuar rrethanat, nëse janë krijuar kushtet për kthim, apo të propozojë vazhdimin e qëndrimit të mëtutjeshëm, bie në kundërshtim me vetë udhëzimin administrativ nr.11/2014, neni 10.3, për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor, në ISSH dhe në SHK.
23. Avokati i Popullit konsideron se neni 5 i UA nr.11/2014, për Punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore –ngecje në zhvillimin mendor, në ISSH dhe në SHK përcakton kriteret për vendosje të rezidentëve nëpër këto institucione. Megjithatë është evident fakti se nga 124 rezidentë në ISSH, SHK në Shtime, Ferizaj, Vushtri, Deçan, Kamenicë, Graçanicë, 41 prej tyre nuk posedonin vendim gjykate, 12 prej tyre nuk posedonin asnjë dokument identifikimi, ndërsa 9 prej tyre ishin ende me letërnjoftime të UNMIK-ut.
24. Avokati i Popullit, bazuar në informatat, dëshmitë, faktet dhe në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”*. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit *“(.) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla (...)*”.

REKOMANDIME

1. *Qendrat për Punë Sociale (QPS) të angazhohen për nxjerrjen e dokumentacionit të regjistrit civil dhe gjendjes civile të 12 rezidentëve, të cilët nuk kanë dokumente identifikimi (për rezidentët e ISSH-së janë përgjegjëse: QPS Lipjan për 5 raste; QPS Ferizaj për 1 rast; QPS Rahovec për 1 rast; QPS Novobërdë për 1 rast; QPS Podujevë për 1 rast dhe QPS Prishtinë për 1 rast; ndërsa për dy rezidentët e SHK Graçanicë është përgjegjëse QPS Graçanicë).*
2. *Të rivlerësohen 41 rastet të identifikuar, të cilët vazhdojnë të jenë pa vendime gjyqësore dhe të trajtohen pa vonesa të mëtejme. Gjithashtu, të rivlerësohen nga komisioni përkatës rastet që janë identifikuar me vendime gjyqësore ku ju është hequr pjesërisht zotësia e veprimit (ka pas raste nga 2006, 2008, shih SHK-Shtime)*
3. *Gjykatat duhet zbatuar ligjin në përcaktimin e kujdestarëve ligjorë për rezidentët, pas heqjes së zotësisë së veprimit.*
4. *Gjykatat duhet trajtuar me prioritet kërkesat e QPS-ve për heqjen e zotësisë së veprimit personave me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillim mendor.*
5. *Duhet të rritet numri i stafit të punës në SHK në Kamenicë, për të cilën duhet të tregohet një gatishmëri më e madhe e komunës për të mundësuar rekrutimin e stafit shtesë.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutem të na informoni për veprimet që do t'i ndërmarrin

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, komunat, QPS-të dhe gjyqësori, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartshënuara. Gjithashtu, Ju lutem që përgjigjen, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 4 mars 2016.

Me nderime

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Habit Hajredini, Zyra për Qeverisje të Mirë(ZQM), ZKM

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 239/2016

Raport lidhur me parashkrimin e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatave Themelore në rastet e kundërvajtjes

Drejtuar:

Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Znj. Lirije Kajtazi, Kryetare e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Znj. Albulena Haxhiu, Kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Znj. Selvije Halimi, Nënkryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Z. Armend Zemaj, Kryesues i Grupit Punues për Projektligjin Nr. 05/L-87 për Kundërvajtje

Prishtinë, më 25 prill 2016

QËLLIMET E RAPORTIT

Ligji që aktualisht rregullon parashkrimin e rasteve të kundërvajtjes në Republikën e Kosovës është Ligji Nr. 011/15-79 i KSAK-së mbi kundërvajtjet (“*Ligji i 1979*”). Ky ligj parashikon tri lloje të mundshme të parashkrimit në raste të kundërvajtjes. Së pari, “[p]rocedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon një vit nga data kur është kryer kundërvajtja” (*id.*, neni 27, par. 1). Së dyti, “[m]e çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, por parashkrimi bëhet në çdo rast kur kalojnë dy vjet nga data kur është kryer kundërvajtja” (*id.*, neni 27, par. 4). Së treti, “[d]ënimi i shqiptuar dhe masa mbrojtëse e dhënë nuk mund të ekzekutohen nëse nga data kur aktvendimi mbi kundërvajtjen ka marrë formën e prerë ka kaluar 1 vit” (*id.*, neni 28, par. 1).

Ky raport ka katër qëllime kryesore:

- (1) të dëshmojë seriozitetin e problemit të parashkrimit në raste të kundërvajtjes;
- (2) të tërheqë vëmendjen tek pasojat e dëmshme që shkakton parashkrimi i lëndëve kundërvajtëse për buxhetin shtetëror të Republikës së Kosovës, si dhe për respektimin e të drejtave të njeriut;
- (3) të japë një vlerësim të zgjidhjeve të këtij problemi që propozohen në Projektligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;
- (4) t’i japë rekomandime Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjidhjen më të drejtë dhe më efikase të problemit.

BAZA LIGJORE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor” (neni 16, par. 8).
- “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 8);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).
- Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

- A. Dispozitat ligjore për rregullimin e procedurës gjyqësore dhe ekzekutimit të vendimeve në raste të kundërvajtjes**

Rastet e kundërvajtjes në Republikën e Kosovës rregullohen, kryesisht, nga një instrument ligjor i kohës së ish-Jugosllavisë, Ligji Nr. 011/15-79 i KSAK-së mbi kundërvajtjet (“*Ligji i 1979*”), megjithëse disa hollësi të procedurës gjyqësore, si dhe të ekzekutimit të dënimeve dhe masave të tjera, rregullohen nga ligje të mëvonshme të Republikës së Kosovës.

Për sa i përket procedurës gjyqësore të ndjekur në raste të kundërvajtjes, *Ligji i 1979* përcakton se “[o]rganet për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes janë gjykata komunale e kundërvajtjes si organ i shkallës së parë” (*id.*, neni 30, par. 1). Por këtë dispozitë e shfuqizoi një ligj tjetër, Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat. Ligji për Gjykatat përcakton që lëndët e kundërvajtjes të trajtohen në shkallën e parë jo nga Gjykatat Komunale të Kundërvajtjes, por nga Gjykatat Themelore të shtatë qendrave rajonale: Gjykatat Themelore të Prishtinës, Gjilanit, Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Ferizajt dhe Mitrovicës (*id.*, neni 9, par. 2). Shih gjithashtu *id.*, neni 39, par. 2 (“Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të . . . Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore e cila ka juridiksionin territorial përkatës”).

Në rast se i pandehuri gjykohet fajtor për vepër kundërvajtëse, *Ligji i 1979* parashikon një sërë dënimesh dhe masash të tjera. Dënimet e parashikuara janë “dënimi me burgim” (*id.*, neni 2) dhe “gjoba” (*id.*, nenet 3-4), ndërsa masat mbrojtëse përfshijnë “marrja e sendit”, “marrja e përfitimit pasuror”, “ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së pavarur”, “ndalimi i drejtimit të automjetit”, “largimi i shtetasit të huaj” dhe “mjekimi i obligueshëm i alkoolistëve dhe i narkomanëve” (*id.*, neni 16).

Për sa i përket ekzekutimit të këtyre dënimeve dhe masave të tjera, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë përcakton se organi që ka përgjegjësinë e zbatimit është Policia e Republikës së Kosovës: “Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga . . . gjyqtari kompetent” (*id.*, neni 6, par. 1). Në bazë të kësaj dispozite, Policia është organi kompetent për ekzekutimin e dënimeve dhe masave të tjera në raste të kundërvajtjes.

Ligji i 1979 vendos afate të rrepta në raste të kundërvajtjes, duke përcaktuar tri lloje të mundshme të parashkrimit.

- (1) “Procedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon një vit nga data kur është kryer kundërvajtja” (*id.*, neni 27, par. 1);
- (2) “Me çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, por parashkrimi bëhet në çdo rast kur kalojnë dy vjet nga data kur është kryer kundërvajtja” (*id.*, neni 27, par. 4); dhe
- (3) “[d]ënimi i shqiptuar dhe masa mbrojtëse e dhënë nuk mund të ekzekutohen nëse nga data kur aktvendimi mbi kundërvajtjen ka marrë formën e prerë ka kaluar 1 vit” (*id.*, neni 28, par. 1).

Dy llojet e para të parashkrimit mund t’i quajmë afatet e *parashkrimit të procedurës*, ndërsa llojin e tretë mund ta quajmë afatin e *parashkrimit të ekzekutimit*. Pasojat që shkaktohen nga parashkrimi i lëndëve të kundërvajtjes përbëjnë temën kryesore të këtij Raporti.

B. Pasqyra statistikore e problemit të parashkrimit të rasteve të kundërvajtjes në fazën e procedurës gjyqësore dhe fazën e ekzekutimit të sanksioneve

Me qëllim që të zbulojë masën dhe gjerësinë e problemit të parashkrimit, Avokati i Popullit kërkoi të dhëna të hollësishme për vitin kalendarik 2015 prej organeve shtetërore që janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurës gjyqësore të këtyre lëndëve dhe ekzekutimin e dënimeve dhe masave të tjera. Siç u shpjegua më sipër, këto organe janë, përkatësisht, Gjykatat Themelore dhe degët e Policisë së Republikës së Kosovës të shtatë qendrave rajonale. Nga statistikat e mbledhura Avokati i Popullit ka

zbuluar se të dyja problemet e parashkrimit, parashkrimi i procedurës dhe parashkrimi i ekzekutimit, janë të përhapura në gjithë Republikën e Kosovës¹.

Për sa i përket parashkrimit të procedurës, statistikave të marra nga Gjykatat Themelore tregojnë se, në vitin 2015, numri i lëndëve kundërvajtëse të parashkruara nëpër gjykata ishin, gjithsej, 26,266. Gjykatat Themelore në të gjitha qendrat rajonale kanë pasur lëndë të parashkruara, por problemi duket të jetë më i madh në Gjykatat Themelore të Prishtinës dhe Gjakovës, ku numri i lëndëve kundërvajtëse të parashkruara ishin, përkatësisht, 11,860 dhe 9,492. Kjo do të thotë se afërsisht 83% të lëndëve kundërvajtëse të parashkruara në vitin 2015 ishin nga këto dy Gjykata.

Për më tepër, statistikave të mbledhura tregojnë se problemi i parashkrimit të procedurës ka gjasë të përkeqësohet edhe më shumë me kalimin e kohës. Në vitin 2015, gjithsej 305,860 lëndë kundërvajtëse janë zgjidhur nga të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës. Mirëpo, 327,162 lëndë kundërvajtëse janë pranuar gjatë vitit 2015. Kjo do të thotë se Gjykatat Themelore në vitin 2015 pranuan 7% më shumë raste të kundërvajtjes sesa zgjidhën dhe, për rrjedhojë, rritja neto e ngarkesës së Gjykatave Themelore gjatë vitit 2015 ishte 21,302 lëndë kundërvajtëse. Nëse ngarkesa e gjykatave në fushën e kundërvajtjes vazhdon të rritet me të njëjtin ritëm në vitet e ardhshme, problemi i parashkrimit të procedurës do të bëhet gjithnjë e më serioz me kalimin e kohës.

Fatkeqësisht, statistikave të dërguara nga degët e Policisë tregojnë se problemi i parashkrimit të ekzekutimit është edhe më serioz sesa ai i parashkrimit të procedurës. Duke mbledhur këto statistika, zbulohet se, në vitin 2015, u parashkruan gjithsej 32,860 urdhëresa të pranuar nga Gjykata Themelore në lëndë kundërvajtëse. Shifrat e mbledhura tregojnë gjithashtu rrezikun për përkeqësim të skajshëm të këtij problemi në vitet e ardhshme. Gjatë vitit 2015 degët e Policisë pranuan nga Gjykatat Themelore gjithsej 96,848 urdhëresa për ekzekutim në lëndë kundërvajtëse, ndërsa ekzekutuan vetëm 37,016 urdhëresa në të njëjtën periudhë. Kjo do të thotë se, gjatë kësaj periudhe, Policia pranuan 262% më shumë urdhëresa sesa ekzekutoi, duke rritur ngarkesën neto të urdhëresave prej 59,832 rastesh kundërvajtëse. Me këtë rritje të skajshme, problemi i parashkrimit të ekzekutimit nuk ka si të mos bëhet shumë më serioz me kalimin e kohës.

Duke bashkuar numrin e rasteve të parashkrimit të procedurës me numrin e rasteve të parashkrimit të ekzekutimit, rezulton se, gjatë vitit 2015, u parashkruan gjithsej $26,266 + 32,860 = 59,126$ raste. Nëse ky numër mbahet konstant vit për vit, do të mund të presim që, nga 327,162 lëndë të pranuar nga Gjykatat Themelore në vitin 2015, rreth 20% prej tyre do të parashkruhen, ose në fazën e procedurës gjyqësore, ose në fazën e ekzekutimit.

PASOJA TË DËMSHME TË PROBLEMIT TË PARASHKRIMIT

Dimensionet marramendëse të problemit të parashkrimit të lëndëve kundërvajtëse, qoftë në fazën e procedurës, qoftë në fazën e ekzekutimit, shkakton një sërë pasojash të rënda për Republikën e Kosovës.

C. Pajoja të dëmshme të parashkrimit për buxhetin shtetëror të Republikës së Kosovës

¹ Për të gjitha statistikave të mbledhura në formë tabelle, shih Shtojcën 1. Kur statistikave të dërguara nga Gjykatat Themelore ndryshonin me statistikave zyrtare të *Raportit Statistikor të Gjykatave Vjetori – 2015*, të publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, atyre të Këshillit Gjyqësor u dha përparësi. Raporti i Këshillit Gjyqësor nuk përfshin të dhëna për parashkrimin e lëndëve kundërvajtëse, ndërsa të dhënat për parashkrim që Avokati i Popullit i ka marrë drejtpërsëdrejti prej Gjykatave Themelore, në disa raste, paraqitën shifra shumë më të vogla se ç'prej në bazë të statistikave të tjera të Raportit të Këshillit Gjyqësor. Për shembull, Raporti i Këshillit Gjyqësor tregon se Gjykata Themelore e Mitrovicës kishte 64,362 lëndë të pazgjidhura në fund të vitit 2015, më shumë sesa në çdo Gjykatë tjetër të Republikës, ndërsa vetë Gjykata Themelore e Mitrovicës deklaroi se kishte vetëm pesë lëndë të parashkruara në gjithë vitin 2015, më pak sesa në çdo Gjykatë tjetër. Kjo mospërputhje ngre mundësinë se të dhënat e disa prej Gjykatave Themelore për parashkrimin e lëndëve e nënvlerësojnë numrin real të rasteve të parashkruara. Nëse po, problemi i parashkrimit, si dhe pasojat e tij të dëmshme, ka mundësi të jenë edhe më të rënda sesa tregohet në këtë Raport, i cili i merr si të mirëqena të dhënat e Gjykatave mbi këtë çështje.

Së pari, megjithëse *Ligji i 1979* parashikon disa dënime dhe masa të ndryshme në raste të kundërvajtjes, dënimi kryesor, sidomos për kundërvajtje në komunikacion rrugor, është vendosja e gjobës. Prandaj, impakti negativ për buxhetin e shtetit kur parashkruhen mijëra lëndë kundërvajtëse çdo vit, duhet të jetë i jashtëzakonshëm. Ky impakt buxhetor mund të llogaritet, përafërsisht. Siç u dëshmuva më sipër, numri i rasteve të parashkruara në fazën e ekzekutimit, në vitin 2015, ishte 32,860, ndërsa numri i rasteve të parashkruara në fazën e procedurës gjatë së njëjtës periudhë ishte 26,266. Për të qenë sa më konservatorë në llogaritjet tona, mund të supozojmë që, po të mos ishin parashkruar këto lëndë, Gjykatat Themelore do të kishin gjykuar në një pjesë të madhe prej tyre, 5,253 raste (20%) e zëmë, që gjoba u vendos gabimisht nga policët rrugorë dhe, për rrjedhojë, do të ishin liruar të gjobiturit nga përgjegjësia. Në bazë të këtij supozimi, numri i rasteve në të cilat shteti, për shkak të parashkrimit të procedurës dhe të ekzekutimit, ka humbur mundësinë e mbledhjes së gjobave në 2015, do të ishte $32,860 + 21,013 = 53,873$ gjithsej. Pastaj, le të vërejmë se Ligji Nr. 02/L-70 për Sigurinë në komunikacion rrugor, përcakton 15 € si gjobë minimale për shkelje të dispozitave të tij (shih *id.*, nenin 141, par. 6; nenin 146, par. 7; nenin 147, par. 2; nenin 148, par. 4; nenin 149, par. 2; nenin 153, par. 2; nenin 164, par. 2; nenin 168, par. 2; nenin 197, par. 2; nenin 305, par. 7; dhe nenin 363). Për të qenë përsëri konservatorë, mund të supozojmë se 53,873 gjobat e humbura kishin vlerë prej vetëm 15 € nga secila.

Edhe me këto supozime tepër konservatore, mund të konkludojmë se problemi i parashkrimit të lëndëve kundërvajtëse, vetëm gjatë vitit 2015, i ka kushtuar buxhetit të Kosovës, minimalisht, 808,095 €. Dhe, meqenëse problemi i parashkrimit ka gjasë të përkeqësohet edhe më shumë në vitet e ardhshme, atëherë edhe ky dëm në buxhetin e shtetit ka gjasë të fryhet edhe më shumë.

D. Pasoja të dëmshme të parashkrimit për respektimin e të drejtave të njeriut

1. Pasoja të dëmshme të parashkrimit për respektimin e së drejtës për jetën dhe së drejtës për sigurinë

Përveç impaktit të jashtëzakonshëm buxhetor, problemi i parashkrimit të rasteve të kundërvajtjes ka gjithashtu pasoja të dëmshme në respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (“*Kushtetuta*”).

Kushtetuta përcakton se “[s]jecili individ gëzon të drejtën për jetën” (*id.*, neni 25, par. 1) dhe se “[s]jecilit i garantohet e drejta e . . . sigurisë” (*id.*, neni 29, par. 1). Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), të drejtat e së cilës, sipas nenit 22 të *Kushtetutës*, “garantohen me këtë Kushtetutë”, përcakton se: “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj” (KEDNJ, neni 2, par. 1) dhe “[ç]dokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale” (*id.*, neni 5, par. 1). Shih gjithashtu Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 3 (“Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake”).

Për të kuptuar lidhjen mes këtyre të drejtave dhe problemit të parashkrimit, duhet t’i kushtojmë vëmendje nenit 53 të *Kushtetutës*, i cili përcakton se: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (“GJEDNJ”).

Vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së përcaktojnë qartë se çdo shtet, jo vetëm se ka obligime negative të mos i shkelë të drejtat e përcaktuara në Konventë, por ka edhe obligime pozitive të mbrojë këto të drejta nga rreziku i shkeljes nga persona të tjerë. Për shembull, në rastin *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 23452/94 (1998), par. 115, Gjykata deklaroi se “fjalja e parë e nenit 2, par. 1 [e drejta për jetën], jo vetëm i ndalon Shtetit që të marrë jetën në mënyrë të qëllimshme dhe të kundërligjshme, por gjithashtu i obligon që të ndërmarrë hapa të përshtatshëm të mbrojë jetën e personave brenda jurisdiksionit të tij”. Për më tepër, Gjykata i referohet shprehimisht “obligimit

primar [të Shtetit] që të sigurojë të drejtën e jetës duke vendosur dispozita penale efektive për të parandaluar dhe dekurajuar kryerjen e veprave kundër personit, me mbështetjen e mekanizmave policorë për parandalimin, shuarjen dhe sanksionimin e shkeljeve të dispozitave të tilla” (*id.*). Shih gjithashtu *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 22535/93 (2000), par. 85, *Kilic kundër Turqisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 22492/93 (2000), par. 62 dhe *Kontrova kundër Republikës së Kosovës*, Aplikimi Nr. 7510/04 (2004), par. 49.

Në bazë të këtyre precedentëve, Republika e Kosovës ka obligim kushtetues, sipas KEDNJ-së dhe nenit 53 të *Kushtetutës*, të sigurojë zbatimin efikas të dispozitave ligjore, përmes ekzekutimit të sanksioneve, për të parandaluar dhe dekurajuar veprat kundërvajtëse që rrezikojnë jetën dhe sigurinë e qytetarëve të Republikës, sidomos në fushën e komunikacionit rrugor. Statistikat e Policisë tregojnë se rrezikshmëria e komunikacionit rrugor është duke u rritur në mënyrë alarmante. Sipas *Raportit Vjetor të Punës së Policisë së Republikës së Kosovës* për vitin 2015, “gjatë vitit 2015 janë evidentuar 17722 aksidente, që në raport me vitin 2014 është shënuar një ngritje për 8.72%” (*id.*, f. 11). Për më tepër, “[n]gritje shënojnë të gjitha llojet e aksidenteve, si ato fatale për 5.41% [dhe] me lëndime për 8.18% . . . Nga ky numër i aksidenteve, 129 persona kanë humbur jetën, që në raport me vitin 2014 shënon një ngritje për 1.57%. Ngritjen fatkeqësisht e shënon edhe numri i personave të lënduar në komunikacionin rrugor për 9.86%” (*id.*). Shih gjithashtu “Kosovë, policia: Shtohen frikshëm aksidentet rrugore”, *Top Channel*, 25 tetor 2015.

Duke marrë parasysh numrin e lartë të vdekjeve dhe lëndimeve trupore të shkaktuara nga aksidente rrugore, si dhe rritjen e këtij numri gjatë vitit të kaluar, është e qartë se Republika e Kosovës ka “obligim primar . . . që të sigurojë të drejtën e jetës duke vendosur dispozita penale efektive për të parandaluar dhe dekurajuar [vojitje të rrezikshme], me mbështetjen e mekanizmave policorë për parandalimin, shuarjen dhe sanksionimin e shkeljeve të dispozitave të tilla”.

Mirëpo, fakti se gati 20% të rasteve të kundërvajtjes përfundojnë në parashkrim, do të thotë se vozitës të papërgjegjshëm po mbeten të padënuar dhe plotësisht të lirë të vazhdojnë sjelljet e tyre të rrezikshme nëpër rrugët e Republikës. Në këto rrethana, efekti parandalues i “sanksionimit të shkeljeve të dispozitave [ligjore]” për këta vozitës, si dhe efekti dekurajues i këtyre sanksioneve për vozitësit në përgjithësi, nuk po funksionojnë siç duhet. Për këtë arsye, parashkrimi i lëndëve kundërvajtëse, qoftë në fazën e procedurës gjyqësore qoftë në fazën e ekzekutimit të sanksioneve, jo vetëm që ka impakt të madh në buxhetin e shtetit, por edhe e pengon Republikën e Kosovës në përmbushjen e obligimit të saj “primar” për të siguruar të drejtën e jetës dhe sigurisë së qytetarëve dhe banorëve të vet, duke siguruar efektin parandalues dhe dekurajues të rregullave kundërvajtëse të komunikacionit rrugor.

2. Pasoja të dëmshme të parashkrimit për respektimin e së drejtës së pronës

Neni 46, par. 1 i *Kushtetutës* përcakton se: “E drejta e pronës është e garantuar”. Po ashtu, sipas nenit 1, par. 1 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së, “[ç]do person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij.” Kjo nuk do të thotë se vendosja e gjobave për veprat kundërvajtëse është e ndaluar në mënyrë kategorike. Përkundrazi, neni 1, par. 2 i Protokollit të Parë përcakton shprehimisht se “dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje që ato i konsiderojnë të nevojshme . . . për të siguruar pagimin e . . . gjobave”.

Mirëpo, autorizimi kushtetues për sigurimin e pagimit të gjobave nuk është pa kufi. Konventa përcakton se “[a]skush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse . . . në kushtet e parashikuara nga ligji” (KEDNJ, Protokollit i Parë, neni 1, par. 1, theks i shtuar). Në të njëjtën mënyrë, neni 55, par. 1 i *Kushtetutës* përcakton, për të gjitha të drejtat e njeriut në përgjithësi, që “[t]ë drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj” (theks i shtuar).

Sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, togfjalëshat “i parashikuar me ligj” dhe “i autorizuar me ligj”, nënkuptojnë parimin e sigurisë ligjore. Parimi i sigurisë ligjore, mes të tjerash, kërkon që privimi i një individi nga prona e tij “nuk duhet të jetë arbitrare” (*Winterwerp kundër Hollandës*, GJEDNJ, Aplikimi nr. 6301/73 (1979), par. 45, theks i shtuar). Në këtë mënyrë, togfjalëshat “e parashikuar me ligj” dhe “e autorizuar me ligj” kërkojnë që ekzekutimi i gjobave të bëhet në mënyrë jo arbitrare. Ky parim konfirmohet edhe nga *Kushtetuta*, e cila përcakton shprehimisht se “[a]skush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona” (*id.*, neni 46, par. 3).

Në bazë të këtyre parimeve, parashkrimi i rasteve të kundërvajtjes në masë të madhe, qoftë në fazën e procedurës, qoftë në fazën e ekzekutimit, paraqet shkelje të së drejtës së pronës të atyre që paguajnë gjobën sepse, në rrethanat aktuale, ku afërsisht 20% të gjobave të vendosura parashkruhen, çështja se kush e paguan dënimin dhe kush jo, bëhet plotësisht arbitrare. Le të supozojmë, si rast hipotetik, që tre persona gjobiten nga Policia për të njëjtën vepër kundërvajtëse në të njëjtën datë, por në qendra të ndryshme rajonale të Republikës. Lënda e personit të parë dëgjohej nga Gjykata Themelore përkatëse, gjoba konfirmohet nga Gjykata dhe i gjobituri e paguan gjobën pa vonesë. Lënda e personit të dytë dëgjohej gjithashtu nga Gjykata Themelore në qendrën rajonale ku banon ai dhe, njësoj si në lëndën e personit të parë, gjoba konfirmohet nga Gjykata. Mirëpo, i gjobituri në këtë rast nuk paguan gjobën me iniciativën e vet dhe, për më tepër, nuk ka adresë të saktë. Për këtë arsye, Policia nuk e gjen dot, një vit kalon dhe i gjobituri lirohet nga pagimi i gjobës për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të sanksionit. Ndërsa, lënda e personit të tretë ngelet e pashqyrtuar fare nga gjykata për më shumë se një vit, sepse Gjykata Themelore në rajonin ku banon është e mbingarkuar me lëndë kundërvajtëse. Për rrjedhojë, lënda nuk dëgjohej, parashkruhet që në fazën procedurale dhe personi i tretë, si personi i dytë, lirohet nga pagimi i gjobës së vendosur. Ky rast hipotetik tregon qartë se vuajtja e dënimit të gjobës, kur parashkrimi i rasteve të kundërvajtjes ndodh në masë të madhe ashtu si në rrethanat aktuale të Republikës së Kosovës, është arbitrare dhe, si e tillë, nuk përmbush kriteret e sigurisë ligjore. Prandaj, problemi i parashkrimit të rasteve, pengon respektimin e plotë të së drejtës së pronës për të mos u privuar nga prona në mënyrë arbitrare.

ZGJIDHJE TË MUNDSHME TË PROBLEMIT TË PARASHKRIMIT

Meqenëse problemi i parashkrimit të rasteve të kundërvajtjes paraqet jo vetëm dëm të madh në buxhetin e Republikës së Kosovës por edhe shkelje të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që autoritetet kompetente, sa më shpejt, të gjejnë një zgjidhje efikase të këtij problemi.

A. Zgjidhjet e propozuara nga Projektligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

Një burim zgjidhjesh mund të jetë Projektligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (“*Projektligji i 2016*”), i cili synon të zëvendësojë tërësisht *Ligjin e 1979* dhe të sjellë reforma të nevojshme në sistemin kundërvajtës. Ky projektligj është tashmë duke u shqyrtuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Më 9 shkurt 2016, *Projektligji i 2016* u shqyrtua në parim nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (“*Komisioni për Legjislacion*”), i cili njëzëri i rekomandoi Kuvendit që të miratojë projektligjin në parim (shih Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, e mbajtur më 9 shkurt 2016, f. 2). Duke e zbatuar rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, Kuvendi, në mbledhjen plenare të 19 shkurtit 2016, e miratoi *Projektligjin e 2016* në parim (shih Transkriptin e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 19 dhe 24 shkurt 2016, f. 46). Pastaj, më 11 mars 2016, Komisioni për Legjislacion caktoi një grup punues dhe vendosi të mbajë një dëgjim publik për *Projektligjin e 2016* më 21 mars 2016 (shih Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, e mbajtur më 11 mars 2016, f. 5). Më 21 mars 2016, siç ishte premtuar, u mbajt dëgjimi publik, në të cilin nënkryesuesja e Komisionit për Legjislacion *znj Selvije Halimi* deklaroi se “kemi vendosur që të bëjmë një grup punues i cili do të merret me amendamentimin e projektligjit dhe

gjithashtu fillimisht organizojmë një dëgjim publik” (Transkripti nga dëgjimi publik i Komisionit për Legjislacion, i mbajtur më 21 mars 2016, f. 2).

Megjithëse *Projektligji i 2016* nuk deklaron shprehimisht qëllimin e zgjidhjes së problemit të parashkrimit, dy propozime në veçanti duken si përpjekje në këtë drejtim. Një pjesë e projektligjit propozon të kalojë, nga Gjykatat Themelore tek organet administrative, kompetencën për të gjykuar një përqindje të rasteve të kundërvajtjes, ndërsa një pjesë tjetër e projektligjit propozon t’u ofrojë qytetarëve zbritje 50% të gjobës së shqiptuar nëse e paguajnë gjobën brenda afatit të vendosur.

1. Kalimi i kompetencës së gjykimit të një pjese të lëndëve kundërvajtëse nga Gjykatat Themelore në organe administrative

Siç kemi parë më sipër, Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat, përcakton që lëndët kundërvajtëse të jenë ekskluzivisht në kompetencën e Gjykatave Themelore të shtatë qendrave rajonale të Republikës së Kosovës. *Projektligji i 2016* propozon një ndryshim të madh në këtë fushë, duke përcaktuar se “[p]ër disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund të shqiptoj[ë] organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike (në tekstin e mëtejme: organi për kundërvajtje) të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje” (*id.*, neni 55, par. 4).

Për sa i përket jurisdiksionit lëndor të organeve për kundërvajtje, *Projektligji i 2016* parashikon që këto organe të kenë kompetencë për të vepruar në rast se “me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj” (*id.*, neni 56, par. 1), si dhe “sipas të gjitha kundërvajtjeve për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumë e përcaktuar saktë; për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në 500 euro; për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik gjoba deri në 1.000 euro dhe për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend” (*id.*, neni 56, par. 2, nënpar. 1-4).

Për sa i përket përbërjes së organit të kundërvajtjes që e dëgjon rastin, *Projektligji i 2016* e lë këtë si çështje relativisht të hapur: “Anëtarët e komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni janë personat zyrtar[ë] të autorizuar me shkallën përkatëse të përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës të nevojshme, nga të cilët së paku një nga anëtarët të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudence” (*id.*, neni 61, par. 2).

Vendimi i organit të kundërvajtjes, megjithatë, nuk parashikohet të jetë përfundimtar: “Kundër vendimit për kundërvajtje të cil[i]n e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ” (*id.*, neni 64, par. 1) dhe “[g]jykata kompetente që të vendosë për konfliktin administrativ[] procedurën e mbrojtjes gjyqësore e zhvillon sipas Ligjit për Konfliktet Administrative” (*id.*, neni 64, par. 4).

Sigurisht se kalimi i një pjese të madhe të lëndëve të kundërvajtjes nga Gjykatat Themelore në “organe të kundërvajtjes” do të lehtësonte problemin e parashkrimit të procedurës gjyqësore, përderisa një ndër shkaqet e këtij problemi është mbingarkesa e Gjykatave Themelore me raste të tilla. Mirëpo, fakti që këto organe nuk janë gjykata, por organe administrative, ngre menjëherë shqetësimin që një reformë e tillë bie në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Sipas nenit 31, par. 2 të *Kushtetutës*, “[ç]dokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm . . . për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”. Në mënyrë të ngjashme, KEDNJ përcakton se: “Në vendosjen e . . . çdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtë për një shqyrtim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj” (*id.*, neni 6, par. 1).

Për të dalluar nëse kalimi i kompetencave të Gjykatave Themelore, për lëndë kundërvajtëse në organe administrative paraqet shkelje të së drejtave të njeriut, duhet fillimisht të pyesim nëse, në raste të kundërvajtjes, kemi të bëjmë me “akuzë penale” në kuptimin e nenit 6 të KEDNJ-së. Nëse jo, atëherë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nuk është e aplikueshme këtu. Sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, koncepti i akuzës penale “duhet interpretuar që të ketë kuptim ‘autonom’ në kontekstin e Konventës dhe jo në bazë të kuptimit të tij në ligjet e brendshme” të një shteti (*Adolf kundër Austrisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 8269/78 (1982), par. 30). Prandaj, nuk është vendimtar fakti se, në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, veprat penale dhe veprat kundërvajtëse janë kategori të ndara. Në vend që të bazohemi në klasifikimin e veprave në ligjet e brendshme të Republikës së Kosovës, duhet të pyesim nëse, sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, një akuzë për veprë kundërvajtëse mund të cilësohet si “akuzë penale” në kontekstin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Precedentët e GJEDNJ-së tregojnë se një akuzë për veprë kundërvajtëse, edhe për një veprë të lehtë me dënim të lehtë, konsiderohet një lloj akuze penale dhe, për këtë arsye, procedura për gjykimin e veprave kundërvajtëse duhet t’u nënshtrohet kriterëve të përcaktuara në nenin 6, par. 1 të KEDNJ-së. Shih, p.sh., rastin *Öztürk kundër Gjermanisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 8544/79 (1984), par. 53-54, në të cilin Gjykata konstatoi se një kundërvajtje në komunikacion rrugor, e shoqëruar me një gjobë të vogël, konsiderohej “veprë penale” në kontekstin e nenit 6 të KEDNJ-së (“Fakti që ishte . . . një veprë kundërvajtëse që nuk ka gjasë të dëmtojë reputacionin e kryesit, nuk e heq prej fushëveprimit të nenit 6 [dhe] . . . [m]ungesa e seriozitetit të dënimit në fjalë nuk mund të largojë prej veprës natyrën e saj thelbësisht penale”).

Prandaj, duhet të pyesim nëse shqyrtimi i rasteve të kundërvajtjes nga organe administrative, siç parashikohet nga *Projektligji i 2016*, lejohet sipas nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së. Në mënyrë që të plotësojë kriteret e nenit 6, organ i kundërvajtjes duhet të jetë “tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj”.

Në këtë kontekst, kriteri më relevant është kriteri i pavarësisë: A janë organet e kundërvajtjes, siç parashikohen në *Projektligjin e 2016*, “të pavarura” në kuptimin e nenit 6, par. 1? Vendimet e GJEDNJ-së konstatojnë se koncepti i pavarësisë përbëhet nga një sërë elementesh të ndryshme: “në mënyrë që të konstatohet nëse një tribunal mund të konsiderohet ‘i pavarur’ në kontekstin e nenit 6, par. 1, duhen marrë parasysh, mes të tjerash, mënyra e emërimit të anëtarëve dhe mandati i tyre, ekzistenca e mbrojtjes nga presion i jashtëm dhe çështja nëse paraqet një dukje të pavarësisë” (*Incal kundër Turqisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 22678/93 (1998), par. 65). Pavarësia nga dega e ekzekutivit konsiderohet me rëndësi të veçantë. Shih *Belilos kundër Zvicrës*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 10328/83 (1988), par. 64.

Rasti më relevant për vlerësimin e *Projektligjit të 2016* është *Lauko kundër Slovakisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 26138/95 (1998). Aplikuesi në këtë rast ishte akuzuar për veprë kundërvajtëse, sipas Ligjit për Kundërvajtje të Slovakisë (*id.*, par. 12). Në bazë të këtij ligji, autoritetet përgjegjëse për gjykimin e rastit në shkallën e parë dhe të dytë ishin, përkatësisht, zyra administrative në nivelin komunal dhe ajo në nivelin rajonal (*id.*, par. 35). Të dyja vendosën kundër aplikuesit, duke e dënuar me një gjobë (*id.*, par. 13-14).

Gjykata konstatoi se procedura e gjykimit të rastit nuk kishte përmbushur kriterin e pavarësisë të përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së. Fillimisht, Gjykata vërejti se zyrat komunale dhe rajonale “janë të ngarkuara me kryerjen e administrimit shtetëror nën kontrollin e qeverisë” dhe se “emërimi i krerëve të këtyre trupave kontrollohet nga ekzekutivi” (*id.*, par. 64). Në bazë të këtyre elementeve, Gjykata konkludoi se “mënyra e emërimit të zyrtarëve të zyrave komunale dhe rajonale, bashkë me mungesën e çdolloj sigurie nga presionet e jashtme dhe çdolloj dukjeje të pavarësisë, tregon qartazi se

këta trupa nuk mund të konsiderohen ‘të pavarura’ nga ekzekutivi brenda kuptimit të nenit 6, par. 1 të Konventës” (*id.*).

Për të njëjtat arsye, as organet e kundërvajtjes të parashikuara në *Projektligjin e 2016*, nuk plotësojnë kriterin e pavarësisë. Njësoj si në rastin *Lauko*, organet e kundërvajtjes do “jenë të ngarkuara me kryerjen e administrimit shtetëror”. Shih *Projektligjin e 2016*, neni 55, par. 4 (“procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund të shqiptoj[ë] organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike . . . të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje”, theks i shtuar). Në këtë mënyrë, *Projektligji i 2016* bën të qartë se organi i kundërvajtjes është pjesë e administratës shtetërore me përgjegjësinë e zbatimit të ligjit. Prandaj, organi i kundërvajtjes jo vetëm se nuk do të jetë i pavarur nga ekzekutivi, por do të jetë pjesë përbërëse e ekzekutivit. Njësoj si në rastin *Lauko*, pra, “mungesa e çdolloj sigurie nga presionet e jashtme dhe çdolloj dukjeje të pavarësisë tregon qartazi se [organet e kundërvajtjes] nuk mund të konsiderohen ‘të pavarura’ nga ekzekutivi brenda kuptimit të nenit 6, par. 1 të Konventës” (*Lauko*, GJEDNJ, *op. cit.*, par. 64).

Mirëpo, me gjithë dështimin e organeve të kundërvajtjes që të plotësojë kriterin e pavarësisë sipas nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së, “besimi i ndjekjes dhe dënimit të kundërvajtjeve tek autoritetet administrative nuk është në kundërshtim me Konventën”, të paktën jo më vete. Nëse organi i kundërvajtjes dështon të plotësojë kriteret e nenit 6, par. 1, atëherë mjafton që i pandehuri “të ketë mundësi të kontestojë . . . vendimin kundër tij përpara një tribunali që ofron garancitë e nenit 6” (*Lauko*, GJEDNJ, *op. cit.*, par. 64). I njëjti qëndrim u pohua nga Gjykata në rastin *Öztiürk*, GJEDNJ, *op.cit.*, par. 56 (“Duke marrë parasysh numrin e lartë të kundërvajtjeve, sidomos në fushën e komunikacionit rrugor, një Shtet Kontraktues mund të ketë arsye të mirë për të lehtësuar gjykatat e tij nga puna e ndjekjes dhe dënimit. Besimi i ndjekjes dhe dënimit të kundërvajtjeve tek autoritetet administrative nuk është në kundërshtim me Konventën, me kusht që personi në fjalë ka mundësi të kontestojë çdo vendim kundër tij përpara një tribunali që ofron garancitë e nenit 6”, theks i shtuar).

Prandaj, pyetja kyçe për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kalimit të kompetencave të gjykimit tek organet e kundërvajtjes është, a mund të kontestohet një vendim i organit të kundërvajtjes “përpara një tribunali që ofron të gjitha garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së”? Siç u përmend më sipër, *Projektligji i 2016* përcakton se “[k]under vendimit për kundërvajtje të cil[i]n e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ” (*id.*, neni 64, par. 1) dhe “[g]jykata kompetente që të vendosë për konfliktin administrativ[] procedurën e mbrojtjes gjyqësore e zhvillon sipas Ligjit për Konfliktet Administrative” (*id.*, neni 64, par. 4).

Në mënyrë që gjykata kompetente për vendosjen e konfliktit administrativ të plotësojë të gjitha kushtet e nenit 6, ajo, sipas GJEDNJ-së duhet të ketë “jurisdikcion të plotë”, duke përfshirë “të drejtën për të anuluar, vendimin e trupit të shkallës më poshtë, në të gjitha aspektet, për sa i përket çështjeve faktike dhe ligjore” (*Schmautzer kundër Austrisë*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 15523/89 (1995), par. 36). Fatkeqësisht, sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata nuk e ka këtë të drejtë. Përkatësisht, “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative” (*id.*, neni 43, par. 1, theks i shtuar). Prandaj, megjithëse gjykata mund të anulojë aktin administrativ nëse “nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike” (*id.*, neni 43, par. 2), prapëseprapë ajo duhet të marrë si të mirëqena faktet e vërtetuara në shkallën e parë. Vetëm konkluzionin në bazë të këtyre fakteve mund ta vërë në dyshim, por jo faktet më vete. Edhe më keq, *Projektligji i 2016* përcakton se “në padi nuk mund të theksohen faktet e reja dhe të propozohen prova të reja, [edhe] nëse paditësi gjen se me siguri se pa fajin e tij nuk ka qenë e mundshme që t’i propozojë në procedurë” (*id.*, 66, par. 1, nënpar. 3).

Duke marrë parasysh këto elemente, gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë kundër organit të kundërvajtjes nuk mund të thuhet se ka “jurisdikcion të plotë”, duke përfshirë “të drejtën për të

anuluar, në të gjitha aspekte, për sa i përket çështjeve faktike dhe ligjore, vendimin e trupit të shkallës më poshtë” (*Schmautzer kundër Austrisë*, GJEDNJ, *op. cit.*, par. 36). Në rastin *Schmautzer*, Gjykata Administrative e Austrisë, njësoj siç parashikohet në *Projektligjin e 2016*, kishte pasur të drejtë të anulojë vendimin administrativ nëse trupi administrativ “ka konstatuar fakte që, në një aspekt të rëndësishëm, bie në kundërshtim me dosjen e rasti” ose “faktet kërkojnë hulumtime të mëtejshme mbi një pikë të rëndësishme” (*id.*, par. 17). Megjithatë, GJEDNJ prapëseprapë konkludoi se kishte shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse Gjykata Administrative e Austrisë “ishte i kufizuar nga gjetjet faktike të autoriteteve administrative” dhe “nuk kishte të drejtë vetë të marrë dëshmi, as të konstatojë fakte, as të marrë parasysh çështje të reja” (*id.*, par. 32). Për të njëjtat arsye, gjykata kompetente për shqyrtimin e vendimeve të organit të kundërvajtjes, e cila, siç parashikohet në *Projektligjin e 2016*, nuk ka të drejtë vetë të marrë dëshmi, as të konstatojë fakte, as të marrë parasysh çështje të reja, nuk mund të konsiderohet tribunal me jurisdiksionin e plotë mbi të gjitha çështjet faktike dhe ligjore.

Për këtë arsye, kalimi i kompetencave për gjykimin e lëndëve kundërvajtëse nga Gjykatat Themelore në organet e kundërvajtjes, edhe pse mund të lehtësojë problemin e parashkrimit të procedurës, paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Një kalim i tillë i kompetencave nga gjyqësori në administratën shtetërore mund të bëhet vetëm nëse i pandehuri ka mundësi të kontestojë vendimin e trupit administrativ përpara një tribunali që plotëson kriteret e nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së dhe që ka jurisdiksionin e plotë mbi të gjitha çështjet faktike dhe ligjore. *Projektligji i 2016* nuk e siguron një mundësi të tillë.

2. Ofrimi i zbritjes 50% të gjobës së shqiptuar në rast të pagimit brenda afatit të vendosur nga Gjykata ose organi administrativ

Krijimi i organit administrativ të kundërvajtjes e ka për qëllim lehtësimin e ngarkesës së gjykatave dhe, rrjedhimisht, uljen e numrit të lëndëve të parashkruara në fazën e procedurës. Ndërsa, ofrimi i zbritjes 50% të gjobës së shqiptuar për ata që paguajnë brenda afatit, e ka për qëllim rritjen e numrit të gjobave të paguara dhe, rrjedhimisht, uljen e numrit të rasteve të parashkruara në fazën e ekzekutimit.

Sigurisht se, me ofrimin e zbritjes 50%, do të mund të arrihet ulja e numrit të rasteve të parashkruara, të paktën deri në një farë mase. Mirëpo, rreziku kryesor i një zgjidhjeje të tillë është që sasia e parave që do të humbeshin si rezultat i zbritjes 50% të gjobave, mund të tejkalojë sasinë e parave që do të fitoheshin si rezultat i rritjes së numrit të gjobëpaguesve. Në këtë rast, zbritja 50% jo vetëm që nuk do të ndihmonte buxhetin e shtetit, por do ta dëmtonte edhe më shumë.

Sa janë gjasat që kjo zgjidhje do të sjellë përmirësime në buxhet? Matematikisht, nëse mbajmë konstante vlerën e gjobave të shqiptuara, numri i të gjobiturve që paguajnë gjobën brenda afatit do të duhej të paktën të dyfishohej, në mënyrë që fitimet nga rritja e numrit të gjobëpaguesve të kompensojë për humbjet që do të rezultonin nga fakti që secili gjobëpagues do të paguante vetëm 50% të gjobës së shqiptuar.

Nëse nuk e mbajmë konstante vlerën e gjobave të shqiptuara, ka një mënyrë tjetër në të cilën fitimet do të mund të tejkalonin humbjet: ata gjobëpagues që nxiten për të paguar gjobat brenda afatit ka mundësi të kenë gjoba të shqiptuara që janë më të larta sesa mesatarja. Në këtë rast, edhe nëse numri i gjobëpaguesve nuk dyfishohet, fitimet nga rritja e numrit të gjobëpaguesve prapëseprapë do të mund të tejkalonin humbjet, për shkak se më shumë persona me gjoba të larta do të shtyheshin të paguanin. Këtë mund ta shpresojmë, të paktën.

Megjithatë, kemi mjaft bazë për të qenë skeptikë për mundësinë që numri i gjobëpaguesve do të rritej më shumë se dyfish, ose që mjaft persona me gjoba të larta do të nxiteshin të paguajnë. Arsyeja është se afati aktual për parashkrimin e gjobave dhe dënimeve të tjera, sipas *Ligjit të 1979*, është tepër i shkurtër: një vit pas datës kur aktvendimi për kundërvajtje merr formën e prerë (shih *id.*, neni 28, par. 1), madje, *Projektligji i 2016* e lë këtë afat të pandryshuar. Shih nenin 43, par. 1 (“Sanksioni i

shqiptuar i kundërvajtjes nuk mund të ekzekutohe[t] nëse nga data kur vendimi mbi kundërvajtjen ka marrë formën e prerë ka kaluar një (1) vit”).

Me një afat kaq të shkurtër të parashkrimit, të gjobiturit kanë shumë pak nxitje për të paguar gjobën e shqiptuar, sidomos nëse kanë gjoba të larta, edhe duke marrë parasysh zbritjen që do të mund ta fitonin sipas reformës së propozuar. Kemi parë më sipër që numri i rasteve të parashkruara në vitin 2015, në fazën e ekzekutimit, ishte 32,860, ndërsa janë pranuar gjithsej 96,848 urdhëresa për ekzekutimin e vendimeve kundërvajtëse. Në bazë të këtyre statistikave, të cilat tregojnë sa shumë pengesa ka në procesin e ekzekutimit të sanksioneve kundërvajtëse, të gjobiturit më të papërgjegjshëm thjesht do të prisnin derisa të parashkruheshin gjobat e tyre, duke e ditur se Policia ka shumë pak gjasë që t'i kapë brenda afatit. Në këtë mënyrë, ata do të merrnin zbritje jo vetëm 50% por 100%, ndërsa të gjobiturit e ndërgjegjshëm, të cilët do të kishin paguar edhe 100% të gjobës në sistemin aktual, tani do të paguanin vetëm 50% të gjobës së tyre në sistemin e themeluar nga *Projektligji i 2016*.

Për këto arsye, Avokati i Popullit konsideron se zbritja 50% e gjobave të shqiptuara në rast të pagimit brenda afatit, nuk është zgjidhje e duhur e problemit të parashkrimit të ekzekutimit. Një zgjidhje e tillë ka rrezik të shkaktojë më shumë dëm në buxhetin e shtetit sesa edhe vetë problemi për të cilin pretendon të jetë zgjidhje.

B. Zgjatja e afateve të parashkrimit

Për arsyet e lartpërmendura, dy zgjidhjet e propozuara në *Projektligjin e 2016* për lehtësimin e problemit të parashkrimit janë mjaft problematike, njëra për arsye se paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe tjetra për arsye se rrezikon të ketë impakt negativ edhe më të madh në buxhetin e shtetit.

Për të arritur tek një zgjidhje më e përshtatshme e problemit të parashkrimit, duhet të kuptojmë më saktë shkaqet e këtij problemi. Në rastin e parashkrimit të procedurës, shkak kryesor është numri jo i mjaftueshëm i gjyqtarëve në krahasim me numrin e lëndëve kundërvajtëse. Për shkak të mbingarkesës së gjykatave, gjyqtarët e kanë të pamundur të nisin procedurën e të gjitha rasteve brenda afatit njëvjeçar pas kryerjes së kundërvajtjes, si dhe të përfundojnë të gjitha këto raste brenda afatit dyvjeçar. Problemi i mbingarkesës së gjykatave, si dhe lidhja e tij me problemin e parashkrimit të lëndëve kundërvajtëse, ka një histori të gjatë dhe është diskutuar dhe stërdiskutuar nëpër raporte, lajme dhe tryeza të shumta gati çdo vit. Shih, p.sh., *Raportin Mujor – qershor 2009*, Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), f. 3 (“Vonesat e zgjatura në trajtimin e lëndëve . . . mund të çojë në parashkrim të lëndëve, posaçërisht në lëndët që përfshijnë kundërvajtje, ku afati i parashkrimit është relativisht i shkurtër”); *Raportin Vjetor Nr. 14 – 2014*, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, f. 33 (“Mbingarkesa e gjykatave me lëndë të vjetra të pazgjadhura dhe vonesa në trajtimin e lëndëve të reja . . . tash sa vjet po e rëndojnë punën e gjyqësorit në Kosovë”); *Raportin e Monitorimit të Gjykatave – 2014*, BIRN Kosovë, f. 34 (“Si pasojë e mungesës së gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesional[ë] shkaktohet . . . vjetërsimi/parashkrimi i lëndëve”); “Mungesa e gjykatësve rrit numrin e lëndëve në gjykatat e Kosovës”, *Koha Ditore*, 14 maj 2015 (“Numri i lëndëve të pazgjadhura në Gjykatat e Kosovës, vazhdon të jetë i lartë dhe kjo siç thuhet është si pasojë e mungesës së gjykatësve”).

Po ashtu, edhe shkaqet e parashkrimit të ekzekutimit janë të ditura: numri jo i mjaftueshëm i stafit përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si dhe mungesa e adresave të sakta në Kosovë, e bëjnë të vështirë ekzekutimin e të gjitha vendimeve brenda afatit njëvjeçar në raste të kundërvajtjes. Shih, p.sh. *Raportin Vjetor Nr. 14 – 2014*, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, f. 132-33 (“Shkaqet të cilat ndikojnë në shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, sipas

KGJK-së, qëndrojnë në numrin e vogël të bashkëpunëtorëve për ekzekutim dhe mungesa e adresave të sakta në Kosovë”).

Shkaqet e lartpërmendura tregojnë se problemi i parashkrimit të lëndëve kundërvajtëse, edhe në fazën e procedurës, edhe në fazën e ekzekutimit, do të mund të zgjidhej nëse Gjykatat Themelore dhe degët e Policisë do të kishin më shumë kohë për të bërë punën e vet. Përkatësisht, me afate të zgjata, problemi i parashkrimit të procedurës do të lehtësohej sepse gjyqtarët do të kishin më shumë kohë për të shqyrtuar lëndët e shumta që vijnë nëpër dyer. Po ashtu, degët e Policisë, do të mund të ekzekutonin më shumë urdhëresa të ardhura nga gjykatat po të kishin afat më të gjatë para se të parashkruheshin këto urdhëresa. Sigurisht se zgjidhja më ideale, afatgjatë, do të ishte të shtohet numri i gjyqtarëve dhe anëtarëve të stafit të Policisë, si dhe të sistematizohen adresat në mbarë territorin e Republikës. Por, deri atëherë, zgjatja e afateve të parashkrimit duket si zgjidhja më efikase e problemit, duke marrë parasysh shkaqet e tij.

Mirëpo, duhet të vlerësojmë këtë zgjidhje jo vetëm nga ana e efikasitetit të tij por edhe nga ana e të drejtave të njeriut. Mund të fillojmë duke kujtuar se problemi i parashkrimit ka pasoja të dëmshme jo vetëm në buxhetin e shtetit, por edhe në respektimin e plotë të së drejtës për jetën dhe sigurinë, si dhe të së drejtës për pronë. Por, nga ana tjetër, duhet të marrim parasysh se afatet e parashkrimit, sidomos afatet e parashkrimit të procedurës, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut. Afatet e parashkrimit të procedurës zakonisht justifikohen në bazë të së drejtës së sigurisë juridike të të pandehurit, përkatësisht e drejta për të mos qenë i rrezikuar *ad infinitum* nga mundësia e ndjekjes penale. Afatet e parashkrimit vendosin një datë të sigurt kur kjo mundësi mbyllet për gjithmonë, duke garantuar kështu sigurinë juridike për të pandehurin. Një tjetër justifikim i zakonshëm për vendosjen e afateve të parashkrimit është që kujtesa e dëshmitarëve prishet gradualisht me kalimin e kohës, duke rrezikuar edhe gjykimin e drejtë. Shih Yair Listokin, “Efficient Time Bars? A New Rationale for the Existence of Statutes of Limitations in Criminal Law”, 31 J. Legal Stud. 99, 99-100 (2002). Për këto arsye, vendosja e afateve të arsyeshme të parashkrimit të procedurës është e domosdoshme për respektimin e plotë të së drejtës së të pandehurve për gjykim të drejtë. Prandaj, afatet e parashkrimit nuk mund të zgjaten pa fund. Zgjatja e këtyre afateve duhet të respektojë kufij të arsyeshëm. Por si mund të përcaktohen këta kufij të arsyeshëm? Dhe, më e rëndësishme, a ka hapësirë brenda këtyre kufijve për zgjatjen e afateve të parashikuara në *Ligjin e 1979* dhe *Projektligjin e 2016*?

Përgjigjja e këtyre pyetjeve duhet të mbështetet në një analizë të saktë të doktrinës së “*margin of appreciation*”, nëpërmjet së cilës GJEDNJ ka njohur njëfarë hapësire në të cilën çdo shtet mund të vlerësojë se si do të ishte mënyra më e përshtatshme e respektimit të të drejtave të njeriut duke marrë parasysh kontekstin specifik të vendit të vet. Varësisht prej rastit, kjo hapësirë mund të jetë më e gjerë ose më e ngushtë në fusha të ndryshme. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, *margin of appreciation* që gëzon një shtet, njihet si veçanërisht e gjerë kur, në një fushë të caktuar,

- (1) “Shteti duhet të balancojë të drejta të Konventës në konkurrencë” me njëra-tjetrën (*Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 6339/05 (2007), par. 77).
- (2) “[R]asti ngre çështje të ndërlikuara dhe vendime të strategjisë sociale: njohja e drejtpërdrejtë e shoqërisë së tyre dhe nevojave të saj, nga ana e autoriteteve, do të thotë se ato [autoritete] janë, në parim, në pozitë më të mirë . . . për të vlerësuar se çfarë është në interesin e publikut” (*Dickson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 44362/04, (2007), par. 78).
- (3) “[N]uk ka konsensus mes Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës” (*id.*).

Të gjitha këto kritere na çojnë në konkluzionin se ka mjaft hapësirë për zgjatjen e afateve të parashkrimit të përcaktuara në *Ligjin e 1979* dhe *Projektligjin e 2016*.

Së pari, siç kemi vënë në dukje, këtu kemi të bëjmë me balancimin e të drejtave të njeriut në konkurrencë me njëra-tjetrën. Nga njëra anë, zgjidhja e problemit të parashkrimit në lëndë

kundërvajtëse është e domosdoshme për respektimin e plotë të së drejtës për jetën dhe sigurinë dhe së drejtës për pronë gjë që mbështet vendosjen e afateve më të gjata të parashkrimit. Por nga ana tjetër, këto të drejta duhet të balancohen me të drejtën e të pandehurve për gjykim të drejtë, e cila paraqet një arsye për të vendosur afate më të shkurtra të parashkrimit. Në raste të tilla, kur duhet të balancohen të drejta në konkurrencë, shteti gëzon hapësirë më të gjerë për të vendosur atë balancë në bazë të rrethanave dhe nevojave të veta. Në rrethanat e Republikës së Kosovës, në të cilën problemi i parashkrimit të rasteve të kundërvajtjes ka marrë përmasa të skajshme, zgjatja e afateve të parashkrimit u përgjigjet nevojave të veçanta të shtetit dhe, për këtë arsye, është zgjidhje e arsyeshme.

Së dyti, problemi i parashkrimit “ngre çështje të ndërlikuara dhe vendime të strategjisë sociale” (Dickson, GJEDNJ, *op. cit.*, par. 78). Vetë fakti se Republika vazhdimisht po përballohet me problemin e parashkrimit që shumë vjet, tregon se ky problem përbën një çështje të ndërlikuar. Përballë kësaj çështjeje të ndërlikuar, vendimi për të zgjatur afatet e parashkrimit do të ishte një “vendim i strategjisë sociale” për zgjidhjen e problemit. Prandaj, hapësira e shtetit të Kosovës për të marrë këtë vendim është e gjerë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Së treti, një studim krahasues i kryer nga Avokati i Popullit tregon qartë se “nuk ka konsensus mes Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës” (*id.*) për sa i përket afateve të parashkrimit, qoftë të procedurës, qoftë të ekzekutimit.² Afati i parashkrimit për nisjen e procedurës kundërvajtëse, në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës, Malta është i shkurtër (tre muaj pas kryerjes së veprës), kurse në një shtet tjetër, Rusia, është shumë më i gjatë (deri në gjashtë vjet). Po ashtu, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit në shtetet e Këshillit të Evropës është më së paku dy muaj (Armenia dhe Gjeorgjia) dhe më së shumti dhjetë vjet (Finlanda, Franca, Holanda dhe Luksemburgu) pas kryerjes së veprës. Për sa i përket ekzekutimit të dënimit, ka disa vende (Letonia, Lituania dhe Ukraina) që përcaktojnë një afat tremujor të parashkrimit pas vendosjes së dënimit, ndërsa një vend tjetër (Malta) përcakton shprehimisht që ekzekutimi i dënimeve të mos parashkruhet kurrë. Mungesa e një konsensusi të qartë mes shteteve të Këshillit të Evropës mbi çështjen e afateve të parashkrimit, do të thotë se Republika e Kosovës, e cila, sipas Ligjit të 1979 si dhe Projektligjit për Kundërvajtjet, ka afate relativisht të shkurtra (një vit për nisjen e procedurës gjyqësore, dy vjet për përfundimin e procedurës gjyqësore dhe një vit për ekzekutimin e dënimit), gëzon mjaft hapësirë për të zgjatur këto afate, me qëllim që të lehtësohet puna e gjykatave dhe Policisë dhe, në këtë mënyrë, të zgjidhë, të paktën deri një farë mase, problemin e parashkrimit.

KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

A. Konstatimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se:

- (1) Problemi i parashkrimit të procedurës gjyqësore dhe të ekzekutimit të dënimeve në raste të kundërvajtjes ekziston në masë të madhe në Republikën e Kosovës dhe ka gjasë të përkeqësohet dukshëm në vitet e ardhshme;
- (2) Problemi i parashkrimit shkakton dëm të madh në buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (3) Problemi i parashkrimit paraqet shkelje të së drejtës për jetën dhe sigurinë, sipas neneve 25 dhe 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 2 dhe 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (4) Problemi i parashkrimit paraqet shkelje të së drejtës së pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 1 të Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

² Për rezultatet e plota të studimit krahasues, shih Shtojcën 2.

- (5) Kalimi i kompetencave për gjykimin e disa lëndëve kundërvajtëse nga Gjykatat Themelore në organe administrative, në mënyrën e parashikuar nga Projektligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- (6) Zbritja 50% e gjobave të shqiptuara në rast të pagimit brenda afatit siç parashikohet në Projektligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 30, par. 3. ka rrezik të dëmtojë buxhetin e Republikës së Kosovës edhe më shumë sesa problemi i parashkrimit;
- (7) Zgjatja e afateve të parashkrimit të procedurës dhe të ekzekutimit do të ishte zgjidhje efikase e problemit të parashkrimit dhe nuk do të paraqiste shkelje të të drejtave të njeriut, sipas doktrinës së “margin of appreciation” të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që:

- (1) Të ndryshohet Projektligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje në mënyrë që të mos kalohen nga Gjykatat Themelore në organe administrative kompetencat për gjykimin e lëndëve kundërvajtëse ose (b) të ndryshohet Projektligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje në mënyrë që të sigurohet mundësia e kontestimit të vendimeve të organeve të kundërvajtjes përpara një tribunali që plotëson kriteret e nenit 6, par. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që ka jurisdiksion të plotë për të shqyrtuar të gjitha çështjet faktike dhe ligjore;
- (2) Të hiqet në tërësi neni 30, par. 3 i Projektligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje: “Në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar”;
- (3) Të zgjaten afatet e parashkrimit të procedurës gjyqësore dhe të ekzekutimit të dënimeve në raste të kundërvajtjes, deri në atë pikë që Kuvendi i Republikës së Kosovës vlerëson të jetë e nevojshme për të lehtësuar, në masë të konsiderueshme, problemin e parashkrimit, pa tejkalluar kufijtë e arsyeshëm sipas praktikës së shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,
 Hilmi Jashari
 Avokat i Popullit

Kopje: Z. Nehat Idrizi, Kryetar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

- Z. Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

SHTOJCA 1

Statistikat për parashkrimin e procedurës gjyqësore dhe ekzekutimit të dënimeve në raste të kundërvajtjes

STATISTIKAT E URDHËRESAVE TË GJYKATAVE THEMELORE NËPËR STACIONET POLICORE PËR PERIUdhËN

1 JANAR - 31 DHJETOR 2015

STATISTIKAT E LËNDËVE KUNDËRVAJTËSE NË GJYKATAT THEMELORE TË KOSOVËS

PËR PERIUdhËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2015

LËNDËT KUNDËRVAJTËSE	LËNDË TË PRANUARA	LËNDË TË ZGJIDHURA	LËNDË TË PAZGJIDHURA	LËNDË TË PARASHKRUARA	LËNDË NGA VITI 2014 E MË PARË
GJYKATAT THEMELORE					
GJ.TH. PRISHTINË	105707	99818	53888	11860	47999
GJ.TH. PRIZREN	56085	45794	20444	105	10153
GJ.TH. PEJË	37102	34037	6471	3470	3406
GJ.TH.MITROVICË	28142	22285	64362	5	58505
GJ.TH. GJILAN	34006	36295	8162	830	10451
GJ.TH. FERIZAJ	37597	41604	37846	504	41853
GJ.TH. GJAKOVË	28523	26027	19914	9492	17418
GJITHSEJ	327162	305860	211087	26266	189785

LËNDËT KUNDËRVAJTËSE	URDHËRESA TË PRANUARA	URDHËRESA TË EKZEKUTUARA	URDHËRESA TË PAEKZEKUTUARA	URDHËRESA TË PARASHKRUARA
GJYKATAT THEMELORE				
GJ.TH. PRISHTINË	19666	6151	36529	7930
GJ.TH. PRIZREN	14000	2336	6159	5505
GJ.TH. PEJË	13506	7649	7308	2728
GJ.TH.MITROVICË	5976	2951	11584	2244
GJ.TH. GJILAN	21603	10519	15136	4440
GJ.TH. FERIZAJ	7924	2237	5057	3629
GJ.TH. GJAKOVË	14173	5173	10758	6384
GJITHSEJ	96848	37016	92531	32860

SHTOJCA 2

Studimi krahasues mbi afatet e parashkrimit në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës

Ky studim krahasues mbledh të dhëna për afatet e parashkrimit, në raste të kundërvajtjes, nga 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Në rezultatet e studimit vërehet se çdo shtet ka mënyrën e vet të trajtimit të veprave kundërvajtëse. Disa shtete konsiderojnë kundërvajtjet si kategori të ndarë nga vepra penale, duke i rregulluar me ligj të veçantë. Disa shtete të tjera i shikojnë si një lloj i veprës penale dhe, për rrjedhojë, i përfshijnë në kodet e tyre penale, bashkë me vepra më të rënda. Ka edhe shtete që nuk e njohin fare kategorinë e kundërvajtjeve, megjithëse, edhe në këto shtete, ekziston një grup veprash më të lehta që janë të dënueshme vetëm me gjobë dhe, në këtë mënyrë, janë të ngjashme me kundërvajtjet, edhe pse nuk e kanë këtë emër shprehimisht. Ky diversitet mes shteteve të Këshillit të Evropës e ka bërë më të vështirë, por jo të pamundur, krahasimin e afateve të parashkrimit mes këtyre shteteve.

Në Andorrë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës, për kundërvajtje penale (Kodi Penal, neni 81, par. d). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 84).

Në Armeni, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është është dy muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Kundërvajtjeve Administrative, neni 37). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre muaj ose një vit pas vendosjes së dënimit, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (*id.*, neni 302).

Në Austri, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës, për vepra penale administrative (Kodi Penal Administrativ, neni 31, par. 1). Afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është tre vjet (*id.*, neni 31, par. 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet pas vendimit (*id.*, neni 31, par. 3).

Në Azerbaixhan, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy muaj ose një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Kodi i Kundërvajtjeve Administrative, neni 36, par. 1).

Në Belgjikë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Procedurës Penale, Titulli Preliminar, neni 21). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e vendimit është një vit pas vendosjes së dënimit (Kodi Penal, neni 93).

Në Bosnjë-Hërcegovinë (Kantoni i Sarajevës), afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet, tre vjet ose pesë vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Ligji për Kundërvajtje, neni 50). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dyfishi i afateve përkatëse të parashkrimit për nisjen e procedurës (*id.*, neni 52). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 51).

Në Bulgari, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit, dy vjet ose pesë vjet pas kryerjes së veprës, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Ligji për Kundërvajtje administrative dhe sanksione, neni 34, par. 1 dhe 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit, për veprat e dënuara me gjobë (*id.*, neni 82, par. 1, nënpar. 1).

Në Danimarkë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës, për veprat që dënohen me më pak se 1 vit burgim (Kodi Penal, neni 93, par. 1, nënpar. 1). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është pesë vjet pas vendosjes së dënimit, për gjobat që nuk tejkalojnë 10,000 Dkr. (*id.*, neni 97a, par. 1, nënpar. 1).

Në Estoni, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është dy ose tre vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Kodi Penal, neni 81, par. 3). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 82, par. 1, nënpar. 3).

Në Finlandë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës, për veprat që dënohen me gjobë (Kodi Penal, kapitulli 8, pjesa 1, par. 2, nënpar. 4). Afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është dhjetë vjet pas kryerjes së veprës, për veprat që dënohen me gjobë (*id.*, kapitulli 8, pjesa 6, par. 2, nënpar. 3). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është pesë vjet pas vendosjes së dënimit, për veprat që dënohen me gjobë të lehtë (*id.*, kapitulli 8, pjesa 13, par. 3).

Në Francë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Procedurës Penale, neni 9). Afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është dhjetë vjet pas kryerjes së veprës ose hapit të fundit të ndërmarrë në procedurë (*id.*, neni 7). Afati për ekzekutimin e dënimit është tre vjet pas vendosjes së dënimit (Kodi Penal, neni 133-4).

Në Gjeorgji, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është dy muaj pas kryerjes së veprës, për kundërvajtje administrative (Kodi i kundërvajtjeve administrative, neni 38, par. 1). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është gjashtë muaj pas vendimit, për kundërvajtje administrative (*id.*, neni 287).

Në Gjermani, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj, një vit, dy vjet, ose tre vjet pas kryerjes së kundërvajtjes administrative, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Kodi i Kundërvajtjeve administrative, neni 31, par. 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet ose pesë vjet për gjobat e shqiptuara për kundërvajtje administrative, varësisht prej sasisë së gjobës (*id.*, neni 34, par. 2).

Në Greqi, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi Penal, neni 111, par. 4). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit, për veprat e dënuar me gjobë (*id.*, neni 114).

Në Hollandë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është tre vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi Penal, neni 70, par. 1, nënpar. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dhjetë vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*, neni 72, par. 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 76, par. 2).

Në Hungari, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji II për Kundërvajtje, neni 6, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës (*id.*, neni 6, par. 6). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 24, par. 1).

Në Irëlandë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për gjykatat kundërvajtëse, neni 10).

Në Islandë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës, për vepra të dënuara me gjobë (Kodi Penal, neni 81, par. 1). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit me gjobë është tre vjet pas vendosjes së gjobës (*id.*, neni 83, par. 1).

Në Itali, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është katër vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi Penal, neni 157). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dhjetë vjet pas vendosjes së dënimit, për veprat e dënuara me gjobë (*id.*, neni 172).

Në Kroaci, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për Kundërvajtje, neni 13, par. 1). Afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është katër vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*, neni 13, par. 6). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 14, par. 5).

Në Letoni, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është katër muaj pas kryerjes së kundërvajtjes administrative (Kodi i Kundërvajtjeve Administrative, neni 37). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre muaj pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 296).

Në Lihtenshtajn, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës, për veprat e dënuara me gjobë (Kodi Penal, neni 57). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është pesë vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 59).

Në Lituani, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës, për kundërvajtje administrative (Kodi i Kundërvajtjeve Administrative, neni 35). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre muaj pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 308).

Në Luksemburg, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Procedurës Penale, neni 640). Afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është dhjetë vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse ose aktit të fundit të procedurës (*id.*, neni 637). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendimit (Kodi Penal, neni 93).

Në Mal të Zi, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për Kundërvajtje, neni 59, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*, neni 59, par. 6). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 60, par. 1).

Në Maqedoni, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për Kundërvajtje, neni 42, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*, neni 42, par. 7). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 43, par. 1).

Në Maltë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është tre muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi Penal, neni 688, par. f). Shprehimisht, nuk ka afat të parashkrimit për ekzekutimin e dënimit (*id.*, neni 687, par. 1).

Në Moldavi, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është tre muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Kundërvajtjeve, neni 30, par. 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 30, par. 5).

Në Monako, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Procedurës Penale, neni 14). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 631).

Në Mbretërinë e Bashkuar, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për gjykatat e magjistratit, neni 127, par. 1).

Në Norvegji, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet për vepra të dënuara me gjobë (Kodi Penal, neni 67). Afati për ekzekutimin e dënimit është dhjetë vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 74).

Në Poloni, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse

(Kodi i Kundërvajtjeve, neni 45, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 45, par. 3).

Në Portugali, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit, tre vjet ose pesë vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Kodi i Kundërvajtjeve, neni 27). Afatet përkatëse të parashkrimit për përfundimin e procedurës janë 1.5 herë më të gjata sesa afatet për nisjen e procedurës (*id.*, neni 28, par. 3). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një ose tre vjet pas vendosjes së dënimit, varësisht prej sasisë së gjobës (*id.*, neni 29, par. 1).

Në Qipro, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës që dënohet deri në tre muaj burgim ose deri në 25 paund, ose të dyja bashkë (Kodi i Procedurës Penale, neni 88).

Në Republikën Çeke, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për Kundërvajtje, neni 20, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dy vjet (*id.*, neni 20, par. 3).

Në Romani, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse të dënuar me gjobë (Ordinanca për regjimin ligjor të kundërvajtjeve, neni 13, par. 1). Afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse të dënuar me gjobë (*id.*, neni 13, par. 3). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së gjobës (*id.*, neni 14, par. 2).

Në Rusi, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy muaj, tre muaj, dy vjet ose gjashtë vjet, për veprat kundërvajtëse, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Kodi i Kundërvajtjeve Administrative, neni 4.5, par. 1). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 31.9, par. 1).

Në San Marino, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj për veprat e dënuara me gjobë (Kodi Penal, neni 106, par. 1). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 125, par. 1).

Në Shqipëri, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës, për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë (Kodi Penal, neni 66, par. d). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është pesë vjet pas vendimit të formës së prerë, për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta (*id.*, neni 68, par. c). Për kundërvajtjet administrative, afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit (Ligji për Kundërvajtjet administrative, neni 46).

Në Serbi, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është një vit pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për Kundërvajtje, neni 76, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*, neni 76, par. 7). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 77).

Në Slovaki, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Ligji për Kundërvajtje, neni 20, par. 1).

Në Sloveni, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet ose pesë vjet pas kryerjes së veprës kundërvajtëse, varësisht prej llojit të kundërvajtjes (Ligji për Kundërvajtje, neni 42, par. 1). Afatet përkatëse të parashkrimit për përfundimin e procedurës janë dyfish i afateve për nisjen e procedurës (*id.*,

neni 42, par. 3). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është dy vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 44, par. 2).

Në Spanjë, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është gjashtë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi Penal, neni 131, par. 2). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është tetë muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (*id.*, neni 131, par. 2, nënpar. 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është një vit pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 133, par. 1).

Në Suedi, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është dy vjet pas kryerjes së veprës nëse vepra është e dënueshme maksimalisht me një vit burgim (Kodi Penal, Kapitulli 35, pjesa 1, par. 1). Afati i parashkrimit për përfundimin e procedurës është pesë vjet pas kryerjes së veprës së dënueshme maksimalisht me gjobë (*id.*, Kapitulli 31, pjesa 6, par. 1). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është pesë vjet pas vendosjes së gjobës (*id.*, Kapitulli 31, pjesa 7, par. 1).

Në Turqi, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është tre vjet, katër vjet ose pesë vjet për veprat kundërvajtëse, varësisht prej sasisë së gjobës së shqiptuar (Kodi i Kundërvajtjeve, neni 20, par. 2). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet, katër vjet, pesë vjet ose dhjetë vjet për veprat kundërvajtëse, varësisht prej sasisë së gjobës së shqiptuar (*id.*, neni 21, par. 2).

Në Ukrainë, afati i parashkrimit për vendosjen e dënimit është dy ose tre muaj pas kryerjes së veprës kundërvajtëse (Kodi i Kundërvajtjeve Administrative, neni 38). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre muaj pas vendosjes së dënimit (*id.*, neni 303).

Në Zvicër, afati i parashkrimit për nisjen e procedurës është tre vjet pas kryerjes së veprës (Kodi Penal, neni 109). Afati i parashkrimit për ekzekutimin e dënimit është tre vjet pas vendosjes së dënimit (*id.*).

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 488/2016

Raport lidhur me pushimin e hetimit të veprave penale të korrupsionit, sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 159

Për:

Z. Kadri Veseli, Kryetar

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Znj. Albulena Haxhiu, Kryetare

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Znj. Lirije Kajtazi, Kryetare,

Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Prishtinë, më 5 gusht 2016

QËLLIMET E RAPORTIT

Veprat penale që mund të quhen krime të korrupsionit përcaktohen në Kodin Nr. 04/L-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XXXIV, i cili mban titullin “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Në raste të korrupsionit, sikurse për vepra të tjera penale, zbatohet neni 159 i Kodit Nr. 04/L-123, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë parashikon që hetimi paraprak i veprës penale të pushohet menjëherë nëse nuk ngritet aktakuzë brenda dy vjetëve pas fillimit të hetimit.

Disa institucione shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile kanë ngritur shqetësimin që ky afat dyvjeçar paraqet një pengesë serioze për ndjekjen efikase të veprave penale të korrupsionit, për shkak se ky afat e ka bërë të pamundur që të ngritet aktakuzë. Mirëpo, me gjithë trajtimin e gjerë të këtij problemi në literaturën e deritanishme, Avokati i Popullit konsideron se ka tri mangësi kryesore në këtë literaturë: (1) mungon një analizë ligjore e saktë e konceptit të pushimit të hetimit sipas nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale, (2) mungon një trajtim i hollësishëm i problemit të pushimit të hetimit të rasteve të korrupsionit posaçërisht nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe (3) ka një mungesë të propozimeve për zgjidhje efikase të problemit, duke marrë parasysh këto të drejta.

Prandaj, për të adresuar këto mangësi, ky Raport ka tri qëllime kryesore:

- (5) të ofrojë një interpretim të saktë të konceptit të pushimit të hetimit sipas nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale;
- (6) të vlerësojë, posaçërisht nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, problemin e pushimit automatik të hetimit të veprave penale të korrupsionit;
- (7) në bazë të këtij vlerësimi, t’u japë rekomandime institucioneve shtetërore për zgjidhjen më të drejtë dhe më efikase të problemit.

BAZA LIGJORE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor” (neni 16, par. 8).
- “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “të publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “të përgatisë raporte vjertore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 8);
- “të rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i

Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

ANALIZA E DISPOZITAVE LIGJORE DHE PRAKTIKËS GJYQËSORE DHE PROKURORIALE

A. Veprat penale të korrupsionit dhe pushimi i hetimit të tyre sipas Kodit të Procedurës Penale, neni 159

Përkufizimi ligjor i termit “korrupsion” gjendet në Ligjin Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Sipas këtij ligji, korrupsioni përfshin “çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin” (*id.*, neni 2, par. 1, nënpar. 3). I njëjti ligj përcakton që Agjencia ka kompetencën të “inicioj[ë] dhe zhvilloj[ë] procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe [të] përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente” (*id.*, neni 5, par. 1, nënpar. 1).

Si çdo vepër penale, veprat penale të korrupsionit përkufizohen nga Kodi Nr. 04/L-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Këto vepra përcaktohen në një kapitull të veçantë të këtij Kodi, Kapitulli XXXIV, i cili mban titullin “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”.³ Kapitulli XXXIV përmban 16 vepra penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 422); Keqpërdorimi i informatës zyrtare (neni 423), Konflikti i interesit (neni 424); Përvetësimi në detyrë (neni 425); Mashtrimi në detyrë (neni 426); Përdorimi i paautorizuar i pasurisë (neni 427); Marrja e ryshfetit (neni 428), Dhënia e ryshfetit (neni 429); Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj (neni 430), Ushtrimi i ndikimit (neni 431); Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 432), Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 433); Falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 434), Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (neni 435); Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë në rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 436); dhe Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (neni 437).

Në rast të kryerjes së këtyre veprave penale, zbatohen dispozitat e përcaktuara nga Kodi Nr. 04/L-123, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kodi i Procedurës Penale përcakton katër faza të ndara të procedurës penale: faza e hetimit, faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklaramit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik (*id.*, neni 68, par. 1). Lidhur me fazën e hetimit, Kodi përcakton se: “Prokuroria e shtetit mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera nëse ka dyshim të arsyeshëm se po ndodh ose ka gjasë të ndodhë në një të ardhme të afërt vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare” (*id.*, neni 102, par. 1).

Pas fillimit të hetimit sipas nenit 102, ka disa rezultate të mundshme. Së pari, hetimi mund të *pezullohet* nëse “i pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga një çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose nga ndonjë sëmundje tjetër e rëndë, nëse është arratisur ose ekzitojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të pandehurit” (*id.*, neni 157, par. 1).

Së dyti, dhe më e rëndësishme për qëllimet e këtij Raporti, hetimi mund të *pushohet* nëse “nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale; vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës syrtare; ka kaluar afati i parashkrimit; vepra penale është përfshirë në falje ose në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [ose] ekzitojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen” (*id.*, neni 158, par. 1). Gjithashtu, “hetimi pushon

³ Edhe Agjencia kundër Korrupsionit e konsideron punën e vet të si të ndërlidhur me Kapitullin XXXIV të Kodit Penal. Shih Agjencia kundër Korrupsionit, *Raport Vjetor, Janar – Dhjetor 2015*, f. 7.

automatikisht me kalimin e afatit kohor nga neni 159” (*id.*, neni 158, par. 3), i cili përcakton se: “Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi . . . , hetimi menjëherë pushohet” (neni 159, par. 1). Megjithatë, Kodi lë hapësirë që gjyqtari i procedurës paraprake të autorizojë vazhdimin e hetimit deri në gjashtë muaj pas afatit dyvjeçar “në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme” (*id.*, neni 159, par. 2). Gjithashtu, Kodi parashikon pushimin e procedurës penale në rast të vdekjes së të pandehurit (*id.*, neni 160).

Rezultati i tretë i mundshëm pas fillimit të hetimit është *ngritja e aktakuzës*. Sipas Kodit, “[p]as përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit” (*id.*, neni 240, par. 1). Mirëpo, Kodi thekson që “[n]ëse hetimi ka përfunduar dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale ose vepra penale, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim për pushimin e hetimit” (*id.*, neni 240, par. 2).

B. Interpretimet kontradiktore të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve

Disa institucione shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile kanë ngritur shqetësimin që neni 159 i Kodit të Procedurës Penale paraqet një pengesë serioze në ndjekjen efikase të rasteve të korrupsionit. Për shembull, Raporti Nr. 1/16 i organizatës KIPRED, me titullin *Pandëshkueshmëria në Kosovë: Lufta kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë* (janar 2016), kritikon “vonesat e qëllimshme në trajtimin e korrupsionit ndaj profilit të lartë”, duke pretenduar se “[n]ë të paktën dy raste që lidhen me korrupsionin e profilit të lartë, . . . përfundimi i afatit kohor prej dy vjetësh për kryerjen e hetimeve, janë shfrytëzuar si shkaqe për të hedhur poshtë rastet pasi që nuk janë parashtruar aktakuzat nga ana e prokurorëve brenda këtij afati të përcaktuar kohor” (*id.*, f. 15). Për më tepër, sipas KIPRED-it, “[d]ështimi për të ngritur një aktakuzë brenda afatit të paraparë kohor ka siguruar një hapësirë për prokurorët e shtetit të Kosovës që të mos merren me raste të ndërlikuara, duke mbështetur pandëshkueshmërinë e disa rasteve të profilit të lartë” (*id.*, f. 17).

Në të njëjtën mënyrë, në *Raportin e Monitorimit të Gjykatave* për vitin 2015, organizata mediale BIRN ka konstatuar se “aktakuzat e ‘vonuara’ të prokurorisë” janë një prej tri shkaqeve kryesore të “dështimeve në luftën kundër korrupsionit” (*id.*, f. 10-11). Sipas këtij Raporti, “[g]atë vitit 2015, BIRN ka hasur në raste kur hetimet nuk janë përfunduar brenda afateve kohore dhe prokurorët nuk kanë kërkuar afate shtesë për vazhdimin e hetimeve në rastet e ndërlikuara, siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale” (*id.*, f. 11). Në këto raste, “Prokuroria ka ngritur aktakuza vetëm pas tejkalimit të afatit dyvjeçar, e të tillat Gjykata e Apelit i ka konsideruar si të paafatshme dhe ka marrë vendim që procedurat penale automatikisht të ndërpriten” (*id.*). Theksohet më tej se “këto raste që rrezikojnë të mbesin pa u gjykuar janë kundër zyrtarëve shtetërorë dhe kapin shumën e miliona eurove” (*id.*). Edhe Agjencia kundër Korrupsionit ka kritikuar Prokurorinë për dështimet e saj në këtë fushë. Në *Raportin Vjetor, Janar – Dhjetor 2015*, pretendohet se “[t]ek disa raste të ngritura me kallëzime penale nga AKK, skadon afati i ndjekjes penale apo është bërë parashkrimi i ndjekjes së veprave penale për shkak të neglizhencës së Prokurorive Kompetente” (*id.*, f. 13).

Mirëpo, jo të gjitha autoritetet shtetërore kanë mendim që neni 159 pengon ngritjen e aktakuzës, edhe pas skadimit të afatit dyvjeçar për fazën e hetimit. Përkatësisht, duket se ka një mosmarrëveshje thelbësore ndërmjet anëtarëve të Gjykatës Supreme, e cila është “autoriteti më i lartë gjyqësor” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 103, par. 2, në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”), për sa i përket interpretimit të nenit 159. Nga njëra anë, kryetari i Gjykatës Supreme, më 19 janar 2015, nënshkroi një qarkore, me anë të së cilës është pretenduar se, pas përfundimit të afatit dyvjeçar të përmendur në nenin 159 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria jo vetëm që nuk mund të vazhdojë hetimin, por edhe e ka të pamundur të ngrejë aktakuzë në rastin përkatës. Sipas organizatës KIPRED, interpretimi i paraqitur në Qarkore po zbatohet prej shumicës së prokurorëve: “Shumica e prokurorëve të shtetit deri më tani kanë pretenduar se ata kanë përdorur interpretimin e gjykatës supreme pasi që prokurorët nuk mund të ngrenë aktakuza pas përfundimit ligjor të fazës së hetimeve” (*Pandëshkueshmëria në Kosovë*, f. 17)

Nga ana tjetër, të paktën disa prej gjykatësve të Gjykatës Supreme e kanë kundërshtuar publikisht qarkoren gjatë shqyrtimit të një aktvendimi të Gjykatës së Apelit. Gjykata e Apelit e kishte hedhur poshtë aktakuzën si të paafatshme, për shkak se ishte ngritur rreth tre muaj pas skadimit të afatit dyvjeçar për përfundimin e hetimit. Një kolegji i Gjykatës Supreme prej tre gjyqtarësh, hodhi poshtë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit duke argumentuar se neni 159 i Kodit të Procedurës Penale, megjithëse vendos një afat dyvjeçar mbi kohëzgjatjen e fazës së hetimit, nuk ndalon ngritjen e aktakuzës pas skadimit të këtij afati. Për të arritur në këtë konkluzion, kolegji arsyetoi se “në dispozitën e nenit 240 [të Kodit të Procedurës Penale], përcakto[het] se aktakuza ngritet pas përfundimit të hetimit” (*Aktvendimi*, par. 38). Sipas këtij arsyeimi, pushimi i hetimit pas afatit dy vjeçar do të thotë thjesht që hetimi ka përfunduar dhe, sipas nenit 240, pas përfundimit të hetimit lejohet ngritja e aktakuzës. Prandaj, e drejta e prokurorit për të ngritur aktakuzë, sipas këtij interpretimi, vazhdon deri në afatin e parashkrimit të veprës penale sipas nenit 106 të Kodit Penal (*id.*). Siç shkruhet në Aktvendim, “ligji siç është tani . . . nuk e parasheh që aktakuza detyrimisht të ngritet para përfundimit të kohës së hetimit” dhe, për rrjedhojë, “ky kolegji, në shumicën e tij nuk pajtohet me nocionin aktakuzë e ‘paafatshme’” (*Aktvendimi*, par. 41). Për këto arsye kolegji shprehu edhe mospajtimin e tij me qarkoren, e cila “përmban mendimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe padyshim reflekton qëndrimin e shprehur nga seanca e përgjithsme e Gjykatës Supreme” por nuk është “ligjërish detyruese” (*Aktvendimi*, par. 42).

C. Interpretimi i saktë i nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale

Aktvendimi i lartcitar i kolegjit të Gjykatës Supreme ngre një pyetje të rëndësishme: A paraqet neni 159 i Kodit të Procedurës Penale një pengesë të vërtetë për ngritjen e aktakuzave në raste të korrupsionit, apo është thjesht një çështje keqinterpretimi? Nëse pranohet arsyeimi i paraqitur në Aktvendim, atëherë neni 159, interpretuar ashtu siç duhet, realisht nuk pengon ndekjen penale në raste të korrupsionit sepse, sipas këtij interpretimi, Prokuroria mund të ngrejë aktakuzë edhe pas skadimit të afatit dyvjeçar të fazës së hetimit.

Avokati i Popullit konsideron se interpretimi i kolegjit të Gjykatës Supreme është i gabuar dhe, për rrjedhojë, problemi i mosngritjes së aktakuzave pas pushimit të hetimit sipas nenit 159, mund të zgjidhet vetëm me ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Siç kemi parë më sipër, kolegji argumenton që, lejohet ngritja e aktakuzës pas pushimit të hetimit, sepse “në dispozitën e nenit 240 [të Kodit të Procedurës Penale], përcakto[het] se aktakuza ngritet pas përfundimit të hetimit” (*Aktvendimi*, par. 38) Ky argument duket që nuk është shumë i qëndrueshëm, sepse ngatërron konceptin e *përfundimit* të hetimit me atë të *pushimit* të hetimit, ndërsa Kodi i Procedurës Penale i dallon mjaft qartë këto dy koncepte. Shih, p.sh., nenin 240 të Kodit të Procedurës Penale, i cili

përcakton që “[n]ëse hetimi *ka përfunduar* dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprë penale ose vepra penale, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim për *pushimin* e hetimit” (*id.*, neni 240, par. 2, theks i shtuar). Ky nen tregon qartë se përfundimi i hetimit nuk është i barabartë me pushimin e hetimit. Përfundimi i hetimit, ashtu siç përdoret në këtë dispozitë, i referohet kryerjes së procesit të mbledhjes dhe vlerësimit të provave. Pas kryerjes së këtij procesi—pas *përfundimit* të hetimit—prokurori ose mund të ngrejë aktakuzë në bazë të provave të mbledhura, ose mund të *pushojë* hetimin nëse këto prova nuk janë të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës. Koncepti i pushimit të hetimit, siç përdoret këtu, nënkupton mosngritjen e aktakuzës. Prandaj, fakti që neni 240, par. 1, parashikon ngritjen e aktakuzës pas “përfundimit” të hetimit, nuk mbështet aspak qëndrimin e kolegjit të Gjykatës Supreme se mund të ngritet aktakuza pas “pushimit” të hetimit. Përkundrazi, nga mënyra se si përdoret koncepti i pushimit, mund të konkludohet se pas pushimit të hetimit, ngritja e aktakuzës është e pamundur.

Fakti që pushimi i hetimit nënkupton mosngritjen e aktakuzës, mbështetet edhe nga dispozita të tjera të Kodit të Procedurës Penale. Për shembull, neni 156 përcakton se “[ç]do tre (3) muaj, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së tij shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të *pushohet* apo të *ngritet aktakuza*” (theks i shtuar). Këtu, pushimi i hetimit dhe ngritja e aktakuzës paraqiten si alternativa përjashtuese. Më tej, neni 158 përcakton se “Prokurori i shtetit e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale; vepra e kryer nuk është veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; ka kaluar afati i parashkrimit; vepra penale është përfshirë në falje ose në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; ose *ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen*” (neni 158, par. 1, theks i shtuar). Edhe këtu, pushimi i hetimit nënkupton mosndjekjen dhe, për rrjedhojë, mosngritjen e aktakuzës kundër të pandehurit.

Në bazë të këtij interpretimi të konceptit të pushimit, mund të konkludojmë që, kur neni 159 i Kodit parashikon që, “[n]ëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, . . . hetimi menjëherë pushohet”, kjo do të thotë se, pas skadimit të afatit dyvjeçar, Prokuroria e ka humbur mundësinë e ngritjes së aktakuzës. Prandaj, zgjidhja e problemit të mosndjekjes së rasteve të korrupsionit për shkak të skadimit të këtij afati nuk mund të zgjidhet me interpretimin kreativ të nenit 159, por vetëm me ndryshimin e tij nga ana e Kuvendit.

LIDHJA NDËRMJET NDJEKJES SË RASTEVE TË KORRUPSIONIT DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton rolin e Avokatit të Popullit si në vijim: “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike” (*Kushtetuta*, neni 132, par. 1). Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit përcakton se: “Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës” (*id.*, neni 1, par. 1).

Duke marrë parasysh rolin e Avokatit të Popullit si mbrojtës i të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrës i institucioneve shtetërore për respektimin e këtyre të drejtave, është e domosdoshme, në këtë Raport, të theksohet mënyra se si problemi i mosndjekjes së rasteve të korrupsionit për shkak të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale ndërlidhet me misionin e Avokatit të Popullit në fushën e të drejtave të njeriut.

A. Vepra penale të korrupsionit kanë pasoja të dëmshme për respektimin e të drejtave të njeriut

Së pari, interesi i Avokatit të Popullit në çështjen e ndjekjes adekuate të rasteve të korrupsionit, bazohet në faktin e njohur se korrupsioni ka pasoja të dëmshme për respektimin e të drejtave të njeriut. Një deklaratë e nënshkruar nga 132 vende të botës, me rastin e mbledhjes së 20 të Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, konfirmon lidhjen ndërmjet korrupsionit dhe të drejtave të njeriut, duke pohuar se: “Jemi thellësisht të shqetësuar për rritjen e impaktit negativ të korrupsionit të përhapur mbi gëzimin e të drejtave të njeriut” (20th Session of the United Nations Human Rights Council, *Cross-Regional Statement on Corruption and Human Rights*, f. 2).

Më hollësisht, disa prej veprave penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIV të Kodit Penal përbëjnë drejtpërdrejt shkelje të të drejtave të njeriut. Për shembull, neni 432, “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, përcakton se: “Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t’i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.” Kur një gjyqtar vendos kundër një pale në procedurë për të nxjerrë dobi pasurore, kjo paraqet një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e cila garantohet nga neni 31, par. 2 të *Kushtetutës* (“[ç]dokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose të çdo akuze penale kundër tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”) dhe neni 6, par. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Në vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve civile . . . , çdokush ka të drejtë për një shqyrtim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj” (në tekstin e mëtejshëm: “KEDNJ”)), e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës (shih *Kushtetutën*, neni 22). Kur një gjyqtar merr vendim kundër një pale në procedurë për të fituar dobi pasurore, i mohon kësaj pale të drejtën për gjykim nga një tribunal *i pavarur*. Për këtë arsye, të paktën një eksperte për të drejtat e njeriut e ka konsideruar “të tejdukshme” që “korrupsioni në administrimin e drejtësisë rrezikon të drejtat elementare për mbrojtje gjyqësore, duke përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë pa vonesë të paarsyeshme” (Prof. Dr. Anne Peters, *Corruption and Human Rights*, f. 11)

Po ashtu, shkelja e nenit 429, par. 2 të Kodit Penal, “Dhënia e ryshfetit” (“Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”), mund të ketë ndikim negativ në të drejta të ndryshme të njeriut. Për shembull, “dhënia e ryshfetit zyrtarëve të zgjedhjeve për të ndërhyrë në procesin zgjedhor, duke mbushur kutitë e votimit në favor të një kandidati ose partie dhe duke falsifikuar numërimin, shkel të drejtën për të votuar” (International Council on Human Rights Policy and Transparency International, *Corruption and Human Rights: Making the Connection*, f. 44). Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes garantohen nga *Kushtetuta*, neni 45 (“Vota është . . . e barabartë” (*id.*, neni 45, par. 2) dhe “Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë . . . për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike” (*id.*, neni 45, par. 3)), si dhe nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25 (“Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që . . . të votojë . . . me votim të përgjithshëm dhe të barabartë”), i cili gjithashtu është derjtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës (shih *Kushtetutën*, neni 22).

Përveç të drejtave primare, dhënia dhe marrja e ryshfetit mund të paraqesë shkelje edhe të së drejtës të një individi për të mos u diskriminuar kundrejt të tjerëve në respektimin e të drejtave të tij. Shih KEDNJ, neni

14 (“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet pa diskriminim mbi çdo lloj baze si p.sh. seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendim politik ose tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, lidhje me një minoritet kombëtar, pronësia, lindja ose status tjetër”). Neni 53 i *Kushtetutës* përcakton se “[t]ë drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (në tekstin e mëtejshëm: “GJEDNJ”). Sipas vendimeve gjyqësore të GJENDJ-së, “[e] drejta . . . për të mos u diskriminuar . . . shkelet kur Shtetet trajtojnë në mënyrë jo të barabartë persona në pozita të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” (*Thlimmenos v. Greece*, Aplikimi Nr. 34369/97, GJEDNJ (2000), par. 44). Në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm”, duhet së paku të ketë një “qëllim legjitim” për pabarazinë në fjalë (“*Relating to Certain Aspects of the Laws on the Use of Languages in Education in Belgium*” v. *Belgium*, Aplikimet Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64, GJEDNJ (1968), par. 10). Kur marrja e ryshfetit shtyn një zyrtar publik të marrë një vendim në favor të një pale, kundrejt të tjerëve, me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, kjo mund të konsiderohet diskriminim, përderisa përbën një trajtim jo të barabartë midis personave në pozita të ngjashme, pa qëllim legjitim. “Korrupsioni . . . shkakton shkelje të barazisë para ligjit si dhe diskriminimin e atyre që nuk kanë mundësitë ekonomike për të korruptuar, ose për t’u mbrojtur kundër praktikave korruptive të të tjerëve” (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, “Corruption as a threat to the Rule of Law”, par. 39).

Në të njëjtën mënyrë, dhënia dhe marrja e ryshfetit, duke shkaktuar arbitraritet në ndryshimin ose zbatimin e ligjit, rrezikon sigurinë juridike: “Mundësia që ligji mund të ndryshohet ose të mos zbatohet për t’iu përshtatur kërkesave të atyre që kanë mundësitë ekonomike për të korruptuar është jokonsistente me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon një proces transparent, llogaridhënës dhe demokratik për miratimin e ligjeve, si dhe siguri juridike, e cila nënkupton parashikueshmërinë” (*id.*, par. 38).

Këto janë vetëm disa shembuj se si veprat penale të korrupsionit mund të shkaktojnë pasoja negative në respektimin e të drejtave të njeriut. Prandaj, përderisa neni 159 i Kodit të Procedurës Penale paraqet pengesë në ndjekjen efikase të rasteve të korrupsionit, Avokati i Popullit ka një interes legjitim, në bazë të rolit të tij kushtetues dhe ligjor, për të kërkuar një zgjidhje.

B. Interpretimet jokonsistente të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale paraqesin shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, si dhe rrezikojnë sigurinë juridike

Siç kemi parë më sipër, ekziston një qasje jo uniforme në lidhje me zbatimin e Kodit të Procedurës Penale për sa i përket nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo qasje ka shkaktuar trajtim jo të barabartë të rasteve të ngjashme, përkatësisht, të rasteve në të cilat afati dyvjeçar për fazën e hetimit ka shkadar. Për shembull, në rastin e diskutuar më lart, i cili u trajtua nga kolegji i Gjykatës Supreme, skadimi i afatit, përfundimisht, nuk ka penguar ngritjen e aktakuzës dhe lënda është kthyer në Gjykatën Themelore për të shkuar në gjykim (shih *Aktvendimin*, “Përfundim”, pjesa C). Por, në raste të tjera në të cilat afati dyvjeçar është skaduar, shumica e prokurorëve përkatës kanë vendosur të mos ngrenë aktakuza fare, duke u bazuar në qarkore. Krejt pavarësisht se cili interpretim është i saktë, trajtimi jo i barabartë i këtyre rasteve nuk ishte rezultat i ndonjë ndryshimi relevant ndërmjet tyre, por thjesht për shkak të ndarjes e rasteve nga prokurorë dhe gjyqtarë të ndryshëm. Prandaj, ky trajtim jo i barabartë nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dhe, për pasojë, mund të konsiderohet diskriminues, sipas standardit të lartpërmendur të diskriminimit të përcaktuar nga GJEDNJ.

Vlen të theksohet se, vetë fakti që vazhdojnë të ekzistojnë interpretimet jokonsistente të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale mes gjyqtarëve dhe prokurorëve të ndryshëm, dëshmon qartë se, me gjithë

pretendimin e qarkores “me qëllim zbatimin unik të ligjeve” (*Raport vjetor i punës së Gjykatës Supreme, Janar-dhjetor 2015*, “Fjala hyrëse e kryetarit të Gjykatës Supreme”, f. 3), faktikisht nuk e ka arritë këtë qëllim. Siç pohohet në Aktvendimin e kolegjit të Gjykatës Supreme, diskutuar më lart, “shumica nuk e konsideron [qarkoren] si ligjërishit detyruese dhe nuk pajtohet me atë (*id.*, par. 42). Për më tepër, edhe qarkoret tjera janë kundërshtuar, jo vetëm nga gjyqtarë të tjerë të Gjykatës Supreme, por edhe nga gjyqtarë të Gjykatës së Apelit. Për shembull, në Rastin Nr. PN554/14, një kolegji i Gjykatës së Apelit ka refuzuar të zbatojë një tjetër qarkore të nxjerrë nga Gjykata Supreme, në të cilën shprehet mendimi që “[ë]shtë e qartë se kur gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues shpall një provë të papranueshme, i takon kolegjit shqyrtues për vëzhgim dhe hetime të vendosë për ankesën dhe jo Gjykatës së Apelit, siç ka qenë praktika e deritanishme në gjykata” (cituar në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Rasti Nr. PN554/14, par. 25). Mirëpo, Gjykata e Apelit nuk e lëshoi juridiksionin mbi rastin në fjalë dhe deklaroi haptas që: “Kolegji konsideron se ky opinion është i pasaktë dhe bazohet në keqinterpretim[.]” (*id.*, par. 26).

Në bazë të shembujve të tillë, mund të konkludohet se qarkoret e nxjerra nga Gjykata Supreme nuk arrijnë qëllimin e “zbatimit unik të ligjeve” por vetëm krijojnë iluzionin e sigurisë juridike. Ky iluzion është vetë i dëmshëm, sepse jep përshtypjen (mbase jo të qëllimshme) që lëshimi i një qarkoreje nga Gjykata Supreme mund të lirojë ligjvënësit nga detyra e tyre për të siguruar në të vërtetë zbatimin unik të ligjeve, duke sqaruar dispozita ligjore të paqarta me anë të ndyrshimeve dhe plotësimeve të ligjeve përkatëse. Interpretimet kontradiktore të nenit 159 nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve tregojnë se zgjidhja e problemit të mosndjekjes së veprave penale të korrupsionit, si dhe sqarimi i çështjes së nenit 159, duhet të kërkohet tek Kuvendi, jo përmes qarkoreve dhe aktvendimeve të gjyqësorit.

NJË ZGJIDHJE E MUNDSHME LEGJISLATIVE E PROBLEMIT TË MOSNDJEKJES EFIKASE TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT

Avokati i Popullit konsideron se, zgjidhja më efikase dhe më e thjeshtë e problemit të mosndjekjes efikase të rasteve të korrupsionit për shkak të nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale, është që Kodi i Procedurës Penale të ndryshohet në mënyrë që *afati dyvjeçar për fazën e hetimit të mos zbatohet për raste të korrupsionit*, d.m.th. që Kodi i Procedurës Penale të mos përcaktojë asnjë afat specifik për përfundimin e hetimit dhe ngritjen e aktakuzës kundër veprave penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIV të Kodit Penal. Me heqjen e afatit për raste të tilla, prokurorët nuk do të kenë asnjë pengesë në ndjekjen e rasteve të korrupsionit pas dy vjetëve të hetimit, përveç afateve të parashkrimit të përcaktuara në nenin 106 të Kodit Penal. As nuk do të mund ta shfrytëzonin afatin dyvjeçar si justifikim për të mos u marrë me një rast të ndërlikuar nga ana e substancës ose të ndjeshëm nga ana politike.

Mirëpo, nga kjo zgjidhje e mundshme lind një shqetësim legjitim: A është në përputhje me respektimin e plotë të të drejtave të njeriut që të mos ketë *asnjë afat ligjor* për përfundimin e hetimit dhe ngritjen e aktakuzës në raste të korrupsionit? Ky shqetësim duket se gjen mbështetje në KEDNJ, si dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila, në bazë të nenit 53 të *Kushtetutës*, është e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 6, par. 1 i KEDNJ-së përcakton që “[ç]dokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me . . . çdo akuzë penale kundër tij, *brenda një kohe të arsyeshëm*” (theks i shtuar). Në interpretimin e frazës kyçe “brenda një afati të arsyeshëm”, Gjykata ka shkruar se “periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me nenin 6, par. 1, fillon pasi personi është zyrtarisht i akuzuar, ose kur dyshimet lidhur me këtë person kanë ndikuar seriozisht në situatën e tij . . . , *si p.sh. data kur hetimi paraprak ka filluar*” (*Philippe Bertin-Mouro v. France*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 36343/97 (2000), par. 52

(theks i shtuar)). Shih, gjithashtu, *Lilja v. Sweden*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 36689/02 (2007), par. 28), *Eckle v. Germany*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 8130/78 (1982), par. 74, dhe *Motta v. Italy*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 11557/85 (1991), par. 15. Vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së në këto raste tregojnë se hetimi paraprak nuk mund të zgjasë në pafundësi. Përkundrazi, hetimi, si dhe fazat e tjera të procedurës penale, duhet të kryhen “brenda një kohe të arsyeshme”. A përbën ky parim një argument kundër moszbatimit të afatit dyvjeçar në raste të korrupsionit?

Përgjigjja është se nuk përbën një argument të tillë, për tri arsye. Së pari, heqja e afatit dyvjeçar në raste të korrupsionit do të thoshte vetëm se nuk do të ketë një afat *ligjor* për përfundimin e hetimit dhe ngritjen e aktakuzës në raste të tilla. Do të vazhdojë të ekzistojë kërkesa *kushtetuese*, në bazë të nenit 6, par. 1 të KEDNJ-së dhe vendimeve të lartpërmendura të GJEDNJ-së, që hetimi paraprak, si dhe fazat e tjera të procedurës penale, të mos zgjasin përtej “kohës së arsyeshme”.

Së dyti, moszbatimi i nenit 159 në raste të korrupsionit i përshtatet mirë praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në të paktën një aspekt: Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi nenin 6, par. 1, thekson parimin që nuk ka një afat kohor universal përpara të cilit kohëzgjatja konsiderohet e arsyeshme *në të gjitha rastet* dhe pas të cilit kohëzgjatja konsiderohet jo e arsyeshme *në të gjitha rastet*. Përkundrazi, “Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave të mbuluara nga neni 6, par. 1 i Konventës duhet vlerësuar në çdo rast sipas rrethanave të tij. Kur e vlerëson arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave penale, Gjykata i ka kushtuar vëmendje, mes të tjerash, kompleksitetit të rastit, sjelljes së aplikuesit dhe mënyra se si çështja është trajtuar nga autoritetet administrative dhe gjyqësore” (*König v. Germany*, GJEDNJ, Aplikimi 6232/73 (1978), par. 99). Fakti që, sipas GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta në çdo rast, dhe jo t’i nënshtrohet ndonjë afati specifik, e bën jo të përshtatshëm zbatimin e afatit universal dyvjeçar sipas nenit 159 (edhe pse mundësia e zgjatjes deri në 6 muaj e lehtëson në një masë të vogël këtë jofleksibilitet). Duke hequr afatin dyvjeçar, të paktën për raste të korrupsionit, Kodi i Procedurës Penale do t’i afrohej më shumë praktikës së GJEDNJ-së.

Së treti, moszbatimi i afatit dyvjeçar në raste të korrupsionit përputhet me doktrinën e “*margin of appreciation*” të GJEDNJ-së. Sipas kësaj doktrine, GJEDNJ ka njohur njëfarë hapësire brenda së cilës çdo shtet mund të vlerësojë se si do të ishte mënyra më e përshtatshme e respektimit të të drejtave të njeriut të përcaktuara në KEDNJ, duke marrë parasysh kontekstin specifik të vendit të vet. Varësisht prej rastit, kjo hapësirë mund të jetë më e gjerë ose më e ngushtë në fusha të ndryshme. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, *margin of appreciation* që gëzon një shtet, njihet si veçanërisht e gjerë kur, në një fushë të caktuar,

- (4) “Shteti duhet të balancojë të drejta të Konventës në konkurrencë” me njëra-tjetrën (*Evans v. United Kingdom*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 6339/05 (2007), par. 77).
- (5) “[R]asti ngre çështje të ndërlikuara dhe vendime të strategjisë sociale: njohja e drejtpërdrejtë e shoqërisë së tyre dhe nevojave të saj, nga ana e autoriteteve, do të thotë se ato [autoritete] janë, në parim, në pozitë më të mirë . . . për të vlerësuar se çfarë është në interesin e publikut” (*Dickson v. United Kingdom*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 44362/04, (2007), par. 78).
- (6) “[N]uk ka konsensus mes Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës” (*id.*).

Të gjitha këto kritere na çojnë në konkluzionin se Republika e Kosovës ka mjaft hapësirë për të hequr afatin dyvjeçar në raste të korrupsionit.

Së pari, kemi parë më sipër që, ndjekja e efikase e veprave penale të korrupsionit është e domosdoshme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përderisa këto vepra penale i rrezikojnë këto të drejta. Prandaj, këtu kemi të bëjmë me balancimin midis nevojës për të mbrojtur këto të drejta nga pasojat negative të

korupsionit dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e të pandehurit që të mos i nënshtrohet hetimit përtej një kohe të arsyeshme. Kur kemi të bëjmë me një balancim të tillë midis të drejtave të ndryshme, shteti gëzon hapësirë të gjerë për të vendosur balancimin e duhur.

Së dyti, zgjidhja e problemit të korupsionit në Kosovë sigurisht “ngre çështje të ndërlikuara dhe vendime të strategjisë sociale”. Sipas “Indeksit të Përceptimit të Korupsionit” të vitit 2015, të nxjerrë nga organizata ndërkombëtare “Transparency International”, Kosova renditet në vendin e 103 prej 168 shteteve të botës, duke zënë pozitën më të keqe në gjithë rajonin (Kroacia zë vendin e 50, Mali i Zi vendin e 61, Maqedonia vendin e 66, Serbia vendin e 71, Bosnja dhe Hercegovina vendin e 76 dhe Shqipëria vendin e 88). Kjo, bashkë me problemin e mirëdokumentuar të mosndjekjes efikase të veprave penale të korupsionit nga ana e Prokurorisë, përbën dëshmi të mjaftueshme që problemi i korupsionit “ngre çështje të ndërlikuara dhe vendime të strategjisë sociale”. Edhe ky faktor krijon hapësirë të gjerë për heqjen e afatit dyvjeçar në rastet e korupsionit.

Së treti, për sa i përket vendosjes së afateve ligjore për përfundimin e hetimit, “nuk ka konsensus mes Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës”. Në një studim të 27 vendeve të Bashkimit Evropian, Transparency International ka konstatuar se vetëm 15 prej tyre kanë vendosur një afat parashkrimi për përfundimin e hetimit: Austria, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Hollanda, Hungaria, Letonia, Luksemburgu, Malta, Polonia, Rumania, Sllovenia, Spanja dhe Suedia (shih Transparency International, *Timed Out: Statutes of Limitations and Prosecuting Corruption in EU Countries*, f. 11). Edhe pse 27 vendet e Bashkimit Evropian përbëjnë vetëm një pjesë të Këshillit të Evropës, i cili përfshin 47 vende gjithsej, fakti që së paku 12 vende nuk kanë vendosur asnjë afat parashkrimi për përfundimin e hetimit, tregon se nuk ka një konsensus të gjerë mes Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për vendosjen e një afati të tillë.

Për arsyet e lartpërmendura, me gjithë shqetësimin që moszbatimin e afatit dyvjeçar në raste të korupsionit do të rrezikonte të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, doktrina e “*margin of appreciation*” e GJEDNJ-së lë mjaft hapësirë për një zgjidhje të tillë.

KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

A. Konstatimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se:

1. Neni 159 i Kodit Nr. 04/L-123, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, interpretuar saktë, vendos një afat dyvjeçar mbi fazën hetimore të lëndëve penale, pas të cilit pushohet hetimi dhe nuk lejohet ngritja e aktakuzës;
2. Problemi i mosndjekjes efikase të veprave penale të korupsionit shkakton pasoja negative për respektimin e të drejtave të njeriut;
3. Interpretimet kontradiktore të neni 159 të Kodit të Procedurës Penale mes gjyqtarëve dhe prokurorëve të ndryshëm, paraqesin shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, si dhe rrezikojnë sigurinë juridike;
4. Qarkoret e nxjerra nga Gjykata Supreme nuk arrijnë qëllimin e zbatimit unik të ligjeve dhe japin vetëm një iluzion të sigurisë juridike;
5. Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për të hequr afatin dyvjeçar për të gjitha veprat penale të Kapitullit XXXIV, “Korupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”, të Kodit Nr.

04/L-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, është zgjidhja më efikase e mosndjekjes adekuate të rasteve të korrupsionit dhe nuk do të paraqiste shkelje të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon Kuvendin e Republikës së Kosovës që:

(1) Të ndryshojë nenin 159 të Kodit Nr. 04/L-123, Kodi i Procedurës Penale, për të hequr afatin dyvjeçar për të gjitha veprat penale të Kapitullit XXXIV “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 415/2016

Raport lidhur me mohimin e së drejtës për qasje në drejtësi, respektivisht mungesën e qasjes në objektin e gjykatës në pjesën veriore të Mitrovicës

Për

Z.Nehat Idrizi
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Z. Blerim Isufaj
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Z. Ali Kutllovci
U. D. Kryetar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Z. Shyqyri Syla
Kryeprokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

Prishtinë, më 8 gusht 2016

QËLLIMI I RAPORTIT

Qëllimi i këtij raporti është të tërheqë vëmendje autoriteteve përgjegjëse nëse gjykata në pjesën veriore të Mitrovicës siguron qasje në drejtësi dhe nëse kjo qasje është në pajtim me standardin e trajtimit të barabartë të qytetarëve para Kushtetutës.

Me anë të këtij raporti Avokati i Popullit synon të tërheq vëmendjen e institucioneve përkatëse/kompetente për pasojat negative nga moszbatimi i ligjit, shkeljet e të drejtave themelore të njeriut për qasje në drejtësi, dhe të rekomandojë zgjidhje të mundshme.

PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

Që prej shkurtit 2008, saktësisht, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, sistemi gjyqësor në Mitrovicë përballet me probleme qenësore në funksionimin e tij. Sistemi gjyqësor kishë filluar punë prej 1 shtator 1999 deri më 20 shkurt 2008. Kështu, për më shumë se tetë vite, ky sistem pothuajse ka ndaluar së funksionuari tërësisht duke e bërë të pamundur për qytetarët e rajonit ushtrimin e të drejtave themelore për qasje në drejtësi, e drejtë kjo e garantuar me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë dhe me Kushtetutën e Kosovës.

Në ndërtesën e gjykatës që ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës nuk ka pasur qasje për gjyqtarët dhe prokurorët publik lokal dhe personelin ndihmës të tyre që pas ngjarjeve të muajve shkurt dhe mars 2008.⁴

Që nga vendosja e tyre zyrtare me 9 dhjetor 2008, ky kompleks i gjykatës është administruar nga personeli i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili aktualisht përbëhet prej gjyqtarëve, prokurorëve, personelit vendor (shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës) dhe personelit ndihmës ndërkombëtar.⁵

Në ndërtesën e Gjykatës në veri të Mitrovicës janë shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe nuk ka pasur qasje në ndërtesën e gjykatës në veri, që kanë mbetur 2500 lëndë të procedurës civile dhe 1700 lëndë të procedurës penale, ku asnjëherë nuk ka pasur mundësi të procedohen.⁶

Aktualisht Gjykata Themelore në Mitrovicë punon në objektin e ish Gjykatës Komunale në Vushtrri. Vitin e kaluar, dega në Vushtrri e GJTHM, është vendosur në një objekt të ri. Mungesa e hapësirave për punë në GJTHM, është e vështirë, pasi disa gjyqtarë punojnë në një zyre. Po ashtu, edhe i gjithë stafi punues kushtet e punës i ka të vështira për arsye të mungesës së hapësirave. Në objektin e gjykatës në veri gjendet EULEX-i. Shpenzimet e kërkuara për mirëmbajtje të objektit në veri paguhen, ndërsa nuk lejohet qasja.

Pothuajse shumica e lëndëve të prokurorisë që kanë mbetur në objekt në veri të Mitrovicës janë parashkruar, për arsye objektive të pamundësisë së qasjes në veri.

PTHM, tani funksionon në objektin e ish gjykatës në Vushtrri, kushtet e punës janë të vështira, për arsye të hapësirës për punë. Ka mungesë të prokurorëve. Pas vendosjes në objekt të ri të degës në Vushtrri të GJTHM, prokuroria ka edhe 2 zyre, por janë të pamjaftueshme për punë.

ANALIZA JURIDIKE

Bllokimi i lëndëve në pjesën veriore dhe mosfunksionimi i plotë i sistemit gjyqësor në Mitrovicë për më shumë se tetë vite paraqet shkelje serioze të drejtave të njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për

⁴Shih raportin e OSBE-së Janar 2011, lidhur me Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë

⁵Po aty, fq...

⁶Shkresë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, GJA.nr.209/2016, 01.07.2016

të Drejtat e Njeriut: e drejta për qasje në drejtësi, e drejta për liri dhe e drejta për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme. Ky raport do të fokusohet në të drejtën për qasje në drejtësi – e drejtë kjo fundamentale dhe burim i realizimit të drejtave të tjera.

E drejta për qasje në drejtësi

Qasja në drejtësi jo vetëm që është e drejtë në vete, por është gjithashtu një mjet fuqizues dhe mundësues në realizimin e ushtrimit të drejtave të tjera. E drejta e qasjes në gjykatë, është e drejtë fundamentale e njeriut e cila nënkupton që askush nuk mund të pengohet apo të ndalohej që t'i drejtohet një gjykate për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij, dhe ndalesat nuk mund të bëhen as nga kushtetuta, ligji, apo çfarëdo akti tjetër, por as nga vendimet individuale të ndonjë gjykate apo autoriteti tjetër.⁷

E drejta për qasje në drejtësi është e drejtë e përcaktuar dhe e mbrojtur me Konventën Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut⁸ (këtu e tutje KEDNJ): dhe në vete përfshin të drejtat themelore të njeriut, siç janë e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së⁹ e Drejta për Ankim Efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së.¹⁰

Qasja në drejtësi përmes gjykatave, "the right of access to a court" sipas KEDNJ nënkupton që gjykatat duhet të jenë të qasshme. Qasja mund të përfshijë gatishmërinë e gjykatave me juridiksion relevant, disponueshmërinë e interpretimit, qasjen në informata dhe qasjen në vendime gjyqësore. Pjesë e kësaj të drejtë gjithashtu mund të përfshihet edhe largësia gjeografike e gjykatës, pra nëse aplikantëve u pamundësohet ndjekja e rregullt e procedurave ligjore për shkak të largësisë gjeografike.¹¹

Duke i pasur parasysh elementet të cilat e karakterizojnë të drejtën për qasje në drejtësi – e cila kërkohet përmes gjykatave, mund të konstatohet që në rastin e Gjykatës së Mitrovicës është shkelur kjo e drejtë në përgjithësi dhe në veçanti: 1) Mohimi i qasjes në informata; 2) Qasja në vendime gjyqësore dhe 3) Mosgatishmëria e gjykatës me juridiksion për të vepruar.

E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut detyron shtetet të garantojnë të drejtën e çdo individi për të shkuar dhe për të pasur qasje në gjykatë - ose për të marrë një mbrojtje gjyqësore lidhur me një çështje penale, civile, administrative apo qoftë edhe për të gjetur se të drejtat e individit janë shkelur. Kështu, duke ditur që mbi 2700 lëndë civile dhe mbi 1500 lëndë penale kanë mbetur të pa proceduara kjo jo vetëm që ka diskriminuar një pjesë të qytetarëve të Kosovës (komunat veriore) por paraqet edhe një rëndesë dhe humbje të kredibilitetit dhe besueshmërinë në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Pamundësimi i ushtrimit të së drejtës për t'iu drejtuar drejtësisë, konkretisht gjykatës, paraqet shkeljen themelore dhe më të rëndësishme sepse vetëm përmes saj mundësohet arritja deri tek të drejtat e tjera

⁷Komentari Kushtetutës së Republikës së Kosovës fq.488

⁸KEDNJ është pjesë e sistemit tonë juridik e Kushtetues sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës "rregullat përgjithësisht të pranuaratë së drejtës ndërkombëtare bëhen pjesë e rendit juridik, se ato janë mbi ligjin vendor, dmth. mbi ligji në Republikës së Kosovës, të cilat i përkasin ligjit vendor kombëtar dhe, si të tilla, këto rregulla(parime) nuk i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë".

⁹Neni 6 KEDNJ "E drejta për një proces të rregullt: Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."

¹⁰Neni 13 KEDNJ: "E drejta për zgjidhje efektive: Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

¹¹Handbook access to justice

(nëpërmjet rrugëve gjyqësore deri tek vendimet meritorë). Me këtë rast, qytetarëve të Mitrovicës u pamundësohet për të mbrojtur vetën kundër shkeljeve të drejtave të tyre, për të korrigjuar gabimet/shkeljet civile, për të mbajtur pushtetin ekzekutiv të përgjegjshëm dhe për të mbrojtur veten e tyre në procedurat penale.

E drejta për procedurë të drejtë dhe zgjidhja me kohë e mosmarrëveshjeve, e drejta për dëmshpërblim të përshtatshëm, si dhe zbatimi i përgjithshëm i parimeve të efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e drejtësisë të cilat parashihen në të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane shkelen në momentin e mohimit të ushtrimit të së drejtës për qasje në drejtësi.¹²

Zbatimi në praktikë i së drejtës për qasje në gjykatë shihet në rastin *Golder v. United Kingdom*¹³ ku një i burgosur kishte tentuar ta padiste rojën e burgut për shpifje sipas procedurës civile, gjë që nuk ishte pranuar nga gjykata nacionale, prandaj GjEDNj vendosi që refuzimi i gjykimit të një padie të tillë nga gjykata ishte shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë të të burgosurit. Sipas paragrafit 36 të Aktgjykimit e drejta për qasje “right to court” interpretohet si në vijim: “Pjesë e së drejtësisë për gjykim ose e qasjes në drejtësi është e drejta për të dorëzuar pranë Gjykatës ose tribunalit çfarëdo lloji të parashtrësës mbi të cilën do të veproi gjykata në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile. “Right to the court” ose e drejta për qasje në drejtësi përfshinë të drejtën që të iniciohen procedura në çështje civile pranë gjykatës kompetente”.

E drejta e qasjes në gjykatë ku GJENDJ konstatoi se Pamundësia e një pale që padia e saj të dëgjohet efektivisht nga një gjykatë në lidhje me një kontest civil është trajtuar nga Gjykata edhe në rastin *Immobiliare Saffi v. Italy*,¹⁴ ku u konstatua se kjo parqet shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, dhe rrjedhimisht në kundërshtim me parimin e shtetit demokratik dhe shtetit e së drejtës.

GjEDNj në rastin *Brandstetter v. Austria*,¹⁵ vendosi që palës së akuzuar i ishte shkëlur e drejta për qasje të barabartë në gjykatë pasi që ankesa e prokurorisë e bërë në gjykatë nuk i ishte dërguar edhe palës së akuzuar, dhe rrjedhimisht kjo e fundit nuk ishte ofruar mundësia e përgjigjes ndaj pretendimit të ankesës së prokurorit.

E drejta për qasje së barabartë në gjykatë është standard i së drejtës për gjykim të drejtë dhe nënkupton që secila palë në procedurën gjyqësore duhet t’i ofrohet ambient dhe kohë e arsyeshme për të dhënë shpjegime mbi rastin, në mënyrë që të mos shihet në sytë e të tjerëve që njëra palë ishte paarsyeshëm e kufizuar ndaj kundërshtarit të tij/saj.¹⁶

Qasja në drejtësi sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh të drejtën për qasje në drejtësi, ku nën nenin 102.2 përcaktohet se “Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.”, duke u bazuar në nenin 102.2 qasja në gjykatë është një e drejtë kushtetuese e garantuar kjo e drejtë kushtetuese konkretizohet edhe me nenin 7 të Ligjit për Gjykata sipas të cilit përcaktohet se “Çdo person ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj”

¹² Doracak mbi ligjin evropian në lidhje me qasjen në drejtësi

¹³ Case of *Golder v. THE UNITED KINGDOM* (Application no. 4451/70) JUDGMENT STRASBOURG 21 February 1975

¹⁴ Case of, *Immobiliare Saffi v. Italy*, Application No. 22774/93, 28 July 1999, Judgement.

¹⁵ Case of, *Brandstetter v. Austria*, 28 August 1991, Judgment, Series A. No. 21, f. 28, para. 68.

¹⁶ Rastin *Bulut v. Austria*,¹⁶

Me kushtetutën e Republikës së Kosovës përcaktohet se çdo person ka të drejtë të qasen në gjykatë, kjo qasje duhet të jetë e barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa diskriminim. Qasja në gjykatë në përputhje me Kushtetutë nënkupton se çdo person pa diskriminim dhe në mënyrë të barabartë ka të drejtë ti drejtohet gjykatës për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tij kushtetuese e ligjore. Qasja në gjykatë përfshinë të drejtën që çdo person ti drejtohet gjykatës dhe të ketë qasje si fizikisht ashtu edhe me anë të shkresave dhe mjeteve tjera juridike.

E drejta e qasjes në drejtësi në përgjithësi dhe e drejta për qasje në gjykatë në veçanti paraqet një element shumë të rëndësishëm duke pasur parasysh se gjykatat ofrojnë mbrojtje gjyqësore të drejtave¹⁷ kundër praktikave të paligjshme dhe mundësojnë zbatimin dhe sundimin e ligjit. Vetëm përmes një gjykate funksionale dhe një sistemi gjyqësor funksional mund të garantohet sundimi i ligjit.

Shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë ekziston në raste: a) kur gjykatat refuzojnë të pranojnë një palë mbi baza *locus standi*, duke e konsideruar që çështja e palës nuk mund t'i qaset gjykatës; b) kur e drejta për qasje në gjykatë kufizohet nga procedura apo kufizime të ndryshme; dhe c) kur vendimet finale gjyqësore nuk zbatohen nga institucionet përkatëse.¹⁸

Mohimi i qasjes në gjykatë paraqet shkelje të të drejtave të njeriut të përcaktuara me KEDNJ dhe Kushtetutë, shkelja e kësaj të drejte i pamundëson personave që të dërgojnë çështjet në Gjykatë Kushtetuese në përputhje nenin 113 paragrafi 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Neni 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ku përcaktohet se “1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. 2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.” me rastin e pamundësimin të dërgimit të çështjes në Gjykatë personave ju pamundësohet edhe shterja e mjeteve juridike që është kusht për dërgimin e një çështje në Gjykatën Kushtetuese dhe në këtë formë personave ju mohohet edhe një e drejtë Kushtetuese.

KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Avokati i Popullit konstaton se:

Mungesa e një sistemi gjyqësor plotësisht funksional në veri të Kosovës paraqet pengesa të mëdha në të drejtat e individit për qasje në drejtësi. Në rastin konkret të shtetasve të Republikës së Kosovës në përgjithësi dhe banorëve të asaj pjese që bie në kompetencë territoriale të asaj gjykate u është penguar vazhdimisht e drejta për qasje në drejtësi që nga 20 shkurti 2008 deri më sot. Mohimi për më shumë se 8 vite i qasjes në Gjykatën në veri të Mitrovicës shkel:

- (1) Të drejtën për gjykim të drejtë e përcaktuar dhe e mbrojtur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe me nenin 102 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹⁷ Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës; *Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave*: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

¹⁸ Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fq.489

- (2) Me rastin e shkeljes së drejtës për qasjes në gjykatë shkelet edhe e drejta për mjete efikase juridike të përcaktuar dhe të mbrojtur nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁹
- (3) E drejta për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshem nga një gjykatë e pavarur e krijuar me ligj e drejtë kjo e përcaktuar dhe e mbrojtur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- (4) Të drejtën për mbrojtje gjyqësore të drejtave të përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.²⁰
- (5) Të drejtës për mbrojtjen e pronësisë dhe pronës e përcaktuar dhe e mbrojtur me nenin 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - KEDNJ-së (protokolli shtesë Paris, 20.III.1952) përkatësisht me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- (6) Funksionimi jo i rregullt i sistemit gjyqësor dhe mohimi i të drejtës për qasjes në gjykatë shkakton pasojat serioze edhe në sundimin e ligjit, forcimin e rendit publik dhe mbrojtjen e rajonit nga praktikatat e kundërligjshme.²¹
- (7) Parashkrimet ligjore: Veprat penale për të cilat në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës parashihet parashkrimi, si pasoj e mungesës së qasjes në gjykatë dhe funksionimit jo të rregullt të organeve gjyqësore pas kalimit të afatit të paraparë ligjorë arrijnë parashkrimin.²²

REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 8 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon që:

- 1) *Këshilli Gjyqësor i Kosovës në afatin sa më të shkurtër kohor të funksionalizojë sistemin gjyqësor në rajonin e Mitrovicës, duke mundësuar kështu qasjen në lëndët civile dhe penale të bllokuara prej vitit 2008 dhe të procedojë me ato që do të vijojnë.*
- 2) *Gjykata në pjesën veriore në Mitrovicë të marrë masat e nevojshme për heqjen e të gjitha pengesave fizike dhe administrative të qasjes në dokumente dhe të bashkëpunojë në nivelin e duhur me pjesën tjetër të degëve të Gjykatës së Mitrovicës.*

¹⁹ Shkelja e të drejtës për qasje në gjykatë shkakton edhe shkelje të së drejtës për mjete juridike efikase sepse me shkeljen e të drejtës për qasje në gjykatë pamundësohet dërgimi i shkresave në gjykatë, shkresave si janë kërkesat ankesat mjetet tjera juridike.

²⁰ Neni 54 i KRK-së parasheh: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

²¹ Mohimi i qasjes në gjykatë dhe organet e drejtësisë pamundëson organet shtetërore po edhe personat që të realizojnë obligimet e tyre ligjore dhe të raportojnë krimin.

²² Parashkrimi paraqitet në ato raste ku veprat penale kanë afat të parashkrimit më të shkurtër se 8 vite, kryesisht veprat penale që kanë dënime me më pak vite burg, veprat penale që kanë dënime me gjoba dhe kundërvajtjet.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 421/2016

Raport lidhur me të drejtën për jetë në rastin B.R.

Për

Z. Imet Rrahmani, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Znj. Ardita Baraku, kryeinspektore shëndetësore
Ministria e Shëndetësisë,

Z. Curr Gjocaj, Drejtor
Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës

Z. Hilmi Mehmeti, Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

Prishtinë, më 10 gusht 2016

QËLLIMI I RAPORTIT

Avokati i Popullit, bazuar në një shkrim të portalit “*Telegrafi.com*”, të datës 12 korrik 2016, ka hapur rast për hetim sipas detyrës zyrtare. Ky raport ka të bëjë me pretendimet e shkrimeve në mediat e shkruara dhe elektronike, lidhur me mungesën e trajtimit të nevojshëm psikiatrik për të ndjerin B. R. (B.R. *i cili ishte i diagnostikuar me sëmundje kronike psikiatrike dhe ishte në trajtim mjekësor nga viti 2003*), dhe synon të vë në pah pasojat e mosbashkëpunimit të autoriteteve përgjegjëse shëndetësore me policinë dhe familjen, si pasojë e së cilës një person ka humbur jetën.

VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

1. Më 13 korrik 2016, Avokati i Popullit ka hapur rast për hetim sipas detyrës zyrtare, bazuar në një shkrim në portalin “*Telegrafi.com*”, të datës 12 korrik 2016. Më 9 korrik 2016, personi në fjalë kishte sulmuar dhe lënduar me armë të ftohtë (thikë) një fëmijë të moshës 11 vjeçare, e më pas kishte sulmuar patrullën policore duke e lënduar njërin nga zyrtarët policor. Pas kësaj zyrtarët policor me përdorimin e armës së zjarrit kishin privuar nga jeta B.R.
2. Më 20 korrik 201, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me ushtruesin e detyrës të Drejtorit Ekzekutiv në SR në Gjilan, të cilin pasi e njoftuan me qëllimin e vizitës atje biseduan lidhur me rastin e B.R. Ai theksoi se të gjitha informatat lidhur me trajtimin mjekësor për B.R. gjinden në Repartin Psikiatrik të këtij spitali dhe të njëjtat mund të sigurohen atje.
3. Ditën e njëjtë përfaqësuesit e IAP-së u takuan me shefin e Repartit Psikiatrik të SR në Gjilan. Gjatë kësaj kohe ata u takuan edhe me Psikologjen Klinike të Repartit Psikiatrik, me të cilën biseduan lidhur me trajtimin psikiatrik të B.R. Ajo deklaroi se në kohën kur ka ndodhur rasti ishte në pushim vjetor, prandaj nuk mund të ofronte asnjë informacion rreth kësaj çështje. Në pyetjen lidhur me trajtimet e mëhershëm psikiatrike të B.R., ajo ishte përgjigjur :”*Ka tri vite e gjysmë që punoj në këtë repart, por asnjëherë nuk e kam trajtuar të ndjerin B.R.*”.
4. Ditën e njëjtë përfaqësuesit e IAP-së u takuan me shefin e Repartit Psikiatrik të SR në Gjilan me të cilin biseduan lidhur me trajtimin shëndetësor të B.R. Ai kishte njoftuar se B.R. ishte pranuar në Repartin Psikiatrik me 6 korrik 2016, me nr. amzë 25-67. Sipas tij B.R. ishte hospitalizuar me vetë dëshirë dhe që më parë ishte diagnostifikuar me sëmundjen (sipas klasifikimit ndërkombëtar kodi F-20.0), si dhe aty ishte trajtuar deri me datë 8 korrik 2016, kur ishte larguar nga Reparti Psikiatrik pa leje dhe pa dijëni të stafit shëndetësor. Ai deklaroi se infermierët pasi kishin kuptuar për largimin e tij, e kishin njoftuar policinë, por nga evidenca mjekësore shihej qartë se nuk ishte evidentuar koha e largimit nga reparti dhe koha kur është njoftuar policia. Lidhur me mjekimet e mëhershme, shefi i repartit i njoftoi se B.R. mjekohej në këtë repart nga viti 2003 dhe ishte hospitalizuar së paku tetë herë, duke theksuar se trajtimi i fundit mjekësor ishte bërë në muajin mars 2015. Ai kishte sqaruar se B.R. ishte sjellë në repart nga familjarët apo kishte ardhur vetë dhe ai asnjëherë nuk kishte urdhër gjykate për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Sipas tij, këtë repart e frekuentojnë rreth gjashtëqind (600) pacient me çrregullime kronike psikotike [...].Përfaqësuesit e IAP-së kërkuan kopje nga dosja mjekësore e rastit, dhe nga ai u udhëzuan që t'i kërkojmë në arkiv të SR. Kopja fizike e historisë së sëmundjes me Nr.25-67, datë 6 korrik 2016, e pacientit u sigurua nga drejtori i Administratës së SR.
5. Po atë ditë përfaqësuesit e IAP-së u takuan me komandantin e Stacionit Policor në Gjilan, me të cilin biseduan lidhur me rastin e B.R. Ai sqaroi se në ngjarjen e 9 korrikut 2016, zyrtarët policor ishin të detyruar të veprojnë për t'u vetëmbrojtur. Ai i njoftoi se ditën kritike, qendra e thirrjeve pranë Stacionit Policor në Gjilan, kishte pranuar një thirrje telefonike nga një qytetar se: “*Një person i armatosur me dy thika e ka plagosur një fëmijë rreth 11 vjeç, si dhe është duke i ndjekur ti godasë me thika disa fëmijë të tjerë*”. Ai sqaroi se policia ju kishte përgjigjur thirrjes dhe menjëherë kishte

shkuar në vendin e ngjarjes, por ku me të ndalur automjetin, zyrtarët policor ishin sulmuar nga i ndjeri B.R. dhe njëri nga zyrtarët policor ishte goditur me thikë në disa pjesë të trupit dhe kishte marrë lëndime të rënda trupore. Sipas tij, zyrtari tjetër policor poashtu ishte rrezikuar nga sulmi i B.R. dhe pas disa paralajmërimeve dhe në pamundësi ta zmbrajs sulmin e B.R., kishte përdorur armën e zjarrit me qëllim që ta neutralizoj sulmin, por fatkeqësisht të shtënat nga arma e zjarrit ishin fatale për B.R. Sipas tij, pas kësaj ngjarje banorët kishin treguar se ditën kritike i ndjeri B.R. i kishte rreshtuar disa fëmije dhe kishte për qëllim t'i godasë me thikë dhe posa e kishte goditur njërin, fëmijët tjerë kishin filluar të iknin duke iu shmangur kështu më të keqes. Ai sqaroi se Inspektorati Policor i Kosovës është duke e hetuar rastin dhe dosja e rastit gjendet në Inspektoratin Policor të Kosovës. Ai sqaroi se Reparti Psikiatrik nuk e ka njoftuar policinë lidhur me arratisjen e këtij personi nga spitali dhe e vetmja thirrje që ka pranuar policia lidhur me këtë çështje kishte ardhur nga qytetari lidhur me dhunën fizike ndaj fëmijëve.

6. Ditën e njëjtë përfaqësuesit e IAP-së u takuan me drejtorin e Qendrës për Shëndetin Mendor në Gjilan, me të cilin biseduan lidhur me rastin e B.R. Ai sqaroi se B.R. ishte mjekuar në këtë qendër nga data 10 shkurt 2005 dhe sipas tij ai asnjëherë nuk kishte *urdhër për trajtim të detyrueshëm psikiatrik* nga gjykata, pasi që njëti nuk ishte delikuent dhe nuk ishte agresiv ndaj personave tjerë.
7. Më 29 korrik 2016, përfaqësuesi i IAP-së u takua me zyrtarët përgjegjës të Gjykatës Themelore (GJTH) në Gjilan, me të cilët bisedoi lidhur me dënimet e mëhershme të B.R. Ata e njoftuan se nga evidenca gjyqësore shihet se pranë kësaj gjykate ishte zhvilluar procedurë penale kundër B.R., sepse ai me datë 13 mars 2008, tek thertorja “*Malësia*” në Gjilan, fillimisht e kishte fyer të dëmtuarin S.P., e pastaj e kishte goditur me thikë duke i shkaktuar lëndime trupore. Lidhur me këtë çështje, GJTH në Gjilan, kishte mbajtur seancë dhe më 6 shtator 2011, e kishte shpallur fajtor B.R. duke i shqiptuar *Masën e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri (Aktvendimi P.nr.548/2008, datë 6 shtator 2011)*.

SIPAS FAKTEVE

I. RRETHANAT E RASTIT

Faktet, të cilat deri tani kanë mund të vërtetohen, bazohen në dosjen mjekësore “*Historia e Sëmundjes*” Nr. amë 25-67, datë 6 korrik 2016, Reparti Psikiatrik i Spitalit Rajonal në Gjilan, Aktvendimi i GJTH në Gjilan, P.nr.548/2008, datë 6 shtator 2011, si dhe në bazë të informatave të tjera që Avokati i Popullit i pati në dispozicion, mund të paraqiten si më poshtë:

8. Më 6 korrik 2016, B.R. ishte pranuar në Repartin Psikiatrik të SR në Gjilan, dhe ishte evidentuar sipas *Historisë së Sëmundjes* me Nr. amë 25-67, me diagnozën udhëzuese “*Çrregullim i Psikozës, F-20*, ndërsa ishte lëshuar nga SR me 9 korrik 2016, me diagnozën përfundimtare *Çrregullim i Psikotik, F-20.0*”.
9. Nga anamneza dhe konstatimi Nr. amë 25-67, datë 7 korrik 2016, kuptojmë se B.R., ka lindur në vitin 1980. Hospitalizmi është i përsëritur për shkak të përkeqësimit të sëmundjes së manifestuar me pagjumësi, halucinacione, auditive, bredhjeve të shumta dhe pamundësisë për të qëndruar në një vend.
10. Nga përshkrimi i gjendjes së pacientit sipas fletë lëshimit të datës 9 korrik 2016 shkruhet: “*Në pyetjet e parashtruara përgjigjej shkurt, jepte kryesisht përgjigje logjike, në të menduar dominonin idetë deluzive, kryesisht të përndjekjes dhe interpretimit*” ndërsa në fund kemi shënimin: “*P.S. gjatë qëndrimit në repart është vërejtur një lloj paretatie dhe euforie por qëndrimi i tij ndaj personelit dhe pacientëve ka qenë korrekt. Është trajtuar me terapi kundër psikozës dhe kundër depresionit. Më 3 korrik 2016, kishte marrë Haloperidol depo 50mg. Ka kërkuar nga shefi i repartit dhe psikiatri*

ordinues vikend, por nuk i është lejuar. Më 10 korrik 2016, në ora 7 e 22 infermierja kujdestare më informon me mesazh se pacienti ishte nga policia të shtunën në mbrëmje. Fletë lëshimi bëhet në rrugë administrative”.

11. Më 21 korrik 2016, IAP u njoftua me shkrimin e publikuar në mediat elektronike lidhur me deklaratën publike të z. Muhamet B. Redenica, e titulluar: “*Rrëfimi i qytetarit nga Gjilani, që pa me sy vrasjen e 9 korrikut*”²³. Kjo deklaratë e z. Redenica e përshkruan hollësisht ngjarjen e lartshënuar.

II. INSTRUMENTET RELEVANTE LIGJORE

12. Neni 21, paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “Kushtetua”) përcakton si në vijim:

“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”

“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tjerëve.”

13. Neni 25, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton si në vijim:

“Secili individ gëzon të drejtën për jetën [...]”.

“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]”.

14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29, paragrafi 1 përcakton: “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente si në vijim:*

Pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

Për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;

Për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, [...]”.

15. Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950), (në tekstin e mëtejme “Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut”, ose “Konventa”) thotë:

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]”.

16. Neni 5, paragrafi 1 Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut”:

”Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”.

²³ <http://www.botasot.info/aktuale-lajme/554572/rrefimi-i-qytetarit-nga-gjilani-qe-pa-me-sy-vrasjen-e-9-korrikut/>, shkarkuar me datë 21 korrik 2016.

17. Neni 75 i Ligjit për Procedurën Jokontestimore Nr. 03/L-007, përcakton: *“Sipas rregullave të kësaj procedure gjykata me aktvendim vendosë për mbajtjen e personit të sëmurë mendërisht (psikik) në institucionin shëndetësor, kur për shkak të natyrës së sëmundjes është e domosdoshme që personi i këtillë të kufizohet në lirinë e lëvizjes dhe të komunikimit me njerëzit jashtë institucionit në fjalë”*.
18. Neni 13, paragrafi 2 i Ligjit Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17, përcakton: *“Nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, Qendra për Punë Sociale duhet të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për një urdhër kujdestarie”*.
19. Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor nr.2004/38,përcakton: *“Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim”, kurse paragrafi 2 i këtij neni përcakton: “Kujdesi shëndetësor është adekuat, në rast se është në përputhje me rregullat etike dhe profesionale, si dhe me udhëzimet relevante, të shërbimit të caktuar shëndetësor”, ndërsa neni 8, paragrafi 3 përcakton : “Në rast se, qytetari largohet nga institucioni shëndetësor pa paralajmërim, mjeku përgjegjës duhet ta evidentojë këtë fakt në dokumentacionin e tij, shëndetësor; atëherë kur, largimi i paparalajmëruar nga institucioni shëndetësor, është i kushtëzuar me gjendjen shëndetësore të qytetarit, duhet të njoftohen autoritetet kompetente, ndërsa në rastin e qytetarit, i cili nuk ka aftësi veprimi, ose ka aftësi të zvogëluar veprimi, duhet të njoftohet përfaqësuesi ligjor i tij”*
20. Neni 1 i Ligjit për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025, (në tekstin e mëtejme “Ligji për Shëndetin Mendor”) përcakton: *“Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore”*. kurse neni 9, paragrafi 1 përcakton: *“Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Në raste të veçanta kjo masë mund të propozohet me kërkesë të komisionit psikiatriko-ligjor. Vendimi përkatës merret nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”*.
21. Neni 5 paragrafi 1 i Ligjit për Shëndetin Mendor, përcakton parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor ndër të cilat janë:
 - 1.1. *“Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.*
 - 1.2. *Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social;*
 - 1.3. *Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore.*
- 1.4. *Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekipe multidisciplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit [....]”*.

22. Neni 16, paragrafi 1, i Ligjit për Shëndetin Mendor, përcakton: “Autoriteti shtetëror përgjegjës garanton mbështetjen psikologjike, psiko-pedagogjike, shërbimet e ndihmës personale ose familjare, si dhe mbështetje financiare përmes skemave të parapara me dispozitat ligjore për personat me aftësi të kufizuara apo personat me çrregullime mendore”, kurse paragrafi 2, përcakton: “Familjet, që kanë persona me çrregullime mendore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse që merren me kujdesin, trajtimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime mendore, kujdesin dhe mbështesin këta persona për integrimin e tyre në familje, komunitet dhe shoqëri”.
23. Neni 19, paragrafi 1 i Ligjit për Shëndetin Mendor, përcakton: “Personi me çrregullime mendore merr trajtim të vullnetshëm në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kusht të informimit paraprak” kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton: “Miratimi i informuar sigurohet nëpërmjet diskutimit me pacientin për natyrën dhe qëllimin e ndërhyrjes terapeutike të propozuar. Përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar janë pjesë e kartelës klinike të pacientit. Pacienti nënshkruan për dhënien e miratimit si në kartelë ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar”
24. Neni 27, paragrafi 1 i Ligjit për Shëndetin Mendor përcakton: “Kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe përfshin, sipas protokollit përkatës, elementet e mëposhtme:
- Mbajtjen me forcë të personit;*
- Përdorimin e detyruar të medikamenteve;*
- Imobilizimin;*
- Izolimin,*
- kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton:*
- “Gjatë kufizimit fizik, kontakti i stafit të shërbimit të shëndetit mendor me klientin duhet të jetë aktiv dhe i vazhdueshëm, që shkon përtej monitorimit rutinë, sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë”*
25. Neni 33 paragrafi 1.2, i Ligjit për Shëndetin Mendor përcakton: “Shkelja e paragrafit 1 të nenit 19 kryerja e trajtimit të vullnetshëm pa marrë miratimin e informuar, dënohet me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në tre (3) vjet”, kurse paragrafi 2 përcakton: “Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobës për shkeljet nga paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 i këtij neni është Inspektoriati i Ministrisë së Shëndetësisë”.
26. Neni 2, paragrafi 2 i Ligjit për Policinë nr. 04/L-076, (në tekstin e mëtejshëm “Ligji për Policinë” përcakton: “Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme”,
27. Neni 10 i Ligjit për Policinë, me të cilin përcaktohen detyrat dhe kompetencat e përgjithshme të policisë, si detyrë parësore përcakton si në vijim:
- “Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat [...]”, kurse neni 19, paragrafi 1 i Ligjit për Policinë përcakton: “Zyrtari policor është i autorizuar të jap vërejtje gojore, me shkrim, vizuale ose vërejtje të tjera ndaj çdo personi që paraqet rrezik për sigurinë personale apo*

publike, paraqet rrezik për pronën private apo publike, prish rendin dhe qetësinë publike, paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion ose ekziston dyshimi i bazuar se është duke kryer apo duke u përgatitur për të kryer një vepër penale ose është duke e detyruar personin tjetër të kryejë vepër penale”.

28. Neni 27 i Ligjit për Policinë në paragrafin 1 përcakton: “Zyrtari policor është i autorizuar të posedoj dhe ta bartë armën zyrtare të zjarrit të lejuar nga policia. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për ta arritur objektivin ligjor të policisë, kur përdorimi i saj është në proporcion me shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e veprës penale në atë situatë dhe vetëm nëse konsiderohet se me përdorimin e mjeteve më të vogla të forcës nuk do të arrihen objektivat legjitime të policisë”, kurse paragrafi 2 i këtij ligji përcakton: “Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër personit tjetër vetëm kur mjetet më pak ekstreme janë të pamjaftueshme që ta:

mbroj jetën e vet ose jetën e të tjerëve nga sulmet e pashmangshme;

parandaloj kryerjen e pashmangshme apo vazhdimësinë e veprës penale që shkakton rrezik të lartë për jetën;

arrestoj personin i cili paraqet rrezik për jetën e të tjerëve dhe që u reziston urdhrave ligjor të dhënë nga zyrtari policor; dhe

parandaloj arratisjen e personit i cili paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor”;

kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton: “Para se ta përdorë armën e zjarrit, zyrtari policor jep vërejtje gojore, prezanton vetën si zyrtar policor, duke urdhëruar personin që të ndalet, por edhe duke e paralajmëruar se do të shtie nëse ai/ajo nuk ndalet.

III. ANALIZA LIGJORE

Kushtetuta si akti më i lartë juridik mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë këtu edhe institucionet shëndetësore.

Kushtetuta në nenin 25, paragrafin 1 përcakton: ”Secili individ gëzon të drejtën për jetën”. Nga ky paragrafi shihet qartë se drejta për respektimin e jetës së qytetarit gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e drejta për jetën (pacenueshmëria e saj) është e drejtë absolute e njeriut, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, shmangia nga kjo e drejtë nuk lejohet.

Avokati i Popullit vëren që Kushtetuta në nenin 26 definon që secili person ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përveç tjerash kur bëhet fjalë për të drejtën e integritetit personal dhe të drejtën në jetë, shteti ka detyrim pozitiv të ndërmarrë të gjitha masat për të mbrojtur pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe psikik të personave, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut.

Në kuptim të dispozitës së nenit 2 dhe nenit 5 paragrafit 1 të Konventës, Avokati i Popullit rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata Evropiane”).

Neni 2 i Konventës paraqet detyrat e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshin aspektet pozitive dhe negative: a) obligimin pozitiv për ta mbrojtur jetën dhe b) obligimin negativ që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të parandalimit dhe hetimit. Detyrimet e parandalimit (shih rastin *Osmani kundër Britanisë së Madhe* të datës 28 shkurt 1998) i obligon qeveritë e shteteve t’i pengojnë dhe luftojnë veprat penale. Nëse vërtetohet që qeveritë kishin njohuri, ose do të duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.

Neni 2 i Konventës, gjithashtu ia imponon detyrimin shtetit për t’i hetuar incidentet vdekjeprurëse duke përcaktuar që elementet kyçe të hetimit në përputhje me nenin 2 janë:

që të jetë i iniciuar nga shteti sipas vullnetit të vet;

që të jetë i pavarur;

që të jetë efektiv;

që publiku të ketë njohuri të mjaftueshme lidhur me të njëjtin hetim, (të jetë i hapur për publikun);

që të jetë mjaft i shpejtë dhe

që të afërmit/familja të jenë të përfshirë.

Në bazë të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNj) fushëveprimi dhe natyra e detyrës që të hetohen incidentet mortore/fatale janë të shpjeguara, në veçanti, në rastin *Tanrikulu kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 8 korrik 1999. Gjykata ka vlerësuar se obligimi që të hetohen rastet e vdekjes nuk ka të bëjë vetëm me rastet e vdekjeve, për të cilat përgjegjës kanë qenë zyrtarët e shtetit, por të gjitha ato raste të vdekjeve për të cilat autoritetet kanë qenë të informuara, domethënë, për të cilat kanë pasur njohuri. Autoritetet duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm/të domosdoshëm që të sigurojnë prova relevante (përfshirë edhe dëshmitë e dëshmitarëve okularë dhe provat e forenzikës), në mënyrë që hetimi të jetë i dobishëm dhe efikas. Prandaj, dështimi për t’u vazhduar rrjedha e qartë e ekzaminimit gjatë hetimeve mund të çojë në konstatimin e një shkeljeje të nenit 2.

GJEDNj në lëndën *Ramsahai* dhe të tjerët kundër Holandës, aktgjykimi i datës 15 maj 2007, konstatoi që: ”ata që janë përgjegjës për bërjen e hetimeve duhet të jenë të pavarur nga personat që janë të përfshirë në incident, qoftë në aspektin e pavarësisë hierarkike dhe institucionale, qoftë në aspektin e pavarësisë praktike”. Kur autoritetet janë të informuara për rastin e vdekjes, ose marrin informacion në lidhje me atë ngjarje në ndonjë mënyrë tjetër, ato janë të obliguara ta bëjnë hetimin, pa marrë parasysh a e ka parashtruar familja e të vdekurit domosdoshmërisht ankesën formale dhe organet hetuese duhet gjithashtu të veprojnë shpejt dhe në mënyrë të arsyeshme.

Gjatë interpretimit të nenit 2 të Konventës në rastin *Branko Tomašić* dhe të tjerët kundër Kroacisë, të datës 15 janar 2009, lidhur me detyrimet pozitive Gjykata ka konstatuar që autoritetet ishin në dijeni për seriozitetin e kërcënimeve, por dështuan në detyrimet e veta pozitive, para se gjithash për shkak të

trajtimin të pamjaftueshëm psikiatrik duke konsideruar që shërimi zgjati shumë shkurtë, por nuk është e qartë, nëse shërimi ishte aplikuar në të vërtetë dhe siç duhet, gjë që mund të aplikohet edhe në rastin konkret.

KEDNJ, neni 5, paragrafi 1, e lejon ndalimin si të ligjshëm për rastet e ndalimit të “Personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, të alkolizuarve ose toksikomanëve apo rrugaçëve”. Për sa i përket arsyes se pse personat që bëjnë pjesë në disa nga këto kategori mund të ndalohen, Gjykata Evropiane u shpreh se “Jo vetëm që ata duhet të konsiderohen me raste si të rrezikshëm për sigurinë publike, por gjithashtu se vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin përkatës”.

Ligji për Procedurën Jokontestimore përcakton qartë rregullat e procedurës kur gjykata mund të vendosë për mbajtjen e personit të sëmurë mendërisht (psikik) në institucionin shëndetësor, kur për shkak të natyrës së sëmundjes është e domosdoshme që personi i këtillë të kufizohet në lirinë e lëvizjes dhe të komunikimit me njerëzit jashtë institucionit. Institucioni shëndetësor duhet drejtuar gjykatës me njoftim me shkrim i cili duhet t’i përmbajë të dhënat për personin e mbajtur në institucion, si dhe për personin që e ka sjellë në atë institucionin shëndetësor. Gjithashtu, bashkë me shkresën njoftuese institucioni shëndetësor ia dërgon gjykatës edhe të dhënat lidhur me natyrën dhe shkallën e sëmundjes, si dhe lidhur me dokumentacionin mjekësor që disponon. Ky ligj e ngarkon më tej gjykatën kompetente, në territorin e të cilës ndodhet institucioni shëndetësor, që menjëherë pasi ta marrë njoftimin (sipas nenit 78 dhe 80 Ligjit për Procedurën Jokontestimore), ose pasi në çfarëdo mënyre tjetër të njoftohet për ndaljen e personit të sëmurë mendërisht pa pëlqimin e tij në institucionin shëndetësor, sipas detyrës zyrtare ta fillojë procedurën për mbajtjen e tij të mëtejme.

Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor në nenin 4, paragrafin 1 përcakton:

“Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim”,

ndërsa i njëjti ligj në paragrafin 2 përcakton:

“Kujdesi shëndetësor është adekuat, në rast se është në përputhje me rregullat etike dhe profesionale, si dhe me udhëzimet relevante, të shërbimit të caktuar shëndetësor.

Qëllimi i këtij ligji sipas ligjvënësit është që të definohen të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, si dhe të vendosen mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësisive. Ligji i obligon institucionet shëndetësore që t’i kushtojnë kujdes shëndetit të pacientit gjatë gjithë kohës, derisa i njëjti gjendet në institucione shëndetësore, në pajtim me rregullat etike dhe profesionale. Ky ligj në vete përmban më shumë të drejta në raport me ofrimin e shërbimeve shëndetësore duke i obliguar institucionet shëndetësore t’i respektojnë të drejtat e qytetarëve për kujdes cilësor shëndetësor, të drejtën e zgjedhjes së profesionistit shëndetësor, të drejtën në dinjitetin njerëzor, të drejtën e komunikimit, të drejtën e largimit nga institucioni, të drejtën për të qenë i informuar, të drejtën e vendimit personal etj.

Neni 8 i këtij ligji përcakton:

“Qytetari, ka të drejtë, që të largohet nga institucioni shëndetësor. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në mënyrën e përcaktuar me ligj, në rastet kur me këtë veprim, rrezikohet siguria fizike ose shëndeti i të tjerëve”,

ndërsa neni 8, paragrafi 3 definon:

“Në rast se, qytetari largohet nga institucioni shëndetësor pa paralajmërim, mjeku përgjegjës duhet ta evidentojë këtë fakt në dokumentacionin e tij shëndetësor atëherë kur, largimi i paparalajmëruar nga institucioni shëndetësor, është i kushtëzuar me gjendjen shëndetësore të qytetarit, duhet të njoftohen autoritetet kompetente, ndërsa në rastin e qytetarit, i cili nuk ka aftësi veprimi, ose ka aftësi të zvogëluar veprimi, duhet të njoftohet përfaqësuesi ligjor i tij.”

Nga analiza e këtyre neneve shihet se ligji kërkon qasje etike dhe profesionale ndaj pacientit, kurse në rastin konkret shihet se institucioni shëndetësor kishte dështuar të ofrojë kujdesin obligativ. Pacienti duke e shfrytëzuar moskujdesin e personelit mjekësor, pa u vërejtur, është larguar nga spitali dhe largimi i tij nuk ishte evidentuar fare në dokumentacionin shëndetësor dhe nuk kishte prova me të cilat do provohesh se janë njoftuar autoritetet kompetente, në pajtim me ligjin.

Ligji për Shëndetin Mendor, në nenin 16 përcakton qartë se autoriteti shtetëror përgjegjës garanton mbështetjen psikologjike, psiko-pedagogjike, shërbimet e ndihmës personale ose familjare, si dhe mbështetje financiare përmes skemave të parapara me dispozitat ligjore për personat me aftësi të kufizuara apo personat me çrregullime mendore. Sipas këtij neni familjet, që kanë persona me çrregullime mendore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse që merren me kujdesin, trajtimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime mendore, kujdesin dhe mbështesin këta persona për integrimin e tyre në familje, komunitet dhe shoqëri. Nga hetimi i këtij rasti shihej qartë se ky bashkëpunim ka munguar që nga fillimi.

Ligjit për Shëndetin Mendor, në nenin 19 përcakton qartë procedurat dhe veprimet që duhet ndërmarrë autoriteti shëndetësor kur personi me çrregullime mendore merr trajtim të vullnetshëm në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, i cili trajtim merret vetëm pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e pacientit, me kusht të informimit paraprak, kurse sipas paragrafit 3 të këtij neni kërkohet që miratimi i informuar sigurohet nëpërmjet diskutimit me pacientin për natyrën dhe qëllimin e ndërhyrjes terapeutike të propozuar, prandaj përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar duhet të janë pjesë e kartelës klinike të pacientit, si dhe pacienti duhet të nënshkruan për dhënien e miratimit si në kartelë ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar. Nga dosja shëndetësore e të B.R. të cilën e ka në dispozicion IAP shihet qartë se Reparti Psikiatrik në Gjilan nuk e ka përfillur fare këtë dispozitë ligjore dhe nga dokumentacioni i prezantuar shihet qartë se nuk ekziston asnjë dëshmi e cila siguron se janë ndërmarrë veprime në jetësimin e këtij neni.

Ligjit për Shëndetin Mendor në nenin 27 përcakton rastet që kur e kërkojnë interesat e personave me çrregullime mendore të bëhet kufizimi fizik i tyre, i cili kufizim mund të zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, duke kërkuar nga autoriteti shëndetësorë që gjatë kufizimit fizik, kontakti i stafit të shërbimit të shëndetit mendor me pacientin duhet të jetë aktiv dhe i vazhdueshëm, që shkon përtej monitorimit rutinë, sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga fletë lëshimi i rastit shihet qartë se pavarësisht faktit se B.R. kishte kërkuar të largohet nga Reparti, ai nuk ishte kufizuar dhe kontakti i stafit të shërbimit të Repartit Psikiatrik me pacientin nuk ishte aktiv dhe i vazhdueshëm, prandaj si pasojë e moskujdesit të tyre ka ardhur deri te e gjithë ngjarja, pasi që ata e kishin

kuptuar tek ditën e nesërme se pacienti i tyre nuk gjendej në repart dhe i njëjti ishte qëlluar nga policia (shih fletë lëshimin Nr.25-67, datë 9 korrik 2016, si dhe paragrafin 10 të këtij raporti).

IV. KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

29. Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmimeve të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën për jetë, konstaton se në rastin konkret, ka pasur shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, pasi që institucionet shëndetësore nuk kanë vepruar në pajtim me parimet Kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi.
30. Avokati i Popullit konsideron që institucioni shëndetësor, i cili e ka pranuar në shërim personin me çrregullime mendore, të njëjtit nuk ia ka ofruar ndihmën e nevojshme profesionale, meqë nga momenti i pranimit të tij në institucionin shëndetësor deri në momentin e arratisjes së tij nga ky institucion, atë asnjëherë nuk kanë vepruar në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor, duke ia mohuar pacientit të drejtat e tij të garantuara. Është shqetësues fakti se, si pasojë e mostrajtimit adekuat dhe mos mbajtjes nën vëzhgim të pacientit ka ardhur deri te arratisja e tij nga ky institucion pa u vërejtur nga askush, prandaj rrethanat e largimit të B.R. nga institucioni në fjalë, mbeten të paqarta deri në një njoftim të mëtejshëm, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme. Avokati i Popullit gjatë hetimit të këtij rasti është informuar se ka pasur edhe raste të tjera të largimit të personave me çrregullime mendore nga institucione të ngjashme nëpër qendra tjera të Kosovës, pra raste të tilla kanë ndodhur edhe më parë (shih raportin e IAP-së A.nr.89/2015, të publikuar me 3 nëntor 2015).
31. Avokati i Popullit konsideron se me mos informimin e gjykatës nga ana e institucionit shëndetësor ka ndodhur shkelja e nenit 78 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, ndërsa cilido arsyetim i dhënë nga institucioni shëndetësor është i pabazë.
32. Avokati i Popullit konstaton se, autoritetet përgjegjëse dështuan në ndërmarrjen e masave në lidhje me detyrimet pozitive, respektivisht mbrojtjen e pacenueshmërisë së integritetit fizik dhe psikik të njeriut, sidomos në rastet kur integriteti dhe jeta e njeriut janë të rrezikuara. Mos bashkëpunimi i familjes me autoritetet po ashtu paraqet problem në vete. Mos njoftimi i autoriteteve kompetente ka ndikuar në dështimin e ndërmarrjes së masave parandaluese.
33. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet shëndetësore nuk kishin informacionet e nevojshme lidhur me masat e shqiptuara nga gjykata ndaj B.R., prandaj si pasojë e mos hulumtimit të duhur për të kaluarën e B.R. dhe mosbashkëpunimit me organet tjera shtetërore, përfshirë gjykatën dhe prokurorinë, duke e neglizhuar situatën është lejuar që të vijë deri te recidivizmi i veprës penale nga ana e B.R.

REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë që:

- *Inspektorati Shëndetësor në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga neni 33 i Ligjit Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, të vlerësojnë trajtimin e të ndjerit B.R. në pajtueshmëri me nenin 19, paragrafi 1, të Ligjit për Shëndetin Mendor, gjatë kohës së qëndrimit të tij në Repartin Psikiatrik të SR në Gjilan nga data 6 deri më 9 korrik 2016.*

- Në pajtim me autorizimet ligjore dhe varësisht nga të gjeturat në terren të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme dhe të njoftojë të gjitha Institucionet e Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës që rastet e tilla eventuale të mos përsëriten në të ardhmen.

Inspektoratin Policor të Kosovës që:

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të vlerësojë plotësimin e kriterëve ligjore për përdorimin e armës së zjarrit nga ana e zyrtarit policor, në pajtim me nenin 27 të Ligjit 04/L-076 për Policinë

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës:

- Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës të nxjerrë një udhëzim, me të cilin do t'i njoftojë të gjitha institucionet shëndetësore për detyrat dhe përgjegjësitë që kanë, kur përballen me raste të trajtimit të personave me çrregullime mendore si dhe t'i obligojnë ato që të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor.
- Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme për ngritjen e nivelit etik dhe profesional të personelit dhe të kërkojë nga punëtorët shëndetësor që t'i trajtojnë pacientët me përgjegjësi dhe profesionalizëm maksimal, duke u ofruar shërbime shëndetësore profesionale dhe duke i mbikëqyrur gjatë gjithë orarit të punës, derisa personat e tillë gjenden në institucionin shëndetësor.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex Officio nr. 425/2015

Raport në lidhje me mungesën e mjeteve juridike efektive

Për: Z. Arban Abrashi, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Z. Nehat Idrizi, Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Z. Hamdi Ibrahim, Kryetar
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 22 gusht 2016

Qëllimi i Raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, që ankuesve t'u ofrohet mundësia e garantuar ligjore dhe kushtetuese për mjete juridike efektive në ankesat e tyre.
2. Në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), janë ankuar numër i konsideruar i qytetarëve të Kosovës kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme MPMS), respektivisht Departamentit të Administratës Pensionale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë konkretisht Departamentit për çështje Administrative, lidhur me refuzimin e kërkesës për njohjen e pensionit për persona me aftësi të kufizuar. Ankuesit pas ankesës në Këshillin e Ankesave pranë MPMS në shfrytëzim të këshillës juridike, për të realizuar të drejtën e tyre të pretenduar, vazhdojnë me procedura në Gjykatën Themelore në Prishtinë konkretisht në Departamentin për çështje administrative të cilat pas zvarritjeve procedurale vendimet gjyqësore nuk merren mbi bazën e meritës së çështjes por vetëm në çështje procedurale.
3. Ky raport është i bazuar në rastin *ex-officio* nr. 425/2015 i cili është hapur në Institucionin e Avokatit të Popullit duke i përmbledhur të gjitha ankesat e natyrës së njëjtë të cilat më poshtë do të përshkruhen me rastin me nr. A. 196/16 Jeton Orllati kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe rastin me nr. A. 230/2016 Musa Kastrati kundër Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme *Ankuesit*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesve, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me mungesën e mjeteve efektive ligjore juridike si dhe zvarritjen e procedurës gjyqësore në nxjerrjen e vendimit gjyqësor.

Baza Ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

Ndërsa neni 18.1.2. *“tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”*

VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

1. Rasti nr. A. 196/16 Jeton Orllati kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë
 - Më 8 mars 2016, z. Jeton Orllati është autorizuar nga familjari i tij z. Xhevat Orllati, person me aftësi të kufizuar që në emrin e tij të parashtrij ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me zvarritje të procedurës për shqyrtim dhe vendosje në padinë e tij të ushtruar me datë 12 gusht 2014, padia e nr. A.1464/14.
 - Ankuesi pohon se ka qenë shfrytëzues i pensionit për persona me aftësi të kufizuar për 10 vjet.
 - Më 15 korrik 2014, ankuesi ka pranuar vendimin nr. 5022178 nga Departamenti i Administratës Pensionale-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale se kërkesa e tij për pension të personave me aftësi të kufizuar pas rivlerësimit është refuzuar me arsyetimin se nuk ekziston aftësia e kufizuar.
 - Kundër vendimit të lartcekur në po të njëjtën datë ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Ankesave si organ i shkallës së dytë, por ankesa e tij i është refuzuar dhe është vërtetuar vendimi

i Komisionit Mjekësor i Departamentit të Administratës Pensionale.

- Më 12 gusht 2014, ankuesi ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative kundër vendimit nr. 5022178 të datës 15 korrik 2014, të Departamentit të Administratës Pensionale-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Më 24 korrik 2015, ankuesi ka parashtruar kërkesë për shpejtim të procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Çështjeve Administrative, por rasti i tij, deri me 27.06.2016, ende nuk është vendosur nga gjykata.

2.Rasti 230/2016 Musa Kastrati kundër Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Më 4 prill 2016, z. Musa Kastrati ka parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit kundër Departamentit të Administratës Pensionale lidhur me refuzim të ankesës së tij për njohje të së drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar.
 - Më 17 dhjetor 2013, ankuesi ka pranuar vendimin nr. 5040752 nga Departamenti i Administratës Pensionale-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale se kërkesa e tij për pension të personave me aftësi të kufizuar pas rivlerësimit është refuzuar me arsyetimin se nuk ekziston aftësia e kufizuar.
 - Më 15 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesa e ankuesit duke anuluar vendimin nr. 5040752 nga Departamenti i Administratës Pensionale-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social dhe rasti kthehet në rishqyrtim dhe në rivendosje në Departamentin e Administratës Pensionale.
 - Më 11 mars 2016, Departamenti i Administratës Pensionale duke vepruar sipas Aktgjykimit nr. 119/2014 të datës 15 dhjetor 2015, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative e refuzon përsëri ankesën e z. Kastrati dhe e vërteton vendimin e komisionit mjekësor të datës 4 nëntor 2013 me arsyetim se tek ankuesi nuk ka dëshmi se ekziston paaftësi e plotë e përhershme pasi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mjekësore për të qenë përfitues i pensionit për persona me aftësi të kufizuar.
 - Sipas Udhëzimit juridik kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë që në afat ligjor prej 30 ditësh përmes padisë të iniciojë kontest në Gjykatën e Apelit.
4. Avokati i Popullit, për të hetuar rastet e natyrës së përshkruar si në rastet e lartshënuara si dhe pretendimet e ankuesve se Komisioni Mjekësor nuk është duke vendosur në përputhje me kriteret e kërkuara për pension të personave me aftësi të kufizuara, ka hapur rastin ex-officio nr.425/2015, kundër MPMS, respektivisht Departamentit të Administratës Pensionale dhe është në vazhdim të procedurave.
 5. Më 17 nëntor 2015, Avokati i Popullit i është drejtuar letër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për të kërkuar informata lidhur me numrin e aplikuesve për pension për persona me aftësi të kufizuar për vitet 2014, 2015 dhe sa nga ata pas procedurës së ri-vlerësimit janë larguar nga skema Pensionale. Gjithashtu është kërkuar se sa nga aplikuesit me vendime gjyqësore janë rikthyer në skemë Pensionale, si dhe është kërkuar informata lidhur me buxhetin e ndarë nga MPMS për pensionet e personave me aftësi të kufizuara për vitet 2014/2015.
 6. Në këtë letër Avokati i Popullit nuk pranoi përgjigje.
 7. Më 2 mars 2016, përfaqësues të Avokatit të Popullit janë takuar me nivel udhëheqës në MPMS për të diskutuar lidhur me çështjet e ngritura të Avokatit të Popullit në letrën e 17 nëntor 2015. Në këtë takim përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë pranuar premtimin se në pyetjet e parashtruara do të pranojnë përgjigje me shkrim por të njëjtën nuk kanë pranuar deri më sot.
 8. Lidhur me zvarritje të procedurës për përgjigje në padi të *ankuesve* për kontest administrativ Avokati i Popullit i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë konkretisht Departamentit për çështje

Administrative dhe kryesisht nga përgjigjet e pranuar arsytimi i gjykatës ka të bëjë se nga ngarkesa e madhe e lëndëve rastet shqyrtohen sipas radhëve.

I. RRETHANAT E RASTIT

9. Personat me aftësi të kufizuar duhet të aplikojnë për të drejtën në pension të pa aftësisë të përhershme mbi bazën e nenit 4 pika 1.3, dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-131, për skemat Pensionale të financuara nga shteti
10. Mbi bazën e ankesave të pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit numri i ankuesve që humbin të drejtën në pensionin e personave me aftësi të kufizuar pas ri-vlerësimit është shqetësues.
11. Për më tepër mbi bazën e procedurave ligjore të cilat *ankuesit* duhet ndjekur si mjete juridike ata pas refuzimit të kërkesave të tyre nga komisioni mjekësor në MPMS, i parashtrajnë ankesat e tyre në Këshillin e Ankesave gjithashtu në MPMS.
12. *Ankuesit* ankesat e tyre i ushtrojnë në formë të shkruar brenda afateve të parapara ligjore organit të shkallës së dytë por në pothuaj të gjitha rastet vendimet e shkallës së dytë vërtetojnë vendimin e Komisionit Mjekësor në MPMS prandaj ankuesit udhëzohen mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve juridike matej përmes konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.
13. Pas zvarritjeve procedurale me të cilat ndër tjerash ballafaqohen *ankuesit* të cilët ushtrojnë padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, konkretisht Departamentin për çështje Administrative ankuesit kthehen në pikën fillestare, pra lënda me vendim gjyqësor kthehet në rishqyrtim në MPMS dhe e njëjta përsëri refuzohet nga Komisioni Mjekësor.

II. INSTRUMENTET RELEVANTE

14. Neni 21, paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “Kushtetuta”) përcakton si në vijim:
“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”
“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”
15. Neni 24, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton si në vijim: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”,* kurse neni 32 i Kushtetutës përcakton: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.*
16. Neni 31, paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*
17. Neni 53 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”,* kurse neni 54 përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*
18. Neni 54, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e Kushtetutës së Kosovës, përcakton: *“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*
19. Neni 132, par. 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton: *“Çdo organ, institucion ose*

autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj."

20. Neni 3 i ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti jep përkufizim për Pensionin e pa aftësisë të përhershme në pikën 1.6, ku thotë se është: *"pensionin i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj"*
21. Neni 19 i ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti parasheh Procedurat Administrative sipas së cilës: *"Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimit të kërkesës në Ministri"*
 - "2. Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe vendoset në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës."*
 - "3. Parashtruesi i kërkesës duhet të njoftohet me shkrim, lidhur me realizimin e të drejtës në pension."*
 - "4. Parashtruesi i kërkesës i paknaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në organin e shkallës së dytë të Ministrisë."*
 - "5. Ankesa bëhet në formë të shkruar në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të vendimit."*
 - "6. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimin të ankesës, nxjerr vendim dhe udhëzon palën për mundësinë e zhvillimit të procedurave të mëtutjeshme gjyqësore."*
 - "7. Pala e pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë, me padi, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimin të vendimit me shkrim, mund të hap konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente."*
 - "8. Procedurat e aplikimit dhe të ankimit në mënyrë të detajuar rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria."*
22. Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut", ose "Konventa") në paragrafin 1, përcakton: *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]"*
23. Neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton *"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare"*.
24. Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: *"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër"*.
25. Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton: *"Aktgjykimet e gjykatës, të nxjerra në konfliktet administrative, janë të detyrueshme"*, kurse neni 43, paragrafi 3 përcakton: *"Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohet, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në"*

shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”.

26. Neni 46, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton: *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, kurse neni 67, paragrafi 1 përcakton: *“Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, gjykata do ta anulojë aktin e kontestuar dhe si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim. Aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit kompetent”.*
27. Neni 25 i Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, par. 1 dhe 3, përcakton: *“Të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.”* dhe *“Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.”*

ANALIZA

28. Kushtetuta si akti më i lartë juridik i një vendi mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve.
29. Avokati i Popullit thekson se e drejta për mjete efektive ligjore është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje vendore. Neni 54, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e Kushtetutës së Kosovës, përcakton: *“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”* prandaj, ky nen duhet të jetë i zbatueshëm të respektohet nga të gjithë, përfshirë këtu edhe MPMS dhe Institucionet Gjyqësore.
30. Avokati i Popullit vëren se personat me aftësi të kufizuar për të realizuar të drejtën në pension të pa aftësisë të përhershme duhet të aplikojnë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-131, për skemat Pensionale të financuara nga shteti, i cili parasheh procedura të cilat ankuesit duhet të ndjekin si mjete juridike.
31. Për më tepër Avokati i Popullit thekson se sipas nenit 9. pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti kërkesa për pension të paftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitat e Kosovës. Këto kërkesa shqyrtohen nga Komisionet Mjekësore në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale të cilat vlerësojnë se a ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës dhe gjithashtu i caktohet kohëzgjatja e të drejtës në pension për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh pas së cilës personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Gjithashtu sipas këtij neni parashtruesi i kërkesës njoftohet me shkrim, lidhur me realizimin e të drejtës në pension.
32. Neni 19 rregullon procedurat administrative sipas së cilës parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në formë të shkruar pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit në organin e shkallës së dytë të Ministrisë. Organi i shkallës së dytë, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim dhe udhëzon

palën për mundësinë e zhvillimit të procedurave të mëtutjeshme gjyqësore.

33. Avokati i Popullit vëren se *ankuesve* të cilëve mbi bazën e vendimeve të komisionit mjekësor u refuzohet e drejta në pension të pa aftësisë të përhershme kanë të drejtë kushtetuese dhe ligjore të ankimojnë këtë vendim në instanca më të larta sipas këshillës juridike. Fakti se gjykatat si instancë më e lartë për vendosje në çështje të konflikteve administrative për këto raste, nuk vendosin në çështje meritore të rasteve por vetëm në çështje procedurale dhe *ankuesit* i rikthehen procedurave nga fillimi. Avokati i Popullit vëren se neni 19 pika 7 i cili jep mundësi për mjete juridike efektive palëve të pakënaqura me vendime në instanca paraprake nuk mund të konsiderohet si mjet juridik efektiv.
34. Avokati i Popullit rikujton se e drejta për mjete efektive ligjore është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje vendore. Neni 54, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e Kushtetutës së Kosovës, përcakton: *“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*. Vendimet gjyqësore në raste mbi bazën e ankesës kundër vendimeve të MPMS, pa e shqyrtuar çështjet e meritës së rastit por vetëm çështjet procedurale tregojnë se, *ankuesit* nuk kanë e mjeteve ligjore efektive.
35. Për më tepër Avokati i Popullit thekson se është obligim kushtetues i shtetit që *ankuesve* t’u garantojë mjete ligjore efektive. E drejta për mjete ligjore efektive është e garantuar edhe me nenin 13 të KEDNJ, parashih të drejtën për zgjidhje efektive sipas së cilës: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*
36. Avokati i Popullit vlerëson se mos procedimi i rasteve si dhe mos shqyrtimi i tyre mbi bazën e meritës së rastit dhe bartja e *ankuesve* nga gjykata duke i rikthyer në instanca të mëparshme në Komision Mjekësor në MPMS, është duke krijuar një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, dhe është duke e zvogëluar apo edhe humb besimin e qytetarëve në drejtësi dhe në shtetin ligjor.
37. Për më tepër Avokati i Popullit konsideron se një situatë e tillë ku vendimet gjyqësore nuk e ndryshojnë pozitën paraprake të *ankuesve* detyrojnë qytetarin e pambrojtur nga shteti, të sillet në një rreth të humbur, pa gjetur zgjidhje për të vënë në vend të drejtën e tij të shkelur.
38. Neni 13 i KEDNJ, duke theksuar në mënyrë të veçantë obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e njeriut, përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo të gëzojë këto të drejta, në mënyrë efektive.
39. Për më tepër Avokati i Popullit konsideron se procedurat gjyqësore deri te pranimi i vendimit të Gjykatës e tejkalon afatin mbi një vjeçar. Kjo bën që përveç që rastet nuk zgjidhen në bazë meritore *ankuesit* ballafaqohen edhe me zvarritje procedurash që në të shumtën e rasteve këto zvarritje ndikojnë që *ankuesit* të humbin të drejtën për ri- aplikim. E drejta për proces të rregullt dhe pa zvarritje është e garantuar edhe me neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i cili përcakton se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”*
40. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se kërkesat e nenit 13 të KEDNJ-së përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse kanë të bëjnë përveç tjerash edhe me zvarritje procedurash atëherë neni 13 i KEDNJ është i zbatueshëm në këto raste sepse nuk mund të konsiderohet se *ankuesve* u jepet mjet efektiv për ankesë.
41. Mbi bazën e analizës së dëshmimeve dhe fakteve, Avokati i Popullit, vëren se në rastet ku personat me aftësi të kufizuar i parashirojnë kërkesat për pension të pa aftësisë të përhershme dhe veprojnë më

tutje në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-131, për skemat Pensionale të financuara nga shteti u bëhet shkelje e të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore, dispozita kushtetuese dhe instrumente ndërkombëtare të lartpërmendura dhe, shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike në vendosjen e lëndës së ankuesit.

42. Avokati i Popullit vlerëson se zvarritjet procedurale në këto raste janë të papranueshme. Siç është cituar edhe më sipër, neni 6, par. 1, i KEDNJ-së përcakton qartë se, “[n]ë përcaktimin e të drejtave . . . të tij civile, . . . çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm” (theks i shtuar). I njëjti parim theksohet edhe në nenin 31, par. 2, të Kushtetutës: “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat . . . brenda një afati të arsyeshëm” (theks i shtuar).
43. Neni 53 i Kushtetutës përcakton se: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Prandaj, në interpretimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të bazohemi në vendimet e GJEDNJ-së lidhur me këtë çështje.
44. Sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, ‘arsyeshmëria’ e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet . . . duke iu referuar kritereve si në vijim: ndërlíkimi i rastit, sjelljet e aplikuesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për aplikuesin në kontestin në fjalë” (GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Frydlander v. France*, Aplikimi Nr. 30979/96 (2000), par. 43, duke cituar GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Comingersoll S.A. v. Portugal*, Aplikimi Nr. 35382/97, par. 19 (2000), par. 19).
45. Të tria kriteret e lartpërmendura na çojnë në konkluzionin se *Ankuesve* në rastin tonë u është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Së pari, rastet në fjalë nuk janë të një natyre të ndërlíkuar, sepse Gjykata Themelore nuk ka nevojë të konstatojë vetë gjendjen mjekësore të ankuesve. Përkundrazi, roli i saj është i kufizuar: gjykata duhet vetëm të konstatojë nëse vlerësimi i komisionit mjekësor të Ministrisë ka respektuar kriteret ligjore relevante. Avokati i Popullit nuk ka asnjë arsye, dhe nuk posedon asnjë dëshmi, për të besuar se zvarritjet në procedurën e këtyre rasteve kanë qenë për shkak të ndërlíkimit të tyre. As Gjykata Themelore vetë nuk e ka pretenduar një gjë të tillë.
46. Së dyti, zvarritjet në procedurë nuk mund të thuhet se janë shkaktuar nga vetë sjelljet e *Ankuesve*. Për vlerësimin e sjelljeve të aplikuesit lidhur me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, “Gjykata konsideron se personi në fjalë duhet vetëm të tregojë kujdes në kryerjen e hapave proceduralë në lidhje me vetveten, të mos përdorë taktika zvarritëse dhe të shfrytëzojë mundësitë e parashikuara në ligjin kombëtar për shpejtimin e procedurave” (GJEDNJ, *Unión Alimentaria Sanders S.A. v. Spain*, Rasti Nr. 11681/85 (1989), par. 35). Sipas këtyre kritereve, zvarritjet nuk janë shkaktuar nga sjelljet e *Ankuesve*. Ata kanë respektuar të gjitha afatet ligjore për paraqitjen e padive përpara Gjykatës Themelore. Pastaj, nuk ka asnjë provë që ata kanë përdorur vetë “taktika zvarritëse”. Dhe në të paktën një rast, rasti i z. Jeton Orllatit, Ankuesi ka paraqitur kërkesë për shpejtim të procedurës. Prandaj, nuk mund të argumentohet se zvarritjet në fjalë justifikohen nga sjelljet e *Ankuesve*.
47. Së treti, kur merret parasysh kriteri i fundit për vlerësimin e zvarritjeve procedurale —se çfarë është në rrezik për aplikuesin në kontestin në fjalë, këto zvarritje duken edhe më të paarsyeshme. Në vendimet e saj, GJEDNJ ka pohuar se autoritetet gjyqësore duhet të t’u japin vëmendje të veçantë rasteve ku interesi në fjalë është me rëndësi jetësore për aplikuesin (shih, p.sh., GJEDNJ, *Doustaly v. France*, Rasti Nr. 26256/95 (1998), par. 48).
48. Rasti *Mocié v. France* (Rasti Nr. 46096/99 (2003)), është me relevancë të veçantë në këtë drejtim. Në këtë rast, aplikuesi kishte kërkuar ngritjen e pensionit të tij për aftësi të kufizuar, për shkak të përkeqësimit të shëndetit të tij. Meqenëse pensioni i tij përbënte pjesën më të madhe të burimeve të tij financiare, autoritetet kombëtare kishin për detyrë t’i përkushtonte kujdes të veçantë rastit të tij, sipas GJEDNJ-së (*id.*, par. 22).

49. Mirëpo, situata e *Ankuesve* në rastet e trajtuara në këtë Raport, është edhe më e rëndë sesa situata e aplikuesit në rastin *Mocié*, sepse rastet e *Ankuesve* kanë të bëjnë me tentimin e MPMS-së për anulimin e plotë të pensionit, kurse rasti *Mocié* kishte të bënte vetëm me mundësinë e rritjes së pensionit. Prandaj, nëse aplikuesi në *Mocié* kishte të drejtë, sipas nenit 6, par. 1, të KEDNJ-së, për shqyrtimin sa më të shpejtë të rastit të tij, atëherë, *a fortiori*, *Ankuesit* në rastet e trajtuara në këtë Raport kanë edhe më shumë të drejtë për shqyrtimin sa më të shpejtë të padive të tyre.
50. Andaj, në bazë të të tria kriterëve të shpallura nga GJEDNJ për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave, e drejta e *Ankuesve* për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nuk po respektohet në nivel të mjaftueshëm. MPMS dhe Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative duhet t'i shqyrtojnë me prioritet, dhe sa më shpejt rastet e tyre.
51. Gjithashtu Avokati i Popullit konsideron se personat me aftësi të kufizuar edhe vetë qasjen në drejtësi e kanë më të kufizuar për shkak të vendndodhjes së Pallatit të Drejtësisë dhe pa transport publik. Andaj, shqyrtimi i këtyre rasteve me prioritet së paku do të lehtësoj dukshëm realizimin e të drejtave të tyre ligjore.
52. Neni 54 i Kushtetutës përcakton se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur. Nga analiza juridike e këtyre rasteve shihet se dhe përkundër faktit se legjislacioni në fuqi u ofron garancitë e duhura për mjete juridike qytetarëve, këto mjete nuk kanë treguar efektivitetin e duhur, por nga kronologjia e rasteve shihet qartë se personat me aftësi të kufizuar nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre të pretenduar edhe pas shfrytëzimit të mjeteve juridike, sepse rastet e tyre kalojnë për vendosje herë të MPMS e herë në gjykata duke u ballafaquar me zvarritje procedurale që mesatarja mund të merret deri në 3 vjet dhe përsëri rasti kthehet në pikën fillestare.
53. Në vendimin e Gjykatës Evropiane në çështjen e *Lukenda kundër Sllovenisë*, datë 6 tetor 2005, kërkuesi u ankua se mjetet juridike në dispozicion në Slloveni për çështjet e zgjatjes së procedimeve, nuk ishin efektive. Ai u mbështet kryesisht në nenin 13 të Konventës i cili parashikon: “Çdokush, të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja kryhet nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.” Gjykata pasi e shqyrtoi këtë rast e deklaroi kërkesën të pranueshme, vlerësoi se ka pasur një shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, gjeti se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës, si dhe konstatoi, se shkeljet e gjetura e kanë origjinën në keqfunksionimin e legjislacionit dhe praktikës së brendshme. Ngjashëm mund të konstatohet se është duke ndodhur edhe në këto raste sepse vendimet gjyqësore nuk e vendosen të drejtën ankuesve në vendin e duhur.
54. Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton që aktgjykimet e Gjykatës, të nxjerra në konfliktet administrative, janë të detyrueshme për palët të cilave ju drejtohen, kurse neni 43, paragrafi 3 përcakton mundësinë që te rastet kur bëhet anulimi i aktit administrativ dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin. Nga rrethanat e këtyre rasteve shihen se kemi një përsëritje procedurash dhe refuzim të vazhdueshëm të të kërkesave të ankuesve për pension të personave me aftësi të kufizuar dhe në të gjitha këto raste të cilat shkojnë me padi në konteste administrative Gjykatat në procedurat e tyre nuk e shfrytëzojnë mundësinë ligjore për të nxjerrë vendim meritur lidhur me konteste.
55. Për shkak të zvarritjeve të gjata dhe jo të arsyeshme të rasteve të *Ankuesve*, në kundërshtim me të drejtë për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si dhe me të drejtën për mjete efektive juridike,

Avokati i Popullit konsideron se Gjykata Themelore e Prishtinës ka detyrim kushtetues për të shfrytëzuar mundësinë ligjore për nxjerrjen e vendimit meritore në këto raste. Kjo është e vetmja mënyrë në të cilën të drejtat kushtetuese të *Ankuesve* mund të respektohen në nivel të mjaftueshëm.

56. Përveç këtyre shkeljeve, duhet vërejtur refuzimi i MPMS-së për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit në hetimin e këtij rasti. Siç u përmend më sipër, Avokati i Popullit, më 17 nëntor 2015, i është drejtuar MPMS-së për të kërkuar informata lidhur me numrin e aplikuesve për pension nga persona me aftësi të kufizuara për vitin 2014 dhe 2015, si dhe sa nga ata janë larguar nga skema pensionale pas procedurës së rivlerësimit. Me gjithë dërgimin e kësaj kërkesë dhe takimin e drejtpërdrejtë me zyrtarët e Ministrisë, Avokati i Popullit, më shumë se 8 muaj pas kërkesës së parë, ende nuk ka pranuar informatat e kërkuara.
57. Refuzimi i MPMS-së për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit përbën shkelje të nenit 132, par. 3 të Kushtetutës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*”) si dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, neni 25, par. 1 (“*Të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij*”).
58. Gjithashtu, refuzimi i MPMS-së për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit ka penguar rëndë zhvillimin e hetimit të këtij rasti. Pa pasur statistikën e kërkuara prej MPMS-së, Avokati i Popullit e ka të pamundur të vlerësojë saktë përmasat e problemit të largimit të personave me aftësi të kufizuara nga skema pensionale.

KONSTATIMET

59. Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmiave të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve në fuqi, konstaton se ankesat e ankuesve lidhur me mos realizimin e të drejtave të tyre në pensione të pa aftësisë të përhershme pas shfrytëzimit të mjeteve juridike të ofruara sipas legjislativës është e arsyeshme dhe e ligjshme. Avokati i Popullit konstaton se në rastet konkrete, ka shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, sepse mjetet juridike të cilat ankuesit i kanë në dispozicion nuk tregojnë efektivitetin e duhur, dhe personat me aftësi të kufizuara nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre të pretenduar edhe pas shfrytëzimit të tyre.
60. Avokati i Popullit duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara më lartë, konsideron se vendimet e komisionit të ankesave si instancë e dytë në të gjitha rastet i vërtetojnë vendimet e komisionit mjekësor në MPMS si instancë e parë dhe u japin këshillë juridike ankuesve të vazhdojnë me procedura gjyqësore në konteste administrative.
61. Avokati i Popullit konsideron, që Gjykatat në asnjërin nga procedurat e saja nuk lëshohen në zbatim të të drejtës materiale të çështjes. Ky defekt po vazhdon me tej, sepse në kontestet administrative gjykatat konstatojnë vetëm shkeljet procedurale në vendimet e MPMS. Kjo shihet si lëshim i gjykatave për të shfrytëzuar mundësinë dhe kompetencën ligjore që vendimet administrative të MPMS të shqyrtohen në meritum të rastit dhe njëherë të riparohen shkeljet duke ndryshuar vendimin administrativ, në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.
62. Avokati i Popullit konstaton se Gjykatat pas vendosjen në raste në afate kohore mbi 2 vjeçare duke e kthyer çështjen te organi administrativ për rivendosje, duke u arsyetuar vetëm në shkelje procedurale kanë bërë që Aktgjykimet të jenë joefikase, pasi që organi administrativ përsëri po nxjerr vendim refuzues për palët dhe rastet serish po paraqiten në gjykata. Ndërsa te palët po krijohet përshtypja se me vendimin e gjykatës i është njohur e drejta, por shpejtë po zhgënjehen me vendimin e gjykatës pas refuzimit të sërishëm nga organi administrativ, pasi që lënda e tyre është kthyer në rishqyrtim te organi administrativ dhe kjo po krijon përshtypjen e një pasigurie juridike dhe mjete ankimore joefektive.
63. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa,*

nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”. Sipas kuptimit të nenit 16, paragrafit 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.05/L-019, Avokati i Popullit ka kompetencë : “Të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor”, kurse sipas nenit 18, paragrafi 1.2 të po këtij ligji, Avokati i Popullit ka përgjegjësi : “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”.

REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon që:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Këshilli i Ankesave:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, t’i trajtojnë kërkesat, dhe ankesat e personave me aftësi të kufizuar mbi bazën e dëshmimeve të paraqitura për gjendjen shëndetësore dhe posaçërisht vendimet e radhës të jenë në pajtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në harmoni me vërejtjet e gjykatës. Aktgjykimet e gjykatës t’i vlerësojnë, për marrjen e vendimit të drejtë për palët dhe t’i evitojnë procedimin automatik të ankesave mbi bazën e refuzimeve të mëhershme.*

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme që në padi për konflikt administrativ përveç shkeljeve procedurale të vendoset edhe në çështje meritore të rasteve, pasi në shumë raste të vendimeve për shkelje procedurale palëve po ju refuzohet serish kërkesa nga organi administrativ.*
- *Paditë për konflikt administrativ në këto raste të shqyrtohen në afate të arsyeshme kohore dhe pa zvarritje procedurale, pasi që në shumë raste palët po e humbin të drejtën e ri-aplikimit për pension për persona me aftësi të kufizuar të parapare sipas ligjit, 6 muaj, pasi organi administrativ nuk po ju pranon aplikimin pa u vendosur rasti në gjykatë.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 563/2016

Raport përkitazi me procedurën e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Drejtuar:

- Z. Kadri Veseli, Kryetar
Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Znj. Albulena Haxhiu, Kryetare
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit
- Znj. Lirie Kajtazi, Kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetura dhe Peticione

Prishtinë, më 30 shtator 2016

QËLLIMET E RAPORTIT

Neni 72 i Rregullores së Kuvendit përcakton “procedura të veçanta për raportet e organeve të pavarura”. Përkatësisht, në lidhje me “Raportin vjetor të punës së organit të pavarur, *që është i themeluar nga Kuvendi*” (po aty, neni 72, par. 1, theks i shtuar), Rregullorja parashikon se “[p]as paraqitjes së raportit, të drejtë për të diskutuar, sipas radhës, kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe deputetët, ndërsa përmbillet me votimin për miratim” (po aty, neni 72, par. 3).

Ky raport ka tri qëllime kryesore:

- (1) Të ofrojë një interpretim të saktë të nenit 72 të Rregullores, sipas të cilit Avokati i Popullit nuk konsiderohet “i themeluar nga Kuvendi”, dhe prandaj, edhe në bazë të Rregullores aktuale, Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit nuk duhet t’i nënshtrohet votimit për miratim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 72;
- (2) Të argumentojë se, për shkak të natyrës së veçantë të punës së Avokatit të Popullit, si dhe në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, roli i Kuvendit nuk është për të votuar për ose kundër miratimit në tërësi të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, por për të kontribuar në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të paraqitura në Raportin Vjetor; dhe
- (3) t’i rekomandojë Kuvendit plotësimin e Rregullores, në bazë të argumenteve të theksuara më poshtë.

BAZA LIGJORE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).²⁴
- “t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 3).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

ANALIZA E RREGULLORES SË KUVENDIT

Rregullorja e Kuvendit është nxjerrë në bazë të nenit 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “Rregullat e Punës së Kuvendit . . . përcaktojnë . . . mënyrën e punës së Kuvendit.” Neni 72

²⁴ Edhe pse Rregullorja e Kuvendit nuk ka statusin e legjislacionit, ndryshimet në Rregullore, të rekomanduara në këtë Raport, mund të kontribuojë në “harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv”, përderisa këto ndryshime do të fuqizojnë rolin e Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e institucioneve të tjera shtetërore.

i Rregullores, i cili mban titullin “Procedurat e veçanta për raportet e organeve të pavarura”, parashikon katër hapa për t’u ndjekur për shqyrtimin e “Raportit vjetor të punës së organit të pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi” (po aty, neni 72, par. 1). Së pari, Raporti Vjetor shqyrtohet nga ai komision funksional që “e mbulon fushën e përgjegjësive të organit të pavarur” (po aty). Së dyti, brenda tri javë pune, ky komision e ka për detyrë “ta shqyrtojë raportin vjetor të organit të pavarur dhe t’i paraqesë Kuvendit raport me rekomandime” (po aty, neni 72, par. 2). Së treti, shqyrtimi i Raportit në mbledhjen e Kuvendit “fillon me paraqitjen e raportit nga raportuesi i komisionit funksional” dhe “të drejtë për të diskutuar, sipas radhës, kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe deputetët, ndërsa përmbillet me votimin për miratim” (po aty, neni 72, par. 3). Së katërti, Rregullorja parashikon se, “me kërkesën e Kuvendit, në mbledhje mund t’i jepet fjala edhe përgjegjësit të organit të pavarur” (po aty, neni 72, par. 4).

Nuk është plotësisht e qartë nga teksti nëse procedurat e parashikuara në nenin 72, interpretuar saktë, duhen zbatuar për Avokatin e Popullit, sepse, sipas gjuhës së kësaj dispozite, procedurat e parashikuara duhen zbatuar vetëm për “Raportin vjetor të punës së organit të pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi” (po aty, neni 72, par. 1, theks i shtuar). Nëse Avokati i Popullit, në kontekstin e kësaj dispozite, konsiderohet si “i themeluar nga Kuvendi”, atëherë, derisa të ndryshohet Rregullorja, procedurat e përcaktuara në nenin 72 janë të zbatueshme për Raportin Vjetor të tij, sikurse për organet e tjera të pavarura që janë të themeluara nga Kuvendi. Por, nëse Avokati i Popullit nuk konsiderohet “i themeluar nga Kuvendi”, atëherë, procedurat e nenit 72 nuk duhen zbatuar për Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit dhe Rregullorja do të duhej të plotësohej me procedura të tjera për shqyrtimin e Raportit të tij.

Togfjalëshi “organ i pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, mund të ndahet në dy pjesë: “organ i pavarur” dhe “i themeluar nga Kuvendi”.

Së pari, kategoria “organ i pavarur” përfshin institucionet që përcaktohen në Kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili mban titullin “Institucionet e Pavarura”. Institucionet e pavarura të listuara në këtë kapitull janë: Avokati i Popullit (nenet 132-135), Auditori i Përgjithshëm (nenet 136-138), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (neni 139), Banka Qendrore e Kosovës (neni 140), Komisioni i Pavarur i Mediave (neni 141) dhe Agjencitë e Pavarura (neni 142).

Mirëpo, termi “organ i pavarur” përfshin jo vetëm institucionet e Kapitullit XII të Kushtetutës, por edhe çdo organ të cilit i garantohet pavarësi, ose që përshkruhet apo etiketohet si i pavarur, kudo që të ndodhet në Kushtetutë. Institucione të tilla janë: Gjykatat e rregullta (“Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat”, neni 4, par. 5); Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (neni 101, par. 2); Këshilli Gjyqësor i Kosovës (“Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij”, neni 108, par. 2); Prokurori i Shtetit (“Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur”, neni 109, par. 2); Këshilli Prokurorial i Kosovës (“Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij”, neni 110, par. 1); dhe Gjykata Kushtetuese (“Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur”, neni 4, par. 6, dhe “Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj”, neni 112, par. 2).

Është e qartë se Kuvendi, në përdorimin e termit “organ i pavarur”, e përdor në këtë kuptimin më të gjerë, që përfshin jo vetëm institucionet e Kapitullit XII të Kushtetutës, por edhe organet e tjera të identifikuar si të pavarura në pjesë të tjera të Kushtetutës. Kjo dëshmohet nga fakti që, në listën e “Agjencioneve të Pavarura” tek uebfaqja e Kuvendit, përfshihen institucione që nuk bëjnë pjesë në Kapitullin XII, si p.sh., Gjykata Kushtetuese dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (shih listën e institucioneve tek <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,1044>).

Pjesa e dytë e togfjalëshit “organi i pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, paraqet probleme më të vështira të interpretimit. Duke përdorur fjalët “i themeluar nga Kuvendi”, neni 72 i Rregullores nënkupton se jo të gjitha organet e pavarura, por vetëm ato që janë të themeluara nga Kuvendi, u nënshtrohen procedurave të përcaktuara në këtë dispozitë. Prandaj, lind pyetja, duhet konsideruar Avokati i Popullit si organ i themeluar nga Kuvendi?.

Ka tri interpretime të mundshme të fjalëve kyçe “i themeluar nga Kuvendi”. Sipas interpretimit të parë, që është edhe interpretimi më i gjerë, çdo organ i pavarur për të cilin ekziston një ligj që rregullon organizimin dhe funksionimin e tij, mund të konsiderohet si “i themeluar nga Kuvendi”, sepse çdo ligj duhet të jetë miratuar nga Kuvendi, në mënyrë që të gëzonte statusin e ligjit. Mirëpo, sipas këtij interpretimi, të gjitha organet e pavarura do të konsideroheshin si “të themeluara nga Kuvendi”, sepse për secilin organ të tillë, ka nga një ligj që rregullon organizimin dhe funksionimin e tij. Shih, p.sh., Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (shih, në veçanti, nenin 59, “KQZ”), Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat, Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Prandaj, sipas interpretimit të parë të fjalëve “i themeluar nga Kuvendi”, të gjitha këto organe konsiderohen “të themeluara nga Kuvendi” dhe, për rrjedhojë, të gjitha këto organe u nënshtrohen procedurave sipas nenit 72 të Rregullores së Kuvendit.

Megjithatë, fakti që ky interpretim nuk e përjashton asnjë organ të pavarur prej fushëveprimit të nenit 72, përbën një argument kundër këtij interpretimi. Një parim i përgjithshëm i interpretimit të instrumenteve ligjore është *rregulli kundër tepricës*: “Një ligj duhet interpretuar në atë mënyrë që t’u jepet efekt të gjitha dispozitave, që asnjë pjesë të mos jetë e paefektshme apo e tepërt, e pavlefshme apo e parëndësishme” (L.M. Eig, “Statutory Interpretation: General Principles and Recent Trends” (2011), f. 13-14, duke cituar Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara, *Hibbs v. Winn*, 542, U.S. 88, 101 (2004)). Shih gjithashtu, T.A. Dorsey, *Statutory Interpretation and Construction* (2010), §3.34, f. 85 (“[Ç]do nen dhe çdo fjalë në ligj përfshihet për një arsye”). Në bazë të këtij parimi, mund të themi se fjalët “i themeluar nga Kuvendi” nuk duhen interpretuar në atë mënyrë që “organ i pavarur” dhe “organ i pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, t’u referohen organeve të njëllajta, sepse në këtë rast, fjalët “i themeluar nga Kuvendi” nuk do të shtonin asnjë gjë; do të ishin fjalë të tepërta. Pikërisht për këtë arsye, fjalët “i themeluar nga Kuvendi” nuk mund të interpretohen sikur të kishin kuptimin “organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet nga një ligj i miratuar nga Kuvendi”, sepse, siç kemi vërejtur më lart, të gjitha organet e pavarura përbushin këtë kriter dhe, për rrjedhojë, Kuvendi nuk do të kishte pasur asnjë arsye për të përdorur togfjalëshin e plotë, “organ i pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, në vend të, thjesht, “organ i pavarur”. Fakti që Rregullorja përfshin këto fjalë, tregon se Kuvendi e kishte për qëllim që të kufizojë fushëveprimin e nenit 72, që të mos zbatohet për të gjitha organet e pavarura. Për rrjedhojë, interpretimi i parë duhet mënjanuar, sepse e shkel rregullin kundër tepricës.

Sipas një interpretimi të dytë, konceptin e themelimit të një organi duhet ta kuptojmë ndryshe, në bazë të gjuhës së përdorur në ligjin që e rregullon atë organ. Ligji i secilit organ të pavarur përcakton nëse ai organ është themeluar nga Kuvendi ose jo. Zakonisht ky informacion gjendet në nenin e parë, ku përcaktohet qëllimi i ligjit. Për disa organe të pavarura, ligjet rregulluese përcaktojnë se e kanë për qëllim themelimin e atyre organeve. Sipas këtij interpretimi të fjalëve “i themeluar nga Kuvendi”, mund të themi

se procedurat e përcaktuara në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit zbatohen vetëm për ato organe të pavarura, ligjet rregulluese e të cilave përcaktojnë shprehimisht se janë të themeluara nga Kuvendi. Ndërsa, për sa i përket atyre organeve, ligjet e të cilave përcaktojnë vetëm funksionimin dhe organizimin, por jo edhe themelimin e tyre, këto organe ndodhen jashtë fushëveprimit të nenit 72.

Merita kryesore e këtij interpretimi të dytë është që, ndryshe nga interpretimi i parë, interpretimi i dytë arrin t'u japë efekt fjalëve "i themeluar nga Kuvendi". Prandaj, interpretimi i dytë nuk e shkel rregullin kundër tepicës. Ndryshe nga interpretimi i parë, jo të gjitha organet e pavarura konsiderohen si të themeluara nga Kuvendi. Për këtë arsye, përdorimi i fjalëve "i themeluar nga Kuvendi", nuk ishte pa qëllim.

Mirëpo, ky interpretim i dytë ka një mangësi tjetër të madhe: ndarja ndërmjet ligjeve që pretendojnë të *themelojnë* organe të pavarura dhe atyre që pretendojnë vetëm të *rregullojnë organizimin dhe funksionimin* e organeve të pavarura, duket të jetë arbitrare. Nuk mund të dallohet ndonjë arsye pse disa prej këtyre organeve përshtrohen, në ligjet e tyre rregulluese, si të themeluara nga këto ligje, dhe disa jo. Për shembull, Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, deklaron shprehimisht një qëllim themelues: "Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm si dhe *themelimi*, organizimi dhe funksioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës" (*po aty*, neni 1, theks i shtuar). Po ashtu, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit shpreh qëllimin "për të trajtuar me shpejtësi ndikimet substanciale negative ekonomike dhe sociale të cilat janë shfaqur si rezultat i kësaj pasigurie juridike si dhe për nxitjen e investimeve në këto ndërmarrje dhe asete përmes *themelimit* të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (*po aty*, Hyrje, theks i shtuar). Neni 1 i të njëjtit ligj mban titullin "*Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit*" (*po aty*, theks i shtuar).

Për dallim nga këto ligje, Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave ("Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave", neni 1) dhe Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit ("Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë kundër Korrupsionit", neni 1), nuk përmendin shprehimisht qëllimin për të themeluar këto organe të pavarura, por vetëm për të përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.

Problemi me interpretimin që po e konsiderojmë, është që nuk ka asnjë arsye parimore pse t'i konsiderojmë Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit si të themeluara nga Kuvendi, por jo edhe Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Agjencinë kundër Korrupsionit. Duket se nuk ka qenë e qëllimshme përfshirja e fjalës "themelimi" në disa ligje dhe jo në të tjera. Prandaj, përdorimi ose mospërdorimi i kësaj fjale nëpër ligjet rregulluese, nuk mund të shërbejë si bazë për të përcaktuar cilat organe duhet t'u nënshtrohen procedurave të parashikuara për shqyrtimin e raporteve vjetore në nenin 72 të Rregullores.

Dy interpretimet e para të fjalëve "i themeluar nga Kuvendi" kanë dalë të dështuara. Prandaj, le të konsiderojmë një interpretim të tretë. Sipas këtij interpretimi, çelësi i dallimit ndërmjet organeve të pavarura që janë të themeluara nga Kuvendi dhe atyre që nuk janë të themeluara nga Kuvendi, gjendet jo në ligj por në Kushtetutë. Kushtetuta përcakton shumë qartë një kategori të veçantë të institucioneve të pavarura që janë në diskrecionin dhe kompetencën e Kuvendit për të themeluar ose jo. Përkatësisht, në nenin 142 të Kushtetutës, përcaktohet se: "Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë *themelimin*, funksionimin dhe kompetencat e tyre" (*po aty*, neni 142, par. 1, theks i shtuar). Për dallim nga këto "agjencitë" e pavarura, që krijohen sipas nevojës dhe me vullnetin e Kuvendit, organet e pavarura që

përcaktohen shprehimisht në Kushtetutë nuk mund të konsiderohen si të themeluara ose të krijuara nga Kuvendi. Për shembull, Kushtetuta përcakton se: “Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni [por jo edhe themelimi] i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj” (*po aty*, neni 103, par. 1); “Organizimi, kompetencat dhe detyrat [por jo edhe themelimi] i Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj” (*po aty*, neni 109, par. 3); dhe “Organizimi, funksionimi dhe kompetencat [por jo edhe themelimi] i Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj” (*po aty*, neni 136, par. 2). Siç tregohet nga këta shembuj, Kushtetuta bën një dallim të qartë ndërmjet (1) agjencive të pavarura, që nuk përcaktohen nga vetë Kushtetuta por janë të krijuara nga Kuvendi, dhe (2) organeve të pavarura që janë të përcaktuara shprehimisht dhe pjesë përbërëse e strukturës kushtetuese.

Ky interpretim i tretë u shmanget mangësive prej të cilave vuajnë interpretimi i parë dhe i dytë. Ndryshe nga interpretimi i parë, ky interpretim nuk e shkel rregullin kundër tepicës. Përfshirja e fjalëve “i themeluar nga Kuvendi” nuk del i tepërt dhe pa qëllim. Përkundrazi, këto fjalë shërbejnë për të kufizuar fushëveprimin e nenit 72 të Rregullores, duke treguar se vetëm organet e pavarura që janë të krijuara nga Kuvendi në bazë të kompetencës së përcaktuar në nenin 136 të Kushtetutës, duhet t’u nënshtrohen procedurave të përcaktuara në nenin 72 për shqyrtimin e raporteve vjetore. Ndërsa, ato organe, ekzistenca e të cilave nuk buron nga Kuvendi por që janë të përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta, nuk konsiderohen si “të themeluara nga Kuvendi” dhe, për rrjedhojë, sipas gjuhës së përdorur në Rregullore, nuk duhet t’u nënshtrohen të njëjtave procedura.

Ky interpretim i shmanget edhe disavantazhit që kemi parë tek interpretimi i dytë. Siç kemi vërejtur më sipër, interpretimi i dytë është bazuar në faktin që disa ligje përcaktojnë qëllimin e themelimit të organeve të pavarura dhe disa nuk e përcaktojnë këtë qëllim, por nuk kemi gjetur ndonjë bazë që do të mund të shpjegonte këtë fakt, që do të mund të shpjegonte *pse* vetëm disa ligje kanë folur për themelimin e organeve përkatëse dhe disa jo. Ndërsa, interpretimi i tretë arrin të shpjegojë qartë dallimin ndërmjet dy llojeve të organeve të pavarura, në bazë të klasifikimit që buron nga vetë Kushtetuta.

Duke u mbështetur në këtë interpretim të tretë, pra, çfarë konkluzionesh mund të nxjerrim për fushëveprimin e nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, posaçërisht për shqyrtimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit?. Siç kemi parë më sipër, kjo dispozitë parashikon katër hapa për shqyrtimin e raporteve vjetore, një prej të cilëve është “përmbyll[ja] me votimin për miratim” (*po aty*, neni 72, par. 2). Dhe, sipas interpretimit më të mirë që kemi gjetur për togfjalëshin “organ i pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, kjo procedurë duhet zbatuar vetëm për ato organe që nuk janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë por që janë të krijuara nga Kuvendi në bazë të kompetencës së tij për të themeluar agjenci të pavarura. Agjenci të tilla janë, p.sh., Agjencia kundër Korrupsionit, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, etj. Për dallim nga këto organe, institucione si Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese, etj., janë parapërcaktuar nga Kushtetuta dhe prandaj, nuk janë krijuar me një akt themelues të Kuvendit. Kuvendi nuk luan një rol në themelimin e këtyre institucioneve por vetëm në rregullimin e organizimit dhe funksionimit të tyre.

Prandaj, nëse procedurat e parashikuara në nenin 72 të Rregullores zbatohen vetëm për raportet vjetore të organeve të themeluara nga Kuvendi, atëherë Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit, i cili është institucion i parashikuar drejtpërdrejt në Kushtetutë, jo i themeluar nga Kuvendi, nuk duhet t’u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë dispozitë, duke përfshirë votimin për miratim.

ROLI I KUVENDIT NË SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR TË AVOKATIT TË POPULLIT

Nëse Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit mbetet jashtë fushëveprimit të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, atëherë lindin pyetje të tjera: Në çfarë mënyre duhet të plotësohet Rregullorja në këtë drejtim? Çfarë roli duhet të luajë Kuvendi në shqyrtimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit?

Si fillim, mund të vërejmë se natyra e punës së Avokatit të Popullit e bën të papërshtatshëm votimin për miratimin e raporteve të tij. Tipari kryesor i raporteve të Avokatit të Popullit është se nuk e kanë për qëllim vetëm të përshkruajnë punën e Institucionit të Avokatit të Popullit. Qëllim edhe më i rëndësishëm i këtyre raporteve është të japin informacione mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, si dhe të paraqesin rekomandime konkrete, drejtuar institucioneve shtetërore përgjegjëse, për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Ky rol i Avokatit të Popullit në paraqitjen e rekomandimeve konfirmohet në Kushtetutë, si dhe në Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit. Neni 135 i Kushtetutës, i cili mban titullin “Raportimi i Avokatit të Popullit”, përcakton shprehimisht se “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore” (po aty, neni 135, par. 3). Po ashtu, Ligji për Avokatin e Popullit, Kapitulli III, “Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit”, përmend 11 herë rolin e Avokatit të Popullit në paraqitjen e rekomandimeve për autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës. Shih nenin 16, par. 8; nenin 17, par. 5 dhe 7; nenin 18, par. 1, nënpar. 2, 5, 6, 7 dhe 9; dhe nenin 18, par. 3 dhe 5.

Fakti që dhënia e rekomandimeve përbën një pjesë të madhe të punës së Avokatit të Popullit i jep një natyrë tjetër raporteve të tij, në krahasim me raportet e shumicës së organeve të tjera të pavarura. Për shembull, sipas Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 20, paraqitja e rekomandimeve nuk përfshihet si pjesë e Raportit Vjetor të Agjencisë që i drejtohet Kuvendit. Po ashtu, Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 4, par. 1, nënpar. 26 përcakton vetëm që Këshilli të përgatisë një raport vjetor “mbi veprimtaritë e gjykatave dhe shpenzimet e Këshillit”. Kjo nuk do të thotë se këto organe të pavarura e kanë të pamundur ose të papërshtatshme që të paraqesin rekomandime, po megjithatë, kompetenca dhe përgjegjësia për të dhënë rekomandime të tilla luajnë një rol shumë më të madh në punën e Avokatit të Popullit, gjë që pasqyrohet qartë në raportet e tij. Shih, p.sh., Raportin Vjetor 2015, Nr. 15, të Avokatit të Popullit, pjesa II, “Përmbledhja e Raporteve me Rekomandime”, f. 78-97.

Për shkak se paraqitja e rekomandimeve luan një rol kaq të rëndësishëm në raportimin e Avokatit të Popullit, votimi për miratimin e Raportit Vjetor të tij nuk është i mjaftueshëm, as edhe i dëshirueshëm, si pjesë e shqyrtimit të atij raporti nga Kuvendi. Votimi për miratim është i përshtatshëm kur Kuvendi dëshiron të shprehë mendimin e tij për punën që ka bërë një institucion *në të kaluarën*, por nuk është i përshtatshëm për një institucion që po raporton për hapat që duhen ndërmarrë nga autoritetet shtetërore *në të ardhmen*. Madje, votimi për miratimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit në tërësi, ngjan më shumë si një hap krejt formal..

Prandaj, Avokati i Popullit propozon që Kuvendi, në vend që të votojë *për* ose *kundër* Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit në tërësi, të plotësojë Rregulloren e Kuvendit me procedura të veçanta për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e autoriteteve të tjera shtetërore. Në këtë mënyrë, Kuvendi do të kishte mundësi për të luajtur një rol në rritjen e nivelit të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Duke marrë parasysh faktin që Avokatit të Popullit i mungojnë kompetencat

ekzekutive për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të tij, është e domosdoshme që për suksesin e misionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, Kuvendi ta mbështesë sa më fuqishëm këtë mision.

Për më tepër, sipas Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, në këtë drejtim Kuvendi e ka për detyrë që të mbështesë punën e Avokatit të Popullit. Në kontekstin e një republike parlamentare, Kuvendi është ai institucion, pushteti i të cilit buron drejtpërsëdrejti nga populli i Republikës. Ky fakt e vesh Kuvendin jo vetëm me *të drejtën* por edhe me *detyrën* për të kërkuar llogari prej institucioneve të tjera shtetërore, sidomos prej Qeverisë. Ky parim gjen konfirmim në tekstin e Kushtetutës: “Kuvendi i Republikës së Kosovës . . . mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, ne bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit” (*po aty*, neni 65, par. 9). Në këtë mënyrë, mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucione të tjera shtetërore është vetëm pjesë e një kompetence më të përgjithshme që Kushtetuta ia ka përcaktuar Kuvendit.

Roli i veçantë i Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, gjen mbështetje edhe në standardet ndërkombëtare dhe evropiane për marrëdhënien midis parlamenteve dhe institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut. Këto standarde janë shpallur, më së fundi, si rezultat i një konference ndërkombëtare të organizuar në vitin 2012 nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC), mes të tjerësh. Në listën e parimeve që rezultoi prej kësaj konference ndërkombëtare, është theksuar roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e autoriteteve shtetërore në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut. Konferenca nxori në pah se :“Parlamentet duhet të mbajnë diskutime të hapura mbi rekomandimet e nxjerra nga institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut” dhe “duhet të kërkojnë informacione prej autoriteteve publike përkatëse se sa është niveli i konsiderimit dhe përgjigjes së rekomandimeve të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, nga ana e autoriteteve publike përkatëse”); nenin 32 (“Parlamentet duhet të kërkojnë të përfshihen në . . . mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nga ana e Shtetit”); dhe nenin 41 (“Parlamentet dhe institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, kur është e përshtatshme, duhet të bashkëpunojnë në mbikëqyrjen e Ekzekutivit në reagimin e tij ndaj aktgjykimeve të gjykatave (kombëtare dhe, kur është e përshtatshme, rajonale dhe ndërkombëtare) dhe tribunaleve apo organeve administrative, rreth çështjeve të ndërlidhura me të drejtat e njeriut”).

Detyrën e parlamenteve kombëtare për të mbikëqyruar autoritetet shtetërore lidhur me të drejtat e njeriut, e konfirmon edhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e cila, në vitin 2011, nxori Rezolutën Nr. 1823, “Parlamentet kombëtare: garantuesit e të drejtave të njeriut në Evropë”. Në këtë Rezolutë, Asambleja Parlamentare ka pohuar se parlamentet kombëtare “janë çelës i implementimit efektiv të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në nivelin kombëtar”, duke iu referuar gjithashtu “detyrës së tyre për të mbrojtur të drejtat e njeriut . . . duke kërkuar llogari prej ekzekutivit” (*po aty*, neni 2, theks i shtuar). Në veçanti, Asambleja Parlamentare është shprehur se “parlamentet kombëtare janë në pozitë të veçantë për të kërkuar llogari prej qeverive për implementim të shpejtë dhe efektiv të aktgjykimeve të Gjykatës [Evropiane për të Drejtat e Njeriut]” (*po aty*, neni 5, par. 1). Në këtë drejtim, Rezoluta “inkurajon deputetët që të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre për të mbikëqyruar me kujdes ekzekutivin e vendeve të tyre për sa i përket implementimit të normave të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, në veçanti” (*po aty*, neni 6, par. 2).

Normat e të drejtave ndërkombëtare të njeriut janë një prej shtyllave kryesore të raporteve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Shih, p.sh., Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nenin 16, par. 1 (“Avokati i Popullit ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a

juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me . . . instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”) dhe nenin 16, par. 4 (“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat edhe liritë e njeriut të përcaktuara me . . . instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”). Përderisa veprimtaritë e Avokatit të Popullit, përfshirë edhe rekomandimet e tij, ndërlidhen kaq ngushtë me normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Kuvendi e ka të pamundur të përmbushë kërkesën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, që të mbikëqyrë respektimin e këtyre normave nga autoritetet shtetërore, pa iu kushtuar rëndësi të veçantë mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Kjo lloj mbikëqyrjeje, jo votimi për miratim, duhet të jetë rezultati i shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit.

A. KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Konstatimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se:

- (1) Procedurat e përcaktuara në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtimin e “raportit vjetor të organit të pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, duke përfshirë edhe votimin për miratimin e raportit, nuk do të duhej zbatuar për Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit”;
- (2) Për shkak të natyrës së veçantë të punës dhe raportimit të Avokatit të Popullit, përkatësisht për shkak të rolit të tij në paraqitjen e rekomandimeve, votimi për miratimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit nuk është as i përshtatshëm, as i dëshirueshëm si pjesë e shqyrtimit të tij në Kuvend; dhe
- (3) Respektimi i plotë i standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të luajë një rol në mbikëqyrjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve që Avokati i Popullit u ka drejtuar autoriteteve të tjera shtetërore.

B. REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që:

- (1) *Të sqarojë shprehimisht se procedurat e veçanta për shqyrtimin e “raportit vjetor të organit të pavarur, që është i themeluar nga Kuvendi”, të përcaktuara në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfshirë edhe votimin për miratimin e raportit, nuk zbatohen për Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit; dhe*
- (2) *Të plotësojë Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të përcaktuar procedura të posaçme për shqyrtimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, duke përfshirë mbikëqyrjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij nga ana e autoriteteve të tjera shtetërore.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të

cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 499/2016

Raport në lidhje me mosrespektimin e procedurave ligjore gjatë procesit të rekrutimit të personelit, sipas konkurseve të shpallura nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në Republikën e Kosovës

Drejtuar :

Z. Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës së Prishtinës,

Z. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit,

Z. Sokol Haliti, kryetar i Komunës së Vitisë,

Z. Muharrem Svarqa, kryetar i Komunës së Ferizajt,

Z. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës së Lipjanit,

Z. Sokol Bashota, kryetar i Komunës së Klinës,

Z. Idriz Vehapi, kryetar i Komunës së Rahovecit,

Z. Svetislav Ivanović, kryetar i Komunës së Novobërdës, dhe

Z. Xhafer Gashi, kryetar i Komunës së Obiliqit.

Prishtinë, më 23 nëntor 2016

Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është promovimi i barazisë si dhe tërheqja e vëmendjes së Drejtorive Komunale të Arsimit(DKA) në Republikën e Kosovës, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin e ligjit dhe respektimin e procedurave ligjore të rekrutimit.

Baza ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:

- *“të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (pika 1),*
- *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);*
- *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 4);*
- *“të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);*
- *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);*
- *“të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8);*

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Në bazë të informatave dhe dokumentacionit të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), faktet mund të përmbliidhen si në vijim:

1. Konkursi i shpallur më 25 korrik 2016, nga DKA në Komunën e Prishtinës, vlerësimi individual i kandidatëve, vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës.
2. Konkursi për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të caktuar, i shpallur më 26 korrik 2016 nga DKA në Komunën e Gjilanit, formularët për vlerësim të kandidatëve, rekomandimi i Komitetit për Arsim nr.01. nr.134/2016, i datës 20.06.2016 dhe vendimi i DKA-së, nr.061-59888, data 22.06.2016.
3. Konkursset për plotësimin e vendeve të punës të shpallura nga DKA në Komunën e Gjakovës, konkursi i datës 03.08.2016, 23.08.2016 31.08.2016, si dhe konkursset e datave 15.01.2016 dhe 02.03.2016.

4. Konkursi i shpallur më 11 korrik 2016 nga DKA në Komunën e Ferizajt, formulari i vlerësimit të kandidatëve dhe vendimi për formimin e komisionit intervistues.
5. Konkursi për plotësimin e vendeve të punës i shpallur më 20 korrik 2016 nga DKA në Komunën e Lipjanit.
6. Konkursi për plotësimin e vendeve të lira të punës i shpallur nga DKA në Komunën e Vitisë, vendimi për emërimin e komisionit për intervistim dhe formulari për poentim të kandidatëve.
7. Konkursi për kuadër mësimdhënës i shpallur më 21 korrik 2016 nga DKA në Komunën e Klinës.
8. Konkursset e shpallura nga DKA-të në komunat : Prizren, Mitrovicë, Skenderaj, Vushtri, Dragash, Suharekë, Hani i Elezit, Rahovec, Podujevë, Obiliq, Malishevë, dhe në komunën e Novobërdës.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (tani e tutje Kushtetuta), Neni 24, Barazia para Ligjit, përcakton se : *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”*(par.1).
10. *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”*(par.2).Gjithashtu sipas nenit 31, paragrafi 1, përcaktohet se : *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.
11. Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], paragrafi 1, *“E drejta e punës garantohet”* ndërsa paragrafi 2, përcakton se : *“Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”*
12. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme Konventa), është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.
13. Neni 14, i Konventës përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.
14. Neni 3 paragrafi 2, i Ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, përcakton se : *“Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”*
15. Ligji Nr.03/L-212 i Punës, Neni 2, paragrafi 2, përcakton se : *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.”*
16. Neni 3, par. 1.17, përkufizon se : *“Diskriminimi - çdo dallim që përfshin përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, që e ka fuqinë e anulimit ose mosdhënies së mundësive të barabarta për punësim apo profesion apo ngritje profesionale”*

17. Ndërsa neni 5, par.1, përcakton se : *“Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, [...] ose çështjeve tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi”*
18. Neni 7, par. 1 i Ligjit, *“Marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeç”*
19. Ndërsa neni 8, par.2, përcakton se : *“Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.”*
20. Udhëzimi Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, përcakton procedurat për për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik sipas Ligjit të Punës.
21. Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 35, par.1, për zgjedhjen e mësimdhënësit, shprehimisht përcakton se : *“[...] mësimdhënësit. [...] zgjidhen përmes një konkursi publik në bazë të meritës personale, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për arsye reale apo të supozuara që ka lidhje me gjininë, racën, gjendjen martesore, orientimin seksual, përkatësinë etnike, nevojat e veçanta, pasurinë, vendin e lindjes, pikëpamjet politike ose filozofike apo rrethanat e tjera.”*
- “Autoritetet që bëjnë emërimet, siç përcaktohet në këtë ligj, krijojnë procedura të drejta, të hapura dhe transparente për angazhim bazuar në kualifikimet dhe nevojat e postit.” (par.3).*
- “Mësimdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA përfshirë edhe drejtorin e institucionit arsimor si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues në përputhje me ligjin në fuqi.”(par.4).*
- “Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxhues ose për mësimdhënës, merren për bazë kushtet, si janë: arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim të përcaktuar në këtë ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm. Emërimet e tilla përfundojnë në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit është bërë emërimi.” (par.5).*
22. Ligji Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 4, par.1, përcakton kompetencat e komunave : *“Komunitet kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për aq sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjisllacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve.”*
23. Sipas nenit 5, përcaktohet se : *“Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë kompetencat e mëposhtme të veçanta komunale në arsimin publik për nivelet 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë) në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i:*
- Gjithashtu pika c), e këtij neni përcakton se komunitet janë kompetente për “punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë;”*
24. Pikërisht duke u bazuar sipas nenit 5, pika c), MASHT-i ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr.17/2009, Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë, sipas nenit 3, par.1, përcaktohet

përbërja e komisionit për zgjedhjen e personelit arsimor, shprehimisht thuhet se “*Dy përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit*”(par.1.1) dhe “*Drejtori i shkollës përkatëse*” (par.1.2).

Analiza ligjore

Analiza ligjore e Avokatit të Popullit bazohet në dokumentacionet dhe konkurset e shpallura nga DKA-të në 19 komuna të Republikës së Kosovës.

Komuna Prishtinës

25. Avokati i Popullit, duke u bazuar në konkursin e shpallur më 25 korrik 2016, nga DKA në komunën e Prishtinës, vëren se ky konkurs është shpallur duke u bazuar në Ligjin e Punës, Ligjin për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës si dhe Udhëzimit Administrativ nr.14/2011, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik në bazë të cilit është formuar edhe komisioni prej pesë anëtarëve për përzgjedhjen e kandidatëve. Sipas paragrafit II, të konkursit përcaktohet se : “*Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.05/2015 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, si dhe akteve tjera juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr.03/L-068 dhe Ligji Nr.04/L-138).*”

Ndërsa në paragrafin III, të konkursit, parashihet që : “[...] *caktimi i shkollës për kandidatet e suksesshëm do të bëhet nga Komuna, përkatësisht Drejtoria e Arsimit*”.

26. Edhe pse sipas paragrafit II të konkursit DKA në Prishtinë shprehimisht thirret për zbatimin e Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Komisioni për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës e kandidatëve formohet duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.14/2011 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it Nr.17/2009, sipas të cilit komisioni përbëhet prej tre anëtarëve dhe njëri prej tyre duhet të jetë drejtori i shkollës.

Komuna e Gjilanit

27. Avokati i Popullit, duke u bazuar në konkursin e shpallur më 26 korrik 2016 nga DKA në komunën e Gjilanit, vëren se ai është shpallur duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin e Punës, sipas konkursit “*kandidatët të cilët aplikojnë më shumë se një shkollë, mund të aplikojnë vetëm me një formularë të aplikimit duke i cekur emrat e shkollave ku aplikon.*”. Sipas kriterëve të rekomanduara nga Komiteti i Arsimit në Komunën e Gjilanit, të datës 20 qershor 2016, vërehet se “*Kandidati që jeton në lokalitetin ku gjendet shkolla, 0.5 pikë (ky kriter vlen vetëm për shkollat fillore të mesme të ulëta në fshatra).* Në këtë rast kandidati i cili jeton në fshat ka përparësi nga të gjithë konkurrentët, mirëpo ai ka përparësi edhe ndaj kandidatëve të cilët jetojnë në qytet.

Komuna e Vitisë

28. Avokati i Popullit, duke u bazuar në konkursin e shpallur më 2 gusht 2016 nga DKA në komunën e Vitisë, vëren se ky konkurs është shpallur duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ Nr.13/2011 (vlen të përmendet se edhe konkursi i shpallur më 11 tetor 2016, mbështetet në këtë Udhëzim Administrativ),²⁵ Ligjin e Punës

²⁵ Ky Udhëzim Administrativ është shfuqizuar sipas nenit 13 të Udhëzimit Administrativ Nr.20/2013, normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 29.05.2013.

dhe Udhëzimin Administrativ Nr.06/2015 mbi përzgjedhjen dhe pranimin e kuadrit arsimor,²⁶ ndërsa emërimi i komisionit për intervista është bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.17/2009, sipas të cilit komisioni formohet prej tre anëtarëve, dy anëtarë të DKA-së dhe drejtori i shkollës, megjithatë në komision janë emëruar katër anëtarë të komisionit për intervista. Po ashtu duke u bazuar në formularin për poentimin e kandidatëve, vërehet se në këtë komunë si kriter për poentim të kandidatëve është edhe : “ *Kandidati vendas (kandidati që jeton ku gjendet shkolla 1 pikë)*”(par. IV).

Komuna e Gjakovës

29. Avokati i Popullit, duke u bazuar në konkursin e shpallur nga DKA në komunën e Gjakovës, më 03.08.2016, 23.08.2016 31.08.2016, si dhe konkurset e datave 15.01.2016 dhe 02.03.2016, vëren se ky konkurs është shpallur duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin e Punës, Udhëzimin Administrativ 06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional dhe Udhëzimi Administrativ 17/2009 Procedura e Zgjedhjes së Personelit Arsimor në Shkollë, sipas konkurseve të shpallura më datën 15 janar 2016 dhe 2 mars 2016, ishte kriteri për aplikim “*Kandidati mund të aplikoj më së shumti në tri (3) vende pune.*”, ndërsa sipas konkurseve të shpallura më datat 3, 23 dhe 31 gusht 2016, vërehet se kandidatët kanë pasur mundësi të aplikojnë në të gjitha vendet e punës të shpallura sipas konkurseve.

Komuna e Ferizajit

30. Avokati i Popullit, duke u bazuar në konkursin e shpallur nga DKA në komunën e Ferizajt, më 11 korrik 2016 , vëren se ky konkurs është shpallur duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ 06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Ndërsa komisioni për intervista është formuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në përbërje prej pesë anëtarëve.

Edhe pse sipas konkursit nuk mund të konstatohet se kandidatët nuk kanë pasur të drejtë të konkurrojnë në të gjitha vendet e punës të shpallura, përfaqësuesi i IAP-it, gjatë vizitës në Zyrën për shërbimin e qytetarëve, ka vërtetuar faktin se kandidatët kanë pasur mundësi të aplikojnë vetëm në dy vende të punës.

Komuna e Lipjanit

31. Avokati i Popullit, duke u bazuar në konkursin e shpallur nga DKA në komunën e Lipjanit, më 20 korrik 2016 ,vëren se ky konkurs është shpallur duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe Statutit të Komunës. Sipas konkursit shprehimisht theksohet se : “*Nëse kandidati aplikon në më shumë se një vend pune, është në dijeni se mund të ftohet në intervistë vetëm në atë shkollë, institucion ku e konsideron me më pak prioritet për të. Andaj rekomandoheni të aplikoni në një vend pune.*”

Komuna e Klinës

32. Konkursi i shpallur nga DKA në komunën e Klinës, është mbështetur në Ligjin e Punës, Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Udhëzimin Administrativ Nr.06/2015 Normativi mbi përzgjedhjen e kuadrit profesional të arsimit të

²⁶ Emërtimi i pasakt i udhëzimit, duhet të jetë Udhëzimi Administrativ Nr.06/2015 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

përgjithshëm dhe Udhëzimin Administrativ Nr.05/2015 për kuadrin mësimdhënës në arsimin profesional, sipas konkursit në pikën 3. thuhet se : *“Kandidatët kanë të drejtë të aplikimit vetëm në një vend pune.”*

Komuna e Rahovecit, Podujevës, Obiliqit, Malishevës, Novobërdës

33. Avokati i Popullit vëren se edhe konkurset e shpallura nga DKA-të në komunën e Rahovecit, komisioni për intervistimin e kandidatëve është themeluar prej pesë anëtarëve, ndërsa në komunën e Podujevës, sipas konkursit parashihet që kandidatët të cilët konkurrojnë në dy pozita do të intervistohen vetëm për njëren pozitë e që intervista do të vlejë për të dy pozitat.

Në komunën e Obiliqit, konkursi është shpallë duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ nr.9/2014 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm,²⁷ në komunën e Malishevës, parashihet se kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla por me dokumentacion të veçantë.

Po ashtu në komunën e Novobërdës, konkursi është shpallë duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ nr.9/2014 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm).

Kriteret e konkursi në kundërshtim me ligjin.

34. Avokati i Popullit ka vërejtur se gjatë hartimit të konkurseve dhe kriterëve për punësimin e mësimdhënësve, në disa komuna, edhe në të kaluarën ka pasur konkurse dhe kriterë të cilat bien ndesh me ligjin, për këtë qëllim Avokati i Popullit edhe më parë ka rekomanduar DKA-të, që gjatë hartimit të konkurseve dhe kriterëve për punësim, të hartojnë kriterë të cilat nuk bien në kundërshtim me ligjin, në mënyrë që të gjithë kandidatët të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit.²⁸
35. Ligji për Vetëqeverisje Lokale në mënyrë të qartë përcakton detyrimet ligjore të komunës që të kujdesen që qytetarët të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre, neni 4, paragrafi 2, shprehimisht përcakton se : *“Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë [...] me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.”*. Avokati i Popullit vëren se, DKA-të e lartë cekura nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim që konkurset e shpallura të jenë në harmoni me ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe të kujdesen që të gjithë të kenë mundësi të barabarta.
36. Avokati i Popullit vëren se sipas vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *“e drejta për të mos u diskriminuar shkelet kur Shtetet trajtojnë në mënyrë jo të barabartë persona në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm,²⁹*. Në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë *“objektiv dhe i arsyeshëm”*, duhet të kalojë dy hapa të tjerë : Së pari, duhet të ketë një *“qëllim legjitim”* për pabarazinë në fjalë dhe, së dyti, duhet të ketë një *“lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar”*.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

37. Avokati i Popullit, duke u bazuar në faktet e rasteve dhe atyre ligjore te paraqitura me lart, konstaton se, kufizimi i zgjedhjes së vendit të punës nga komuna e Prishtinës është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 49, të Kushtetutës, formimi i komisionit intervistues gjithashtu është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe nenin 3, paragrafi 1.1

²⁷ Ky Udhëzim Administrativ është shfuqizuar sipas nenit 14, të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015, për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 10.07.2015.

²⁸ Shih IAP, Raporti vjetor 2014, faqe 83

²⁹ GJEDNJ, rasti Thlimmenos v. Greece, aplikacioni Nr.34369/97, 6 prill 2000, par.44.

dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.17/2009, i cili përcakton procedurat e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë. Lidhur me zbatimin e Ligjit të Punës nga Komuna e Prishtinës, Avokati i Popullit, vëren se sipas Ligjit të Punës, neni 2 paragrafi 2, përcaktohet se dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, mirëpo vetëm në rast se ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës, prandaj, në rastin konkret, me që marrëdhënia e punës për personelin arsimor, rregullohet me ligje të veçanta të arsimit, Komuna e Prishtinës, ka pasur obligim të zbatoj ligjet e veçanta të arsimit.

38. Avokati i Popullit, duke analizuar kriteret për poentimin e kandidatëve në komunën e Gjilanit dhe në komunën e Vitisë, konstaton se kriteri në bazë të cilit kandidatët të cilët jetojnë në lokalitetin ku gjendet shkolla, sipas të cilit kriter konkurruesit fitojnë pikë, është kriter diskriminues, ky kriter në njërin anë, shkel të drejtën për trajtim të barabartë dhe krijon pabarazi ndërmjet konkurrentëve dhe në anën tjetër krijon favorizim për kandidatët në bazë të lokalitetit ku jetojnë, me që sipas Kushtetutës, të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe me që askush nuk mund të diskriminohet, autoritetet komunale duhet të sigurojnë që të gjithë qytetarët të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta, prandaj, veprimet e tilla të autoriteteve publike në këto komuna cenojnë barazinë para ligjit dhe janë në kundërshtim me dispozitat ligjore.
39. Avokati i Popullit, vëren se në disa komuna kandidatët kanë mund të aplikojnë në të gjitha vendet e punës, ndërsa në disa tjera kanë mund të aplikojnë vetëm në një apo në dy vende të punës, prandaj, kufizimi i të drejtës për të aplikuar vetëm në një vend të punës (komuna e Lipjanit dhe komuna e Klinës), apo në dy vende të punës (komuna e Ferizajt) janë kufizime të cilat mohojnë të drejtën e garantuar të kandidatëve për të konkurruar në të gjitha vendet e punës.
40. Po ashtu, konkurset e shpallura nga DKA-të janë mbështetur në dispozita të ndryshme ligjore, në disa raste edhe në Udhëzime Administrative të shfuqizuara, në disa komuna janë zbatuar Ligji i Punës dhe Udhëzimi Administrativ Nr.14/2011 i MPMS, ndërsa në disa tjera janë zbatuar dispozitat e veçanta ligjore të MASHT-it, prandaj, në situata të tilla, kur kemi një ligj të përgjithshëm dhe ligjet e veçanta, Avokati i Popullit konsideron se duhet të zbatohen ligjet e veçanta të cilat rregullojnë çështjen e punësimit të mësimdhënësve.³⁰
41. Po ashtu vërehet se, sipas vendimeve për formimin e komisioneve intervistuese, të nxjerra nga DKA-të, lidhur me numrin e anëtarëve të komisioneve intervistuese, disa komuna kanë formuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, disa me katër dhe në disa komuna me pesë anëtarë, në disa komuna kemi pasur edhe vëzhgues ndërsa në disa komuna nuk janë përfshi në komision drejtorët e shkollave, këto dallime kanë ndodhë për shkak të zbatimit të akteve të ndryshme ligjore nga DKA-të. Prandaj, Avokati i Popullit tërheqë vërejtjen se komisionet intervistuese duhet të formohen në bazë të nenit 35, paragrafi 4, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ Nr.17/2009 Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë, si akte ligjore të veçanta të cilat rregullojnë procedurat e punësimit të mësimdhënësve³¹.
42. Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmimeve të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, në pajtim me legjislacionin përkatës, konstaton se ka pasur shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, me që zyrtarët përgjegjës të DKA-ve në komunën e Prishtinës, Gjilanit, Vitisë, Ferizajt,

³⁰ Ligji i Punës, neni 2, paragrafi 2.

³¹ Ligji i Punës, neni 2, paragrafi 2.

Lipjanit, Klinës, Rahovecit, Novobërdës dhe Obiliqit, kanë vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

43. Si përfundim, Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që këto praktika të mos përsëriten në të ardhmen, në mënyrë që të gjitha veprimet e organeve komunale të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në bazë të kësaj që u tha më lart, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të autoriteteve, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019.:

Avokati i Popullit rekomandon që :

Komuna e Prishtinës

1. *Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të siguroj të drejtën e garantuar Kushtetuese të kandidatëve që secili person është i lirë të zgjedhë vendin e punës.*

Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Vitisë

2. *Të ndërmarrin të gjitha masat që t'u jepet fund rasteve të tilla të trajtimit të pabarabartë dhe të sigurohet që të gjithë kandidatët të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për punësim në institucionet e arsimit, pa marrë parasysh vendin ku jetojnë apo ku kanë lindur.*

Komuna e Prishtinës, Komuna e Vitisë, Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Rahovecit

3. *Të sigurojnë që komisioni për përzgjedhjen e mësimdhënësve të formohet në përputhje me ligjin.³²*

Komuna e Ferizajt, Komuna e Lipjanit dhe Komuna e Klinës

4. *Të garantojnë të drejtën e çdo kandidati për të aplikuar në të gjitha vendet e punës pa kufizime të mëtejme.*

Komuna e Vitisë, Komuna e Novobërdës dhe Komuna e Obiliqit

5. *Të ndërmarrin të gjitha masat që në të ardhmen hartimi i konkurseve të bëhet në mbështetje të akteve ligjore të cilat janë fuqi.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Kopje : Z. Habit Hajredini, udhëheqës i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

³² Neni 35, par.4, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe neni 3, i Udhëzimit Administrativ Nr.17/2009 Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë parashohin formimin e komisionit intervistues.

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 382/2016

Raport në lidhje me cenimin e dinjitetit dhe së drejtës së pensionistëve për pensione

Drejtuar:

- Z. Arban Abrashi, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Prishtinë, më 25 nëntor 2016

QËLLIMET E RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) lidhur me domosdoshmërinë e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor të pensionistëve si pasojë e procedurave të lajmërimit që burojnë nga Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (Ligji Nr. 04/L-131) dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS Nr. 05/2015).
2. Më 16 qershor 2016, Avokati i Popullit ka hapur rast për hetim sipas detyrës zyrtare, *ex officio* 382/2016, bazuar në një shkrim të gazetës “Koha ditore”, të datës 30 maj 2016. Raporti është i bazuar në hetimet dhe mbështetet në faktet dhe provat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me detyrimin e shfrytëzuesve të pensioneve që të paraqiten çdo 6 (gjashtë) muaj pranë organit kompetent të MPMS-së, në mënyrë që të mos u ndërpritet pensioni.

BAZA LIGJORE

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).
- “t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 3).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

PËRMBLEDHJA E FAKTEVE - ANALIZA E RASTIT

1. E drejta për pensione dhe e drejta e dinjitetit njerëzor garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligje vendore dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
2. Mbrojtja e dinjitetit të njeriut është parim bazë i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 23), “*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.*” Kjo e drejtë paraqet pacenueshmërinë e integritetit të njeriut, lirinë për të zhvilluar lirshëm personalitetin në kuptimin trupor, shpirtëror dhe moral.
3. Ligji i Punës Nr. 03/L-212 përcakton se çdo person që e mbush moshën prej 65 vitesh e arrin moshën e pensionimit dhe me këtë rast i ndërpritet marrëdhënia e punës.
4. Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës Nr. 04/L-101 përcakton se Moshja e Pensionimit është moshja gjashtëdhjetë e pesëvjeçare (65).

5. Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti Nr. 04/L-131, në nenin 8 i përcakton kushtet dhe kriteret për njohjen e së drejtës në pension kontributpagues.³³
6. Me Ligjin për Skemat Pensionale Nr. 04/L-131: Rregullohen dhe përcaktohen pensionet bazike të moshës, pensionet kontributpaguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti; konsolidimin, harmonizimin dhe unifikimin e skemave pensionale të aplikueshme, të cilat aktualisht financohen nga Buxheti Shtetëror i Kosovës; bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i nënshkruan Republika e Kosovës me shtetet përkatëse; kriteret kushtet dhe procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e së drejtës në pension për pagesat e pensioneve.
7. Neni 24 i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti Nr. 04/L-131 përcakton se:

“Ministria, do të ndërmarrë veprime me të cilat do të monitorojë burimet ekzistuese të informatave për të identifikuar pensionistët që kanë vdekur, me qëllim që të bëjë ndërprerjen e pagesës së Pensionit sa më parë që është e mundshme. 2. Shfrytëzuesit e pensionit bazik të moshës dhe shfrytëzuesit e pensioneve të parakohshme duhet të paraqiten në zyrat e caktuara nga Ministria një herë në gjashtë muaj me dokumentet përkatëse të identifikimit. 3. Ministria mund të suspendojë përkohësisht pagesën e pensionit nëse pensionisti nuk arrin të bëjë një gjë të tillë konform paragrafit 2 të këtij neni. 4. Suspendimi nga pagesa e pensionistëve në shfrytëzimin e pensioneve, do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.”

Mbi këtë bazë, Ministria duhet të ndërmarrë veprime që të identifikojë pensionistët që kanë vdekur, me qëllim që të bëhet ndërprerja e Pensionit, dhe të pamundësohet keqpërdorimi, dhe këtë e ka bërë me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2015 për Procedurat e Lajmërimit, Suspendimin nga Pagesa dhe Kthimin e Mjeteve në rastet e Keqpërdorimit të Pensioneve.

Me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2015, personat që janë shfrytëzues të pensionit janë të obliguar të lajmërohen personalisht çdo 6 muaj në zyrat e departamenteve për pensionistë. Në të kundërtën do t’u suspendohet përkohësisht pagesa e pensionit. Nëse pensionisti lajmërohet në zyrën përkatëse pensionale, brenda 3 muajve nga data e suspendimit të pagesës, atij do t’i vazhdohet pagesa e pensionit. Por, nëse lajmërohet pas këtij afati, kërkesa e tij do të konsiderohet si riaplikim dhe pagesa e tij rrjedhë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

8. Obligimi i pensionistëve për t’u lajmëruar sipas Udhëzimit Administrativ në fjalë, është përcjellë me pakënaqësi dhe ankesa të shfrytëzuesve pensional. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se shfrytëzuesit pensional përballen me ndjenjën e cenimit të integritetit në vazhdimësi, duke qenë të obliguar të lajmërohen në organet kompetente të MPMS-së, si kusht për të fituar një të drejtë që e kanë të garantuar me ligj. Situata bëhet edhe më rënduese për pensionistët që janë në moshë të shtyrë, apo me probleme shëndetësore. Pritja në radhë të gjata korridoreve të Ministrisë është e rëndë jo vetëm në kuptimin fizik por paraqet edhe përbuzje në kuptimin moral e shpirtëror.
9. Një nga dokumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut në nenin 1 thotë: *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta... [..]”*
10. Në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shqetësimi për dinjitetin njerëzor vërehet nga të paktën katër aspekte:

³³ Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999

- (1) ndalimin e të gjitha llojeve të trajtimit çnjerëzor, poshtërimin, ose degradimit nga një person mbi një tjetër;
- (2) garantimi i mundësisë për zgjedhje individuale dhe kushtet për 'vetë-përmbushje të çdo individi ',autonomie, apo vetë-realizimi;
- (3) Të kuptuarit se mbrojtja e identitetit dhe kulturës së një grupi mund të jetë e domosdoshme për mbrojtjen e dinjitetit personal;
- (4) krijimi i domosdoshëm i kushteve për çdo individ që të përmbushë nevojat e tij themelore.³⁴

Në rastin në fjalë, nevojë themelore është e drejta e pensionistit për të gëzuar pensionin e tij qetësisht. Procedurat për lajmërimin e pensionistëve paraqesin vështirësi të mëdha duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre shëndetësore dhe emocionale, si dhe standardin jetësor.

11. GJEDNJ, në interpretimet e saj në raport me dinjitetin njerëzor bazohet kryesisht në nenin 3 të KEDNJ, i cili thotë: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.
12. Po ashtu, GJEDNJ vlerëson se neni 3 nuk bazohet vetëm në nevojën për të luftuar fenomenin e torturës, por mbrojtja që ky nen siguron përfshin edhe lloje të ndryshme të dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik³⁵. Duke u thirrur në nenin 3 të KEDNJ, përmes interpretimeve, GJEDNJ ka ofruar më shumë mundësi që shkelja e dinjitetit si e drejtë, të përfshihet dhe të trajtohet më shpesh, dhe të konsiderohet me rëndësi të madhe dëmtimi i individit në aspektin emocional e psikologjik.
13. Nenin 3, në kontekstin e Konventës, Gjykata e ka renditur shpesh e në mënyrë të përsëritur, së bashku me Nenin 2, të drejtën për jetën, si një nga të drejtat më themelore që mbrohen nga Konventa, qëllimi thelbësor i së cilës është që të mbrojnë dinjitetin e një individi e integritetin e tij fizik.
14. Po ashtu, në bazë të së drejtës ndërkombëtare nënkuptohet se shteti duhet të angazhohet në respektimin e të drejtave të njeriut, të përmbahet nga ndërhyrja në gëzimin e të drejtave, dhe duhet të angazhohet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga keqpërdorimi i tyre. Shteti duhet të angazhohet në ndërmarrjen e veprimeve pozitive në mënyrë që ta lehtësojë gëzimin e të drejtave.³⁶ Në rastin konkret, Ministria duhet të ndërmarrë veprime të atilla që të mos e cenojë dinjitetin e pensionistëve dhe t’u mundësojë që qetësisht dhe në mënyrë të papenguar ta gëzojnë të drejtën e tyre.
15. Avokati i Popullit vlerëson se obligimi i pensionistëve për lajmërim, ndonëse ka një qëllim legjitim dhe buron nga ligji, i mungon elementi i përfshirjes së dallimeve mes nevojave dhe konteksteve që i shkaktojnë këto dallime. Kjo për arsye se pensionistët në parim nuk janë në pozicione të njëjta dhe nuk ndajnë të njëjtat nevoja, as në kuptimin fizik/shëndetësor e as në atë moral e shpirtëror. Ligji për pensione me të cilin përcaktohet procedura e lajmërimit, do të duhej të parashihte rrethanat që pamundësojnë pritjet në radhë për lajmërim, siç mund të jenë shëndeti i dobët i pensionistit, rrethanat emocionale si ndikon ky proces në kuptimin psikologjik, dhe arsye të tjera.

³⁴ A. Reis Montero, *Ethics of Human Rights*, University of Lisbon, Portugal, Springs, 2014, fq.249, shih në: https://books.google.com/books?id=oPi8BAAAQBAJ&pg=PA249&lpg=PA249&dq=prohibition+of+all+kinds+of+inhumane+tr eatment,+humiliation+or+degradation+of+one+person+over+another;+%28%29+guarantee+the+possibility+for+individual+ch oice+and+the+conditions+for+%27self-fulfillment+of+each+individual+%22autonomy,+or+self-realization;+%283%29+understanding+that+protecting+the+identity+and+culture+of+a+group+may+be+necessary+for+the+pro tection+of+personal+dignity;+%284%29+creation+of+necessary+conditions+for+every+individual+to+meet+his+basic+needs.&source=bl&ots=5NP07ya0r8&sig=jBuqL_6xeRXVsuOaoiMcJRNhDdA&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjtyuje8vrPAhWBUro KHX9SB5YQ6AEIJTAB#v=onepage&q&f=false, (27.10.2016)

³⁵ Udhëzues për zbatimin e nenit 3 të KEDNJ, nr.6, fq.10.

³⁶ Marthe Fredvang and Simon Biggs, Social Policy Working Paper no. 16 The rights of older persons, *Protection and gaps under Human Rights Law*, August 2012.

16. GJEDNJ në rastin Bouyid kundër Belgjikës³⁷, duke e analizuar shkeljen e dinjitetit në kuadër të nenit 3 të KEDNJ, vlerëson se ekziston një lidhje veçanërisht e fortë në mes të konceptit të trajtimit “poshtërues” ose dënimit dhe respektit për dinjitetin. Edhe Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut më 1973, ka theksuar se në kuadër të nenit 3 të KEDNJ, shprehja “trajtim poshtërues” tregon se qëllimi i përgjithshëm i kësaj dispozite është për të parandaluar ndërhyrjet në dinjitetin njerëzor.³⁸
17. Gjykata Kushtetuese e Hungarisë duke vendosur në rastin 23/1990 X.31 AB, lidhur me kërkesën për t’i shpallur jokushtetuese disa dispozita të Kodit Penal të Hungarisë, trajton çështjen e dinjitetit njerëzor dhe vlerëson se dinjiteti i njeriut është një e drejtë absolute subjektive dhe nuk mund të kufizohet dhe as të zvogëlohet meqenëse është e drejtë themelore.³⁹
18. Duke u bazuar në interpretimet e GJEDNJ lidhur me dinjitetin dhe nenin 3 të KEDNJ-së, por edhe në interpretimin që Gjykata Supreme e Kanadasë ka bërë në rastin *Law v. Canada*⁴⁰, një nga autorët⁴¹ e “Dinjiteti i Njeriut dhe Interpretimi Gjyqësor i të Drejtave të Njeriut”, EJIL 19 (2008)⁴², thekson se dinjiteti njerëzor nënkupton që individi apo një grup/komunitet të ndjehet i respektuar dhe i vlerësuar, ka të bëjë me fuqizimin, me integritetin fizik dhe psikologjik. Për të intensifikuar këtë parim ekzistojnë ligjet, ato përcaktojnë me kujdes nevojat, kapacitetet e individëve, gjithmonë duke përfshirë dallimet mes nevojave të tyre dhe kontekstin e atyre dallimeve.
19. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se sipas së drejtës ndërkombëtare, pensionet parashihen brenda fushës të së drejtës së pronësisë të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁴³ Koncepti i pronës është interpretuar në terma shumë të gjerë, por që përmbajnë interesa dhe të drejta ekonomike, të drejtat mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Neni 1, Protokollit 1, i KEDNJ:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare....[...].”

20. GJEDNJ, në rastin *Wieczorek kundër Polonisë*, thekson se neni 1, Protokollit 1, i KEDNJ, përmban tri rregulla të veçanta, ku rregulli i parë, i përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është i një natyre të përgjithshme dhe shqipton parimin e gëzimit të qetë të pronës; rregulli i dytë, i përfshirë në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin nga prona; rregulli i tretë, i përfshirë në paragrafin e dytë, pranon se shtetet kontraktuese kanë të drejtë, ndër të tjera, për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Por, gjykata rithekson se rregulla e dytë dhe e tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes me të drejtën e gëzimit të qetë të pronës dhe për këtë arsye duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm shprehur qartë në rregullin e parë.⁴⁴
21. E drejta e pronësisë në bazë të KEDNJ nuk përcakton dhënien e pensionit apo shumën, meqenëse këto rregullohen me ligje nacionale dhe se shtetet gëzojnë hapësirën e dhënies së përfitimeve sociale. Megjithatë, në momentin që pensionet janë dhënë (në bazë të kontributeve sipas rastit) ato

³⁷ Rasti BOUYID v. BELGIUM (App. no. 23380/09), shih në: <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-157670#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2223380%2F09%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-157670%22%5D%7D> , (31.10.2016)

³⁸ *Po aty*, paragrafi 90.

³⁹ Vendimi 23/1990 (X. 31.), heqja e dënimit me vdekje, 31 tetor 1990, faqe 30. Shih në: http://www.mkab.hu/letoltesek/en_0023_1990.pdf, (30.10.2016)

⁴⁰ Vendim i Gjykatës Supreme të Kanadasë, i datës 25 mars 1999, <https://scc-csc.lexum.com/scc-csc/scc-csc/en/item/1691/index.do#> , (01.11.2016)

⁴¹ Christofer McCrudden, Professor of Human Rights Law, Oxford University; Fellow, Lincoln College, Oxford; Overseas Affiliated Professor, University of Michigan Law School.

⁴² Dinjiteti i Njeriut dhe Interpretimi Gjyqësor i të Drejtave të Njeriut, EJIL 19 (2008), 655-724

⁴³ Neni 1, Protokollit 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁴⁴ Rasti i *Wieczorek k. Polonisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (Nr. i Aplikimit 18176/05), Vendim, Strasburg, 2010, paragrafi 56.

konsiderohen si pronësi. Si pasojë, trajtimi i pensioneve bëhet në përputhje me kërkesat e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili e parasheh që gjatë trajtimit të pensioneve duhet të ndiqet një qëllim i ligjshëm i cili nuk cenon interesat e individit duke bërë dëm apo shtuar barrë të rëndë mbi qytetarë, por njëkohësisht duhet të ruhen edhe interesat e përgjithshme.

22. Avokati i Popullit konsideron se lajmërimi i pensionistëve që janë gjallë si kusht për vazhdimin e pensionit, është procedurë rënduese sepse bie ndesh me qëllimin e ligjshëm bazuar në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Ky grup (komuniteti i pensionistëve) diskriminohet, shkaktohen lodhje dhe ngarkesë fizike gjatë pritjeve, dhe ata nuk ndihen të barabartë me pjesën tjetër të qytetarëve.
23. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se reduktimi ose ndërprerja e të drejtave të pensionit paraqet një ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pronës.⁴⁵ Kështu është argumentuar në vendimin e GJEDNJ të rastit *Wieczorek k. Polonisë*. Në rastin e përmendur, kërkuesja kishte pretenduar që është privuar nga e drejta për gjykim të drejtë sepse i është mohuar ndihma ligjore për parashtrimin e një apeli dhe se i ishte shkelur e drejta për respektimin e pasurisë së saj në momentin që i është ndërprerë pensioni invalidor që e kishte marrë për pesëmbëdhjetë vjet. Ndonëse në mungesë të vërtetimit të gjendjes shëndetësore të shfrytëzueses së pensionit nga ana e organit kompetentë.
24. Avokati i Popullit vlerëson se rol të madh luan mënyra se si interpretohet Ligji për Skemat Pensionale dhe se Ministria ka pasur hapësirë të përdorë alternativa për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji. Meqenëse vetë Ligji për Skemat Pensionale përcakton gjetjen e burimeve ekzistuese për të identifikuar pensionistët që nuk jetojnë më, kjo jo domosdoshmërisht duhet të aplikohet vetëm me procedurën e lajmërimit të pensionistëve, e cila përcaktohet në pikën vijuese të nenit dhe që i ka dhënë kompetencë Ministrisë të nxjerrë udhëzimin administrativ me kushtet e lajmërimit.
25. Avokati i Popullit konsideron se pjesë e këtyre burimeve mund të jenë të dhënat që MPMS mund të sigurojë në forma të tjera, si për shembull organet përkatëse komunale (zyrat për regjistrim të cilat i posedojnë listat e qytetarëve të gjallë, përmes shpalljeve publike, etj).
26. Avokati i Popullit konsideron se një kusht i tillë i përcaktuar me ligj dhe më pas me akt nënligjor, përveç që është diskriminues dhe cenon dinjitetin e pensionistëve, ajo nuk ka efektin që ligji ka tentuar të ofrojë në parim.
27. Avokati i Popullit thekson se duke u bazuar në analizën e standardave ndërkombëtare dhe në analizën e legjislacionit nacional, konkludohet se dinjiteti njerëzor paraqet themelin nga i cili burojnë të drejtat e njeriut. Ndonëse nuk ka një përkufizim të caktuar, dinjiteti njerëzor nënkupton vlerën e brendshme që njeriu ka, vlerë e cila kërkon të respektohet. Shteti dhe ligjet duhet të ekzistojnë për t'i shërbyer individit në përmbushjen e qëllimeve dhe jo anasjelltas.

KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në këtë raport, duke u bazuar në analizën e standardeve ndërkombëtare dhe në analizën e legjislacionit nacional, është trajtuar domosdoshmëria e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor të pensionistëve të Republikës së Kosovës dhe të drejtës së pensioneve, si pasojë e procedurave të lajmërimit që burojnë nga ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (Ligji Nr. 04/L-131) dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS Nr.05/2015).

Në bazë të analizës për rastin, fakteve të mbledhura, ligjeve në fuqi dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit konstaton se me këtë është shkelë dinjiteti i njeriut, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë, dhe se reduktimi ose ndërprerja e të drejtave të pensionit paraqet ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pronës.

⁴⁵ *Po aty*, paragrafi 56.

Avokati i Popullit, konstaton se, përveç që kjo masë ligjore është diskriminuese dhe e cenon dinjitetin e pensionistëve, ajo nuk ka efektin që ligji ka tentuar të ofrojë në parim. Ministria duhet të ndërmarrë veprime të atilla që të mos e cenojë dinjitetin e pensionistëve dhe t'u mundësojë që qetësisht dhe në mënyrë të papenguar ta gëzojnë të drejtën e tyre.

REKOMANDIM

Në bazë të analizës së rastit dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 16, paragrafin 15 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- **Në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, Ministria të inicioj procedurat për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në atë mënyrë që të riparojë shkeljet ndaj pensionistëve.**
- **Në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, Ministria të funksionalizojë burimet e saj verifikuese në raport me statusin e pensionistëve edhe përmes formave të tjera siç janë analizuar më lart dhe bëjë njoftim publik për ndryshimin e procedurave.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 894/2016

Raport në lidhje me Vlerësimin Nacional të të Drejtave të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues në Kosovë

Drejtuar:

- z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- z. Isa Mustafa, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
- znj. Lirije Kajtazi, Kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur Dhe Peticione
- znj. Flora Brovina, Kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
- z. Nait Hasani, Kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
- z. Imet Rrahmani, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë
- z. Arsim Bajrami, Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- znj. Dhurata Hoxha, Ministre e Ministrisë së Drejtësisë
- z. Arban Abrashi, Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
- znj. Edi Gusia, u.d.Drejtoreshë e Agjencionit për Barazi Gjinore

Prishtinë, 22 dhjetor 2016

Qëllimi i raportit

Ky Raport ka për qëllim vlerësimin në nivel vendi të të Drejtave në Shëndetin Riprodhues dhe Seksual (më tutje DSHRS) dhe shkallën në të cilën këto drejta, të mbrojtura me Kushtetutë, realizohen në praktikë, përmes ligjeve, politikave dhe implementimit në Kosovë; për të vlerësuar fushat kyçe të progresit si dhe barrierat.

Vlerësimi, i pari i këtij lloji në Kosovë, është i fokusuar në shtatë çështjet kyçe të DSHRS-së: shërbimet dhe informatat mbi kontraceptivët; abortin e sigurt, shëndetin e nënës; HIV/AIDS; edukimin gjithëpërfshirës seksual; dhunën kundër gruas; kancerit e shëndetit riprodhues. Fokusohet po ashtu në grupet e rrezikuara përfshirë adoleshentët; komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian; meshkujt që bëjnë seks me meshkuj, punëtorët femra të seksit (PFS) dhe personat me aftësi të kufizuara.

Çështje kyçe në lidhje me të drejtat njerëzore siç janë besueshmëria dhe prania e të dhënave, jo-diskriminimi, privatësia përfshirë konfidencialitetin dhe pjesëmarrjen ishin po ashtu në fokus të vlerësimit, siç edhe ishte sistemi i gjerë shëndetësor dhe konteksti socio-ekonomik që janë shumë të rëndësishme për të kuptuar DSHRS-në, fushat e progresit dhe pengesat.

Për të vlerësuar progresin dhe pengesat, vlerësimi ka identifikuar një sërë pyetjesh dhe indikatorësh në lidhje me çështjet e DSHRS-së. Të dhënat janë analizuar me tri pyetje kryesore në mendje: cila është gjendja e DSHRS e popullatës së Kosovës, përfshirë grupet e marginalizuara? Cilat ligje kyçe, politika dhe iniciativa janë adaptuar nga Qeveria, dhe cila është gjendja e implementimit të tyre? Cilat janë përputhjet dhe mospërputhjet mes mbrojtjes kushtetuese të DSHRS-së dhe realitetit? Ky raport përfshinë rekomandimet e bazuara në gjetjet nga këto pyetje.

Baza ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:

- *“të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (pika 1),*
- *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);*
- *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 4);*
- *“të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);*
- *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);*
- *“të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8);*

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

Konteksti i Raportit dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

Kosova u bë shtet i pavarur në vitin 2008. Para kësaj ishte e qeverisur nga Misioni i Brendshëm Administrues në Kosovë (UNMIK) për një periudhë prej nëntë vitesh (1999-2008). Ligjet e Kosovës, institucionet dhe sistemi shëndetësor janë relativisht të reja dhe janë zhvilluar përkundër ambientit sfidues ekonomik me nivel të lartë të varfërisë dhe papunësisë, dhe trashëgimisë së luftës së viteve 1998-99, e cila solli dëme të mëdha në infrastrukturën e sistemit shëndetësor.

Në këtë kontekst janë bërë disa arritje të mëdha. Kosova ka një kornizë të fortë kushtetuese për mbrojtjen e DSHRS-ve si dhe një numër relevant ligjesh e politikash. Vendi po ashtu ka bërë progres/arritje në zhvillimin e një sistemi të ri shëndetësor me sistem të duhur referimi. Veçanërisht në lidhje me çështjet e DSHRS-së, ka një shkallë të ulët të vdekshmërisë dhe prevalencë të ulët të HIV/AIDS-it.

Megjithatë, progresi nuk ka qenë i barabartë me një sërë sfidash që pengojnë realizimin adekuat të DSHRS-ve në Kosovë. Disa nga këto kanë të bëjnë me sistemin shëndetësor në përgjithësi, përfshirë: kontributet e ulëta buxhetore në shëndetësi; implementimi i dobët i ligjeve dhe politikave; koordinimit të dobët mes sektorëve si dhe autoriteteve qendrore dhe komunale; kufizime signifikante në grumbullimin e të dhënave përfshirë sistemin e informimit shëndetësor që preket nga raportimi i kufizuar dhe të dhëna të pasakta; qasje më të kufizuar në kujdes shëndetësor për personat që jetojnë në zonat rurale; dhe tendencës së popullatës për të kapërcyer qendrat e mjekësisë familjare dhe të shkojnë drejtpërdrejt tek specialisti i shëndetit seksual dhe riprodhues. Ka edhe monitorim të dobët dhe llogaridhënie, përfshirë atë në lidhje me praktikën siç është aborti klandestin, dhe implementimi i politikave. Pjesëmarrja e popullatës përfshirë grupet e marginalizuara në zhvillimin e politikave në lidhje me DSHRS-në është e kufizuar. Privatësia dhe konfidencialiteti respektohen dobët nga profesionistët me që përcillet me mosndëshkim, gjë që shkel jo vetëm të drejtat njerëzore për privatësi, por që vepron edhe si një dekurajim në kërkimin e shërbimeve nga profesionistët e licencuar. Shumica e politikave mbi shëndetin riprodhues dhe seksual kanë skaduar dhe duhet zëvendësuar: në të njëjtën kohë është e rëndësishme që proceset e formulimit të politikave nuk dominojnë sektorin deri në përjashtimin apo implementimit të DSHRS-ve.

Për më tepër, ka sfida të ndërlidhura, që secila prek të gjitha apo një sërë çështjesh të DSHRS-ve, secila çështje e DSHRS-ve e vlerësuar në këtë raport ballafaqohet me problemet përkatëse:

- *Qasja në shërbime dhe informata për kontraktivët:* përdorimi i metodave moderne të kontracepsionit është tepër i ulët. Ka një vetëdije të ulët rreth metodave moderne të kontracepsionit, posaçërisht mes disa grupeve siç janë adoleshentët dhe popullata rurale. Kontraktivët konsiderohen të shtrenjtë nga disa segmente të popullatës dhe shpërndarja e rregullt dhe falas e kontraktivëve në qendrat e mjekësisë familjare është ndërprerë që nga ndalimi i furnizimit të tyre nga Fondi i Popullatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA). Profesionistët shëndetësor ndonjëherë ngurrojnë të diskutojnë kontracepsionin me përdoruesit të cilët po ashtu ngurrojnë të flasin nga ana e tyre.
- *Qasja në abort dhe kujdesin pas abortit:* ka një problem shumë serioz dhe përhapur që është aborti klandestin nga klinikat private, të cilat nuk janë të licencuara për të kryer procedurën, përkundër ofrimit të shërbimeve të sigurta dhe legale të abortit në një numër klinikash publike shëndetësore. Në rrethana të tilla klandestine edhe pa rregulluara, aborti nuk është i sigurt. Gratë dhe vajzat adoleshente raportohet të kërkojnë aborte të tilla për shkak të mungesës së privatësisë dhe konfidencialitetit në sektorin publik. Edhe raportimi i aborteve është i kufizuar, posaçërisht nga institucionet private, që e bën

të pamundur për të vlerësuar shkallën e problemit. Ligji mbi Përfundimin e Shtatzënisë kërkon rishikim, përfshirë largimin e kufizimit të abortit për femrat mbi 16 vjeç.

- *Shëndeti i nënës:* vdekjet e nënave regjistrohen si të tilla vetëm nëse ndodhin në institucione emergjente obstetrike dhe qendra të lindjeve, që e bën të vështirë për të vlerësuar shkallën e vdekshmërisë së nënave. Nuk ka udhërrëfyes klinik dhe protokolle për shëndetin e nënës. Gratë shtatzëna shpesh kërkojnë kujdes antenatal nga shërbimet e specializuara se sa nga qendrat e mjekësisë familjare të cilat janë të pajisura për të mbështetur shtatzënitë e pa komplikua.
- **Sindroma i imunodeficiencës së fituar/Virusi i imunodeficiencës humane (HIV/AIDS):** Përkundër prevalencës së ulët të HIV/AIDS-it, përdorimi i ulët i kondomave, diskriminimi dhe stigma që rrethon marrëdhëniet mes gjinisë së njëjtë, mungesa e edukimit gjithëpërfshirës seksual në shkolla dhe për rininë jashtë shkollave, dhe dështimi nëqasjen ndaj punëtorëve të seksit me profilaksi vullnetare për HIV/AIDS, përbëjnë pengesa në DSHRS-ë. Terapia antiretrovirale (ARV) nuk është vazhdimisht e pranishme për trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS.
- *Edukimi gjithëpërfshirës mbi seksualitetin:* përkundër iniciativave të fundit për të zhvilluar edukim mbi seksualitetin, ofrimi është tepër i kufizuar. Jo të gjithë fëmijët dhe adoleshentët marrin edukim seksual të përshtatshëm për moshën në shkolla, derisa më shumë përpjekje duhet bërë për të mbështetur ofrimin e tij për të rinjtë jashtë shkollave dhe grupet e popullatës.
- *Kanceri i gjirit dhe i sistemit riprodhues:* nevojat e skenimit dhe trajtimit të kancerit cervikal duhet të jenë prioritet i parë. Shërbimet për të detektuar dhe trajtuar kancerin e gjirit duhet zhvilluar po ashtu. Ka mungesë të grumbullimit sistematik të të dhënave mbi incidencën dhe trajtimin e kancerit cervikal dhe atij të gjirit.
- *Grupet e rrezikuara:* në këtë kontekst të DSHRS-së, grupet e rrezikuara përfshijnë adoleshentët dhe të rinjtë, meshkujt që bëjnë seks me meshkuj, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Përpjekje të veçanta janë të nevojshme për të mbuluar këto grupe me intervenime të duhura të bazuara në të drejtat e njeriut dhe promovimin e DSHRS-së.

Rekomandimet

Në bazë të vlerësimit të bërë lidhur me shtatë çështjet kyçe të DSHRS-së të trajtuara në këtë raport dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

Kuvendit të Republikës së Kosovës

- Kushtetuta duhet amenduar për të përfshirë Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Kartën Sociale të Evropës në mënyrë që të jenë direkt të aplikueshme në ligjin vendor në Kosovë.
- Objektivat e qëndrueshme zhvillimore: Kuvendi duhet adoptuar formalisht Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore, duke pasur parasysh fokusin e tyre të rëndësishëm mbi DSHRS-të.

Qeverisë së Republikës së Kosovës

- Qeveria duhet të monitorojë dhe të bëjë përpjekje për të siguruar gëzimin e të drejtave dhe DSHRS-ve nga personat me aftësi të kufizuara.

- Buxheti: Qeveria duhet rritur kontributet e buxhetit për sektorin shëndetësor për pesë për qind në krahasim me vitin paraprak dhe për aktivitetet tjera të lidhura me shëndetin në sektorët tjerë. Resurset e alokuara për shëndetin riprodhues nuk duhet bartur diku tjetër.
- Sigurimi shëndetësor: Qeveria duhet vazhduar me mbledhjen e kontributeve të sigurimit shëndetësor dhe duhet implementuar Ligjin mbi Sigurimet Shëndetësore. Shëndeti seksual dhe riprodhues, përfshirë planifikimin familjar dhe kujdesin ndaj nënës duhet përfshirë në pakon themelore të shërbimeve në këtë fond. Kontraceptivet duhet mbuluar nën skemën e Sigurimit Shëndetësor, së paku për grupet vulnerabël siç janë definuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Pjesëmarrja: Qeveria duhet siguruar pjesëmarrjen e bartësve të të drejtave në zhvillimin e të gjitha politikave dhe programeve të reja mbi DSHRS. Në veçanti duhet bërë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të rrezikuara dhe marginalizuara, siç janë gratë, adoleshentët, LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët e seksit, dhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- Ligji mbi Ndërprerjen e Shtatzënisë duhet amandamentuar:
 - a. Qeveria duhet të sigurojë se shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues përfshirë shërbimet e abortit plotësojnë nevojat e të gjithë adoleshentëve. Duke pasur parasysh këtë, nuk duhet pasur kufizim moshe për abortin, me fjalë të tjera, edhe të miturave nën moshën 16 vjeç duhet ofruar shërbime aborti.
 - b. Edhe pse adoleshentët duhet inkurajuar të flasim me prindërit apo të rritur të tjerë rreth shtatzënisë dhe abortit në pajtim me interesin më të mirë të tyre dhe kapaciteteve të tyre, Qeveria duhet konsideruar lejimin e të miturave të kryejnë abort të sigurt pa pëlqimin e prindërve. Vendimi për abort dhe nëse prindërit duhet informuar rreth shtatzënisë dhe abortit, duhet t'i lihet adoleshentëve. Qeveria duhet punuar po ashtu për të siguruar që vajzat adoleshente të marrin vendime autonome dhe të informuara rreth shëndetit riprodhues, përfshirë abortin. Definicioni i “abortit” duhet amandamentuar në ligj dhe Udhëzimin Administrativ 09/11 për të larguar “me dhunë” nga definicioni ekzistues “ndërprerje e shtatzënisë me dhunë”.
- Pas tërheqjes së Fondit Global nga Kosova në vitin 2017, institucionet në Kosovë duhet përcaktuar buxhet në implementimin e strategjisë së HIV-it.
- Përpjekje më të mëdha nevojiten për të adresuar stigmatizimin dhe diskriminimin e grupeve të popullatës siç janë MSM (meshkujt që kryejnë seks me meshkuj) dhe punëtorët e seksit.
- Ekziston një nevojë në rritje për të elaboruar të drejtat e të mbijetuarve në “shërbimet shëndetësore dhe sociale” në nenin 27 të Ligjit mbi Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje. Trajtimi mjekësor, mbështetja psikologjike, strehimi, rehabilitimi dhe re-integrimi i të mbijetuarve duhet definuar qartë, dhe një ndarje e qartë e përgjegjësisë për institucionet qendrore dhe lokale duhet ofruar për të siguruar se shërbimet ofrohen në praktikë.
- Qeveria duhet konsideruar rishikimin e Ligjit mbi Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje për të siguruar se urdhrat mbrojtës nuk janë të kufizuara me kohë, por mund të lëshohen pa afat në rastet kur ekziston rreziku për të mbijetuarit/at. Në të njëjtën kohë, duhet modifikuar gjuha në ligj për t’u referuar si “kryerës të pretenduar” dhe jo si “kryerës” kur është e përshtatshme, për të shmangur paragjykimet e fajit para gjykimit.
- Qeveria duhet zhvilluar infrastrukturë, rrisë resurset njerëzore dhe zhvillojë kapacitetet profesionale në kontekstin e ofrimit të shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarit/at. Fondet për të mbijetuarit/at kanë qenë shumë të kufizuara dhe duhet rritur që kjo të ndodhë.

- Duhet bërë përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin mes institucioneve që punojnë më të mbijetuarit/at e dhunës (policisë, profesionistëve shëndetësor, strehimoreve, shërbimeve sociale, gjykatave)
- Qeveria e Kosovës duhet alokuar resurse adekuate për të grumbulluar të dhëna mbi dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave të prekura nga lufta.
- Qeveria e Kosovës duhet ndërmarrë masa efektive për adresimin e çështjes së grave të abuzuara seksualisht gjatë luftës duke kërkuar persekutimin e krimeve të lidhura me dhunën seksuale gjatë luftës në pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare.
- Qeveria e Kosovës duhet sigurojë që Komisioni mbi Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale është plotësisht funksional dhe të implementohet korniza ligjore aktuale.
- Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë mbështetje për rehabilitimin dhe trajtimin e traumave psikologjike, qasje të lehtë në edukim, kujdes shëndetësor dhe shërbime, dhe të luftojë stigmatizimin në shoqëri për të gjitha gratë e prekura nga lufta.
- Duhet ofruar resurse Bordit Kombëtar mbi Kontrollin e Kancerit dhe për Programin Kombëtar për Kontrollin e Kancerit 2014-2020.
- Garancitë Kushtetuese dhe garanci të tjera ligjore të barazisë dhe jo diskriminimit duhet respektuar, mbrojtur dhe plotësuar nga Qeveria dhe të gjithë akterët tjerë.
- Në përpjekjet e saj për të përmirësuar qasjen në informata dhe shërbime kontraceptive nga masat e cekura me lartë (dhe të tjera), strategjia e Qeverisë duhet vënë vëmendje të veçantë në ato grupe që janë më pak të informuara dhe kanë më pak qasje, siç janë identifikuar nga raporti i MICS dhe të dhëna tjera të besueshme. Këtu përfshihen adoleshentët dhe të rinjtë, personat me nivel më të ulët të edukimit, popullata që jetojnë në zona rurale, si dhe punëtorët e seksit dhe meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM) (shih Kapitulli 3, seksioni 7). Vëmendje duhet dhënë edhe qasjes në kontraceptiv për personat me aftësi të kufizuara. Prandaj këto grupe duhet ftuar të marrin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e strategjive, jo vetëm pse është e drejtë njerëzore e tyre, por sepse shërben edhe në rritjen e efektivitetit të këtyre strategjive.
- Është më se e rëndësishme që për të arritur standardet më të larta të shëndetit, Qeveria të adresoj problemin e abortit që kryhet në mënyrë klandestine në kushte të pasigurta nga institucione private dhe të pa autorizuara për të kryer procedurën. Të drejtat shëndetësore të gruas përfshijnë të drejtën për shërbime shëndetësore të mira dhe sigurta.
- Qeveria duhet të bëjë rishikimin e shërbimeve të abortit dhe një studim me fokus në reformën në sektorët publik dhe privat për të përcaktuar opsionet më të mira për përmirësimin e qasjes, si dhe cilësisë së abortit legal. Ofruesit e sektorit publik të abortit duhet përmirësuar shërbimet e tyre përfshirë përmirësimin e respektit të të drejtave të përdoruesve, si dhe ofrimin e kujdesit gjithëpërfshirës, përfshirë informatat e sakta, këshillimin jo dirigjues nëse kërkohet nga gruaja, shërbimet e abortit pa vonesë, dhe shërbimet kontraceptive pas abortit për të ndihmuar parandalimin e shtatzënive të paplanifikuara në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, Qeveria duhet konsideruar nëse është e përshtatshme të autorizojë dhe rregullojë numrin e klinikave private që kryejnë shërbimet e abortit duke pasur parasysh që ato plotësojnë kriteret e sigurisë dhe standardet e definuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), si dhe Udhëzimi Administrativ 09/11 është i rregulluar siç duhet. Qeveria duhet konsideruar po ashtu zgjerimin e ofrimit të shërbimeve të abortit tek ofruesit e shërbimeve jo të specializuara në pajtueshmëri me udhëzuesit e OBSH-së .

Ministrisë së Shëndetësisë

- Sistemi shëndetësor: Duhet të ketë përpjekje të vazhduara të udhëhequra nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me drejtoritë komunale për të përmirësuar funksionimin e qendrave të mjekësisë familjare për të inkurajuar popullatën të përdor këto institucione kur është e përshtatshme. Për zonat rurale duhet përmirësuar nevojat në lidhje me qasje në sistemin shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë duhet zhvilluar dhe implementuar masa për të bërë shërbimet shëndetësore, posaçërisht qendrat e mjekësisë familjare, miqësore për adoleshentët.
- Privatësia: Ministria e Shëndetësisë duhet bërë një rishikim të shkaqeve kryesore, manifestimeve dhe pasojave të mungesës së respektit mbi privatësinë dhe konfidencialitetin në institucionet shëndetësore riprodhuese dhe seksuale, përfshirë shërbimet kontraceptive, abortin, kujdesin pas abortit, kujdesin shëndetësor maternal dhe testimin dhe këshillimin vullnetar (KTV) për IST-të, duke marrë parasysh mbrojtjen formale të të dhënave dhe procedurat, dhe qëndrimet dhe veprimet e profesionistëve shëndetësor mbi këto çështje. Është kritike ngritja e vetëdijes dhe trajnimit i profesionistëve shëndetësor mbi këto çështje, dhe procedura të qarta kur shkelen këto detyra.
- Komunikimi dhe koordinimi: Ministria e Shëndetësisë duhet krijuar një organ koordinues ndër-institucional mbi shëndetin seksual dhe riprodhues për të përmirësuar koordinimin dhe komunikimin mes institucioneve nacionale dhe trupave të tjera nacionale dhe komunale. Të drejtat e njeriut duhet përfshirë në mënyrë eksplicite në termat e referencës.
- Indikatorët dhe të dhënat: Duhet bërë përpjekje që Sistemi i Informimit Shëndetësor të përfshijë të dhënat gjithëpërfshirëse dhe të besueshme, përfshirë çështje të caktuara të DSHRS-ve, si dhe shëndetit të nënës dhe abortit. Duhet përmirësuar regjistrimin i vdekjeve maternale, përfshirë zgjerimin e kriterëve të raportimit nga institucionet emergjente obstetrike dhe qendrave të lindjeve deri në të gjitha vendet ku ato ndodhin. Ministria e Shëndetësisë duhet përpjekur për të siguruar që ofruesit e shërbimeve të abortit janë në pajtim me nenin 21 të Ligjit për Ndërprerjen e Shtatzënisë, që deklaron se secili institucion shëndetësor është i obliguar për të raportuar të dhënat statistikore mbi ndërprerjet e shtatzënieve. Grumbullimi i të dhënave mbi dhunën e bazuar në gjini duhet përmirësuar. Të dhënat duhet grumbulluar dhe ndarë sipas natyrës së diskriminimit siç është gjinia, etnia, moshja, gjendja sociale dhe ekonomike (p.sh. niveli i edukimit dhe të ardhurat) dhe aftësitë e kufizuara. Ky rishikim ka gjetur veçanërisht informata të kufizuara mbi DSHRS për personat me aftësi të kufizuara, duhet bërë përpjekje më të mëdha për të ofruar të dhëna mbi këtë fushë.
- Inspektorati shëndetësor duhet forcuar. Numri i inspektorëve duhet rritur. Inspektorati duhet të përdorë mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës si kornizë reference për inspektimet e tij.
- Qasja në mekanizmat llogaridhënës: Ministria e Shëndetësisë duhet rritur vetëdijen e popullatës, dhe të përmirësoj qasjen e vet në mekanizmat llogaridhënës mbi DSHRS-të, përfshirë gjykatat, IAP-në dhe organet administrative. Duhet kushtuar vëmendje sigurimit të qasjes për grupet e rrezikuara siç janë adoleshentët.
- Trajnimi mbi DSHRS-të: Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UNFPA-në duhet ofruar trajnim mbi DSHRS për politikë bërësit kryesorë në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Ministria e Shëndetësisë duhet bërë të mundshëm ofrimin falas të kontraceptivëve së paku të një kontraceptivi hormonal të kombinuar me dozë të ulët, një hormonal injektabel, kondoma meshkujsh, një dispozitiv intrauterin (T) me bakër, dhe një kontraceptiv emergjent për grupet në vijim: “1) segmentit më të varfër dhe të tretë të popullatës; 2) çifteve që janë nën nivelin e varfërisë ekstreme (i.e. 12% të popullatës); 3) komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian; 4) adoleshentëve seksualisht aktiv nga moshat 15-19 vjeç; 5) grave që vuajnë dhunë në familje dhe atyre në strehim; 6) të rinjve nga moshja 15-24 vjeç që jetojnë në vende rurale”; dhe 7 (PFS). Këto duhet ofruar nga mjekët dhe gjinekologët në Qendrat e Mjekësisë Familjare. Kjo duhet mbështetur nga një sistem i logjistikës dhe menaxhimit të kontraceptiveve (SLMK) dhe një linjë te veçantë buxheti për

kontraktivët. Duhet bërë përpjekje për të përmirësuar shfrytëzimin e Qendrave të Mjekësisë Familjare nga popullata për planifikimin familjar.

- Ministria e Shëndetësisë duhet prokuruar kontraktivët, duke shfrytëzuar prokurimin nga pala e tretë nga UNFPA.
- Për të implementuar Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) 07/2013 Metodën dhe Mjetet Moderne për Planifikim Familjar, Ministria e Shëndetësisë duhet siguruar se ofrohet një furnizim i rregullt me kontraktivë në Qendrat e Mjekësisë Familjare. Harxhimi i stoqeve duhet shmangur.
- Kondomët duhet të jenë gjerësisht të disponueshëm me kosto të ulët në aparate të instaluar në vende të përshtatshme që janë të qasshme dhe që ofrojnë privatësi për konsumatorët.
- Kontraktivët duhet mbajtur në Listën e Barnave Esenciale.
- Në pajtim me Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) 07/2013 Metodën dhe Mjetet Moderne për Planifikim Familjar, Ministria e Shëndetësisë duhet siguruar se profesionistët shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare në mënyrë profesionale dhe proaktive ofrojnë informata mbi planifikimin familjar kur kërkohet, dhe qasja e tyre ndaj përdoruesve është me respekt dhe dinjitet, dhe që ruhet konfidencialiteti dhe privatësia e pacientëve në të gjitha rastet. Duke pasur parasysh këtë Ministria e Shëndetësisë duhet:
 - a. Siguruar trajnim të vazhduar për mjekët, infermierët dhe mamitë në ofrimin e informatave të duhura për kontraktivët, përfshirë eliminimin e paragjyqimeve dhe ofrimin e këshillimit për planifikimin familjar për pacientët, ashtu që ata do mund të bëjnë zgjedhje të pavarur dhe informuar rreth përdorimit të kontraktivëve.
 - b. Investigimi i çështjeve të tjera për të përmirësuar qasjen në informata në qendrat e mjekësisë familjare, siç është ofrimi i fletushkave informative mbi metodat e pranishme kontraktive, përdorimin e tyre dhe përfitimet dhe efektet e tyre, si dhe grupeve mbështetëse të pacientëve.
 - c. Duhet siguruar se Inspektorati Shëndetësor, dhe koordinatorët e cilësisë së shërbimeve brenda institucioneve publike, monitorojnë dhe rishikojnë cilësinë dhe pranueshmërinë e shërbimeve të planifikimit familjar.
- Aspirimi me vakum dhe dilatimi dhe evakuimi duhet zëvendësuar dilatimin dhe kiretazhën e mprehtë për të gjitha abortet kirurgjike. Aspirimi me vakum duhet prezantuar për abort kirurgjik për shtatzënitë deri 12-14 javë të gestacionit. Po ashtu, Qeveria duhet konsideruar abortin medicinal me kombinimin e mifepristone-misoprostol në pajtueshmëri me udhëzuesit e OBSH-së.
- Qeveria duhet inkurajuar regjistrimin e produkteve të paketuara të mifepristone and misoprostol dhe pastaj të vlerësoj mundësitë për adresimin e shitjes ilegale pa recetë të mifepristone and misoprostol. Të paktën, produktet e pa regjistruara në treg duhet testuar për cilësi.
- Sistemi i rishikimit të vdekjeve maternale dhe “near miss” (rasteve potenciale për vdekje, dëmtimet, lëndimet) duhet implementuar. Metodologjia duhet të jetë konsistente me “Beyond the Numbers ” të OBSH-së.
- Udhërrëfyesit dhe protokollet klinike në lidhje me shëndetin e nënës duhet zhvilluar dhe implementuar.
- Duhet bërë përpjekjet për të inkurajuar gratë të përdorin shërbimet e lidhura me maternitetin në qendrat e mjekësisë familjare. Për shembull, duhet bërë përpjekje për të adresuar barrierat siç janë shpenzimet e transportit. Një skemë kuponësh mund të merret parasysh për të furnizuar gratë që nuk janë në gjendje të paguajnë shpenzimet.

- Ministria e Shëndetësisë duhet promovuar përdorimin rutinë të Klasifikimit të Robson-it për të udhëzuar vendimet rreth adresimit të prerjes cezariene, dhe monitoruar nëse klinikat i përdorin këto kriterë në praktikë. UNFPA duhet mbështetur ofrimin e informatave për publikun mbi përdorimin e duhur, dhe komplikimet që mund të vijnë nga prerjet cezariene.
- Ministria e Shëndetësisë duhet ofruar ARV-në në kohë të duhur. Prandaj, medikamentet e HIV/AIDS-it duhet klasifikuar ndryshe për të tejkaluar procedurat e zgjatura të prokurimit.
- Ministria e Shëndetësisë duhet kompletuar kornizën ligjore dhe rregullatore dhe të amiratojë plane të veprimit për të reaguar ndaj HIV/AIDS-it që mundësojnë qasje efektive dhe të koordinuar në adresimin e çështjeve të drejtave të njeriut të lidhura me HIV/AIDS-in, përfshirë vënien e vëmendjes së veçantë në grupet e rrezikuara siç janë punëtorët e seksit, meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM), adoleshentëve dhe rinjve, përdoruesit e drogave të injektuara (PDI), si dhe për të parandaluar transmetimin nga nëna-tek-fëmija.
- Ministria e Shëndetësisë duhet zgjeruar shërbimet specifike parandaluese, përfshirë qasjen në informata, kondomë, Këshillimin dhe Testimin Vullnetar (KTV), për grupet e rrezikuara siç janë MSM, punëtorët e seksit, PDI, adoleshentëve dhe të rinjve. Këto grupe duhet përfshirë në dizajnin dhe implementimin e këtyre shërbimeve.
- Ministria e Shëndetësisë duhet bërë më shumë në promovimin dhe përdorimin e qendrave të KTV-së.
- Programi i skenringut (depistimit) për kancerin cervical në komunën e Prishtinës duhet mbështetur dhe shpërndarë në të gjithë vendin, së bashku me trajtimin siç kërkohet në linjë me standardet ndërkombëtare. Skenringu për kancerin e gjirit duhet prezantuar po ashtu. Në të dyja rastet kjo do kërkojë fonde, trajnimet dhe zhvillim të institucioneve siç është identifikuar në analizën e fundit të gjendjes së kancerit cervical dhe atij të gjirit në Kosovë.
- Duhet bërë trajnimet e profesionistëve shëndetësor që punojnë në fushën e raportimit të rasteve nën Regjistrin Kombëtar të Kancerit.

Komisionet Parlamentare

- Komisionet parlamentare: Komisioni mbi Shëndetësinë, Punën dhe Mirëqenien Sociale dhe Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sporte, Administrim Publik, Qeverisje Lokale dhe Media duhet mbajtur përgjegjës Ministrinë e Shëndetësisë dhe atë Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për mbarëvajtjen e DSHRS brenda politikave dhe planeve të tyre të veprimit si dhe për zhvillimin dhe implementimin e këtyre politikave dhe strategjive.

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

- Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet siguruar zhvillim dhe implementim të strategjive dhe planeve të veprimit për edukimin seksual të përshtatshëm për moshën, përfshirë shkollat dhe për adoleshentët dhe të rinjtë jashtë shkollave.
- MASHT duhet siguruar se edukimi seksual gjithëpërfshirës i përshtatshëm për moshën ofrohet si lëndë e rregullt për të gjithë fëmijët edhe adoleshentët në shkollat e Kosovës. Ky duhet të jetë një përkushtim eksplisit në kornizat e plan programeve për nivelet e ndryshme të edukimit dhe të reflektohet në planin strategjik të radhës. Në linjë me standardet ndërkombëtare, edukimi seksual gjithëpërfshirës duhet mbuluar temat në vijim: rritja dhe zhvillimi, anatomia dhe fiziologjia seksuale; riprodhimi, kontracepsioni, shtatzënia dhe lindja, HIV/AIDS; IST, jeta familjare dhe marrëdhëniet ndër njerëzore; kultura dhe seksualiteti, rolet e gjinive; sjellja seksuale; diversiteti seksual; dhuna e bazuar në gjini; dhe praktikatat e dëmshme. Duhet zhvilluar materiale mësimore të përshtatshme për moshën e nxënësve mbi edukimin seksual gjithëpërfshirës.

- MASHT duhet siguruar se të gjithë mësuesit të cilët do përfshihen në edukimin gjithëpërfshirës seksual do trajnohen në ofrimin e edukimit të përshtatshëm për moshën, gjithëpërfshirës dhe të bazuar në të drejtat e njeriut. Nëse kërkohet, materialet e trajnimit të bazuara në të drejtat e njeriut duhet zhvilluar.
- Edukimi gjithëpërfshirës seksual për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë jashtë shkollave duhet ndërtuar mbi infrastrukturën ekzistuese, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile që punojnë në atë fushë. Standardet e edukimit përmes të rinjve mbi edukimin gjithëpërfshirës seksual duhet zhvilluar me pjesëmarrjen e të rinjve.
- Adoleshentët dhe të rinjtë duhet marrë pjesë në dizajnin e edukimit gjithëpërfshirës seksual në shkolla dhe jashtë tyre dhe në ofrimin e këtij edukimi përmes iniciativave të edukimit përmes bashkëmoshatarëve.

Ministrisë së Drejtësisë

- Duhet draftuar dhe implementuar një Strategji e re Kombëtare dhe Plan Veprimi kundër Dhunës ndaj Gruas, dhe duhet mbështetur nga një buxhet real dhe i detajuar. Duhet identifikuar qartas institucionet përgjegjëse brenda qeverisë dhe autoriteteve lokale, si dhe një institucion me përgjegjësi për implementim në terren. Duhet krijuar hapësirë për partneritete dhe mbështetje nga akterë jo shtetëror, dhe specifikuar mekanizma bashkëpunimi, por duke mos u dhënë përgjegjësi formale me plan. Qeveria e Kosovës duhet ofruar fonde adekuate për implementimin e planit.
- Ngritja e vetëdijes së mëtejme mbi dhunën në familje dhe ligj kërkohet në disa fronte.

Instituti Gjyqësor i Kosovës

- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet bërë trajnimet për gjykatësit mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ligjeve mbi dhunën në familje.

Agjencisë për Barazi Gjinore

- Agjencia për Barazi Gjinore duhet udhëhequr ngritjen e vetëdijes lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në institucione kyçe.
- Duhet edukuar dhe ngritur vetëdijen mes popullatës mbi dhunën e bazuar në gjini dhe atë në familje me të gjitha format e saj, përfshirë popullatën Rome, Ashkali dhe Egjiptiane.

Rekomandime të përgjithshme

- Implementimi i politikave: Të gjitha autoritetet përgjegjëse në Republikën e Kosovës duhet siguruar implementim të ligjeve dhe politikave në fushën e DSHRS-së.
- Duhet përmirësuar llogaridhënia e të gjitha autoriteteve respektive dhe përgjegjëse publike në nivel qendror dhe lokal, në veçanti, policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve për performancën e tyre në ballafaqimin me rastet e dhunës në familje dhe konformitetit të tyre me standardet ndërkombëtare dhe vendore, dhe me protokollin, përfshirë adresimin e menjëhershëm të rasteve. Duhet implementuar sanksionimet nëse dështon konformiteti me ligjin.
- Autoritetet përgjegjëse duhet mbështetur implementimin e akteve nënligjore duke ofruar fonde dhe infrastrukturë adekuate.
- Mekanizmat për implementimin e moshës së martesës duhet zhvilluar dhe policia dhe prokurorët duhet zbatuar ligjin në rastet kur ato ndodhin.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion

ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje : Z. Habit Hajredini, udhëheqës i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Bashkëngjitur : Raporti: "Të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues në Kosovë: Një realitet përtej ligjit"

II. RAPORTET E BAZUARA NË ANKESA

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr: 322/2015

Samile Pruthi

kundër

Komunës së Gjakovës

Raport me rekomandime lidhur me cenimin e të drejtës për mjedis jetësor

Për: Znj. Mimoza Kusari-Lila,
Kryetare e Komunës së Gjakovës
Rr. "Nëna Terezë", p.n.
50000 Gjakovë

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit Nr.05/L-019, neni 18.1.2

Prishtinë, 4 mars 2015

Qëllimi i raportit

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes komunës së Gjakovës, për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin e të drejtës për ambientin, lidhur me rastin e ankueses në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit është i autorizuar: *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

Përshkrimi i çështjes

Ky raport është bazuar në ankesën e pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), nga znj. Samile Pruthi e cila ankohet se *shtëpia e saj dhe afro pesëmbëdhjetë shtëpi tjera në rrugën “Durgut Vokshi”, në Gjakovë, nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit, prandaj ujërat e zeza dhe ato fekale derdhen mbi tokë, duke ndotur mjedisin, dhe se banorët e kësaj rruge përballen me rrezikun nga shfaqja e sëmundjeve infektive.*

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon IAP, mund të përmbliidhen si në vijim:

1. Avokati i Popullit, në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit, më 23 qershor 2015, ka pranuar ankesën e znj. Samile Pruthi, kundër komunës së Gjakovës, lidhur me moszgjidhjen e problemit të kanalizimit për afro pesëmbëdhjetë familje, në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë.
2. Më 26 qershor 2015, z. Pruthi paraqiti ankesën në IAP se banorët e rrugës “Durgut Vokshi” kanë parashtruar kërkesë drejtuar kryetares së komunës së Gjakovës, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Kryesuesit të Asamblesë Komunale (parashtrësat nr.01-352-419-33, nr.09-352-419-30, nr. 09-352-419-26, të gjitha të datës 25 qershor 2015).
3. Më 1 korrik 2015, përfaqësuesi i IAP-së realizoi vizitë në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë” dhe u takua me disa nga banorët e kësaj lagjeje. Nga vizita në terren u pa qartë se kjo lagje urbane (shumë afër qendrës së qytetit) jeton në kushte të rënda të ambientit jetësor, nën kërcënimin e përhapjes së ndonjë sëmundjeje infektive, pasi si pasojë e mungesës së kanalizimeve, ujërat e zeza dhe ato atmosferike derdhen mbi sipërfaqen e tokës, si dhe e tërë lagjja kundërmon erë fekalesh.
4. Më 2 korrik 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike (DSHP) në Komunën e Gjakovës, me të cilin bisedoi lidhur me çështjen e ankueses. Ai e njoftoi se ka informacione rreth këtij problemi, i cili sipas tij ka mbi tridhjetë vite që nuk po zgjidhet. Ai sqaroi se lidhur me këtë çështje është duke u zhvilluar një procedurë gjyqësore, prandaj, sipas tij, duhet pritur vendimin e gjykatës.
5. Më 3 korrik 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me zyrtarët e Drejtorisë për Mjedis dhe Mbrojtje të Ambientit (DUMM) në komunën e Gjakovës, me të cilët bisedoi lidhur me çështjen e ankueses. Ata e njoftuan se kanë përpiluar një draft projekt me tri propozime për sanimin e këtij problemi, duke theksuar se kanë propozuar zgjidhje të përkohshme derisa të hartohet një plan rregullativ për këtë zonë.

6. Më 10 korrik 2015, IAP u informua se Gjykata Themelore në Gjakovë, në procedurën penale e cila ishte duke u zhvilluar lidhur me derdhjen e ujërave të zeza mbi sipërfaqen e tokës e kishte trajtuar këtë rast si vepër penale (*ndotje e ambientit dhe dëmtim prone*). Gjykata kishte marrë vendim dënues për disa nga kryefamiljarët e kësaj lagje, të cilët i kishte dënuar me dënim me kusht për dy vite, në zëvendësim me gjashtë muaj burgim.
7. Më 22 korrik 2015, IAP u informua se lidhur me petitionin është dhënë përgjigje vetëm nga DSHP, e cila i ka informuar banorët që: *“Për kanalizimin fekal që kërkoni zgjidhje DSHP nuk ka kompetencë për zgjidhjen e problemit pronësor. Kjo kompetencë i takon Gjykatës Civile. Në momentin kur gjykata në fjalë përfundon me zgjidhjen (pozitive), atëherë mund të na drejtoheni neve si drejtori me kërkesë për ekzekutimin e kanalit”*.
8. Më 7 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me drejtorin e DSHP, lidhur me rrjedhat e rastit të ankueses. Ai e informoi se gjatë muajit gusht 2015, ishte në vendngjarje së bashku me inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MPMH) dhe me disa ekspertë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë (Departamenti i Epidemiologjisë) dhe se atje gjendja është shqetësuese, prandaj duhet të ndërmerren masa urgjente për sanimin e saj.
9. Më 8 tetor 2015, Avokati i Popullit i dërgoi letër kryetares së komunës së Gjakovës, lidhur me çështjen, nga e cila kërkoi informacione lidhur me rrjedhat e këtij rasti në procedurën para organeve komunale, si dhe kërkoi të informohet me planet e komunës për zgjidhjen e kësaj çështje, por nuk ka marrë përgjigje deri në afatin e caktuar, më 28.10.2015.

Baza ligjore

10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 52, paragrafi 1, përcakton: *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin”*, kurse paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton”*.
11. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), në nenin 8, paragrafin 1 përcakton: *“Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare,baneses [...]”*
12. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 17, përcakton: *“Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar: [...] e) mbrojtjen e mjedisit lokal, f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale, i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut [...]”*.
13. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr.03/L-230, neni 1, paragrafi 1 përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut”* kurse paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Ky ligj përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, (në tekstin e mëtutjeshëm VSM) përmes integritimit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm”*.

14. Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit Nr. 04/L-175, në nenin 10, paragrafi 1 përcakton: *“Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit ushtron mbikëqyrjen inspektive dhe kontroll përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së mjedisit”, kurse neni 34 përcakton: “Inspektori mundet të kërkojë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante, nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike”.*
15. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025, neni 1, paragrafi 2 përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian”* kurse neni 2 paragrafi 2 përcakton: *“Ky ligj synon [...] përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut [...] bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit [...]”.*
16. Po ashtu, ky ligj në nenin 34, paragrafi 1 përcakton: *“Kur konstatohet ose vërtetohet se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik ka shkaktuar dëm mjedisor me qëllim ose nga pakujdesia, e cila rezulton me çrregullime mjedisore, është i detyruar ta kthejë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut apo kapacitetit të përgjithshëm rehabilitues të pjesës së dëmtuar”* kurse neni 50, paragrafi 3 përcakton: *“Komunat, në kuadër të përgjegjësisë të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit [...]”.*
17. Ligji për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse Nr.02/L-109, parasheh ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, përmes nenit 8, paragrafi 8.2 i cili përcakton: *“Masat e përgjithshme për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse janë [...] Mënjanimi i ujërave të ndotura dhe hedhurinave sipas mënyrës dhe nën kushtet në të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i insekteve dhe i brejtësve [...]”.*
18. Ligji për Shëndetësinë Publike Nr.02/L-78, neni 6, paragrafi 6.1 përcakton: *“Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet”* kurse paragrafi 6.2 përcakton: *“IKSHPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet”.*
19. Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, neni 1, paragrafi 1 përcakton: *“Rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria ose një Komunë mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi”*

Analiza ligjore

20. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 52, paragrafi 1, shprehimisht përcakton përgjegjësinë e të gjithëve për mjedisin jetësor duke theksuar se: *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin”*, kurse paragrafi 2 i këtij neni përcakton detyrimet organeve për të respektuar liritë dhe të drejtat e të tjerëve, duke kërkuar që *“Institucionet e pushtetit publik të angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton”*, prandaj këto dispozita kushtetuese

janë parime imperative dhe duhet të respektohen nga të gjitha autoritetet përfshirë këtu edhe komunën e Gjakovës.

21. KEDNJ, në nenin 8, paragrafin 1 përcakton: “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës, [...]”. Për qëllimet e Nenit 8, është roli i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për të dhënë vlerësimin, mbi faktin nëse një ndërhyrje në një të drejtë të Konventës është e justifikueshme në bazat e interesit të publikut apo kur vlerësohet nëse një shtet nuk ka bërë mjaftueshëm për të qenë në pajtim me ndonjë detyrim pozitiv që përmban kjo dispozitë. Në përgjithësi, vendbanimi, brenda kuptimit të nenit 8, është vendi ku një person banon, ose ku ky person vendos bazat e veta, e në këtë kuadër, të gjitha vendet e banimit përbëjnë vendbanimin. Megjithatë, në disa rrethana Konventa i kërkon shtetit që të ndërmarrë hapa për t’i siguruar individëve të drejtat e tyre sipas nenit 8, dhe mund të kërkojë që të mbrojë personat nga aktivitetet e individëve të tjerë privatë që i pengojnë ata të gëzojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre. Sipas Gjykatës, shteti, me qëllim që të përcaktojë nëse ekziston një detyrim pozitiv apo jo, duhet të marrë në konsideratë faktin nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe interesave të individit.
22. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në gjykimin e datës 23 nëntor 1994 në rastin *Lopez Ostra kundër Spanjës*⁴⁶ konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës duke konstatuar se ndotja ambientit mund të afektojë mirëqenien e individit dhe t’i parandalojë atij nga gëzimi i shtëpisë së tij në mënyrë të tillë që të ndikojë negativisht jetën private dhe familjare. Në analogji me këtë rast mund të cilësohet e tërë lagjja përreth shtëpive të ankueses, të cilët iu ekspozohen rreziqeve mjedisore nga kundërmimi i ujërave të zeza të cilat derdhen mbi sipërfaqe të tokës. Po ashtu, banorët janë rrezikuar nga pickimi i insekteve të cilat janë në kontakt me ujëra të zeza dhe mund të jenë burim i infeksioneve, krejt kjo si rrjedhojë e dështimit të organeve kompetente të komunës së Gjakovës, të cilat deri më tash nuk kanë arritur t’i përmbushin detyrimet pozitive ndaj qytetarëve të kësaj lagje.
23. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 17, përcakton se Komunitatet kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislativën e zbatueshme, në fushat e zhvillimit lokal ekonomik, planifikimit urban dhe rural, shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit, zbatimit të rregullores së ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave dhe shumë kompetenca të tjera. Nga sa u tha më sipër komuna është kompetente për zgjidhjen e kësaj çështjeje, por deri më tash ajo nuk ka ndërmarrë veprime në drejtim të zgjidhjes së çështjes së ankueses duke u thirrur në inkompetencë (shih pikën 7).
24. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr.03/L-230, në nenin 1, paragrafi 1 përcakton se me hartimin e këtij ligji ligjvënësi kishte për qëllim që me Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, kurse në paragrafin 2, të këtij neni sqaron se përmes këtij ligji përcaktohen kushtet, mënyrat dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, përmes integritetit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të

⁴⁶

CASE OF LÓPEZ OSTRÁ v. SPAIN (Application No. 16798/90) paragrafi 51

konsiderueshme në mjedis dhe realisht në rastin konkret dëmet mjedisore kanë ndodhur pikërisht për arsye se një vlerësim i tillë ka munguar në të kaluarën dhe banorët janë pajisur me leje ndërtimore pa ju siguruar infrastruktura e nevojshme (qasja në rrjetin e kanalizimeve për ujërat e zeza dhe atmosferike) dhe fatkeqësisht akoma mungon një VSM me një plan rregullator urban, i cili do të siguronte dalje prej kësaj situatë.

25. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025, ka për qëllim të krijimit të standardeve mjedisore në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian, prandaj neni 1, paragrafi 2, përcakton se ligji është që të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me tendencë graduale të përafrimit me standarde për mjedis të Bashkimit Evropian, neni 34, paragrafi 1 i këtij ligji përcakton situatat kur konstatohet ose vërtetohet se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik ka shkaktuar dëm mjedisor me qëllim ose nga pakujdesia, e cila rezulton me çrregullime mjedisore, është i detyruar ta kthejë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut apo kapacitetit të përgjithshëm rehabilitues të pjesës së dëmtuar, kurse neni 50, paragrafi 3, i obligon komunat, që në kuadër të përgjegjësive të veta të përcaktuara me ligj të sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe të bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit. Ligji përcakton se në rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, komunat dhe Qeveria duhet të nxjerrin plane të intervenimit. Në situatën e krijuar te rasti i ankueses lirisht mund të konkludohet se kemi dëm mjedisor dhe çrregullime mjedisore, përkundër faktit se komuna ka qenë e informuar me gjendjen e krijuar, por deri më tash nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi.
26. Ligji për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse Nr.02/L-109, parasheh ndërmarrjen e një varg masash për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, kurse neni 8, paragrafi 8.2, përcakton detyrimet e përgjithshme për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse, duke kërkuar që ujërat e ndotura dhe mbeturinat të trajtohen sipas mënyrës në të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i insekteve dhe i brejtësve. Ky ligj e përcakton se *Vatër infeksioni* është territori që karakterizohet me praninë e burimit të infeksionit (njeriun apo kafshën) dhe faktorët favorizues të mjedisit jetësor për përhapjen e infeksionit. Prandaj, nisur nga gjendja e krijuar në terren si pasojë e derdhjes së ujërave të ndotura mbi sipërfaqen e tokës, mund të vijmë në përfundim se nuk janë siguruar masat mbrojtëse nga autoritetet përgjegjëse dhe këtu kemi të bëjmë me vatër të mundshme infeksioni.
27. Ligji për Shëndetësinë Publike Nr.02/L-78, neni 6, paragrafi 6.1 e përcakton si autoritet përgjegjës Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) që të bëj hulumtimin e ndikimit të faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe t'i propozoj masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet, kurse paragrafi 6.2 përcakton kompetencën që kur haset nevoja IKSHPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet. Banorët e kësaj lagje tregojnë se ky lokalitet është vizituar disa herë nga autoritetet shëndetësore por rekomandimet lidhur me ndërmarrjen e masave për sanimin e kësaj gjendje kanë munguar deri më tash.
28. Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit Nr. 04/L-175, në nenin 10, paragrafi 1 përcakton që Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit ushtron mbikëqyrjen inspektuese dhe kontrollë përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së mjedisit, kurse neni 34 përcakton që inspektori mundet të kërkojë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante,

nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike. Pavarësisht kompetencës së inspektorëve se mund të kërkojnë mendim dhe bashkëpunim profesional me autoritetet tjera, nga hetimi i këtij rasti shihet se ata asnjëherë nuk e kanë adresuar çështjen tek organet tjera sidomos nga ato shëndetësore, dhe nuk kanë kërkuar që të alarmohet kjo gjendje, në mënyrë që të mbrohet popullata nga kjo ndotje e ambientit me rrezik për paraqitjen e sëmundjeve infektive dhe nuk kanë kërkuar që ky problem të sanohet.

29. Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, neni 1, paragrafi 1 përcakton rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria ose një komunë mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi. Sipas këtij ligji termi *shpronësim* nënkupton çdo vepër të një Organi Shpronësues që përfshin marrjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është në zotërim ose pronësi të një personi në një pronë të paluajtshme, *krijimin e detyrueshëm të një servituti* ose një të drejte tjetër të shfrytëzimit në pronën e paluajtshme. Organi shpronësues sipas këtij ligji është i autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve që shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij të përcaktuara në ligj dhe tek rastet kur qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit. Tek këto raste përfitimi publik nga shpronësimi duhet të jetë më i madh se sa interesat nga të cilat do të ndikohen negativisht nga shpronësimi dhe prona e paluajtshme, e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues. Pavarësisht rregullativës ligjore dhe mundësive ligjore që çështja e ankueses dhe banorëve tjerë të kësaj lagje të zgjidhet sipas këtij ligji, komuna ka dështuar në zbatimin e detyrimeve dhe në zbatimin e ligjit në raport me interesin publik duke u thirrur në mungesë të kompetencës (shih paragrafi 7).
30. Bazuar në atë që u tha më sipër Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”. Në kuptim të nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)*”.

Andaj, Avokati i Popullit

REKOMANDON

1. *Komuna e Gjakovës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me të gjitha autoritetet tjera përgjegjëse, të ndërmarrë masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të kanalizimit për banorët e rrugës “Durgut Vokshi” në Gjakovë.*
2. *Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e komunës së Gjakovës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të hulumtuar gjendjen epidemiologjike dhe shëndetësore të banorëve, si dhe shkallën e ndotjes së ambientit. Varësisht nga të gjeturat në terren, të përpiloj raport me shkrim dhe t’i njoftoi banorët dhe institucionet për gjendjen dhe rreziqet eventuale, si dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të banorëve.*
3. *Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet e veta ligjore, të fillojë procedurat për hartimin e një plani rregullativ urban për pjesën e rrugës “Durgut Vokshi” në Gjakovë, me të cilin do të përcaktonte infrastrukturën e nevojshme mjedisore për banorët e kësaj pjese, në pajtim me standardet përkatëse*

si zgjidhje përfundimtare të këtij problemi.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren Komuna e Gjakovës, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 4 prill 2016.

Me nderime

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 348/2015

Raport lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike nga Komuna e Fushë Kosovës

drejtuar

Z. Burim Berisha, kryetar i komunës së Fushë Kosovës

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16, paragrafi 8 dhe nenit 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, më 14 mars 2016 publikon raportin në vijim:

Prishtinë, më 14 mars 2016

Qëllimi i raportit

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Komunës së Fushë Kosovës lidhur me ankesën e znj. Albana Gashi, e parashtuar në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, bazuar në faktet dhe provat, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, si dhe obligimin kushtetues për bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Neni 135, par. 3 të Kushtetutës e jep kompetencë Avokati të Popullit që të bëjë rekomandime *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Po ashtu sipas, nenit 18.1.2 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi që: *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”.*

Përshkrimi i çështjes

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit të ofruara nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. *Më 14 maj 2015, Lëvizja Vetëvendosje, i është drejtuar Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, në Komunën e Fushë Kosovës, me kërkesë (nr.312), për qasje në “Listën e të gjitha bizneseve të regjistruara në Komunën e Fushë Kosovës”.*
2. *Më 9 qershor 2015, znj. Albana Gashi, i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në Komunën Fushë Kosovës, me kërkesë (nr. 582) për qasje në “Listën e pronave në shfrytëzim dhe pronësi të komunës së Fushë Kosovës”.*
3. *Më 9 qershor 2015, e njëjta i është drejtuar Drejtorisë për Shërbime Publike, në Komunën e Fushë Kosovës, me kërkesë (nr. 383) për qasje në “Kopjen e dokumentacionit për dhënien e tenderit, kompanisë së caktuar mbi vendosjen dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik solar në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2012, 2013 dhe 2014”.*
4. *Më 9 qershor 2015, znj. Gashi i është drejtuar Drejtorisë për Shërbime Publike, në Komunën Fushë Kosovë, me kërkesë (nr. 384), për qasje në “Kopjen e dokumentacionit për dhënien e tenderit, kompanisë së caktuar për hapjen e puseve për ujë të pijshëm në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2015”.*
5. *Më 11 qershor 2015, znj. Albana Gashi, pranoi përgjigje nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në komunën Fushë Kosovës, nga e cila kuptohet që “Numri i Bizneseve aktive në komunën Fushë Kosovë, është 854, me gjithsejtë 1825 punëtorë, sipas pronësisë dominojnë bizneset individuale”.*

Veprimet në Institucionin e Avokatit të Popullit

6. *Më 6 korrik 2015, Avokati i Popullit, nëpërmjet postës elektronike, ka pranuar ankesën e znj. Albana Gashi, në emër të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, lidhur me mospërgjigjen e Komunës së Fushë Kosovës, në kërkesat e saj nr. 582, 383, 384, për qasje në dokumente publike, si dhe përgjigjen e pjesshme dhe të paarsyetuar të komunës, përkitazi me kërkesën të evidentuar me nr. 312.*

7. Më 16 shtator 2015, Avokati i Popullit, i dërgoi letër z. Burim Berisha, kryetar i Komunës Fushë Kosovë, përmes së cilës kërkoi të informohet për arsyen e kufizimit të plotë të qasjes sipas kërkesave nr. 582, 383, 384, si dhe kufizimin e pjesshëm në kërkesën nr. 312, për qasjes në dokumente publike. Avokati i Popullit nuk pranoi asnjë përgjigje nga komuna e Fushës Kosovës.
8. Më 23 tetor 2015, Avokati i Popullit nëpërmjet letrës së dytë e ka përsëritur kërkesën për t'u informuar lidhur me arsyen e kufizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike.
9. Më 2 nëntor 2015, Avokati i Popullit, pranoi përgjigje nga z. Burim Berisha, kryetar i komunës së Fushë Kosovës, nëpërmjet së cilës theksoi se: *“Ne jemi të hapur për të gjithë, por nuk i vlerësojmë ata që e keqpërdorin dokumentacionin zyrtar, dhe e tillë është Lëvizja Vetëvendosje, në komunën e Fushë Kosovës.*

Ne nuk jemi servis i askujt dhe punojmë për teket e askujt. Paraardhësi i zonjës Albana Gashi i ka marrë po të njëjtat dokumente në tërësi dhe nuk i përsërisim më, sa herë ata të ndërrohen në postet e tyre udhëheqëse.

Komuna jonë ka web faqen ku mund të merren shumë informacione.

Zonja Albana, dhe përfaqësuesit tuaj zotëri Avokat i Popullit, sa herë të dëshirojnë mund të vijn dhe të kenë qasje në dokumente zyrtare”.

Instrumentet Relevante

10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Kushtetuta e Kosovës), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të Drejtën për Qasje në Dokumente Publike, sipas së cilës definohet që: *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”.*
11. Paragrafi 2, i po të njëjtit nen të Kushtetutës së Kosovës, përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet, janë të arritshme për të gjithë, në përjashtim të atyre dokumenteve qasja e të cilave është e kufizuar me ligj: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”.*
12. E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale Për të Drejtat e Njeriut, e cila secilit i garanton *“Lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”.*
13. Lirinë për të marrë dhe dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane “Liria e Shprehjes”: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”.*
14. Sikurse Kushtetuta e Kosovës, po ashtu edhe Konventa Evropiane, e parashohin si një të drejtë e cila nuk është absolute dhe kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet për arsye të caktuara: *“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.*
15. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës së Kosovës, është përcjellë edhe në nenin 1, të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215 (në tekstin e mëtejshëm LQDP), sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike”.*

16. Neni 4, paragrafi 1, të LQDP, specifikon që: *”Çdo kërkues i dokumentit, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj”*, ndërsa paragrafi 4 saktëson se *“Dokumentet publike të pranuar nga kërkuesi nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale”*.
17. Neni 7, paragrafi 8, i LQDP thekson se : *“Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj”*.
18. Neni 12, paragrafi 1, i LQDP, parasheh arsyet e përjashtimit të së drejtës për qasje në dokumente publike:
- Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:*
- 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;*
 - 1.2. sigurisë publike;*
 - 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;*
 - 1.4. hulumtimeve disiplinore;*
 - 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;*
 - 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;*
 - 1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;*
 - 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;*
 - 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;*
 - 1.10. mjedisit, apo,*
 - 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.*
19. Neni 12, paragrafi 2, i LQDP, thotë se: *“Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin”*.
20. Neni 17, paragrafi 1, i LQDP, *“Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar”*.
21. Neni 9.1, i Ligjit Nr. 02/L-28 Për Procedurën Administrative (në tekstin e mëtutjeshëm LPA), parasheh që:
- “Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”, dhe 9.2. “Çdo person fizik dhe juridik, pa qenë e nevojshme të tregojë interes specifik, në raportet me organet e administratës publike, ka të drejtat procedurale që vijojnë:*
- a) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike,*
 - b) brenda një kohe të arsyeshme,*
 - c) në të njëjtën mënyrë si për çdo person tjetër,*
 - d) me mjete të përshtatshme dhe efektive”*.
22. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013, për Transparencë në Komuna, i cili ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve të komunës përmes së rregullave që mundësojnë ushtrimin dhe zhvillimin e praktikave më të mira administrative për qasje në dokumente publike, parasheh procedurat për qasje të publikut në dokumente publike.

Analiza e rastit

Lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente publike

23. Avokati i Popullit, bazuar në analizën legjislacionit dhe fakteve të paraqitura me lart, lidhur me ankesën e znj. Gashi, për qasje në dokumente publike në Komunën e Fushë Kosovës, vëren se kjo e drejtë është e garantuar me instrumentet ndërkombëtare, Kushtetutë, dhe aktet tjera ligjore të lartpërmendura.
24. Ankuesja më 9 qershor 2015, i është drejtuar Drejtorive përkatëse të Komunës së Fushë Kosovës, tri kërkesa: nr. 582, 383 dhe 384 për qasje në dokumente të ndryshme publike të komunës (shih pikat 2,3 dhe 4 të raportit). Por nuk ka marr asnjë përgjigje nga komuna e Fushë Kosovës, përkundër të drejtës dhe detyrimit ligjor të Komunës sipas nenit 7, paragrafi 8 të LQDP, për dhënien e përgjigjes në afat ligjor prej 7 ditëve, nga dita e parashtrimit të kërkesës *”Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes së plot, apo të pjesërishme”*.
25. Avokati i Popullit, po ashtu vëren që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, e komunës në fjalë, përkitazi me kërkesën me nr. 312, datë 14 maj 2015, të përfaqësueses së “Lëvizjes Vetëvendosje” për qasje në *”Listën e të gjitha bizneseve të regjistruara në Komunën e Fushë Kosovës”*, i është përgjigjur vetëm më 11 qershor 2015, 21 ditë me vonesë.
26. Përkundër kërkesës për qasje në *”Listën e të gjitha bizneseve të regjistruara në Komunën e Fushë Kosovës”*, përgjigja me nr. 399 e datës 11 qershor 2015, e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik është e pjesshme: *“Numri i Bizneseve aktive në komunën Fushë Kosovë, është 854, me gjithsejtë 1825 punëtorë, sipas pronësisë dominojnë bizneset individuale”*.
27. Po ashtu, përgjigjja në fjalë nuk e përmban edhe këshillën për shfrytëzimin e mjeteve juridike ashtu sikurse parashihet në nenin 7, paragrafi 8, i LQDP: *“Institucioni publik obligohet që [...] të informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim.*
28. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, thekson se vonesat në dhënien e informatës mund t’i heqin në mënyrë të vazhdueshme, apo të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të, sepse një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t’i mohojë këtij lajmi tërë vlerën dhe interesin (shih rasti *The SundayTimes V. The United Kingdom*)⁴⁷.

Lidhur me përgjigjen e Kryetarit të Komunës, për Avokatin e Popullit

29. Kryetari i komunës së Fushë Kosovës, në përgjigjen e datës, 2 nëntor 2015, në kërkesën e Avokatit të Popullit, lidhur me rastin e ankueses znj. Gashi, thekson se *“... Ne jemi të hapur për të gjithë, por nuk i vlerësojmë ata që e keqpërdorin dokumentacionin zyrtar, dhe e till është Lëvizja Vetëvendosje, në komunën e Fushë Kosovës”*. Por theksimet për keqpërdorim të dokumenteve nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje, mbeten të padëshmuara për Avokatin e Popullit, pasi nuk kemi marrë asnjë dokument zyrtar të komunës, për vlerësimin e keqpërdorimit të dokumenteve nga pala, apo të ndonjë mase administrative ndëshkuese.
30. Po ashtu, Avokati i Popullit, lidhur me pjesën e përgjigjes se: *“Nuk jemi servis i askujt dhe punojmë për teket e askujt”*, thekson se ofrimi i qasjes në dokumente dhe pajisja me informata nuk është shërbim, por është e drejtë, e garantuar me instrumente ndërkombëtare, kushtetutë dhe aktet tjera ligjore të përmendura më lart. GJEDNJ në rastin *Autronic Ag V. Switzerland*, thekson se *“Liria për të*

⁴⁷ *Case Of The Sunday Times V. The United Kingdom, (Application no. 6538/74), 26 april 1979*

*marrë informacion, përfshin të drejtën për të mbledhur dhe kërkuar informacione, nëpërmjet të gjitha burimeve të mundshme ligjor*⁴⁸

31. Në anën tjetër, Avokati i Popullit e mirëpret gatishmërinë për bashkëpunim, dhe vlerëson se detyra e kryetarit të komunës është kyçe në forcimin e transparencës dhe demokracisë dhe urë lidhëse në mes komunës dhe qytetarit, andaj ka dhe përgjegjësi ligjore, të përgjigjes në parashtresat e ndryshme të qytetarëve, duke përfshirë edhe ato të qasjes në informata. Siç theksohet në aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Observer And Guardian V. The United Kingdom*⁴⁹ “T’i mohosh publikut informacione mbi funksiononim e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë”

Konkludim

32. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se “*Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik*”, si dhe duke u bazuar në faktet e ofruara si më lart, konstaton se mos përgjigja e Komunës së Fushë Kosovës, përkitazi me kërkesën e znj. Albana Gashi, dhe përgjigja jo e plotë në kërkesë, janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.
33. Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike si e drejtë kushtetues dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët të shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënien, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 27, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit:

Rekomandon

- *Komunën e Fushë Kosovës, që znj. Gashi t’i mundësojë qasje në dokumentet e kërkuara në përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*
- *Që Komuna, të ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë, lidhur me zbatimin Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, si dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë komuna e Fushë Kosovës, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartcekura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor, më së largu brenda tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të këtij raporti.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

⁴⁸ *Case Of Autronic Ag V. Switzerland, (Application no. 12726/87), 22 May 1990*

⁴⁹ *Case Of Observer And Guardian V. The United Kingdom, (Application no.13585/88), 26 November 1991*

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr: 223/2015; 229/2015; 65/2016

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Raport lidhur me lirimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore të shitura nga Agjencia Kosovare e Privatizimit nga shfrytëzuesit e paligjshëm

Për: Z. Avni Jashari,
U.D. Zëvendës Drejtor Menaxhues – likuidim
Z. Shpend Maxhuni,
Drejtor i Policisë së Kosovës
Z. Aleksandër Lumezi,
Kryeprokuror i Shtetit

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1.2

Prishtinë, më 19 prill 2016

Qëllimi i raportit

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Shtetërore lidhur me uzurpimin e pronave të privatizuara nga shfrytëzuesit e paligjshëm.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

2. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit ka përgjegjësi *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*
3. Po ashtu sipas nenit 18, paragrafi 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit është i autorizuar *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”*

Heqja dorë nga përgjegjësia

4. Asgjë nga përmbajtja e këtij raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Avokatit të Popullit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e pushtetit rreth çështjeve lidhur me ligjin dhe praktikën e lartpërmendur ose të shqyrtojë dekretet e ngjashme ligjore për pajtueshmërinë e tyre me standardet e njohura ndërkombëtare. Avokati i Popullit i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar jurisdikcionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme.

Përshkrimi i rastit

5. Ky raport është bazuar në ankesa të ndara të parashtruara nga z. Lavdim Mehmeti z. Xhevat Sadrijaj, dhe z. Nexhat Kastrati kundër AKP-së lidhur me uzurpimin e pronave të cilat ata i kanë blerë nga AKP-ja nëpërmjet procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Rasti i z. Lavdim Mehmeti

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, më 30 prill 2015, ka pranuar ankesë nga z. Lavdim Mehmeti kundër AKP-së, në lidhje me lirimimin e objektit N.SH. “Gërmia”, Shitorja Nr.1, Lakrishte, Prishtinë, të cilin ankuesi e ka blerë nga AKP-ja sipas *Marrëveshjes për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës*, Nr.289/2011, të datës 11 tetor 2011.
7. Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve të cilat ai i ka paraqitur te Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), ai edhe pse e ka kryer bartjen e pronës në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri, asnjëherë nuk ka mundur ta marrë pronën nën posedim faktik për shkak se prona si gjatë kohës së shitjes ashtu dhe deri më tani ka mbetur e uzurpuar nga shfrytëzuesit e paligjshëm. Fakti se prona ishte e uzurpuar në kohën e shitjes vërtetohet me Shtojcën 2 të *Marrëveshjes për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës* e cila në mënyrë eksplicite thekson se *“...kjo pronë është e uzurpuar dhe është përgjegjësi e blerësit të merret me të gjitha shpenzimet dhe rreziqet në lidhje me uzurpimet e objektit dhe t’i liroj ato.”* Rrjedhimisht, më 8 dhjetor 2011, z. Mehmeti kishte paraqitur padi për lirimimin e pronës në Gjykatën Themelore të Prishtinës (GJTHP), mirëpo ajo ende nuk ka vendosur lidhur me padinë.

Rasti i z. Xhevat Sadrijaj

8. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, më 30 prill 2015, ka pranuar ankesë nga z. Xhevat Sadrijaj kundër AKP-së, në lidhje me lirimimin e objektit N.SH. “Rilindja”, Shitorja Nr.3, Prishtinë.
9. Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve të cilat ai i ka paraqitur në IAP, ankuesi është bërë pronar i pronës më 1 shkurt 2012. Deri në shitjen e pronës AKP-ja si administratore e pronës së ndërmarrjeve shoqërore e kishte lëshuar pronën me qira dhe me rastin e shitjes së saj e kishte

njoftuar qiramarrësin për pronarin e ri. Z. Sadrijaj pohon se qiramarrësi ka refuzuar të lirojë pronën ose të vazhdojë kontratën e qiramarrjes me atë si pronar të ri. Z. Sadrijaj për më shumë pohon se AKP-ja nuk ka marrë përgjegjësi për lirimin e pronës prandaj ai më 13 mars 2013 ka paraqitur padi për lirimin e paluajtshmërisë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës (GJTHP) por ajo nuk ka vendosur ende lidhur me padinë.

Rasti i z. Nexhat Kastrati

10. Sipas pohimeve të ankuesit ai më 13 gusht 2012 ka nënshkruar Marrëveshjen mbi Shitjen e Aksioneve të ndërmarrjes shoqërore “Trepça” objekti biznesor Restorant “Ylli” në Mitrovicë, me Drejtorin Menaxhues të AKP-së. Në kohën e shitjes së pronës, prona i ishte lëshuar me qira nga AKP-ja shfrytëzuesit aktual të pronës, i cili ka refuzuar ta lirojë pronën me pretekst se ai ka një kontratë për qiranë me AKP-në dhe se ka bërë investime në atë pronë. Sipas marrëveshjes AKP-ja nuk merr përgjegjësi për barrën që mund të ekzistojë mbi pronën dhe se është përgjegjësi e blerësit të merret me të gjitha shpenzimet dhe rreziqet në lidhje me uzurpimet e objektit dhe t’i liroj ato. Z. Kastrati ka paraqitur padi për lirimin e pronës së uzurpuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë (GJTHM), për të cilën kishte vendosur gjyqtarja e EULEX-it. GJTHM ka aprovuar kërkesëpadinë e z. Kastrati mirëpo pala tjetër në procedurë, ka paraqitur ankesë dhe lënda që nga fundi i vitit 2013 ndodhet në Gjykatën e Apelit.
11. Z. Kastrati ka paraqitur ankesë në IAP në fazën përfundimtare të hetimeve lidhur me rastet e z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj. Mirëpo, specifikat e ankesës së z. Kastrati janë të ngjashme me ato të ankesës së z. Sadrijaj, prandaj Avokati i Popullit e ka përfshirë rastin e Z. Kastrati në këtë raport.

Hezitimi i gjykatave për të vendosur lidhur me paditë civile për lirimin e pronave të uzurpuara

12. Avokati i Popullit vëren se nga Gjykata Themelore në Prishtinë ka hezitim për zgjidhjen e rasteve të z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj. Ndërsa, në rastin e z. Kastrati hezitimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë ishte evident pasi që për rastin në shkallën e parë ka vendosur gjyqtarja e EULEX-it. Sipas Aktgjykimit të GJTHM C.nr.221/2012 i datës 12 dhjetor 2013, vihet në pah se Këshilli Gjyqësor i Kosovës kishte zhvilluar procedurë disiplinore kundër gjyqtarit vendor për shkak të vonesave procedurale, pa fajin e paditësit, z. Kastrati.
13. Sidoqoftë, Avokati i Popullit vë në pah se uzurpimi i paligjshëm i pronës është vepër penale e sanksionuar me nenin 332 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr.04/082, dhe në rastet konkrete Policia e Kosovës dhe prokuroritë përkatëse do të duhej të ndërmerrnin hapa konkret para se rastet të procedoheshin në procedurë civile.⁵⁰

Bashkëpunimi i AKP-së me Avokatin e Popullit

14. AP fillimisht kishte zhvilluar një takim me zyrtarët e AKP-së për të marrë informata lidhur me rastet. Gjatë takimit, AP ishte vënë në dijeni se AKP-ja më 21 nëntor 2014 kishte nxjerrë një vendim me numër reference 270/2014, sipas të cilit të gjitha asetet e ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë në juridiksion të AKP-së do të lirohen nga posedimet e paligjshme dhe se lidhur me këtë më 10 dhjetor 2014 ka nxjerrë një *Udhëzues për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit (Shfrytëzuesit e Paligjshëm)* i cili ka për qëllim krijimin e praktikave uniforme për Zyrat Rajonale të AKP-së me zbatimin e një procedure unike për lirimin e asteve të uzurpuara në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe njësitë organizative të AKP-së.
15. Avokati i Popullit më 4 nëntor 2015 i është drejtuar AKP-së, me dy letra të ndara lidhur me ankesat e z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj, me ç ‘rast ka kërkuar qartësim të juridiksionit të AKP-së për lirimin e pronave të uzurpuara dhe ka kërkuar informata lidhur me mundësinë e përfshirjes së pronave të blera nga z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj në procesin e lirimit të asteve të uzurpuara.

⁵⁰ Shih nenin 14 të Ligji nr. 03/1-006 për Procedurën kontestimore: “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”

16. Më 19 nëntor 2015, AKP-ja i është përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe ka njoftuar se shitjet e pronave kanë qenë të mbështetura me dokumentacion relevant përmes të cilit AKP-ja në atë kohë i ka bërë publikisht të njohura dhe se të dhënat për lokalet e sipërpërmendura, duke theksuar shprehimisht se në kohën e shitjes lokalet ishin të uzurpuara, se AKP-ja nuk mban përgjegjësi për lirimimin e objekteve dhe nuk do të mbahet përgjegjëse për çfarëdo detyrimi që mund të rrjedh në të ardhmen dhe se kjo është përfshirë edhe në kontratën e nënshkruar me vullnet të lirë nga palët. Sidoqoftë, AKP-ja në përgjigjet e saj ka cekur se mbetet e përkushtuar që kërkesat e z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj, do t'i paraqiten pa vonesë Bordit të Drejtorëve të AKP-së, pas funksionalizimit të tij⁵¹, për udhëzim veprimi në këto raste, për shkak se vendimi i 21 nëntorit 2015 për lirimimin e aseteve nga uzurpimi dhe posedimet e paligjshme nuk ka veprim retroaktiv.

Analiza Ligjore

17. Avokati i Popullit vëren se kontratat e shitblerjes kanë hyrë në fuqi më 11 tetor 2011 (Lavdim Mehmeti me AKP-në), më 1 shkurt 2012 (Xhevat Sadrijaj me AKP-në) dhe më 13 gusht 2012 (Nexhat Kastrati me AKP-në), gjatë kohës kur në fuqi ishte Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës nr.45/81, 29/86 dhe 28/88). Edhe pse Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr.04/L-077 Për Marrëdhëniet Detyrimeve, i cili ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2012, në rastet konkrete do të zbatohet ligji i mëparshëm për shkak se marrëdhënia e detyrimeve ka lindur në kohën kur ligji i mëparshëm ishte në fuqi.
18. Avokati i Popullit është në dijeni se Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit është një ligj specifik dhe se në situata të caktuara i përjashton dispozitat e disa ligjeve të tjera, por ky ligj nuk përmban dispozita që përjashtojnë ligjin për marrëdhëniet detyrimore. Kjo për shkak se edhe vetë *Marrëveshja për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës* në nenin 7.8 të saj përcakton se kjo marrëveshje do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje me ligjin në fuqi. Pastaj fakti se palët janë udhëzuar t'i drejtohen gjykatës së rregullt kompetente dhe jo Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme vërteton se për marrëveshjet në fjalë zbatohet *Ligji për marrëdhëniet detyrimore*.
19. Kontratat në mes të AKP-së dhe ankuesve janë kontrata të dyanshme detyruese ku secili kontraktues mban përgjegjësitë për të metat materiale dhe juridike të përmbushje të kontratës. Neni 121, paragrafi 2 i Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës nr.45/81, 29/86 dhe 28/88) përcakton se: *“Kontraktuesi përgjigjet edhe për të metat juridike të përmbushjes dhe ka për detyrë ta mbrojë palën tjetër nga të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë me të cilat e drejta e saj do të përjashtohet ose kufizohet.”*
20. Përgjegjësia për të metat juridike të sendit (eviksioni) ekziston në rastet e shqetësimit të blerësit nga persona të tretë, për shkak të pretendimit të tyre se kanë të drejtën e pronësisë mbi sendin ose sendi është i ngarkuar me ndonjë të drejtë, siç është, p.sh., e drejta e servitudës, e pengut, e hipotekës apo ndonjë ngarkesë tjetër, e cila ka ekzistuar para se blerësi ta blinte atë send. Kërkesat e personave të tretë më së shpeshti shfaqen me marrjen e posedimit të sendit.⁵² Që të ekzistojë përgjegjësia për të metat juridike, duhet të plotësohen këto kushte: që e meta juridike të ketë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, që blerësi të mos ketë ditur për një të metë të tillë dhe shitësi të jetë njoftuar me kohë për shqetësimin juridik nga ana e blerësit.⁵³
21. AKP-ja ka pohuar, madje e ka përfshirë në marrëveshje faktin se blerësit kanë qenë të njoftuar se prona është e uzurpuar, prandaj sipas kësaj del se nuk plotësohet kushti i dytë për t'u konstatuar përgjegjësia për të metat juridike. Mirëpo, Avokati i Popullit konsideron se shitja e ndërmarrjeve shoqërore është një proces më i ndërlikuar i shitjes së pronave i përcaktuar me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, prandaj AKP-ja do të mund të ketë qenë në pozitë më të favorshme si

⁵¹ Avokati i Popullit më 30 tetor 2015 ka publikuar Raport me Rekomandime për Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, duke kërkuar propozimin dhe emërimin sa më të shpejtë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

⁵² Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Botimi i tretë, Prishtinë 2008; E Drejta e Detyrimeve, Mr.Sc. Rifat Zylfiu, fq.585.

⁵³ Po aty, fq.585

administratore e pronës në shitje se sa blerësit, duke përfshirë kështu në marrëveshje dispozitat të cilat e përjashtojnë atë nga përgjegjësitë për të metat juridike. Mirëpo, palët me kontratë mund ta kufizojnë ose ta përjashtojnë përgjegjësinë për të metat juridike të sendit, përveçse kur shitësi ka ditur për ekzistimin e mungesave të tilla (theks i shtuar) ose e shfrytëzon pozitën monopolistike dhe në rast të kontraktimit të një klauzole të tillë, ajo nuk do të ketë efekt juridik, përkatësisht do të jetë nule.⁵⁴

22. Avokati Popullit vëren se në rastin e z. Lavdim Mehmeti prona ka qenë e uzurpuar edhe kur AKP-ja ka qenë administratore e pronës, ndërsa në rastin e z. Xhevat Sadrijaj dhe në rastin e z. Nexhat Kastrati prona ishte lëshuar me qira nga AKP-ja dhe se me rastin e shitjes nga AKP-ja qiramarrësit nuk e kishin liruar pronën dhe as nuk kanë pranuar të hyjnë në kontratë për qiranë me pronarët e rinj, me ç'rast ata nga pozita e qiramarrësit janë shndërruar në shfrytëzues të paligjshëm të pronave të privatizuara. Pa dyshim se në të tri situatat kemi të bëjmë me uzurpim të paligjshëm të pronës.

E drejta për mbrojtje të pronës

23. Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh:

1. *“E drejta e pronës është e garantuar” [...].*

24. Neni 1 i Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.”

25. Lidhur me mbrojtjen e të drejtës pronësore Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastin Nr.K1187/13 N. Jovanoviq kundër Agjencisë Kosovare të Pronës, të cilës e drejta pronësore i është konfirmuar nga Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), por ajo nuk ka mundur të hyj në posedim për shkak të uzurpimit të pronës nga persona të paaautorizuar, ka konstatuar se: *“vendimi i KKPK-së, përbente pritje legjitime për parashtruesen, me te cilin është konstatuar se e njëjta është pronare legjitime e asaj prone. Prandaj, parashtruesja ka të drejtë ta gëzojë në mënyrë paqësore atë pronë, ashtu si garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në këto rrethana, asaj i është mohuar e drejta e gëzimit dhe posedimit të pronës (shih, mutatis mutandis, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec. nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII).”*
26. Në rastin e ankuesve në IAP janë *Marrëveshjet për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës* por edhe regjistrimi i të drejtës pronësore në Regjistrin e Paluajtshmërive që kanë krijuar pritje legjitime lidhur me pronat të cilat ata i kanë blerë nga AKP-ja.
27. Prandaj Avokati i Popullit konstaton se është cenuar e drejta pronësore e z. Mehmeti z. Sadrijaj dhe z. Kastrati.

Barazia para ligjit

28. Neni 3, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se:

“Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre.

29. Avokati i Popullit përshëndet nxjerrjen e Vendimit nr. 270/2014 dhe *Udhëzuesit për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit (Shfrytëzuesit e Paligjshëm)* që vlen për pronat që aktualisht janë nën juridiksionin e AKP-së dhe veprimet që AKP-ja i ka ndërmarrë për lirimin e pronave që janë në shitje. Kjo garanton se të gjitha pronat që do të shiten në të ardhmen do të lirohen

⁵⁴ Po aty, fq.586

nga shfrytëzuesit e kundërligjshëm dhe inkurajon AKP-në që të vazhdojë këtë proces në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

30. Mirëpo, Avokati i Popullit konsideron që vendimi nr. 270/2014 duhet të plotësohet dhe se juridiksione i AKP-së për lirim të pronave të uzurpuara të zgjerohet edhe për pronat të cilat janë shitur para se vendimi të hyj në fuqi, përkatësisht për pronat e shitura para datës 21 nëntor 2014, duke u mbështetur në faktin se sipas analizës ligjore të mësipërme AKP-ja nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia për të metat juridike të përmbushjes.
31. Avokati i Popullit, konsideron se vendimi nr.270/2014 i cili aktualisht vlen vetëm për pronat që janë nën juridiksionin e AKP-së cenon barazinë para ligjit. Kjo për arsye se shitja e pronave është bërë në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe se për të gjithë blerësit janë zbatuar procedura të njëjta të shitjes, prandaj edhe rezultati i shitjes së pronës do të duhej po ashtu të jetë i njëjtë për të gjithë blerësit.
32. Avokati i Popullit dëshiron të vejë në pah edhe nenin 2, paragrafin 3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili parasheh se :
“Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollat e saj.”
33. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se edhe lista e uzurpatorëve të pronave shoqërore do të duhej të zgjerohet për të gjitha pronat e uzurpuara prej vitit 1999.

Detyrimet dhe autorizimet e Policisë së Kosovës

34. Neni 10 i Ligjit nr. 04/1-076 për Policinë, përcakton detyrimet dhe autorizimet e Policisë së Kosovës. Sipas nenit 10, paragrafi 1 të ligjit, detyrat e përgjithshme të policisë janë, në mes tjerash, të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat (pika 1 e paragrafit 1); të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave (pika 2 e paragrafit 1); të hetojë veprat penale dhe kryesit e tyre (pika 5 e paragrafit 1).
35. Avokati i Popullit konstaton se ankuesit nëpërmes punëve juridike të vlefshme si bazë juridike dhe regjistrimit në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri⁵⁵ janë bërë posedues të të drejtave mbi pronat e uzurpuara, se mbrojtja e pronës është një e drejtë themelore,⁵⁶ dhe se uzurpimi i pronës është vepër penale.⁵⁷

Në bazë të kësaj që u tha më lart, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të autoriteteve, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 18 paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit:

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit

Rekomandon që:

1. *Agjencia Kosovare e Privatizimit të plotësojë vendimin nr. 270/2014 të datës 21 nëntor 2014 edhe për pronat për të cilat Agjencia ka përgjegjësi për të metat juridike të përmbushjes, të cilat janë shitur para datës 21 nëntor 2014.*
2. *Policia e Kosovës të veprojë në bazë të detyrave dhe autorizimeve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 10, paragrafi 1, pika 1, pika 2 dhe pika 5, të Ligjit nr. 04/1-076 për Policinë dhe të*

⁵⁵ Shih nenin 36, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/1-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore

⁵⁶ Shih nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

⁵⁷ Shih nenin 332 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr.04/082.

procedojë rastet e uzurpimit të pronave të privatizuara pranë prokurorive publike përkatëse në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale;

- 3. Prokuroritë Publike të fillojnë procedurën penale kundër uzurpuesve të pronave të privatizuara në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 20 maj 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 185/2012

Mikireme Maliqi

kundër

Gjykatës së Apelit

Raport lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në rastin C. nr. 3439/15 që ka të bëjë me ndarjen e pasurisë së fituar në bashkëpronësi

Për: Znj. Tonka Berishaj- u.d. Kryetare
Gjykata e Apelit në Prishtinë
Z. Nehat Idrizi, kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8

Prishtinë, më 5 maj 2016

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për përmirësimin e punës së gjyqësorit dhe funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave.
2. Ky raport është bazuar në ankesën individuale të znj. Mikireme Maliqi, mbështetet në faktet dhe provat e palës, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokati i Popullit (IAP), lidhur me procedurën gjyqësore për të vendosur për lëndën C. nr. 3439/15, që ka të bëjë me njohjen e të drejtës së pronësisë në bazë të kontributit të përbashkët në bashkëshortësi.

Përmbledhja e fakteve

3. Në bazë të informatave dhe dokumentacionit të cilat i posedon IAP, faktet mund të përmbliidhen si në vijim:
4. Më 22 maj 2000, ankuesja parashtrroi padi për njohjen e të drejtës së pronësisë në bazë të kontributit të përbashkët në bashkëshortësi në Gjykatën Komunale në Gjilan (GJKGJ).
5. Më 8 dhjetor 2000, GJKGJ, duke vendosur lidhur me çështjen, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.187/2000, sipas të cilit refuzohet kërkesëpadija e paditëses për njohjen e të drejtës së pronësisë në bazë të kontributit të përbashkët në bashkëshortësi në ½ pjesë ideale për dy banesat në Gjilan, truallin e blerë te parku i qytetit, sendet e luajtshme në ordinancë dhe veturën.
6. Gjykata e Qarkut në Gjilan (GJQGJ), duke vendosur sipas ankesës së paditëses, më 10 prill 2001, ka nxjerrë aktgjykimin Ac.nr. 5/2001, sipas të cilit është refuzuar ankesa e paditëses si e pabazuar.
7. Kundër aktgjykimit të GJQGJ, paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe ka propozuar që të priset aktgjykimi i shkallës së dytë dhe lënda të kthehet për rigjykim në shkallë të parë.
8. Gjykata Supreme e Kosovës (GJSK), pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, ka nxjerrë aktvendimin Rev. nr. 20/2001, të datës 31 dhjetor 2002, sipas të cilit pranohet revizioni i paditëses dhe për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, priset aktgjykimi i GJQGJ, Ac.nr. 5/2001 i datës 10.04.2001 dhe aktgjykimi i GJKGJ, C.nr.187/2000, i datës 08.12.2000, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
9. Më 14 nëntor 2005, GJKGJ, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.83/2003, sipas pjesës së I të dispozitivit të aktgjykimit, pjesërisht është aprovuar kërkesëpadija e paditëses dhe është konstatuar se paditësja ka të drejtën e bashkëpronësisë, në bazë të kontributit të përbashkët në bashkëshortësi në 1/3 e pjesës ideale të shtëpisë me dy hyrje dhe në pjesën e oborrit. Ndërsa sipas pjesës së II të dispozitivit, refuzohet kërkesëpadija e paditëses për njohjen e të drejtës për ½ pjesë në banesën prej 45 metra katror, truallin në sipërfaqe prej 200 metra katror dhe një pjesë të sendeve të luajtshme.
10. GJQGJ, duke vendosur lidhur me çështjen, më 30 gusht 2008, ka nxjerrë aktgjykimin Ac.nr. 26/2006, sipas të cilit pjesërisht ka ankesën e paditëses dhe ka ndryshuar pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të GJKGJ, C.nr.83/2008, dhe ka vërtetuar që paditësja ka të drejtën e bashkëpronësisë në bazë të kontributit të përbashkët në pjesët në punët zanatore të objektit të të paditurit në ¼ pjesë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar në pjesën II dhe III të dispozitivit.
11. Kundër aktgjykimit të GJQGJ, paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
12. GJSK, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, ka nxjerrë aktvendimin Rev. nr. 268/2006, të datës 24 dhjetor 2008, sipas të cilit pranohet revizioni i paditëses dhe për shkak të shkeljes thelbësore të

dispozitive të procedurës kontestimore, prishet aktgjykimi i GJQGJ, Ac.nr. 26/2006 dhe aktgjykimi i GJKGJ, C.nr.83/2003, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

13. Më 20 dhjetor 2010, GJKGJ, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.46/2009, sipas të cilit aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, dhe detyrohet i padituri që në emër të pasurisë së fituar në bashkësinë jashtëmartesore dhe në bashkësinë martesore, e llogaritur në shumën e të hollave në lartësi prej 54.864.35 Euro, si dhe t'ia njohë të drejtën e pronësisë për ½ e pjesës ideale në bashkëpronësi paditëses në emër të pasurisë së përbashkët të paluajtshme.
14. GJQGJ, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, ka nxjerrë aktvendimin AC.nr.85/2011, të datës 17 maj 2012, sipas të cilit prishet aktgjykimi i GJKGJ, C.nr.46/2009 i datës 20.12.2010, dhe lënda për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore, i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
15. Më 25 qershor 2015, GJTHGJ, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.393/12, sipas të cilit aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses, sipas dispozitivit I, vërtetohet se paditësja në bazë të kontributit të dhënë gjatë bashkësisë jashtëmartesore dhe martesore, është bashkëpronare e pasurisë së përbashkët prej 33.85 %, të sipërfaqes së përgjithshme të shtëpisë dhe oborrit, sipas dispozitivit të II, refuzohet si e pabazuar me ligj pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses e kërkuar më tepër se pjesa e gjykuar, që ka të bëjë me vërtetimin e të drejtës së pronësisë së paditëses nga ½ e pjesëve ideale të shtëpisë dhe oborrit, dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën është kërkuar nga ½ e pjesës ideale të banesës në rrugën “Bojana” dhe banesës në lagjen “Kamnik” dhe ½ e ngastrës kadastrale që gjendet në rrugën “M.Tita”. Sipas dispozitivit III, refuzohet edhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses sipas të cilës ka kërkuar që të vërtetohet se është bashkëpronare nga ½ e pjesëve ideale të mjeteve shtëpiake.
16. Më 9 korrik 2015, paditësja ka ushtruar ankesë në GJAP, kundër aktgjyqimit C.nr.393/12, të datës 9 korrik 2015.

Baza ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit

17. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”* Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

Hetimet e rastit nga Avokati Popullit

18. Më 18 prill 2012, ankuesja, kundër GJQGJ, i është drejtuar Avokatit të Popullit me ankesë për zvarritje të procedurave gjyqësore sipas padisë të ushtruar më 22 maj 2000, në GJKGJ, për ndarjen e pasurisë së fituar në bashkëshortësi.
19. Më 19 prill 2012, përfaqësuesi i IAP, vizitoi GJQGJ, bisedoi me gjyqtarin e rastit i cili pohoi se rasti do të procedohet shumë shpejt nga gjykata.
20. Më 17 maj 2012, GJQGJ, ka nxjerrë aktvendimin Ac.nr.85/2011, sipas të cilit prishet aktgjykimi i shkallës së parë dhe lënda kthehet në rivendosje.
21. Pas kthimit të lëndës në rivendosje në shkallë të parë, rasti i është ndarë për shqyrtim gjyqtarit të parë, mirëpo sipas kërkesës së palës së paditur për përjashtimin e gjyqtarit, rasti i është ndarë gjyqtarit të dytë, i cili, më vonë, për shkak të dyshimeve për kryerjen e veprës penale, është paraburgosur. Për këtë arsye, në muajin mars të vitit 2013, rasti i është ndarë në punë gjyqtarit të tretë, i cili e ka proceduar dhe nga data 21 maj 2013 e deri më 25 qershor 2015, kur është nxjerrë aktgjykimi i shkallës së parë, janë mbajtur dymbëdhjetë seanca gjyqësore për shqyrtimin e rastit.

22. Gjithashtu, nga data 6 maj 2014 deri më 14 janar 2015, gjyqtari i tretë i rastit, sipas vendimit të Komisionit Disiplinor, në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), është suspenduar përkohësisht nga puna, për shkak të dyshimeve për veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë.
23. Menjëherë pas kthimit të gjyqtarit në punë, më 22 janar 2015, përfaqësuesi i IAP, ka vizituar GJTHGJ, ka biseduar me gjyqtarin, i cili menjëherë ka caktuar seancën për datën 27 shkurt 2015. Më 21 maj 2015, është mbajtur seanca gjyqësore dhe çështja kontestimore është shpallur e përfunduar, dhe më 25 qershor 2015, GJTHGJ ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.393/12.
24. Avokati i Popullit vëren se, gjatë kësaj periudhe me rastin janë marrë tre gjyqtarë, ka pasur dy kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve nga rasti, një gjyqtar është përjashtuar nga rasti, një gjyqtar është paraburgosur dhe gjyqtari i tretë gjatë kësaj periudhe është suspenduar nga puna në kohëzgjatje prej më shumë se tetë muaj.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

25. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (KRRK), në nenin 31, paragrafi 1, përcakton se : *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.*
26. Ndërsa neni 54, përcakton se: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*
27. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm”.*
28. Ndërsa neni 13 i KEDNJ përcakton se: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*
29. Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në nenin 1 përcakton : *“Rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridike-civile të personave fizik dhe juridik, po qe se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe”.*
30. Sipas nenit 10, paragrafi 1 të po këtij ligji *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zbatohet pa ndonjë zvarritje dhe me sa më pak shpenzime e të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të drejtash që u takojnë palëve sipas këtij ligji”.*
31. Neni 12 i këtij ligji obligon gjykatën që *“Procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seanceve: a) seancës përgatitore; b) seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.”*
32. Ndërsa sipas nenit 190, paragrafi 3, të po këtij ligji, parashihet se *“Gjykata e shkallës së dytë do ta caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejt të çështjes edhe po që se aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dy herë dhe kur në seancën e kolegjit vlerëson se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë.”*
33. Neni 199 i këtij ligji përcakton se: *“Gjykata e çështjes ka për detyrë që menjëherë pasi t'i arrijë aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, të caktoj seancën përgatitore apo seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes e cila duhet të mbahet më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj”.*

34. Ndërsa neni 441, paragrafi 1, shprehimisht përcakton se: “*Seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar*”. Paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton po ashtu se: “*Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë [...]*”.
35. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, neni 7, paragrafi 3, përcakton se: “*Çdo person ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj.*”
36. Ndërsa sipas nenit 7, paragrafi 5, të po këtij ligji, përcaktohet se “*Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.*”

Analiza ligjore

37. Parashtruesja e ankesës ankohet në dështimin e gjyqësorit, Gjykata Komunale Gjilan, Gjykata e Qarkut në Gjilan dhe Gjykata Supreme të Kosovës, për të vendosur lidhur me padinë e saj të parashtruar më 22 maj 2000, pasi që ende nuk është marrë një vendim përfundimtar lidhur me rastin, ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së saj, për proces të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm kohor të paraparë me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, i cili garanton që: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile çdo kush ka të drejtë për proces të hapur dhe të drejtë brenda një afati të arsyeshëm (...)*”.
38. Avokati i Popullit vëren se rasti në fjalë, që nga paraqitja e parashtrësës më 22 maj 2000, datë kur znj. Maliqi, i është drejtuar me padi Gjykatës Komunale në Gjilan, procedurat kanë zgjatur më shumë se 15 vite dhe deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti ende nuk kemi një vendim të formës së prerë, që nuk është në pajtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ dhe nenin 10.1 të LPK.
39. Po ashtu, Avokati i Popullit, lidhur me sjelljen e autoriteteve gjyqësore vëren se, që nga data 22 maj 2000, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë gjithsej katër aktgjykime, tri aktgjykime të cilat janë prishur nga gjykatat më të larta, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, ndërsa aktgjykimi i katërt është nxjerrë më 25 qershor 2015. GJQGJ, si gjykatë e shkallës së dytë, ka nxjerrë dy aktgjykime dhe një aktvendim, aktgjykimet, po ashtu janë prishur sipas revizionit të GJSK. Ndërsa GJSK, ka nxjerrë dy aktvendime, sipas të cilëve është pranuar revizioni i palës paditëse dhe janë prishur aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Andaj për këtë arsye, Avokati i Popullit konstaton se, kjo vendimmarrje e gjykatave/gjyqtarëve paraqet një dështim të tyre në vendosjen përfundimtare të rastit, në dëm të ankueses dhe paraqet dështim për mbrojtje gjyqësore të drejtave të njeriut të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
40. Avokati i Popullit përkujton se KEDNJ është instrument ndërkombëtar për të drejtat e njeriut drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Neni 13 i KEDNJ-së, thekson në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, në radhë të parë, të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit ligjor, të ofrojë garanci shtesë për një individ që ai t’i gëzojë këto të drejta në mënyrë efektive. Pra, neni 13 i garanton individit, mjete efektive ankimi te autoritetet vendore, për shkelje të pohuara të të drejtave, ndërsa neni 6, parasheh shqyrtimin e rastit brenda një kohe të arsyeshme.
41. Avokati i Populli përkujton se, e drejta precedentale e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vërtetuar që në rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Girolomi kundër Italisë*, më 19 shkurt 1991 dhe aktgjykimin *Boddaert kundër Belgjikës*, më 12 tetor 1995). Për rastin në fjalë, procedura gjyqësore ishte filluar në Gjykatën Komunale në Gjilan, më 22 maj 2000, ndërsa më 25 qershor 2015, GJTHGJ ka nxjerrë aktgjykimin e fundit C.nr.393/12, dhe tani lënda është sipas ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë si shkallë e dytë gjyqësore, ende pa u vendosur.

42. Lidhur me fushën e zbatueshmërisë së nenit 13 të KEDNJ-së, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ, në disa raste shprehimisht e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, përbëjnë një kërcënim serioz për sundimin e ligjit të vendit. Kufizimet e theksuara në nenin 13 të KEDNJ, GJEDNJ i komenton kështu: *“Për sa i përket dështimit të supozuar për të siguruar seancë brenda një afati të arsyeshëm, nuk mund të shquhet asnjë kualifikim i tillë në fushën e nenit 13. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me konventë, më shumë favorizon mbajtjen në minimum të kufizimeve të nënkuptuara me nenin 13.”*
43. Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ nuk parashkruan ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës. Ai përcaktim varet nga rrethanat e veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj se çfarë është në interes për ankuesin.
44. Avokati i Popullit vëren se, edhe përkundër faktit se KGJK, më 16 prill 2007, ka miratuar Planin strategjik për gjyqësorin e Kosovës për periudhën 2007-2012, sipas të cilit duhej të zgjidheshin lëndët e vjetra të grumbulluara në mënyrë të sigurohet zgjidhja me kohë e të gjitha lëndëve që u ishin dorëzuar gjykatave, ndërsa nga qershori i vitit 2014 deri në qershor të vitit 2019, është aprovuar edhe Plani i dytë Strategjik për eliminimin e grumbullimit të rasteve. Megjithatë, përkundër këtyre planeve strategjike, parashtruesja e padisë, asnjëherë nuk ka përfutuar nga strategjitë në fjalë.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

45. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion ankueses, përmes së cilës ajo do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës, me parashikimin apo shpresën për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar. Kjo mënyrë e veprimit të gjyqësorit dëshmon për mohimin e drejtësisë për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.
46. Avokati i Popullit konstaton se periudha kohore mbi 15 vite pa vendim përfundimtar ka ndodhur pa fajin e palës paditëse. Ajo në asnjë moment nuk mund të konsiderohet se i ka kontribuar vonesave në vendosjen e lëndës.
47. Nisur nga analiza e dispozitave ligjore të lartpërmendura, informatave dhe fakteve të cilat i posedon Avokati i Popullit, konstaton se, ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura, se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike, duke dështuar sistemi gjyqësor në vendosjen e lëndës së ankueses. Zvarritja dhe joefikasiteti i procedurave sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, një parim që autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë.
48. Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *“[...] Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit *“Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës”*, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës

Rekomandon

Gjykatën e Apelit në Prishtinë

1. *Duke pasur parasysh faktin që ankuesja ka iniciuar procedurën gjyqësore që nga vitit 2000 dhe lidhur me rastin janë nxjerrë disa vendime të gjykatave dhe ende nuk kemi një vendim të formës së prerë, Gjykata të shqyrtoi mundësinë që të ndërmarr veprime në vendosjen e rastit, brenda një afati të arsyeshëm kohor, përkundër faktit që lënda në këtë Gjykatë gjendet që nga data 9.07.2015.*

Këshillin Gjyqësor të Kosovës

2. *Të inicioj përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formën e parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.*

Në pajtim me nenin 132 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.05/L-019, Ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të këtij raporti.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 431/2015

Ismet Rusinovci

kundër

Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

dhe Agjencionit për Zhvillim të Bujqësisë (AZHB)

Raport lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi I. R., në lidhje me procedurën e dhënies granteve për ndërtimin e stallës, objekteve përcjellëse dhe mekanizëm bujqësor nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)

Për: Z. Memli Krasniqi, ministër
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Rr. “Nëna Terezë”
10000 Prishtinë

Z. Elhami Hajdari, Kryeshef Ekzekutiv
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
Rr. “Nazmi Gafurri”
10000 Prishtinë

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3 Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16

Prishtinë, më 16 maj 2016

Qëllimi i raportit

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), përkatësisht ministrit të kësaj ministrie, z. Memli Krasniqi dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), z. Elhami Hajdari, në:

1. Në të drejtën e znj. Isufi, për t'u informuar lidhur me ankesën e paraqitur më 15.06.2015, kundër vendimit të AZHB-së, REF: 07/4, të datës 02.06.2015 brenda afatit kohor në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative të Republikës së Kosovës.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

2. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”.*

Përshkrimi i çështjes

3. Ky raport është bazuar në ankesën e parashtruar më 10 korrik 2015 në IAP, të ankuesit z. Ismet Rusinovci, në emër të gruas së tij, znj. Kimete Isufi, kundër MBPZHR, përkatësisht AZHB-së, lidhur me çështjen e aplikimit për një grant të ndërtimit të stallës dhe të objekteve përcjellëse dhe mekanizëm bujqësor, të datës 7 prill 2015, me numër të aplikacionit 19/157.
4. Më 2 qershor 2015, AZHB-ja, mori vendim që fermeres znj. Kimete Isufi t'ia refuzojë kërkesën e saj për grant dhe në pjesën e arsytimit të vendimit shkruan se fermerja është nga Komuna e Shtërpçës.
5. Znj. Isufi kundër këtij vendimi, parashtrroi ankesë për rishqyrtim më 15 qershor 2015, por ajo nuk ka pranuar deri më tani asnjë përgjigje lidhur me ankesën e parashtruar në MBPZHR.
6. Më 5 qershor 2015, AZHB publikoi listën e vlerësimit të aplikimeve për vitin 2015 dhe në pjesën ku janë shënimet e znj. Isufi, me numër rendor 128, ankuesi pohon se shënimet nuk janë të sakta, duke filluar nga komuna e aplikimit dhe emri i projektit.
7. Më 16 shtator 2015, Avokati i Popullit (AP), dërgoi një letër ministrit të MBPZHR, z. Memli Krasniqi për të kërkuar të dhëna dhe informata lidhur me arsyet e mos-përgjigjes nga kjo ministri, të ankesës për rishqyrtim znj. Isufi, të parashtruar më 15 qershor 2015 në MBPZHR.
8. Më 5 tetor 2015, AP ka pranuar përgjigjen e MBPZHR, sipas së cilës thuhet se *“Pas aplikimit të znj. Kimete Isufi nga fshati Nishefc, Komuna e Prishtinës, AZHB ka bërë kontrollimin administrativ të aplikacionit dhe kanë konstatuar se bazuar në Nenin 5, paragrafi 2.4 dhe 2.9 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 të MBPZHR për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Vitin 2015, në dosjen e aplikuesit mungon kopja e skicës së objektit dhe përlllogaritja e shpenzimeve dhe për këtë arsye është marrë vendim për refuzimin e saj”.*
9. Pala pohon se pas Vendimit të AZHB për refuzimin e kërkesës së saj, znj. Isufi ka bërë ankesë për rishqyrtim në MBPZHR më 15 qershor 2015 tek Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, i cili ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe ka nxjerr Rekomandim për rishqyrtimin e lëndës, më 28 korrik 2015, nr. prot.3263 dhe duke marrë për bazë nenin 33 të udhëzimit administrativ Nr.01/2015 të MBPZHR. Pas kësaj, AZHB, sipas rekomandimeve të komisionit, ka bërë rishqyrtimin e dosjes së znj. Kimete Isufi dhe ky komision ka konstatuar më 17 gusht 2015 se përsëri në dosjen e projektit nuk gjendet kopja e skicës së objektit dhe parallogaritja e shpenzimeve, sikur parashihet me udhëzimin administrativ Nr.01/2015 të MBPZHR dhe për këtë arsye projekti në fjalë nuk është kualifikuar për mbështetje. Pala pohon se me refuzimin e serishëm nga AZHB nuk e ka njoftuar atë.

Baza ligjore

10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31 përcakton: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 32: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*
12. Konventa Evropiane për të Drejtat e të Njeriut (KEDNJ), është dokument ligjor i zbatueshëm me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Në paragrafin 1 të nenit 6, KEDNJ shprehimisht thekson se: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*
13. Ligji Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative të Republikës së Kosovës:
 - Neni 11: *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizik dhe juridik”.*
 - Neni 38.4: *“Drejtuari i organit të administratës publike shqyrton menjëherë kërkesat për veprim drejtuar organit nga pala e interesuar dhe kryen veprimet e mëposhtme:*
 - a) *njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar dhe se procedimi administrativ ka filluar ose*
 - b) *njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa nuk është pranuar dhe se pala mund të ankohe kundër këtij vendimi sipas procedurës të parashikuar në nenin 101 të këtij Ligji ose;*
 - c) *njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative përpara se organi t’i përgjigjet kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme”.*
 - Neni 90.1: *“Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh”.*
 - Neni 109: *“Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative me anë të të cilave:*
 - a). *merren vendime lidhur me pretendimet e tyre;*
 - b). *caktohen detyrime dhe dënime ose shkaktohen dëme;*
 - c). *krijohen, marrin fund, zgjerohen ose kufizohen interesa legjitime ose të drejta të palëve, ose pengohen kushtet për gëzimin e tyre në ndonjë mënyrë tjetër”.*
 - Neni 131.1: *“Organi administrativ kompetent shqyrton ankimin administrativ dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të ankimit”.*
14. Sipas Nenit 33, paragrafi 4 i udhëzimit administrativ Nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015: *“Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 30 ditësh duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtuar parashtruesit të ankesës”.*

Analiza ligjore

15. Bazuar në faktet përmbledhëse të rastit, të ankesës së parashtruar të z. Ismet Rusinovci, në emër të gruas së tij, znj. Kimete Isufi kundër MBPZHR-së, respektivisht AZHB-së, IAP vëren se AZHB-ja kishte pranuar dokumentacionin për aplikim për grant më 7.4.2015, me numër të aplikacionit 19/157, sipas dëftesës për pranimin e dokumenteve të nënshkruar nga aplikantja znj. Isufi dhe zyrtarit rajonal.

16. Në listën kontrolluese të dokumenteve të dorëzuara nga aplikantja, shkruan se *“në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikantin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce duke ja rrumbullakuar dokumentet që i mungojnë aplikantit. Aplikanti ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që të kompletoj dokumentet. Në rast kur kërkohet vetëm kopja e dokumentit, aplikanti e shkruan me dorë në kopje “sikur në origjinal” dhe ja sjellë origjinalin në shikim të zyrtarit rajonal i cili e verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ja kthen origjinalin aplikantit”*. Një gjë e tillë është e përcaktuar edhe në udhëzimin administrativ nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Vitin 2015, përkatësisht në nenin 27, tek Kontrollimi i aplikacioneve në Zyrën Regjionale, paragrafët: 2, 4 dhe 5.⁵⁸
17. Mirëpo, në vendimin e AZHB të datës 02.06.2015, REF:07/4, të pranuar nga ankuesja znj. Isufi, shkruan se *“Gjatë kontrollës administrative të dokumentacionit të aplikuesit Kimete Isufi është konstatuar se aplikuesi nuk e kalon pragun e pranueshmërisë së aplikacioneve duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ dhe Udhëzuesin për Aplikant. Në aplikacion mungojnë dokumentet në vijim: Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015, Neni 9, Paragrafi 2, nën paragrafi 2.4, Pika 2.4.9, thotë: Për projektet e ndërtimit aplikantët në rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë: 2.4.9.1: Kopjen e skicave të objektit dhe një paralogaritje të shpenzimeve të materialit dhe punëve të parapara. Aplikuesi nuk e ka sjellë skicën. Andaj duke marrë parasysh këto pika AZHB-ja merr vendim për refuzim.”* Pra, refuzimi i kërkesës për grant sipas AZHB, znj. Isufi i bëhet për shkak se ajo nuk ka sjellë skicën dhe një paralogaritje të shpenzimeve. Por, në listën kontrolluese të dokumenteve të dorëzuara nga aplikantja shkruan se *“në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin..”* Prandaj, ankuesi pohon se dokumentet e kërkuara janë pranuar nga zyrtari regjional, bazuar edhe në dëftesën për pranimin e dokumenteve të nënshkruar nga ai dhe nga aplikantja, të datës 7.4.2015, me nr. aplikacioni 19/157, komuna e Prishtinës. Pra, në listën kontrolluese të dokumenteve të dorëzuara nuk kërkohet ndonjë dokument tjetër, në rast të mungesë të ndonjë dokumenti obligativ, atëherë zyrtari rajonal nuk do ta pranonte aplikacionin, *por e regjistron aplikantin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce duke ja rrumbullakuar dokumentet që i mungojnë aplikantit*, ashtu siç përcaktohet në udhëzimin administrativ nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Vitin 2015, përkatësisht në Nenin 27, paragrafi 2,4 dhe 5.
18. Më tutje, nëse e analizojmë vendimin e 2.6.2015 të AZHB-së, të dorëzuar nga ankuesi z. Rusinovci në IAP, shkruan se *“Duke u bazuar në kërkesën e parashtruar nga aplikuesi, Kimete Isufi nga Komuna e Shtërpçës, me të cilën ka kërkuar përkrahje për mbështetje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural përkatësisht në nën masën 101.4.a. Sektori i Qumështit nga lopët”*. Bazuar në pohimet e ankueses znj. Isufi, si fillim, ajo nuk është as nga Shtërpca dhe ky është gabimi i dytë i AZHB-së, pas atij të parit, ku në Listën e Vlerësimit të Aplikimeve për Vitin 2015, më 5.6.2015 në pjesën e shënimeve për znj. Isufi, me nr. rendor 128, figuronte se vendi i aplikimit ishte Malisheva kurse në vendimin në fjalë si vend aplikimi është Shtërpca. Në letrën e ministrit të MBPZHR-së, z. Memli Krasniqi, më 20.9.2015, dërguar në IAP, ai ka përmendur gabimin e bërë nga ana e zyrtarëve të AZHB-së, ku në vend të vendit të aplikimit që ka qenë Prishtina është shënuar Malisheva, por z. Krasniqi nuk jep ndonjë të dhënë mbi arsyet e gabimit të lëshuar në vendimin e 02.06.2015 të AZHB-së, ku shkruan se vendi i aplikimit të aplikueses është Shtërpca.
19. Gjithashtu, në vendimin e AZHB, më 2.6.2015 të dorëzuar nga ankuesi në IAP, ceket se ankuesja ka kërkuar përkrahje për mbështetje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural përkatësisht në nën masën 101.4.a. Sektori i Qumështit nga lopët. Ankuesi, pohon se gruaja e tij znj. Isufi ka aplikuar për ndërtimin e stallës për dele dhe dhi, ashtu siç mund të kuptohet në biznes-planin, përkatësisht në faqen 3, tek

⁵⁸ Paragrafi 2: *“Zyret Regjionale përkatëse për bujqësi i kontrollojnë se a është kompletuar aplikacioni”*. Paragrafi 4 *“Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe i tregon për dokumentet që i mungojnë aplikuesit. Paragrafi 5 thotë “Aplikuesi ka afat deri në përfundim të Thirrjes për Aplikim që t’i kompletojë dokumentet”*.

përshkrimi i aseteve kryesore në pronësi të aplikuesit (*Tabela 1, pika nr.3: dele, qingja, dhi dhe edha*) dhe jo për lopët, ashtu siç ceket në vendimin në fjalë “101.4 a. Sektori Prodhimi i qumështit nga lopët”, po ashtu edhe në Listën e Vlerësimit të Aplikimeve për Vitin 2015, të datës 05.06.2015 të publikuar nga AZHB, shkruan “Masa 101.4.a. Sektori Prodhimit i qumështit nga lopët, gjithashtu edhe në shënimet për znj. Isufi në këtë listë me nr. rendor 128, ceket “Ndërtimi i stallës për lopë qumështore”. Por, në përgjigjen e z. Krasniqi dërguar IAP, shkruan se “znj. Isufi ka aplikuar në sektorin e prodhimit të qumështit nga delet/dhitë”. Prandaj, në bazë të këtyre të dhënave, kemi vërejtur një varg parregullsish gjatë trajtimit dhe vlerësimit të kërkesës për grant të znj. Isufi.

20. Po ashtu, në arsyetimin e vendimit të datës 2.6.2015 të AZHB-së, të dorëzuar nga pala në IAP ceket se *udhëzimi administrativ Nr.01/2015, neni 9, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4, pika 2.4.9, thotë: Për projektet e ndërtimit aplikantët në rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë: 2.4.9.1. Kopjen e skicave të objektit dhe një paralogaritje të shpenzimeve të materialit dhe punëve të parapara*. Andaj, IAP ka analizuar udhëzimin administrativ në fjalë se Neni 9, i cili ka të bëjë me Sektorin e Qumështit, paragrafi 2 ka të bëjë me “*Investimet e pranueshme*” kurse nënparagrafi 2.4. ka të bëjë me “*Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë*”, kurse pika 2.4.9 nuk ekziston fare në këtë nen, pasi që ky nen, pra neni 9, përfundon me paragrafin 2.7 dhe më pas vijon paragrafi 3, pra 2.4.9 fare nuk ekziston. Prandaj arsyetimi i vendimit të AZHB-së të datës 2.6.2015, REF: 07/4 është e gabuar baza ligjore, sepse nuk i referohet skicës së objektit, ashtu siç ju e keni precizuar. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, përkatësisht të nenit 86, paragrafi 1 “*Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit*”. Po ashtu, në nenin 86, paragrafi 3 i këtij ligji thuhet: “*Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit*”. AP konstaton se baza ligjore e vendimit 2.6.2015 të AZHB-së është e pasaktë prandaj kjo mund të shërben si argument i mjaftueshëm që jo vetëm që akti në fjalë, të quhet si akt i paarsyetueshëm, por edhe i pavlefshëm njëkohësisht.⁵⁹
21. Kujtojmë se znj. Isufi kishte parashtruar më ankesë për rishqyrtim më 15.06.2015 në MBPZHR dhe ndër të tjera cek se “*ankuesja nuk është nga Shtërpa*”. Në përgjigjen e ministrit të MBPZHR, z. Krasniqi dërguar në IAP më 5 tetor 2015, mes tjerash bëhet e ditur se Komisioni për shqyrtimin e ankesave ka bërë shqyrtimin e ankesës së znj. Isufi duke nxjerr Rekomandim për rishqyrtim të lëndës.⁶⁰ Më pas AZHB sipas rekomandimeve të komisionit, ka bërë rishqyrtimin e dosjes së znj. Isufi dhe ka konstatuar përsëri se në dosjen e projektit nuk gjendet kopja e skicës së objektit dhe paralogaritja e shpenzimeve, sikur parashihet me udhëzimin administrativ Nr.01/2015 të MBPZHR dhe për këtë arsye projekti në fjalë nuk është kualifikuar për mbështetje.
22. Megjithatë, në bazë të pohimeve të parashtruesit të ankesës në IAP, ende znj. Isufi nuk e ka pranuar njoftimin për shqyrtimin e ankesës, të datës 28.7.2015 nga AZHB pasi që siç vërehet në këtë njoftim e znj. Isufi është komuna e Shtërpcës, edhe pse në ankesën e saj për rishqyrtim të datës 15.6.2015 kishte përmendur që ajo nuk është nga kjo komunë. Madje, Ligji Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative, edhe në raste të pasaktësive ose gabimeve të dukshme parasheh obligimin e organit të bëjë përmirësimet ashtu siç ceket në nenin 96 “*Në rastet kur akti administrativ është i vlefshëm, por ka pasaktësi ose gabime të dukshme, organi administrativ që e ka nxjerrë një akt të tillë, me iniciativën e vet ose me kërkesën e palëve në një procedim administrativ, korrigjon gabimet materiale dhe pasaktësitë e dukshme të aktit pa ndryshuar përmbajtjen e tij. Korrigjimi i akteve administrative me pasaktësi dhe gabime të dukshme mund të bëhet në çdo kohë*”.
23. Prandaj, duke pasur parasysh që liritë dhe të drejtat e njeriut, të garantuara në bazë të instrumenteve ndërkombëtare, të parapara me Kushtetutë, kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës,⁶¹

⁵⁹ Shih komentarin e Ligjit për Procedurën Administrative, viti 2014, Botimi i Parë, z. Mazllum Baraliu dhe z. Esat Stavileci.

⁶⁰ Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2015 të MBPZHR, neni 33.

⁶¹ Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 1. *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.*

Avokati i Popullit, tërheq vëmendjen, që e drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, që secilit i garanton *“Lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”*.⁶²

24. Po ashtu, sipas nenit 53, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, Avokati i Popullit, thekson se sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), liria për të marrë informacion, përfshin të drejtën për të mbledhur dhe kërkuar informacione, nëpërmjet të gjitha burimeve të mundshme ligjore.⁶³

Konstatimi i Avokatit të Popullit

25. Mosnjoftimi i ankueses lidhur me shqyrtimin e ankesës së saj, më 28.7.2015 nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2015. IAP konstaton se ky mosnjoftim ka ardhur pasi në kopjen e njoftimit në fjalë, shkruan gabimisht adresa e znj. Isufi (komuna e Shtërpçës), edhe pse ajo në ankesën për rishqyrtim, më 15.6.2015, të dërguar në MBPZHR, kishte theksuar se nuk është nga Shtërpca.
26. AP vlerëson se Lista kontrolluese e dokumenteve të dorëzuara, nuk është në përshtatje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin administrativ nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 dhe Udhëzuesin për Aplikant. Është dashur që të ceket që në mesin e kriterëve të jetë precizuar edhe skica e objektit. IAP vlerëson se aplikuesja ka bërë një paralogaritje të shpenzimeve të materialit duke u bazuar në Biznes-planin e ndërtimit të stallës dhe objekteve përcjellëse dhe mekanizëm bujqësor, në faqen 8.
27. IAP konstaton se znj. Isufi nuk ka pranuar ende vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, prandaj ajo nuk mund të shfrytëzojë mjetet juridike, ashtu siç përcaktohet në nenin 33, paragrafi 6 i udhëzimit administrativ Nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015, që citon se *“Kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, në afat prej 30 ditësh, aplikuesi mund t'i drejtohet gjykatës kompetente”*. Pamundësia e shfrytëzimit të mjeteve juridike është në kundërshtim të plotë me nenin 13 *“E drejta për zgjidhje efektive”* të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁶⁴ Gjithashtu, bazuar në nenin 90, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative thotë që *“Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh”* dhe nenit 33, paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 citon *“Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 30 ditësh duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtuar parashtruesit të ankesës”*. Po ashtu AP konstaton se bazuar në Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative, përkatësisht nenin 132, paragrafi 1 citon se *“Në qoftë se organi që ka nxjerrë ose ka refuzuar të nxjerrë aktin administrativ të apeluar vendos të pranojë kërkesën për rishqyrtim, ai merr vendim përkatës”*.

Prandaj, Avokati i Popullit

REKOMANDON

⁶² Neni 19, i Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, e nxjerrur dhe e shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor 1948.

⁶³ *Liria e Shprehjes*, Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, fq. 13, paragrafi 13., Rasti Autronic kundër Zvicrës, 1990.

⁶⁴ Neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut citon se *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*.

Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

- 1. Të harmonizojë Listën kontrolluese të dokumenteve të dorëzuara me udhëzimin administrativ Nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015 dhe udhëzuesin për aplikant, duke përcaktuar që në listën kontrolluese të theksohen kriteret e kërkuara në bazë të këtij udhëzimi, në mesin e tyre edhe skica e objektit.*
- 2. Të nxjerrë dhe dërgojë vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave znj. Isufi, ashtu siç përcaktohet në nenin 33, paragrafi 4 të udhëzimit administrativ Nr.01/2015 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2015.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren nga MBPZHR dhe AZHB, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartcekura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor, më së largu brenda tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit të këtij raporti.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Kopje:

- Z. Abit Hajredini, udhëheqës i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit
- Znj. Emine Kelmendi, koordinatore e Njesisë për të Drejtat e Njeriut, MBPZHR
- Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione i Republikës së Kosovës
- Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa .nr. 291/2014

Rrahim Bajrami

kundër

Gjykatës Themelore në Prishtinë

Raport në lidhje me zvarritjen procedurale nga Gjykatës Themelore në Prishtinë për vendosjen e lëndës P nr.42/15 të ankuesit Rr. B.

Për: Z. Hamdi Ibrahim, Kryetar
Gjykata Themelore Prishtinë, Pallati i Drejtësisë, Hajvali
10000 Prishtinë

Z. Nehat Idrizi, Kryesues,
Këshilli Gjyqësor i Kosovës, rruga” Luan Haradinaj p.n.
10000 Prishtinë.

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8

Prishtinë, më 10 qershor 2016

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me domosdoshmërinë e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për përmirësimin e punës së gjyqësorit dhe funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Rrahim Bajrami, dhe mbështetet në faktet dhe provat, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me procedurën gjyqësore për të vendosur për lëndën P.nr. 42/15

Përmbledhja e fakteve

3. Në bazë të informatave dhe dokumentacionit të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), faktet mund të përmbliken si në vijim:
4. Në vitin 1970, ankuesi kishte blerë 50 ari tokë, në fshatin Çagllavicë, nga pronari Urosh Steviq, të cilën nuk e kishte kaluar në pronësi të tij ndonjëse e kishte punuar pa problem deri në vitin 2000. Pas vitit 2000, kanë filluar problemet kur kanë filluar të shiten tokat rreth pronës së tij dhe se një ditë kjo pronë nga djali i Urosh Steviqit është shitur me ç'rast ka kaluar në pronësi të dy blerësve të rinj.
5. Më 30 maj 2003, ankuesi ka parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
6. Më 7 prill 2004, ankuesi ka parashtruar padi për pengim posedim dhe propozim për caktimin e masës së përkohshme, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, lidhur me pronën e njëjtë.
7. Më 15 korrik 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin C.nr. 1634/2004, cakton masën e përkohshme në lidhje me padinë për pengim posedimin.
8. Më 24 mars 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me gjyqtarin e çështjes z. Sami Gërdovci nxjerr aktvendimin për heqjen e masës së përkohshme të sigurimit të pronës (C.nr. 1634/2004), sipas kërkesës së përfaqësuesit të paditurve, me arsyetimin se paditësi z. Rrahim Bajrami është i vdekur. Masa e përkohshme ishte vendosur në vitin 2004 dhe ende pa u zgjidhur përfundimisht kontesti, gjykata kishte lëshuar vendimin për anulimin e masës së përkohshme, pa administruar dhe vërtetuar qoftë edhe një fakt të vetëm sipas Ligjit të Procedurës Jokontestimore, për shpalljen e vdekjes së personit kyç në këtë proces.
9. Më 23 tetor 2012, në Gjykatën Themelore në Prizren, është ngritur aktakuzë PP.nr.1338/09 kundër z. Sami Gërdovci ish-gjyqtar në Gjykatës Komunale në Prishtinë, për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 346 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr. 04/L-082 (KPRK) dhe z.Meriman Vehapi, ish-gjyqtar i Gjykatës Komunale në Prizren, për veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 269, para. 2 me para. 1 të KPK-së.
10. Më 13 mars 2014, duke vendosur lidhur me delegimin e kompetencës territoriale, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr. 157/2014, e cakton Gjykatën Themelore në Gjilan, si gjykatë kompetente për vendosjen e lëndës, pasi njëri nga të akuzuarit kishte parashtruar kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Prizren.
11. Pasi që Gjykata Themelore në Gjilan ishte caktuar si gjykatë kompetente për vendosjen e lëndës së ankuesit, me qëllim të informimit lidhur me veprimet të cilat janë ndërmarr nga ana e Gjykatës Themelore në Gjilan për caktimin e shqyrtimit kryesor në çështjen e ankuesit, përfaqësuesi i IAP-së e kishte vizituar Gjykatën Themelore në Gjilan, më datë 9.7.2014, 31.7.2014, 18.8.2014, 5.9.2014, 16.9.2014, 09.10.2014, 17.11.2014, 2.12.2014, 8.1.2015, 20.1.2015, 25.2.2015, 26.2.2015, dhe 7.5.2015, duke kërkuar nga gjyqtari përkatës që të procedohet lënda e ankuesit.
12. Më 30 janar 2015, Gjykata Themelore në Gjilan, duke vepruar sipas qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës GJA-S.u.A. 10/2015 për zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nr. 04/L-123 (KPPK) dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, sa i përket kompetencës

territoriale nga ana e prokurorive dhe gjykatave, të datës 12.1.2015, shkresat e lëndës në fjalë ia dërgoi për vendosje Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda.

13. Më 7 maj 2015, Avokati i Popullit, i dërgoi një letër kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën kërkoi informata për veprimet e ndërmarra ose ato që planifikonte të ndërmerre që rasti i ankuesit të shqyrtohej brenda afatit të arsyeshëm kohor. Në letrën e dërguar Avokati i Popullit nuk pranoi përgjigje.
14. Më 3 korrik 2015, Avokati i Popullit, sërish i dërgoi letër kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke e përkujtuar atë se nuk ka pranuar përgjigje dhe duke kërkuar përgjigje në çështjen e ankuesit brenda një afati të arsyeshëm kohor.
15. Më 16 korrik 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë ku u njoftua se: *“Gjykata Themelore e Gjilanit e ka dërguar këtë lëndë te Gjykata Themelore në Prishtinë për vendosje edhe pse si i akuzuar është përfshirë ish gjyqtari i Gjykatës Komunale në Prishtinë Sami Gërdovci. Kjo lëndë më 08.07.2015 do ti kthehet Gjykatës Themelore në Gjilan në kompetencë të mëtejme sepse ka një vendim të Gjykatës së Apelit e cila ka caktuar si gjykatë kompetente Gjykatën Themelore të Gjilani.”*
16. Më 16 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së, gjatë vizitës në Gjykatën Themelore në Gjilan, bisedoi me referentën e Gjykatës, e cila deklaroi se më 4 gusht 2015, lënda nga Gjykata Themelore në Gjilan, për shkak të kompetencës territoriale është dërguar në Gjykatën e Apelit.
17. Më 23 shtator 2015, përfaqësuesi i IAP-së, e vizitoi Gjykatën Themelore në Gjilan dhe nga referentja e gjykatës u njoftua se gjatë kësaj periudhe të vitit 2015, për shkak të kompetencës territoriale dhe lëndore janë dërguar nga Gjykata Themelore në Gjilan, në gjykatat e tjera 7 (shtatë) lëndë.
18. Më 3 mars 2016, përfaqësuesi i IAP-së, bisedoi me kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili ka deklaruar se gjatë muajit mars 2016, do të filloj shqyrtimi në çështjen e ankuesit.
19. Më 19 prill 2016, përfaqësuesi i IAP-së sërish e vizitoi Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe bisedoi me gjyqtarin e çështjes, i cili deklaroi se pasi që më herët ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Komunale në Prishtinë dhe ka pasur raporte të mira me të pandehurin, kishte parashtruar kërkesë për përjashtim e cila është aprovuar dhe lënda nga ai i është caktuar për vendosje gjyqtarit tjetër.
20. Më 6 prill 2009, ankuesi, në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, e ka parashtruar një ankesë kundër gjyqtarit Gërdovci, lidhur me parregullsitë e evidentuara gjatë procedimit të lëndës E.nr. 363/03.
21. Më 24 korrik 2009, ankuesi ka marrë një përgjigje nga zyra e prokurorit disiplinor në të cilën thuhet *“[...] ZPD nuk do të hap hetim disiplinor por parashtrësën tuaj do të ja përcjell për konsideratë Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës nëse gjyqtari i lartshënuar do të aplikoj për ndonjë post gjyqësor[...].”*
22. Më 1 mars 2016, përfaqësuesi i IAP, ishte në Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe bisedoi me inspektoren e lartë, e cila deklaroi se deri më sot nuk është nxjerr asnjë vendim kundër ish gjyqtarit Gërdovci.
23. Më 25 mars 2016, ankuesi e kishte pranuar një përgjigje nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, në të cilën thuhet: *“[...] Ju informojmë se ZPD ka gjet vonesë në vendosjen e lëndëve tuaja C.nr.911/03 dhe P.nr.590/14, por vonesat kanë ardhur si rezultat i rrethanave objektive ngarkesa e gjyqtarëve me numër të madhe të lëndëve. ZPD konsideron se, tani për tani vonesat nuk janë të mjaftueshme për të hapur hetim disiplinor lidhur me pohimet tuaja nga parashtrësja. Nëse lëndët tuaja nuk vendosen brenda një afati të arsyeshëm kohor, luteni me mirësi ta njoftoni ZPD-në”.*

Baza ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit

24. Sipas nenit 135, para. 3 të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
25. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

Instrumentet ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta u garanton qytetarëve mbrojtjen e të drejtave të tyre, në gjykata, përdorimin e mjeteve juridike, si dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke u bazuar në nenet, si me poshtë:

26. Neni 31 përcakton: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
27. Neni 32 përcakton: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*
28. Neni 54 përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)

Konventa është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

29. Paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së, garanton që: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*
30. Ndërsa, neni 13 i KEDNJ-së përcakton: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtare, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*

Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199

31. Në nenin 11 para. 1 përcakton: *“Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.”*
32. Po ashtu, neni 7, paragrafi 2 i po këtij ligji, përcakton: *“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”*

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nr. 04/L-123

33. Në nenin 5 paragrafi, 2, përcakton: *“Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.”*
34. Neni 62 para. 1.1 i KPPK-së, parasheh që *“I dëmtuari nga vepra penale duhet të trajtohet me respekt nga policia, prokurorët, gjyqtarët ose organi tjetër që zbaton procedurën penale.”*
35. Ndërsa neni 62, paragrafi 1.3, i kodit në fjalë përcakton që: *“I dëmtuari ka cilësinë e palës.”*

Analiza ligjore e rastit

36. Duke pasur parasysh ankesën e parashtruesit, lidhur me vonesat e gjykatave për të vendosur lidhur me rastin e z. Bajrami, Avokati i Popullit vëren se e drejta për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për mjete efektive juridike, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, nuk është përmbushur, pasi gjykatat themelore, kanë zvarritur vendosjen e lëndës së *ankuesit* për më shumë se 4 vite. Procedura gjyqësore është iniciuar në vitin 2012 dhe ende nuk është vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti. Zvarritjet e tejzgjatura të procedurave gjyqësore dhe pa një vendim përfundimtar të formës së prerë janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, nenin 7, paragrafi 1 dhe 11 paragrafi 2 për Ligjin për Gjykatat dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nenin 5 paragrafin, 2, nenin 62 paragrafi 1.1.
37. Avokati i Popullit përkujton që edhe e drejta precedente e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka vërtetuar që për rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës penale, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Boddaert kundër Belgjikës*, më 12 tetor 1995).
38. Lidhur me rastin e ankuesit, procedura gjyqësore ishte filluar në Gjykatën Themelore në Prizren, më 23 tetor 2012 dhe vazhdon ende në vitin 2016, pa një vendim gjyqësor.
39. Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ-së nuk parasheh ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës, por, ai përcaktim varet nga rrethanat e veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj se çfarë është në interes për ankuesin. Sipas GJEDNJ-së, është e domosdoshme të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i procedurave me qëllim të përcaktimit të arsyes për zgjatje të procedurës. Kjo do të thotë që, vonesat e caktuara lidhur me një pjesë të procedurave mund të mos përbëjnë shkelje nëse zgjatja e tërësishme e procedurës nuk ka qenë e tepruar. Nga provat dhe dëshmitë e prezantuara nga ankuesi dhe dëshmitë dhe provat e siguruara nga hetimi i rastit, Avokati i Popullit nuk gjen arsye për zvarritje të procedurës.
40. Edhe pse rasti, sipas evidencës së prokurorisë, PP.nr. 1338/09, vërehet se është hapur në vitin 2009 dhe aktakuzë të ngritur në vitin 2012, ende nuk është marrë vendim gjyqësor meritator në shkallën e parë, lidhur me rastin. Deri më tani lënda është bartur nga një gjykatë në tjetrën, fillimisht në Gjykatën Themelore në Prizren, pastaj në atë të Gjilanit dhe tani në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
41. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur mbi 6 vite, duke filluar nga prokuroria dhe mbi 4 vite nga ngritja e aktakuzës në gjykatë, vë në dyshim respektivisht është në kundërshtim me neni 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
42. Neni 13 i KEDNJ-së, duke theksuar në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo gëzon këto të drejta në mënyrë efektive. Kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave, sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i z. Bajrami ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i KEDNJ-së është i zbatueshëm.

43. Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme ashtu si parashihet me, nenin 7, paragrafi 1 dhe 11 paragrafi 2 për Ligjin për Gjykatat dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nenin 5 paragrafin, 2, nenin 62 paragrafi 1.1. Nga informatat në dispozicion nuk mund të konstatohet se ankuesi, me veprimet/mosveprimet e tij, ka kontribuar në çfarëdo forme në zvarritjen e procedurës gjyqësore.
44. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion ankuesit, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, me parashikimin apo shpresën për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar.
45. Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshem, të garantuar me aktet ligjore dhe se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike, në trajtimin e rastit nga ana e gjykatave/gjyqësorit, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafin 1 të KEDNJ, nenin 7, paragrafi 1 dhe 11 paragrafi 2 për Ligjin për Gjykatat dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nenin 5 paragrafi, 2, nenin 62 paragrafi 1.1.
46. Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të eliminimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut të ankuesit dhe përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës:

Rekomandon

Gjykatën Themelore në Prishtinë

Që duke pasur parasysh faktin se aktakuza është ngritur në vitin 2012 dhe lidhur me rastin nuk ka asnjë veprim procedural për vendosjen e lëndës, të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen meritore, pa vonesë të mëtutjeshme në lidhje me rastin e z. Rrahim Bajrami (P nr. 42/15).

Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Të inicioj përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formën e parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshem kohor, më së largu deri më 11 korrik 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 6/2016 dhe nr. 120/2016

Valon Jonuzi
Fatmir Rusinovci

kundër

Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)

Raport në lidhje me kontrollet e paautorizuara të KEDS-it në prona private

- Për: Z. Aleksander Lumezi
Kryeprokuror i Shtetit
Z. George Karagutoff
Drejtor i Përgjithshëm, KEDS
Z. Blerand Stavileci
Ministër i Zhvillimit Ekonomik
Z. Enver Halimi
Zyra e Rregullatorit për Energji
- Kopje: Z. Habit Hajredini
Zyra për Qeverisje të Mirë, pranë zyrës së Kryeministrit
Znj. Lirije Kajtazi, kryetare
Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
- Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 5 dhe neni 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019.

Prishtinë, më 14 korrik 2016

Qëllimi i raportit

1. Qëllim i këtij raporti është njoftimi i Prokurorisë së Shtetit për pretendimet lidhur me kontrollet e paautorizuara në pronat private dhe hapësirat e konsumatorëve nga ana e KEDS-it, si dhe tërheqja e vëmendjes së KEDS-it, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji lidhur me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

2. Neni 16, paragrafi 5 i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton se: “[N]ëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve.”
3. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit ka përgjegjësi “[t]ë tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”

Heqja dorë nga përgjegjësia

4. Asgjë nga përmbajtja e këtij raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Avokatit të Popullit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e pushtetit rreth çështjeve lidhur me ligjin dhe praktikën e lartpërmendur ose të shqyrtojë dekretet e ngjashme ligjore për pajtueshmërinë e tyre me standardet e njohura ndërkombëtare. Avokati i Popullit i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar juridiksionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme.

Përshkrimi i rastit

5. Ky raport është bazuar në ankesa të ndara të parashtruara nga z. Valon Junuzi nga Prishtina dhe nga z. Fatmir Rusinovci nga Prishtina kundër KEDS-it lidhur me kontrollet e paautorizuara në pronat private dhe hapësirat e banimit të konsumatorëve.

Rasti i z. Valon Junuzit

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 29 janar 2016, ka pranuar ankesë nga z. Valon Junuzi kundër KEDS-it lidhur me një fushatë që KEDS-i kishte ndërmarrë në Lagjen e Universitetit në Prishtinë, për të kontrolluar pajisjet elektrike brenda hapësirave të banimit. Z. Junuzi ka pohuar se nuk ka lejuar zyrtarët e KEDS-it për të hyrë në hapësirat e banimit duke konsideruar që kjo paraqet shkelje të së drejtës së tij në privatësi. Ankuesi ka pohuar se zyrtarët e KEDS-it kanë insistuar për të marrë informata lidhur me pajisjet elektrike që z. Junuzi kishte brenda hapësirave të banimit. Z. Junuzi pohon se ai nuk i kishte lejuar zyrtarët për të hyrë brenda në hapësirat e banimit mirëpo gojarisht i kishte njoftuar ata lidhur me pajisjet elektrike shtëpiake të cilat ndodhen në banesën e tij.

Rasti i z. Fatmir Rusinovci

7. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 29 shkurt 2016 ka pranuar ankesë nga z. Fatmir Rusinovci lidhur me tentimet e zyrtarëve të KEDS-it për të hyrë në shtëpinë e ankuesit, por që nuk kishin arritur pasi që djali i tij 13 vjeçar, i cili në atë kohë ndodhej në shtëpi kishte rezistuar dhe nuk kishte lejuar futjen në shtëpi të zyrtarëve të KEDS-it. Ankuesi më tutje pohon se megjithatë, zyrtarët e KEDS-it kishin hartuar një procesverbal me numër nr. 1537690 i datës 4 shkurt 2016, i lëshuar në emër të bashkëshortes së ankuesit znj. Merita Kashtanjeva, por që sipas ankuesit të dhënat e paraqitura në procesverbal nuk janë të sakta.

Rasti i konsumatorit me shifër 13107

8. Avokati i Popullit po ashtu ka pranuar ankesë nga një qytetar nga Mitrovica i cili dëshiron që informatat personale të mos publikohen në këtë raport.⁶⁵ Ankuesi ka pohuar se zyrtarët e KEDS-it më 15 korrik 2015 e kishin kryer një kontroll të njehsorit elektrik si dhe të pajisjeve elektrike brenda shtëpisë së tij pa dhënë ndonjë sqarim konkret lidhur me qëllimin e kontrollit. Ankuesi pohon se bashkëshortja e tij kishte lejuar që zyrtarët e KEDS-it të kryejnë kontrollin e pajisjeve duke mos ditur se kjo paraqet një kontroll ta paautorizuar. Ankuesi si provë ka sjellë procesverbalin me numër nr.0662698 i datës 15 korrik 2015. Ankuesi ka pohuar se si motiv për paraqitjen e ankesës ka shërbyer reagimi publik i Avokatit të Popullit lidhur me kontrollet e paautorizuara të KEDS-it.⁶⁶

Veprimet e Avokatit të Popullit dhe bashkëpunimi me autoritete përkatëse

Më 29 janar 2016, Avokati i Popullit ka kërkuar nga KEDS-i vendosjen e masës së përkohshme me të cilën rekomandohej pezullimi i aktiviteteve të KEDS-it në kontrollimin e banesave, për shkak se kontrolli i paautorizuar i banesës mund të shkaktojë shkelje të së drejtës në privatësi.

9. Më 3 shkurt 2016, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga Z. George Karagutoff, drejtor i përgjithshëm i KEDS-it, në të cilën përshkruhet baza ligjore mbi të cilën operon KEDS-i dhe me të cilën nuk trajtohet fare kërkesa e Avokatit të Popullit për masë të përkohshme.
10. Më 10 shkurt 2016, Avokati i Popullit i është drejtuar z. Karagutoff duke i rikujtuar atij se Kërkesa e për Masë të Përkohshme do të duhej të trajtohej.
11. Më 24 shkurt 2016, z. Karagutoff është përgjigjur, në mes tjerash, se Avokati i Popullit me kërkesën e tij për masë të përkohshme i ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore pasi që ai ka të drejtë të kërkoj vetëm pezullimin e ekzekutimit të vendimeve administrative prandaj ka kërkuar që Avokati i Popullit të rishqyrtoj kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme.
12. Z. Karagutoff në të dy përgjigjet e tij, në asnjë rast nuk ka pranuar dhe në njëfarë mënyre e ka anashkaluar faktin se KEDS-i kryen kontrole brenda hapësirave të banimit por të gjithë çështjen e ka fokusuar të kontrolli i orëve matëse dhe pajisjeve që janë pronë e KEDS-it dhe se kërkesa për pezullim të kontrollimit do t'i shkaktonte dëme të jashtëzakonshme KEDS-it.
13. Në tërë korrespondencën në mes Avokatit të Popullit dhe drejtorit të përgjithshëm të KEDS-it janë kopjuar Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, mirëpo Avokati i Popullit nuk ka pranuar asnjë reagim nga këto dy institucione shtetërore.
14. Avokati i Popullit që në kontaktet e para me zyrtarët e ndryshëm të KEDS-it ka vërejtur një hezitim shqetësues nga zyrtarët e KEDS-it për të dhënë çfarëdo informate lidhur me veprimet e KEDS-it, madje është vërejtur edhe hezitim për të dhënë detaje rreth emrit, mbiemrit dhe kontaktit të drejtorit të përgjithshëm të KEDS-it, të cilat nuk gjenden as në web faqen zyrtare të KEDS-it. Detajet rreth emrit dhe kontaktit të drejtorit të përgjithshëm janë mësuar nga burimet e IAP-it, jashtë KEDS-it, pasi që sigurimi i kësaj informate brenda KEDS-it ishte i pamundur.
15. Përveç procesverbaleve të paraqitura në IAP nga vet palët, të cilat dëshmojnë se KEDS-i kryen kontrole të pajisjeve elektrike brenda hapësirave të banimit, IAP nëpërmes zyrave në terren ka mësuar se KEDS-i është duke vazhduar kontrollet e pajisjeve elektrike shtëpiake brenda hapësirave të banimit. Informatat të cilat IAP i ka marrë nga terreni janë se KEDS-i kohë pas kohe ndërmerre fushata të tilla (informatë nga rajoni i Gjakovës) dhe se për dy zyrtarë të KEDS-it në rajonin e

⁶⁵Ankuesi ka kërkuar nga IAP që të emri i tij të mos publikohet në Raport me Rekomandime. Avokati i Popullit udhëhiqet, në mes tjerash, nga parimet e konfidencialitetit (shih nenin 3, paragrafi 1 i Ligjit për Avokatin e Popullit), prandaj ka respektuar kërkesën e palës për të mos publikuar emrin dhe mbiemrin në këtë raport.

⁶⁶ <http://koha.net/?id=27&l=95985>

Gjilanit më 29 janar 2016 Prokuroria Themelore në Gjilan kishte ngritur aktakuzë për shkak të kontrollit të kundërligjshëm të shtëpisë.

16. Sa i përket procesverbaleve të cilat palët i kanë sjellë në IAP, Avokati i Popullit nuk paragjykon vërtetësinë e përmbajtjes së tyre por konsideron se lëshimi i procesverbaleve me të dhëna lidhur me pajisjet elektrike brenda hapësirave të banimit mund të paraqet një indikacion lidhur me kryerjen apo tentimin për të kryer kontrole brenda hapësirave të banimit.

Analiza e dispozitave ligjore të cilave u referohet KEDS-i

17. Avokati i Popullit ka analizuar dispozitat e ligjeve, rregullave dhe procedurave të cilave u referohet KEDS-i, në korrespondencën me Avokatin e Popullit.
18. Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike përcakton se pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Pajisja matëse paraqet pikën e lidhjes së konsumatorit në rrjetin elektrik dhe respektivisht përdoret për matjen e energjisë elektrike të shpenzuar. Sipas nenit 31 të Ligjit për Energjinë Elektrike pajisja matëse duhet të vendoset në kufirin e pronësisë apo afër tij.
19. Avokati i Popullit vëren se kjo dispozitë e Ligjit për Energjinë Elektrike nuk përcakton kontrollin e hapësirave të banimit, madje ligji në mënyrë të qartë e specifikon se pajisja matëse duhet të vendoset në kufirin e pronësisë apo afër tij. Avokati Popullit konsideron se kjo dispozitë ligjore është përcaktuar në mënyrë që të evitohet keqpërdorimi i energjisë elektrike por edhe nevoja për të hyrë në pronat e konsumatorëve.
20. Ligji Nr.03/L-184 për Energjinë, neni 28, paragrafi 1 përcakton se: *“Personat fizikë dhe juridikë do të lejojnë zyrtarët që ushtrojnë inspektime në përputhshmëri me këtë ligj, mund të hyjnë dhe të kalojnë në pronën e çfarëdo individi për ushtrimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me inspektimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve energjetike, instalimeve apo sistemeve.”*
21. Avokati i Popullit vëren se paragrafi 1 i nenit 28 i Ligjit për Energjinë nuk i jap kompetenca zyrtarëve që ushtrojnë inspektime dhe që në mënyrë arbitrare të hyjnë në pronat e konsumatorëve. Neni 28 në përgjithësi flet për pronën e konsumatorëve ku janë vendosur stabilimentet energjetike, instalimet apo sistemet e operatorit dhe nuk bëhet fjalë për hapësirat e banimit dhe pajisjet elektrike brenda këtyre hapësirave.
22. Avokati i Popullit konsideron se KEDS-i i referohet nenit 28 në mënyrë të fragmentuar, përkatësisht i referohet vetëm paragrafit 1 të nenit 28, ndërsa paragrafi 2 dhe 3 të nenit 28 i bëjnë të qarta situatat se kur dhe ku përfaqësuesit e autorizuar të ndërmarrjeve për energji mund t'i qasen pronës së konsumatorit. Për hir të korrektësisë Avokati i Popullit i citon paragrafët 2 dhe 3 të nenit 28 të Ligjit për Energji:
 2. *Personat fizikë dhe juridikë do t'u lejojnë përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve për energji qasje në pronën e tyre në të cilën gjenden stabilimentet, aparaturat, rrjetat, ose sistemet energjetike në të cilat qasja e tillë është e nevojshme, me qëllim të mirëmbajtjes apo kontrollimit të tyre, prerjes së pemëve ose vegjetacionit tjetër që mund të pengoj veprimin e stabilimenteve, aparaturës, rrjetave ose sistemit.*

3. *Personat fizikë dhe juridikë duhet t'iu lejojnë qasje përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve për energji, për inspektimin e pajisjeve për matje që gjenden në pronën e tyre, në të cilën qasja e tillë është e nevojshme, dhe nuk mund të ndalojnë përfaqësuesit e ndërmarrjeve për energji të bëjnë shkyçjen e pajisjeve për matje ose aparaturave të tjera në lidhje me sistemin e energjisë.*
23. Rregullat për Kushtet e Përgjithshme mbi Furnizimin me Energji, të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në gusht të vitit 2011, neni 20, përcakton se: *“Konsumatori është i obliguar t'iu lejojë qasje në pronën e tij përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në nenet 27, 28 dhe 29 të Ligjit për Energji.”*
24. Avokati i Popullit vëren se nenet 27, 28 dhe 29 flasin për mirëmbajtjen dhe inspektimin e stabilimenteve që janë pronë e ndërmarrjes për energji dhe që mund të gjenden në pronën e konsumatorit, dhe se nuk bëhet fjalë për pajisjet elektrike që ndodhen në hapësirat e banimit të konsumatorëve që janë pronë e konsumatorëve.
25. Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, e aprovuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), më 21 korrik 2009⁶⁷, neni 5, të cilit i referohet Drejtori i Përgjithshëm i KEDS-it, paragrafi 1, pika a), përcakton se zyrtarët e autorizuar kanë të drejtë të hyjnë në objekte të banimit në prani dhe me pëlqim të konsumatorit, ndërsa paragrafi 2 i nenit 5 përcakton se: *në rast se konsumatori refuzon të lejojë qasjen në pronën e tij.... atëherë mund të kërkohet asistencë nga organet e sigurisë për të kryer veprimin e planifikuar konform nenit 22.3 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë.*
26. Avokati i Popullit vëren se Neni 22 i Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në përgjithësi përcakton rregullat e ekzekutimit të shkyçjes dhe po ashtu vëren se është neni 22.4 ai i cili udhëzon që në rast se konsumatori refuzon të lejojë qasje në pronën e tij me qëllim të shkyqjes apo rikycjes të kërkohet asistencë nga organet e sigurisë. Avokati i Popullit thekson se çështja kryesore e komunikimit me drejtorin e përgjithshëm të KEDS-it nuk e ka pasur objekt shqyrtimi shkyçjen apo rikycjen e konsumatorëve por kontrollet eventuale të KEDS-it brenda hapësirave të banimit të konsumatorëve.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

27. Ankuesit në një rënë anë kanë pretenduar se i është shkelur e drejta e tyre e privatësisë dhe kanë paraqitur procesverbalet të cilat mund të jenë indikacion se KEDS-i ka kryer kontrolle brenda hapësirave të banimit të ankuesve. Në anën tjetër KEDS-i nuk ka pohuar nëse ka kryer kontrolle brenda hapësirave të banimit. Avokati i Popullit, duke u bazuar në deklaratat dhe pretendimet e palëve, në këtë rast ankuesve në një rënë anë dhe në anën tjetër KEDS-it si palë përgjegjëse, nuk mund të nxjerrë ndonjë konkludim konkret. Është kompetencë e prokurorive përkatëse për të kryer hetime lidhur me faktin nëse KEDS-i ka kryer dhe mënyrën se si janë kryer kontrollet nëpër pronat e konsumatorëve.
28. Në këtë situatë Avokati i Popullit rikujton se kontrollet në objektet private për dyshime të veprave penale mund të bëhen vetëm me urdhër gjyqësor nga ana e policisë, dhe atë duke respektuar Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123, përkatësisht në pajtim me nenin 105 dhe 108 të Kodit.
29. Avokati i Popullit po ashtu rikujton se kontrollet e kundërligjshme janë të sanksionuara me nenin 201, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082, i cili përcakton se:

⁶⁷ Në një komunikim që IAP ka pasur më ZRRE-në është mësuar se Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike, e aprovuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), më 21 korrik 2009, aktualisht vlen për KEDS-in sipas licencës të cilën KEDS-i e ka marrë pas privatizimit të rrjetit të distribucionit të KEK-ut.

“Personi zyrtar i cili me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij bën kontrollim të kundërligjshëm të banesës, objekteve apo personit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.”

30. Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen e KEDS-it, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Zyrës së Rregullatorit për Energji se kontrollet eventuale të paautorizuara paraqesin shkelje të së drejtës së privatësisë të garantuar me nenin 36, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:
 1. *Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës...*
 2. *Kontrollet e cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhet vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet në mënyre retroaktive.*
31. Sikur Kushtetuta e Republikës së Kosovës ashtu edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është instrument ndërkombëtar drejtpërdrejtë i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe se ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike, garanton të drejtën në respektimin e jetës private dhe familjare. Neni 8 i KEDNJ-së përcakton se:
 1. *Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*
 2. *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.*

Praktika Gjyqësore e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

32. Avokati i Popullit vëren se Gjykata Supreme ka miratuar mendimin juridik GJA-SU-A.nr.176/2014, i datës 23 prill 2014, lidhur me kontrollimin dhe kalibrimin e njësorit elektrik, kur dyshohet se është abuzuar me energjinë elektrike. Qëndrimi i Gjykatës Supreme për kontrollimin e njësorit elektrik, marrjen e tij, dërgimin në kontrollim dhe kalibrim, nuk është i nevojshëm urdhri i gjykatës. Gjykata Supreme ka miratuar mendimin juridik me kërkesë të vet KEDS-it për shkak se disa gjykata kontrollimin e njësorit nga kompetentët e KEDS-it, po e shpallin si provë e pa pranueshme. Me këtë rast Gjykata Supreme, duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 257, paragrafi 2, konsideron si provë të pa pranueshme, në mes tjerash, kontrollin e personit, shtëpisë ose lokaleve tjera i zbatuar në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale (pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, zbatimi i kontrollit në kundërshtim me urdhrin e zbatuar etj.).
33. Avokati i Popullit njëjtë sikur Gjykata Supreme konsideron se KEDS-i ka të drejtë të kontrollojë njësorët elektrik, që janë pronë e KEDS-it dhe që sipas ligjit duhet të vendosen *“në kufirin e pronësisë apo afër tij”*.

Kontrolli i banesave sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

34. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e ka bërë të qartë se për shtetet që janë palë të KEDNJ-së mund të konsiderohet si domosdoshme nevoja për të vendosur masa sikur që është kontrolli i hapësirave të banimit dhe konfiskimit në mënyrë që të sigurohen prova fizike lidhur me vepra të ndryshme penale. Përderisa masa të tilla normalisht do të mund të ndërhyjnë në të drejtat e personit, të përcaktuara me nenin 8, paragrafin 1 të KEDNJ-së, justifikimi për marrjen e masave të tilla duhet të jetë përkatës dhe i mjaftueshëm dhe jo të jetë disproporcional me arritjen e qëllimit. Për më shumë, GJEDNJ-ja kërkon arsyetim se legjislacioni përkatës dhe praktika i ofron individëve mbrojtje efektive dhe adekuate kundër keqpërdorimeve. Praktika e GJEDNJ-së përqendrohet në kërkesën së kontrolli duhet të jetë i ligjshëm dhe në pajtim me procedurën adekuate për mbrojtje nga arbitrariteti dhe keqpërdorimet. Pa marrë parasysh hapësirën e vlerësimit që ju lejohet shteteve, GJEDNJ-ja është veçanërisht vigjilente kur autoritetet autorizohen me ligj për të kryer kontrole pa autorizim gjyqësor (rasti *Camenzind v. Switzerland*, aktgjykimi i datës 16 dhjetor 1997). Sipas GJEDNJ, nëse individët duhet të mbrohen nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve në të drejtat e garantuara me nenin 8, atëherë edhe me kornizën ligjore të brendshme duhet të vendosen kufizime strikte lidhur me këtë. GJEDNJ do të marrë parasysh rrethanat e veçanta për secilin rast në mënyrë që të përcaktojë nëse në rastin konkret, ndërhyrja në fjalë ka qenë proporcionale për të arritur qëllimin.⁶⁸
35. Duke mos paragjykuar nëse KEDS-i ka kryer apo jo kontrole të paautorizuara, dhe duke pasur parasysh se ligjet e Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe ligjet dhe aktet nënligjore të cilave KEDS-i u bënë referencë, e rregullojnë çështjen e kontroleve nëpër prona private, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se çfarëdo interpretim i këtyre dispozitave në favor të kontroleve të paautorizuara të hapësirave të banimit, në rastin konkret interpretimi të cilin KEDS-i e ka paraqitur, mund të bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në rast konflikti ka përparësi ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike, si dhe do të jetë në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së, në bazë të të cilës do të interpretohen të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas nenit 53 të saj.
36. Në fund Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji në nenin 3, paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës se:

“Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektim të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”

Në bazë të kësaj që u tha më lart, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të autoriteteve, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16, paragrafi 5 dhe nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019.

Rekomandon që:

- 1. Zyra e Kryeprokurorit të Kosovës të kërkojë nga prokuroritë kompetente themelore fillimin e hetimeve ndaj zyrtareve përgjigjes të Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me***

⁶⁸ The Right to Respect for Private and Family Life, *A guide to the implementation of Article 8 of the European Convention on Human Rights*, Ursula Kilkelly, Human rights handbooks, No. 1

Energji Elektrike lidhur me kontrole të paautorizuara nëpër hapësirat e banimit dhe të pajisjeve elektrike që janë pronë e konsumatorëve.

2. Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike:

- a. të ndërpresë hyrjet e paautorizuara në banesa ose cilitdo objekti privat, për kontrollimin eventual të pajisjeve elektrike, pronë private e konsumatorëve.*
- b. të avancojë rrjetin e shpërndarjes dhe të instalimeve në atë mënyrë që të jetë në gjendje të kontrollojë humbjet e energjisë elektrike duke i evituar në tërësi kontrollet në pronat e konsumatorëve në veçanti kontrollet brenda hapësirave të banimit të konsumatorëve; dhe*
- c. në rastet kur ka dyshime për keqpërdorim apo humbje të energjisë elektrike të kërkojë nga organet kompetente fillimin e hetimeve.*

3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Zyra e Rregullatorit për Energji të mbrojnë të drejtat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, ashtu sikur që është përcaktuar me Kushtetutë, në raport me Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, e cila si kompani private ushtron një autorizim publik në Republikën e Kosovës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 15 gusht 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 113/2016

Safet Gashi

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Raport me rekomandime lidhur me mos zbatimin e vendimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Për: Z. Petrit Gashi, Kryesues dhe Drejtor
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Kopje: Z. Habit Hajredini,
Zyra për Qeverisje të Mirë, pranë Zyrës së Kryeministrit

Znj. Lirije Kajtazi, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Avokati i Popullit në Kosovë, në pajtim me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 18, paragrafi 1.2 dhe nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, publikon raportin si në vijim:

Prishtinë, më 20 korrik 2016

Qëllimi i Raportit

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin e vendimit të plotfuqishëm të lëndës me nr. PRZ004-0054, të datës 28 qershor 2011, pa vonesa të mëtutjeshme.

Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Safet Gashi (në tekstin e mëtejme ankuesi) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës në zbatimin e këtij vendimi nga AKP-ja.

Baza Ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*.

Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18 paragrafi 1.2, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e organeve përgjegjëse, dhe që shkaktojnë shkelje të të drejtave të njeriut”*.

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokati i Popullit (IAP), të paraqitura nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Më 20 shkurt 2006 *ankuesi*, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar kompensimin për miellin dhe grurin e dorëzuar në NSH IMBB “Sillosi” në Xërxë.
2. Më 27 prill 2011 Komiteti i Likuidimit (KL) i NSH IMBB “Sillosi”, ndërmarrje në likuidim dhe *ankuesi*, nënshkruan marrëveshje mbi zëvendësimin e detyrimeve, përkatësisht për kryerjen e pagesës së mjeteve monetare, si kundërvlerë për grurin dhe miellin e dorëzuar. Sipas marrëveshjeve pagesa e mjeteve do të bëhej në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/48, mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre, me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.
3. KL për NSH IMBB “Sillosi”, i emëruar në bazë të nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 mbi Organizatat Tregtare dhe neni 9.2 të Ligjit nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), më 28 qershor 2011, nxjerrë vendimin nr. PRZ004-0054, me të cilat miratoi në tërësi kërkesën e *ankuesit*, për kompensimin e shumës në të holla, në kundërvlerë të grurit-miellit, në shumën e paraparë me marrëveshjet e nënshkuara më 27 prill 2011, përkatësisht, në shumë prej 4, 924.40 € (katërmijë e nëntëqind e njëzet e katër euro e dyzet centë).
4. *Ankuesi*, me rastin e parashtrimit të ankesës në IAP ka pohuar se me gjithë marrëveshjet dhe vendimin e lëshuar nga AKP-ja, ai vendim ende nuk është zbatuar, dhe çështja vazhdon të mbetet e pashqyrtuar nga kjo agjenci. Këtë çështje ankuesi e ka parashtruar në IAP, qysh në vitin 2012.
5. Lidhur me çështjen e *ankuesit*, më 8 nëntor 2012, përfaqësuesja e IAP-së, përmes postës elektronike kërkoi informata nga kryesuesi i zyrës rajonale të AKP-së në Prizren. Ai kishte informuar se shpërndarja e mjeteve të NSH-së në likuidim nuk mund të bëhet edhe për një kohë, për shkak të amandamentimit të Ligjit për AKP-në.
6. Më 3 dhjetor 2012, *ankuesi* ishte në zyrën e IAP në Prizren dhe shprehu shqetësimin, lidhur me faktin se shpërndarja e mjeteve ende nuk kishte filluar dhe se nuk dihej as kur do të fillonte. Ai me këtë rast u njoftua me veprimet e ndërmarra nga IAP.

7. Më 3 dhjetor 2012, përfaqësuesja e IAP-së, ka kërkuar informata nga Departamenti i Likuidimit të AKP-së në Prishtinë, lidhur me çështjen e *Ankuesit*. Departamenti i Likuidimit përmes postës elektronike është përgjigjur më 10 janar 2013, se janë duke shqyrtuar ankesat e mbetura nga NSH “Sillosi” dhe se procesi i shqyrtimit të tyre mund të zgjasë nëse palët ankohen në dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjithashtu, është theksuar se procesi ka zgjatur për shkak të ndryshimit të Ligjit për AKP-në, si dhe të formimit të komisionit të ri për likuidim.
8. Më 10 prill 2013 dhe 20 qershor 2013, përfaqësuesja e IAP-së, kërkoi informata nga AKP, lidhur me atë se çfarë veprime janë ndërmarrë në zgjidhjen e çështjes, mirëpo nuk mori përgjigje.
9. Më 4 korrik 2013, Avokati i Popullit i dërgoi letër drejtorit, të Departamentit për koordinim të Likuidimit në AKP, z. Muharrem Arifi, përmes së cilës kërkoi informata, lidhur me veprimet e ndërmarra apo ato që planifikoheshin të ndërmerren nga gjykata, për rastin e *ankuesit*.
10. Më 6 gusht 2013, Avokati i Popullit, mori përgjigje nga drejtori i Departamentit për Koordinim të Likuidimit z. Muharrem Arifi, në të cilën thekson se Bordi i AKP-së, në përbërjen e vet e ka të mangët për një anëtar ndërkombëtar, e cila tashmë ka kohë që ka dhënë dorëheqje dhe Autoriteti i Likuidimit nuk mund të kërkojë aprovim nga bordi i drejtorëve të agjencisë shpërndarjen e fondit të likuidimit kreditorëve, pasi pagesat të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15 të Ligjit për agjencinë kufizohen me ekzistencën e tre anëtarëve ndërkombëtarë në përbërjen e bordit.
11. Më 9 shkurt 2016, *ankuesi* përsëri parashtroi ankesë në IAP, duke informuar se ende nuk është ekzekutuar vendimi i plotfuqishëm nr. PRZ004-0054, i nxjerrë nga AKP-ja më 28 qershor 2011.
12. Me 17 dhjetor 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin nr. 05-V-213, i emëroi 8 anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
13. Më 30 dhjetor 2015, është mbajtur mbledhja e konstituimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me kryesues/kryetar z. Petrit Gashi (*komunikata për media e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më 30 dhjetor 2015*).

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm/E drejta për një proces të rregullt

14. Parimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 paragrafi 2. thekson: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të parashikuara me këtë Kushtetutë*”.
15. Vend të posaçëm në mesin e këtyre të drejtave, sipas kuptimit të nenit 31, paragrafi 1 të Kushtetutës, zë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ku përcakton: “*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*” Ndërsa, paragrafi 3 i të njëjtit nen thekson. “*Çdo kush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj*”.
16. Neni 54, Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
17. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut është dokument ndërkombëtar, i cili në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është i zbatueshëm drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave ligjore dhe

akteve të tjera të institucioneve publike. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6, i KEDNJ, garanton që: “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm”.

18. Neni 13 i KEDNJ-së, përcakton të drejtën për zgjidhje efektive sipas së cilës: “Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara më këtë Konventë, ka të drejtën për mjete ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga ana e personave që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Nr. 04/L-034

19. Neni 1, paragrafi 1e Ligjit për AKP-në përcakton: “AKP është organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj”.
20. Sipas nenit 1 paragrafi 2 “Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores s- UNMIK-ut 2002/12, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë”.
21. Sipas nenit, 2 paragrafi 1 me kushtet e përcaktuara në këtë ligj: “Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara në këtë ligj”.
22. Sipas nenit 2, paragrafi 2, pika 2 Agjencia “Shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme”.
23. Paragrafi 2 i nenit 2 pika 4 i këtij ligji përcakton shprehimisht obligimin e Agjencisë kundrejt kreditorëve: “Përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asete të caktuar, nga mjetet e realizuar nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit”.
24. Paragrafi 3. i nenit 2 të këtij ligji përcakton: “Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj”.
25. Neni 9, paragrafi 1 i këtij ligji thotë: “Bordi mund të iniciojë likuidimin e një ndërmarrje, korporate, aseti ose një pjese të saj, përmes lëshimit të vendimit për Likuidim nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurave të përcaktuara të parapara në shtojcën 1 të këtij ligji”.
26. Neni 9, paragrafi 2 i këtij ligji thotë: “Të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjes që i nënshtrohet Vendimit të Likuidimit, i dorëzohen autoritetit përkatës të likuidimit të themeluar në bazë të shtojcës 1 të këtij ligji”.
27. Neni 9, paragrafi 3 i këtij ligji parasheh: “Secili autoritet i likuidimit është pjesë integrale e Agjencisë. Të gjitha veprimet apo mosveprimet e autoritetit të likuidimit janë veprime dhe mosveprime të Agjencisë. Secili person që punon, apo është i angazhuar apo i emëruar të ndihmojë autoritetin e likuidimit është person i punësuar apo angazhuar nga Agjencia sipas kuptimit të nenit 18. 5 të këtij ligji”.

Analiza ligjore e rastit

Lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për një proces të rregullt

28. Duke pasur parasysh ankesën e parashtruesit, lidhur me dështimin e AKP-së për të vendosur në rastin e tij, Avokati i Popullit, bazuar në analizën e dëshmimeve dhe fakteve, vëren se e drejta për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për mjete efektive, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, nuk është përmbushur, pasi AKP-ja, ka zvarritur ekzekutimin e lëndës së ankuesit për më shumë se 10 vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2006, dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti, se zvarritje të tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një zbatim të vendimit përkatës të nxjerrë nga AKP-ja, janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
29. Avokati i Popullit vëren se nga viti 2006, kur *ankuesi*, ka parashtruar kërkesë për kompensimin për mallra dhe shërbime, kanë kaluar mbi 10 vite, dhe atij ende nuk i është realizuar e drejta në bazë të kërkesës së parashtruar.
30. Avokati i Popullit vëren se nga viti 2011, kur është nënshkruar marrëveshja në mes të KL të NSH IMBB "Sillosi" në likuidim dhe ankuesit bujk nga Rahoveci, për zëvendësimin e detyrimeve, kanë kaluar 5 vite dhe ende nuk u është dhënë mundësia e realizimit të drejtës së tyre në pajtim me marrëveshjen e nënshkruar, pasi lënda e tij, mbetet ende në procedurë të AKP-së, e cila nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret që rasti të mbyllet në përputhje me ligjet në fuqi.
31. Avokati i Popullit konsideron se është shqetësues fakti se nga data 28 qershor 2011, kur KL të IMBB "Sillosi" në likuidim ka nxjerrë vendimin nr. PRZ004-0054 në të mirë të *ankuesit*, kanë kaluar 5 vite dhe atij, ende nuk i është mundësuar realizimi i të drejtës në bazë të këtij vendimi të nxjerrë nga AKP-ja, për pagesën e shumës së të hollave në kundërvlerë të mallit të dorëzuar. Për më tepër edhe sot nuk vërehet ndonjë përpjekje e gjykatës që procedurën ta përfundojë, në përputhje me ligjet në fuqi.
32. Deri në ditën e hartimit të këtij raporti, nuk është zbatuar vendimi i AKP-së, nga autoritetet përgjegjëse të obliguara për zbatimin e tyre, me gjithë faktin se zbatimi i tyre është deshtë të kryhet me kohë dhe në afatin e caktuar ligjor.
33. Sa i përket qartësisht të pozicionit dhe juridiksionit të AKP, Avokati i Popullit konsideron se, AKP është organ i pavarur publik, i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (shih nenin 142 të Kushtetutës). Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion, lidhur me çështjet nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse statusi i të cilave është i rregulluar me ligj.
34. Avokati i Popullit përkujton se neni 6 par. 1 të KEDNJ, nuk parashikon ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës. Në rastin konkret AKP nuk mund të përdorë si justifikim ndryshimin e ligjit për AKP-në ose ndërrimin dhe mosfunksionimin e bordit të anëtareve të AKP-së.
35. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 6 të KEDNJ, sipas së cilës çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj (...). Në këtë rast dështimi në zbatimin e vendimit të formës së prerë për lëndën PRZ004-0054, përbën shkelje të këtij neni.

36. Avokati i Popullit konsideron se është shqetësues fakti se një procedurë gjyqësore 10 vjeçare, si në rastin e *ankuesit* do të krijonte një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, do të zvogëlonte dhe humbiste besimin e qytetarëve në drejtësi dhe shtetin ligjor.
37. Avokati i Popullit konstaton se moszbatimi i vendimeve të formës së prerë të nxjerra nga autoriteti i likuidimit të AKP-së dhe të pazbatuara, paraqet shkelje të të drejtave të njeriut të *ankuesit*, të garantuara me nenin 3.2, barazia para ligjit, nenin 54, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
38. Në të vërtetë, mungesës së mjetit efektiv juridik, në kuptim të shkeljes së të drejtës së tij për shqyrtim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohor, që garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, përbën shkelje edhe të drejtës së tij për mjet efektiv juridik në bazë të nenit 13 të KEDNJ-së.
39. Neni 13 i KEDNJ-së, duke theksuar në mënyrë të veçantë obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojtë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo të gëzojë këto të drejta, në mënyrë efektive.
40. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i *ankuesit*, ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës në zbatimin e vendimit, neni 13 i KEDNJ-së është i zbatueshëm.
41. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk u është vënë në dispozicion *ankuesit*, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës, në zbatimin e vendimit me parashikimin apo shpresën për të arritur çfarëdo lehtësimi, në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar nga AKP-ja.
42. Nga 30 dhjetori 2015, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është funksional.
43. Avokati i Popullit, në cilësinë e rekomanduesit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, qëllimin e mirë për përmirësimin e punës dhe rritjen e shkallës së ligjshmërisë për zbatimin e vendimeve të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, bazuar në gjithë atë që u tha më sipër, si dhe në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “ [...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”; si dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla...*”, e vlerëson të arsyeshëm këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të drejtës së shkelur të *ankuesit*.

REKOMANDON

Agjencinë Kosovare të Privatizimit

- 1. Për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e vendimit të formës së prerë në lëndën, nr. PRZ004-005, të datës 28 qershor 2011, të ankuesit z. Safet Gashi.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren AKP-ja, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 16 gusht 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 114/2016

Zeqir Morina

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Raport me rekomandime lidhur me mos zbatimin e vendimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Për: Z. Petrit Gashi, Kryesues dhe Drejtor
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Kopje: Z. Habit Hajredini,
Zyra për Qeverisje të Mirë, pranë Zyrës së Kryeministrit

Znj. Lirije Kajtazi, kryetare
Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Avokati i Popullit në Kosovë, në pajtim me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 18, paragrafi 1.2 dhe nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, publikon raportin si në vijim:

Prishtinë, më 20 korrik 2016

Qëllimi i Raportit

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin e vendimit të plotfuqishëm të lëndës me nr. PRZ004-0042, të datës 28 qershor 2011, pa vonesa të mëtutjeshme.

Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Zeqir Morina (në tekstin e mëtejme ankuesi) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës në zbatimin e këtij vendimi.

Baza Ligjore

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*.

Poashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18 paragrafi 1.2, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e organeve përgjegjëse, dhe që shkaktojnë shkelje të të drejtave të njeriut”*.

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokati i Popullit (IAP), të paraqitura nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Më 20 shkurt 2006 *ankuesi*, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar kompensimin për miellin dhe grurin e dorëzuar në NSH IMBB “Sillosi” në Xërxë.
2. Më 27 prill 2011 Komiteti i Likuidimit (KL) i NSH IMBB “Sillosi”, ndërmarrje në likuidim dhe *ankuesi*, nënshkruan marrëveshje mbi zëvendësimin e detyrimeve, përkatësisht për kryerjen e pagesës së mjeteve monetare, si kundërvlerë për grurin dhe miellin e dorëzuar. Sipas marrëveshjeve pagesa e mjeteve do të bëhej në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/48, mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre, me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.
3. KL për NSH IMBB “Sillosi”, i emëruar në bazë të nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 mbi Organizatat Tregtare dhe neni 9.2 të Ligjit nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), më 28 qershor 2011, nxjerrë vendimin nr. PRZ004-0054, me të cilin miratoi në tërësi kërkesën e *ankuesit*, për kompensimin e shumës në të holla, në kundërvlerë të grurit-miellit, në shumën e paraparë me marrëveshjet e nënshkruara më 27 prill 2011, përkatësisht, në shumë prej 2, 633.30 € (dymijë e gjashtëqind e tridhjetë e tri euro e tridhjetë centë).
4. *Ankuesi*, me rastin e parashtrimit të ankesës në IAP ka pohuar se me gjithë marrëveshjet dhe vendimin e lëshuar nga AKP-ja, ai vendim ende nuk është zbatuar, dhe çështja e tij vazhdon të mbetet e pashqyrtuar nga kjo agjenci. Këtë çështje ankuesi e ka parashtruar në IAP, në vitin 2012.
5. Më 3 dhjetor 2012, përfaqësuesja e IAP-së, ka kërkuar informata nga Departamenti i Likuidimit të AKP-së në Prishtinë, lidhur me çështjen e *ankuesit*. Departamenti i Likuidimit përmes postës elektronike është përgjigjur më 10 janar 2013, se janë duke shqyrtuar ankesat e mbetura nga NSH “Sillosi” dhe se procesi i shqyrtimit të tyre mund të zgjasë nëse palët ankohen në dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjithashtu, është theksuar se procesi ka zgjatur për shkak të ndryshimit të Ligjit për AKP-në, si dhe të formimit të komisionit të ri për likuidim.

6. Më 4 janar 2013, Avokati i Popullit i dërgoi letër drejtorit, të Departamentit për koordinim të Likuidimit në AKP, z. Muharrem Arifi, përmes së cilës kërkoi informata, lidhur me veprimet e ndërmarra apo ato që planifikoheshin të ndërmerren nga AKP-ja, për rastin e *ankuesit*.
7. Me 18 janar 2013, *ankuesi* është paraqitur në IAP, për t'u informuar në lidhje me rastin e tij, i cili është njoftuar për veprimet e ndërmarra nga IAP.
8. Më 22 janar 2013, Avokati i Popullit, mori përgjigje nga drejtori i Departamentit për Koordinim të Likuidimit z. Muharrem Arifi, në të cilën thekson se Bordi i AKP-së, në përbërjen e vet është i mangët për një anëtar ndërkombëtar, e cila tashmë ka kohë që ka dhënë dorëheqje dhe Autoriteti i Likuidimit nuk mund të kërkojë aprovim nga Bordi i Drejtorëve të agjencisë shpërndarjen e fondit të likuidimit kreditorëve, pasi pagesat të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15 të ligjit për Agjencinë kufizohen me ekzistencën e tre anëtarëve ndërkombëtarë në përbërjen e bordit.
9. Me 6 shkurt, 19 shkurt dhe 5 mars 2013, *ankuesi* ishte në IAP dhe shprehu shqetësimin, lidhur me faktin se shpërndarja e mjeteve nuk kishte filluar dhe se nuk dihej as kur do të fillonte. Ai me këtë rast u njoftua me veprimet e ndërmarra nga IAP.
10. Më 10 prill, 24 maj dhe 20 qershor 2013, lidhur me çështjen e *ankuesit* përfaqësueja e IAP-së, ka kërkuar informata nga Departamenti i Likuidimit të AKP-së në Prishtinë, por nuk ka pranuar përgjigje.
11. Më 9 shkurt 2016, *ankuesi* përsëri ka parashtruar ankesë në IAP, për zvarritje të procedurës lidhur me moszbatimin e vendimit të plotëfuqishëm nr.PRZ004-0042, nga AKP-ja.
12. Më 17 dhjetor 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 05-V-213, i emëroi 8 anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
13. Më 30 dhjetor 2015, është mbajtur mbledhja e konstituimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me kryesues/kryetar z. Petrit Gashi (*komunikata per media e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më 30 dhjetor 2015.*)

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm/e drejta për një proces të rregullt

14. Parimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 paragrafi 2. thekson: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të parashikuara me këtë Kushtetutë*”.
15. Vend të posaçëm në mesin e këtyre të drejtave, sipas kuptimit të nenit 31, paragrafi 1 të Kushtetutës, zë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ku përcakton: “*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedure para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*” Ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen thekson. “*Çdo kush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj*”.
16. Neni 54, Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave, i Kushtetutës së Kosovës, përcakton: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
17. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut është dokument ndërkombëtar, i cili në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është i zbatueshëm drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave ligjore dhe

akteve të tjera të institucioneve publike. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6, i KEDNJ, garanton që: “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm”.

18. Neni 13, i KEDNJ-së, përcakton të drejtën për zgjidhje efektive sipas së cilës: “Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara më këtë Konventë, ka të drejtën për mjete ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga ana e personave që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Nr. 04/L-034

19. Neni 1, paragrafi 1e Ligjit për AKP-në përcakton: “AKP është organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj”.
20. Sipas nenit 1 paragrafi 2 “Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullore s- UNMIK-ut 2002/12, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë”.
21. Sipas nenit, 2 paragrafi 1 me kushtet e përcaktuara në këtë ligj: “Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj”.
22. Sipas nenit 2, paragrafi 2, pika 2 Agjencia “Shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme”.
23. Paragrafi 2 i nenit 2 pika 4 i këtij ligji përcakton shprehimisht obligimin e Agjencisë kundrejt kreditorëve: “Përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asete të caktuar, nga mjetet e realizuar nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit”.
24. Paragrafi 3. i nenit 2 të këtij ligji përcakton: “Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj”.
25. Neni 9, paragrafi 1 i këtij ligji thotë: “Bordi mund të iniciojë likuidimin e një ndërmarrje, korporate, aseti ose një pjese të saj, përmes lëshimit të vendimit për Likuidim nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurave të përcaktuara të parapara në shtojcën 1 të këtij ligji”.
26. Neni 9, paragrafi 2 i këtij ligji thotë: “Të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjes që i nënshtrohet Vendimit të Likuidimit, i dorëzohen autoritetit përkatës të likuidimit të themeluar në bazë të shtojcës 1 të këtij ligji”.
27. Neni 9, paragrafi 3 i këtij ligji parasheh: “Secili autoritet i likuidimit është pjesë integrale e Agjencisë. Të gjitha veprimet apo mosveprimet e autoritetit të likuidimit janë veprime dhe mosveprime të Agjencisë. Secili person që punon, apo është i angazhuar apo i emëruar të ndihmojë autoritetin e likuidimit është person i punësuar apo angazhuar nga Agjencia sipas kuptimit të nenit 18. 5 të këtij ligji”.

Analiza ligjore e rastit

Lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për një proces të rregullt

28. Duke pasur parasysh ankesën e parashtruesit lidhur me dështimin e AKP-së për të vendosur në rastin e tij, Avokati i Popullit, bazuar në analizën e dëshmimeve dhe fakteve, vëren se e drejta për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për mjete efektive, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, nuk është përmbushur, pasi AKP-ja, ka zvarritur ekzekutimin e lëndës së ankuesit për më shumë se 10 vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2006 dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti, se zvarritje të tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një zbatim të vendimit gjyqësor janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
29. Avokati i Popullit vëren se nga viti 2006, kur *ankuesi*, ka parashtruar kërkesë për kompensimin për mallra dhe shërbime nga AKP-ja, kanë kaluar mbi 10 vite, dhe atij ende nuk i është realizuar e drejta në bazë të kërkesës së parashtruar.
30. Avokati i Popullit vëren se nga viti 2011, kur është nënshkruar marrëveshja në mes të KL të NSH IMBB "Sillosi" në likuidim dhe ankuesit bujk nga Rahoveci, për zëvendësimin e detyrimeve, kanë kaluar 5 vite dhe ende nuk u është dhënë mundësia e realizimit të drejtës së tyre në pajtim me marrëveshjen e nënshkruar, pasi lënda e tij, mbetet ende në procedurë të AKP-së, e cila nuk ka ndër marrë asnjë veprim konkret që rasti të mbyllet në përputhje me ligjet në fuqi.
31. Avokati i Popullit konsideron se është shqetësues fakti se nga data 28 qershor 2011, kur KL të IMBB "Sillosi" në likuidim ka nxjerrë vendimin nr. PRZ004-0054 në të mirë të *ankuesit*, kanë kaluar 5 vite dhe atij, ende nuk i është mundësuar realizimi i të drejtës në bazë të këtij vendimi të nxjerrë nga AKP-ja, për pagesën e shumës së të hollave. Për më tepër edhe sot nuk vërehet ndonjë përpjekje e gjykatës që procedurën ta përfundojë, në përputhje me ligjet në fuqi.
32. Deri në ditën e hartimit të këtij raporti, më 15 mars 2016, nuk është zbatuar vendimi i AKP-së, nga autoritetet përgjegjëse të obliguara për zbatimin e tyre, me gjithë faktin se zbatimi i tyre është deshtë të kryhet me kohë dhe në afatin e caktuar ligjor.
33. Sa i përket qartësisht të pozicionit dhe juridiksionit të AKP, Avokati i Popullit konsideron se, AKP është organ i pavarur publik, i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 04/L-034, dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (shih nenin 142 të Kushtetutës). Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion, lidhur me çështjet nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse statusi i të cilave është i rregulluar me ligj.
34. Avokati i Popullit përkujton se neni 6 para. 1 të KEDNJ-së, nuk parashikon ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës. Në rastin konkret AKP nuk mund të përdorë si justifikim ndryshimin e ligjit për AKP ose ndërrimin e bordit të anëtareve të AKP-së.
35. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 6 të KEDNJ-së, sipas së cilës çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj (...). Në këtë rast dështimi në zbatimin e vendimit të formës së prerë për lëndën PRZ004-0054, përbën shkelje të këtij neni.

36. Avokati i Popullit konsideron se është shqetësues fakti se një procedurë gjyqësore 10 vjeçare, si në rastin e *ankuesit* do të krijonte një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, do të zvogëlonte dhe humbiste besimin e qytetarëve në drejtësi dhe shtetin ligjor.
37. Avokati i Popullit konstaton se moszbatimi i vendimeve të formës së prerë të nxjerra nga autoriteti i likuidimit të AKP-së dhe të pazbatuara, paraqet shkelje të të drejtave të njeriut të *ankuesit*, të garantuara me nenin 3.2, barazia para ligjit, nenin 54, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
38. Në të vërtetë, mungesës së mjetit efektiv juridik, në kuptim të shkeljes së të drejtës së tij për shqyrtim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohor, që garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, përbën shkelje edhe të drejtës së tij për mjet efektiv juridik në bazë të nenit 13 të KEDNJ-së.
39. Neni 13 i KEDNJ, duke theksuar në mënyrë të veçantë obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo të gëzojë këto të drejta, në mënyrë efektive.
40. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ-së. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i *ankuesit*, ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës në zbatimin e vendimit, neni 13 i KEDNJ-së është i zbatueshëm.
41. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk u është vënë në dispozicion *ankuesit*, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës, në zbatimin e vendimit me parashikimin apo shpresën për të arritur çfarëdo lehtësimi, në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar nga AKP-ja.
42. Nga 30 dhjetori 2015, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është funksional.
43. Avokati i Popullit, në cilësinë e rekomanduesit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, qëllimin e mirë për përmirësimin e punës dhe rritjen e shkallës së ligjshmërisë për zbatimin e vendimeve të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, bazuar në gjithë atë që u tha më sipër, si dhe në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “ [...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”; si dhe nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla...*”, e vlerëson të arsyeshëm këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të drejtës së shkelur të *ankuesit*.

REKOMANDON

Agjencinë Kosovare të Privatizimit

- 1. Për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e vendimit të formës së prerë në lëndën, nr. PRZ004-005, të datës 28 qershor 2011, të ankuesit z. Zeqir Morina.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren AKP-ja, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 16 gusht 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 303/2015

SLLAVICA GJORGJEVIQ

Raport lidhur me mos përmbarimit të Aktgjykimi të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren

Për: Z. Ymer Hoxha, Kryetar
Gjykata Themelore në Prizren

Z. Nehat Idrizi - Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Z. Zef Prendndrecaj, Drejtor
Zyra e Prokurorit Disiplinor

Prishtinë, 12 gusht 2016

PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

Faktet që janë konstatuar deri më tani mund të paraqiten si më poshtë:

1. Me aktvendimin mbi bartjen e të drejtave të shfrytëzimit të tokës për ndërtim të Komunës së Prizrenit nr.03/3463-138, të datës 30.03.1993, znj. Sllavica Gjorgjeviq (në tekstin e mëtejme ankuesja) ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të ngastrës nr.65c, pjesë e parcelës kadastrale. br.7140/1, me sipërfaqe prej 180 m2. Në bazë të Aktvendimit për lejen e ndërtimit të dhënë nga Komuna nr.04/4-351-233 të datës 08.11.1993, si dhe dokumenteve teknike të investimit për ngastrën në fjalë nr.65C, ankuesja gjatë vitit 1997 e ka filluar ndërtimin e një objekti banimi.
2. Më 28.8.1999, për shkak të të luftës në Kosovë ankuesja u largohua nga Prizreni. Sipas pohimeve të ankueses, fqinji i saj i parë e ka uzurpuar ngastrën në fjalë në mënyrë të paligjshme, në të cilën tashmë e kishte filluar edhe ndërtimin. Personi në fjalë, i cili e ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme pronën e ankueses, në ndërtimin tashmë të filluar ka ndërtuar katin për dheshë dhe katin e parë, edhe pse ai e dinte që po ndërtonte në tokën e tjetrit dhe pa lejen e pronarit.
3. Më 30.4.2005, ankuesja iu drejtuar Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD), e cila mori vendim, në të cilin theksohet që ankueses t'i kthehet posedimi në ngastrën e kontestuar, kurse të paditurit i është dhënë urdhri që ngastrën e njëjtë ta lirojë në afat prej 30 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij urdhri dhe ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Më 16.12.2005 vendimi i HPD mori formë të prerë.
4. Më 21.7.2005, ankuesja parashtrroi padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit (tani Gjykata Themelore në Prizren) kundër të paditurit, i cili në mënyrë kundërligjore ka hyrë në pronën e saj të patundshme (në tekstin e mëtejme: i padituri) për shkak të ndërtimit në ngastrën e huaj.
5. Më 25.2.2008, ankuesja ka parashtruar në Prokurorinë Publike në Prizren një padi penale kundër të paditurit për veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme. Më pas, më 18.4.2012, në bazë të kërkesës së përsëritur të ankueses sërisht është hapur lënda e re (PNR-472/12-IV), sepse ankuesja ishte informuar se lënda e mëparshme ka "humbur". Pas një kohe, në shkrimoren e Prokurorisë Publike ankuesja përsëri ka marrë informatën se një lëndë e tillë nuk ekziston në këtë prokurori. Lidhur me këtë ankuesja i është drejtuar Prokurorisë Publike në Prizren dhe e ka informuar për situatën e lartpërmendur. Kryeprokurori publik në Prizren mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur përsëri ka urdhëruar formimin e një lënde të re (tani NR-698/12 të datës 11.09.2012.). Mirëpo, që nga ajo ditë, ankuesja nuk ka marrë asnjë informacion në lidhje me këtë lëndë.
6. Më 2.6.2009, ankuesja i dërgoi Gjykatës Komunale në Prizren propozimin që të nxjerrë masë të përkohshme të ndalimit të ndërtimit në ngastrën e huaj. Gjykata kurrë nuk veprroi sipas kësaj kërkesë.
7. Më 22.10.2009, Gjykata Komunale në Prizren nxori aktvendim, me të cilin refuzohet padia e ankueses si e palejueshme. Në realitet, gjykata gjatë seancës, të njëjtën ditë e ka shqyrtuar vendimin e HPD-së, të datës 30.4.2005, nga e cila rrjedh se në rastin konkret, për këtë çështje kontestuese midis palëve është vendosur me vendim të Komisionit për marrëdhënie pronësore dhe banesore (HPCC) dhe gjykata është e obliguar që vendimet e këtij komisioni t'i marrë si obligative dhe të njëjtat nuk mund të shqyrtohen përsëri në këtë kontest gjyqësor. Në bazë të nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut, 1999/23 për Themelimin e Administratës dhe Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për çështje banesore dhe pronësore, është përjashtuar juridiksioni i kësaj Gjykate për të vendosur në këtë çështje.

8. Në 30.4.2010, ankuesja paraqiti një kërkesë në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit – inspeksionit të ndërtimit për të dalë në vendin e ngjarjes, me qëllim që inspeksioni t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore dhe për të ndaluar punët e mëtejme ndërtimore në pronën e saj.
9. Më 9.8.2010, ankuesja mori përgjigje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit, sipas të cilës janë marrë të gjitha masat lidhur me këtë rast, duke mos specifikuar ndonjë masë konkrete, të cilën e kanë ndërmarrë.
10. Pas parashtrimit të ankesës së ankueses në organet e shkallës së dytë kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr 422/05, të datës 22.10. 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren e shfuqizon vendimin e atakuar dhe lënda i kthehet Gjykatës Komunale në Prizren për shqyrtim.
11. Më 29.9.2010, në përputhje me urdhrin e Gjykatës së Qarkut, ankuesja iu drejtua Gjykatës Komunale në Prizren për shkak të precizimit të kërkesë-padisë.
12. Më 20.12.2010, Gjykata Komunale në Prizren mori aktvendim, me të cilin i obligon ekspertët të bëjnë matjen e parcelës së kontestuar dhe t'ia dërgojnë raportin kësaj gjykate brenda afatit ligjor. Gjithashtu, gjykatësi i lëndës e obligoi ankuesen që brenda një afati të caktuar Gjykatës Komunale në Prizren t'ia dorëzojnë dëshminë e certifikatës së pronësisë apo listën poseduese për ngastrën e kontestuar.
13. Më 31.5.2011, gjykatësi i rastit parashtroi një kërkesë me shkrim që EULEX-i ta marrë në punë këtë rast, në bazë të konstatimit se ka të bëjë palë të nacionaliteteve të ndryshme, po ashtu për shkak të ndërlikueshmërisë dhe vetë natyrës së lëndës në fjalë.
14. Me vendim të datës 7.7.2011, kërkesa e lartpërmendur e gjyqtarit të lëndës është pranuar dhe rasti u është ndarë gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Pejë, meqë gjyqtarët e EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prizren kryesonin në këtë rast në shkallën e dytë. Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it caktoi një seancë me kërkesë të gjyqtarit të lëndës të Gjykatës Komunale në Prizren.
15. Më 10.10.2011, në seancën kryesore Gjykata e Qarkut në Pejë mori vendim mbi vlerën lëndës në kontest, e urdhëroi ankuesen ta korrigjojë kërkesën në aspektin e numrit të parcelës kontestuese, dhe e obligoi të paditurin të paraqesë një përgjigje me shkrim lidhur me zgjerimin e kërkesës së ankueses.
16. Ankuesja dhe i padituri në mënyrë të përsëritur gjatë vitit 2011 i kanë dorëzuar Gjykatës Komunale në Prizren plotësim të padisë dhe përgjigje në të.
17. Më 21.12.2011, Gjykata Komunale në Prizren nxori aktgjykim, me të cilin e urdhëron të paditurin ta kthejë tokën në gjendjen e mëparshme dhe për këtë qëllim t'i pezullojë të gjitha punët që janë bërë në mënyrë arbitrare në ngastrën që është në pronësi të ankueses, përkatësisht ta largojë objektin e ndërtuar pa dijeninë dhe pëlqimin e ankueses, në afat prej 30 ditësh, nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi.
18. Më 30.1.2012, i padituri parashtroi ankesë në shkallën e dytë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren të datës 21.12.2011 (P.br.462/10). Në lidhje me këtë, më 29.2.2012, brenda afatit ligjor, i autorizuari i ankueses ia dorëzoi gjykatës një përgjigje në pretendimet e ankesës së të paditurit.

19. Më 18.5.2012, Gjykata e Qarkut në Prizren në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it, vendosi që ankesa e të paditurit (Ac.no.114/12) të refuzohet si e pabazuar dhe të konfirmohet aktgjykimi i marrë më parë i Gjykatës Komunale në Prizren, duke e arsyetuar vendimin e vet.
20. Gjykata theksoi rëndësinë e interpretimit të nenit 25 të Ligjit mbi Bazat e marrëdhënieve juridiko pronësore Nr.6/80-FOIA (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr.6/80), veçanërisht në kontekstin e legjitimitetit aktiv. Në këtë drejtim, është dëshmuar që ankuesja ka të drejtën e shfrytëzimit të tokës dhe të drejtën për të ndërtuar shtëpi në të njëjtën tokë, ndërsa sipas aktvendimit të Komunës së Prizrenit nr. 04/4, të datës 08.11.1993, theksohet se ankuesja "ka paguar në mënyrë të rregullt tarifën e konfirmuar për shfrytëzimin e tokës për ndërtim." Gjithashtu, është theksuar që këto rregulla duhet të shikohen në perspektivën kohore të vitit 1990, sepse në atë kohë, toka publike është dhënë vetëm për shfrytëzim dhe me të drejtën e ndërtimit, pa fitimin e pronësisë. Prandaj, kjo do të thotë që pozicioni ligjor i ankueses është madje edhe më i fuqishëm se sa pozicioni i pronarit, sepse përveç kësaj ankuesja kishte të drejtë edhe të ndërtojë shtëpi në tokën e kontestuar. Gjykata e Qarkut konkludoi se ankuesja është e mbrojtur në të njëjtën mënyrë si edhe "pronari", kurse person me të drejtën e shfrytëzimit të tokës dhe të drejtën për ndërtimin e shtëpisë duhet të jetë i mbrojtur nga sekuestrimi i paligjshëm.
21. Më 6.6.2012 i padituri paraqiti një propozim për rishikim në Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 3.7.2012 ankuesja ia paraqiti Gjykatës Komunale në Prizren një propozim për përmbarimin e aktgjykimit, për shkak se i padituri deri në atë kohë nuk i kishte përmbushur detyrimet e tij të përcaktuara sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të lartpërmendura, brenda afatit i cili i është caktuar.
23. Më 8.10.2012 ankuesja ia dërgoi një kërkesë EULEX-it që i njëjti të marrë në dorë vendosjen në proces me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik para Gjykatës Supreme të Kosovës.
24. Më 12.10.2012, ankuesja i dërgoi një letër urgjente kryetarit të trupit gjykues të EULEX-it për përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm në lëndën e saj, që u konfirmua në procedurën e shkallës së dytë të gjykatave.
25. Më 15.10.2012, kryetari i Trupit gjykues të EULEX-it mori aktvendim, me të cilin refuzohet kërkesa që gjyqtarëve të EULEX-it t'u ndahet lënda në fjalë e kontestit civil të ankueses, por e njëjta do të merret në konsiderim për t'u monitoruar nga ana e Ekipit mobil të gjyqtarëve të EULEX-it. Gjithashtu, në aktvendim theksohet se kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës do të njoftohet për aktvendimin në fjalë.
26. Më 28.11.2012, ankuesja dërgoi Gjykatës Supreme të Kosovës përgjigje në revizionin e të paditurit.
27. Më 17.12.2012, ankuesja përgjigjen në fjalë në revizionin e të paditurit përsëri ia dërgoi Gjykatës Supreme për shkak se parashtesa, të cilën e kishte paraqitur më parë, sipas pohimeve të ankueses nuk gjendej në Gjykatën Supreme.
28. Më 20.2.2013, ankuesja përsëri i dërgoi Gjykatës Supreme të Kosovës një letër urgjence në lidhje me propozimin për revizionin e të paditurit.
29. Më 19.3.2013, ankuesja i dërgoi një shkresë EULEX-it me kërkesën që ta rishqyrtojë vendimin e datës 5.3.2013, të nxjerrë nga kryetari i Kolegjit të gjyqtarëve të EULEX-it dhe kërkesë për ndarjen e lëndës gjyqësore civile dhe përmbarimore të Gjykatës Komunale në Prizren (P.br.462/10;Ac.nr.114/12) gjyqtarëve të EULEX-it.

30. Më 27.3.2013, nënkryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it e njoftoi ankuesen që kërkesa e saj i është përcjellë EULEX-it, Sektorit për fuqizim, për shqyrtim.
31. Më 2.4.2013 i padituri-debitori i dërgoi Gjykatës Themelore në Prizren një kundërshtim që të refuzohet propozimi i kreditorit në lëndën I.br.1241/12 i datës 3.7.2012 për ekzekutim në bazë të aktgjykimit P.br.462/10, të datës 21.12.2011 si i palejueshëm, për shkak se lënda gjendet në Gjykatën Supreme të Kosovës.
32. Më 12.4.2013, Gjykata Themelore në Prizren nxori aktvendim që kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të plotfuqishëm dhe përmbarues nuk mund ta ndalojë përmbarimin. Mirëpo, me këtë aktvendim njëkohësisht kërkesa e propozuesit, përkatësisht e ankueses shtyhet derisa gjykata e shkallës së parë të vendosë për kundërshtimin e parashtruar.
33. Më 28.5.2013 është mbajtur seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prizren, në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e EULEX-it, të cilët bëjnë monitorimin e gjykimit. Përfaqësuesi ligjor i ankueses në atë rast paraqiti propozimin e kreditorit për lëshimin e urdhrin nga gjykata, me qëllim që debitori të depozitohet shumën monetare të nevojshme për zbatimin e veprimeve ekzekutive, d.m.th. rrënimin e ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme në pronën e saj. Duke pasur parasysh se në shqyrtim nuk mori pjesë debitori, për shkak të shëndetit të dobët. Seanca tjetër gjyqësore u caktua të mbahet më 1.7.2013.
34. Më 17.6.2013 i padituri-debitori iu drejtua Gjykatës Themelore në Prizren me një parashtrësë dhe kërkoi që të pezullohet procedura e përmbarimit për shkak të rishikimit të parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimit të formës së prerë P.br 462/10, të datës 21.12.2011, si dhe për shkak të shëndetit të dobët të debitorit të përmbarimit.
35. Më 1.7.2013, gjyqtari i lëndës në procedurën përmbarimore I.br.1241-12 në Gjykatën Themelore në Prizren, e autorizoi kreditorin përmbarues që me shpenzimet e debitorit përmbarues t'ia besojë kryerjen e veprimeve të rrënitit dhe heqjes së objektit të ndërtuar në mënyrë të paligjshme, pra, kthimin e tokës në gjendjen e saj fillestare. Gjykata e urdhëroi ankuesen që të dërgojë profaturën e lëshuar nga kompania që do të bëjë rrënimin së bashku me parallogarinë e shpenzimeve për punën e kryer.
36. Më 10.10.2013, ankuesja ia dërgoi Gjykatës Themelore në Prizren një shkresë me parallogarinë e shpenzimeve të kompanisë, e cila do të kryente rrënim objekteve të ndërtuar anë mënyrë të paligjshme në pronën e saj.
37. Më 25.2.2014, ankuesja përsëri iu drejtua Gjykatës Supreme të Kosovës me qëllim që të marrë informacionin, nëse Gjykata Supreme e ka zgjidhur kërkesën për rishikim, të paraqitur nga i padituri në këtë lëndë dhe me atë rast ajo u informua se lënda është zgjidhur më 09.07.2013 dhe i është përcjellë Gjykatës Themelore në Prizren që nga data 09.09.2013. Në realitet, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë aktgjykimin (Rev.nr.247/2012), me të cilin refuzohet si i pabazë rishikimi i të paditurit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Gž.br114/2012, të datës 18.05.2012.
38. Më 14.03.2014 në seancën e mbajtur në Gjykatën Komunale në Prizren, gjykatësi përmbarues i lëndës i njoftoi të pranishmit se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.247/2012, e datës 09.07.2013 është refuzuar rishikimi i të paditurit.
39. Gjithashtu, në të njëjtën seancë, Gjykata nxori aktvendimin, me të cilin i urdhërohet përfaqësuesit të të paditurit-debitorit që në afat prej 7 ditësh të depozitohet fonde që prona e ankueses të kthehet në

gjendjen fillestare, si dhe nga patundshmëria e ankueses të largohen të gjitha gjërat e lëvizshme. Gjithashtu, i padituri është informuar se në qoftë se nuk i depoziton mjetet e udhëruara, që mjetet e njëjta do të mbulohen nga pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e të paditurit.

40. Duke pasur parasysh se gjykata kompetente nuk ka ndërmarrë asnjë masë kundër të paditurit-debitorit, i cili ka qenë i obliguar të depozitojë shumë të caktuar mjetesh Gjykatës për rrënimin e objektit, sipas pohimeve të ankueses, kurse sipas transkriptit të bashkangjitur të seancës të datës 15.04.2014, përfaqësuesi ligjor i ankueses e ka sugjeruar Gjykatën për depozitim të papaguar nga ana e debitorit, gjë të cilën gjykatësi i lëndës e arsyeoi duke thënë që softueri i gjykatës është i bllokuar dhe për këtë arsye ka qenë e pamundur të bëhet pagesa e shumës në fjalë nga mjetet në dispozicion nga llogaritë bankare të të paditurit.
41. Më 11.6.2014, ankuesja i dërgoi Gjykatës Themelore në Prizren kërkesë për lirimin nga detyrimet për të paguar shpenzimet ligjore, duke përfshirë edhe taksat gjyqësore. Ankuesja e bazoi propozimin në faktin se pagesa e shpenzimeve gjyqësore do të rrezikonte seriozisht ekzistencën e saj, meqë ajo është pensioniste dhe nuk posedon asnjë patundshmëri jashtë Prizrenit.
42. Më 9.7.2014, ankuesja dërgoi një letër urgjente gjykatësit të procedimit përmbarues të Gjykatës Themelore në Prizren që urgjentisht të caktojë një seancë gjyqësore përmbaruese për përbarimin e aktgjykimit të formës së prerë pa vonesë.
43. Më 9.9.2014, në seancën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prizren, përfaqësuesi ligjor i ankueses kërkoi që Gjykata ta miratojë propozimin ankueses për depozitim të fondeve të nevojshme nga ana e të paditurit-debitorit, për përbarimin e aktgjykimit dhe të vepohet në përputhje me aktvendimin përmbarues dhe përmes formës së detyrueshme të sigurohen fondet e nevojshme.
44. Gjyqtari përmbarues i lëndës me këtë rast konstatoi që nuk ka mund të gjejë bazë ligjore që të urdhërojë që nga llogaria bankare e debitorit-të paditurit të përbarimit të bëhet transferi mjeteve adekuate në emër të depozitit. Gjithashtu, i padituri-debitori ka deklaruar që nuk i ka mjetet përkatëse, duke theksuar se dispozitat e nenit 13 të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore parashikojnë që shpenzimet e procedurës përmbarimore paraprakisht i bart kreditori i përbarimit, prandaj në këtë kuptim propozoi që Gjykata në pajtim me dispozitën 2 të neni të ligjit të lartpërmendur, të caktojë një afat, brenda të cilit kreditori do të depozitojë mjete për rrënimin e objekteve kontestuese në pronën e ankueses.
45. Më 9.9.2014, gjykata nxori aktvendimin I.br1241-12, me të cilin i urdhërohet palës kreditore që në afat prej 15 ditësh të deponojë shumën e kërkuar të mjeteve monetare për kryerjen e veprimeve përmbarimore, sepse në të kundërtën nuk mund të realizohet përbarimi i kërkuar. Përveç kësaj, gjyqtari i procedurës përmbarimore konstatoi që "në procedurën përmbarimore gjyqtari përmbarues, me gjithë vendimin për miratimin e propozimit të kreditorit, në çdo kohë, të njëjtin mund ta shfuqizojë ose të mos veprojë sipas të njëjtit për shkak të pamundësisë së ndërmarrjes së një veprimi të tillë". Me të njëjtin aktvendim I.br1241-12 është miratuar kërkesa e ankueses për lirimin nga taksat gjyqësore.
46. Aktvendimi I.br.1241-12 i datës 09.09.2014, i është dërguar më 9.2.2015, si dhe përkthimi i të njëjtit në gjuhën serbe, duke konstatuar mbingarkesën e njësisë për përkthime të gjykatës.
47. Më 30.9.2014, ankuesja ka deponuar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren I.br.1241/12, të datës 28.8.2014.

48. Më 21.1.2015, ankuesja i ka dërguar një parashtrësë gjyqtarit të procedurës përmbaruese, me të cilën e informon gjykatën se ka marrë informatën për vdekjen e të paditurit-debitorit dhe se Gjykata duhet të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore në mënyrë që të vazhdohet procedura e filluar e përmbarimit.
49. Më 11.2.2015, ankuesja iu drejtua Gjykatës së Apelit të Kosovës me një ankesë, me të cilën plotësisht kontestohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren I.br.1241/12, i datës 09.09.2014, për shkak të shkeljes së dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
50. Më 25.2.2015, Gjykata Themelore në Prizren i dërgoi ankueses vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore në lidhje me ankesën e parashtruar kundër aktvendimit të gjykatës së njëjtë në procedurën e përmbarimit I.br.1241/12 të datës 9.9.2014.
51. Më 27.2.2015, ankuesja iu drejtua Gjykatës Themelore në Prizren me parashtrësën sipas vërejtjes në fjalë për pagesën e taksave gjyqësore. Në realitet, ankuesja me parashtrësën në fjalë propozon që gjykata e përmbarimit ta tërheqë/anulojë vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore, sepse e njëjta gjykatë me aktvendimin I.br.1241/12, të datës 28.8.2014 e ka liruar ankuesen nga pagesa e taksave gjyqësore në këtë lëndë përmbarimore.
52. Më 30.4.2015, ankuesja i është drejtuar institucioneve relevante në Kosovë si: Shefit të Misionit të Zyrës së UE në Kosovë, kryesuesit të Kolegjit gjyqësor të EULEX-it, kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Zyrës së Prokurorit disiplinor, duke i informuar për vendimet e gjyqtarit të procedurës përmbarimore.
53. Më 21.5.2015 i autorizuari i debitorit të përmbarimit i dërgoi një parashtrësë Gjykatës Themelore në Prizren. Në fakt, meqë kreditori i përmbarimit nuk veproi në afatin e paraparë sipas aktvendimit I.br.1241/12 të datës 9.9.2014, përkatësisht ankuesja nuk e deponoi shumën e cekur monetare, debitori propozoi që gjykata të nxjerrë aktvendim, me të cilin do ta pezullojë përmbarimin, do t'i shfuqizojë të gjitha veprimet e zbatuara dhe do ta obligojë kreditorin e përmbarimit t'i paguajë shpenzimet e procedurës për çdo seancë të mbajtur.
54. Më 12.6.2015, ankuesja u përgjigj në kërkesën e të autorizuarit të debitorit të përmbarimit në lidhje me çështjen e pezullimit të procedurës për shkak të mospagesës së shumës për procedurën e përmbarimit, me arsyetimin se lënda pret të vendosjen sipas ankesës së palës kreditore në Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe kjo gjykatë ende nuk ka marrë vendim.
55. Më 17.6.2015, Gjykata Themelore në Prizren e shtyu seancën e caktuar gjyqësore për konfirmimin e kamatëvonesës, të cilën ankuesja duhet ta paguajë në bazë të aktvendimit për shpenzimet gjyqësore të Gjykatës Themelore I.br.1241/12, meqë i padituri-debitori ka ndërruar jetë. Gjykata së pari duhet t'i drejtohet Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës së Prizrenit, që të marrë të dhëna nga libri amzë i të vdekurve për debitorin në fjalë dhe të caktojë një përfaqësues të përkohshëm të debitorit-të paditurit.
56. Më 30.9.2015, Gjykata e Apelit të Kosovës nxori aktvendimin GZ.br.1252/2015, me të cilin e miraton si të bazuar ankesën e ankueses, kurse aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren I.br.1241/12 të datës 09.09.2014 e shfuqizon, prandaj lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

II VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

57. Më 26.05.2015, ankuesja e paraqiti një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër Gjykatës Themelore në Prizren, që ka të bëjë me mospërmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm përmbarues të Gjykatës Themelore në Prizren, si dhe me pretendimet e ankueses për trajtim të pabarabartë dhe shkelje të parimit të barazisë para ligjit dhe mosrespektim të Ligjit për procedurën përmbarimore në lidhje me veprimet e ndërmarra në procesin e përmbarimit të vendimit.
58. Më 9.6.2015, IAP nisi hetimet dhe e regjistroi ankesën e ankueses me A.nr. 303/2015 dhe ankueses i dërgoi njoftimin për pranueshmëri.
59. Më 14.7.2015, IAP i dërgohet i gjithë dokumentacioni relevant, i cili është i dërguar nga ankuesja në lidhje me rastin e saj të mospërmbarimit të aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor.
60. Më 31.8.2015, ankuesja i dërgon IAP parashtrësat, me të cilat i është drejtuar Shefit të Misionit të Zyrës së UE në Kosovë, kryesuesit të Kolegjit gjyqësor të EULEX-it, kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Zyrës së Prokurorit disiplinor, duke i informuar për vendimet e gjyqtarit të procedurës përmbarimore të Gjykatës Themelore në Prizren.
61. Më 08.09.2015, IAP mori informata se pasardhësi ligjor i të paditurit të ndjerë, në lëndën I.nr.1241/12, u vra në një incident të armatosur në lagjen Bazhdarane në Prizren, kur persona të panjohur kishin shtënë nga një veturë në lëvizje në një grup njerëzish. Lidhur me këtë, ankuesja e informoi këshilltaren ligjore të IAP-së që seanca e caktuar gjyqësore, që ishte planifikuar të mbahej më 16.09.2015, me qëllim të përcaktimit të kamatëvonesës për shkak të mospagesës së taksave gjyqësore nga ana e ankueses në Gjykatën Themelore në Prizren, është shtyrë.
62. Më 10.9.2015 në procedurën e hetimit, këshilltarja ligjore e IAP-së në takim me administratorin e Gjykatës Themelore në Prizren, kërkoi shpjegime lidhur me mosrespektimin e Ligjit për procedurën përmbarimore në procesin e përmbarimit të vendimit dhe kërkoi shikim në të dhënat statistikore për marrjet e vendimeve, në të cilat palëve u është lëshuar aktvendimi për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore për shkak të kushteve të dobëta ekonomike, ndërsa të njëjtës i urdhërohet pagesa e shpenzimeve të procedurës së përmbarimit. Pala përgjegjëse ka deklaruar që Gjykata nuk ka informacione dhe nuk mban evidencë në lidhje me vendimet e marra, lidhur me rastet identike, kur palëve u është lëshuar një vendim për pagesën e shpenzimeve gjyqësore. Përveç kësaj, pala përgjegjëse me këtë rast nuk i ka arsyetuar faktet, mbi të cilat i bazon pretendimet e veta, përkundër faktit që Këshilli Gjyqësor i Kosovës në raportin e vet vjetor statistikor mbi punën e gjykatave publikon të dhëna të kësaj natyre dhe të cilat gjykatat në Kosovë janë të obliguara t'ia dorëzojnë të njëjtit. Gjithashtu, me këtë rast nuk janë arsyetuar shkaqet objektive dhe të vlefshme, në bazë të të cilave Gjykata Themelore në Prizren si organ i pavarur dhe i paanshëm nuk është në gjendje të zbatojë dhe përmbarojë një vendim të plotfuqishëm në një periudhe kohore prej 4 vitesh.
63. Më 30.9.2015, ankuesja e informoi këshilltaren ligjore që Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit të përmbarimit kundër aktvendimit I.br.1241/12, ka marrë vendim. Në realitet, me aktvendimin GZ.br.1252/2015 Gjykata e Apelit e miraton si të bazuar ankesën e ankueses, kurse Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren I.br.1241/12 i datës 9.9.2014 shfuqizohet dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

III. INSTRUMENTET RELEVANTE

64. Neni 21, paragrafi 2. dhe 3 i Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “Kushteta”) definojnë si në vazhdim:

“[...] Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”

“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”

[...]

65. Neni 31 i Kushtetutës definojnë:

“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”

66. Neni 24 i Kushtetutës në lidhje me barazinë para ligjit në pjesën përkatëse citon:

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”

“2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

67. Neni 46, i cili ka të bëjë me pronën, i Kushtetutës definojnë:

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. (...).”

68. Neni 6 paragrafi 1 Ligjit për Procedurën Përmbartimore Nr.04/L-139 (në tekstin e mëtejme “Ligjit për procedurën përmbartimore”) parasheh detyrën e gjykatës të veprojë me ngutshmëri në rast të përmbartimit.

69. Neni 17 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore parasheh që Ligji për procedurën kontestimore nr.03/L-006 të zbatohet përshtatshëmish në procedurën përmbartimore, po që se me ndonjë ligj tjetër nuk është paraparë ndryshe.

70. Neni 10, pika 3 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore parasheh, midis të tjerash “Që gjykata urdhëron përmbartimin në mënyrën, të cilën e propozon kreditori i përmbartimit. Në qoftë se aktvendimi për përmbartim nuk mund të përmbartohet ashtu, kreditori i përmbartimit mund të propozojë një mënyrë tjetër për përmbartim dhe me propozimin e tij gjykata nxjerr aktvendim.”

71. Në nenet 152-166 të Ligjit për Procedurën përmbartimore përcaktohen detajet e përmbartimit përmes transferimit të fondeve në llogari bankare.

72. Neni 155 i Ligjit për procedurën përmbartimore, në veçanti parasheh që organi përmbartues t’ia dorëzojë drejtpërdrejt bankës vendimin për përmbartim ose urdhrin për përmbartim. Personi zyrtar i bankës e regjistron datën dhe kohën kur i është dorëzuar bankës aktvendimi apo urdhri për përmbartim. Një kopje e këtij aktvendimi apo urdhri për përmbartim i dërgohet edhe Bankës Qendrore të Kosovës. Gjykata ia përcjell aktvendimin për përmbartim bankës, e cila menjëherë ia bllokoi të

gjitha llogaritë e debitorit të përmbarrimit dhe i dorëzon të dhënat mbi burimet që janë në dispozicion në këto llogari. Pas marrjes së këtyre të dhënave banka urdhëron pagesën në radhë të parë nga llogaria bankare që është specifikuar në aktvendimin për përmbarrim. Në qoftë se ka disa llogari në bankë, të cilat janë precizuar në aktvendimin për përmbarrim, pagesa do të bëhet sipas radhës në të cilën janë listuar ato llogari. Në qoftë se nuk ka mjaft mjete në llogarinë e përmendur në aktvendimin për përmbarrim, banka urdhëron pagesën nga llogaritë e tjera, në të cilat debitori i përmbarrimit ka mjete.

73. Në nenet 190-271 të Ligjit mbi procedurën përmbarrimore janë paraqitur detajet që kanë të bëjnë me përmbarrimin në raport me pasurinë e paluajtshme të debitorit të përmbarrimit.

Ligji për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore 04/L-118 (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji i procedurës kontestimore"):

Neni 1 i Ligjit për procedurën kontestimore në pjesën relevante thotë:

“Me Ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.”

Neni 10, pika 1 e Ligjit për Procedurën Kontestimore thekson:

“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”

74. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtutjeshëm "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut" ose "Konventa"), është një pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse neni 22.2 i Kushtetutës garanton të drejtën për zbatim të drejtpërdrejtë të Konventës dhe protokolleve të saj, e cila me Kushtetutën e Republikës së Kosovës u garantohet të gjithë qytetarëve të saj.

75. Paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës (4 nëntor 1950) në pjesën përkatëse thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet [...].”

76. Neni 13 i Konventës thotë:

“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instancë kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare..”

77. Me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës definohet:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”

IV ANALIZA

78. Pas shqyrtimit të këtij rasti, rezulton se Gjykata Themelore në Prizren nuk ka vepruar në përputhje me procedurën ligjore të përcaktuar në procedurën e përmbarimit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës komunale në Prizren, të cilin edhe Gjykata e Qarkut edhe Gjykata Supreme e Kosovës e kanë konfirmuar me vendimet e veta.
79. Meqenëse kjo nuk është bërë, Avokati i Popullit thekson se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e pronës personale dhe të pronës në përgjithësi, si dhe mbrojtja e kësaj të drejte në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zbatimi i të cilave është i garantuar drejtpërdrejt me Kushtetutë, si akti më i lartë juridik i një shteti duhet të respektohet. Mirëpo, ekzistenca e kësaj të drejte, në qoftë se ajo nuk është e mbrojtur në praktikë nuk ka kurrfarë kuptimi, nëse qytetarët nuk janë në gjendje t'i mbrojnë të drejtat e tyre legjitime me anë të mjeteve dhe mekanizmave efektiv juridik.
80. Duke analizuar të gjitha faktet e cituara në ankesë, Avokati i Popullit konstatoi arsyeshmërinë e ankesës, kur merret parasysh që edhe pas kalimit të më shumë se 4 viteve nuk është realizuar përmbarimi i vendimit përfundimtar dhe të formës së prerë të gjykatës. Të gjitha faktet ligjore dhe faktike të prezantuara gjatë gjykimit të shkallës së parë dhe të dytë gjykata i ka shqyrtuar në mënyrë korrekte dhe të plotë dhe i ka vlerësuar në aktgjykimet e veta, në të cilat, ndër të tjera, nuk kishte asnjë bazë ligjore apo ndonjë bazë tjetër që të respektohet kërkesa për rishikim e të paditurit në Gjykatën Supreme të Kosovës. Korniza ligjore (duke përfshirë Konventën dhe Protokollet e saj), në mënyrë të qartë garanton mbrojtjen e të drejtave të pronësisë dhe konfirmon që ndërtuesi i pandërgjegjshëm nuk mund të fitojë dobi nga ndërtimi i pandërgjegjshëm. Gjykata e konstatoi këtë me analizën e ligjeve në fuqi dhe zbatoi rregulla që kanë të bëjnë me të drejtën e ankueses në aspektin e pasurive të patundshme dhe ndërtimit të pandërgjegjshëm të të paditurit. Në këtë rast është zbatuar parimi ligjor "superficies solo cedit", i cili në mënyrë absolute i jep përparësi të drejtës së ankueses – pronarit të ndërgjegjshëm të pasurisë së patundshme, por jo të paditurit – ndërtuesit të pandërgjegjshëm. Paligjshmëria e veprimeve të të paditurit, përkundër të gjitha paralajmërimeve është sanksionuar qartë me vendimet e gjykatës.
81. Avokati i Popullit e thekson rëndësinë e faktit se procedura e përmbarimit për nga natyra e vet juridike është emergjente dhe urdhëron largimin e pasojave të dëmshme në afatet sa më të shkurtra të mundshme. Refuzimi i debitorit të përmbarimit që vullnetarisht ta lirojë pronën, të cilën e shfrytëzon në mënyrë të paligjshme nuk e zvogëlon obligimin e Gjykatës themelore në Prizren të veprojë në përputhje me autoritetin e vet ligjor, duke përdorur mekanizmat ekzistues, në mënyrë të veçantë të veprojë në përputhje me nenin 155 të Ligjit për procedurën e përmbarimit.
82. Përmbarimi i vendimit të marrë nga gjykata kompetente duhet të shihet si një pjesë përbërëse e së drejtës për një gjykim të drejtë, siç e konfirmon këtë praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtutjeshëm "Gjykata Evropiane"), në mënyrë të veçantë i referohemi rastit Hornsby kundër Greqisë (shih: aktgjykimi i datës 19.03.1997, Raportet 1997-11 dhe I510, paragrafi 40), ku thuhet se përmbarimi i vendimit gjyqësor si një mjet juridik efektiv nuk duhet të mbetet vetëm në letër, por duhet të realizohet edhe në praktikë. Në këtë rast, parashtruesi i ankesës nuk duhet të privohet nga të mirat e vendimit të plotfuqishëm, i cili është nxjerrë në favor të tij.
83. Në funksion të analizës ligjore të ankesës së paraqitur në IAP dhe procedurave të palëve përgjegjëse, pas skadimit të një periudhe prej 4 vjetësh për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, Avokati i Popullit vëren paqartësi dhe arsyetime kontradiktore të gjykatës, gjatë procedurës

së përmbarimit në rastin I.br.1241/12. Në fakt, gjyqtari i procedurës së përmbarimit më 14.03.2014. e miraton propozimin e kreditorit për lëshimin e urdhrit, me të cilin debitori është i obliguar të depozitohet shumën e kërkuar që nevojitet për zbatimin e veprimeve përmbaruese, të rrënimin, të cilat i janë besuar kompanisë së caktuar nga Prizreni, në përputhje me nenin 292 të Ligjit për procedurën përmbarimore, i cili parasheh: *“Kërkuesi i përmbarimit mund të propozojë që organi përmbarues me aktvendim apo urdhër për përmbarim ta urdhërojë debitorin që më parë ta depozitohet në Gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër”*).

84. Meqë debitori i përmbarimit nuk ka depozituar mjete, për të cilat ka qenë i obliguar me urdhër të gjykatës në një periudhë të caktuar kohore, është i paqartë arsyetimi i gjykatës se mosveprimi i debitorit sipas urdhrit të gjykatës për depozitim, nuk tërheq masa të tjera, të cilat gjykata ka në dispozicion si mjet për ta detyruar debitorin e përmbarimit të veprojë sipas urdhrit të gjykatës (në pronën e debitorit), ose caktimin e gjobës për mospëmbushje të detyrimit të depozitimit, që i është përcaktuar në kuptim të nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit për procedurën e përmbarimit.
85. Përveç kësaj, Avokati i Popullit konstaton se Gjykata nuk e ka zbatuar nenin 276 të Ligjit për procedurën përmbarimore, i cili e rregullon çështjen e mjeteve financiare në veprimet e përmbarimit, në bazë të urdhrit të dhënë përmbarimor të datës 14 mars 2014.
86. Në nenet 152-166 të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore përcaktohen detajet e përmbarimit përmes transferit të mjeteve në llogari bankare. Neni 155 i këtij ligji, në mënyrë të veçantë, parashikon që gjykata ia përcjell aktvendimin për përmbarim Bankës Qendrore, e cila menjëherë e urdhëron bankën amë t’i ngrijë të gjitha llogaritë e debitorit të përmbarimit dhe të dërgojë të dhëna në lidhje me mjetet që janë në dispozicion në këto llogari. Pas marrjes së këtyre të dhënave, lëshohet urdhri që të bëhet pagesa nga llogaria bankare që është specifikuar në aktvendimin për përmbarim. Në qoftë se ka disa llogari në bankë, të cilat janë precizuar në aktvendimin për përmbarim, pagesa do të bëhet sipas radhës në të cilën janë listuar ato llogari. Në qoftë se nuk ka mjaft mjete në llogarinë e përmendur në aktvendimin për përmbarim, banka do të urdhërojë pagesën nga llogaritë e tjera, në të cilat debitori i përmbarimit ka mjete.
87. Më tej, në nenet 143-187 të Ligjit për procedurën e përmbarimit janë paraqitur detajet që kanë të bëjnë me përmbarimin në pronën e paluajtshme të debitorit të përmbarimit.
88. Gjyqtari i përmbarimit i lëndës duke konstatuar se sistemi kompjuterik nuk funksionon, se softueri është i bllokuar dhe se nuk mund të shihet a ka i padituri mjete për t’i mbuluar shpenzimet e përmbarimit të aktgjykimit, nxjerr një urdhër të ri, me të cilin, në kundërshtim me urdhrin e vet paraprak, tani e obligon ankuesen të depozitohet mjete në shumën prej 19,495.41 eurosh, të nevojshme për shpenzimet e kryerjes së përmbarimit. Gjykata arsyetoi se e obligon kreditorin e përmbarimit për arsye se "... në rastin konkret bëhet fjalë për një veprim përmbarues, të cilin mund ta kryejë debitori i përmbarimit, por edhe cilido tjetër, siç është paraparë në nenin 292 dhe 293 të Ligjit mbi procedurat e përmbarimit." Më tej, meqë debitori nuk e ka përmbytur urdhrin e gjykatës për të depozituar një sasi të caktuar të mjeteve, me qëllim të përmbarimit përfundimtar të aktgjykimit të formës së prerë, Gjykata i referohet nenit. 13. paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, i cili parashikon: Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori. Ajo që u prezantua këtu paraqet ekzistencën e kontradiktave të dukshme midis asaj që thuhet në arsyetimet e vendimit, si dhe ekzistimi i kontradiktave midis arsyeve të përmendura të faktet vendimtare.

89. Gjithashtu duhet theksuar që me të njëjtin aktvendim I.nr.1241/12 të datës 28.8.2014, gjykata e miratoi kërkesën e ankueses për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore, sepse ankuesja është pensioniste nuk është në gjendje ta paguajë shumën e taksave gjyqësore.
90. Neni 468 i Ligjit për procedurën kontestimore parashikon: *“Gjykata e liron nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore palën e cila, sipas gjendjes së vet të përgjithshme pasurore është në pamundësi t’i përballojë ato shpenzime pa dëmtuar ushqimin e domosdoshëm të vet dhe të familjes së ngushtë të saj. Lirimi nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore përfshin lirin nga pagimi i taksave gjyqësore dhe lirin nga deponimi i paradhënies për shpenzimet e dëshmitarëve, të ekspertëve të këqyrjes në vend si dhe të shpalljeve gjyqësore.”*
91. Përveç kësaj, neni 4 i Ligjit për procedurën e përmbarrimit thotë që debitori është i obliguar që kreditorit të përmbarrimit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës dhe të gjitha shpenzimet e tjera të shkaktuara gjatë procedurës së përmbarrimit.
92. Më tutje, duke pasur parasysh që ankuesja nuk ka vepruar sipas urdhrin të gjykatës për depozitim, i padituri/debitori i është drejtuar gjykatës me një parashtrësë, me propozim që gjykata të nxjerrë aktvendim, me të cilin do të pezullohet përmbarrimi, do të shfuqizohen të gjitha veprimet e zbatuara dhe do ta obligojë znj. Gjorgjeviq t’i paguajë shpenzimet gjyqësore të procedurës për çdo seancë të mbajtur gjyqësore.
93. Neni 13, paragrafi 2 i Ligjit për procedurën përmbarrimore thotë që shpenzimet në fjalë *“Propozuesi i përmbarrimit ka për detyrë t’i parapaguajë brenda afatit të caktuar nga organi përmbarrues. Organi përmbarrues do ta pezullojë përmbarrimin po qe se nuk parapaguhet shpenzimet brenda afatit të tillë. Po qe se brenda afatit të dhënë nga organi përmbarrues nuk parapaguhet shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë.”* Në mënyrë të qartë rezulton se neni 13, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore parashikon që në qoftë se brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti përmbarrues (gjykata), nuk bëhet pagesa e shpenzimeve për kryerjen e veprimeve konkrete, atëherë nuk do të kryhet vetëm një veprim i tillë. Pra, organi përmbarrues ka dhënë urdher me aktvendim të paplotfuqishëm të datës 9.9.2014, të bëhet përmbarror deponimi, të bëhet depozitimi për kryerjen e veprimeve konkrete – rrënimin e objektit, në mënyrë që debitori i përmbarrimit i cili e propozon pezullimin e përmbarrimit dhe shfuqizimin e të gjitha veprimeve të ndërmarra, nuk mund të thirret në nenin 13 paragrafin 2, i cili përcakton se në qoftë se nuk bëhet parapagimi i shpenzimeve për kryerjen e veprimeve konkrete, atëherë nuk do të bëhet vetëm veprimi i tillë.
94. Më 18.2.2015, ankueses i është dorëzuar vërejtja nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren për pagesën e taksave gjyqësore, e cila me aktvendimin e datës 9.9.2014 është liruar, sepse e njëjta pensioniste, nuk ka pasuri të tjera të patundshme dhe nuk ishte në gjendje të paguajë shumën në fjalë.
95. Gjithashtu Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 31 përcakton:
- “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
96. Avokati i Popullit konstaton se ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të parashtruesit të ankesës për barazi para ligjit, duke marrë parasysh rrethanat që nuk është përmbarruar vendim i formës së prerë i gjykatës, gjë që është në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje.

drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

97. Avokati i Popullit më tutje vëren që mospërmbarimi i vendimit nga ana e Gjykatës dhe dështimi i organeve kompetente të Republikës së Kosovës të sigurojnë mekanizma efektivë në kuptim të përmbarimit të vendimeve të formës së prerë, është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe paraqet shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me nenin 21 të Kushtetutës. Në këto rrethana, Avokati i Popullit konstaton se mospërmbarimi i vendimit të formës së prerë përbën shkelje në lidhje me nenin 6.1 të Konventës. Në realitet, ankuesja ankohet për faktin se ka pritur aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore për gati gjashtë vjet dhe pas marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë deri më sot i njëjti nuk është përmbuar. Rasti praktikisht qëndron i pa zgjidhur një kohë relativisht të gjatë dhe pikërisht kjo përbën shkeljen e të drejtës së saj për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës, i cili thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm.” [...]“

98. Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton që ankueses për shkak të zvarritjes dhe mospërmbarimit të vendimit, i është mohuar e drejta në pronën e saj.

99. Avokati i Popullit rikujton se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane konstatoi se në rastin i cili përfshin përcaktimin e të drejtës civile, kohëzgjatja e procedurave zakonisht llogaritet nga koha e fillimit të procedurës gjyqësore (shih për shembull, Sienkiewicz kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 30.9.2003) deri në kohën kur më në fund merret vendimi lidhur me rastin dhe/ose përmbahet aktgjykimi. (shih Vocaturo kundër Italisë (II), aktgjykimi i datës 24.5.1991).

100. Avokati i Popullit vëren se procedurat e filluara në tërësi para asokohe Gjykatës Komunale, tani Gjykatës Themelore në Prizren, më 21.7.2005, kur u ngrit padia kundër të paditurit dhe vazhdojnë edhe sot. Për këtë arsye, procedurat zgjasin gati dhjetë vjet.

101. Avokati i Popullit rikujton se në lëndën e lartpërmendur Vocaturo kundër Italisë, qeveria italiane shpjegoi që arsyeja e vonesës në procedurë ishte numri i madh i rasteve në gjykata. Në këtë rast, Gjykata konsideron se neni 6, paragrafi 1 ua imponon shteteve detyrimin t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrën e tillë që gjykatat t'i plotësojnë kërkesat e Konventës. Megjithatë, vonesa në punë nuk e përfshin përgjegjësinë e shteteve, me kusht që të ndërmerren me kohë masa, dhe të merren me situata të kësaj natyre (shih Milasi kundër Italisë, aktgjykimi e datës 25.6.1987. Shih gjithashtu, *Foti dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i datës 10.12.1982).

102. Avokati i Popullit konstaton që gjykatat kompetente kanë obligim të sigurojnë drejtësi me kohë. Në këtë kuptim, gjithashtu rikujton që neni 10 i Ligjit të procedurës kontestimore thotë se gjykatat do t'i "zhvillojnë procedurat pa vonesa të panevojshme".

103. Përveç kësaj, në rastin konkret, shteti ka detyrim të organizojë një sistem të përmbarimit të aktgjyqimeve, i cili është efektiv edhe në ligj dhe në praktikë (sh. aktgjykimin Fuklev kundër Ukrainës, nr. 71186/01, paragrafi 84, i datës 7.6.2005). Pavarësisht, nëse debitori i përmbarimit është person privat apo njësi e kontrolluar nga shteti, shteti është ai që duhet t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe me këtë rast të sigurojë pjesëmarrjen efektive të gjithë aparatit të tij (sh. Mutatis mutandis aktgjykimi në lëndën Pini dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 78028/01 dhe 78030/01, paragrafët 174-189, ECHR 2004-V (ekstraktet)).

104. Avokati i Popullit gjithashtu konstaton se gjykata është e obliguar që brenda kompetencave të veta të gjejë mekanizma efikas të natyrës përmbushëse, në kuptim të përmbushjes së detyrimeve të parapara me ligj dhe Kushtetutë. Si pasojë, e veprimeve e veta, përkatësisht me dështimet e veta për të vepruar bëhet diskriminimi, meqë palët në të njëjtën situatë nuk trajtohen në mënyrë të barabartë, siç parashihet me Kushtetutë. Do të ishte e pakuptueshme që sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës të lejojë që vendimi i plotfuqishëm gjyqësor të mbetet joefektive në dëm të palës. Pra, procedurat joefektive dhe mos zbatimi i vendimeve prodhojnë efekte që na çojnë në një situatë që nuk është në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 21 i Kushtetutës), parimin të cilin autoritetet e Kosovës janë të detyruara ta respektojnë.
105. Avokati i Popullit në mënyrë të arsyeshme konsideron se i padituri është i detyruar ta lirojë pronën nga të gjithë personat dhe gjërat, t'i largojë strukturat e ndërtuara në mënyrë të paligjshme dhe pas kësaj t'ia dorëzojë pronën ankueses në cilësinë e pronarit të ligjshëm. Me vetë faktin që ankuesja në mënyrë absolute është kundër që shfrytëzuesi i pandërgjegjshëm vazhdon ta përdorë në mënyrë të paligjshme pronën, është e nevojshme ndërmarrja e të gjitha veprimeve ligjore dhe faktike për përmbarrimin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës dhe në këtë mënyrë t'i sigurohet ankueses qasja dhe mundësia që në mënyrë të papenguar ta gëzojë e qetë pronën e saj.
106. Sa i përket këtij rasti konkret, Avokati i Popullit është i mendimit se, përkundër pretendimeve të palës përgjegjëse, procedura e përmbarrimit sipas vetë natyrës së vet duhet të zgjidhet shpejt (sh. paragrafët 32 dhe 38 dhe Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [GC], nr 35382/97, paragrafi 23, ECHR 2000-IV). Edhe pse mund të pranohet që disa procedura të përmbarrimit janë më të komplikuar, Avokati i Popullit nuk e konsideron që ky rast është aq kompleks sa për ta justifikuar zvarritjen e përmbarrimit.

Konstatim

107. Avokati i Popullit konstaton që autoritetet nuk i kanë ndërmarrë masat e domosdoshme për përmbarrimin e aktgjykimit. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se për këtë arsye ka ardhur deri te shkelja e të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

E drejta për mjete efektive juridike: neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

108. Ankuesja ka paraqitur ankesë kundër mungesës së një mjeti juridik efektiv, në kuptim të shkeljes të së drejtës së saj për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që përbën shkelje të së drejtës së saj për një mjet efektiv juridik, sipas nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

"Çdokush, të cilin i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

109. Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut disa herë ka theksuar që vonesat e tepërta në zbatimin e drejtësisë në aspektin, kur pala nuk ka asnjë mjet ligjor në dispozicion, përbën kërcënim të sundimit të ligjit brenda sistemit juridik vendor (shih, për shembull, Bottazzi kundër Italisë, aktgjykimi i 28.07.1999 dhe Di Mauro kundër Italisë aktgjykimi i 28.7.1999). Avokati i Popullit rikujton gjithashtu që ndonëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsideron se kërkesat për një mjet efektiv ligjor duhet të interpretohen në kuptimin që mjeti juridik mund të jetë efektiv në aspektin e fushëveprimit të

kufizuar të kërkimit të ndihmës thelbësore në kontekstin e caktuar (Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë aktgjykimi i 6 shtatorit të vitit 1978), e njëjta ka konsideruar si vijon:

“Lidhur me dështimin e cekur që të sigurohet gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor [...] asnjë kualifikim thelbësor brenda fushëveprimit të nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, të parapara në Konventë do të diskutoheshin në favor të kufizimeve të theksuara të nenit 13 dhe do të mbaheshin minimalisht. (Kudla kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 26 tetor 2000)”.

110. Neni 13 pasqyrohet drejtpërdrejt në detyrimin e shteteve që përmes sistemeve të veta gjyqësore t'i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe në këtë mënyrë t'i krijojnë garanci shtesë individit, gjë që do t'i siguronte atij ose asaj që këto të drejta t'i gëzojë në mënyrë efikase. Shikuar nga kjo perspektivë, e drejta e një personi për gjykim brenda një kohe të arsyeshme kohore do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston asnjë mundësi që të paraqitet një ankesë te autoritet shtetërorë. Dispozitat e nenit 13 i përforcojnë ato të nenit 6 (shih aktgjykimin e lartpërmendur Kudla). Për këtë arsye neni 13 garanton një mjet ankimi efikas para autoriteteve shtetërore për shkeljen e pretenduar të dispozitave të nenit 6, për përfundimin e çështjes brenda një kohe të arsyeshme. Meqë ky rast ka të bëjë me një ankesë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
111. Në kuptim të dispozitave të nenit 13 të Konventës Evropiane, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë sigurimin e një mjeti ligjor vendor që të merret me çështjen e "ankesës kontestuese" sipas Konventës dhe të japë kompensimin e duhur financiar (Kaya kundër Turqisë gjykimi i 19 shkurtit 1998.). Çdo mjeti i tillë juridik duhet të jetë efektiv në praktikë dhe në ligj (Ilhan kundër Turqisë aktgjykimi i 27 qershorit 2000.). Në lidhje me ankesën në kohëzgjatjen e procedurës, Avokati i Popullit rikujton që "mjeti ligjor efektiv" në kuptim të nenit 13 të Konventës duhet të jetë në gjendje ta parandalojë shkeljen e pretenduar, ose vazhdimin e të njëjtës, ose sigurimin e kompensimit adekuat për çfarëdo shkelje që ka ndodhur tashmë (shih aktgjykimin e lartpërmendur Kudla).
- përputhje me ligjin, si dhe normat dhe standardet në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut.

Këshillin Gjyqësor të Kosovës :

- **Të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formën e parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.**
- **Të sigurohet barazia e përdorimit të gjuhëve zyrtare në të gjitha gjykatat, në mënyrë që të gjitha procedurat, dokumentet, informatat dhe dokumentet në lidhje me procedurat të lëshohen brenda një kohe të arsyeshme në gjuhën zyrtare të palëve.**

Zyrën e Prokurorit Disiplinor:

- **Zyra e Prokurorit Disiplinor të hetojë rastin që ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës së përmbarimit si dhe shpërdorimin e mundshëm të detyrës nga zyrtarët përgjegjës.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve

konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 595/2015

Isnije Dula

Raport lidhur me detyrimet pozitive që burojnë nga neni 29 dhe neni 31, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nga neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Për: Z. Imet Rrahmani, Ministër
Ministria e Shëndetësisë
Rr. "Zagrebi" p.n.
10000 Prishtinë

Prishtinë, më 26 shtator 2016

Qëllimi i raportit

Ky raport bazohet në ankesën individuale të znj. Dula dhe ka për qëllim që të evidentojë disa nga mangësitë e veprimeve institucionale në trajtimin e këtij rasti dhe të tërheqë vëmendjen e institucioneve përgjegjëse në lidhje me masat që duhet ndërmarr për zbatimin e të drejtës për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, për personat me çrregullime mendore.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (neni 18, par.1, nënpar.1.2);
- “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 8);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

Përshkrimi i çështjes

Ky raport është bazuar në ankesën e pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), nga znj. Isnije Dula, e cila ka paraqitur ankesë kundër Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, lidhur me pretendimet për moszbatim të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë (P.nr.709/14), për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në ndalim.

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon IAP, mund të përmblihen si në vijim:

1. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, më 29 tetor 2015, ka pranuar ankesën e znj. Isnije Dula, kundër Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, lidhur me moszbatimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë (P.nr.709/14), për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik të djalit të saj z. B. D.

2. Ankuesja pohon se djalit të saj z. B.D., (i lindur më 23 shtator 1968), që nga mosha 15-vjeçare i ishin shfaqur probleme shëndetësore me çrregullime mendore dhe që nga atëherë, ai ishte diagnostifikuar se vuan nga sëmundja mendore.
3. Ankuesja pohon se si pasojë e çrregullimeve mendore dhe veprimeve të dhunshme të B.D. para dhjetë vitesh i kishte vdekur bashkëshorti, ndërsa në vazhdimësi ishin dhunuar fizikisht nga z. B.D. ajo dhe disa nga familjarët e tjerë.
4. Më 10 nëntor 2013, pak para mesnate, z. B.D. fillimisht kishte tentuar ta hapë me dhunë derën e shtëpisë së njërit nga fqinjët në lagjen ku banon ankuesja, prandaj fqinji duke dëgjuar zhurmën, posa kishte hapur derën ishte sulmuar fizikisht nga z. B.D.
5. Më 11 nëntor 2013, pas ngjarjes së lartshënuar z. B.D., ishte larguar nga shtëpia dhe në mbrëmjen e kësaj dite familja e tij ishte njoftuar se ai gjendet në fshatin Xërxë dhe se ishte duke e penguar lëvizjen e veturave në rrugë. Familjarët e z. B.D., menjëherë kishin njoftuar Stacionin Policor në Gjakovë, të cilët për shkak të inkompetencës territoriale dhe zonës së përgjegjësisë për veprim, kishin kërkuar veprim nga Stacioni Policor i Komunës së Rahovecit. Drejtuesi i automjetit policor gjatë ngasjes së veturës duke synuar arrinte sa më shpejt në vendin e ngjarjes e kishte përplasur (goditur) me veturë z. B.D., të cilit i kishte shkaktuar lëndime të rënda trupore (*Fractura acetabulum reg lat. dex et contuzio capitis regio occipitalis*) dhe të njëjtin menjëherë e kishte transportuar në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë. Nga dokumentacioni mjekësor shihet se z. B.D., është hospitalizuar më 11 nëntor 2013, si dhe ka qëndruar në spital deri më 27 dhjetor 2013.
6. Më 18 shkurt 2015, lidhur me veprën penale të sulmit (shih paragrafi 4) Gjykata Themelore në Gjakovë mori aktvendim (P.nr.709/14) dhe z. B.D., ia shqiptoi masën e *Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik me Ndalim në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë*, në kohë të pacaktuar, duke e detyruar institutin ta informojë gjykatën me raport me shkrim së paku një herë në dy muaj.
7. Sipas pohimeve të familjarëve më 20 mars 2015, ka filluar ekzekutimi i aktvendimit P.nr.709/14, kundër z. B.D., lidhur me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë dhe ky trajtim është ekzekutuar deri më 26 tetor 2015.
8. Më 25 shkurt 2016, familjarët e ankueses njoftuan se z. B.D., nuk po e merr terapinë me rregull dhe sipas tyre ekziston rrezik potencial që i njëjti të shfaqë dhunë fizike ndaj ankueses (e cila jeton e vetme në shtëpi me z. B.D.), si dhe ndaj fqinjëve apo personave tjerë në rrugë dhe gjetiu.

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

9. Më 9 nëntor 2015, përfaqësuesi IAP-së kërkoi të dhëna statistikore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), lidhur me numrin e personave kundër të cilëve janë marrë vendime për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, prej vitit 2010 deri në vitin 2015, në nivel të të gjitha gjykatave në Republikën e Kosovës, si dhe ndaj sa personave (të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore) është zhvilluar procedura për t'iu marrë zotësia e veprimit për periudhën 2010-2015.
10. Më 10 nëntor 2015, IAP u informua nga KGJK, se këtë informatë e posedon vetëm si "Masat e Trajtimit të Detyrueshëm" për të gjitha llojet e masave që ka marrë gjykata, kurse lidhur me numrin e personave që iu është marrë zotësia e veprimit, kjo informatë gjendet vetëm në lëndë dhe KGJK nuk i ka të përpunuara këto të dhëna.
11. Më 12 nëntor 2015, përfaqësuesit e IAP-së kanë zhvilluar takim me përfaqësuesit e Institutit Special në Shtime (ISSH) për të vlerësuar situatën e vendosjes së personave me aftësi të kufizuara mendore në këtë institucion, si dhe vendosjen e personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet.

12. Më 19 nëntor 2015, përfaqësuesi i IAP-së u takua me administratorin e GJTH në Gjakovë, me të cilin bisedoi, lidhur me lëndën P.nr.709/14. Ai, pasi mori informacionet e nevojshme nga gjykatësja e rastit, theksoi se vendimi i gjykatës (P.nr.709/14) është në fuqi dhe autoriteti të cilit i është drejtuar vendimi ka obligim ligjor ta zbatojë atë.
13. Më 24 nëntor 2015, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me drejtorin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, me Neuropsikiatrin, me Psikologjen, si dhe me Punëtorin Social, me të cilët biseduan lidhur me çështjen e z. B.D. Ata i njoftuan se z.B.D., është pranuar në Institut për Trajtim të Detyrueshëm Psikiatrik, më 5 mars 2015, si dhe është lëshuar nga ky Institut më 27 tetor 2015. Ata theksuan se ky është i vetmi rast që ka qëndruar kaq gjatë në këtë institucion (gjithsejtë 237 ditë). Sipas tyre trajtimi i mëtutjeshëm duhet të vazhdohet në Qendrën e Shëndetit Mendor (QSHM) në Gjakovë, si dhe nevojitet që zyrtari i Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Gjakovë, të punojë me familjen e z. B.D. dhe rasti të menaxhohet nga trekëndëshi *Familje-QSHM-QPS*.
14. Më 25 nëntor 2015, përfaqësuesit e IAP-së u takuan me drejtorin e QSHM në Gjakovë me të cilin biseduan lidhur me çështjen e z. B.D. Ai sqaroi se në këtë qendër trajtohen rreth treqind e shtatëdhjetë (370) persona me çrregullime mendore, të cilët kryesisht vuajnë nga sëmundjet psikike. Sipas tij, nga numri i përgjithshëm i këtyre të pacientëve, vetëm pesë nga ta janë agresivë dhe të dhunshëm ndaj ambientit ku jetojnë. Ai sqaroi se personat me çrregullime mendore që shkaktojnë vepra penale mbahen në Institutin e Psikiatrisë Forenzike deri në *Remision*, pastaj vazhdon trajtimi i tyre nëpër QSHM në formë ambulatorie, si dhe në Shtëpitë Integruese në Bashkësi. Ai sqaroi se QSHM-ve iu mungon baza kompjuterike e të dhënave për shërbimet e ofruara ndaj këtyre pacientëve, prandaj këto qendra nuk kanë informacionet e duhura lidhur me trajtimin terapeutik të këtyre pacientëve dhe kohën e marrjes së terapisë (*sipas protokoleve mjekësore këta pacientë duhet të marrin terapi parenterale çdo 21 ditë*). Sipas tij, çështje në vete paraqesin rastet kur mungon bashkëpunimi i familjarëve me Qendrën e Shëndetit Mendor, prandaj te këto raste trajtim i pacientëve është shumë i vështirë. Ai informoi se lidhur me trajtimin e z. B.D., Gjykata Themelore në Gjakovë, më 10 korrik 2015, e ka ndryshuar masën e trajtimit nga *Trajtimi i Detyrueshëm Psikiatrik me Ndalim* duke e zëvendësuar me masën *Trajtim i Detyrueshëm Psikiatrik në Liri*.

Baza ligjore

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 25, paragrafi 1 përcakton: “*Secili individ gëzon të drejtën për jetën*”, kurse neni 26 përcakton: “*Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]*”
16. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29, paragrafi 1 përcakton: “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente si në vijim:*
 - *Pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;*
 - *Për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;*
 - *Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;*
 - *Për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, [...]*”.

17. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), në nenin 2, përcakton: *“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]”*, kurse neni 5, paragrafi 1 përcakton: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”*.
18. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, në nenin 87, paragrafi 1 përcakton: *“Kryesi me çrregullim mendor ose personi i cili është duke u trajtuar si i tillë, do të trajtohet me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e qenësishëm të njeriut”* kurse paragrafi 2 përcakton *“Standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullim mendor zbatohen për kryesin me çrregullim mendor për aq sa është e mundur, me ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për aq sa janë të nevojshme sipas rrethanave”*.
19. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, në nenin 88 përcakton: *“Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund ti shqiptohen kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli janë:*
trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli”.
20. Ligji për Procedurën Jokontestimore Nr. 03/L-007, në nenin 75 përcakton: *“Sipas rregullave të kësaj procedure gjykata me aktvendim vendosë për mbajtjen e personit të sëmurë mendorisht (psikik) në institucionin shëndetësor, kur për shkak të natyrës së sëmundjes është e domosdoshme që personi i këtyllë të kufizohet në lirinë e lëvizjes dhe të komunikimit me njerëzit jashtë institucionit në fjalë”*.
21. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Nr. 03/L-182, neni 4, paragrafi 1 përcakton: *“Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund ti shqiptohet kryesit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje”*, kurse neni 7, paragrafi 1 përcakton: *“Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje”*.
22. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17 për neni 1.3, përcakton: *“Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të [...] sëmundjes mendore [...]”*.
23. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.02/L-17, neni 3, paragrafi 3 përcakton: *“Në emër të Ministrisë, Departamenti përkatës është përgjegjës për drejtimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha funksioneve operative të përcaktuara me këtë ligj [...] miratimin e themelimit të objekteve rezidenciale për përkujdesje nga ana e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare[...]”*.
24. Ligji Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17, neni 13, paragrafi 2 përcakton: *“Nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, Qendra për Punë Sociale*

- duhet të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për një urdhër kujdestarie”, kurse paragrafi 4 përcakton: “Një urdhër i tillë specifikon hapat që Qendra për Punë Sociale është kompetent t’i ndërmarrë në mënyrë që të mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e personit për të cilin jepet urdhri. Kompetencat që i ka gjykata në dispozicion janë:
- a. *Mbikëqyrja e rrethanave të jetesës të të rriturit të rrezikuar nga ana e një profesionisti të caktuar nga Qendra për Punë Sociale për këtë qëllim, gjersa ai/ajo qëndron në shtëpinë e tij;*
 - b. *Urdhëresa për Qendra për Punë Sociale për të vendosur të rriturin, i cili mendërisht nuk është i aftë për t’u kujdesur për veten në një objekt të përshtatshëm rezidencial [...]”.*
25. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.02/L-17, neni 13, paragrafi 5 përcakton: “Personi i cili është subjekt i një urdhri kujdestarie nuk mund të mbahet asesi në një institucion ndëshkues”, kurse paragrafi 6 përcakton: “Nëse është e nevojshme, gjykatat mund të urdhërojnë Shërbimin Policor të Kosovës që ta ndihmojë Qendrën për Punë Sociale në zbatimin e urdhrit të kujdestarisë”.
26. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L -025, neni 1 përcakton: “Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore”. kurse neni 9, paragrafi 1 përcakton: “Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Në raste të veçanta kjo masë mund të propozohet me kërkesë të komisionit psikiatriko-ligjor. Vendimi përkatës merret nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”.
27. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025, neni 5 paragrafi 1 përcakton parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor ndër të cilat janë:
- 1.1. *“Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.*
 - 1.2. *Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime mendore në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social;*
 - 1.3. *Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore.*
 - 1.4. *Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekipe multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit [...]”.*
28. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L -025, neni 29 paragrafi 1 përcakton: “Këshilli Profesional për Shëndetin Mendor është organ këshillimor i Ministrit të Shëndetësisë. Fushëveprimi, kompetencat, përbërja si dhe mandati i Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor, përcaktohet me akt nënligjor të cilin e propozon Ministria e Shëndetësisë dhe e miraton Qeveria” kurse paragrafi 2 i këtij neni përcakton: “Këshilli profesional për Shëndetin Mendor këshillon ministrin e Shëndetësisë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe për rishikime të rëndësishme ligjore, organizative e teknike në fushën e shëndetit mendor”.

Analiza ligjore

29. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është akti më i lartë juridik, i cili mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit dhe të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë këtu edhe autoritet të cilave ju është drejtuar ky raport.
30. Kushtetuta në nenin 25, paragrafin 1 përcakton: *"Secili individ gëzon të drejtën për jetën"*. Nga ky paragrafi shihet qartë se drejta për respektimin e jetës së qytetarit gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e drejta për jetën (pacenueshmëria e saj) është e drejtë absolute e njeriut, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, shmangia nga kjo e drejtë nuk lejohet. Avokati i Popullit thekson që kur bëhet fjalë për të drejtën e integritetit personal dhe të drejtën në jetë, shteti ka detyrime pozitive, që të ndërmarrë të gjitha masat për të mbrojtur pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe psikik të personave, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në aktgjykimin KI. 41-12, ka gjetur se ka shkelje të së drejtës për jetë, në rastet kur organet gjyqësore apo organet tjera të shtetit nuk u ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve, e kur këtë e kërkojnë rrethanat e rastit. Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe sqaron që ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre, që i janë ekspozuar rrezikut.
31. Avokati i Popullit vëren që Kushtetuta në nenin 26 definon që secili person ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përveç tjerash përfshin edhe të drejtën që: *"Askush të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj, përveç rasteve që janë në pajtim me ligjin [...]"*, kurse neni 29, paragrafi 1 përcakton: *"Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente"*. Sipas këtij neni personi mund të privohet nga liria përveç tjerash edhe në rastet për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, [...]. Autoritet përgjegjëse kanë obligim ligjor që personat me çrregullime mendore të cilët paraqesin rrezik potencial për familjen dhe shoqërinë të mbahen në institucione shëndetësore adekuate dhe në trajtim psikiatrik për aq kohë sa të jetë e nevojshme.
32. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), në nenin 2, përcakton : *"E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]"*, kurse neni 5, paragrafi 1 përcakton: *"Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]"*.
33. Neni 2 i Konventës paraqet detyrat e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshin aspektet pozitive dhe negative:
 - a) *obligimin pozitiv për ta mbrojtur jetën dhe*
 - b) *obligimin negativ që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës.*
34. Obligimi pozitiv imponon detyrime të parandalimit dhe hetimit. Detyrimet e Parandalimit sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ, shih rastin *Osmani kundër Britanisë së Madhe*

të datës 28 shkurt 1998) i obligon qeveritë e shteteve t'i pengojnë dhe luftojnë veprat penale. Nëse vërtetohet që qeveritë kishin njohuri, ose do to duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.

35. GJEDNJ gjatë interpretimit të nenit 2 të KEDNJ tek rasti *Branko Tomašić dhe të tjerët kundër Kroacisë*, lidhur me detyrimet pozitive analizon rastin kur një person ka realizuar kërcënimet e tij të mëparshme për të vrarë partneren e tij dhe vajzën e tyre të vogël. Ai kishte qenë i burgosur për pesë muaj për shkak të kërcënimeve me vdekje që i'a kishte bërë më herët familjes së tij, prandaj autoritetet urdhëruan masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim. Menjëherë pas lirimit të tij, ai vrau gruan e tij dhe fëmijën, para se të bënte vetëvrasje. Gjykata gjeti se autoritetet ishin në dijeni për seriozitetin e kërcënimeve, por dështuan në detyrimet e veta pozitive, para se gjithash për shkak të trajtimit të pamjaftueshëm psikiatrik duke konsideruar se ai zgjati shumë shkurtë, si dhe nuk ishte e qartë se a është trajtuar në të vërtetë dhe si duhet ky person. GJEDNJ gjeti se nuk kishte asnjë vlerësim paraprak të rrezikut para lirimit të tij nga masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, kurse legjislacioni vendor nuk e ka lejuar vazhdimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik edhe pas mbajtjes së dënimit, gjë që sipas gjykatës paraqet shkelje të nenit 2 të KEDNJ. Një situatë të ngjashme kemi edhe në rastin e ankueses kur djali i saj me çrregullime mendore për shkak të trajtimit jo të mjaftueshëm psikiatrik dhe sulmeve fizike të kohëpaskohshme, është kthyer në shqetësim serioz për familjen dhe fqinjët e saj duke e rrezikuar jetën dhe pronën e tyre.
36. KEDNJ, neni 5, paragrafi 1, e lejon ndalimin si të ligjshëm për rastet e ndalimit të *“personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, të alkolizuarve ose toksikomanëve apo rrugaçëve”*. Përsa i përket arsyes se pse personat që bëjnë pjesë në disa nga këto kategori mund të ndalohen, Gjykata u shpreh se *“Jo vetëm që ata duhet të konsiderohen me raste si të rrezikshëm për sigurinë publike, por gjithashtu se vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin përkatës”* (shih rastin *Guzzardi kundër Italisë nr. 7367/76*)
37. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, në nenin 87, paragrafi 1 përcakton detyrimet e autoriteteve që ndaj kryesit me çrregullim mendore ose personit i cili është duke u trajtuar si i tillë, që të trajtohet me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e qenësishëm të njeriut, kurse paragrafi 2, i detyron autoritet që standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullime mendore të zbatohen për kryesin me çrregullim mendor për aq sa është e mundur, me ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për aq sa janë të nevojshme sipas rrethanave të rastit.
38. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, në nenin 88, përcakton masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund të shqiptohen kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore, apo është i varur nga droga ose alkooli. Këto masa sipas kodit janë: *trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli*. Kodi Penal sqaron më tutje se Gjykata, mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se ekziston rrezik serioz se kryesi sërisht do të kryejë vepër penale, prandaj trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale, si dhe kur konstaton se trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz.

39. Ligji për Procedurën Jokontestimore Nr. 03/L-007, në nenin 75 përcakton rregullat e procedurës që gjykata me aktvendim të vendosë për mbajtjen e personit të sëmurë mendërisht (psikik) në institucionin shëndetësor, kur për shkak të natyrës së sëmundjes është e domosdoshme që personi i këtillë të kufizohet në lirinë e lëvizjes dhe të komunikimit me njerëzit jashtë institucionit shëndetësor. Avokati i Popullit në rastet e mëhershme ka gjetur se nuk janë respektuar dispozitat ligjore lidhur me këtë çështje, prandaj ka lëshuar raport me rekomandime për t'iu dhënë fund shkeljeve të tilla (shih raportin e publikuar nga IAP, me nr.protokoli 1488, datë 3 nëntor 2015), kurse me hyrjen në fuqi të Ligjit për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025 (dhjetor 2015), të cilin menjëherë e pasoi hartimi i *Rregullores për Pranimin dhe Trajtimin e Personave me Çrregullime Mendore në Institucionet Profesionale të Shëndetit Mendor*, kjo çështje është zgjidhur.
40. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Nr. 03/L-182, neni 4, paragrafi 1 përcakton rastet kur masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund t'i shqiptohet kryesit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje, kurse neni 7, paragrafi 1 përcakton rastet kur masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje. Nga ankesa e ankueses shihet qartë se gjykata ka marrë aktvendim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik në pajtim me legjislacionin në fuqi, por shqetësimi i ankueses është adresuar të mostrajtimi i vazhdueshëm psikiatrik dhe lirimi i personit me çrregullime mendore nga instituti (trajtimi psikiatrik në ndalim) dhe trajtimi ambulantor i tij (trajtimi psikiatrik në liri).
41. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17 në nenin 1.3 përcakton termin *person në nevojë*, i cili sipas ligjit nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak se:
- a) është fëmijë pa përkujdesje prindore;
 - b) është fëmijë me sjellje asociale, apo është delikuent i mitur;
 - c) ka marrëdhënie të çrregulluara në familje, apo është në moshë të shtyer;
 - d) lëngon nga sëmundja trupore apo aftësitë e kufizuara fizike ose mendore;
 - e) lëngon nga sëmundjet mendore;
 - f) ekspozohet rrezikut nga shfrytëzimi, abuzimi, dhuna në familje apo trafikimi;
 - g) ekspozohet rrezikut të varësisë nga alkooli ose drogat;
 - h) ekspozohet emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu, ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë.

Analizuar nga ajo që u tha më lartë shihet qartë se i biri i ankueses duhet të cilësohet si *person në nevojë* dhe se i njëjti duhet të trajtohet sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

42. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.02/L-17, neni 3, paragrafi 3 përcakton detyrimin që në emër të Ministrisë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Departamenti përkatës është përgjegjës për drejtimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha funksioneve operative të përcaktuara me këtë ligj, ku ndër të tjera përmendet edhe obligimi për miratimin e themelimit të objekteve rezidenciale për përkujdesje nga ana e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, kurse Ligji Për Ndryshimin dhe Plotësimin e

Ligjit Nr. 02/L-17, neni 13, paragrafi 2 përcakton situatat që nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, QPS duhet të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për një urdhër kujdestarie, kurse paragrafi 4 përcakton që urdhri i tillë duhet të specifikon hapat dhe kompetencat që QPS mund t'i ndër marrë me qëllim që të mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e personit për të cilin jepet urdhri. Kompetencat që i ka gjykata në dispozicion sipas këtij ligji janë mbikëqyrja e rrethanave të jetesës të të rriturit të rrezikuar, prandaj mbikëqyrja duhet të bëhet nga ana e një profesionisti të caktuar nga QPS, gjersa personi i mbikëqyrur qëndron në shtëpinë e tij, si dhe urdhëresa për QPS-në për të vendosur të rriturin, i cili mendërisht nuk është i aftë për t'u kujdesur për veten në një objekt të përshtatshëm rezidencial.

43. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.02/L-17, neni 13, paragrafi 5 përcakton që personi i cili është subjekt i një urdhri kujdestarie nuk mund të mbahet asesi në një institucion ndëshkëimor, kurse paragrafi 6 përcakton që nëse është e nevojshme, gjykatat mund të urdhërojnë Shërbimin Policor të Kosovës që ta ndihmojë QPS-në, në zbatimin e urdhrat të kujdestarisë. Nga analiza e rastit shihet se personit me çrregullime mendore nuk i është marrë zotësia e veprimit në pajtim me ligjin, prandaj ai është ndëshkuar nga Gjykata për veprat penale të cilat i ka kryer, si dhe lëvizja e tij e lirë në rrugë është bërë pengesë dhe rrezik serioz për personat tjerë, kurse si rezultat i sëmundjes mendore ai nuk ka mundur të kujdeset për vetveten, prandaj ai ka pësuar aksident komunikacioni nga vetura e policisë (shih paragrafin 5).
44. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015, si qëllim kryesor në nenin 1 paraqet mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor dhe parandalimin e problemeve që lidhen më të, si dhe garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Me këtë ligj përcaktohen procedurat dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.
45. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025, në nenin 5 përcakton parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor, ndër të cilat parashihet parimin e ofrimit të kujdesit shëndetësorë për personat me çrregullime mendore nga ekipet multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit të këtyre personave. Sipas këtij ligji Ekipet multidisiplinare janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, këshilltarë psikosocial, terapeutë të punës, logopedë, terapeutë zhvillimi apo profesionist të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor.
46. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025, në nenin 9, paragrafin 1 përcakton që heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas kësaj dispozite në raste të veçanta kjo masë mund të propozohet me kërkesë të komisionit psikiatriko-ligjor dhe vendimi përkatës duhet të merret nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për heqjen apo kufizimin e zotësisë së veprimit.
47. Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L -025, në nenin 29, e përcakton themelimin e Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor në cilësinë e organit këshillimor të Ministrit të Shëndetësisë, me ç' rast përcakton që fushëveprimi, kompetencat, përbërja si dhe mandati i Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor duhen të përcaktohet me akt nënligjor të cilin e propozon Ministria e Shëndetësisë dhe e miraton Qeveria. Sipas këtij neni, Këshilli Profesional për Shëndetin Mendor

këshillon ministrin e Shëndetësisë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe për rishikime të rëndësishme ligjore, organizative e teknike në fushën e shëndetit mendor, por pavarësisht faktit se ky ligj ka hyrë në fuqi prej dhjetorit të vitit 2015, një veprim i tillë akoma nuk ka ndodhur nga ana e *Ministrit të Shëndetësisë*.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

48. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e ofruara dhe faktet e mbledhura, si dhe ligjet relevante, të cilat përcaktojnë të drejtën për jetën private dhe familjare, si dhe të drejtën shëndetësore, konstaton se ankesa e ankueses është e arsyeshme dhe e ligjshme. Në rastin konkret, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, pasi autoritetet përgjegjëse të cilat sipas legjislacionit në fuqi janë të veshura me kompetencë dhe kanë për obligim ndërmarrjen e detyrimeve pozitive lidhur me rastin, kanë dështuar në plotësimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre në raport me qytetarin.
49. Avokati i Popullit konstaton se bazuar në vendimet e GJEDNJ autoritetet përkatëse kanë dështuar që të ndërmarrin veprime konkrete dhe nuk i kanë zbatuar detyrimet pozitive për të ndërmarrë veprimet e duhura në drejtim të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik deri në marrjen e zotësisë së veprimit të personit me çrregullime mendore, duke parandaluar ushtrimin e dhunës fizike ndaj personave të tretë. Avokati i Popullit konstaton se si pasojë e mostrajtit të duhur psikiatrik, personi me çrregullime mendore ka shkaktuar dhunë në familjen e tij, si dhe tek personat e tjerë, duke rrezikuar seriozisht jetën dhe pronën e tyre, prandaj nga rrethanat e këtij rasti konstatohet se z. B.D., ka ushtruar dhunë fizike ndaj anëtarëve të familjes dhe duke i rrezikuar ata me jetë, por në raste të caktuara kësaj dhune i'u janë ekspozuar edhe fqinjët dhe qytetarët e tjerë (shih paragrafin 3, 4 dhe 5). Avokati i Popullit rikujton se sipas nenit 53, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga vendimet e kësaj gjykate shihet se shtetet kanë detyrime pozitive ndaj shtetasve të tyre.(shih paragrafët 34, 35 dhe 36).
50. Avokati i Popullit konstaton se z. B.D., do të duhej ti nënshtrohej tretmanit të nevojshëm psikiatrik në institucione përkatëse shëndetësore për trajtim të nevojshëm psikiatrik apo ti merrej zotësia e veprimit dhe ti caktohej kujdestari. Nga rrethanat e rastit shihet qartë se lënia pa kujdestar e z. B.D., si dhe qarkullimi i tij i lirë në rrugë ka sjellë deri të pengimi i komunikacionit në rrugë, e më pas edhe te aksidentimi i tij, me ç'rast z. B.D., ka marrë lëndime të rënda trupore nga vetura e policisë (shih paragrafin 5). Avokati i Popullit konstaton se kësaj gjendje i kanë kontribuar edhe neglizhenca e familjes dhe mungesa e bashkëpunimit të autoriteteve përgjegjëse të cilat kanë dështuar të ofrojnë kujdesin e duhur ndaj z. B.D., si dhe të ofrojnë trajtimin e duhur shëndetësor ndaj tij.
51. Avokati i Popullit konstaton se organet kompetente ligjore, nuk kanë bërë sa duhet në ndërmarrjen e masave për detyrime pozitive, respektivisht mbrojtjen e pacenueshmërisë së shëndetit të njeriut, sidomos në rastet kur ajo rrezikohet nga veprimet e rrezikshme të personave me çrregullime mendore, kur ata nuk janë në mjekim të nevojshëm, si dhe kur atyre nuk u janë kufizuar lëvizjet e tyre. Fatkeqësisht raste të tilla janë kthyer në dukuri shqetësuese në shumicën e qyteteve të Republikës së Kosovës, prandaj shëtitjet e lira në rrugë nga kategoria e personave me çrregullime mendore dhe ballafaqimi i qytetarëve me veprimet e tyre të dhunshme po kthehen në brengë dhe rrezik serioz për jetën dhe pronën e tyre.
52. Avokati i Popullit konstaton se lidhur me këtë temë autoritetet përgjegjëse nuk kanë bërë hulumtimet e nevojshme në terren dhe deri më tash autoritetet shëndetësore nuk posedojnë numrin e saktë dhe

statistikat e nevojshme për këtë kategori të personave. Po ashtu deri më tash nuk ka pasur ndonjë rekomandim nga autoritetet përgjegjëse për masat që duhet të ndërmerren, në mënyrë që këta persona të largohen nga vendet publike dhe të vendosen në vende të caktuara, në të cilat varësisht nga nevojat shëndetësore të tyre do të merrnin trajtimin e nevojshëm shëndetësor.

53. Avokati i Popullit konstaton se ka shumë raste kur kjo kategori e personave kanë shkaktuar dhunë fizike me lëndime të rënda trupore dhe me fatalitet (shih paragrafin 13), si dhe dëmtime prone, prandaj autoritetet kompetente kanë obligim ligjor që të ndërmarrin masat e nevojshme me parandalim, që këta persona të marrin trajtimin e nevojshëm psikiatrik, si dhe ndaj kryesve me çrregullim mendore ose personave që janë duke u trajtuar si të tillë, të trajtohen me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e qenësishëm të njeriut, në pajtim me standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullime mendore, me ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për aq sa janë të nevojshme sipas rrethanave të rastit. Avokati i Popullit konstaton se hyrja në fuqi e Ligji për Shëndetin Mendor Nr. 05/L-025, në masë të madhe do të ndikoj në rregullimin e kësaj gjendje, por hartimi i akteve nënligjore dhe themelimi i Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor dhe funksionalizimi i ekipeve multidisciplinare duhet të bëhet sa më parë dhe pa vonesa.
54. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”*. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit *“(…) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (…)*”.

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit:

REKOMANDON

- 1. Ministria e Shëndetësisë, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me të gjitha autoritetet tjera përgjegjëse, të ndërmarrë masa për krijimin e një baze të të dhënave nëpërmjet të cilës do të mund të përcillet tretmani mjekësor i këtyre personave (kalendari i terapisë parenterale-depo), në të cilin bazë të të dhënave mund të kenë qasje të gjitha institucionet e shëndetit mendor në Republikën e Kosovës, të të gjitha niveleve (parësor, dytësor dhe tretësor), duke pasur parasysh respektimin edhe dispozitat e Ligjit për Shëndetin mendor.**
- 2. Institucionet e Shëndetit Mendor, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me Institucionet tjera përgjegjëse, të ndërmarrin veprimet e nevojshme në terren që personat me çrregullime mendore të cilët kanë predispozita të shkaktojnë dhunë fizike dhe dëmtim prone të largohen nga publiku, si dhe trajtohen në Institucionet e Shëndetit Mendor me shtretër derisa të bëhen të parrezikshëm për rrethin dhe shoqërinë.**
- 3. Ministria e Shëndetësisë në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e ekipeve multidisciplinare me qëllim të mbrojtjes së shëndetit mendor të këtyre personave duke provuar maksimalisht që ata të integrohen dhe të risocializohen në familje dhe shoqëri si persona të parrezikshëm, në të kundërtën (kur tretmani rehabilitues nuk ka sukses apo sëmundja mendore është e pashërueshme), të mos përjashtohet mundësia e kërkesës për heqjen e zotësisë së veprimit, si dhe vendosja e tyre në institucione përkatëse, në pajtim me legjislacionin në fuqi.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmermi lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 702/2015

Zharko Dejanoviq

kundër

Komuna e Kllokot – Vërbovcë

Raport në lidhje me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike nga Komuna e Kllokotit

Për: Z. Srecko Spasiq, kryetar i komunës së Kllokot – Vërbovcit

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3,
Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, neni 16 paragrafi 8 dhe neni 27

Prishtinë, më 3 tetor 2016

Qëllimi i raportit

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Komunës së Kllokotit - Vërbovcit (KKV) lidhur me ankesën e z. Zharko Dejanoviq, kryesues i Kuvendit të KKV-së, bazuar në faktet dhe provat, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Neni 135, par. 3 të Kushtetutës e jep kompetencë Avokati të Popullit që të bëjë rekomandime *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Po ashtu sipas, nenit 18.1.2 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi që: *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”.*

Përshkrimi i çështjes

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit të ofruara nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Më 2 tetor 2015, me që në takimin e nëntë të Kuvendit të Komunës, këshilltarët e komunal janë pajtuar se është e nevojshme qasja në listat e pagave të të gjithë të punësuarve në komunë, kryesuesi i KKV-së, i është drejtuar udhëheqësit të personelit në KKV-it, me kërkesë (nr.6403/2), për qasje në *“Listën e të gjithë të punësuarve në komunë”*.
2. Më 5 tetor 2015, z. Zharko Dejanoviq, ka pranuar përgjigjen nga udhëheqësi i personelit (nr.6410/3), sipas të cilës ai njoftohet se kërkesa e tij për qasje në dokumente publike, duhet t’i drejtohet zyrtarit për informim apo zyrtarit të emëruar nga kryetari i komunës, i cili ka të drejtë dhe është i obliguar të kryej shërbimet e kërkuara për qasje në dokumente publike.
3. Më 5 tetor 2015, duke vepruar sipas përgjigjes së udhëheqësit të personelit, ankuesi i është drejtuar z. Vojislav Kostiq, i emëruar nga kryetari i komunës me kërkesë për qasje në dokumente publike (nr.6415/2).
4. Më 7 tetor 2015, z. Dejanoviq, i është drejtuar me kërkesë për qasje në dokumente publike (nr.6428/2), drejtorit të Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Çështje Sociale, Kulturë, Rini dhe Sport, drejtorit të Drejtorisë për Administratë dhe Shërbime Publike, drejtorit për Bujqësi, Pylltari, dhe drejtorit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Urbanizëm.
5. Më 15 tetor 2015, z. Dejanoviq, me që nuk ka pranuar asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e tij, përsëri, i është drejtuar me kërkesë (6462/2) z. Nikola Nojkic, drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.

Veprimet në Institucionin e Avokatit të Popullit

6. Më 18 dhjetor 2015, Avokati i Popullit, ka pranuar ankesën e z. Zharko Dejanoviq, kryesues i Kuvendit të Komunës Kllokot - Vërbovcë, lidhur me mospërgjigjen e Komunës së Kllokot - Vërbovcit, në kërkesat e tij nr. 6403/2, 6415/2, 6428/2, 6462/2, për qasje në dokumente publike, si dhe përgjigjen e pjesshme (nr.6410/3) dhe të paarsyetuar të komunës, përkitazi me kërkesën të evidentuar me nr. 6403/2.

7. Më 5 janar 2016, përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), me qëllim të hetimit të rastit, vizitoi Komunën e Kllokot - Vërbovcit, bisedoi me kryetarin e komunës, me që ai nuk kishte njohuri për kërkesat e ankuesit për qasje në dokumente publike, fillimisht u njoftua për kërkesat dhe u kërkua nga ai që organet përgjegjëse të përgjigjen në kërkesat e ankuesit. Në fund të takimit kryetari i komunës premtoi se do të interesohet lidhur me kërkesat dhe se ankuesi do të marrë përgjigjen e duhur.
8. Më 21 janar 2016, përfaqësuesi i IAP-it, bisedoi me ankuesin dhe u njoftua se ai nuk ka pranuar përgjigjen.
9. Më 4 shkurt 2016, përfaqësuesi i IAP-it, bisedoi me Zyrtares për të Drejtat e Njeriut, e cila pohoi se ankuesit i është kthyer përgjigja.
10. Më 14 mars 2016, ankuesi, përsëri pohoi se nuk ka pranuar përgjigje.
11. Më 15 mars 2016, përfaqësuesi i IAP-it, kërkoi nga përgjegjësit e komunës, kopjen e përgjigjes së kthyer ankuesit.
12. Më 17 mars 2016, përgjegjësit e komunës, i ofruan përfaqësuesit të IAP-it, kopjen e përgjigjes për ankuesin, mirëpo përgjigja e ofruar nr.6410/3, është e datës 5 tetor 2015, të cilën z. Dejanoviq, e ka pranuar nga udhëheqësi i personelit, sipas të cilës ai njoftohet se kërkesa e tij për qasje në dokumente publike, duhet t'i drejtohet zyrtarit për informim apo zyrtarit të emëruar nga kryetari i komunës, i cili ka të drejtë dhe është i obliguar të kryej shërbimet e kërkuara për qasje në dokumente publike.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta e Kosovës), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të Drejtën për Qasje në Dokumente Publike, sipas së cilës definohet që: *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”*.
14. Paragrafi 2, i po të njëjtit nen të Kushtetutës së Kosovës, përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet, janë të arritshme për të gjithë, në përjashtim të atyre dokumenteve qasja e të cilave është e kufizuar me ligj: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”*.
15. E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila secilit i garanton *“Lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”*.
16. Lirinë për të marrë dhe dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane “Liria e Shprehjes”: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*.
17. Sikurse Kushtetuta e Kosovës, po ashtu edhe Konventa Evropiane, e parashohin si një të drejtë e cila nuk është absolute dhe kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet për arsye të caktuara: *“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”*.

18. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës së Kosovës, është përcjellë edhe në nenin 1, të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215 (në tekstin e mëtutjeshëm LQDP), sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike”*.
19. Neni 4, paragrafi 1, të LQDP, specifikon që: *“Çdo kërkues i dokumentit, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj”*, ndërsa paragrafi 4 saktëson se *“Dokumentet publike të pranuar nga kërkuesi nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale”*.
20. Neni 7, paragrafi 2, përcakton se : *“Nëse institucioni publik nuk posedon, nuk disponon ose nuk e mbikëqyrë informatën, e ka njohuri për organin gjegjës, resorin e tij ose institucionin tjetër, menjëherë ose më së voni pesë (5) ditë pune, nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim të kërkuesit, është i detyruar që kërkesën t’ia përcjellë organit gjegjës ose sektorit të tij, i cili e posedon, disponon ose e mbikëqyrë informatën.”* , ndërsa në paragrafin 3, përcaktohet se : *“Për këto veprime institucioni përkatës publik, nga paragrafi 2. i këtij neni, është i detyruar që ta njoftojë kërkuesin. “, po ashtu i njëjti nen në paragrafin 8, të LQDP thekson se : “Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj”*.
21. Neni 12, paragrafi 1, i LQDP, parashihet arsyet e përjashtimit të së drejtës për qasje në dokumente publike: *Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:*
- 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
 - 1.2. sigurisë publike;
 - 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;
 - 1.4. hulumtimeve disiplinore;
 - 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;
 - 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;
 - 1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;
 - 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
 - 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
 - 1.10. mjedisit, apo,
 - 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.
22. Neni 12, paragrafi 2, i LQDP, thotë se: *“Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin”*.
23. Neni 17, paragrafi 1, i LQDP, *“Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar”*.
24. Ligji Nr. 03/L-40 Për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), neni 4, paragrafi 4, përcakton se : *“Të gjitha autoritetet komunale u përgjigjen qytetarëve të komunës në format e përcaktuara me ligj”*.
25. Neni 39, paragrafi 2, thotë se : *“ Anëtari i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga zëvendëskryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.”*
26. Ndërsa, paragrafi 5, i po të njëjtit nen, përcakton se : *“Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngrisë çështjen në kuvendin e komunës.”*

27. Neni 68, paragrafi 5, i LVL, përcakton se : “Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.”
28. Neni 9.1, i Ligjit Nr. 02/L-28 Për Procedurën Administrative (në tekstin e mëtutjeshëm LPA), parasheh që “Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”, dhe 9.2. “Çdo person fizik dhe juridik, pa qenë e nevojshme të tregojë interes specifik, në raportet me organet e administratës publike, ka të drejtat procedurale që vijojnë:
- a) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike,
 - b) brenda një kohe të arsyeshme,
 - c) në të njëjtën mënyrë si për çdo person tjetër,
 - d) me mjete të përshtatshme dhe efektive”.
29. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013, për Transparencë në Komuna, i cili ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve të komunës përmes rregullave që mundësojnë ushtrimin dhe zhvillimin e praktikave më të mira administrative për qasje në dokumente publike, parasheh procedurat për qasje të publikut në dokumente publike.

Analiza e rastit

Lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente publike

30. Avokati i Popullit, bazuar në analizën legjislacionit dhe fakteve të paraqitura me lart, lidhur me ankesën e z. Dejanoviç, për qasje në dokumente publike në Komunën e Kllokot - Vërbovcit, vëren se kjo e drejtë është e garantuar me instrumentet ndërkombëtare, Kushtetutë, dhe aktet tjera ligjore të lartpërmendura.
31. Ankuesi më 2 tetor 2015, i është drejtuar institucioneve publike përkatëse të Komunës së Kllokotit - Vërbovcit, me katër kërkesa: nr. 6403/2, 6415/2, 6428/2, 6462/2, për qasje në dokumente publike të komunës (shih pikën 6 të raportit). Por nuk ka marr asnjë përgjigje nga komuna e Kllokot - Vërbovcit, përkundër të drejtës dhe detyrimit ligjor të Komunës sipas nenit 7, paragrafi 8 të LQDP, për dhënien e përgjigjes në afat ligjor prej 7 ditëve, nga dita e parashtrimit të kërkesës “Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes së plot, apo të pjesërishtme”.
32. Avokati i Popullit, po ashtu vëren se udhëheqësi i personelit në komunën në fjalë, përkitazi me kërkesën me nr. 6403/2, datë 2 tetor 2015, për qasje në “Listën e pagave për të gjithë të punësuarit në komunë”, i është përgjigjur në afatin ligjor. Mirëpo edhe përkundër përgjigjes në afatin ligjor, Avokati i Popullit, vëren se në rastin në fjalë, institucioni publik është dashur që kërkesën në fjalë ta përcjellë tek personi përgjegjës dhe se është dashur që të respektohet paragrafi 2 dhe 3, i nenit 7 të LQDP, i cili përcakton obligimin ligjor të institucioneve publike për përcjelljen e kërkesës organit gjegjës ose sektorit të tij, i cili e posedon, disponon ose e mbikëqyrë informatën dhe për këto veprime institucioni përkatës publik është i detyruar që ta njoftoj kërkuuesin (paragrafi 3), ndërsa në rastin në fjalë, sipas përgjigjes, vërehet se në vend që të përcjellët kërkesa tek institucioni publik përkatës, kërkuesi është njoftuar që me kërkesë t’i drejtohet institucioneve tjera në komunën e Kllokot-Vërbovcit.
33. Po ashtu, edhe pse sipas përgjigjes vërehet se kërkesa e z. Dejanoviç për qasje në listat e pagave refuzohet, përgjigja në fjalë nuk e përmban edhe këshillën për shfrytëzimin e mjeteve juridike ashtu sikurse parashihet në nenin 7, paragrafi 8, i LQDP: “Institucioni publik obligohet që [...] të informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim”.
34. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, thekson se vonesat në dhënien e informatës mund t’i heqin në mënyrë të vazhdueshme, apo të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të, sepse

një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t'i mohojë këtij lajmi tërë vlerën dhe interesin (shih rasti *The SundayTimes V. The United Kingdom*)⁶⁹.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

35. Avokati i Popullit, konstaton se z. Srecko Spasic, kryetar i komunës së Kllokot - Vërbovcit, në takimin me përfaqësuesin e IAP-it, më datën 5 janar 2016, lidhur me rastin e ankuesit, premtoi se do të angazhohet që ankuesi të pranoj përgjigjen brenda një jave, gjë të cilën nuk e ka dëshmuar deri më tani.
36. Po ashtu, Avokati i Popullit, lidhur me pjesën e përgjigjes se: “ [...] zyrtari i emëruar nga kryetari i komunës është i obliguar të kryej shërbimet e kërkuara [...]”, vëren se ofrimi i qasjes në dokumente dhe pajisja me informata nuk është shërbim, por është e drejtë, e garantuar me instrumente ndërkombëtare, kushtetutë dhe aktet tjera ligjore të përmendura më lart. GJEDNJ në rastin *Autronic Ag V. Switzerland*, thekson se “*Liria për të marrë informacion, përfshin të drejtën për të mbledhur dhe kërkuar informacione, nëpërmjet të gjitha burimeve të mundshme ligjor*”⁷⁰
37. Në anën tjetër, Avokati i Popullit e mirëpret gatishmërinë për bashkëpunim, dhe vlerëson se detyra e kryetarit të komunës është kyçe në forcimin e transparencës dhe demokracisë dhe urë lidhëse ndërmjet institucioneve publike si dhe në mes komunës dhe qytetarit, andaj ka edhe përgjegjësi ligjore, të përgjigjes në parashtrësat e ndryshme të qytetarëve, duke përfshirë edhe ato të qasjes në informata. Siç theksohet në aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Observer And Guardian V. The United Kingdom*⁷¹ “*T’i mohosh publikut informacione mbi funksionimin e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë*”.
38. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se “*Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik*”, si dhe duke u bazuar në faktet e ofruara si më lart, konstaton se mos përgjigja e Komunës së Kllokotit -Vërbovcit, përkitazi me kërkesën e z. Dejanoviq, dhe përgjigja jo e plotë në kërkesë, janë në kundërshtim me dispozitat e LQDP.
39. Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët të shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënien, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 27, të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit :

Rekomandon

- ***Komunën e Kllokot – Vërbovcit, që ta shqyrtojë kërkesën e z. Dejanoviq, për qasje në dokumente publike, në pajtueshmëri me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.***
- ***Që Komuna, të ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë, lidhur me zbatimin Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, si dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë komuna e Kllokot – Vërbovcit, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartcekura.

⁶⁹ *Case Of The Sunday Times V. The United Kingdom*, (Application no. 6538/74), 26 april 1979

⁷⁰ *Case Of Autronic Ag V. Switzerland*, (Application no.12726/87), 22 May 1990

⁷¹ *Case Of Observer And Guardian V. The United Kingdom*, (Application no.13585/88), 26 November 1991

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor, më së largu brenda tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të këtij raporti.

Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 733/2015

Florije Govori - Fejzullahu

kundër

Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Raport me rekomandime lidhur me dështimin e MASHT-it, për shqyrtim në afatin ligjor të ankesës së parashtruar nga znj. F. G.

Për: Z. Arsim Bajrami, ministër
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
Rruga “Agim Ramadani”
10000 Prishtinë

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3;
Ligji për Avokatin e Popullit 05/L -019, neni 18.1.2

Prishtinë, 7 tetor 2016

Qëllimi i raportit

Ky raport ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së MASHT-it, lidhur me të drejtën e znj. Govori - Fejzullahu, për t'u informuar për ankesën e parashtruar më 14 maj 2015, me numër 1617, kundër vendimit 01/146 të datës 22. 04. 2015, të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prizrenit (UPZ) "Ukshin Hoti" në Prizren, me të cilin është shkarkuar nga pozita e Prorektore për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore."*

Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 18 paragrafi 1.2. përcakton se Avokati i Popullit ka përgjegjësi; *"të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla"*

Përmbledhja e fakteve të rastit

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) përmbledhen si në vijim:

1. Më 15 prill 2015, Këshilli Drejtues i UPZ "Ukshin Hoti" në Prizren, duke vendosur sipas propozimit të Rektorit të UPZ-së, ka nxjerrë vendimin Nr.1 ref.170/2015, sipas të cilit *"Shkarkohet nga pozita e Prorektore për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë Prof.Ass.Dr.Florie Govori Fejzullahu"*
2. Më 14 maj 2015, ankuesja kundër vendimit në fjalë i drejton MASHT-it ankesën nr.1617, duke e kundërshtuar vendimin e lartpërmendur si të jashtëligjshëm.
3. Më 28 dhjetor 2015, ankuesja parashtrori në IAP ankesë kundër MASHT-it, për shkak të zvarritjes së procedurës lidhur me dhënien e përgjigjes në ankesën nr. 1617, të datës 14. 5. 2015.
4. Më 12 janar 2016, ankuesja u njoftua se AP i ka hapur hetimet lidhur me çështjen e saj.
5. Më 4 shkurt 2016, Avokati i Popullit, i dërgoi shkresë Ministrit të MASHT-it, me të cilën kërkoi të informohet për veprimet e ndërmarra nga kjo ministri, që ky rast të procedohet brenda afatit të arsyeshëm kohor, në pajtim me ligjin.
6. Më 29 shkurt 2016, ankuesja e informoi Avokatin e Popullit, se lidhur me ankesën e saj, ende nuk ka marr kurrfarë përgjigje nga ana e MASHT-it.
7. Më 11 mars 2016, Avokati i Popullit i drejtoi letër përsëritëse ministrit të MASHT-it, lidhur me rastin e ankueses.
8. Më 11 maj 2016, Avokati i Popullit mori përgjigje lidhur në letrën e datës 11 mars 2016, me të cilën njoftohet se përkitazi me ankesën e znj.Govori-Fejzullahu, kundër MASHT-it, Komisioni për Parashtrësia dhe Ankesa i MASHT-it, ka marrë vendim për mos shqyrtimin e kësaj lënde për shkak të inkompetencës së tij, dhe se shqyrtimi i lëndëve të tilla hyn në sfondin e përgjegjësive mandatore të Këshillit/ave Drejtues/e të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë. Të njëjtën ditë, Avokati i Popullit, pranoi edhe vendimin nr.613/2-1K, të nxjerrë nga Komisioni për Parashtrësia dhe Ankesa, sipas të cilit *"Nuk shqyrtohet ankesa Nr.613-2 e datës 11.03.2016 e parashtruar nga Z. Hilmi Jashari – Avokat i Popullit, për Znj.Florie Govori-Fejzullahu."*

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë

9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (KRK), në nenin 31, paragrafi 1, përcakton se: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.
Ndërsa në nenin 32 përcakton: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*
10. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Në paragrafin 1 të nenit 6, të KEDNJ shprehimisht theksohet se : *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*

Ligji për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28

11. Ligji për Procedurën Administrative (LPA), në nenin 11, përcakton shprehimisht obligimin për vendimmarrje *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë.”*
12. Në nenin 38, të po të këtij ligji, në mënyrë të detajuar parashihet fillimi i procedimit administrativ nga pala dhe obligimi i organit për dhënie të përgjigjes me shkrim:
“38.4. Drejtuesi i organit të administratës publike shqyrton menjëherë kërkesat për veprim drejtuar organit nga pala e interesuar dhe kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar dhe se procedimi administrativ ka filluar, ose*
 - b) njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa nuk është pranuar dhe se pala mund të ankohet kundër këtij vendimi sipas procedurës të parashikuar në nenin 101 të këtij Ligji ose;*
 - c) njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative përpara se organi t'i përgjigjet kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme.”*
13. Neni 90 në paragrafin 1 të po këtij ligji, rregullon mënyrën e shpalljes së akteve administrative *“Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh.”*
14. Neni 92 parasheh se akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet, sipas pikës c) : *“kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga ky ligj ose ndonjë ligj tjetër,”* ndërsa paragrafi d) parasheh se : *“kur akti është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ky Ligj ose ndonjë ligj tjetër.”*
15. Ndërsa sipas nenit 131.1, përcaktohet afati për marrjen e vendimit : *“Organi administrativ kompetent shqyrton ankimin administrativ dhe nxjerrë vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të ankimit”*.
16. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04-L-037, në nenin 27 paragrafi 5, parasheh ; *“ Personeli akademik dhe personeli tjetër i bartësit të arsimit të lartë gëzon të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo veprim të institucionit të arsimit të lartë dhe për t'ia drejtuar atë ankesë fillimisht Ministrisë dhe pastaj një gjykatë kompetente.”*
17. Statuti i UPZ “ Ukshin Hoti” nr.04-V-621, i datës 30 maj 2013, në nenin , 185, thekson; *“Personeli akademik dhe joakademik kanë të drejtë t'i kundërshtojnë vendimet e marra nga organet e Universitetit, nga njësitë akademike apo nga njësitë organizative rreth të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësi të tyre”*. Ndërsa paragrafi 3. Pika 6, e po këtij neni këtë çështje e precizon edhe më,

duke përcaktuar se personeli akademik dhe joakademik mund të kundërshtojë vendimin tek: *“Ministria, nëse vendimi në instancë të parë është bërë nga Këshilli Drejtues”*.

Analiza ligjore

18. Këshilli Drejtues i UPZ “Ukshin Hoti” në Prizren, bazuar në kompetencat që ka, më 15 prill 2015, ka nxjerrë vendimin nr.i ref.170/2015, sipas të cilit vendim znj. Govori Fejzullahu, shkarkohet nga pozita e Prorektorese për buxhet, financa dhe infrastrukturë, mirëpo, Avokati i Popullit, vëren se, edhe pse sipas vendimit, ankueses i është dhënë këshilla juridike për të drejtën e ankesës në afat prej 15 dite, ajo nuk përmban një kujtesë se ankuesja ka të drejtë të apeloj kundër vendimit në rrugë administrative ose gjyqësore. Me që vendimi i Këshillit Drejtues të UPZ “Ukshin Hoti” nuk përmban informacione si akt administrativ, Avokati i Popullit konstaton se ai është në kundërshtim me nenin 84, paragrafi 2, pika g) e LPA.
19. Kundër vendimit të Këshillit Drejtues, ankuesja më 14 maj 2015, i ka parashtruar ankesë ministrit të MASHT-it, e cila është bartur në Komisionin për Parashtrësia dhe Ankesa në MASHT, mirëpo që nga atëherë ankuesja nuk ka pranuar përgjigje lidhur me të. Çështja e mostrajtimimit, përkatësisht e mosinformimit të znj. Govori - Fejzullahu, ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për proces të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm kohor. E drejtë kjo e sanksionuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, sipas të cilit; *“Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile çdo kush ka të drejtë për proces të hapur dhe të drejtë brenda një afati të arsyeshëm (...)”*.
20. Avokati i Popullit vëren se, zvarritja e procedurës ka ndodhur si pasojë e dështimit të MASHT-it, për të trajtuar ankesën e ankueses ashtu siç e parasheh ligji, konkretisht LPA, i cili në nenin 11 parasheh shprehimisht se; *“Organet e Administratës Publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë”*. Gjithashtu ligji në fjalë, precizon saktësisht situatat dhe afatet për përgjigje, madje edhe kur këto organe e konsiderojnë veten inkompetente.
21. Për shkak të zvarritjes së procedurës në rastin e ankueses, Avokati i Popullit më 4 shkurt 2016, i është drejtuar MASHT-it nëpërmjet një letre, si dhe më 11 mars 2016, me letër përsëritëse, lidhur me të cilën më 6 prill 2016 ka marr shkresën, dhe bashkëngjitur me të një vendim, me këtë përmbajtje: *“Nuk shqyrtohet ankesa nr.613-2 e datës 11.3.2016 e parashtruar nga zoti Hilmi Jashari – Avokat i Popullit, për znj. Florije Govori Fejzullahu”*. Ndërsa më tej në arsyetimin të këtij vendimi, Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; *“...shpallet jo kompetent për shqyrtimin dhe trajtimin e kësaj lënde”*.
22. Avokati i Popullit konstaton, se trajtimi i ankesës së znj. Govori-Fejzullahu, nga MASHT-i, si ankesë e ushtruar në emër të saj nga ana e Avokatit të Popullit, është në kundërshtim me LPA, në të cilin ligj, saktësohen me përpikëri, subjektet e procesit juridiko-administrativ, parashtrësia si dhe obligimet e organeve vendimmarrëse për të vendosur lidhur me parashtrësia.
23. Avokati i Popullit nuk është palë dhe as përfaqësues i ankueses siç trajtohet në këtë vendim. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L -019, neni 16, në lidhje me kompetencat dhe mandatin e tij thuhet shprehimisht: *“Avokati i Popullit ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera,...”*. çka d.m.th. se Avokati i Popullit nuk përpilon parashtrësia në emër të palëve dhe nuk i përfaqëson ato në procedurat gjyqësore apo administrative. Prandaj edhe në këtë rast, kërkesa e tij ka qenë informimi në lidhje me fazën në të cilën ndodhet procedura në çështjen e ankueses, si dhe veprimet e ndërmarra nga ana e MASHT-it, që rasti të procedohet brenda një afati të arsyeshëm kohor në pajtim me ligjin.
24. Avokati i Popullit konstaton se, mospërgjigja e ministrit të MASHT-it si dhe shpallja jo kompetent e Komisionit për Parashtrësia dhe Ankesa, lidhur me shqyrtimin e ankesës së znj. Govori-Fejzullahu, me të cilin vendim informohet Avokati i Popullit, e jo ankuesja, që është palë në këtë raport juridiko - administrativ, bie në kundërshtim të plotë me nenin 18, paragrafi 1 të LPA nr.02/L-28, i cili

shprehimisht precizon ; “ a) organi i administratës publike, të cilit gabimisht i drejtohet kërkesa, brenda 2 ditësh pune nga dorëzimi i kërkesës, merr vendim me anë të të cilit konstaton jo kompetencën nga ana e tij për çështjen”.

25. Avokati i Popullit është i brengosur veçanërisht, lidhur me trajtimin e ankueses për faktin se kur ajo më datën 14 maj 2016, është paraqitur në MASHT- Zyra e Protokollit, për të marrë përgjigjen lidhur me ankesën, përgjigja nuk është dhënë nga nëpunësi i kësaj zyre me arsytim; “se një kopje të vendimit është dashur tua jap Avokati i Popullit...”.
26. Avokati i Popullit thekson se e drejta e ankueses për një proces administrativ, pa zvarritje është e garantuar edhe me LPA. Në nenin 90, paragrafi 1, në mënyrë precize saktësohet afati kohor i shpalljes së akteve administrative; “Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh.” Ndërkaq në rastin e znj. Govori-Fejzullahu, kanë kaluar afër 18 muaj, dhe fakti se ajo ende nuk ka marrë përgjigje edhe në kohën kur po e hartojmë këtë raport, dëshmon për shkelje të së drejtës, përkatësisht mohim të kësaj të drejte të garantuar me kushtetutë dhe ligj.
27. Meqë sipas nenit 27, paragrafi 5, të Ligjit për Arsimin e Lartë, po ashtu edhe sipas nenit 185, paragrafi 3, pika 6, të Statutit të UPZ “Ukshin Hoti”, ankesa fillimisht duhet t’i drejtohet ministrisë e pastaj një gjykate kompetente, edhe ankuesja me të drejtë i është drejtuar MASHT-it dhe ka kërkuar shqyrtimin e rastit, por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje. Pra, ministri i MASHT-it, nuk e ka trajtuar ankesën, e ka hedhur përgjegjësinë për zgjidhjen e çështjes, tek Komisioni për Parashtrësia dhe Ankesa, i cili ka nxjerrë vendim për jo kompetencë, gjë që si rrjedhojë ankueses i është mohuar realizimi i të drejtës, nuk i është ofruar përgjigje sipas ankesës. Veprimet e MASHT-it, nuk mund të konsiderohen si arsytim për refuzimin e shqyrtimit të ankesës së ankueses gjë që , me të drejtë parashtrohet pyetja, se ku tjetër duhet kërkuar mbrojtjen e të drejtave për shkeljet e kryera nga autoritetet publike , kujt duhet t’i adresohet ankesa, pasi që sipas ligjit dhe sipas Statutit të UPZ “Ukshin Hoti” parashihet që fillimisht ankesa t’i drejtohet Ministrisë dhe pastaj gjykatës, e në rastin konkret ankuesja i është drejtuar Ministrisë.
28. E përkujtojmë se ministri i MASHT-it, më 22 tetor 2015, ka nxjerrë vendimin Ref.nr.332/01B, sipas të cilit ka vendosur që të shfuqizohet vendimi Nr.Prot.2/378, i datës 21.10.2015, i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës ”Hasan Prishtina”, prandaj edhe në rastin e ankueses kemi të bëjmë me ankesë kundër vendimit të Këshillit Drejtues të UPZ “Ukshin Hoti”, Avokati i Popullit konsideron se ministri është dashtë të angazhohet që ankuesja të marrë përgjigje në afatin ligjor.
29. Në të vërtetë, duket qartë se ankueses i është pamundësuar, shfrytëzimi i mjeteve efektive juridike, prandaj Avokati i Popullit, vlerëson se, mos marrja parasysh e këtyre fakteve të rëndësishme është në kundërshtim të plotë me kërkesat e Nenit 32 të Kushtetutës.
30. Avokati i Popullit, konstaton se dispozitivi dhe arsytimi i vendimit Ref.613/2-1K, i datës 04.05.2016, i nxjerrë nga Komisioni për parashtrësia dhe ankesa, është i pasaktë dhe përmban gabime të dukshme, për shkak se Avokati i Popullit nuk ka ushtruar ankesë më 11.03.2016, por përmes shkresës ka kërkuar informata në lidhje me ankesën e znj. Govori – Fejzullahu, me nr.1617 të parashtruar më 14 maj 2015, ministrit të MASHT-it, vendimi në fjalë i bashkëngjitur në përgjigjen dërguar Avokatit të Popullit, nuk është nxjerrë në përputhje me nenin 92, pika c) dhe d) të LPA, sipas të cilit parashihet se një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm nëse nxirret në kundërshtim me formën e kërkuar nga ky ligj por edhe në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ky ligj.
31. Po ashtu vendimi në fjalë është nxjerrë edhe në kundërshtim me nenin 84.2 (g) dhe (h), sipas të cilit, në mesin e tjerave vendimi duhet të përmbajë ;” një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të apelojnë kundër vendimit në rrugë administrative ose gjyqësore; dhe (h) një kujtesë për afatet kohore që palët duhet t’i kenë parasysh për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ose të ankimit administrativ apo gjyqësor.”

32. Nga të dhënat e prezantuara më lart, Avokati i Popullit gjithashtu konstaton se në rastin e ankueses ka zvarritje të paarsyeshme të procedurës për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës së saj, nga ana e MASHT-it, pasi që nga inicimi i ankimit, nga maji i vitit 2015 e deri më sot, kanë kaluar afro 18 muaj dhe ankuesja ende nuk ka marr kurrfarë përgjigje. Prandaj kjo zvarritje e paarsyeshme dhe e tepruar në rastin e ankueses dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë nga MASHT-i, çka përbën shkelje të nenit 31, dhe 54 të KRK-së, si dhe nenit 6, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
33. Lidhur me zbatimin e nenit 13 të KEDNJ, Avokati i Popullit përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa raste ka theksuar shprehimisht, se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, përbëjnë një kërcënim serioz për sundimin e ligjit.
34. Prandaj, zvarritja dhe jo-efikasiteti i procedurave sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, parim ky i sanksionuar me aktet më të larta ligjore si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare, që autoritetet e Kosovës kanë për obligim t'i respektojnë pa përjashtim.

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit i rekomandon:

Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe të Teknologjisë që :

1. *Të garantojë shqyrtimin e ankesave për të gjitha palët, brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe në pajtim me ligjet në fuqi.*
2. *Të shpallë absolutisht të pavlefshëm aktin administrativ (neni 93.3)⁷²*
3. *Nxjerrjen e aktit administrativ në bazë të Ligjit për Procedurën Administrative (neni 84), (përmbajtja e aktit administrativ).*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019, (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,
 Hilmi Jashari
 Avokat i Popullit

⁷² Neni 93,3, i LPA, përcakton : “*Secila palë e interesuar mund t’i drejtohet në çdo kohë organit të administrates publike me një kërkesë për shpalljen e një akti të caktuar si absolutisht të pavlefshëm.*”

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 160/2015

Bajram Kadrija

kundër

Komunës së Gjakovës

Raport përkitazi me shkeljen e të drejtave që dalin nga marrëdhënia e punës

Për: Znj. Mimoza Kusari-Lila, kryetare
Komuna e Gjakovës

Kopje: Z. Arban Abrashi, ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Znj. Violeta Xërxa-Thaçi, Drejtore
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë

Z. Vaton Durguti, Kryetar
Gjykata Themelore në Gjakovë

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3, Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, neni 16 paragrafi 8 dhe neni 27

Prishtinë, më 10 tetor 2016

VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

1. Më 20 mars 2015 z. Bajram Kadrija ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër Kryetares së Komunës së Gjakovës dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjakovë, që ka të bëjë me mosekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), si dhe të vendimeve të plotfuqishme të Trupës Ekzekutive të Inspektorëve të Punës (TEIP), lidhur me kthimin e tij në pozitën e mëparshme të punës: “*Kryeshefi Departamentit të Mjekësisë Familjare në QKMF në Gjakovë*”.
2. Më 30 mars 2015, ankesa është regjistruar në IAP (nr. i ankesës 160/2015).
3. Më 2 prill 2015, përfaqësuesi i AP-së bisedoi me shefin e Zyrës së Personelit në Komunën e Gjakovës, lidhur me çështjen e ankuesit. Ai e njoftoi se Komuna e Gjakovës ka pranuar Vendimin e KPMSHCK (*Vendimi nr. A. 02/301/2014*), por të cilin e ka përcjellë te QKMF për shkak të inkompetencës, duke sqaruar se më pas ka pasuar edhe njoftimi i KPMSHCK (*njoftimi nr. 653/2015*), drejtuar Zyrës së Kryeministrit me kërkesë për ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për shkak të moszbatimit të vendimit të KPMSHCK. Sipas tij përmbushja e obligimeve të vendimit bie në kompetencën e komisionit të QKMF-së, prandaj ai i ka dërguar shkresat te QKMF, që të procedojë më tutje me këtë çështje.
4. Më 15 prill 2015, përfaqësuesi i AP-së bisedoi me drejtoreshën e QKMF-së lidhur me çështjen e ankuesit. Ajo ishte e kufizuar në përgjigjet e saj lidhur me veprimet e ndërmarra nga QKMF në çështjen e ankuesit, prandaj kishte kërkuar t'i jepen disa ditë kohë që të mund të sqarohet me administratën e QKMF-së, me premtimin se AP do të njoftohet për zhvillimet e ngjarjes.
5. Më 5 maj 2015, përfaqësuesi i AP-së u takua me drejtoreshën e QKMF, e cila e informoi se sipas drejtorit komunal të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), lënda e ankuesit kishte kaluar në procedurë gjyqësore, prandaj duhet pritur vendimin e gjykatës. Ajo nuk i dha kurrfarë dokumentacioni përfaqësuesit të AP-së lidhur me këtë çështje, dhe se e tërë ngjarja sipas saj bazohej në thëniet e drejtorit të DSHMS.
6. Më 12 qershor 2015, përfaqësuesi i AP-së bisedoi me kryeinspektorin e Punës pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), lidhur me çështjen e ankuesit. Ai e njoftoi se Inspektorët e Punës të TEIP, kanë nxjerrë dy vendime në favor të ankuesit në të dy instancat, dhe sipas tyre QKMF nuk ka iniciuar konflikt administrativ kundër vendimit të TEIP. Sipas tij, pavarësisht kësaj ankuesi mund të realizojë të drejtën e tij përmes procedurës përmbarimore në gjykatë mbi bazën juridike të përmbarimit të vendimeve administrative.
7. Më 22 qershor 2015, përfaqësuesi i AP-së bisedoi me drejtorin e DSHMS, r me qëllim të informimit me procedurat që janë duke u zhvilluar në çështjen e ankuesit. Ai hezitoi të japë informacione lidhur me këtë çështje dhe theksoi që për të marrë informacionet e kërkuara, duhet t'i drejtohem me kërkesë me shkrim.
8. Më 23 qershor 2015, përfaqësuesi i AP-së zhvilloi takim të përbashkët me kryetaren e Komunës së Gjakovës dhe me drejtorin e DSHMS, me të cilët bisedoi lidhur me çështjen e ankuesit. Ata shprehën keqardhje se AP është duke u marrë me çështjen e ankuesit, pasi sipas tyre ankuesi: “*Është personazh skajshmërisht i politizuar dhe vjen nga komuna e Deçanit*”. Ata shprehën qëndrimin se ankuesi ka arritur t'i bindë institucionet relevante që të vendosin në favor të tij, duke e apostrofuuar edhe AP-në. Sipas tyre askush nuk po pyet se si ka ardhur ankuesi në këtë pozitë, pa u respektuar asnjë kriter ligjor, por pas shkarkimit të tij, të gjitha institucionet po kërkojnë zbatimin e vendimeve

të cilat sipas tyre janë të ndikuara politikisht. Në fund të takimit ata shprehën qëndrimin që kjo çështje do të analizohet edhe një herë nga ana e autoriteteve përgjegjëse komunale dhe varësisht nga epilogu do të njoftohemi me zhvillimet e tjera.

9. Më 10 korrik 2015, përfaqësuesi i AP-së i dërgoi email kryetares së komunës së Gjakovës nga e cila kërkoi informacione lidhur me zhvillimet e ndërmarra nga ana e tyre në çështjen e ankuesit.
10. Më 14 korrik 2015, AP ka pranuar email nga drejtori i DSHMS në Gjakovë i cili njoftoi se lidhur me çështjen e ankuesit QKMF ka iniciuar konflikt administrativ, në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GJTHP), Departamenti për Çështje Administrative, por pa prezantuar kopje të padisë apo numër të lëndës në gjykatë.
11. Më 3 shtator 2015, përfaqësuesi i AP-së u takua sërish me drejtoreshën e QKMF-së, nga e cila pranoi kopje fizike të padisë kundër vendimit të TEIP dhe KPMSHCK, të dërguara në GJTH në Prishtinë, në Departamentin për Çështje Administrative (*dërgesa postare nr. 1482097, datë 17 dhjetor 2014*), si dhe kopje të padisë së QKMF-së, drejtuar gjykatës së lartshënuar, kundër vendimit të KPMSHCK (*dërgesa postare nr. 1477859, datë 10 tetor 2014*).

I. RRETHANAT E RASTIT

Faktet, të cilat deri tani kanë mund të vërtetohen, bazohen në pretendimet e ankuesit, si dhe në bazë të informatave të tjera që Avokati i Popullit i pati në dispozicion, mund të paraqiten si më poshtë:

12. Z. Bajram Kadrija, me kualifikim mjek i përgjithshëm, ka themeluar marrëdhënie pune me ish-Shtëpinë e Shëndetit në Gjakovë (tash QKMF) në vitin 1983, kurse prej vitit 1993 (pas përfundimit të studimeve specialistike), është sistemuar në pozitën *mjek specialist pediatër* në QKMF në Gjakovë.
13. Më 12 prill 2013, QKMF kishte shpallur konkurs të brendshëm për plotësimin e vendit të lirë të punës: *"Kryeshef i Departamentit të Mjekësisë Familjare"*, sipas konkursit nr. 233/2013, datë 12 prill 2013, meqë asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk i kishte plotësuar kushtet e kërkuara, QKMF e kishte vazhduar konkursin edhe për pesë (5) ditë, sipas njoftimit të publikuar me nr. 233/2, të datës 22 prill 2013.
14. Më 30 prill 2013, pas përfundimit të procedurave rekrutuese QKMF kishte marrë vendim për emërimin e z. Bajram Kadrija në pozitën e *Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare*, me mandat tre (3) vjeçar (vendimi nr. 263/2013, të datës 30 prill 2013).
15. Me 11 maj 2013, Asociacioni i Mjekëve Familjarë (AMF), dega në Gjakovë paraqiti reagim me shkrim para institucioneve komunale (kryetarit të komunës, drejtorit të DSHMS, përfaqësuesve të partive politike në Asamblenë Komunale) Inspektoratit Shëndetësor, Inspektoratit të Punës, kryetarit të Sindikatës së Shëndetësisë së Kosovës, mediave etj., duke kërkuar nga ata që të anulohet konkursi nr. 233, i datës 12 prill 2013, të shpallet një konkurs tjetër në të cilin do të shpalleshin të gjitha pozitat të cilave iu ka skaduar kontrata, si dhe konkursi i shpallur të respektojë kriteret dhe procedurat ligjore.
16. Më 21 maj 2014, drejtori i DSHMS, rekomandon drejtoreshën e QKMF që brenda afatit prej dhjetë ditësh të kryejë përzgjedhjen e kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare (*Rekomandimi nr. 05-zyrtarisht, datë 21 maj 2014*).
17. Më 30 maj 2015, QKMF mori aktvendim (*nr. 332, datë 30 maj 2014*) me të cilin z. Bajram Kadrija shkarkohet nga pozita e Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare pranë QKMF në Gjakovë.
18. Më 2 qershor 2014, QKMF shpall konkurs për plotësimin e pozitës së lirë të punës: *"Kryeshef i Departamentit të Mjekësisë Familjare në QKMF"* (*njoftimi nr. 334/2014, datë 2 qershor 2014*).

19. Më datë 10 qershor 2014 QKMF e anulon konkursin e shpallur sipas paragrafit të lartshënuar (*vendimi nr. 374/2014, datë 10 qershor 2014*).
20. Më 10 qershor 2014, z. Bajram Kadrija ushtron ankesë kundër aktvendimit nr. 332 të datës 30 maj 2014, të QKMF-së dhe kërkon anulimin e konkursit dhe rikthimin e tij në vendin e punës.
21. Më datë 12 qershor 2014, QKMF e rishpall konkursin me disa ndryshime në paragrafin që kishte të bënte me kushtet e kërkuara për kandidatët (njoftimi nr. 380/2014, datë 12 qershor 2014).
22. Më 13 qershor 2014, QKMF, i përgjigjet me shkrim ankesës së z. Bajram Kadrija, të cilin e rekomandon që për shkeljet e pretenduara nga marrëdhënia e punës t'i drejtohet me ankesë Inspektoratit të Punës (njoftimi nr. 332/3, datë 13 qershor 2014).
23. Më 7 korrik 2014, z. Bajram Kadrija ushtron padi pranë Gjykatës Themelore (GJTH) në Gjakovë kundër të paditurës QKMF, lidhur me kërkesën për prishjen e aktvendimit të QKMF nr. 332, të datës 30 maj 2014.
24. Më 22 gusht 2014, Inspektori i Punës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) merr vendim që ankesa e z. Bajram Kadrija (nr. 436/2014, datë 1 korrik 2014) është e bazuar dhe QKMF ka bërë shkelje të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, neni 70, paragrafi 1, pika 4.1, 1.4.2, 1.6.2, si dhe paragrafin 2, 3 dhe 4, si dhe neni 71.2.
25. Më 29 gusht 2014, KPMSHCK merr vendim (nr. A 02/301/2014, datë 29 gusht 2014) në të cilin thuhet: "*Detyrohet komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të bëjë shqyrtimin e ankesës nr. 332 të datës 10 qershor 2014*" dhe "*Obligohen Kryetarja e Komunës dhe Menaxheri i Personelit të Komunës për zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit*".
26. Më 30 tetor 2014, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, duke vepruar si organ i shkallës së dytë vendosi që të refuzojë ankesën e QKMF-së dhe vërtetoi vendimin e Inspektorëve të Punës me nr. 543/2014, të datës 22 gusht 2014.
27. Më 3 mars 2015, KPMSHCK e njofton me shkresë (nr. 653/2015) Kryeministrin e Republikës së Kosovës, lidhur me moszbatimin e vendimeve të këshillit nga ana e Komunës së Gjakovës, si dhe kërkon nga Kryeministri që në pajtim me ligjin të ndërmerren masa disiplinore dhe materiale kundër personave përgjegjës të cilët kishin obligim ligjor për ekzekutimin e vendimeve.
28. Më 24 korrik 2015, pas propozimit për përmbarim, GJTH në Gjakovë, e përcakton si të lejueshëm kërkesën e z. Bajram Kadrija, lidhur me *propozimin për përmbarimin e vendimit të inspektorëve të punës nr. 543/2014, të datës 22 gusht 2014, i formës së prerë sipas vendimit të kryeinspektorit të punës në Prishtinë me nr. protokollit 93/14 të datës 30 tetor 2014 (aktvendimi E. nr. 321/15 të datës 24 korrik 2015)*.
29. Më 28 tetor 2015, QKMF e ushtroi *prapësim* kundër aktvendimit E. nr. 321/15 të datës 24 korrik 2015, duke kërkuar nga gjykata që të *vihet jashtë fuqie* aktvendimi për lejimin e përmbarimit.
30. Më 3 nëntor 2015, z. Bajram Kadrija ushtroi përgjigje në prapësim, kundër QKMF, duke kërkuar nga gjykata që të refuzojë prapësimin e QKMF-së dhe të vazhdojë me procedurën e përmbarimit.

II. INSTRUMENTET RELEVANTE

31. Neni 21, paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme "Kushtetuta") përcakton si në vijim:

"Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë."

"Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve."

32. Gjithashtu, neni 49, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton si në vijim: *“E drejta e punës garantohet”,* kurse neni 53 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
33. Neni 14 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950), (në tekstin e mëtejshëm Konventa) përcakton: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.*
34. Neni 5 i Ligjit të Punës Nr. 03/L në paragrafin 1 përcakton :*“Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi”,* kurse neni 70, paragrafi 1 përcakton :*“Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur ndërprerja e tillë arsyetohet për:*
- a. *arsye ekonomike, teknike ose organizative;*
 - b. *kur i punësuarit nuk është më i aftë t’i kryejë detyrat e punës;*
 - c. *në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit dhe*
 - d. *për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës”.*
35. Neni 71 i Ligjit të Punës në Paragrafin 1 përcakton: *“Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:*
- 1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;
 - 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;
 - 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.
36. Neni 82 i Ligjit të Punës përcakton: *“I punësuarit në çdo kohë mund t’ia dorëzojë ankesën Inspektoratit të Punës për çështje të cilat bien nën kompetencat e këtij organi”* kurse neni 83 përcakton: *“Për shkeljen e dispozitave të këtij ligji nga ana e punëdhënësit, Inspektorati i Punës do t’i shqiptojë masat ndëshkuese bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës”.*
37. Neni 2, paragrafi 2, nën a), i Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr. 2002/9, përcakton: *“Inspektorati i punës do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë [...]”,* kurse neni 3, paragrafi 3 i këtij ligji përcakton: *“Me qëllim të zbatimit të ligjit nga fushëveprimtaria e tij, autoriteti i Inspektoratit të punës koordinon veprimet dhe bashkëpunon me qeveritë komunale, inspeksionet tatimore, inspeksionet shëndetësore me autoritetet tjera relevante dhe me policinë e Kosovës”.*
38. Ligji për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr. 2002/9, në nenin 5, paragrafi 5 përcakton: *“Inspektorët e punës në kuadër të kompetencave të tyre japin vërejtje me shkrim për parregullsitë e konstatuara dhe caktojnë afatin brenda të cilit duhet të eliminohen këto parregullsi”* kurse sipas Ligjit Nr. 03/L-

017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9, neni 5 përcakton: “Inspektorët e punës në kuadër të kompetencave të tyre shënojnë me anë të raportit zyrtar mos respektimin apo shkeljen e dispozitave ligjore. Inspektori i punës me vendim shqipton gjobën[...]”.

39. Ligji për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr. 2002/9, në nenin 6, paragrafi 3 përcakton: “Kundër vendimit të Inspektoratit të Punës organ i shkallës së dytë, mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh”, kurse paragrafi 4 i këtij neni përcakton: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të Punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”.
40. Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) Nr. 04/L-077 përcakton: “Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë”, kurse neni 6, paragrafi 3 i këtij ligji përcakton: “Çdo veprim përmes të cilit bartësi i një të drejte vepron me qëllimin e vetëm ose të qartë të dëmtimit të tjetrit konsiderohet keqpërdorim i të drejtës”.
41. Neni 124, paragrafi 1, i LMD-së, përcakton: “Kushtet e përgjithshme të caktuara nga ana e një palë kontraktuese, qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale apo të referuara nga kontrata, përbëjnë marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve kontraktuese në të njëjtën kontratë dhe si rregull janë njësoj detyruese”, kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton: “Kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese në rast se kanë qenë të njohura për te ose është dashur t’i njihje në rastin e lidhjes së kontratës”.
42. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, neni 221 përcakton: “Kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pagat apo të ardhurat e tjera, kohëzgjatjen e orarit të punës, punën jashtë orarit apo punën me ndërrime, pushimin apo mungesën nga puna, ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësajsoj punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.
43. Ligj për Procedurën Përmbarimore Nr. 04/L-139, neni 21 përcakton: “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër” kurse neni 22 përcakton: “Dokumente përmbaruese janë:
- vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;
 - vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi[...]”.
44. Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.03/L-192, neni 13, përcakton: “Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit”, kurse neni 14, i po këtij ligji përcakton: “Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i

është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit”.

Analiza ligjore

45. Kushtetuta si akti më i lartë juridik i një vendi mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë këtu edhe QKMF-në dhe institucionet tjera shëndetësore.
46. Neni 49, i Kushtetutës në paragrafin 1 përcakton se e drejta e punës garantohet, prandaj nisur nga ky fakt janë krijuar një gamë e gjerë e ligjeve dhe akteve tjera përcjellëse (nënligjore), duke përfshirë edhe themelimin e mekanizmave të posaçëm për mbikëqyrje të zbatimit të këtij legjislacioni. Ligjvënësi ka paraparë të sanksionueshëm mosrespektimin e kësaj të drejte dhe këtë fushë e ka rregulluar me norma imperative *jus cogens*, prandaj mosrespektimi i kësaj të drejte sipas legjislacionit në fuqi paraqet vepër penale (shih paragrafin 42).
47. Avokati i Popullit vëren që në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata Evropiane”). Nisur nga rastet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI 89/13, të datës 12 mars 2014, mund të shihet se parashtruesja, kishte lidhur kontratë pune me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës për periudhë të pacaktuar kohore, në pozitën stjuardesë tokësore, por pas një viti punëdhënësi i saj e kishte njoftuar për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së punës. Gjykata kishte gjetur se shkëputja e kontratës së punës ishte bërë në kundërshtim me Rregulloren 2001/27, për LTHPK, e cila ishte e aplikueshme në atë kohë, duke përcaktuar që kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësi ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës. Gjykata kishte gjetur se mungojnë këto shkelje, prandaj kishte konstatuar se punëdhënësi ka shkelur nenin 24 dhe nenin 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
48. Në vendimin e Gjykatës Evropiane në çështjen e *Lukendas kundër Sllovenisë*, datë 6 tetor 2005 (forma e prerë e vendimit datë 06 janar 2006), kërkuasi u ankua se mjetet juridike në dispozicion në Slloveni për çështjet e zgjatjes së procedimeve, nuk ishin efektive. Ai u mbështet kryesisht në nenin 13 të Konventës i cili parashikon: “Çdokush, të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja kryhet nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.” Gjykata pasi e shqyrtoi këtë rast e deklaroi kërkesën të pranueshme, vlerësoi se ka pasur një shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, gjeti se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës, si dhe konstatoi, se shkeljet e gjetura e kanë origjinën në keqfunksionimin e legjislacionit dhe praktikës së brendshme. Ngjashëm në rastin e ankuesit, mjete juridike në dispozicion pavarësisht se ishte konstatuar se janë në anën e tij, ishin treguar joefektive sepse ato nuk u përfillen nga autoritetet përgjegjëse dhe nuk e kthyen drejtësinë në vendin e duhur.
49. Në vendimet e Gjykatës Evropiane të çështja “*Qufaj co. shpk kundër Shqipërisë*,” datë 2 tetor 2003, dhe çështja “*Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*”, datë 13 nëntor 2007, lidhur me shkeljet e të

drejtave të ankuesve për të pasur një proces të rregullt ligjor, si pasojë e dështimit të autoriteteve përgjegjëse për të ekzekutuar vendimet administrative të formës së prerë dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë, gjykata tërhoqi vëmendjen se ekzekutimi i vendimeve është pjesë përbërëse e “gjykimit” për qëllimet e Nenit 6 dhe vonesa në ekzekutimin e vendimit mund të cenojë thelbin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Evropiane vëren se, pavarësisht faktit nëse jemi para një vendimi gjyqësor apo administrativ që është përfundimtar (i formës së prerë), ligji i brendshëm dhe Konventa parashikon që vendimi të zbatohet përndryshe kemi shkelje të nenit 6, parag. 1 të Konventës.

50. Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Në çështjen e ankuesit shihet hapur se ankesat e para kanë filluar nga AMF lidhur me pretendimet se janë shkelur kriteret e konkursit, sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kriteret e nevojshme për t’u përzgjedhur në pozitën e caktuar, pasi ai vjen nga komuna e Deçanit. Avokati i Popullit vëren se sipas konkursit të QKMF-së kandidati për këtë pozitë do të duhej të ishte *banor i përhershëm i komunës së Gjakovës* (shih konkursin e QKMF nr. 233/2013, datë 12 prill 2013, si dhe reagimin e AMF , ku ndër pretendimet e shkeljes së pikave të konkursit përmendet fakti se *ankuesi është nga Deçani dhe asambleist i Asamblesë Komunale të kësaj komune*. Në kuptim të kësaj dispozite vërehet se kemi të bëjmë me trajtim të pabarabartë të punëtorëve të QKMF-së, në mes të atyre që jetojnë në komunën e Gjakovës me ata që jetojnë në komunitat tjera të Kosovës, prandaj mund të konstatojmë se kjo dispozitë është diskriminuese.
51. Neni 5 i Ligjit të Punës Nr. 03/L në paragrafin 1, përcakton që diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi. Ligji përcakton se punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kriteret dhe mundësi të barabarta, ndërsa dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit. Në rastin konkret kemi shpërputhje të vullneteve për ndërprerje të kontratës në mes të ankuesit dhe QKMF, prandaj punëdhënësi në mënyrë të njëanshme dhe kundërshtim me ligjin ka vendosur që të shkarkojë ankuesin nga pozita e kryeshefit.
52. Neni 70 i Ligjit të Punës Nr. 03/L në paragrafin 1, përcakton rastet kur punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative, te rastet kur i punësuarit nuk është më i aftë t’i kryejë detyrat e punës, në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit apo për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, kurse paragrafi. 3,i po këtij neni, kërkon që punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t’ia shpjeguar atij ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t’ia dorëzojë paralajmërimin, kurse neni 71, par. 1, i po këtij ligji përcakton afatet kur punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar, bazuar në nenin 70, të këtij ligji sipas këtyre intervaleve kohore të njoftimit:
- prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;
 - prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;
 - mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

Nga analiza e këtij rasti shihet qartë se mungojnë cilado nga premiset e nenit 70 për t'ia ndërprerë kontratën ankuesit, prandaj edhe Inspektorati i Punës si mekanizëm për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës ka gjetur se QKMF ka bërë shkelje të Ligjit të Punës.

53. Neni 82 i Ligjit të Punës sqaron rastet e mbrojtjes së të drejtës së punëtorëve duke përcaktuar se i punësuar i në çdo kohë mund t'ia dorëzojë ankesën Inspektoratit të Punës për çështje të cilat bien në kompetencat e këtij organi, kurse neni 83 përcakton situatat kur Inspektorët gjejnë shkelje të dispozitave të ligjit nga ana e punëdhënësit, ata (Inspektorati i Punës) duhet të shqiptojnë masat ndëshkuese bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës. Praktikisht ankuesi ka vepruar konform ligjit duke paraqitur rastin para Inspektorëve të Punës, të cilët e kanë shqyrtuar kërkesën e tij, kanë nxjerrë vendim lidhur me shkeljet e Ligjit të Punës, si në shkallë të parë po ashtu edhe në shkallë të dytë. Inspektorët e Punës dhe TEIP nuk kanë marrë asnjë masë ndëshkuese ndaj punëdhënësit, i cili e ka shkelur ligjin, por këto veprime të tyre kanë ngelur vetëm në nivelin e konstatimeve. Ky veprim i Inspektorëve ka bërë që këto mjete juridike të mos jenë efektive, prandaj ankuesi është detyruar t'i drejtohet gjykatës me propozim që t'i ekzekutojë me dhunë këto vendime administrative të formës së prerë dhe gjykata e ka lejuar përmbarimin.
54. Neni 2, paragrafi 2, nën a), i Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr. 2002/9, përcakton detyrat që autoriteti i Inspektoratit të Punës të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, kurse neni 3, paragrafi 3 i këtij ligji përcakton mundësitë që me qëllim të zbatimit të ligjit nga fushëveprimtaria e tij, autoriteti i Inspektoratit të Punës koordinon veprimet dhe bashkëpunon me qeveritë komunale, inspeksionet tatimore, inspeksionet shëndetësore me autoritetet tjera relevante si dhe me Policinë e Kosovës. Kjo dispozitë u jep hapësirë inspektorëve që kur hasin rastet e moszbatimit të ligjit të cilat me kodin penal janë përcaktuar si vepra penale të mund të bashkëpunojnë me policinë dhe mekanizmat tjerë që të mund të ngriten kallëzime penale, por pavarësisht mundësisë ligjore këto veprime nuk kanë ndodhur në rastin e ankuesit.
55. Ligji për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr. 2002/9, në nenin 5, paragrafi 5 përcakton detyrimin që inspektorët e punës në kuadër të kompetencave të tyre japin vërejtje me shkrim për parregullsitë e konstatuara dhe të caktojnë afatin brenda të cilit duhet të eliminohen këto parregullsi. Pavarësisht mundësive ligjore dhe kompetencave që i kishin në dispozicion Inspektorët e Punës dhe TEIP, ata nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim të tillë, duke mos kërkuar nga QKMF që t'i eliminojë parregullsitë e konstatuara si dhe nuk kanë vepruar konform Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9, neni 5 i cili përcakton që Inspektorët e punës në kuadër të kompetencave të tyre shënojnë me anë të raportit zyrtar mos respektimin apo shkeljen e dispozitave ligjore dhe me vendim shqiptojnë gjobën.
56. Ligji për Inspektoratin e Punës në Kosovë Nr. 2002/9, në nenin 6, paragrafi 3 përcakton mundësinë që kundër vendimit të Inspektoratit të Punës në shkallë të dytë, mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh, kurse paragrafi 4 i këtij neni përcakton që ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të Punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit. Realisht, në rastin e ankuesit QKMF ka iniciuar konflikt administrativ, por nuk i ka ekzekutuar vendimet e Inspektorëve dhe TEIP, duke krijuar përshtypjen e një pasigurie juridike para punëtorëve të tjerë të QKMF-së dhe opinionit të gjerë me perceptimin se QKMF është më e fortë se ligji.
57. Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) Nr. 04/L-077 thekson se në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë

dhe ndershmërisë, kurse neni 6, paragrafi 3 i këtij ligji përcakton se çdo veprim përmes të cilit bartësi i një të drejte vepron me qëllimin e vetëm ose të qartë të dëmtimit të tjetrit konsiderohet keqpërdorim i të drejtës. Analizuar nga faktet e paraqitura në rastin e ankuesit mund të konkludohet se parimi ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë nuk është zbatuar.

58. Neni 124, paragrafi 1, i LMD-së, përcakton se kushtet e përgjithshme të caktuara nga ana e një palë kontraktuese, qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale apo të referuara nga kontrata, përbëjnë marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve kontraktuese në të njëjtën kontratë dhe si rregull janë njësoj detyruese, kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton se kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese në rast se kanë qenë të njohura për të ose është dashur t'i njihite në rastin e lidhjes së kontratës. Nga ajo që u tha më lartë shihet qartë QKMF si institucion publik (punëdhënësi) duke e shfrytëzuar epërsinë në raport me ankuesin (punëtorin), ka vepruar në kundërshtim me veprimet e saj të mëhershme, duke anuluar vendimet e veta pas trembëdhjetë muajsh zbatimi, pavarësisht detyrimeve që i kishte pranuar me kontratë për tri vite.
59. Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, neni 221 përcakton që kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pagat apo të ardhurat e tjera, kohëzgjatjen e orarit të punës, punën jashtë orarit apo punën me ndërime, pushimin apo mungesën nga puna, ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësajsoj punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Nëse e analizojmë me vëmendje këtë dispozitë ligjore dhe nga rrethanat dhe dëshmitë e këtij rasti, mund të kuptojmë se QKMF me vetëdije nuk e ka zbatuar ligjin (dhe po vazhdon të mos e zbatojë), pavarësisht se janë konstatuar shkeljet ligjore nga ana e disa autoriteteve kompetente dhe gjykatës e cila ka lejuar përmbarimin e këtyre vendimeve.
60. Ligj për Procedurën Përmbarimore Nr. 04/L-139, neni 21 përcakton që organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me ligj nuk është parashikuar diçka tjetër, kurse neni 22 përcakton që dokumente përmbaruese janë vendimi përmbarues i gjykatës, ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese, si dhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative. Sa i përket çështjes se a do të duhej t'i ekzekutonte QKMF vendimet e administrative nuk ka fare dilema, por arsyet pse nuk janë zbatuar deri më tash këto vendime lënë hapësirë për interpretime dhe dyshime se këto veprime janë bërë për qëllime të caktuara.
61. Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.03/L-192, neni 13, përcakton që vendimi i këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarë të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ligji thekson se ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, kurse neni 14, lejon mundësinë që kundër vendimit të këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i këshillit nuk është i ligjshëm, mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi, duke specifikuar se inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

62. Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmive të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, në pajtim me legjislacionin përkatës, i cilai e përcakton të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, konstaton se ankesa e ankuesit është e arsyeshme dhe e ligjshme. Në rastin konkret, Avokati i

Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, meqë zyrtarët përgjegjës të QKMF-së dhe Komunës së Gjakovës kanë vepruar në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi duke i tejkaluar autorizimet zyrtare, pra kanë ndërmarrë veprime që janë në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane, Ligjin e Punës, si dhe me aktet e tjera juridike të përmendura më lartë.

63. Avokati i Popullit duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara më lartë, konsideron se QKMF, ka marrë vendim të pabazuar dhe kundërligjor për shkarkim të ankuesit nga pozita e kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare. Është shqetësues fakti se, si pasojë e mospërfilljes së vendimeve të KPSHCK dhe Inspektorëve të Punës dhe TEIP, si dhe lejimit të ekzekutimit nga gjykata, QKMF nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural për zbatim të vendimeve apo negociimit të kësaj çështje me ankuesin. Këto mosveprime nga ana e QKMF-së lënë hapësirë interpretimi për veprime të qëllimshme. Avokati i Popullit gjatë hetimit të këtij rasti dhe rasteve tjera kundër QKMF-së është informuar se praktikisht ka edhe raste të tjera kur Inspektorët e Punës kanë gjetur shkelje ligjore nga ky institucion dhe vendimet e tyre nuk janë përfillur nga QKMF, pra raste të tilla kanë ndodhur edhe më parë.
64. Avokati i Popullit konsideron, që Inspektorët e Punës nuk e kanë zbatuar meritorisht të drejtën materiale, pasi kanë gjetur shkeljet ligjore dhe nuk kanë shqiptuar masa ndëshkuese në pajtim me ligjin. Ata duke u ndalur vetëm në çështjet e shkeljeve procedurale kanë bërë që këto mjete juridike (vendimet) të jenë joefikase dhe drejtësia të mos vendoset në vendin e duhur. Është i pakuptimtë fakti se në vendimet e Inspektoratit (në të dy shkallët) vetëm kanë konstatuar shkeljet duke mos kërkuar nga shkelësi (QKMF) që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të eliminuar shkeljet, si dhe për të kompensuar palën e dëmtuar (ankuesin) duke krijuar bindjen se këto vendime janë joprofesionale. Si pasojë e këtij mosefikasiteti këto vendime administrative të formës së prerë janë dërguar (nga ankuesi) në procedura përmbareuese para gjykatës kompetente, duke i krijuar shpenzime shtesë ankuesit dhe duke i marrë mjaft kohë. Avokati i Popullit me të drejtë e parashtron pyetjen se kujt i duhen këto institucione të cilat kanë për mandat ligjor mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përderisa vendimet e tyre janë detyruese për palët dhe ato nuk zbatohen? Avokati i Popullit konsideron se praktika të tilla të injorancës dhe kryeneçësisë nga autoritetet përgjegjëse duhet të ndërpriten njëherë e përgjithmonë dhe shkelësit e ligjit duhet të përballen me pasojat.
65. Avokati i Popullit konstaton se organet shtetërore përgjegjëse për këtë rast nuk arritën të ndërmarrin masa efektive në lidhje me detyrimet pozitive, respektivisht mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, sidomos te rastet kur këto të drejta janë të cinguar, kurse në rastin konkret si pasojë e mosefikasitetit të këtyre masave tani po ballafaqohen me pasojat. Avokati i Popullit konstaton se ankesat e mëhershme të ankuesit (apo edhe punëtorëve tjerë) të parashtruara kundër QKMF-së, nuk janë shqyrtuar nga Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia, sepse QKMF nuk kishte një komision të tillë. Nisur nga ky fakt KPMSHCK kishte kërkuar nga komuna që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të bëjë shqyrtimin e ankesës nr. 332 të datës 10 qershor 2014, duke obliguar Kryetaren e Komunës dhe Menaxherin e Personelit të Komunës së Gjakovës për zbatimin vendimit brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit (shih paragrafin 23). Pavarësisht kësaj, këto autoritete nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim për themelimin dhe funksionalizimin e këtij komisioni pranë QKMF-së.
66. Avokati i Popullit vëren se se, Gjykata Themelore në Gjakovë nuk ka vepruar në *procedurë summare* duke e trajtuar padinë e ankuesit si lëndë me *prioritet (shih paragrafin 23) sipas nenit 475, të Ligjit për Procedurën Kontestimore* Nr. 03/L-006, i cili përcakton që në kontestet nga marrëdhënia e

punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.

67. Avokati i Popullit me këtë rast dëshiron të tërheqë vëmendjen se në procedurën e përmbartimit GJTH në Gjakovë, gjykata nuk ka vepruar sipas Mendimi Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Nr. 223/2015 i datës 14 korrik 2015, me të cilin sqarohen paqartësitë lidhur me nenin 72 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Gjkata Supreme vë në pah se versioni i ligjit në gjuhën shqipe nuk cakton afat për vendosje sipas prapësimit, ndërsa versioni në gjuhën angleze (neni 72, paragrafi 1) e përcakton se: *“Në prapësimet e paraqitura gjykata vendos në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të prapësimit.”* Gjykata Supreme me anë të këtij Mendimi Juridik ka shprehur qëndrimin se gjykatat themelore, duhet të vendosin lidhur me prapësimet e paraqitura kundër urdhrave përmbartimore, të nxjerra nga organet përmbartuese, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së tij. Kjo për shkak se versioni në gjuhën shqipe përmban një lëshim teknik të ligjvënësit. Nga rrethanat e rastit shihet se QKMF ka ushtruar *Prapësimin* me 28 tetor 2015, por GJTH në Gjakovë nuk i ka respektuar afatet sipas këtij Mendimi Juridik dhe deri më tash nuk e ka përfunduar çështjen e ankuesit në procedurë përmbartimore (shih paragrafin 28).
68. Kur është fjala për mos bashkëpunimin e autoriteteve përgjegjëse (QKMF dhe DSHMS) me AP-në (shih paragrafët 4, 5. dhe 7), Avokati i Popullit konsideron që mosofrimi i plotë i dokumentacionit dhe pasqyrimin të rrjedhave të ngjarjes, sipas kërkesës së AP-së, është veprim kundërkushtetues dhe veprim kundërligjor. Avokati i Popullit është i mendimit që pamundësimi i qasjes në lëndën e ankuesit është bërë me qëllim që ankuesit t’i pamundësohet shfrytëzimi efektiv i mjeteve juridike, kurse kjo situatë është tejkaluar pas takimit të përfaqësuesit të AP-së me kryetaren e Komunës së Gjakovës (shih paragrafin 8 dhe 9).

Avokati i Popullit rikujton se neni 132, paragrafi 3 i Kushtetutës përcakton:

“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”,

69. Më tutje, Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, në nenin 18, paragrafin 6, përcakton: *“Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet, të çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, duke përfshirë dosjet mjekësore për personat e privuar nga liria, në pajtim me ligj, dhe mund t’i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas këtij ligji, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit”,*

Neni 25, paragrafi 2, i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”* kurse paragrafi 3 i këtij neni përcakton: *“Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare”.*

70. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)*”, si dhe “*të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon:

Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë që:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, si dhe në bashkëpunim me të gjitha njësitë vartëse, të ndërmarrë masa urgjente për zbatimin e vendimeve të Inspektorëve të Punës në çështjen e ankuesit dhe veprime të tilla të moszbatimit të vendimeve të mos përsëriten në të ardhmen.*
- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të ngritë kapacitetet e nevojshme dhe të themelojë Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia pranë QKMF-së.*

Kryetaren e Komunës së Gjakovës që:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të ngritë kapacitetet profesionale duke ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme që rastet e tilla të mospërfilljes së vendimeve administrative të TEIP dhe KPMSHCK të mos përsëriten në të ardhmen.*

Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që:

- *Të nxjerrë një udhëzim me shkrim dhe të kërkojë nga të gjitha zyrat rajonale të Inspektorëve të Punës, përfshirë edhe Trupën Ekzekutive të Inspektorëve të Punës (TEIP) që është detyrë dhe obligim i tyre ligjor të përcjellin zbatimin e vendimeve të tyre, si dhe të aplikojnë pjesën ndëshkuese në pajtim me ligjin, kur hasin në shkeljet e të drejtave nga marrëdhënia e punës.*
- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të ngritë kapacitetet e nevojshme që në kuadër të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, kur hasen raste eventuale nga cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës të cilat sipas Kodit Penal cilësohen si vepra penale të raportohen te organet e ndjekjes.*

Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjakovë që:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore te rastet e kontesteve nga marrëdhënia e punës të veprave me nguti, konform nenit 475 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, kurse te procedurat e përmbartimit të vendimeve të TEIP dhe KPMSHCK sipas prapësimit, gjykata të veprave brenda afateve ligjore sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr. 223/2015 i datës 14 korrik 2015.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve

konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 29/2016

Durmish Hasani

kundër

Komunës së Vushtrisë

Raport për lirimin e pronës së uzurpuar publike komunale

Për: Z. Bajram Mulaku, Kryetar
Komuna e Vushtrisë

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3,
Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, neni 18.1.2

Prishtinë, më 12 tetor 2016

Qëllimi i raportit

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Komunes së Vushtrrisë, për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse, për të liruar rrugën-hapësirën, që do të siguronte lëvizjen e lirë dhe të papenguar të banorëve dhe obligimin e organeve kompetente komunale, Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, për përmbushjen e obligimeve ligjore, që burojnë nga kompetencat e tyre vetanake dhe ekskluzive ligjore, për lirin e hapësirave publike.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Po ashtu sipas nenit 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit është i autorizuar: *“Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin te drejtat njeriut dhe të bëjë rekomandimin që t’u jepet fund rasteve te tilla dhe kur është e domosdoshme të shpreh mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse ne lidhje me rastet e tilla”.*

Përshkrimi i çështjes

Ky raport është bazuar në ankesën e pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), nga z. Durmish Hasani. Ai dhe familja e tij, që nga viti 2008, kanë vështirësi të lëvizjes dhe qasjes në rrugën publike të fshatit Strofc, rrugë kjo e cila është në pronësi të Komunes së Vushtrrisë dhe gjendet shumë afër shtëpisë së ankuesit, por për arsye të uzurpimit (bllokimit të rrugës) nga një bashkëfshatar, ankuesi dhe familja nuk mund ta shfrytëzojnë atë.

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit të ofruara nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

1. Më 12 qershor 2015, ankuesi z. Durmish Hasani, pas disa takimeve dhe bisedave verbale me zyrtaret e Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit, i është drejtuar kryetarit të Komunes së Vushtrrisë, me kërkesë (nr.02-007-39661), për lirin e pronës publike komunale.
2. Më 16 qershor 2015, kryetari i Komunes së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me drejtorë të drejtorive komunale, kërkesën e ankuesit të datës 12 qershor 2015, e delegon te drejtorët e Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit, për shqyrtim të mëtejme.
3. Më 2 tetor 2015, ankuesi, gjegjësisht pas katër muaj pritje iu drejtua përsëri kryetarit të Komunes së Vushtrrisë, (kërkesa me nr.02-007-61656), për shkak se nga drejtoritë e lartcekura ende nuk kishte pranuar përgjigje.
4. Më 2 tetor 2015, ankuesi i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në komunën e Vushtrrisë, me kërkesë (nr.18-007-61023), që drejtoria në fjalë të dalë në terren dhe të bëjë vendosjen e pikave dhe kufizimin e pronës së uzurpuar publike komunale.
5. Më 2 tetor 2015 dhe 22 shkurt 2016, ankuesi iu drejtua përsëri kryetarit të Komunes së Vushtrrisë, me kërkesat (nr.02-007-70975 dhe 02-007-7476), për lirin e pronës publike komunale dhe

njëkohësisht duke e informuar se nga drejtoritë e lartcekura nuk është ndërmarrë asgjë lidhur me rastin e tij.

Veprimet në Institucionin e Avokatit të Popullit

6. Përkitazi me çështjen e lartpërmendur, IAP më 5 janar 2016, ka pranuar ankesë nga z. Durmish Hasani, lidhur me uzurpimin e pronës publike komunale dhe pengimin e lëvizjes së lirë.
7. Më 19 shkurt 2016, përfaqësuesi i AP-së u takua me drejtorin e Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Vushtrrisë, me të cilin bisedoi lidhur me çështjen e ankuesit. Ai e njoftoi se ka informacione rreth këtij problemi, i cili sipas tij që nga viti 2008 nuk po zgjidhet. Ai sqaroi se çështja në fjalë është një problem mes dy familjeve që janë në marrëdhënie farefisnie, dhe se është e vërtetë se pjesa-rruga ku pretendon ankuesi është pronë publike komunale e uzurpuar nga personi i quajtur A. H., por se ata si autoritet komunal nuk kanë ndërmarrë asgjë lidhur me këtë rast sepse ka të bëjë me familje që janë në hasmëri.
8. Më 18 prill 2016, përfaqësuesi i AP-së, me qëllim që të informohet për së afërmi me rastin, realizoi vizitë në fshatin Strofc dhe u informua me gjendjen në terren. Gjatë vizitës u takua me ankuesin nga i cili u informua për vendndodhjen e pronës së uzurpuar dhe njëkohësisht pranoi nga ankuesi edhe disa dokumente shtesë, relevante për rastin.
9. Më 18 maj 2016, përfaqësuesi i AP-së u takua me drejtorin e Drejtorisë për Inspektime, i cili deklaroi se çështjet e uzurpimit të pronës nuk janë në kompetencë të drejtorisë për Inspektime, përveç në raste të caktuara kur Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë kërkon asistencë për lirin e uzurpimit.
10. Më 15 qershor 2016, përfaqësuesi i AP-së u takua me zyrtaren ligjore të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, e cila deklaroi se është në dijeni për rastin dhe kërkesat e z. Hasani, por që drejtoria në fjalë nuk ka kompetencë ligjore për shqyrtim dhe zgjidhje të tij.

Analiza ligjore

11. Meqenëse, me Kushtetutën e Republikës Kosovës (KRK), neni 7, paragrafi 1, përcaktohet që, “[...], respektimi të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, [...]”, renditen në vlerat në të cilat bazohet rendi Kushtetues i vendit, për Avokatin e Popullit është e pakuptueshme zvarritja e ndërmarrjes së veprimeve për lirin e hapësirës- pronës se uzurpuar, nga organet kompetente komunale, duke pasur parasysh kohën e gjatë të ekzistimit të këtij problemi dhe shfrytëzimit të pronës së uzurpuar komunale.
12. Bazuar në obligimin kushtetues nga neni 123, paragrafi 4 i KRK-së, sipas të cilit “*Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike [...]*”, është i paarsyeshëm dhe kundërligjor mosreagimi përkatës i organeve komunale, përkundër rëndësisë së pronës në fjalë për lëvizje të lirë për fshatarët e kësaj lagje.
13. Edhe pse rruga në fjalë në regjistrat kadastral figuron si pronë komunale, edhe përkundër obligimit ligjor sipas kuptimit të nenit 4.2, të Ligjit, për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 (LVL), i cili kërkon nga organet komunale që të kujdesen që qytetarët, “[...] të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve”, komuna e Vushtrrisë nuk ka ndërmarrë veprimet përkatëse deri më tani.
14. Avokati i Popullit, vëren se komuna nuk është përgjegjës në ankesat e njëpasnjëshme të z. Hasani për lirin e hapësirës publike të uzurpuar dhe gjendja nuk ka ndryshuar, edhe pse kanë kaluar pothuajse 8 vite, pas uzurpimit të kësaj prone.
15. Gjithashtu, Avokati i Popullit vëren se, gjendja e tillë është e patolerueshme, kur kemi parasysh se ankuesit dhe familjes së tij për të dalë në rrugën kryesore të fshatit i duhet afërsisht të kaloj një

kilometër, në një rrugë fshati pothuajse të pakalueshme, përderisa po të ishte prona në fjalë e liruar, ankuesi do të kishte qasje në rrugën kryesore në afërsi prej 67.50 metrash.⁷³

16. Shqetësues për Avokatin e Popullit është mos reagimi i Komunës së Vushtrrisë, edhe përkundër kërkesave të shumta drejtuar kryetarit., Ankuesi asnjëherë nuk ka pranuar përgjigje dhe nuk është njoftuar lidhur me parashtrësën e tij. Në nenin 81, i cili i referohet afateve të përgjithshme kohore për përfundimin e procedimit administrativ përcaktohet se ” *Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjet e posaçme ose kur shtyrja bëhet e detyrueshme për shkak të situatave të jashtëzakonshme*” ndërsa neni 109, detyrimi për të njoftuar, përcakton: ” *Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative me anë të të cilave:*
 - a). *merren vendime lidhur me pretendimet e tyre;*
 - b). *caktohen detyrime dhe dënime ose shkaktohen dëme;*
 - c). *krijohen, marrin fund, zgjerohen ose kufizohen interesa legjitime ose të drejta të palëve, ose pengohen kushtet për gëzimin e tyre në ndonjë mënyrë tjetër.*
17. Po ashtu, shqetësues është edhe mos reagimi i Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, e cila edhe përkundër kërkesave të adresuara asaj, asnjëherë nuk i është përgjigjur ankuesit, përkatësisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim.
18. Ligji në mënyrë të qartë përcakton detyrimet ligjore të komunës në raport me të drejtat e qytetarëve, neni 4, prag.2 ” *Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë [...]*”. Po ashtu, vendimet e organeve komunale janë akte administrative të natyrës ekzekutive, me të cilat komunat ushtrojnë pushtetin e tyre ligjor në të gjitha fushat e kompetencës ligjore. Avokati i Popullit, vëren se komuna e Vushtrrisë nuk ka përdorur kompetencat e veta ligjore në fuqi, dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për lirimin e pronës se uzurpuar në mënyrë që fshatarëve të këtij fshati në këtë lagje t’ua bëjë të mundur lëvizjen e lirë dhe të papenguar, e drejtë kjo e paraparë edhe me nenin 2 të KEDNJ.
19. Në vazhdim, Avokati i Popullit, përkujton rëndësinë e nenit 17 të LVL, për kompetencat ekskluzive të komunës, në fushën e planifikimit urban dhe rural, mbrojtjes së mjedisit lokal, në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, ” *[...] menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal [...]*”, si dhe ” *mirëmbajtjes së parqeve dhe hapësirës publike*”. Bazuar në këtë, Avokati i Popullit vlerëson se veprimet e komunës për rastin në fjalë, janë joproporcionale, në krahasim me rëndësinë e sigurimit të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe lirimit të pronës publike nga uzurpimi arbitrar.
20. Duke u nisur nga të dhënat e paraqitura më lartë, dëmin e shkaktuar dhe vonesat e komunës në sanimin e gjendjes faktike, Avokati i Popullit ua rikujton dhe thekson që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështje të ngjashme, lidhur me ndërhyrjet arbitrare të individëve në hapësira, si dhe dëmtimin e tyre pa asnjë përpjekje për t’u penguar nga institucionet përgjegjëse, ka konstatuar se ” *jo vetëm autoritetet publike duhet të përmbahen nga mos ndërhyrja në të drejtat e individëve, por ata duhen ndërmarrë hapa konkretë në mbrojtjen e të drejtave të tyre*”.⁷⁴

Konstatimet e Avokatit të Popullit

21. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridikë dhe fizikë, si dhe duke u bazuar në faktet e përmendura më lart, konstaton se mosndërmarrja e veprimeve përkatëse nga organet kompetente komunale, në rastin konkret nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të

⁷³ Situacioni i rrugës kontestuese që mban numrin kadastral 278 Z.K. Strofc (gjeodet z. Bedri Dobra).

⁷⁴ GJEDNJ, rasti *Hatton and Others v. the United Kingdom*, Application no. 36022/97, 8 July 2003, paragrafi 100,119,123, në: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-59686#{%22itemid%22:\[%22001-59686%22\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-59686#{%22itemid%22:[%22001-59686%22]}) (07.05.2015).

Ambientit dhe Drejtoria e Inspekcionit në komunën e Vushtrrisë, për lirim të hapësirës në fjalë, janë duke shkaktuar pengim të lëvizjes së lirë të qytetarëve.

22. Avokati i Popullit konstaton se në këtë rast, komuna ka dështuar për të parandaluar pengimin e efekteve negative të ndikimit në mjedis, nga mbyllja e rrugës, pasi qasja në rrugën kryesore të fshatit është pamundësuar.
23. Zvarritja e ndërmarrjes së veprimeve efikase lidhur me pronën publike komunale me vite të tëra, dëshmon për mosgatishmërinë dhe papërgjegjshmërinë e organeve kompetente komunale, për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me obligimet e tyre ligjore, në raport me qytetarët.
24. Avokati i Popullit konsideron se autoritetet kanë për obligim që të respektojnë ligjin dhe të përgjigjen në ankesa-kërkesa të qytetarëve. Mos përgjigjen në kërkesën e ankuesit (shih pikat 1.3.4 dhe 5 të raportit), Avokati i Popullit i konsideron si dështim të Komunës së Vushtrrisë, për të zbatuar nenin 81 dhe 109 të Ligjit Nr. 02/L-28, për Procedurën Administrative.
25. Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019 Avokati i Popullit :

REKOMANDON

1. *Komuna e Vushtrrisë në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me autoritetet tjera përgjegjëse, të ndërmarrë masa që në afatin sa më të shkurtër kohor të largojnë të gjitha pengesat për lirim të rrugicës së fshatit, në mënyrë që qytetarët të mund të kalojnë lirshëm dhe të kenë qasje të papenguar në rrugën kryesore të fshatit.*
2. *Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të shqyrtojnë kërkesat e palëve dhe t'u kthejnë përgjigje atyre brenda afateve të përcaktuara ligjore.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019 (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr: 72/2015

PREK KRASNIQI

Raport lidhur me mungesën e mjeteve efektive juridike

Për: Z. Arban Abrashi, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Z. Hamdi Ibrahim, kryetar
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 17 tetor 2016

Qëllimi i Raportit

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, që ankuesit t'i ofrohet mundësia e garantuar ligjore dhe kushtetuese për mjete juridike efektive në ankesën e z. Prek Krasniqi i cili më 3 shkurt 2015, ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, në emër të së ëmës znj. Marije Krasniqi, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), respektivisht Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të Luftës (DFDILVC), lidhur me refuzimin e kërkesës për njohjen e pensionit familjar të viktimës civile të luftës nga data e aplikimit

Ky raport bazohet në ankesën individuale të z. Prek Krasniqi dhe ka për qëllim që të evidentojë disa nga mangësitë e veprimeve institucionale në trajtimin e këtij rasti dhe të tërheqë vëmendjen e Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të Luftës (DFDILVC), respektivisht Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me ofrimin e mundësive të garantuara ligjore dhe kushtetuese për mjete juridike efektive.

Sipas fakteve

I. RRETHANAT E RASTIT

Faktet, të cilat deri tani kanë mund të vërtetohen, bazohen në dokumentet e paraqitura nga ankuesi, si dhe në informata të tjera që Avokati i Popullit i pati në dispozicion, dhe paraqiten si më poshtë:

1. Në muajin shkurt 2009, znj. Marije Krasniqi, nga Fshati Ramoc, komuna e Gjakovës, ka paraqitur kërkesë pranë DFDILVC me të cilën kërkon që t'i njihet e drejta në pension të familjeve të viktimave të luftës, për djalin e saj të vranë, të ndjerin Pashk Gjon Abazi.
2. Më 18 mars 2009, DFDILVC, pas shqyrtimit të kërkesës (*Nr.04-03/412*) së znj. Marije Krasniqi për njohjen e së drejtës për pension për familjet e viktimave civile të luftës nxjerr vendim me të cilin e refuzon kërkesën e znj. Krasniqi, me arsyetimin se në dokumentet e parashtrueses ekzistojnë tre mbiemra të ndryshëm.
3. Më 22 prill 2009, sektori i ankesave pranë DFDILVC duke vepruar si organ i shkallës së dytë në ankesën e znj. Krasniqi, vendosi që të mbetet në fuqi vendimi i shkallës së parë duke e udhëzuar palën e pakënaqur që brenda afatit ligjor të iniciojë kontest administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës (*Vendimi nr.04-03/412, datë 22 prill 2009*).
4. Më 20 gusht 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, duke e zhvilluar kontestin administrativ sipas padisë së znj. Krasniqi, kundër vendimit të shkallës së dytë të DFDILVC (*Vendimi nr.04-03/412, datë 22 prill 2009*) vendosi që padia e ankueses është e bazuar dhe lënda t'i kthehet DFDILVC për rishqyrtim dhe rivendosje (*Aktgjykimi A.nr.330, datë 20 gusht 2009*).
5. Më 9 shtator 2009, DFDILVC duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (*A.nr.330/2009, datë 20 gusht 2009*) e rishqyrtoi lëndën e znj. Krasniqi dhe mori vendim me të cilin : *“Ankesa Refuzohet”*, me arsyetimin se : *“Me rastin e vendosjes sipas ankesës sërish u vërtetua se nuk plotësohen kushtet ligjore për pension familjar të viktimës civile. Me ankesë nuk ofrohen dëshmi se janë kryer ligjërisht ndërrimet e emrit personal të të ndjerit Pashk Gjon Abazi në Krasniqi si tek anëtarët e tjerë të familjes konform Ligjit Nr.02/L-118 për emrin personal”*, duke e udhëzuar palën e pakënaqur që brenda afatit ligjor sërish të iniciojë kontest administrativ pranë Gjykatës Supreme të Kosovës (*Vendimi nr.04-03/412, datë 9 shtator 2009*).
6. Më 14 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, sërish duke e zhvilluar kontestin administrativ sipas padisë së znj. Krasniqi, kundër vendimit të DFDILVC (*Vendimi nr.04-03/412, datë 9 shtator 2009*) mori Aktgjykim: *“Miratohet Padia. Anulohet vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies*

Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, nr.04-03/412, datë 09.9. 2009”. Në arsyetimin e Aktgjykimit gjykata thekson se: *”Padiësja si nënë e të ndjerit e ka ndërruar mbiemrin nga Abazi në Krasniqi së bashku me të gjithë anëtarët e tjerë të familjes, por me ndërrimin e mbiemrit asgjë nuk ka ndryshuar sa u përket raporteve familjare në mes të djalit të ndjerë Pashk dhe padiësës si nënë e tij [...]. Në fund të arsyetimit të aktgjykimit :”Gjykata e obligon organin e paditur që në procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanojë të metat e cekura të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj”*. (Aktgjykimi A.nr.848/2009, datë 14 shtator 2012).

7. Më 9 tetor 2012, DFDILVC duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (A.nr.848/2009, datë 14 shtator 2014) e rishqyrtoi lëndën e znj. Krasniqi dhe sërish mori vendim: *“Ankesa Refuzohet”*, me arsyetimin se: *“Me rastin e rivendosjes sipas ankesës sërish u vërtetua se nuk plotësohen kushtet ligjore për pension familjar të viktimës civile. Bazuar në faktin se nuk ofrohen dëshmi se ligjërisht janë kryer ndërrimet e emrit personal të të ndjerit Pashk Gjon Abazi si tek anëtarët e tjerë të familjes së ankueses konform Ligjit Nr.02/L-118 për emrin personal [...]”* duke e udhëzuar palën e pakënaqur që brenda afatit ligjor sërish të iniciojë kontest administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës (Vendimi nr.04-03/412, datë 9 tetor 2012).
8. Më 21 mars 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative mori aktvendim, me kërkesë për znj. Krasniqi që të bëj plotësimin e padisë në afat prej 8 ditësh (Aktvendimi A.nr.1354/2012, datë 21 mars 2014).
9. Më 15 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative mori Aktgjykim: *“Aprovohet kërkesëpadija e padiësës Marije Krasniqi nga fsh. Ramoc, KK Gjakovë. Anulohet vendimi i Qeverisë së Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti për Familjet e dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave civile në Prishtinë me Nr. 04-03/412, dt. 09.10.2012 dhe çështja i kthehet të paditurës në rivendosje”*.(Aktgjykimi A.1354/2012, datë 15 tetor 2014).
10. Më 15 dhjetor 2014, DFDILVC në procedurë të shqyrtimit në çështjen e znj. Krasniqi, duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative(A.1354/2012, datë 15 tetor 2014) mori vendim që znj. Krasniqi t’i njihet e drejta në pension të Familjeve të Viktimave Civile të Luftës nga data 1 nëntor 2014.
11. Më 12 janar 2015, Sektori për ankesa pranë DFDLVC, duke vepruar si organ i shkallës së dytë në ankesën e znj. Krasniqi, për njohjen e së drejtës në kompensim nga data e aplikimit (18 mars 2009), vendosi që të refuzojë ankesën e saj, duke e udhëzuar palën e pakënaqur të iniciojë kontestin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (Vendimi 04-03/412, datë 12 janar 2015).
13. Më 3 shkurt 2015, z. Prek Krasniqi ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, në emër të së ëmës znj. Marije Krasniqi, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), respektivisht Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të Luftës (DFDILVC), lidhur me refuzimin e kërkesës për njohjen e pensionit familjar të viktimës civile të luftës nga data e aplikimit. Më 6 shkurt 2015, znj. Krasniqi sërish parashtrroi padi për iniciimin e kontestit administrativ me kërkesë për kompensimin retroaktiv të të drejtës në pension Familjar për Viktimat Civile të Luftës (Lënda Gjyqësore A.25/15, datë 6 shkurt 2015).

II. INSTRUMENTET RELEVANTE LIGJORE

14. Neni 21, paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “Kushtetuta”) përcakton si në vijim: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”*, dhe *“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*
15. Neni 24, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton si në vijim: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”*, kurse neni 32 i Kushtetutës përcakton: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*.
16. Neni 53 i Kushtetutës përcakton : *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, kurse neni 54 përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*.
17. Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, (në tekstin e mëtejshëm “Konventa”) në paragrafin 1, thuhet: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”*.
18. Neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*.
19. Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.
20. Neni 2 i Ligjit Nr. 02/L-2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës në paragrafin 6 përcakton: *“Viktimë civile e luftës, konsiderohet personi i cili ka vdekur nga pasojat e luftës në Kosovë, prej 27.02.1998 deri më 20.06.1999, si dhe personat të cilët konsiderohen të zhdukur gjatë kësaj periudhe kohore, si dhe personat që kanë pësuar nga mjetet shpërthyes që kanë mbetur nga pasoja e luftës”*, kurse paragrafi 11 i këtij neni përcakton: *“Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të këtij Ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtra, prindërit, njerku, njerka, si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore ”*.
21. Neni 11 i Ligjit Nr. 02/L-2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës përcakton: *“Anëtarët e familjes së viktimës civile të luftës, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë Ligj realizojnë këto të drejta:*
- 22.

- a) *Pensionin familjar civil të luftës,*
 - b) *Përkujdesjen shëndetësore primare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike;*
 - c) *Lirim nga tatimi në pronë, nëse familja është në gjendje të rëndë materiale;*
 - d) *Tarifën e lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike, nëse familja është në gjendje të rëndë materiale;*
 - e) *Shfrytëzues të pensionit sipas radhës janë: bashkëshorti/ja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtra, prindërit (babai, nëna, njerku, njerka)”.*
23. Neni 1 i Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre përcakton: *“Qëllimi i nxjerrjes këtij ligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit”,* kurse Neni 3, paragrafi 1.10, përcakton: *“Viktimë Civile e Luftës-personi i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut, e më vonë ka vdekur brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyes të mbetura pas përfundimit të luftës”.*
24. Neni 5, paragrafi 1 Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre përcakton: *“Në përputhje me njohjen dhe përcaktimin e statusit për kategoritë e dala nga lufta, pensionet e përcaktuara në këtë ligj janë: Pensioni familjar të cilin e realizojnë familja e ngushtë e dëshmorit, familja e ngushtë e të zhdukurit të UÇK-së, familja e ngushtë e viktimës civile të luftës [...]”,* kurse neni 22, paragrafi 1 përcakton: *“Të gjitha kërkesat e paraqitura në organin përgjegjës të Ministrisë sipas Ligjit Nr. 02/L-02 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, të cilat janë në shqyrtim e sipër, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të rregullohen dhe përcaktohen sipas dispozitave të këtij ligji”.*
25. Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton: *“Aktgjykimet e gjykatës, të nxjerra në konfliktet administrative, janë të detyrueshme”,* kurse neni 43, paragrafi 3 përcakton: *“Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”.*
26. Neni 46, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton: *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”,* kurse neni 67, paragrafi 1 përcakton: *“Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me*

vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, gjykata do ta anulojë aktin e kontestuar dhe si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim. Aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit kompetent”.

Analiza e rastit

27. Kushtetuta si akti më i lartë juridik i një vendi mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimit dhe realizimit praktik të këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë përfshirë këtu edhe DFDILVC dhe institucionet gjyqësore.
28. Neni 24, i Kushtetutës në paragrafin 1 përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim, kurse neni 32 i Kushtetutës përcakton që secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike efektive kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative për të cilat konsideron se i cenojnë të drejtat ose interesat e personit në mënyrën e përcaktuar me ligj. Nisur nga ky fakt, janë krijuar një gamë e gjerë e bazës ligjore dhe akteve tjera përcjellëse (nënligjore), duke përfshirë së fundmi edhe themelimin e Departamentit për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me kompetencë për të vendosur për të gjitha kontestet administrative në Republikën e Kosovës. Ligjvënësi e ka paraparë të rëndësishme rregullimin e kësaj fushë, prandaj të njëjtën e ka rregulluar me norma imperative.
29. Avokati i Popullit thekson që në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata Evropiane”), kurse neni 54 i Kushtetutës përcakton se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur. Nga analiza juridike e këtij rasti shihet se pavarësisht që është konstatuar shkelja e të drejtës së znj. Krasniqi nga ana e DFDILVC-së, si dhe përkundër faktit se legjislacioni në fuqi i kishte ofruar garancitë e duhura për mjete juridike, këto mjete nuk janë treguar efektive.
30. Në vendimin e Gjykatës Evropiane, te rasti *Leshchenko & Toliupas kundër Ukrainës (rasti nr. 56918/00, datë 8 nëntor 2005)*, lidhur me pretendimet e paditësve se kohëzgjatja e procedimeve në çështjen e tyre e tejkalonte kërkesën e “*afatit të arsyeshem*” të parashtruar në nenin 6, para. 1 të Konventës, gjykata gjeti se ka shkelje, pavarësisht që qeveria kishte pohuar se procedimet ishin komplekse dhe se nuk kishte periudha të konsiderueshme vonese që mund t’i atribuoheshin autoriteteve të brendshme, duke provuar të argumentojë se kërkuesit ishin përgjegjës për vonesat e çështjes e cila kishte zgjatur dhjetë vjet, kështu që përfundoi me vendimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme, duke konkluduar se ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1 të. Gjykatës Evropiane dhe se kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e kërkuesve dhe përfaqësuesit të tyre nuk mund të shpjegojë zgjatjen e tepruar të procedimeve.
31. Në vendimin e Gjykatës Evropiane në çështjen e *Lukenda kundër Sllovenisë*, datë 6 tetor 2005, kërkuesi u ankua se mjetet juridike në dispozicion në Slloveni për çështjet e zgjatjes së procedurave, nuk ishin efektive. Ai u mbështet kryesisht në nenin 13 të Konventës i cili parashikon: “*Çdokush, të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja kryhet nga persona që veprojnë në përmbushje të*

funksioneve të tyre zyrtare.” Gjykata pasi e shqyrtoi këtë rast e deklaroi kërkesën të pranueshme, dhe vlerësoi se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, po ashtu gjeti se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, si dhe konstatoi, se shkeljet e gjetura e kanë origjinën në keqfunksionimin e legjislacionit dhe praktikës së brendshme. Ngjashëm mund të konstatohet se ka ndodhur edhe në rastin e ankuesit, sepse pavarësisht se ishte konstatuar se mjetet juridike në dispozicion janë në anën e znj. Krasniqi, ato ishin treguar joefektive sepse nuk u përfillën nga DFDILVC dhe nuk e vendosën të drejtën e saj, në vendin e duhur.

32. Në vendimet e Gjykatës Evropiane të çështja “*Qufajco. shpk kundër Shqipërisë,*” datë 2 tetor 2003, dhe çështja “*Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë,*” datë 13 nëntor 2007, lidhur me shkeljet e të drejtave të ankuesve për të pasur një proces të rregullt ligjor, si pasojë e dështimit të autoriteteve përgjegjëse për të ekzekutuar vendimet administrative të formës së prerë, dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë, gjykata tërhoqi vëmendjen se ekzekutimi i vendimeve është pjesë përbërëse e “gjykimit” për qëllimet e nenit 6 dhe se vonesa në ekzekutimin e tyre mund të cenojë thelbin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Evropiane vëren se, pavarësisht faktit nëse jemi para një vendimi gjyqësor apo administrativ që është përfundimtar, ligji i brendshëm dhe Konventa parashikon që vendimi të zbatohet përndryshe kemi shkelje të Nenit 6, parag.1 të Konventës.
33. Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Në kuptim të kësaj dispozite vërehet se kemi të bëjmë me trajtim të pabarabartë të znj. Krasniqi në raport me përfituesit e tjerë të cilët ishin duke përfituar pensione sipas skemës sociale për personat e kësaj kategorie, prandaj mund të konstatojmë se veprimi i DFDILVC ishte diskriminues.
34. Neni 2 i Ligjit Nr. 02/L-2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës në paragrafin 6 përcakton se viktimë civile e luftës, konsiderohet personi i cili ka vdekur nga pasojat e luftës në Kosovë, prej datës 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999, si dhe personat të cilët konsiderohen të zhdukur gjatë kësaj periudhe kohore, si dhe personat që kanë pësuar nga mjetet shpërthyesë që kanë mbetur nga pasojat e luftës, kurse paragrafi 11 i këtij neni përcakton që anëtarë të familjes së ngushtë janë bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), thjeshtri, thjeshtra, prindërit, njerku, njerka, si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore. Nga analiza e këtij rasti shihet se znj. Krasniqi kishte aplikuar t’i njihet e drejta në pension për djalin e saj të vrarë, sipas kësaj dispozite ligjore, por kërkesa e saj ishte refuzuar nga DFDILVC, në kundërshtim me ligjin.
35. Neni 1 i Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (*i cili e shfuqizoi Ligjin Nr.02/L-2*), përcakton se qëllimi i ligjit është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit, kurse neni 3, paragrafi 1.10, përcakton se viktimë civile e luftës është personi i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut, e më vonë ka vdekur brenda periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri me 20 qershor 1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës. Avokati i Popullit me

të drejtë e shtron pyetjen se rasti konkret a është trajtuar në mënyrë meritore në pajtim me qëllimin e ligjit i cili përcakton se këto kategori të dala nga lufta e UÇK-së me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit?

36. Neni 5, paragrafi 1 Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre përcakton që në përputhje me njohjen dhe përcaktimin e statusit për kategoritë e dala nga lufta, pensionet e përcaktuara e këtë ligj janë pensioni familjar të cilin e realizojnë familja e ngushtë e dëshmorit, familja e ngushtë e të zhdukurit të UÇK-së, familja e ngushtë e viktimës civile të luftës etj, kurse neni 22, paragrafi 1 i këtij ligji përcakton se të gjitha kërkesat e paraqitura në organin përgjegjës të MPMS, sipas Ligjit Nr. 02/L-02 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, të cilat janë në shqyrtim e sipër, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të rregullohen dhe përcaktohen sipas dispozitave të këtij ligji. Pavarësisht se ky ligj kishte hyrë në fuqi gjatë kohës sa ishte në shqyrtim ankesa e znj. Krasniqi, ndryshimi i ligjit nuk pati ndonjë efekt në zgjidhjen e kësaj çështje, por kërkesa e znj. Krasniqi vazhdoi të qarkullonte nga një institucion tek tjetri sipas relacionit MPMS-Gjykatë dhe anasjelltas.
37. Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton që aktgjykimet e Gjykatës, të nxjerra në konfliktet administrative, janë të detyrueshme për palët të cilave ju drejtohen, kurse neni 43, paragrafi 3 përcakton mundësinë që te rastet kur bëhet anulimi i aktit administrativ dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin. Nga rrethanat e rastit shihet se kemi një përsëritje procedurash dhe refuzim të vazhdueshëm të kërkesës nga ana e DFDILVC-së, por asnjëra nga Gjykatat në procedurat e tyre nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë ligjore për të nxjerrë vendim meritor lidhur me kontestin.
38. Neni 46, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përcakton mundësinë që në ndonjë rast kur gjykata mund të konstatojë se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mund ta anulojë atë, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, prandaj gjykata me aktgjykim mund të vendosë për çështjen administrative dhe aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”, kurse neni 67, paragrafi 1 përcakton situatat nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ sërish e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, gjykata duhet ta anulojë aktin e kontestuar dhe si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim. Nga analiza e këtij rasti shihet qartë se gjykata i kishte në dispozicion të gjitha mundësitë ligjore ta zgjidhë në substancë çështjen e ankueses, sepse pas anulimit të aktit administrativ e kishte të qartë se akti tjetër administrativ i DFDILVC ishte nxjerrë sërish në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës dhe në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, prandaj kur znj. Krasniqi kishte paraqitur padi të re, gjykata do të duhej ta jetësonte këtë dispozitë ligjore, të anulonte aktin e kontestuar dhe si rregull, vetë të vendoste për këtë çështje me aktgjykim.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

39. Avokati i Popullit, në bazë të dëshmimeve të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, konstaton se ankesa e ankuesit është e arsyeshme dhe se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Avokati i Popullit duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara më lart, konsideron se DFDILVC, ka marrë vendime të pabazuara dhe të kundërligjshme me të cilat ia ka refuzuar të drejtën në pension familjar znj. Krasniqi, pavarësisht se gjykatat kishin gjetur se vendimet administrative të DFDILVC ishin të pabazuara. Gjykata kishte rekomanduar DFDILVC-në t'i marrë parasysh të metat e gjetura në vendimet e saj, duke arsyetuar se ndryshimi i mbiemrit familjar në çështjen e ankuesit nuk kishte ndryshuar kurrfarë rrethane në raport me anëtarin e familjes, si dhe ndryshimi i mbiemrit familjar ishte lejuar sipas aktvendimit Nr. 201-82 të datës 3 maj 2002.
40. Avokati i Popullit konsideron, që Gjykatat në asnjërin nga procedurat e saja në këtë rast (*shih paragrafët 6, 8 dhe 11 të këtij raporti*) nuk janë lëshuar në zbatim të të drejtës materiale në çështjen e znj. Krasniqi dhe ky defekt i ka përcjellë gjykatat e në kontestet administrative në mënyrë sistematike, pasi ato vetëm kishin konstatuar shkeljet ligjore në vendimet e DFDILVC-së, por nuk kishin shfrytëzuar mundësinë dhe kompetencën ligjore për të riparuar këto shkelje duke ndryshuar vendimin e DFDILVC me aktgjykim, në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative (shih paragrafi 38).
41. Avokati i Popullit konstaton se gjykata, duke e kthyer çështjen te organi administrativ për rivendosje, ka bërë që aktgjykimet të jenë joefikase dhe drejtësia të mos vendoset në vendin e duhur. Është i pakuptimtë fakti se në vendimet e gjykatës (në të tri aktgjykimet) vetëm janë konstatuar shkeljet ligjore, por nuk janë marrë veprime për të detyruar shkelësin (DFDILVC) që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të eliminuar shkeljet, si dhe për të kompensuar palën e dëmtuar, me ç'rast është zbehur fuqia dhe besimi në gjyqësor.
42. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*". Sipas kuptimit të nenit 16, paragrafit 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.05/L-019, Avokati i Popullit ka kompetencë : "*Të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor*", kurse sipas nenit 18, paragrafi 1.2 të po këtij ligji, Avokati i Popullit ka përgjegjësi : "*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla*".

Prandaj, Avokati i Popullit

REKOMANDON

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që:

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, t'i trajtojnë kërkesat dhe ankesat e qytetarëve mbi bazën e dëshmimeve të paraqitura dhe t'ju kushtohet kujdes i posaçëm aktgjykimeve të gjykatave dhe t'i vlerësojnë ato për marrjen e vendimit të drejtë për palët dhe mos t'i kthejnë prapa në procedura gjyqësore.

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative që:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme që në padi për konflikt administrativ përveç shkeljeve procedurale të vendoset edhe në çështje meritorë të rasteve, pasi në shumë raste të vendimeve për shkelje procedurale palëve po ju refuzohet serish kërkesa nga organi administrativ.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

RAPORT ME REKOMANDIME

Ankesa nr. 564 /2016

Halili dhe të tjerët

Raport lidhur me të drejtat e të pandehurit në procedurë penale

Drejtuar:

- z. Blerim Isufaj , Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës
- z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit
- z. Nehat Idrizi, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- z. Besim Morina, U.D. Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, 20 tetor 2016

Qëllimi i Raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vërejtjes mbi shkeljen e të drejtave themelore në procedurën penale, përkatësisht në fazën e hetimit me rastin e ngritjes së aktakuzës dhe dërgimit të çështjes në gjykatë. Në këtë drejtim do të trajtohet në veçanti publikimi i njoftimit për ngritje të aktakuzës pa njoftimin paraprak të personave të akuzuar.
2. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka pranuar 3 ankesa nga persona të ndryshëm me inicialet F.H., D.K. dhe H.A. (tutje Ankuesit) që kanë shqetësimin e njëjtë, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre në një rast të ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (tutje Prokuroria Speciale) pranë Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjilan, ku janë të përfshirë 39 persona, të cilët nuk janë njoftuar për këtë veprim nga ana e prokurorisë, por këtë fakt e kanë mësuar vetëm përmes mediave me datë 16 shtator 2016. Pas pranimit të këtyre ankesave, IAP ka hapur rastin me qëllim të mbledhjes së fakteve dhe analizës së tyre me qëllim të konstatimit nëse ka shkelje të të drejtave ligjore të palëve që kanë qenë të përfshira në aktakuzën e Prokurorisë Speciale për shkak të mos informimit të tyre para se të bëhet njoftimi publik në media.
3. Prandaj, përmes këtij raporti Avokati i Popullit ka për qëllim kryesor:
 - të tërheq vërejtjen mbi domosdoshmërinë e mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, jetësimit të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtave tjera të personave që mund të jenë objekt i hetimit dhe akuzimit për vepra penale;
 - të argumentoj shkeljen e të drejtave të palëve në procedurë penale, përmes interpretimit të saktë dispozitave ligjore që garantojnë këto të drejta dhe të cilat janë të detyrueshme për organet e drejtësisë, përkatësisht Prokurorinë Speciale;
 - të vë në pah shkeljet e dispozitave ligjore në rastin për të cilin janë ankuar personat e akuzuar, dhe duke bërë një interpretim me të thellë në dritën e të drejtave themelore të njeriut të jap rekomandime konkrete që shkeljet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Baza juridike

4. Raporti bazohet në nenin 135, *parag.3* i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përkatësisht nenin 16 (*parag.1-4* dhe 8) dhe nenin 18, *parag.1* (nënparag. 1.1-1.2 dhe 1.6). Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit në përgjigje të ankesës së personave të lartë përmendur, përmes këtij raporti vendos të shqyrtoj rastin e shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë, ligje dhe me instrumente ndërkombëtare, dhe të jap rekomandimet përkatëse.

Përmbledhja e fakteve dhe veprimet fillestare të Institucionit të Avokatit të Popullit

5. IAP me datë 23.09.2016 ka pranuar tri ankesa nëpërmjet e-mail adresës zyrtare nga ankues të ndryshëm, të cilët pretendojnë se janë njoftuar vetëm nga mediat për ngritjen e aktakuzës kundër tyre nga Prokuroria Speciale dhe konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre themelore të garantuara me kushtetutë dhe ligjet në fuqi.
6. Ankuesit në shkresat e tyre paraqesin faktin se me datë 16.09.2016 në ora 14:30, në portalet e gazetave “Telegafi” dhe “Express” e më vonë edhe në televizionin KTV dhe ARTA, në mënyrë të vazhdueshme është dhënë informacioni për ngritjen e aktakuzës nga Prokuroria Speciale ndaj 39 të

akuzuarve, në mesin e tyre edhe ankuesit. Përkundër kësaj, ankuesit nuk kanë marrë asnjë njoftim zyrtar apo konfirmim nga prokuroria në lidhje me aktakuzën e ngritur ndaj tyre siç është njoftuar vazhdimisht në mjete të informimit, prandaj konsiderojnë se më këtë u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (përkatësisht nenet 21, 23 dhe 30) dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Sipas ankuesve, në mbrëmjen e datës 16.09.2016 kanë përjetuar një traumë, kur për ngritjen e aktakuzës janë informuar familja e ngushtë dhe rrethi i gjerë familjar drejtpërdrejt nga mjetet e informimit duke shkaktuar një gjendje të rëndë emocionale. Me këtë veprim, përkatësisht dhënien e njoftimit për media nga Prokuroria Speciale pa njoftimin dhe informimin paraprak të tyre si persona të përfshirë në aktakuzë, ankuesit konsiderojnë se është shkelur dinjteti i tyre personal dhe familjar, si dhe janë prejudikuar si fajtorë, çka përbën shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë. Ankuesit, duke konsideruar se pasojat e shkaktuara ndaj tyre me dhënien e njoftimit për media nga Prokuroria Speciale nuk mund të zbutën me ankesë në adresë të IAP, por për shkak të besimit të tyre në IAP, kërkojnë trajtimin e kësaj çështje edhe me qëllim të marrjes së masave që shkeljet e tilla mos të përsëriten në të ardhmen.

7. Pas pranimit të ankesave, IAP ka hapur rast dhe përveç veprimeve të tjera ka kontaktuar edhe palët, të cilët kanë dëshmuar se edhe pas njoftimit në media akoma nuk kanë pranuar aktakuzën nga Prokuroria Speciale dhe nuk kanë angazhuar as avokat mbrojtës meqenëse nuk janë të informuar për përmbajtjen e aktakuzës që është publikuar në media (Deklarimet e datës 29.09.2016). Pra, rrjedhimisht sipas këtyre dëshmive del se detyrimi i informimit të palëve për aktakuzën nga ana e Prokurorisë Speciale nuk është përmbushur as përmes avokatit.
8. IAP ka vërejtur se përveç mediave që janë përmendur nga ankuesit, njoftimi për ngritjen e aktakuzës nga Prokuroria Speciale me datë 16.09.2016 ndaj 39 personave ku janë të përfshirë edhe ankuesit, është publikuar edhe në disa media të tjera dhe në web-faqën zyrtare të Prokurorisë Speciale të Kosovës (Shih <http://www.psh-ks.net/sq/lajme/prokuroria-speciale-e-republikes-se-kosoves-kan-gritur-aktakuzë-kunder-39-personave-per-vepra-penale-qe-nderlidhen-me-krim-te-organizuar-dhe-korrupsion>).
9. Në bazë të komunikimit me ankuesit, IAP është njoftuar ndërkohë se ata kanë pranuar kopjet e aktakuzës me datë 06.10.2016.
10. Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit ka vërejtur se ka bazë për vlerësimin e shkeljeve të pretenduara nga ankuesit, si persona të akuzuar ne procedurë penale, dhe ne vijim të raportit vendos të analizoj të drejtat themelore të personave që janë objekt i hetimit dhe akuzës në procedurë penale siç garantohet me dispozitat formale-juridike në lidhje me të drejtën për informim, për t'u prezumuar të pafajshëm dhe për t'u trajtuar me dinjtet. Analiza në këtë raport do të kufizohet kryesisht në lidhje me shkeljet e pretenduara në rastin konkret të paraqitur nga ankuesit, përkatësisht njoftimit publik mbi faktin e ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë Speciale (përmes medieve) dhe mos informimi paraprak i personave të përfshirë në aktakuzë.

Analiza e rastit

I. E drejta për t'u informuar për aktakuzën dhe përmbajtjen e saj ne raport me përgatitjen e mbrojtjes efektive – garancitë ligjore për të pandehurin

11. E drejta e personit të pandehur në procedurë penale për t'u informuar në kohë sa më të shpejtë në lidhje me aktakuzën dhe provat e tjera, përbën një nga të drejtat themelore të tij. Në rastin konkret, ku janë të përfshirë edhe ankuesit, Prokuroria Speciale nuk ka arritur të zbatoj këtë të drejtë ligjore.

Avokati i Popullit vë në pah se njoftimi i të pandehurit me aktakuzën dhe vënia në dispozicion i provave në afat sa më të shpejt, nuk paraqet thjesht një detyrim formal, por në vetvete përmban garancinë e ruajtjes së dinjitetit të personit të akuzuar (duke e njoftuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë të qartë për akuzat) dhe në anën tjetër paraqitet si parakusht për përgatitjen e mbrojtjes efektive nga i pandehuri për fazat e tjera të procedurës.

12. Për me tepër, me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP) që është në fuqi nga 1 janar 2013, derisa zbatohet modeli me premisa të tipit akuzator për dallim nga kodi i kaluar⁷⁵, informimi në kohë për ngritjen e aktakuzës dhe përgatitja efektive e mbrojtjes marrin vlerë të posaçme për shkak të rolit që tani kanë palët në procedurë penale. Në këtë drejtim, detyrimi i prokurorit të shtetit është edhe më i madh që të kujdeset për ruajtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të pandehur gjatë fazës së hetimit dhe ngritjes së aktakuzës, derisa nuk kemi një rol aktiv të njëjtë të gjyqtarit në këtë fazë. Edhe për këtë arsye, mos informimin e palëve për aktakuzën nga ana e Prokurorisë Speciale në kohën e ngritjes së saj, para se ky fakt të bëhet publik në media, Avokati i Popullit e konsideron veprim në kundërshtim me detyrimet që ka prokurori i shtetit.
13. Sipas nenit 242, *parag.1* të KPP “*Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit*”. Nga kjo buron obligimi i prokurorit të shtetit që në momentin e ngritjes së aktakuzës duhet të sigurohet se edhe materialet janë të gatshme për t’i dhënë të pandehurit.⁷⁶
14. Në lidhje me rastin konkret, duhet cituar se KPP në dispozitën mbi “Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës” në nenin 244, *parag.1* (nënpag.1.1-1.6) përcakton se: “*Jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet e mëposhtme ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit:*
 - *procesverbalet mbi deklaratimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri;*
 - *emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t’i thërret për dëshmim dhe çdo deklaratim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë;*
 - *të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfaqësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklaratimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje;*
 - *rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen;*
 - *kallëzimet penale dhe raportet e policisë; dhe*
 - *përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.*

⁷⁵ Siç dihet, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale (1 janar 2013) në sistemin tonë zbatohet sistemi inkuizitor, ku gjyqtari kishte rol aktiv në mbledhjen e provave dhe përgjegjësi funksionale me të madhe për mbrojtjen e të drejtave të personit të pandehur në procedurë penale. Me Kodin e ri është akceptuar modeli i sistemit akuzator kur gjyqtari tani nuk e ka këtë rol, por barra bie mbi prokurorin e shtetit dhe të pandehurin për mbledhjen dhe prezantimin e provave, prandaj edhe detyrimet dhe përgjegjësitë e prokurorit për mbrojtjen e të drejtave të palëve në procedurë janë shtuar. Me shumë shih edhe Udhëzuesi i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë 2013 (tutje Udhëzuesi i KPP) fq.31 dhe vazhdim.; Raporti i OSBE-së: Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë, 26 Qershor 2016 (tutje Raporti i OSBE-së).

⁷⁶ Për me shumë shih edhe Udhëzuesi i KPP, fq.62.

15. Nga këto dispozita del se prokurori i shtetit, në rastin konkret prokurori i Prokurorisë Speciale nuk ka zbatuar këtë detyrim në raport me të pandehurit (ankuesit). Për me tepër, duhet theksuar se në *parag.3* përcaktohet se: *“Pas ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit çfarëdo materiali të ri të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre”*. Në rastin konkret, përveç të tjerave, Avokati i Popullit vëren se Prokuroria Speciale nuk ka shfrytëzuar as këtë mundësi që përcaktohet në KPP që të njoftoj të akuzuarit për aktakuzë e ngritur ndaj tyre (pra, afatit kohor prej 10 ditëve, në kuptim të një afati të arsyeshëm), siç del nga deklaratimet e ankuesve se as pas këtij afati nuk kanë pranuar aktakuzën me materialet përkatëse dhe nuk kanë avokat të autorizuar (Deklaratat e datës 29.09.2016). Përkundrazi, IAP është informuar se ankuesit kanë pranuar kopjen e aktakuzës (*Aktakuza PPS.Nr.129/2014*) vetëm me datë 06.10.2016, afërsisht 1 muaj nga ngritja e saj (10.09.2016 – data e ngritjes së aktakuzës).
16. Avokati i Popullit konsideron se megjithëse parashihet mundësia ligjore që gjyqtari (në rastin e ankuesve kryetari i trupit gjykues) të dorëzoj një kopje të aktakuzës për të pandehurin gjatë shqyrtimit fillestar (neni 245 i KPP), kjo nuk mund të konsiderohet në asnjë rast si zëvendësim i njoftimit nga ana e prokurorit për ngritjen dhe përmbajtjen e aktakuzës.⁷⁷ Madje sipas dispozitës së përcaktuar në *parag.2* të nenit 245 ku thuhet se : *“Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep kopjen e aktakuzës të pandehuri apo të pandehurve, nëse ata nuk i kanë pranuar këto kopje të aktakuzës më parë”*, vërehet se detyrimi i gjyqtarit apo kryetarit të trupit gjykues është i natyrës plotësuese. Aq me tepër, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen, se me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit dhe të drejtave themelore të personave të pandehur, obligimi i prokurorit që të njoftoj të pandehurin për ngritjen e aktakuzës dhe përmbajtjen e saj ekziston gjithmonë para se njoftimi për këtë veprim të bëhet publik, çka nuk ka ndodhur në rastin e ankuesve.
17. Në lidhje me rastin e ankuesve dhe për raste të tjera, Avokati i Popullit vëren gjithashtu, se mos informimi për ngritjen e aktakuzës dhe përmbajtjen e saj, përveç cenimit të dinjitetit të personave të pandehur nga informimi vetëm përmes mediave, logjikisht rezulton edhe me pasoja të tjera për të pandehurit siç është e drejta për *“negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë”* para ngritjes së aktakuzës (shih neni 233, *parag.1*), apo edhe aplikimi i mundësive të tjera ligjore që përcaktohen në KPP siç janë *“lirimi nga dënimi”* (neni 234) dhe shpallja *“dëshmitarë bashkëpunues”* (nenet 235-239).
18. Në raport me vazhdimin e procedurës penale, Avokati i popullit thekson se mos informimi me kohë për ngritjen e aktakuzës, për provat dhe shkresat e lëndës, siç ka ndodhur në rastin e ankuesve, ka për pasojë dobësimin e pozitës së të pandehurve për përgatitjen e mbrojtjes efektive, sidomos për fazën e kundërshtimit të provave në të cilat bazohet akuza apo paraqitjen e kërkesës për hüdhen e aktakuzës nga i pandehuri (neni 259 dhe 250). Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e njoftimit për ngritjen e aktakuzës dhe përmbajtjen e saj për personat e akuzuar, dhe mosvënia në dispozicion e provave dhe materialeve të tjera e rrezikon shfrytëzimin efektiv të këtyre mundësive ligjore nga i pandehuri, dhe cenon parimin e barazisë së palëve në procedurë, si një nga parimet themelore të procedurës penale në Kosovë. Derisa ligjvënësi ka përcaktuar pozitë të barabartë të paditësit dhe të pandehurit, është detyrim i prokurorisë dhe gjykatës që për këto të drejta të kujdesen gjatë gjithë procedurës penale, përfshirë edhe fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorisë.

⁷⁷ Duhet theksuar se në rastin e ankuesve, akoma nuk ka kaluar afati prej 30 ditëve për mbajtjen e shqyrtimit fillestar (sipas nenit 245 të KPP), por kjo nuk arsyeton në asnjë rast mohimin e të drejtave të personit të pandehur gjatë fazës së hetimit dhe para ngritjes së aktakuzës (siç u argumentua me lartë), sidomos dhënien e njoftimit në media për ngritje të aktakuzës pa informuar personat e akuzuar.

19. Për shkak të rëndësisë së njoftimit dhe dorëzimit të shkresave për palët në procedurë, KPP këtë aspekt e rregullon në mënyrë të detajuar në dispozitat e tij (*shih* nenet 476-484). Në lidhje me rastin e ankuesve, Avokati i Popullit kujton në veçanti përcaktimin në nenin 478, *parag.2*, ku parashihet se: “*Të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës i dërgohet personalisht aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit,...*”. Sipas kësaj (*Ex lege*) del se të pandehurit njoftimi dhe shkresat e lëndës duhet t’i dërgohen në kohë të arsyeshme dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj.⁷⁸

20. Përveç mos zbatimit të dispozitave të KPP që u trajtuan me lartë, mbi të drejtën e ankuesve që të njihen me faktin e ngritjes së aktakuzës dhe të informohen qartësisht për akuzat që u vihen në barrë, ky veprim i Prokurorisë Speciale është në kundërshtim edhe me dispozitat dhe frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kushtetuta), Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), dhe përgjithësisht standardeve ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit rikujton, si në vijim:

Në lidhje me këtë aspekt, në nenin 30 të Kushtetutës përcaktohet se: “Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;

(2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;

(3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

(4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;

(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t’i sigurohet mbrojtja falas;

(6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Gjithashtu në nenin 6, *parag.3* të KEDNJ përcaktohet se çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

⁷⁸ Për një krahasim të këtij aspekti shih edhe Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë (Nr.5 i Regj.Themeltar, nr.5 i Vendimit) të datës 10.04.2009, për pushimin e gjykitit të çështjes penale Nr.1, të vitit 2007, ku gjykata me tjerash ka konstatuar se ka shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga Prokuroria, për shkak të mos informimit dhe vënies në dispozicion të pandehurve (ose mbrojtësve të tyre) aktet e procedimit penal ndaj tyre, në formën dhe mënyrën e përcaktuar me ligj, para se çështja të dërgohet në gjykatë. Ky konstatim i gjykatës është mbështetur konkretisht në nenin 327, *parag. 2* të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “... *prokurori, pasi ... sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi (i tij) është njohur me aktet (e çështjes), vendos ... dërgimin e çështjes në gjykatë*”. Me shumë shih vendimin në web faqën zyrtare të gjykatës : <http://www.gjykataelarte.gov.al/>.

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës.

21. Bashkimi Evropian, në mënyrë të vazhdueshme edhe në kuadër të legjislacionit dytësor i ka kushtuar kujdes përcaktimit dhe avancimit të të drejtave të personave të përfshirë në procedurë penale, me theks të veçantë edhe të drejtës për informim mbi akuzat.⁷⁹
22. Gjithashtu, duhet theksuar se GJEDNJ në praktikën e saj, që nga fillimi ka qenë rigorozë dhe shumë e kujdesshme në raport me të drejtën e informimit të personave për aktakuzën dhe vënien në dispozicion të saj në mënyrë të qartë për të pandehurin, në kuptim të sqarimit të detajuar për faktet dhe provat kundër tij.
23. Në lidhje me rastin e ankuesve duhet theksuar, se për me tepër, GJEDNJ kishte konsideruar një rast si shkelje e të drejtave të personit të akuzuar, kur *“edhe pse është dorëzuar aktakuza, megjithatë, fakti se i pandehuri nuk ka qenë me origjinë italiane dhe nuk ka pasur vendqëndrim në Itali, ka njoftuar autoritetet gjyqësore italiane në një mënyrë të qartë, se për shkak të gjuhës ka vështirësi në kuptimin e komunikimit të tyre, dhe ka kërkuar që të dërgojnë dikë që flet gjuhën e tij amtare ose të flasnin në njërin nga gjuhët zyrtare të Kombeve të Bashkuara...”*, mos përmbushja e kësaj kërkesë nga autoritet italiane është konsideruar nga gjykata se i ka pamundësuar të pandehurit që të njihet me akuzat kundër tij, dhe kjo është cilësuar si shkelje e nenit 6 parag.3(a), të KEDNJ” (Shih *Brozicek v. Italisë*, 10964/84, 19 dhjetor 1989).
24. Gjithashtu në një rast të gjykimit për veprën penale “të dhunimit”, pas konstatimit të natyrës së rend të kësaj vepre, Gjykata në mes të tjerash gjen se e drejta e aplikuesit (të pandehurit) që të jetë i informuar në hollësi mbi natyrën dhe shkakun e akuzimit kundër tij dhe e drejta e tij që të ketë kohë dhe lehtësime për përgatitjen e mbrojtjes së tij është shkelur për shkak se *“informatat që kanë përmbajtur akuzën kanë qenë të karakterizuara me paqartësi siç janë hollësitrat mbi kohën dhe vendin e kryerjes, dhe në mënyrë të përsëritshme ka pas kundërthënie dhe ndryshime gjatë kohës së gjykimit...”* (*Mattoccia v. Italisë*, 23969/94, 25 korrik 2000).
25. Në një rast tjetër (*Sadak dhe të Tjerët v. Turqisë*, 29900/96, 29901/96, 29902/96 dhe 29903/96, 17 korrik 2001), GJEDNJ konstaton se: *“Në rastin e rikualifikimit të fakteve, Gjykata e Sigurisë Kombëtare të Ankarasë është dashur t’i mundësojë të pandehurve mundësinë për të ushtruar të drejtat e tyre të mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive, posaçërisht duke iu dhënë atyre kohë të domosdoshme për të bërë këtë gjë. Dosjet e rastit tregojnë që gjykata kombëtare e sigurisë, e cila ka pas mundësi të vendosë për shembull të shtyj dëgjimin edhe njëherë për faktet që janë rikualifikuar, por nuk u ka dhënë këtë mundësi të pandehurve për të përgatitur mbrojtjen për akuzën e re, për të cilën nuk janë informuar deri në ditën e fundit të gjykimit, gjë që ka qenë qartësisht shumë vonë. Përveç kësaj, avokatët e aplikuesve (të pandehurve) nuk kanë qenë të pranishëm në ditën kur është bërë dëgjimi i fundit... Duke marrë parasysh këto fakte, Gjykata ka nxjerr përfundimin se e drejta e aplikuesve (të pandehurve) për tu informuara në hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër*

⁷⁹ Shih Direktiva (BE) 2012/13 e datës 22 Maj 2012, mbi të drejtën e informimit në procedure penale (<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012L0013&from=EN>), Direktiva (BE) 2016/343 e datës 09 Mars 2016, mbi fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën për të qenë i pranishëm në gjyq në kuadër të procedurës penale (<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32016L0343&from=en>), etj.

tyre dhe e drejta e tyre për të pas kohë adekuate dhe lehtësira për përgatitjen e mbrojtjes së tyre është shkelur".⁸⁰

26. Nga këto raste, vërehet se në lidhje me të drejtën për t'u informuar për aktakuzën dhe përmbajtjen e saj (në mënyrë të qartë dhe të detajuar) dhe dhënien e mundësisë për të përgatitur mbrojtjen efektive kundër akuzave, praktika e GJEDNJ ka përcaktuar një standard të lartë në pajtim me përcaktimet e KEDNJ. Prandaj, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen, se ky standard duhet zbatuar edhe nga prokuroritë dhe gjykatat në Republikën e Kosovës, çka në rastin e ankuesve të cilët nuk janë informuar për ngritjen e aktakuzës ndaj tyre para se njoftimi të bëhet publik në media, Prokuroria Speciale as për afërsisht nuk ka përmbyshur detyrimin ligjor apo kërkesat e këtij standardi.

II. Detyrimi i mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe respektimi i prezumimit të pafajësisë në procedurë penale

27. Avokati i Popullit, vëren se në rastin e ankuesve përveç shkeljes së të drejtave të tyre që u përmendën me lartë, me publikimin në media të ngritjes së aktakuzës pa njoftim paraprak është cenuar edhe dinjiteti njerëzor i tyre. Siç del nga deklaratimet e ankuesve dhe faktet e mbledhura nga IAP, njoftimi i të akuzuarve për ngritjen e aktakuzës ka ardhur vetëm përmes mediave, dhe të kuptuarit e këtij fakti në këtë mënyrë ka shkakuar shqetësim të madh të personave të përfshirë dhe familjeve të tyre.
28. Detyrimi i respektimit të dinjitetit të secilit person buron nga kushtetuta, ku në nenin 23 përcaktohet se "*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*". Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit kujton se edhe veprimet dhe vendimet e të gjitha organeve të drejtësisë duhet të jenë në frymën e këtij përcaktimi, si parimi fundamental dhe kornizë e interpretimit të të drejtave themelore të çdo individi, përfshirë edhe palëve në procedurë penale.
29. Mbrojtja e "Dinjitetit të njeriut" është parimi bazë i përcaktuar edhe në dokumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948 (neni 5), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 7), etj.
30. Nuk ka dyshim, se në frymën e këtyre përcaktimeve është edhe KPP, madje në dispozitat e tij edhe shprehimisht përcaktohet obligimi i mbrojtjes së dinjitetit të personit të pandehur në procedurë penale (shih në veçanti nenet 83, *parag.6*; neni 108, *parag.5*; dhe neni 154, *parag.3*).
31. Andaj, Avokati i Popullit, insiston që parimi i mbrojtjes së dinjitetit të personave që janë si të pandehur në procedurë penale, duhet të jetë bazë e të gjitha interpretimeve dhe veprimeve procedurale nga ana e prokurorisë dhe gjykatës.
32. Avokati i Popullit tërheq vërejtjen, se publikimi i aktakuzave dhe sidomos zbulimi i identitetit të personave të dyshuar përmes mediave, pa një kujdes të madh dhe me respektim rigoroz të ligjeve në fuqi, paraqet rrezik për cenimin e dinjitetit të palëve në procedurë penale dhe parimit të prezumimit të pafajësisë së të pandehurve.
33. Në rastin e ankuesve, cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë konsiston në mos informimin e tyre për ngritjen e aktakuzës dhe mos vënien në dispozicion të provave dhe materialeve të rastit ndaj tyre,

⁸⁰ Për më shumë mbi praktikën e GJEDNJ në raport me të drejtën për t'u informuar për përmbajtjen e aktakuzës dhe të drejtën për të përgatitur mbrojtjen në mënyrë efektive shih edhe rastet: *Vaudelle v. Francës*, 35683/97, 30 janar 2001, *Miriaux v. Francës*, 73529/01, 26 shtator 2006, *X v. Mbretërisë së Bashkuar*, 8231/78, 6 mars 1982, etj.

me çka përveç të drejtës për informim në kohë, atyre u është vështirësuar edhe përgatitja efektive e mbrojtjes me qëllim të kundërshtimit të provave mbi fajësinë e tyre.

34. Prezumimi i pafajësisë si parim themelor në procedurë penale, është i përmbajtur në dispozitat e kushtetutës, ku në nenin 31, *parag.5* përcaktohet se: “Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin”. Ndërsa KPP në nenin 3, *parag.1*, për me tepër precizon se: “ Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”. Si tillë parimi i prezumimit të pafajësisë derivon edhe nga teksti dhe fryma e dokumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 11, *parag.1*.) dhe KEDNJ (neni 6, *parag.2*), të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës (neni 22 i kushtetutës).
35. Si i tillë, prezumimi i pafajësisë së të pandehurit në procedurën penale të Kosovës, nuk duhet të jetë vetëm i nënkuptueshëm, por duhet të shprehet nga çdo veprim i organeve të drejtësisë, ne veçanti në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës. Në raport me rastin e ankuesve dhe raste të tjera në këtë fazë të procedurës, i takon prokurorisë që të kujdeset për ruajtjen e identitetit të personit të dyshuar/akuzuar, dhe vënia në dispozicion e aktakuzës dhe provave që e ngarkojnë, duhet të bëhet gjithmonë para se njoftimi për rastin të publikohet në media (apo edhe web faqën zyrtare).

Konstatimet kryesore të Avokatit të Popullit

36. Në këtë raport është trajtuar aspekti i të drejtave të personave të pandehur në procedurë penale, sa i përket fazës së hetimit dhe ngritjes së aktakuzës. Në përgjigje të ankesave të parashtruara nga palët në adresë të IAP, këto të drejta janë trajtuar në raport me normat ligjore në fuqi, përkatësisht e drejta për t’u informuar për akatakuzën dhe përmbajtjen e saj para dhënies së njoftimit për media, e drejta e personave të akuzuar për t’u prezumuar të pafajshëm dhe mbrojtja e dinjitetit të tyre.
37. Në bazë të analizës së rastit konkret në raport më kushtetutën, ligjet dhe dokumentët ndërkombëtare, Avokati i Popullit konstaton se nuk ka zbrastësi ligjore nga këndvështrimi i rregullimit të të drejtave të personit të pandehur në procedurë penale (në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës), por problemi qëndron në moszbatimin e detyrimeve ligjore nga organet e drejtësisë, si në rastin e ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria Speciale dhe publikimi në media pa njoftim paraprak të personave të përfshirë në aktakuzë.
38. Në rastin e ankuesve, Avokati i Popullit konstaton se:
- Ka shkelje të drejtës themelore të personave të pandehur në procedurë penale, për t’u informuar mbi akuzat menjëherë pas ngritjes së aktakuzës, dhe para se ky fakt të bëhet publik në media.
 - Me këtë veprim të Prokurorisë Speciale, rrjedhimisht është cenuar edhe parimi i barazisë se palëve në procedurë, që siç u konstatua edhe me lartë se në sistemin akuzator që përcakton KPP, ky parim ka vlerë të posaçme për të pandehurin.
 - Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se dhënia e njoftimit për media për ngritje të aktakuzës pa njoftimin paraprak të personave të akuzuar, është në kundërshtim me detyrimin e prokurorisë për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe paraqet edhe cenim të parimit të njohur për prezumim të pafajësisë.
 - Si përfundim, Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që këto praktika të mos përsëriten në të ardhmen, në mënyrë që vendimet e organeve të drejtësisë (në këtë rast edhe Prokurorisë

Speciale), veprimet procedurale dhe njoftimet mbi rastet penale të jenë në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe dinjitetit të palëve në procedurë, dhe rritjes së besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë penale.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të analizës së rastit dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, *parag.3* të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, *parag.4* të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon për:

Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kryeprokurorin e Shtetit, që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të ndërmarrim masat e nevojshme:

- *që të udhëzojnë dhe mbikëqyrin respektimin e të drejtës së personave të pandehur për t'u informuar në kohë për aktakuzën kundër tyre dhe t'u mundësohet në mënyrë efektive shfrytëzimi i të drejtës ligjore për kundërshtimin e akuzave.*
- *që në çdo rast të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe mbrojtja e dinjitetit të personave pandehur në pajtim me KPP, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare (në veçanti KEDNJ).*
- *në respektim të këtyre parimeve të bëhet edhe njoftimi i publikut për fazën e hetimeve. Për rastet e ngritjes së aktakuzës, personat e akuzuar të njoftohen gjithmonë para dhënies së njoftimit në media.*

Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- *që të udhëzojë të gjitha Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës, në mënyrë që gjyqtarët në procedurë paraprake të kenë kujdes të shtuar për respektim rigoroz të të drejtave të personit të pandehur në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës.*

Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- *që në kuadër të programit të tyre të ofrojnë trajnime shtesë të fokusuar mbi të drejtat e personit të pandehur në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës, në pajtim me standardet më të larta për të drejtat e njeriut.*

Në pajtim me nenin 132, *parag.3* i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerren lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

III. OPINIONET E AVOKATIT TË POPULLIT

OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT

Opinionon nr. 25/2016

**Opinion lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin
Grudić kundër Serbisë, Aplikimi Nr. 31925/08**

Grudić kundër Serbisë

Prishtinë, më 15 shkurt 2016

PËRMBLEDHJA

Në rastin *Grudić kundër Serbisë*, Aplikimi Nr. 31925/08 (2012), Republika e Serbisë papritmas ua ndërpreu pensionet aplikuesve, dy qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga fakti se ata i plotësonin kushtet ligjore për të marrë pensione të tilla. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur njëzëri se kjo ndërprerje ka shkelur të drejtën e aplikuesve për gëzimin paqësor të posedimeve të tyre, sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe urdhëroi Serbinë t’u ofrojë aplikuesve kompensim të drejtë në pajtim me Nenin 41 të Konventës (shih *Grudić*, §§90–96). Gjykata po ashtu vendosi—në pajtim me Nenin 46, paragrafi 2 të Konventës—që duke pasur parasysh numrin e madh të aplikimeve nga qytetarë të tjerë të Kosovës, pensionet e të cilëve në mënyrë të ngjashme mund të ishin ndërprerë gabimisht, “Qeveria përgjegjëse duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të siguruar që autoritetet kompetente serbe të zbatojnë ligjet relevante për të garantuar pagimin e pensioneve dhe për të kompensuar për këstet e mëparshme të papaguara në fjalë” (*Grudić*, §99).

Rregulli 9.2 i *Rregullores së Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e zbatimit të aktgjykimeve dhe kushteve të marrëveshjeve miqësore* parashikon: “Komiteti i Ministrave është i autorizuar të marrë në konsideratë çdo komunikatë nga . . . institucionet kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut lidhur me zbatimin e aktgjykimeve sipas Nenit 46, paragrafi 2 të Konventës.”

Në pajtim me këtë rregull, po ju shkruaj për të shprehur shqetësimin tim serioz se Republika e Serbisë ka dështuar të përmbushë obligimet e saj sipas aktgjykimit *Grudić* “për të garantuar pagimin e pensioneve dhe për të kompensuar për këstet e mëparshme të papaguara në fjalë.” Bazuar në parashtruesat publikisht të qasshme të Republikës së Serbisë drejtuar Gjykatës dhe Komitetit të Ministrave, duket se Serbia ka shkelur që të dyja, letrën dhe frymën e Aktgjykimit *Grudić*, veçanërisht (1) duke u mbështetur në baza të gabuara juridike, për të mohuar të drejtën e potencialisht mijëra aplikuesve legjitim nga Kosova për rinisjen e pagimin e pensioneve; dhe (2) duke vendosur kufizime të kundërligjshme mbi kompensimin për këstet e papaguara, përfshirë edhe kamatën ligjore, për ata qytetarë të paktë, aplikimet e të cilëve dolën të suksesshme.

Ky Opinion fillon me një përmbledhje të shkurtër të Aktgjykimit *Grudić* dhe të zbatimit të aktgjykimit deri më tani. Pastaj, ai paraqet në mënyrë të detajuar defektet juridike prapa refuzimit tronditës, nga ana e Serbisë, të 96.1% të aplikimeve të parashtruara nga qytetarët e Kosovës për vazhdimin e marrjes së pagesave të pensioneve, si dhe kufizimin e kundërligjshëm prej 12 muajsh, të cilin Serbia e ka vendosur mbi nivelin e kompensimit për këstet e papaguara. Opinioni po ashtu përmend mundësinë që, duke marrë parasysh proporcionin jashtëzakonisht të madh të aplikimeve (84.3%) për të cilat Serbia gjykoj se u mungon dokumentacioni i nevojshëm, Serbia po i lejon konfliktit politik rreth sovranitetit të Republikës së Kosovës që të pengojë zbatimin e plotë të aktgjykimit *Grudić*. Përfundimi i Opinioni tregon hapat që Republika e Serbisë duhet të ndërmarrë për të qenë në përputhje të plotë me aktgjykimin e Gjykatës.

SFONDI

1. Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Grudić kundër Serbisë*

Parashtruesit e kërkesës në rastin *Grudić* ishin një çift që jetonte në Kosovë dhe të cilëve u është njohur e drejta për pension invalidor në vitet 1995 dhe 1999, përkatësisht, nga Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Serbisë (“SPDIF”) (*Grudić*, §§6–7). Më 9 qershor 1999 dhe 15 janar 2000, përkatësisht, SPDIF papritmas ndërpreu pagesën e pensioneve të tyre, pa asnjë shpjegim. (*id.*, §9). Eventualisht, pas kërkesës së aplikuesve në vitin 2003 që të rifillohet pagesa e pensioneve, SPDIF lëshoi një vendim zyrtar në vitin 2005 duke pezulluar pensionet e tyre në mënyrë retroaktive (*id.*, §§10–11). Arsyetimi i SPDIF për

pezullimin, sipas aktgjykimit të Gjykatës, ishte se tani “Kosova ishte nën administrim ndërkombëtar” (*id.*, §11), dhe “pasi që shteti përgjegjës nuk ishte në gjendje të mbledhë kontributet për sigurimin pensional në Kosovë që nga viti 1999, personat të cilëve qysh më parë u ishte njohur e drejta për pension nga SPDIF në këtë territor, më nuk kishin mundësi t’i merrnin ato” (*id.*, §13).

Gjykata njëzëri e hodhi poshtë këtë justifikim. Pikënisja për aktgjykimin e Gjykatës ishte se “[k]ërkesa e parë dhe më e rëndësishme e Nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje nga autoriteti publik në të drejtën e gëzimit paqësor të së drejtës në pronë duhet të jetë e ligjshme” (*id.*, §73). Pasi që “të drejtat pensionale ekzistuese të parashtruesve të kërkesës përbënin posedim në kuadër të kuptimit të Nenit 1 Protokollit nr. 1 ” (*id.*, §77), pezullimi i pensioneve nga ana e SPDIF “në mënyrë të qartë përbënte ndërhyrje në gëzimin paqësor të posedimeve të tyre” (*id.*). Prandaj, pezullimi duhej t’i nënshtrohej kushtit të ligjshmërisë.

Zbatimi i kushtit të ligjshmërisë nga Gjykata u mbështet në mënyrë vendimtare në Opinionin e adoptuar në vitin 2005 nga Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë, Departamenti Civil, lidhur me të drejtat për pension në Kosovë: “Në lidhje me situatën në Kosovë, ky opinion pohonte . . . se një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor” (*Grudić*, §31). Shih *id.*, §80 (“Gjykata Supreme, . . . lidhur me situatën në Kosovë, vuri në dukje në mënyrë të veçantë se një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor”).

Pastaj, Neni 110 njeh vetëm dy baza sipas të cilave të drejtat e përfituesit për sigurim mund të kufizohen në mënyrë të ligjshme. *Së pari*, këto të drejta mund të ndërpriten nëse “gjatë ushtrimit të të drejtave, kushtet për fitimin dhe ushtrimin e së drejtës nuk ekzistojnë më” (Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Neni 110, paragrafi 1), ose me fjalët e aktgjykimit *Grudić*, “nëse ndodh që dikush më nuk i plotëson kushtet origjinale ligjore” për fitimin dhe ushtrimin e kësaj të drejte (*Grudić*, §26). *Së dyti*, të drejtat për pension po ashtu mund të ndërpriten nëse përfituesi tashmë është “duke ushtruar të drejtat sipas këtij sigurimi me një organizatë të obligueshme për pension dhe sigurim nga një shtet i formuar në territorin e ish-Jugosllavisë” (*id.*, Article 110, para. 2). Përveç këtyre dy bazave, Neni 110 nuk njeh asnjë bazë tjetër për ndërprerje, ose kufizim, të të drejtave të përfituesit për sigurim. Në veçanti, nuk ekziston “referencë për pezullim të mundshëm të pakufishëm të pensionit në këtë dispozitë” për shkak të pamundësisë së SPDIF për të mbledhur kontributet në një territor të caktuar (*Grudić*, §78).

Gjykata gjeti se asnjëra nga të dy bazat ligjore të përcaktuara në Nenin 110 për ndërprerjen e pensioneve nuk është përmbushur në rastin e parashtruesve të kërkesës (*id.*). Kështu, gjykata ka arritur konkludimin se “ndërhyrja me ‘posedimet’ e aplikuesve nuk ishte në pajtim me legjislacionin relevant vendor” (*id.*, §81), dhe prandaj, Serbia i ka shkelur të drejtat e aplikuesve të parashikuara në Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës (*id.*, §83).

Bazuar në konstatimin e shkeljes së të drejtave, Gjykata urdhëroi Republikën e Serbisë t’u ofrojë aplikuesve kompensim të drejtë në pajtim me Nenin 41 të Konventës. Përveç urdhrit që secilit parashtrues të kërkesës t’i paguhen EUR 7,000 si dëm jomaterial, Gjykata urdhëroi që “Qeveria përgjegjëse t’u paguajë aplikuesit të parë dhe të dytë . . . pensionet e tyre duke filluar prej datës 9 qershor dhe 15 janar 2000, përkatësisht . . . , së bashku me kamatën ligjore” (*Grudić*, §92). Aktgjykimi *Grudić* në këtë mënyrë u dha të drejtë aplikuesve jo vetëm për rinisjen e pagimit të pensioneve të tyre, por gjithashtu edhe për t’u kompensuar për këstet e papaguara, duke i llogaritur nga datat përkatëse në të cilat këto pagesa janë pezulluar, përfshirë edhe kamatën ligjore.

Veç kësaj, Gjykata vërejtë se kostatimi i shkeljes imponoi obligime më të gjëra mbi Republikën e Serbisë, pasi që kishte gjasë të ketë shumë më shumë qytetarë të Kosovës pensionet e të cilëve ishin ndërprerë nga SPDIF mbi të njëjtën bazë të kundërligjshme si në rastin e aplikuesve dhe të cilët, si edhe në rastin e aplikuesve, kishin të drejtën për rinisjen e pagimit të pensioneve dhe kompensimin për këstet e papaguara, përfshirë edhe kamatën ligjore. Në fakt, madje edhe Republika e Serbisë në pretendimet e saj të parashtruara para gjykatës, haptazi pranoi se numri i qytetarëve të Kosovës në gjendje të ngjashme me aplikuesit e rastit *Grudić* është i konsiderueshëm: “Qeveria vuri në dukje se shumica e përgjithshme e borxhit potencial të shtetit përgjegjës për situatat e ngjashme me atë të aplikuesve do të ishte me të vërtetë e lartë. . . . [T]ë dhënat zyrtare të SPDIF tregonin se shumica në fjalë ishte vlerësuar të jetë 1,008,358,614 euro (“EUR”), ndërsa Ministria e Financave e kishte përcaktuar vetë këtë shumë në vlerën EUR 1,050,468,312[.] (*Grudić*, §71). Prandaj, Gjykata konstatoi se “[b]azuar në këtë . . . numër të madh të aplikuesve potencialë, Qeveria përgjegjëse duhet të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që autoritetet kompetente serbe të zbatojnë ligjet relevante për të garantuar pagimin e pensioneve dhe për të kompensuar për këstet e mëparshme të papaguara në fjalë” (*id.*, §99), duke theksuar më tej se “është e kuptueshme se disa procedura administrative dhe faktike të verifikimit, të shpejta dhe të arsyeshme, mund të jenë të domosdoshme lidhur me këtë” (*id.*). Gjykata urdhëroi që këto masa të ndërmerren brenda afatit prej “gjashtë muajsh nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë” (*Grudić*, Conclusion, §3(d)).

1. Zbatimi i aktgjykimit *Grudić* deri më tani

Pasi që aktgjykimi mori formën e prerë më 24 shtator 2012, Komiteti i Ministrave, në mbledhjen e tij të 1157, të mbajtur më 6 dhjetor 2012, “ftoi autoritetet serbe që të sigurojnë sa më shpejtë që të jetë e mundur një plan veprimi për përcaktimin e masave të ndërmarrë dhe/ose të parashikuara dhe që të mbajë të informuar Komitetin për zhvillimet e situatës” (Vendimi nr. 3).

Në përgjigje të ftesës së Komitetit, Republika e Serbisë ia dërgoi Komitetit letrën të cilën ia kishte dërguar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 20 dhjetor 2012, në të cilën kishte kërkuar një vazhdim të afatit, për shkak të vonës në zbatimin e masave të përgjithshme të urdhëruara nga gjykata. Serbia ofroi një numër arsyetimesh për këtë vonësë. Mes të tjera arsyetimesh, Republika e Serbisë pretendoi se për shkak të miratimit të “Rregullores nr. 2001/35 – për Pensionet në Kosovë nga UNMIK-u më 22 dhjetor 2001, shumë qytetarë të Kosovës dhe Metohisë, përfituesit e mëparshëm të pensioneve nga Fondi Për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Republikës së Serbisë, realizuan të drejtën në pension nga administrata ndërkombëtare, duke ua njohur vitet e punës të realizuara në kuadër të Fondit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë.” Dhe “[d]uke pasur parasysh faktin se përfituesi nuk mund të realizojë të drejtën në pension mbi të njëjtat baza edhe nga administrata ndërkombëtare edhe nga Republika e Serbisë,” Serbia pretendoi se i duhej kohë shtesë me qëllim të “krahasimit të të dhënave lidhur me pensionet së bashku me UNMIK-un.” Përveç kësaj, letra theksonte se në përgjithësi “Republika e Serbisë nuk i njehtë ashtuquajturat akte të Republikës së Kosovës, kështu që i tërë dokumentacioni që dorëzohet nga përfituesit potencialë për të dëshmuar të drejtën në pension duhet të lëshohet nga UNMIK-u.” Dhe përfundimisht, në përmbyllje të letrës, Republika e Serbisë tregoi se “gjithashtu do të ndërmerren hapa për ta bërë këtë çështje subjekt të negociatave ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, të cilat kanë qenë në vazhdim dhe janë duke u zhvilluar në drejtim pozitiv.”

Disa muaj më vonë, Komiteti i Ministrave, në mbledhjen e tij të 1164 të mbajtur më 7 mars 2013, raportoi se më në fund e ka marrë planin e veprimit nga Republika e Serbisë që përfshin “një kalendar të masave që do të ndërmerren për zbatim” të aktgjykimit *Grudić*, si dhe “informatën lidhur me masat e marra për identifikimin dhe verifikimin e personave të cilëve do t’u jepet e drejta për rinisjen e pagesës së

pensioneve dhe kompensimin për këste të mëparshme të papaguara” (Vendimi nr. 1). Duke vënë në dukje se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e kishte vazhduar afatin për zbatimin e këtyre masave deri më 24 shtator 2013, Komiteti “inkurajoi autoritetet serbe që të intensifikojnë përpjekjet e tyre, jo vetëm që të përfundojnë procesin e verifikimit, por po ashtu që të ndërmarrin të gjitha masat e duhura në kuadër të këtij afati” (Vendimi nr. 3).

Më 8 prill 2013, Serbia i dërgoi Komitetit “Raportin për Masat e Ndërmarra për të Zbatuar Planin e Veprimit të Qeverisë së Republikës së Serbisë Lidhur me Pagesat e Pensioneve të Realizuara në Territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.” Ky Raport e informoi Komitetin, ndër të tjera, se 1,643 aplikacione për rinisjen e pagimit të pensioneve janë dorëzuar deri më tani. Por, Komiteti në mbledhjen e mbajtur më 6 qershor 2013, kërkoi më shumë informata. Veçanërisht, “i bëri thirrje autoriteteve të Serbisë të sigurojnë informata për numrin e aplikacioneve të pranuar, përfshirë këtu edhe aplikacionet me dokumentacion të pakompletuar dhe numrin e vendimeve të marra deri më tani, përfshirë edhe numrin e vendimeve pozitive dhe negative” (Vendimi nr. 2). Gjithashtu kërkoi më tej informata për masat e ndërmarra për të siguruar pagesat e borxheve” (Vendimi nr. 3). Në kuadër të vazhdimin të afatit të datës 24 shtator 2013, të cilin gjykata ia dha Serbisë, Komiteti po ashtu e inkurajoi Serbinë të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të respektuar këtë afat (Vendimi nr. 4).

Më 20 shtator 2013, vetëm disa ditë para skadimit të afatit të vazhduar, Serbia dërgoi një “Raport Përcjellës në rastin *Grudić kundër Serbisë* lidhur me Masat e Përgjithshme,” në të cilin raportoi se ka pranuar deri më tani 8,151 aplikime për rinisjen e pagimit të pensioneve dhe se nga ky numër, vetëm 1,278 (15.7%) janë parashtruar me të gjitha dokumentet e nevojshme. Nga aplikimet të cilat Serbia i konsideroi të plota, vetëm në 37 raste (2.9%) u morën vendime pozitive për rinisjen e pagimit të pensioneve. Gjithashtu, “vendimet për rinisjen e pagimit të pensioneve gjithashtu përcakton kompensimin për këstet e mëparshme të papaguara deri 12 muaj më parë.” Ky raport përcjellës, megjithatë, nuk jep ndonjë shenjë se Serbia e kishte paguar edhe kamatën ligjore, pavarësisht udhëzimeve në aktgjykimin e rastit *Grudić*.

1,241 vendimet negative, sipas Serbisë “u morën vetëm për shkak se aplikuesit paraqitën dëshmi në aplikimet e tyre se ata janë përfitues të pensioneve në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.” Serbia pretendon se “në pajtim me Rregulloret e UNMIK-ut, të gjithë personat që e kanë vendbanimin në këtë territor dhe të paktën 15 vjet sigurimi pensional me Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë kanë të drejtë për pension.” Dhe “[p]asi që dispozitat e legjislacionit relevant Serb përjashtojnë mundësinë për të marrë njëkohësisht dy pensione, aplikimet e tyre u refuzuan për këtë arsye.”

Menjëherë pas raportit të Serbisë, Komiteti i Ministrave u takua sërish lidhur me zbatimin e aktgjykimit *Grudić*, në mbledhjen e 1179, të mbajtur më 26 shtator 2013. Në këtë mbledhje, Komiteti, duke vënë në dukje numrin e ulët të vendimeve pozitive lidhur me kërkesat për rinisjen e pagimit të pensioneve, “theksoi në këtë drejtim rëndësinë e sigurimit që çdo refuzim i kërkesës për rinisje të pagimit të pensioneve të ketë bazë të qartë në ligjin vendor” (Vendimi nr. 2). Komiteti më tej u “bëri thirrje autoriteteve Serbe që, në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit, të sigurojë informata të mëtutjeshme lidhur me pagimin e rifilluar të pensioneve, përfshirë këtu edhe dispozitat ligjore të cilat arsyetojnë refuzimin e pagimit të tillë dhe trajtimin e kompensimit të kësteve të mëparshme të papaguara” (Vendimi nr. 4). Përfundimisht, duke pasur parasysh se afati i vazhduar nga gjykata më 24 shtator 2013 kishte kaluar, Komiteti u bëri thirrje autoriteteve serbe të sigurojnë pagesat e pensioneve dhe borgjeve “pa asnjë vonesë” (Vendimi nr. 5).

Në “Raportin Përcjellës në rastin *Grudić kundër Serbia* Lidhur me Masat e Përgjithshme,” të parashtruar më 24 tetor 2013, Republika e Serbisë dorëzoi përmbledhjen e fundit të statistikave të përditësuara. Në këtë raport, Serbia pohoi se 8,238 aplikime janë parashtruar deri më tani për rinisjen e pagimit të pensioneve. Nga ky numër, Serbia i konsideroi 1,295 (15.7%) aplikime si të shoqëruara me dokumentacionin e plotë. Nga ky numër i vogël, numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për rifillim të pagesave të pensioneve ishte 51 (3.9%).

Për këta 51 aplikues të suksesshëm, “vendimet për rinisjen e pagimit të pensioneve gjithashtu përcaktan kompensimin për këstet e mëparshme të papaguara deri 12 muaj më parë, në përputhje me Nenin 123 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor,” i cili parasheh që “këstet mujore të akumuluar të pensionit, kompensimi monetar për dëmtim trupor, që nuk paguhen për shkak të rrethanave të shkaktuara nga përfituesi, do të paguhen pastaj deri në 12 muaj, me efekt retroaktiv prej datës kur përfituesi, duke mos ekzistuar më rrethanat, parashtron një kërkesë për pagim.” Sërish, ky Raport Përcjellës, si edhe ai i fundit, nuk tregon asgjë për pagimin e kamatës ligjore sipas aktgjykimit *Grudić*.

Serbia theksoi për Komitetin se çka kishte parë si bazë ligjore për refuzimin e 96.1% të kërkesave për rifillim të pagesave të pensioneve. Serbia pretendoi se “pothuajse në të gjitha rastet, bazë ligjore për refuzimin e këtyre kërkesave ishte fakti se këta parashtrues të kërkesave tashmë ishin përfitues të pensionit në Kosovë.” Por, me gjithë deklaratën e qartë të aktgjykimit *Grudić* se “sa i përket situatës në Kosovë, . . . një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit të Sigurimit Peshional dhe Invalidor” (*Grudić*, §80), Serbia e bazoi refuzimin e saj pothuajse universal të aplikimeve nga Kosova në një dispozitë tjetër ligjore, Neni 119: “Sipas Nenit 119 të Ligjit për Sigurimin Peshional dhe Invalidor, *përfituesi i pensionit i cili përmbush të drejtën për dy ose disa pensione në territorin e Republikës së Serbisë mund të përdorë vetëm njërën nga pensionet e lartpërmendura, sipas vendimit të tij/saj*” (theks në origjinal).

Në takimin e tij të fundit lidhur me zbatimin e aktgjykimit *Grudić*, takimi i 1186 i Komitetit të Ministrave, i mbajtur më 5 dhjetor 2013, Komiteti “vuri në dukje sqarimet e dhëna nga autoritetet Serbe lidhur me bazën ligjore për refuzimin e rinisjes së pagimit të pensioneve, si dhe procedurat e shqyrtimit gjyqësor në dispozicion të personave kërkesat e të cilëve u refuzuan, dhe udhëzoi Sekretariatit të bëjë një analizë të thellë të çështjes në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet serbe” (Vendimi nr. 2). Komiteti gjithashtu “i bëri thirrje autoriteteve serbe të sigurojnë sa më shpejt që të jetë e mundur informata konkrete për Komitetin lidhur me çështjen e kompensimit për këste të mëparshme të papaguara, siç kërkohet nga Gjykata në aktgjykimin e saj” (Vendimi nr. 3). Po ashtu, lidhur me çështjen e kësteve të mëparshme të papaguara, shënimet nga mbledhja e Komitetit në dhjetor 2013 tregojnë se, Serbia është e obliguar të paguajë këste të mëparshme përtej thjesht 12 muajve. Shënimet rikujtojnë që “në aktgjykimin *Grudić* Gjykata Evropiane dha kompensim të drejtë për dëme materiale të pësuar si rezultat i pezullimit të pensioneve të aplikuesve që nga vitet 1999 dhe 2000, përkatësisht. ” Nga ky fakt, Komiteti arsyetoi se “këstet e papaguara midis datës së pezullimit të pagimit të pensioneve në fjalë dhe datës së rinisjes së pagimit, kanë për t’u paguar. Informata lidhur me këtë është ende duke u pritur.”

Përfundimisht, Raporti i 8-të vjetor (2014) i Komitetit të Ministrave për mbikqyrjen e zbatimit të aktgjykimeve dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i publikuar në mars 2015, raporton se pas mbledhjes së Komitetit të mbajtur në dhjetor 2013, “është në pritje të informatave për trajtimin e kërkesave të parashtruara pas masave të miratuara deri më tani – veçanërisht në dritën e rezultatit të një numri të rasteve të parashtruara pranë gjykatës dhe të komunikuar tek Qeveria.”

Sipas dijenisë sime, ky raport i vitit 2014 siguron informatën e fundit në dispozicion për zbatimin e aktgjykimit *Grudić*.

ARGUMENTI

A. Duke refuzuar aplikimet nga qytetarët e Kosovës në bazë të Nenit 119 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Serbia ka vepruar me mosbindje të drejtpërdrejtë ndaj deklaratës së qartë dhe kategorike të Aktgjykimit në rastin *Grudić*, se “lidhur me situatën në Kosovë, . . . një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor” (*Grudić*, §80).

Siç shihet, Republika e Serbisë, në raportin e saj të fundit “Raportin e zbatimit në rastin *Grudić* k. Serbisë Lidhur me Masat e Përgjithshme,” të datës 24 tetor 2013, përfundimisht shpërfaqti bazat e supozuara ligjore sipas të cilave e ka refuzuar pothuajse çdo aplikim nga qytetarët e Kosovës të dokumentuar plotësisht (96.1%) për rifillim të pagesës së pensioneve. Por, duke u mbështetur në Nenin 119 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Republika e Serbisë shpërfill në mënyrë flagrante deklaratën e qartë dhe të përsëritur të aktgjykimit *Grudić*, duke u bazuar në një Opinion të Divizionit Civil të Gjykatës Supreme të Serbisë, që “në lidhje me situatën në Kosovë, . . . një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor” (*Grudić*, §31; theks i shtuar), gjithashtu të ritheksuar, duke përdorur pothuajse të njëjtat fjalë të sakta më vonë në aktgjykim: “lidhur me situatën në Kosovë, vuri në dukje në mënyrë të veçantë se një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor” (*Grudić*, §80; theks i shtuar).

Vlen të përmendet se para se Komiteti i Ministrave të ushtronte presion mbi Republikën e Serbisë që të citojë “dispozitat ligjore të cilat arsyetojnë refuzimin e pagesave për pensione” (Vendimi nr. 4, Mbledhja e 1179 e Komitetit të Ministrave, 26 shtator 2013), duket të mos i ketë shkuar askujt ndërmend se Neni 119 do të mund madje të përdorej si arsye ligjore për të refuzuar pagesat për pensione të qytetarëve të Kosovës. Neni 119 nuk u përmend dikur në Opinionin e Gjykatës Supreme i mbështetur në aktgjykimin *Grudić*. Në të vërtetë, nuk jam në dijeni të ndonjë dokumenti publik të qasshëm, para Raportit Përcjellës të 24 tetorit 2013, në të cilin cilido institucion kompetent i Republikës së Serbisë të ketë tentuar të pretendojë që Neni 119 i Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor do të mund të shërbente si bazë për diskualifikim të qytetarëve të Kosovës nga ushtrimi i të drejtave të tyre për pension.

Një shqyrtim më i hollësishëm i kontekstit ligjor të Nenit 119 shpërfaq përse është tërësisht i pazbatueshëm në situatën e Kosovës. Në përkthimin e përdorur nga Raporti Përcjellës i Republikës së Serbisë, Neni 119 parashikon që “një përfitues i pensionit i cili plotëson kriteret për të marrë dy ose disa pensione në territorin e Republikës së Kosovës mund të përdorë vetëm një nga pensionet e lartpërmendura sipas vendimit të tij/saj.” Siç e pamë më lartë, Serbia argumenton se kjo dispozitë i parandalon qytetarët e Kosovës të marrin në të njëjtën kohë Pensionin Bazik të paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35, e cila bazohet vetëm në moshë dhe pensionin të cilin kanë të drejtë ta marrin sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Serbisë, i cili bazohet në kontributet e bazuara në punë. Shih *id.*, Neni 3 (“Pensioni obligativ dhe sigurimi invalidor është sigurim ku të drejtat, bazuar në punësim, në rast të moshës së shtyerë, aftësisë së kufizuar, vdekjes dhe dëmtimeve trupore duhet të jetë i siguruar”; theks i shtuar).

Por, kur Neni 119 ia ndalon përfituesit ushtrimin e “së drejtës për dy ose disa pensione në Republikën e Serbisë,” kjo nuk përfshin pensionin e parashikuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/35. Në vend të

kësaj, fjalët “dy apo disa pensione” u referohen tri llojeve të pensioneve të përcaktuara në Nenin 18 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, i cili përcakton se “të drejtat pensionale dhe invalidore duhet të jenë detyruese: (1) në rast të moshës së shtyerë – e drejta për të marrë pension të moshës; (2) në rast të paaftësisë – e drejta për të pranuar pension invalidor; (3) në rast të vdekjes . . . e drejta për të marrë pension familjar [.]” Me fjalë të tjera, ajo çka Neni 119 ndalon është që përfituesi të ushtrojë të drejtën e tij/saj për të marrë më shumë se një nga tri llojet e përgjithshme të pensioneve të parapara në ligj.

Kjo është bërë mjaft e qartë nga konteksti ligjor i Nenit 119. Vetëm dy dispozita para Nenit 119 të Ligjit, përcaktohet se: “Në rast se një përfituesi të pensionit familjar nuk i paguhet pension familjar të cilin ai/ajo ka të drejtë ta marrë . . . për shkak se ai/ajo është duke marrë pension të moshës ose invalidor, gjatë asaj periudhe, anëtarëve tjerë bazë të familjes do t’u shpërndahet pensioni familjar në vlerën e përcaktuar sikur që përfituesit e pensionit të mos kishin të drejtë për pension familjar” (Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Neni 117, theks i shtuar). Neni 119 thjesht bën të qartë çka më parë ishte e nënkuptuar në pjesën e Nenit 117 të theksuar më lartë: nëse një përfitues i plotëson kërkesat ligjore për të marrë më shumë se një nga tre pensionet e parapara me ligj (i moshës, invalidor, familjar), ai ose ajo nuk mund të marrë të gjitha pensionet por duhet të zgjedhë njërin nga ato. Por, pensionet e parapara me Rregulloren e UNMIK 2001/35, qartazi, nuk është një nga pensionet e parashikuara në Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Serbisë. Prandaj nuk ka asnjë bazë për të lexuar Nenin 119 të Ligjit në mënyrë që t’i detyron qytetarët e Kosovës të zgjedhin ndërmjet pensioneve të UNMIK-ut dhe pensioneve të cilët ata kanë të drejtë t’i marrin nga SPDIF.

Për këtë arsye Opinioni i vitit 2005 i Gjykatës Supreme të Serbisë, Divizioni Civil, dhe aktgjykimi *Grudić* duke u bazuar në të, nuk i kushtojnë aspak vëmendjen Nenit 119 dhe deklarojnë se “lidhur me situatën në Kosovë, . . . një e drejtë e njohur për pension mund të kufizohet vetëm mbi bazën e Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor” (*Grudić*, §80; theksimi i shtuar). Duke shpërfillur Nenin 110 dhe duke refuzuar 96.1% të aplikimeve nga qytetarët e Kosovës, në bazë të Nenit jorelevant 119, Republika e Serbisë ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me aktgjykimin *Grudić* dhe në mënyrë të kundërligjshme ka ndërhyrë në të drejtën e, potencialisht, mijëra qytetarëve të Kosovës për të gëzuar në mënyrë paqësore posedimet e tyre.

B. Neni 110 i Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nuk i lejon Serbisë të refuzojë aplikimet nga qytetarët e Kosovës me arsyetimin se ata marrin Pensionin Bazik të parashikuar nga rregulloret e UNMIK-ut, sepse marrja e Pensionit Bazik në asnjë mënyrë nuk përbën “ushtrim të së drejtës sipas . . . sigurimit” të garantuar nga Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Serbisë (*id.*, Neni 110).

Meqenëse Neni 110 është dispozita e vetme në bazë të së cilës Serbia mund të kufizojë në mënyrë të ligjshme të drejtat për sigurimin pensional, le të pyesim tani nëse, sipas kësaj dispozite, ekziston ndonjë arsye për refuzimin e aplikimeve nga qytetarët e Kosovës për shkak të marrjes së Pensionit Bazik të garantuar nga UNMIK-u. Siç e pamë më lart, Neni 110 parashikon vetëm dy baza mbi të cilat të drejtat për sigurimin pensional mund të ndërpriten. Së pari, të drejtat për sigurim mund të ndërpriten “nëse ndodh që dikush më nuk i plotëson kushtet origjinale ligjore” për fitimin dhe ushtrimin e këtyre të drejtave (*Grudić*, §26). Marrja e Pensionit Bazik nga UNMIK-u qartazi nuk ndikon në çështjen, “a i plotëson dikush kushtet origjinale ligjore” për fitimin e së drejtës për pension (p.sh., dhënien e kontributeve, vërtetimi i aftësisë së kufizuar, etj.), dhe Republika e Serbisë as nuk pretendon se ndikon në përmbushjen e këtyre kërkesave.

Prandaj, e vetmja bazë në Nenin 110 për refuzimin e aplikimeve nga qytetarët e Kosovë do të ishte paragrafi 2 i kësaj dispozite, i cili përcakton se të drejtat e një përfituesi për sigurim do të ndërpriten nëse ai ose ajo është tashmë “duke ushtruar të drejtat sipas këtij sigurimi me një organizatë të obligueshme për pension dhe sigurim nga një shtet i formuar në territorin e ish-Jugosllavisë” (*id.*, Neni 110, para. 2).

Siç e pamë më lart, Republika e Serbisë ka pretenduar se marrja e Pensionit Bazik sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/35, në ndonjë mënyrë mund të cilësohet si ushtrimi i të drejtave që është fituar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, ose ndërlidhet në ndonjë mënyrë me sigurimin SPDIF. Shih Raportin Përcjellës të Republikës së Serbisë të 20 shtator 2013 (“në përputhje me rregulloret e UNMIK-ut, të gjithë personat që e kanë vendbanimin në këtë territor dhe të paktën 15 vjet sigurimi pensional me Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë kanë të drejtë për pension,” theks i shtuar), si dhe letrën e 20 dhjetor 2012, dërguar nga Republika e Serbisë tek Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ridërguar tek Komiteti i Ministrave (“meqenëse . . . adoptimi i Rregullores nr. 2001/35 – *Për Pensionet në Kosovë* nga UNMIK-u më 22 dhjetor 2001, shumë qytetarë të Kosovës dhe Metohisë, përfitues të dikurshëm të pensioneve të Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë, fituan të drejtën për pension nga administrata ndërkombëtare, duke njohur vitet e punës të kryera me Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë,” theks i shtuar).

Ky pretendimi i Serbisë, që marrja e pensionit sipas Rregullores 2001/35 të UNMIK-ut ndërlidhet në ndonjë mënyrë me të drejtat si kontributdhënës në SPDIF, është qartazi jo i vërtetë. Neni 4.1 i Rregullores në fjalë përcakton qartë që Pensionit Bazik është e drejta e “të gjithë personave që banojnë rregullisht në Kosovë dhe që kanë arritur Moshën e Pensionit.” Aktgjykimi *Grudić* gjithashtu e bën këtë gjë më se të qartë, duke pohuar se Rregullorja parashikon se “të gjithë personat që ‘banojnë rregullisht’ në Kosovë, të moshës 65 e sipër, do të gëzojnë të drejtën për një ‘pension bazik’” (*Grudić*, §39). Prandaj, e drejta për pagimin e pensioneve sipas Rregullores 2001/35 nuk varet në asnjë mënyrë prej kontributeve të dhëna në skemën e sigurimit SPDIF. Në fakt, në gjithë Rregulloren, nuk ka as një përmendje, as edhe një sugjerim, që të drejtat e pensionit sipas Rregullores ndërlidhen me të drejtat si kontributdhënës në SPDIF. Prandaj, mund të konkludojmë që marrja e Pensionit Bazik të UNMIK-ut nuk përbën “ushtrimin e të drejtave sipas . . . sigurimit” të garantuar nga SPDIF. Për këtë arsye, Neni 110 nuk jep asnjë justifikim për refuzimin, nga ana e Serbisë, të 96.1% të aplikimeve nga qytetarët e Kosovës për shkak të marrjes së Pensionit Bazik të parashikuar nga Rregullorja 2001/35. Këta qytetarë ende nuk kanë marrë pagimin e pensioneve që kanë fituar me të drejtë, bazuar në vitet e tyre të shumta të kontributeve në SPDIF. Duke ua mohuar këto pagesa thjesht për shkak se ata kanë marrë Pensionin Bazik të UNMIK-ut, Republika e Serbisë po ndërhyr paligjshmërisht në të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të posedimeve të tyre, në njëjtën mënyrë siç bëri me aplikuesit e rastit *Grudić*.

Megjithatë, për hir të transparencës dhe informim të plotë, do të dëshiroja të vëreja që Republika e Kosovës tanimë ka një ligj në fuqi që, ndryshe nga Rregullorja 2001/35 të UNMIK-ut, në fakt u lejon qytetarëve të Kosovës të përfitojnë nga statusi i tyre si kontributdhënës në SPDIF. Ky ligj, Ligji Nr. 04/L-131 i Republikës së Kosovës për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (“Ligji për Skemat Pensionale”), parashikon që, përveç “Pensionit Bazik të Moshës,” i cili “do të paguhet tek personat që janë qytetarë të përhershëm të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet identifikuese dhe që kanë arritur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65)” (*id.*, Neni 7, par. 1), qytetarët e Kosovës me të drejtat e sigurimit me SPDIF kanë të drejtë për “pensionin kontributpagues të moshës (*id.*, Neni 8, par. 1, nënpar. 2), “pensionin invalidor të punës” (*id.*, Neni 11, par. 1) dhe “pensionin familjar” (*id.*, Neni 12, par. 1-2), në bazë të kontributeve të dhëna në SPDIF në ish-Jugosllavi. Marrja e ndonjërit prej këtyre tri pensioneve

jobazike do të mund të shërbejë si bazë për ndërprerjen e pensioneve prej Republikës së Serbisë sipas kriterëve të Nenit 110, par. 2, të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, sepse marrja e pensioneve jobazike do të mund të konsiderohej në mënyrë legjitime si “ushtrimi i të drejtave sipas sigurimit [SPDIF] me një organizatë të obligueshme të sigurimit pensional dhe invalidor nga një shtet i formuar në territorin e ish-Jugosllavisë.”

Megjithatë, tri pika të rëndësishme duhen theksuar. *Së pari*, nga tri pensionet jobazike të parashikuara nga Ligji për Skemat Pensionale të Republikës së Kosovës, vetëm njëri prej tyre, pensioni kontributpagues i moshës, është aktualisht duke u paguar tek qytetarët e Kosovës. Për dallim, ata qytetarë që kanë të drejtë, sipas ligjit, për pensionin invalidor të punës dhe për pensionin familjar, nuk kanë marrë, as nuk janë duke marrë tani, përfitimet për të cilat kanë të drejtë ligjore. Arsyeja për këtë është e thjeshtë: Republika e Serbisë ende ka në posedimin e vetë të gjitha kontributet e paguara në SPDIF nga qytetarët e Kosovës përpara vitit 1999 dhe ende nuk është pajtuar për t’ia transferuar këto kontribute Republikës së Kosovës. Edhe përfituesit e tanishëm të pensionit kontributdhënës të moshës nuk po paguhën nga ndonjë fond pensional. Në vend të kësaj, ata po paguhën nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës. Shih Ligjin për Skemat Pensionale, Neni 5 (“Mjetet financiare për pagimin e të gjitha pensioneve të parashikuara nga ky Ligj do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës”). Vitet e shumta të kontributeve të paguara nga këta qytetarë përpara vitit 1999 mbeten me SPDIF deri më sot. Ky fakt jo vetëm e bën të pamundur që Republika e Kosovës të paguajë pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare mbi bazën e kontributeve të qytetarëve të Kosovës në SPDIF, por gjithashtu rrezikon qëndrueshmërinë edhe të pensionit kontributpagues të moshës, i vetmi pension që është aktualisht duke u paguar tek përfituesit sipas ligjit.

Sic u përmend më sipër, Republika e Serbisë ka ofruar sugjerimin e dobishëm që çështja e pensioneve të diskutohen në negociatat e vazhdueshme për normalizimin e marrëdhënieve midis Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kosovës. Nëse qëllimi i këtyre negociatave është për të siguruar transferimin e kontributeve të qytetarëve të Kosovës nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës, e mbështes këtë qëllim plotësisht. Por, do të theksoja që çdo përpjekje, gjatë këtyre negociatave, për të zvogëluar të drejtat ligjshëmrisht të fituara për pensione nga qytetarët e Kosovës, do të ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me aktgjykimin *Grudić*. E drejta e qytetarëve të Kosovës për të marrë pensione në bazë të kontributeve të tyre të mëparshme, është tani juridikisht e vendosur sipas aktgjyqimit të Gjykatës. Kjo e drejtë nuk mund të sakrifikohet sipas përlllogaritjeve të negociimit politik.

Së dyti, përderisa refuzimi i aplikimeve prej qytetarëve të Kosovës për rinisjen e pagesës së pensioneve, është bazuar në faktin që të njëjtët kanë marrë Pensionin Bazik, të gjitha këto refuzime duhen rivlerësuar, për arsyen që kemi cituar tashmë: marrja e Pensionit Bazik nga UNMIK nuk jep baza për ndërprerjen e të drejtave për pension sipas Nenit 110 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Serbisë. Në vend të kësaj, në mënyrë që të vlerësojë drejt aplikimet e marra prej qytetarëve të Kosovës, Serbia duhet të sigurojë informacione mbi pensione jo nga UNMIK-u, por nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Republikës së Kosovës. Vetëm kjo e fundit mund të japë të dhëna që tregojnë nëse qytetarët e Kosovës që kanë aplikuar tek SPDIF për rinisjen e pagimit të pensioneve janë tashmë duke marrë pensionin kontributpagues të moshës, sipas Ligjit për Skemat Pensionale të Republikës së Kosovës.

Së treti, edhe në ato raste ku SPDIF refuzon një aplikim për rinisjen e pagimit të pensioneve, për shkak se aplikuesi tashmë është duke marrë pensionin kontributpagues të moshës nga Republika e Kosovës, SPDIF është prapëseprapë i obliguar, sipas aktgjyqimit *Grudić*, për të kompensuar këta aplikues për këste të papaguara deri në datën kur ai ose ajo filloi të merrte pensionin kontributpagues të moshës nga Republika e Kosovës, bashkë me kamatën ligjore. Dështimi i Republikës së Serbisë për të kompensuar plotësisht

qytetarët e Kosovës për këstet e mëparshme të papaguara, përfshirë kamatën ligjore, është një shqetësim serioz. Tek kjo çështje do të kthehemi tani.

C. Duke vendosur një kufizim prej 12 muajsh mbi kompensimin e qytetarëve të Kosovës për këstet e papaguara, Serbia bie në kundërshtim me (1) Aktgjykimin *Grudić*, i cili kërkon që këstet e mëparshme të papaguara të llogariten nga data kur pensionet e përfituesve u ndërprejnë padrejtësisht (*id.*, §92), dhe (2) Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Serbisë, i cili parashikon kufizimin prej 12 muajsh mbi kompensimin e kësteve të papaguara vetëm nëse ndërprerja e pensioneve ishte “shkaktuar nga përfituesi” (*id.*, Neni 123)

Siç kemi parë më sipër, sipas vetë Republikës së Serbisë, ajo ka vendosur një kufizim prej 12 muajsh mbi nivelin e kompensimit që ka paguar për këstet e papaguara tek qytetarët e Kosovës. Shih Raportet Përcjellëse të Republikës së Serbisë të 20 shtatorit 2013 (“Vendimet për rinisjen e pagimit të pensioneve gjithashtu përcakton kompensimin për këstet e mëparshme të papaguara deri 12 muaj më parë”) dhe të 24 tetor 2013 (“Vendimet për rinisjen e pagimit të pensioneve gjithashtu përcaktojnë kompensimin për këstet e mëparshme të papaguara deri 12 muaj më parë, në përputhje me Nenin 123 të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor”). Pastaj, Neni 123 përcakton se “këstet mujore të akumuluar të pensionit, kompensimi monetar për dëmtim trupor, që nuk paguhen për shkak të rrethanave të shkaktuara nga përfituesi, do të paguhen pastaj deri në 12 muaj, me efekt retroaktiv prej datës kur përfituesi, duke mos ekzistuar më rrethanat, parashtron një kërkesë për pagim.”

Ky kufizim prej 12 muajsh mbi kompensimin për këstet e papaguara përbën një shkelje serioze të obligimeve të Republikës së Serbisë sipas *Grudić* dhe është plotësisht pa justifikim edhe sipas Neni 123, në të cilin mbështetet Serbia.

Në rastin e dy aplikuesve në *Grudić*, aktgjykimi i Gjykatës ka urdhëruar shprehimisht që “Qeveria përgjegjëse t’u paguajë aplikuesit të parë dhe të dytë . . . pensionet e tyre duke filluar prej datës 9 qershor dhe 15 janar 2000, përkatësisht . . . , së bashku me kamatën ligjore (*Grudić*, §92, theks i shtuar). Datat e theksuara janë të rëndësishme më të lartë, sepse janë pikërisht datat kur pensionet e dy aplikuesve u ndërprejnë nga SPDIF (shih *Grudić*, §9). Prandaj, aktgjykimi *Grudić* paraqet parimin që ata qytetarë të Kosovës, pensionet e të cilëve u ndërprejnë padrejtësisht, kanë të drejtë jo vetëm për t’u kompensuar për këstet e mëparshme të papaguara për një periudhë prej 12 muajsh, por për tërë periudhën në të cilën pensionet e tyre ishin padrejtësisht të pezulluara. Kjo pikë u cek shprehimisht në shënimet e mbledhjes së Komitetit të Ministrave të mbajtur nga 3–5 dhjetor 2013, në të cilat deklarohet në mënyrë të prerë se “këstet e papaguara midis datës së pezullimit të pagimit të pensioneve në fjalë dhe datës së rinisjes së pagimit, kanë për t’u paguar.” Aktgjykimi i Gjykatës në rastin *Grudić* nuk lejon më pak se kompensimi i plotë për këstet e papaguara, gjatë tërë periudhës së pezullimit të kundërligjshëm, pa vendosjen e kufizimit prej 12 muajsh.

Megjithatë, edhe më e habitshme është fakti se kufizimi prej 12 muajsh i vendosur nga Republika e Serbisë nuk justifikohet as nga dispozita ligjore që vetë Serbia e citon në mbështetje të këtij kufizimi. Gjuha e Neni 123 bën shumë të qartë se kufizimi prej 12 muajsh vendoset vetëm kur pensioni i përfituesit nuk paguhet “për shkak të rrethanave të shkaktuara nga përfituesi.” Në rastin e qytetarëve të Kosovës, si p.sh. aplikuesit në *Grudić*, dështimi për të paguar pensionet nuk ishte “për shkak të rrethanave të shkaktuara nga përfituesi[t].” Përkundrazi, dështimi i pagimit ishte rezultat i drejtpërdrejtë i vendimit të njëanshëm të SPDIF për të pezulluar pensionet, mbi bazat që Gjykata në rastin *Grudić* ka konstatuar të jenë të kundërligjshme. Në rrethanat e tilla, as aktgjykimi *Grudić*, as Neni 123 i Ligjit për Sigurimin

Pensional dhe Invalidor, nuk mund të justifikojë dështimin e Republikës së Serbisë për të kompensuar plotësisht qytetarët e Kosovës për këstet e mëparshme të papaguara.

Raportet Përcjellëse të parashtruara nga Republika e Serbisë sugjerojnë dy dështime të tjera ligjore nga ana e autoriteteve serbe sa i përket kompensimit për këste të papaguara. *Së pari*, këto Raporte janë krejtësisht të heshtura sa i përket pagimit të kamatës ligjore. E drejta për të marrë kamatë mbi këstet e papaguara u theksua në aktgjykimin *Grudić* (see *id.*, §92). Njësoj sikurse u vendos se aplikuesit në atë rast kishin të drejtë për të marrë kamatë ligjore, kamatë e tillë po ashtu duhet t'u paguhet të gjithë aplikuesve të cilët kanë të drejtë kompensimi për këste të mëparshme.

Së dyti, Raportet Përcjellëse të parashtruara nga Republika e Serbisë tregojnë që autoritetet kanë pranuar të japin kompensimin për këste të papaguara vetëm në ato raste ku kanë marrë vendim për rinisjen e pagimit të pensioneve. Mirëpo, me gjasë, ka një numër të konsiderueshëm të aplikuesve që mbase nuk kanë të drejtë për rinisjen e pagimit të pensiomeve, për shkak se janë duke marrë pensionin kontributpagues të moshës prej Republikës së Kosovës, por që prapëseprapë kanë të drejtë për t'u kompensuar për këste të papaguara, përderisa pensionet e tyre ishin ndërprerë padrejtësisht, para se të fillonin të merrnin pensionin kontributpagues të moshës. Këto dy dështime duhet të adresohen nga Republika e Serbisë për të siguruar respektimin e plotë të aktgjykimit *Grudić*.

D. Këmbëngulja e Republikës së Serbisë që “i tërë dokumentacioni që dorëzohet për të dëshmuar të drejtën për pension nga përfituesit potencialë duhet të lëshohet nga UNMIK-u” ka mundësi që po pengon seriozisht zbatimin e aktgjykimit *Grudić*.

Shqetësimi i fundit të cilin dëshiroj ta shpreh ka të bëjë me numrin jashtëzakonisht të lartë të kërkesave për të cilat Republika e Serbisë ka konsideruar se u mungon dokumentacioni i nevojshëm. Në Raportin e saj të fundit përcjellës, Serbia theksoi se nga 8,238 kërkesat e marra deri më tani për rinisjen e pagimit të pensioneve, ka gjykuar se vetëm 1,295 (15.7%) janë të shoqëruara me tërë dokumentacionin e kërkuar. Duke marrë parasysh pretendimet e vazhdueshme të Republikës së Serbisë për bashkëpunim me UNMIK-un mbi çështjen e pensioneve dhe deklaratës së saj se “i tërë dokumentacioni që dorëzohet për të dëshmuar të drejtën për pension nga përfituesit potencialë duhet të lëshohet nga UNMIK-u” sepse “Republika e Serbisë nuk njuh të ashtuquajturat akte të Republikës së Kosovës,” i kam dërguar një letër Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kreut të UNMIK-ut z. Zahir Tanin, më 21 janar 2016, për të marrë sqarim lidhur me nivelin alarmues të refuzimeve të aplikimeve nga qytetarët e Kosovës. Ndër të tjera, kam pyetur UNMIK-un nëse “është në dijeni të çfarëdo dokumenti apo dokumentesh që kërkohen të parashtrohen bashkë me kërkesën për pension, por të cilat qytetarët e Kosovës e kanë vështirë t'i marrin.” Deri më sot, nuk kam marrë përgjigje nga z. Tanin dhe për këtë arsye nuk jam në gjendje të nxjerr konkluzione të sigurta lidhur me arsyet që qëndrojnë pas gjetjeve të Serbisë lidhur me mungesën e shpeshtë të dokumentacionit tek aplikantët prej Kosovës.

Megjithatë, një sqarim i mundshëm për shkallën e lartë të mungesës së dokumentacionit, është fakti që UNMIK-u më nuk lëshon dokumente civile për qytetarët e Kosovës. Kompetenca për lëshimin e dokumenteve është transferuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Ligjin për Dokumentet e Identifikimit Nr.03/L-099, i cili hyri në fuqi më 1 nëntor 2008. Refuzimi i Serbisë për të pranuar çfarëdo dokumenti të lëshuar në Kosovë, përveç atyre të lëshuara nga UNMIK mundet në këtë mënyrë të japë një shpjegim për numrin e lartë të qytetarëve të Kosovës, aplikimet e të cilëve u refuzuan si jo të plota. Prandaj, implementimi i plotë i aktgjykimit *Grudić*—i cili urdhëron pagimin e pensioneve, kësteve të mëparshme të papaguara dhe kamatës ligjore për të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët plotësojnë kushtet

ligjore për të marrë pensione të tilla—mund të kërkojë nga Republika e Serbisë të heq refuzimin e saj kategorik për të pranuar dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës.

PËRFUNDIM

Për arsyet e lartpërmendura, konkludoj me modesti se, në mënyrë që Republika e Serbisë të sillet në përputhje të plotë me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Grudić kundër Serbisë*, autoritetet serbe duhet:

- (1) të rivlerësojnë të gjitha aplikimet e qytetarëve të Kosovës për rinisjen e pagimit të pensioneve, në rastet në të cilat aplikuesit janë refuzuar, për shkak se ata kanë marrë Pensionin Bazik të parashikuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35;
- (2) të shpallin publikisht, për të mirën e qytetarëve të Kosovës të cilët ende nuk kanë aplikuar për rinisjen e pagimit të pensioneve, se fakti që kanë marrë Pensionin Bazik të parashikuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35, më nuk do të konsiderohet si faktor përjashtues;
- (3) të shpallin publikisht se përfituesit aktualë të pensionit kontributpagues të moshës nga Republika e Kosovës, ndonëse nuk do të kualifikoheshin për rinisjen e pagimit të pensioneve nga Republika e Serbisë, prapëseprapë mund të kualifikohen për kompensimin e kësteve të papaguara, përfshirë kamatën ligjore, për periudhën kohore para se ata të fillonin të marrin pension nga Republika e Kosovës;
- (4) të marrin vendime pozitive për rinisjen e pagimit të pensioneve në rast të të gjithë qytetarëve të Kosovës të cilët plotësojnë kriteret origjinale ligjore për të marrë pensione nga Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor (SPDIF) dhe të cilët për momentin nuk po marrin pensionin kontributpagues të moshës nga Republika e Kosovës;
- (5) të paguajnë plotësisht këstet e papaguara, përfshirë edhe kamatën ligjore, për qytetarët e Kosovës pensionet e të cilëve ishin ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme, duke llogaritur kompensimin nga data kur pensionet janë pezulluar deri në datën kur (a) këto pensione nisën të paguhen përsëri nga Republika e Serbisë, ose (b) aplikuesit filluan t'i marrin pensionet kontributpaguese të moshës nga Republika e Kosovës;
- (6) të qartësojnë saktësisht se mungesa e çfarë dokumentacioni është shkaktare për hedhjen poshtë nga Republika e Serbisë e 84.3% të aplikacioneve nga qytetarët e Kosovës si jo të kompletuara dhe, nëse ka nevojë, të pranojnë si të vlefshëm dokumentacionin nga Republika e Kosovës me qëllim që të zbatohet plotësisht aktgjykimi *Grudić*; dhe
- (7) të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për të transferuar në Republikën e Kosovës të gjitha kontributet që janë paguar nga qytetarët e Kosovës para vitit 1999 dhe që kanë mbetur në posedim të SPDIF, si një zgjidhje afatgjatë për të siguruar qëndrueshmërinë e pagimit të pensioneve për qytetarët e Kosovës, të cilët kanë kontribuar në SPDIF, në pajtim me ligj.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT

Opinion nr. 528/2016

Opinion në lidhje me procedurat e ankimimit të vendimeve administrative lidhur me çështjen e njohjes dhe verifikimit të statusit të veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

drejtuar

Qeverisë së Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 6 shtator 2016

BAZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135 (3): “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.

Ligji Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18 (3): “Avokati i Popullit mund të këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Qeverisë së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në territorin e Republikës së Kosovës”.

QËLLIMI

1. Duke marrë parasysh Vendimin nr. 05/90, të datës 1 qershor 2016, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e aplikueshmërisë së ligjeve në fuqi, me theks të veçantë mbi respektimin e procedurës së rregullimit të statusit të veteranit të luftës, ky opinion i Avokatit të Popullit ka për qëllim që:
 - Të tërheq vëmendjen Qeverisë së Republikës së Kosovës se Vendimi 05/90, i datës 1 qershor 2016, nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe, në këtë mënyrë, shkel të drejtat e procedurës së rregullimit të statusit të veteranit të luftës;
 - Të propozojë procedurën ankimore më të përshtatshme për palët e interesuara në rregullimin e statusit të veteranit të luftës, kundër vendimit të nxjerrë nga ana e organit të administratës publike, konkretisht Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin të Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Komisioni).

BAZA LIGJORE E VEPRIMIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

2. Në pajtim me nenin 135 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”. Më tutje, *Lex specialis* mbi punën e Avokatit të Popullit, konkretisht Ligji Nr.05/L-019 (këtu e tutje Ligji për Avokatin e Popullit), parasheh në nenin 18 (3) që është nën përgjegjësinë e të njëjtit të :“këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Qeverisë së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në territorin e Republikës së Kosovës”, dhe 18 1.6 “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”

GJENDJA FAKTIKE

3. Në prill të vitit 2014 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Ligji për Veteranët) i cili parasheh beneficione për veteranë, duke përfshirë e duke mos u kufizuar me: pension, shërbime shëndetësore falas, të drejtën e përparësisë në punësim, drejtën e udhëtimit falas, përkujdesja për banim, stazhi i dyfishtë si dhe përparësia e pranimit në institucionet arsimore publike.
4. Në lidhje me atë që u tha më lart, Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Organizata e Veteranëve) ka kërkuar⁸¹ nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta zbatojë këtë Ligj, duke konsideruar që pas miratimit të të njëjtit, pozita shoqërore dhe ekonomike e veteranëve do duhej të përmirësohej dukshëm.

⁸¹ Portali koha.net: “Veteranët falënderojnë deputetët për Ligjin”, i datës 3 prill 2014.

5. Ligji për Veteranët parasheh Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve, i cili është themeluar në bazë të Ligjit 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (këtu e tutje Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre). Ky Komision ka për mandat njohjen e statusit të veteranit dhe kategorive të tjera. Puna e këtij Komisioni është e rregulluar me Rregulloren Nr.23/2012 për Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Rregullore për Komisionin).
6. Më tutje, Kryesia e Organizatës së Veteranëve, në një nga mbledhjet e saj⁸², ka shqyrtuar edhe çështjen e verifikimit të veteranëve të luftës dhe ka ardhur në përfundim që ka numër të fryrë të veteranëve, si dhe nga ata të cilëve iu është dhënë statusi i veteranit pa bazë, gjë kjo e cila është në kundërshtim me ligjin në fuqi. Në atë drejtim, kjo Organizatë i ka bërë thirrje Prokurorisë së Shtetit, që të bëjë vërtetimin e numrit të saktë të veteranëve.
7. Në lidhje me atë që u theksua më lart, Prokuroria e Shtetit ka dhënë deklaratë⁸³ në bazë të së cilës konkludohet se një çështje e tillë nuk bie në domenin e punës së Prokurorisë së Shtetit, përderisa e njëjta mund të jetë përgjegjëse dhe kompetente vetëm për ndjekjen e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale, si dhe do të kryejë hetime në secilin rast ku ka dyshim të bazuar që është kryer një vepër penale e ku plotësohen kushtet e parapara me ligj.
8. Po ashtu, në lidhje me këtë çështje, është deklaruar⁸⁴ edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (këtu e tutje FMN) I cili ka paralajmëruar Qeverinë e Republikës së Kosovës se vë në rrezik buxhetin e shtetit, me ndarjen e parave për veteranë. Sipas FMN-së, edhe pse janë ndarë 60 milion euro, Qeveria rrezikon të përfshihet në një shpenzim prej 100 milion euro, për të zbatuar obligimet ndaj veteranëve, të përcaktuara me ligj. FMN konsideron që një shpenzim i këtillë i buxhetit nuk duhet bërë ndaj çështjeve jo emergjente.
9. Në fund, por jo edhe nga rëndësia, Qeveria e Republikës së Kosovës, me 1 qershor të vitit 2016, ka nxjerrë Vendimin Nr.05/90, me anë të së cilit ka aprovuar Raportin e Komisionit. Sipas këtij Vendimi, evidenca e prezantuar nga Komisioni në Raportin nga pika 1: *“miratohet si listë e pa përmbyllur e verifikimit të personave të kategorizuar sipas Ligjit për Veteranë”* dhe se lista përfundimtare mbetet të shqyrtohet dhe miratohet në të ardhmen, gjë, kjo, e cila u kundërvihet dispozitave ligjore në fuqi.

KORNIZA LIGJORE

10. Ligji Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe familjeve të tyre) me anë të të cilit rregullohet statusi që përfshin, por nuk kufizohet me veteranë. Po ashtu, fushëveprimi i këtij Ligji shtrihet mbi rregullimin e të drejtave dhe beneficioneve të posaçme për anëtarët e familjeve të veteranëve, si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

⁸² Portali koha.net: “OVL-UÇK-së: Numri i veteranëve i fryrë, Prokuroria t’i nis hetimet”, i datës 8 qershor 2016.

⁸³ Portali koha.net: “Prokuroria e Shtetit: Nuk merremi me pastrim listash të veteranëve, por me hetime”, i datës 28 qershor 2016.

⁸⁴ Portali telegrafi.com: “FMN kritikon ashpër Qeverinë: Për veteranët po e rrezikoni buxhetin”, qershor 2016.

11. Neni 6 i Ligjit të lartpërmendur, taksativisht, numëron beneficionet që u takojnë kategorive të përcaktuara me këtë ligj, *“varësisht nga statusi dhe kriteret e përcaktuara, për shkak të sakrificës sublime dhe kontributit shumë të lartë në luftën çlirimtare të UÇK-së”*. Neni në fjalë, përfshin, por nuk kufizon: shtesa për përkujdesje, rehabilitim mjekësor, shërbimet spitalore jashtë vendit pa kompensim, stazhin e dyfishtë, lirin nga tatimi në pronë, përparësinë e regjistrimit dhe pranimit në institucione arsimore publike si dhe tarifën e liruar dhe reduktimi i harxhimeve të energjisë elektrike për nevoja personale.
12. Neni 12, që rregullon statusin dhe të drejtat e veteranëve të UÇK-së, përcakton se: *“sipas dispozitave të këtij ligji, nga organi përgjegjës i Qeverisë, njihet dhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-së” dhe “Të drejtat në beneficione për veteranët e UÇK-së si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë”*.
13. Neni 15(1) i këtij Ligji rregullon njohjen dhe statusin, duke paraparë si kompetente për këtë çështje: *“Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së apo të internuarit të UÇK-së”*. Më tutje, në paragrafin 8 të po të njëjtit nen, përcaktohet: *“Organizimi i punës, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë, pagesa për angazhimet e anëtarëve, si dhe çështjet tjera të rëndësishme të Komisionit Qeveritar, do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës”*. Në fund, paragrafi 9 i këtij neni, përcakton që: *“Komisioni Qeveritar...().përcakton Listën e personave të kategorive të përcaktuara me këtë ligj”*.
14. Më tutje, neni 19 i këtij Ligji parasheh: *“...drejtpërsëdrejti do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative”*.
15. Në fund, neni 20 i po të njëjtit Ligj parasheh obligimin e Qeverisë që të nxjerr: *“rregulloren për fushëveprimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe përcaktimin e statusit të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së”*.
16. Ligji Nr.04/L-261 për Veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Ligji për Veteranë) në nenin 2, rregullon fushëveprimin e këtij Ligji, duke përcaktuar se: *“me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione për Veteranët e UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave, siç është përcaktuar në nenin 12 paragrafi 2, të Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre”*.
17. Neni 5 i këtij Ligji përcakton që: *“Statusi i të gjitha kategorive të veteranëve të UÇK-së konstatohet nga Komisioni”*.
18. Më tutje, neni 6, në paragrafin 2, rregullon publikimin e listave fillestare, duke përcaktuar që: *“Komisioni bën publike Listat fillestare sipas kategorive përkatëse”*. Listat fillestare mbeshin publike tridhjetë (30) ditë, sipas paragrafit të tretë të këtij neni. *“Personat të cilët për arsye të caktuara nuk kanë pasur mundësi për aplikim për njohjen e statusit të veteranit mund të aplikojnë për njohjen e këtij statusi në bazë të kriterëve të përcaktuara me akt nënligjor të veçantë”*, në bazë të paragrafit 4 të nenit 6.
19. Për më tepër, neni 7 i këtij Ligji, rregullon procedurën ankimore, duke paraparë afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja publike e Listave fillestare, brenda të cilit *“çdo aplikues me prova të reja apo i cili mendon se i është bërë e padrejtë, mund t’i drejtohet Komisionit për rishqyrtimin e ankesës”*. I njëjti afat është i aplikueshëm edhe për: *“çdo qytetar i cili ka të drejtë të paraqesë ankesë”*.

apo fakte lidhur me personat që janë apo që nuk duhet të jenë në Listën fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së”, në bazë të paragrafit të dytë të këtij neni. Në fund, paragrafi 5 i këtij neni parasheh që: “Kundër vendimit të Komisionit pala e pakënaqur ka të drejtë që të iniciojë procedurën në Gjykatën kompetente”.

20. Neni 36 i këtij Ligji parasheh aplikueshmërinë e dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
21. Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje Ligji për Procedurën Administrative) rregullon realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke gjetur zbatim në çdo rast kur një organ publik realizon autoritetin publik, konkretisht (neni 2): *“vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave...”*.
22. Në bazë të nenit 52 (1.5.) të këtij Ligji për Procedurën Administrative, një akt administrativ është i paligjshëm, kur: *“është në kundërshtim me ligjin material”*.
23. Në lidhje me paragrafin më lart, neni 57 i këtij Ligji për Procedurën Administrative parasheh shfuqizimin e një akti administrativ të ligjshëm: *“për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj.”*
24. Në fund, por jo edhe nga rëndësia, neni 98 i këtij Ligji për Procedurën Administrative, parasheh afatin për përfundimin e procedurës administrative, duke theksuar në paragrafin 2, që: *“në rast së ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”,* që është në lidhje me nenin 131 i cili parasheh procedurën e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik, ku sipas paragrafit 4: *“kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të rri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala”*.
25. Bazuar në nenin 144 të këtij Ligji, një akt administrative do të bëhet i ekzekutueshëm me: *“skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar.”*
26. Gjykata kompetente vendos mbi ligjshmërinë e akteve administrative, me të cilat organet kompetente të administratës publike vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik, në bazë të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (këtu e tutje Ligji për Konfliktet Administrative).
27. Përderisa neni 13 i këtij Ligji për Konfliktet Administrative përcakton që: *“konflikti administrative mund të fillojë vetëm kundër aktit administrative të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”,* neni 16 parasheh mundësinë që akti administrativ të kundërshtohet: *“për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore.”*
28. Në bazë të nenit 18: *“paditës në konfliktin adminsitrativ mund të jetë personi fizik, juridik, Avokati i Popullit dhe shoqatat e organizatat tjera që veprojnë në mbrojtje të interesit publik”,* kurse në bazë të nenit 19: *“atëherë kur personi fizik është anëtar i ndonjë organizate joqeveritare, (kjo organizatë mundet (në emër të tij ta paraqesë padinë dhe të zhvillojë konfliktin administrative kundër aktit administrativ”*.
29. Më tutje, Rregullorja për Komisionin Qeveritar me nenin 9 rregullon procedurën e ankesës, duke përcjellë këtu fjalën e ligjit dhe duke caktuar mundësinë e paraqitjes së ankesës: *“një muaj pasi*

Regjistrat bëhen publike”. Për më tepër, rishqyrtimin bën Komisioni i Posaçëm prej tre anëtarësh të Komisionit, të emëruar nga Komisioni, bazuar në paragrafin 4 të këtij neni.

30. Neni 10 i Rregullores për Komisionin Qeveritar parasheh përcaktimin e regjistrave përfundimtarë: *“një muaj pasi Regjistrat bëhen publike”*.
31. Vendimi Nr.05/90 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 1 qershor 2016, aprovon raportin e Komisionit Qeveritar dhe miraton evidencën e prezantuar nga Komisioni si: *“të pa përmbyllur, në lidhje me verifikimin e personave të kategorizuar në bazë të Ligjit 04/L-261 për veteranët e luftës së UÇK-së”*. Për më tepër: *“lista përfundimtare () mbetet të shqyrtohet dhe miratohet në të ardhmen”*.

ANALIZA LIGJORE

32. Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre parasheh beneficinet që do t'i takojnë këtyre kategorive, duke paraparë krijimin e Komisionit Qeveritar kompetencat e të cilit do të pasqyroheshin në përcaktimin e statusit të njëres prej kategorive të përmendura më lart. Në pajtim me nenin 15 të këtij Ligji përcaktohet përbërja e këtij Komisioni Qeveritar, ku, në paragrafin 8, parashihet organizimi i punës së këtij Komisioni Qeveritar me akt nënligjor.
33. Më tutje, Ligji i veçantë për Veteranët, rregullon të drejtat në beneficione të kategorisë specifike, veteranëve të UÇK-së, duke iu referuar ndërmjet tjerash: shtesës në përkujdesje, shërbimit shëndetësor pa pagesë jashtë vendit dhe stazhit të dyfishtë. I njëjti Ligj i referohet punës së Komisionit Qeveritar të paraparë me Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjarëve të tyre. Mund të konkludohet përtej çdo dyshimi që Komisioni Qeveritar është kompetent në përcaktimin e statusit të veteranit të luftës dhe që i njëjti do të veprojë në bazë të aktit nënligjor të nxjerrë nga ana e Qeverisë së Kosovës. Konstatimi i statusit të veteranit nga ana e këtij Komisioni Qeveritar, do t'ia mundësojë përfutjesit të këtij statusi shfrytëzimin e beneficioneve të parapara me dy ligje të lartpërmendura, e në bazë të sakrificës, angazhimit dhe kontributit të çmuar në Luftën Çlirimtare të Kosovës.
34. Në bazë të asaj që u tha më lart, Komisioni Qeveritar vepron si vijon: publikon listat fillestare dhe lejon afatin prej tridhjetë (30) ditësh gjatë së cilit çdo aplikues ka të drejtë ankimi në bazë të provave të reja, apo i cili mendon se i është bërë një e padrejtë, e kjo në bazë të nenit 7 të Ligjit për Veteranë. Në lidhje me këtë, e në bazë të paragrafit 2 të po të njëjtit nen, çdo qytetar ka të drejtë të paraqes ankesë apo fakte lidhur me personat që janë apo nuk duhet të jenë në Listën fillestare, brenda afatit të paraparë prej tridhjetë (30) ditësh.
35. Komisioni Qeveritar, në bazë të Rregullores mbi Komisionin Qeveritar përcakton procedurën ankimore. Kjo Rregullore parasheh afatin prej tridhjetë (30) ditësh brenda të cilit mund të ankohet pala e kënaqur dhe mbi ankesën e së cilës vendos Komisioni i Posaçëm për rishqyrtimin e kërkesës, i përbërë nga tre anëtarë të Komisionit, të emëruar nga Komisioni. Përderisa afati për ushtrimin e ankesës është përcaktuar, Ligji por edhe Rregullorja heshtin kur flitet për afatin kohor brenda së cilit duhet të merret vendimi mbi ankesën e ushtruar. Megjithatë, Ligji për Veteranët, në nenin 36, shprehimisht iu referohet dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, që do të aplikohen, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me dispozita ligjore Në lidhje me këtë, e në bazë të nenit 98 të Ligjit për Procedurën Administrative, në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë afat për përfundimin e procedurës, siç është rasti me Ligjin për Veteranët, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. Duke marrë parasysh faktin që neni 98 i referohet përfundimit të procedurës administrative, duke nënkuptuar nxjerrjen e

vendimit në shkallë të parë, mund të konkludohet që i njëjti rregull vlen edhe për përfundimin e procedurës pas ankesës, pasi që: 1) edhe neni 98 parasheh përfundimin e procedurës sa më shpejtë që është e mundur, pasi që një parim i tillë është në proporcionalitet me mbrojtjen e të drejtave të palëve në procedurë dhe parandalimin e zvarritjes së procedurës dhe 2) kapitulli i Ligjit për Procedurën Administrative, i cili rregullon procedurën ankimore, nuk parasheh rregulla të veçanta mbi afate për përfundimin e procedurës. Në lidhje me këtë që u tha deri tani, mund të vihet në përfundim që Komisioni i Posaçëm për rishqyrtim të ankesave, duhet të nxjerrë listën përfundimtare mbi statusin e veteranëve, brenda periudhës së paraparë me Ligjin për Procedurën Administrative.

36. Duke përcjellë dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative mbi afatet, mund të krijohet përshtypja që dispozitat e nenit 78 janë të aplikueshme në rastin e vendosjes mbi ankesë të Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim të ankesave. Paragrafi 2 i këtij neni thekson që: *“në qoftë se ligji apo akti nënligjor nuk precizojnë një afat të caktuar, afati përcaktohet nga vetë organi publik që kryen procedurën në përputhje me nenin 10”*, nen, i cili, në paragrafin e dytë thekson se: *“organi publik zhvillon procedurën administrative sa më të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative”*. Marrë këtë parasysh, lind nevoja të iu referohet përsëri dispozitave të nenit 98, që rregullon afatet për përfundimin e procedurës siç është shpjeguar në nenin më lart. Duke mos paragjykuar dispozitat e nenit 78, duhet të merret parasysh që neni 98 iu referohet afateve mbi përfundimin e procedurës: *“të inicuar me kërkesë të palës”*. Ushtrimi i ankesës mbi aktin administrativ të nxjerrë nga organi i administratës, mund të konsiderohet kërkesë e përsëritur e palës, përmes së cilës *ri-kërkohet* njohja apo mos njohja e status të veteranit. Atëherë, duhet të konstatohet që dispozitat e aplikueshme në lidhje me afatet mbi përfundimin e procedurës administrative pas ushtrimit të ankesës, janë dispozitat e nenit 98.
37. Duke mos paragjykuar atë që u tha më lart, Rregullorja për Komisionin Qeveritar parasheh të drejtën e ankimit në Gjykatën kompetente, kundër Vendimit të Komisionit të Posaçëm. Bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative, qëllimi i të njëjtit është mbrojtja gjyqësore e të drejtave të personave fizik dhe juridik, interesa këto që janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike. Për më tepër, ky Ligj në nenin 13 parasheh fillimin e konfliktit administrativ kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë dhe në nenin 16 parasheh kundërshtimin e të njëjtit, për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore. Për më tepër, ky Ligj parasheh në rolin e paditësit personin fizik, juridik, por edhe Avokatin e Popullit, duke mos përjashtuar edhe organizatën joqeveritare, brenda së cilës personi fizik është anëtar dhe në interesin e të cilit organizata mund të veprojë, siç do mund të ishte rasti me Organizatën e Veteranëve të luftës së UÇK-së. Duke pasur parasysh këtë e duke mos anashkaluar faktin që caktimi i statusit të veteranit kalon nëpër procedurë administrative me vendim të nxjerrë nga organi i administratës publike, përmes ligjeve të cilat parashohin aplikueshmërinë e dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Administrative, e përmes punës së Komisionit që nxjerr vendim në formë të aktit administrativ që mund të goditet përmes procedurës para gjykatës, konkretisht konfliktit administrativ, mund të thuhet përtej çdo dyshimi që kjo është procedura e duhur për t’u përcjellë nga pala e pakënaqur e interesuar për njohjen e statusit të veteranit të luftës. Kjo edhe për arsye të mundësisë së kundërshtimit të aktit përfundimtar për shkak të mos aplikimit apo aplikimit jo të drejtë të dispozitave ligjore dhe për faktin që konflikti administrative shërben *apriori* për mbrojtjen e interesave që janë cenuar me vendime individuale apo me veprime të organeve të administratës publike.

38. Nisur nga ajo që u tha më lart, këndvështrim i veçantë duhet të vihet mbi Vendimin 05/90 të nxjerrë nga ana e Qeverisë së Kosovës, me 1 qershor 2016, përmes së cilit miratohet evidenca e prezantuar nga Komisioni dhe lista si e pa përmbyllur. Më tutje, i njëjti Vendim, parasheh shqyrtimin dhe miratimin e Listës përfundimtare në të ardhmen. Ky Vendim nuk parasheh dhe nuk përmend afatin tridhjetë (30) ditësh për ushtrimin e ankesës kundër listës iniciale të publikuar. Lista e miratuar në këtë mënyrë, si e “pa përmbyllur” dhe e cila nuk evidenton afatin kohor për ankesë, nxit pasiguri juridike, duke mos garantuar statusin e veteranëve të evidentuar në listë, posaçërisht, duke mos paraparë respektimin e hapave ligjorë që i referohen procesit të ankesës dhe afatit për ushtrimin e të njëjtës. E njëjta vlen edhe për “miratimin e listës përfundimtare në të ardhmen”, e ardhme, kjo, e cila nuk përcaktohet me një afat kohor që automatikisht nxit pasiguri juridike dhe mos respektimin e dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin për Procedurën Administrative, në lidhje me afatet kohore, por edhe në lidhje me parimet e përgjithshme të procedurës, sipas të cilave: “*organi publik duhet zhvilluar procedurë sa më të shpejtë () duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*”.

Në bazë të asaj që u tha më lart, Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 135, par. 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 18, par. 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nxjerr këtë:

OPINION

Është e nevojshme që Qeveria e Republikës së Kosovës është e nevojshme ta rishikojë punën e Komisionit Qeveritar sa i përket dispozitave ligjore përkitazi me respektimin e afateve kohore për ushtrimin e ankesës, publikimin e listave fillestare, por edhe në lidhje me afatet për përfundimin e procedurës administrative pas ankesës, në bazë të analizës së dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative të përshkruar më lart.

Avokati i Popullit e vlerëson të nevojshëm ndryshimin e Rregullores mbi Komisionin Qeveritar sa i përket dispozitave që përcaktojnë afatet kohore për nxjerrjen e vendimeve të Komisionit Qeveritar pas ankesës dhe përcaktimit shprehimor të natyrës së vendimeve të Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim të ankesave (vendosja përmes aktit përfundimtar administrativ), po ashtu edhe

Ndryshimin e Rregullores mbi Komisionin Qeveritar në aspekt të përbërjes së Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim të ankesave, pasi që aktualisht, anëtarët përzgjidhen nga radhët e anëtarëve të Komisionit Qeveritar, që kanë marrë vendimin në shkallë të parë. Me qëllim të sigurimit të pavarësisë në nxjerrjen e vendimeve, sidomos në rregullimin e çështjeve të ndejshme, siç është kjo e rregullimit të statusit të veteranit të luftës, që me vete sjell gëzimin e beneficioneve të përcaktuara me ligj, duhet vepruar në drejtim të ndryshimit të Rregullores mbi Komisionin Qeveritar, në pajtim me përshkrimin e dhënë.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT

Opinion nr. 280/2016

Opinion lidhur me gjendjen e krijuar në hapësirat në zonën e interesit të veçant ekonomik sipas Vendimit nr. 4/119, datë 3 nëntor 2004 dhe Vendimit 02/57, datë 13 mars 2009 të Qeverisë së Kosovës dhe propozimi për ndërmarrjen e masave efektive për zgjidhjen e çështjes

Për:

Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 13 tetor 2016

Historia e shkurtër e çështjes

Qeveria e Kosovës, më 3 nëntor 2004, me Vendimin nr. 4/119, shpalli tokat e fshatit Hade, Sibovc, Leshkoviq dhe Cërna Vodice të komunës së Obiliqit, zonë të interesit të veçantë. Vendimi në nenin II, obligoi Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Kuvendin Komunal të Obiliqit të ndalojë ndërtimet dhe mbindërtimet e reja.

Më 13 mars 2009, Qeveria e Kosovës, lëshoi Vendimin tjetër nr. 02/57, përmes së cilës shpalli zonë të interesit të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" me një sipërfaqe prej 143,254 km² e cila përfshiu zonat kadastrale të Obiliqit, Fushë Kosovës, Vushtrisë dhe Drenasit.

Procesi i zhvendosjes dhe i shpronësimit të disa lagjeve në fshatin Hade, është përcjellur me mungesë të informit, lidhur me procesin, që ka krijuar paqartësi.

Hapësira e dedikuar për zhvendosjen e banorëve e quajtur Hada e Re, asnjëherë nuk është kompletuar me infrastrukturë për banim e cila do të siguronte, dhe garantonte banorëve kushte të dinjitetshme dhe cilsore të banimit.

Ndërtimet e reja, në zonat e interesit vazhduan në fshatin Hade, e po ashtu me hapa të përshpejtuar në Shipitullë, pa u penguar. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, e po ashtu Komuna e Obiliqit, dështuan t'i ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore për kontrollimin dhe ndalimin e ndërtimeve në zonat e interesit.

Lidhur me gjendjen dhe ndikimin në të drejtat e njeriut

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar dhe pranon në vazhdimësi ankesa nga qytetarët që jetojnë në zonën e interesit të veçantë, me pretendim që të drejtat dhe liritë e tyre janë duke u cenuar, pas shpalljes së vendbanimeve të tyre zonë të interesit të veçantë.

Avokati i Popullit, ka hetuar dhe shqyrtuar në vazhdimësi ankesat e qytetarëve lidhur me ndikimin e aktiviteteve të mihjes në të drejtën e tyre për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, në të drejtën e jetës, privatësisë, gëzimit të shtëpisë, të pronës, madje edhe në lirinë e lëvizjes.

Bazuar në hetimet e bëra në terren dhe informatave të tjera, Avokati i Popullit vëren që veprimtaria e mihjes në fshatrat Hade dhe Shipitullë, ka vështirësuar jetën e banorëve. Shpallja e hapësirave zonë të veçantë ka penguar gëzimin e të drejtës së pronës/shtëpisë.

Edhe pse gjendja mjedisore është larg standardeve të dëshirueshme, dhe normat e ndotjes sipas raporteve ekzistuese shpeshherë tejkalojnë kufijtë e lejuar të përcaktuar me legjislacionin vendor, me mundësi të ndikimit negativ në shëndetin e qytetarëve, edhe pse obligim pozitiv i shtetit, zhvendosja, shpronësimi apo lëvizja e popullatës nga ato hapësira, si masë proporcionale dhe efektive për zgjidhjen e çështjes, që nga viti 2004 nuk është kryer.

Përderisa, banorët në vazhdimësi janë ballafaquar, dhe vazhdojnë të ballafaqohen me ndotje të ajrit, të ujit dhe tokës, zhurmë dhe vibrime, nga operimi i makinerisë së rëndë, organet kompetente kanë vazhduar të qëndrojnë në heshtje, të mos përpiqen të gjejnë zgjidhje karshi një situate të paqartë, në të cilën nuk ka përmirësim, gjithnjë me tendencë përkeqësimi.

Përveç, ndikimit negativ në mjedis, moszgjidhja e situatës me masa efektive ka ndikuar negativisht në mirëqenien ekonomike të banorëve. Avokati i Popullit vëren që dështimi i shtetit dhe operatorit për të investuar, apo për të investuar mjaftueshëm, në proporcion me dëmin e shkaktuar në mjedis, dhe në

infrastrukturën e trashëguar brenda hapësirave në fjalë, ka krijuar mjedis jo të sigurt për jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Qytetarët e këtyre hapësirave janë lënë në një situatë Limbo, shteti nuk ka arritur të përmbushë obligimet e tij pozitive të parapara në Kushtetutë dhe ligje, karshi qytetarëve *për të respektuar, të drejtat e tyre, të drejtën për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, të jetës, privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë/pronës etj.*

Baza Kushtetuese dhe ligjore

Avokati i Popullit, Ju sjell në vëmendje bazën kushtetuese dhe vetëm një nga spektri i gjerë i bazës ligjore në Republikën e Kosovës, e cila garanton mjedis tjetër prej atij të krijuar, dhe njëherit obligon shtetin dhe organet kompetente ndërmarrjen e masave për zgjidhjen e gjendjes.

Neni 3 [Barazia para Ligjit], *“Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”.*

Neni 7 [Vlerat] *“1.Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e ../, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë ...”.*

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.*

Neni 25 [E Drejta për Jetën] *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën”.*

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë] *“Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës ...”.*

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] *“1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet. 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente”.*

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin”.*

Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Neni 1, paragrafi 2 2. *“Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.”*

Neni 2, paragrafi 1 *“Ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut përndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm”.*

Ky ligj synon: *“2.1. shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhepërmirësimin e mjedisit të dëmtuar; 2.2. përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut; 2.3. ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtrishme dhe të papërtrishme, si dhe menaxhimin e*

qëndrueshëm të tyre; 2.4. bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtje mjedisit.”

Përfundim

Bazuar në faktet, bazën kushtetuese dhe ligjore të përmendur më lartë, Avokati i Popullit, me qëllim:

1. Që situata e gjatë e paqartësisë dhe pasigurisë, me të cilën janë duke u ballafaquar banorët e zonave në fjalë, ku nuk vërehet përparim dhe përmirësim, por vetëm përkeqësim, të përfundojë;
2. Që t'u shmangemi rreziqeve të mundshme nga rrëshqitjet e dheut, apo aksidentet e ngjajshme mjedisore;
3. Që neglizhenca dhe dështimi i organeve kompetente për kontrollimin e situatës, që nga viti 2004, të përfundojë;
4. Që shteti të bëjë balansimin e interesave në mes të qytetarëve dhe interesave ekonomike; dhe
5. Që shteti t'i përmbush obligimet pozitive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

PROPOZON

1. *Që çështja të propozohet si pikë e rendit të ditës në mbledhjet e radhës të Kuvendit;*
2. *Që ministri i Zhvillimit Ekonomik, dhe u. d. i ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të mbajnë fjalë në seancën parlamentare për hapat që sigurojnë zgjidhjen dhe koha më e afërt kur mund të sigurohen kushtet për fillimin e fazës së parë të zhvendosjes /shpronësimit;*
3. *Që të vendoset data më e afërt, e fundit, kur do të filloj zhvendosja/shpronësimi; dhe*
4. *Që i tërë procesi i zhvendosjes/shpronësimit të bëhet në bazë të prioriteteve dhe legjislacionit në fuqi.*

Me nderime

Avokati i Popullit
Hilmi Jashari

OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT

Opinion nr. 322/2015

Samile Pruthi

kundër

Komunës së Gjakovës

Opinion për qartësimin e procedurave ligjore të cilat Komuna e Gjakovës duhet t'i ndërmerr në drejtim të zgjidhjes së problemeve mjedisore në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë

Për: Znj. Mimoza Kusari-Lila,
Kryetare e Komunës së Gjakovës

Prishtinë, më 14 tetor 2016

Qëllimi i Opinioni Juridik

Qëllim i këtij Opinioni Juridik është qartësimi i procedurave ligjore përkitazi me veprimet që Komuna e Gjakovës duhet ndërmarrë në drejtim të zgjidhjes së problemeve me mjedisin jetësor dhe në qasjen e rrjetit të kanalizimit të qytetit, të banorëve në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë,

Kompetenca e Avokatit të Popullit

Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019 , Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (neni 18, par.1, nënpar.1.2);
- “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 8);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Përshkrimi i çështjes

Avokati i Popullit është njoftuar nëpërmjet ankesës së parashtruar nga znj. Samile Pruthi, se shtëpia e saj dhe afro pesëmbëdhjetë shtëpi të tjera në rrugën “Durgut Vokshi”, në Gjakovë, nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit, dhe se ujërat e zeza dhe ato fekale derdhen në sipërfaqe duke degraduar kështu mjedisin dhe duke rrezikuar banorët e kësaj rruge nga shfaqja e sëmundjeve infektive.

Përmbledhja e fakteve

1. Më 23 qershor 2015, Avokati i Popullit, ka pranuar ankesën e znj. Samile Pruthi, kundër Komunës së Gjakovës, lidhur me moszgjidhjen e problemit të kanalizimit për afro pesëmbëdhjetë familje, në rrugën “Durgut Vokshi” në Gjakovë.
2. Pas hetimeve të zhvilluara, Avokati i Popullit (AP), më 4 mars 2016, publikoi Raportin me Rekomandime, drejtuar Komunës së Gjakovës për ndërmarrjen e masave si në vijim:
 - a. Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me të gjitha autoritetet tjera përgjegjëse, të ndërmarrë masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të kanalizimit për banorët e rrugës “Durgut Vokshi” në Gjakovë;
 - b. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e komunës së Gjakovës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të hulumtuar gjendjen epidemiologjike dhe shëndetësore të banorëve, si dhe shkallën e ndotjes së ambientit. Varësisht nga të gjeturat në terren, të përpiloj raport me shkrim dhe t’i njoftoi banorët dhe institucionet për

gjendjen dhe rreziqet eventuale, si dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të banorëve;

- c. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet e veta ligjore, të fillojë procedurat për hartimin e një plani rregullativ urban për pjesën e rrugës “Durgut Vokshi” në Gjakovë, me të cilin do të përcaktonte infrastrukturën e nevojshme mjedisore për banorët e kësaj pjese, në pajtim me standardet përkatëse si zgjidhje përfundimtare të këtij problemi.
3. Më 13 qershor 2016, Avokati i Popullit u takua me kryetaren e Komunës së Gjakovës, me të cilën diskutoi çështjen e zbatimit të rekomandimeve nga e cila u informua lidhur me vështirësitë e hasura në zbatimin e rekomandimeve.
4. Më 4 korrik 2016, Avokati i Popullit në pajtim me nenin 16, par.11, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ndërmjetësoi mes palëve kontestuese, *Komuna e Gjakovës dhe z. O. H.* me qëllim të arritjes së marrëveshjes për zgjidhjen e çështjes, por z. O.H. ishte i prerë në qëndrimin tij se nuk do të lejonte vendosjen e gypave të kanalizimit në pronën e familjes së tij.

Analiza ligjore e problemit

5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 52, paragrafi 1, shprehimisht përcakton përgjegjësinë e të gjithëve për mjedisin jetësor duke theksuar se: “*Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin*”, kurse paragrafi 2 i këtij neni përcakton detyrimet organeve për të respektuar liritë dhe të drejtat e të tjerëve, duke kërkuar që “*Institucionet e pushtetit publik të angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton*”, prandaj këto dispozita kushtetuese janë parime imperative dhe duhet të respektohen nga të gjitha autoritetet përfshirë këtu edhe komunën e Gjakovës.
6. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në nenin 8, paragrafi 1 përcakton: “*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës, [...]*”. Për qëllimet e Nenet 8, është roli i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për të dhënë vlerësimin, mbi faktin nëse një ndërhyrje në një të drejtë të Konventës është e justifikueshme në bazat e interesit të publikut apo kur vlerësohet nëse një shtet nuk ka bërë mjaftueshëm për të qenë në pajtim me ndonjë detyrim pozitiv që përmban kjo dispozitë. Në përgjithësi, vendbanimi, brenda kuptimit të nenit 8, është vendi ku një person banon, ose ku ky person vendos bazat e veta, e në këtë kuadër, të gjitha vendet e banimit përbëjnë vendbanimin. Megjithatë, në disa rrethana Konventa i kërkon shtetit që të ndërmarrë hapa për t’i siguruar individëve të drejtat e tyre sipas nenit 8, dhe mund të kërkojë që të mbrojë personat nga aktivitetet e individëve të tjerë private që i pengojnë ata të gëzojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre. Sipas Gjykatës, shteti, me qëllim që të përcaktojë nëse ekziston një detyrim pozitiv apo jo, duhet të marrë në konsideratë faktin nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe interesave të individit.
7. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në gjykimin e datës 23 nëntor 1994 në rastin *Lopez Ostra kundër Spanjës*⁸⁵ konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës duke konstatuar se ndotja e ambientit mund të afektojë mirëqenien e individit dhe t’i parandalojë gëzimin e shtëpisë së tij në mënyrë të tillë që të ndikojë negativisht në jetën private dhe familjare. Në analogji me këtë rast mund të cilësohet e tërë lagjja përreth shtëpive të ankueses, të cilët u ekspozohen rreziqeve mjedisore nga kundërmimi i ujërave të zeza të cilat derdhen mbi sipërfaqe të tokës. Po ashtu, banorët janë të rrezikuar nga pickimi i insekteve të cilat janë në kontakt me ujëra të zeza dhe mund të jenë burim i infeksioneve, krejt kjo si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve pozitive të komunës së Gjakovës ndaj qytetarëve të kësaj lagjeje..

⁸⁵ CASE OF LÓPEZ OSTRA v. SPAIN (Application No. 16798/90) paragrafi 51

8. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në nenin 17, përcakton se Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushën e zhvillimit lokal ekonomik, planifikimit urban dhe rural, shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit, zbatimin të rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit dhe mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave dhe shumë kompetenca të tjera.
9. Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-139, neni 1, paragrafi 1 përcakton rregullat dhe kushtet sipas të cilave qeveria ose një komunë mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi. Sipas këtij ligji termi shpronësim nënkupton çdo veprë të një Organi Shpronësues që përfshin marrjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është në zotërim ose pronësi të një personi në një pronë të paluajtshme, krijimin e detyrueshëm të një servituti ose një të drejte tjetër të shfrytëzimit në pronën e paluajtshme. Organi shpronësues, sipas këtij ligji, është i autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve, që nënkupton se shpronësimi duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij të përcaktuara në ligj edhe tek rastet kur qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit. Përfitimi publik nga shpronësimi duhet të jetë më i madh se sa interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga shpronësimi dhe prona e paluajtshme. e cila është objekt i zgjedhur i shpronësimit, të mos jetë i zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues.

Përfundim

Duke u bazuar në të gjeturat e këtij rasti, mund të konstatohet se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që të merret vendim, me të cilin hapësira në fjalë shpallet zonë e interesit publik. Vendimi duhet të merret pasi që në rastin konkret janë shtuar të gjitha mundësitë tjera, ky veprim është i domosdoshëm për një funksionim efikas të komunës, si dhe hyn brenda fushës së kompetencave ekskluzive të komunës. Një vendim i tillë, mund të merret sepse kemi të bëjmë me qëllim të ligjshëm dhe ky qëllim bazohet në Ligjin Nr. për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205, të datës 28 tetor 2010. Sipas këtij ligji *Organi Shpronësues* është i autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve në vijim:

- a. *Shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij të përcaktuara në paragrafët e mëposhtëm;*
- b. *Qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e Shpronësimit;*
- c. *Përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga shpronësimi;*
- d. *Prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues;*
- e. *Organi Shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28 tetor 2010.*

Neni 4, paragrafi 2 i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nr.03/L-139 ,përcakton që Organi Shpronësues i Komunës është kryetari i Komunës, përveç nëse kuvendi komunal i komunës përkatëse, përmes një akti të miratuar në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, cakton një autoritet tjetër publik komunal për të vepruar në cilësinë e Organit Shpronësues të Komunës. Organi Shpronësues i Komunës mund të bëjë shpronësimin e pronës se paluajtshme kur shpronësimi i prek shprehimisht të drejtat private në fushëveprimin e paragrafit 2 të nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme,, kur prona e paluajtshme përkatëse gjendet plotësisht brenda kufijve të Komunës,

kur shpronësimi ndërlihet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë me arritjen e njërit nga qëllimet publike siç përcaktohen në pikat e poshtëshënuara të nenit 4:

2.4.1 Zbatimi i një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Komunal në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;

2.4.3.Ndërtimi ose zgjerimi i një ndërtese ose objekti i cili i do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Komunal për ushtrimin e funksionit të tij publik, apo në ndërtimin, zgjerimin, themelimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve në vijim, nëse kjo është e nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të komunës ose ka një përfitim tjetër të qartë publik për banorët e komunës dhe është në përputhje me kushtet e aplikueshme ligjore siç janë :

2.4.3.1 rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda Komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun; objektet publike të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për sigurimin e shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe/ose të mirëqenies sociale brenda Komunës;

2.4.3.3 gypat që përdoren për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për vendbanimet brenda Komunës, deponitë komunale dhe vendet për deponimin e mbeturinave publike, varrezat publike komunale ose parqet publike komunale dhe objektet publike komunale të sportit [...].

Neni 5 i këtij ligji përcakton që Organi Shpronësues në çdo kohë para inicimit të një procedure të shpronësimit mund të autorizojë kryerjen e punëve përgatitore për përcaktimin e përshtatshmërisë potenciale të një ose më shumë parcelave të pronës së paluajtshme për qëllimin përkatës publik. Komuna apo ministria këtë procedurë e quajnë elaborat, autorizim duhet të përcaktohet në detaje në një vendim me shkrim të Organit Shpronësues. Vendimi duhet të përcaktojë parcelën ose parcelat e pronës së paluajtshme të cilat janë objekt i autorizimit, po ashtu ligji e lejon që punët përgatitore mund të kryhen edhe pa lejen e pronarëve dhe zotëruesve përkatës të interesave. Në këto raste rekomandohet që për të gjitha punët përgatitore dhe gjatë procedurave të shpronësimit, organi shpronësues ta mbaj në dijeni Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit, si dhe të marrë këshilla teknike nga ata, sepse në fazën e mëvonshme komuna ka të drejtë, që për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik për të cilin është shpronësuar prona, të bartë një të drejtë të shfrytëzimit apo administrimit të kësaj prone, te Kompania Rajonale e Ujësjellësit, në rastin konkret të drejtën e mirëmbajtjes së kanalizimit.

Inicimi dhe përfundimi i procedurave të shpronësimit, duhet të bëhet në përputhje me nenin 7, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28 tetor 2010, kurse kërkesa për shpronësim duhet të bëhet në përputhje me nenin 8, të të njëjtit ligj.

Organi Shpronësues duhet të organizojë mbajtjen e dëgjimit publik me qëllim të përfshirjes së publikut në vendimmarrje, në përputhje me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, pasi që çdo vendim i shpronësimit pa përfshirjen e publikut në vendimmarrje mund të përbëjë bazë të mjaftueshme që të atakohet me padi dhe të anulohet nga gjykata (*shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KI 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal te Prizrenit, datë 22 dhjetor 2010*). Avokati i Popullit konstaton se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që Komuna e Gjakovës të ndërmarrë masat ligjore në dispozicion për zgjidhjen e këtij problemi, duke shfrytëzuar autorizimet që dalin nga Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe ligjeve të tjera që e rregullojnë këtë fushë.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT

Opinion nr. 668/2016

Opinion në lidhje me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve, si dhe masat që duhet ndërmarrë institucionet përgjegjëse

drejtuar

- Z. Arban Abrashi, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Z. Arsim Bajrami, Ministër
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Z. Imet Rrahmani, Ministër
Ministria e Shëndetësisë
- Z. Skender Hyseni, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Prishtinë, më 15 nëntor 2016

QËLLIMI I OPINIONIT

Qëllimi i këtij Opinioni është tërheqja e vëmendjes përkitazi me ndikimin negativ të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe rëndësinë e parandalimit të saj, duke e identifikuar, referuar dhe trajtuar me kohë.

BAZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 50, paragrafi 1, përcakton: *“Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre”*; paragrafi 3 përcakton: *“Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi”* dhe paragrafi 4 i këtij neni përcakton: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, (...) duhet të jenë në interesat më të mirë të fëmijës”*.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135 (3): *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*.

Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nën par. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nën par. 6);
- “t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 3).

Gjithashtu, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e fëmijës garanton mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, e cila ka zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në kuadër të punës që bën, në funksion të përmbushjes së misionit dhe mandatit që ka, ka zhvilluar takime të drejtpërdrejta me fëmijë të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, duke ofruar mundësinë e bashkëbisedimit lidhur me shqetësimet e tyre, me të cilat ballafaqohen, jo vetëm brenda ambienteve shkollore, por edhe në familje apo gjetiu.

Shumica e shqetësimeve të shprehura kishte të bënte me dhunën psikologjike, fizike, por edhe ngacmimet seksuale, të cilat IAP i ka hetuar, trajtuar dhe adresuar te institucionet përkatëse.

Gjithashtu, IAP, sipas detyrës zyrtare ka filluar hetimet lidhur me veprimet e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge (fëmijët që kërkojnë lëmoshë, pastrojnë xhamat e veturave, shesin gjësende të ndryshme etj.), të cilët i hasim rrugëve apo edhe lokaleve gjatë orëve të vona të mbrëmjes, e të cilët përballen drejtpërdrejtë me rrezikun për abuzim.

Dhuna, në Kosovë, ashtu siç edhe në mbarë botën, është shqetësuese dhe vazhdon të jetë problematike. Këtë e rëndon pikëpamja e një numri të konsiderueshëm të njerëzve të cilët e shohin dhunën fizike, si mjet për edukimin dhe disiplinimin e fëmijëve. Kjo pikëpamje është pasojë e mendësisë së trashëguar dhe mënyrës se si ata janë rritur dhe edukuar. Aq më tepër është shqetësuese kur vetë fëmijët e pranojnë si të

natyrshme dhunën si mjet disiplinimi dhe edukimi. Këta fëmijë, kanë predispozitën rrethanore që të bëhen abuziv, krahasuar me fëmijët që nuk kanë përjetuar dhunë.

DHUNA NDAJ FËMIJËVE

Dhuna ndaj fëmijëve mund të shfaqet si abuzim fizik, emocional/psikologjik, trajtim neglizhent, shfrytëzim seksual, apo si çdo shfrytëzim tjetër që ka si rezultat dëmtimin e shëndetit të fëmijës.

Abuzimi fizik ndaj fëmijëve përfshinë rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike dhe që mund të rezultojë me lëndime trupore joaksidentale.

Zakonisht, abuzimi fizik ndodh bashk me atë emocional/psikologjik. Kjo formë e abuzimit shkatërron vetëvlerësimin e fëmijëve, dëmton funksionimin fizik, emocional, njohës apo të sjelljes së fëmijës.

Abuzimi psikologjik përfshinë format e të bërtiturit, fajësimin, kërcënimet, trembjen, diskriminimin, talljen, denigrimin, kritikizmin përbuzës, izolimin ose pengimin për t'u shoqëruar me bashkëmoshatarët. Këto forma quhen edhe keqtrajtime psikologjike që përçojnë te fëmijët idenë se ata janë të pavlerë, kanë të meta, janë të shëmtuar, të padëshiruar dhe kërcënues.

Neglizhimi i referohet dështimit të një prindit apo kujdestarit përgjegjës për të siguruar një zhvillim të mirëfilltë të fëmijës. Pra, kur fëmija vuan ndikimin e mungesave apo mangësive të kujdesit që lidhen me nevojat elementare, si ushqimi, strehimi i sigurt, kushtet, kujdesi shëndetësor, edukimi, mungesa e dashurisë.

Si shenja të neglizhimit të fëmijës janë: mungesa në shkollë, vjedhja, vërehet papastërtia e trupit, mungesa e veshmbathjes në përputhje me motin, mungesa e kujdesit dentar, shpesh vërehet edhe te pesha dhe zhvillimi fizik ku nuk janë në përputhje me moshën kalendarike dhe jep për të besuar në mosushqyerje, pastaj angazhimi në punë, bredhja rrugëve, kërkimi i lëmshës, shitja e gjëseneve në rrugë, kafene.

Disa ekspertë tani pretendojnë se abuzimi psikologjik/emocional dhe neglizhimi janë faktorët më të spikatur të rrezikut për shqetësime emocionale afatgjata.

Formë tjetër e dhunës ndaj fëmijëve është edhe “*shfrytëzimi seksual*, e cila nënkupton çdo aktivitet seksual të kryer me një fëmijë nëpërmjet detyrimit, forcës ose kërcënimit, keqpërdorimit të besimit, autoritetit apo ndikimit (duke përfshirë marrëdhëniet e varësisë brenda familjes) ose keqpërdorimit të pozitës së rëndë të fëmijës, sidomos në rastet e paaftësisë mendore ose fizike ose një situatë të varësisë”⁸⁶.

Konventa mbi të drejtat e fëmijës ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që kanë qenë viktimë të keqtrajtimit apo shfrytëzimit seksual.

Ndikimi i dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve

Dhuna ndaj fëmijëve është jashtëzakonisht komplekse dhe me pasoja të rënda psiko-sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. *Këto pasoja mund të vazhdojnë të japin efekte edhe në moshën e rritur*⁸⁷.

Hulumtimet tregojnë se përvojat traumatike të tilla si format e ndryshme të abuzimit në fëmijëri, fëmija si dëshmitar i një krimi të dhunshëm, apo përsëritja e vazhdueshme e dhunës ndaj fëmijëve mund të

⁸⁶Institucioni i Avokatit të Popullit & Save the Children; Raporti: “Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në Kosovë”, Prishtinë 2012

⁸⁷Danese, A. *et al.* (2009) Adverse childhood experiences and adult risk factors for age-related disease: depression, inflammation, and clustering of metabolic risk markers. *Archives of Pediatrics & Adolescent Medicine* **163**, 1135–1143.

transformojë strukturën e trurit në zhvillim (rezultatet e marra kohët e fundit nga studimet e imazheve të trurit), e ndryshojnë balancën kimike, duke e bërë atë më të vështirë për fëmijët që të përqendrohen, të krijojnë kujtime dhe për të ndërtuar marrëdhënie të besueshme, pra i dëmtojnë të gjitha aftësitë e fëmijës për të performuar mirë në shkollë, apo në rrethin social.

Nga literatura kemi shumë konstatime që përshkruajnë efektet negative të dhunës ndaj fëmijëve në zhvillimin e tyre psiko-social, një nga të cilat thotë:

“Keqtrajtimi i fëmijëve mund të rezultojë me stres toksik. Kjo mund të ndikojë trurin dhe të shkaktojë dëmtime kognitive (të njohjes) dhe ndryshime në sjellje. Nga ana tjetër, kjo mund të rezultojë me adoptimin e sjelljeve të rrezikshme për shëndetin, dëmtim të shëndetit mental dhe fizik, arritje të dobëta në mësim dhe perspektivë të dobët për punësim në të ardhmen dhe përkeqëson padrejtësinë sociale. Keqtrajtimi i fëmijëve po ashtu mund t’i kontribuojë dhunës gjatë jetës dhe përcjellja e saj në gjeneratat e njëpasnjëshme. Nëse zgjatet reagimi i stresit toksik, mund të rritet rreziku edhe për sëmundje të zemrës, diabetit, abuzimin me substanca”⁸⁸

Fëmijët e keqtrajtuar janë në rrezik të shtuar për çrregullime psikiatrike si dhe mjekësore⁸⁹.

“Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një rritje dramatike në numrin e raporteve klinike që lidhin abuzimin seksual në fëmijëri me format specifike të psikopatologjisë së të rriturve. Tek të rriturit, si probleme afatgjata dhe afatshkurtra psikosociale të cilat janë vërejtur, janë: Shtrembërimet kognitive (njohëse) të tilla si ndjenja e fajit, turpi, dhe vetë-fajësimi; Çrregullimet e humorit, të tilla si ankthi apo depresioni; Stresi post traumatik; Problemet ndërpersonale, të tilla si izolimi, frika e intimitetit, dhe ri viktimizimi; Sjellje vetë lënduese (tentimeve për vetëvrasje apo vetë-gjymtimi); Abuzimi i substancave; Çrregullim kufitar i personaliteti; “çrregullimet somatoforme”⁹⁰, Çrregullimet e të ngrënit, disa format të psikozës kronike dhe çrregullime të shumta të personalitetit”.⁹¹

Madje edhe në rastet kur nuk zhvillohet një çrregullim i diagnostifikueshëm, ata vuajnë një distres të rëndësishëm si dhe dëmtim në zhvillimin dhe funksionimin kognitiv, social dhe emocional.

Nga përcjellja e fëmijëve me histori të keqtrajtimit është gjetur se shpesh ata kanë arritje edukative më të varfëra, janë të papunë dhe kanë rrezik të shtuar për përfshirje në aktivitetet kriminale⁹².

Lidhur me *pasojat në sjellje*, fëmijët që kanë përjetuar dhunë të vazhdueshme psikologjike, mund të jenë më pak kompetent në ndërveprimet e tyre shoqërore me moshatarët. Për disa fëmijë të abuzuar fizikisht, kjo mund të manifestohet në tërheqjen apo shmangien, ose frikë, zemërim dhe agresivitet. Fëmijët e neglizhuar priren të kenë një mendim të cenuar mbi vetëvlerësimin dhe aftësinë e tyre; janë të paqëndrueshëm, të pandjeshëm emocionalisht; të dhunshëm dhe e shohin botën negativisht.

Egziston një marrëdhënie në mes të viktimizimit të fëmijërisë dhe delikuencës më vonë, ku fëmijët e abuzuar fizikisht dhe të neglizhuar kanë predispozita, dhe janë në rrezik për të kryer veprime delikente.

⁸⁸ Berg, T (Augeo Foundation), Dekker. M; Kooi.C. Tackling violence against children in Europe

⁸⁹ Nanni, V. et al. (2012) Childhood maltreatment predicts unfavorable course of illness and treatment outcome in depression: a meta-analysis. *American journal of psychiatry* 169, 141–151.

⁹⁰ Çrregullimet somatoforme karakterizohen me simptome fizike, për të cilat nuk ka shkaqe fizike të dukshme. Kanë ankesa për dhimbje të mëdha për të cilat nuk ka asnjë shkak të njohur organik.

⁹¹ <http://www.nap.edu/read/2117/chapter/8#224>

⁹² Currie, J. & Widom, C.S. (2010) Long-term consequences of child abuse and neglect on adult economic well-being. *ChildMaltreatment* 15, 111–120.

Nëse fëmija ka përjetuar cilëndo formë të abuzimit, qoftë në mjedisin familjar, në institucione të kujdesit për fëmijë apo në shkollë, dhe nëse nuk ka marrë ndihmën e nevojshme, do të ketë pasoja negative më vonë si i rritur dhe do të jetë e vështirë të tejkalohen pa trajtim adekuat.

Të gjitha këto, këtë dukuri e bëjnë të jetë i shoqëruar me një kosto të lartë personale dhe shoqërore dhe si i tillë parandalimi i saj duhet të kuptohet jo vetëm si përgjegjësi morale por edhe si një synim urgjent për të mirën e shoqërisë.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna mbetet sfidë e shtetit dhe shoqërisë e cila kërkon koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë të profesionistëve nga fushat e mjekësisë, psikologjisë, edukimit, punës sociale, drejtësisë etj.

Duke marrë parasysh këto që u thanë më lartë, Avokati i Popullit e sheh të nevojshme që :

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- *të bëjë fushata të informimit publik për të rritur ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e shoqërisë për pasojat e abuzimit ndaj fëmijëve, si dhe të promovoj në vazhdimësi metoda jo të dhunshme të edukimit dhe disiplinës;*
- *të angazhoj psikologë dhe pedagogë në të gjitha shkollat, për mbështetje dhe ndihmë të fëmijëve;*
- *të krijohen sisteme të përshtatshme për fëmijët, që të mund të raportojnë dhunën dhe të informohen për mekanizmat ku mund t'i drejtojnë ankesat;*
- *të bëhet ngritja e kapaciteteve të punonjësve arsimor, lidhur me pasojat e dhunës ndaj fëmijëve, si dhe rëndësinë e identifikimit dhe referimit me kohë të këtyre rasteve, tek autoritetet përgjegjëse.*

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht Qendrat për Punë Sociale, si dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme :

- *në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me të gjitha autoritetet tjera përgjegjëse, të ndërmarrin veprimet përkatëse për mbrojtjen dhe ndihmën e fëmijëve në nevojë, në veçanti, fëmijëve të cilët punojnë punë që rrezikojnë shëndetin e tyre, fëmijëve që mbledhin gjësende nëpër kontejnerë, fëmijëve që shesin gjësende në rrugë dhe kafene, fëmijëve që kërkojnë lëmshë dhe të cilët mund jenë viktima potenciale të formave të ndryshme të abuzimit.*

Ministria e Shëndetësisë:

- *të zhvillojë programe trajnimi për personelin në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, lidhur me rëndësinë e identifikimit dhe raportimit me kohë të rasteve të abuzimit ndaj fëmijëve, si dhe pasojave ligjore që mund t'i bartin personeli shëndetësor në raste të mos raportimit.*
- *të shtohet numri i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë në Kosovë, meqë të njëjtat janë të pakta në Kosovë. Shërbimet e tilla, duhet të fuqizohen me programe intervenuese për përmbushjen e nevojave zhvillimore, si dhe për identifikimin dhe trajtimin e hershëm të rasteve në rrezik për çrregullime psikiatrike.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e

kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

**IV. AVOKATI I POPULLIT NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS
(AMICUS CURIAE)**

MENDIM JURIDIK I AVOKATIT TË POPULLIT TË KOSOVËS,
NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)

Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Amicus Curiae nr. 2/2016

Menidim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me shkeljen e të drejtës së personave të privuar nga liria për trajtim adekuat mjekësor

Bazuar në nenin 16, paragrafin 9, të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, prandaj më 2 shkurt 2016, mbi bazën e nenit të lartpërmendur jep këtë:

Prishtinë, më 2 shkurt 2016

MENDIM JURIDIK

Lidhur me shkeljen e të drejtës së personave të privuar nga liria për trajtim të duhur mjekësor, të garantuar me nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 43 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve, që përcaktojnë qartë obligimin e shtetit për trajtimin e personave të sëmurë.

Rasti A.nr. 2/2016, Sami Lushtaku, i cili ankohet për mungesë të trajtimit të duhur mjekësor në burg.

ARSYETIM

Në çështjen në fjalë, ankuesi pretendon se ai nuk ka marrë trajtimin ose ekzaminimin e duhur mjekësor, në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 27, shprehimisht përcakton se “Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”.

Në kuptim të dispozitës së nenit 3 të Konventës, se “Askush nuk i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”, Avokati i Popullit rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), përderisa Konventa zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Gjykata thekson se neni 3 i Konventës flet për një ndër vlerat më themelore të një shoqërie demokratike. Ajo ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin ose dënimin çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih Labita kundër Italisë, nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV).

Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 18 janar 2016, në çështjen nr. P938/13, me aktvendim kishte vendosur për të refuzuar kërkesën e palës të ushtruar përmes avokatit për hospitalizim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Në paragrafin e parë të arsyetimit për refuzimin e hospitalizimit gjykatësi kishte theksuar si në vijim:

“Në disa raste të mëparshme Sami Lushtaku i ka përdor vizitat spitalore që t’i shkel kushtet e paraburgimit dhe të takoj persona të tjerë pa kurrfarë mbikëqyrje të zyrtarëve korrektues, për këtë arsye ka qenë e nevojshme që ai të vendoset në Burgun e Sigurisë së Lartë”

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane, në veçanti rasti 39806/05 *Paladi kundër Moldavisë*, ku gjykata unanimisht ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të Konventës Evropiane, Gjykata njëzëri ka konstatuar se ka shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane, në kuptim të nevojës së pakontestueshme të parashtruesit të kërkesës për trajtim konstant mjekësor të specializuar dhe mungesën apo zgjerimin e një asistence të tillë gjatë kohës së paraburgimit të tij.

Andaj, në rastin e z. Lushtaku, kufizimi i të drejtës për trajtim adekuat mjekësor, nuk mund të konsiderohet si masë disiplinore për shkak të tejkalimit ose shkeljeve të rregullave të Shërbimit Korrektues. Për më tepër, është fakt i pakontestueshëm që Burgu i Sigurisë së Lartë, nuk mund të ofrojë shërbimet e kërkuara. Stacionari i këtij burgu ofron shërbime deri në orën 16:00, respektivisht 19:00, por që nuk ka mjek kardiolog por vetëm mjek të përgjithshëm. Edhe ndërsa ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve të tij mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, ai mund të ketë ditur se ishte në rrezik të një emergjence mjekësore në çdo moment, emergjencë me pasoja serioze dhe se nuk kishte ndihmë të kualifikuar mjekësore të disponueshme. Kërkuetit jo vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga autoritetet, por ai u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, kjo mund të ketë çuar në një ankth të konsiderueshëm të tij.

GJEDNJ, rithekson se *“Shteti duhet të garantojë që një person të mbahet në paraburgim në kushte të cilat janë në përputhje me dinjitetin e tij njerëzor, që mënyra dhe metoda e ekzekutimit të masës të mos e bëjnë të paraburgosurin subjekt të ankthit dhe vështirësisë të një intensiteti i cili kalon nivelin e paevitueshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim dhe që duke pasur parasysh kërkesat praktike të burgimit, shëndeti i tij dhe mirëqenia të sigurohen në mënyrë adekuate, ndër të tjera, të paraburgosurit të sigurohet ndihma e duhur mjekësore”*.

GJEDNJ, thekson më tej se, sipas jurisprudencës së saj, keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal ashpërsie për t'u konsideruar se bien në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ky minimum varet nga tërësia e rrethanave të çështjes, efektet e saj fizike dhe mendore, dhe, në disa raste, seksi, moshë, gjendja shëndetësore e viktimës (shih, midis të tjerave, Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 18 janarit 1978, Seritë A nr. 25, f. 65, § 162). Megjithëse qëllimi i një trajtimi të tillë është faktor për t'u marrë parasysh, në veçanti pyetja nëse ai kishte si qëllim të poshtëronte ose të degradonte viktimën, mungesa e një qëllimi të tillë nuk të çon në mënyrë të paevitueshme në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 (shih Peers kundër Greqisë, nr. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III).

Në Aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, në paragrafin pesë të arsytimit gjykata thekson si në vijim:

“Çfarëdo lëshimi i bërë në favor të të akuzuarit për shkak të “grevës së urisë” së tij mund të inkurajojë atë dhe personat e tjerë që të vazhdojnë me veprime të njëjta në mënyrë që ta pengojnë drejtësinë”

[...] Duke iu kthyer çështjes në fjalë, mund të shihet se gjithsesi, neni 3 nuk mund të interpretohet sikur parashikon një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të burgosurve për arsye shëndetësore. Ai, në fakt i vendos detyrimin shtetit të mbrojë mirëqenien fizike të personave të cilëve u është mohuar liria. Gjykata e pranon se ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut jo gjithmonë mund të jetë në të njëjtin nivel si ndihma e ofruar në institucionet më të mira mjekësore për publikun e gjerë. Gjithsesi, shteti duhet të sigurojë se ruhen siç duhet shëndeti dhe mirëqenia e të burgosurve nëpërmjet, ndër të tjerash, ofrimit të ndihmës së nevojshme mjekësore (shih *Kudła kundër Polonisë*). Në *Farbtuhs kundër Letonisë* (nr. 4672/02, § 56, 2 dhjetor 2004), Gjykata theksoi se nëse autoritetet do të kishin vendosur të çonin dhe të mbanin një person të sëmurë rëndë në burg, ata duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për garantimin e kushteve të burgimit që u përkojnë nevojave të veçanta të të burgosurit që vijnë si rezultat i paaftësisë së tij (shih *gjithashtu Paladi kundër Moldavisë*).

Në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit është absolutisht e papërputhshme me burgimin, neni 3 mund të kërkojë nxjerrjen e një personi të tillë në kushte të caktuara (shih Papon kundër Francës (nr. 1) (dec.), nr. 64666/01, ECHR 2001-VI, dhe Priebke kundër Italisë (dec.), nr. 48799/99, 5 prill 2001). Ka tre elemente të veçanta që duhen shqyrtuar në lidhje me përputhshmërinë e shëndetit të kërkuarit me qëndrimin e tij në burgim: (a) kushtet mjekësore të burgosurit, (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim dhe (c) këshillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të kërkuarit (shih Mouisel kundër Francës, nr. 67263/01, §§ 40-42, ECHR 2002-IX).

Avokati i Popullit, konsideron, po ashtu se vuajtja e shkaktuar të dënuarit, me mos lejim për trajtim sipas rekomandimit të mjekëve, përben trajtim çnjerëzor dhe degradues. Ashtu si edhe në rastin Tekin Yıldız kundër Turqisë, par. 48-53, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 3 të Konventës. Gjykata konstatoi në veçanti se gjendja shëndetësore e parashtruesit të kërkesës nuk është e kompatibile me paraburgimin [...] pa marrë parasysh mos ndryshimin e kushteve, nuk mund të konsiderohen se kanë vepruar në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 3. Vuajtja e cila iu shkaktua parashtruesit të kërkesës, [...] Gjykata po ashtu konstatoi se shkelja e nenit 3 të Konventës do të ndodhte edhe nëse parashtruesi i kërkesës do të kthehej në burg pa përmirësim domethënës të gjendjes së tij mjekësore.

Ashtu, si dhe në rastin Serifis kundër Greqisë, ku Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, duke vënë në dukje në mënyrë të veçantë se ishte e qartë nga shkresat e lëndës se pa marrë parasysh seriozitetin e sëmundjes nga e cila vuante parashtruesi i kërkesës, autoritetet greke kanë zvarritur

çështjen e ofrimit për parashtruesin e kërkesës të një forme të asistencës mjekësore gjatë mbajtjes së tij në paraburgim e cila do të mund të korrespondonte me nevojat e tij aktuale. Gjykata konsideroi se mënyra se si autoritetet e trajtuan gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës gjatë dy viteve të para të burgosjes së tij e kanë bërë atë subjekt të ankthit apo vështirësisë të një intensiteti i cili tejkalon nivelin e paevitueshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim. Në rastin e z. Lushtaku, Avokati i Popullit, konsideron se Burgu i Sigurisë së Lartë, nuk mund të ofrojë kushte për trajtimin e tij dhe vendosja e të dënuarit në spital publik ose në institucion shëndetësor ku mund të ofrohen shërbimet e nevojshme, është e domosdoshme.

Avokati i Popullit, nga hetimet e rastit të z. Lushtaku, vëren që nuk është respektuar mendimi i tre mjekëve, të fushës, kardiolog që i dënuari ka nevojë për hospitalizim, për ekzaminim të mëtejshëm, pasi që Burgu i Sigurisë së Lartë, nuk mund të ofrojë shërbimet e kërkuara. Stacionari i këtij burgu ofron shërbime deri në orën 16:00, respektivisht 19:00, por që nuk ka mjek kardiolog por vetëm mjek të përgjithshëm.

Avokati i Popullit është informuar nga drejtori i burgut por edhe nga i dënuari se është kryer një ekspertizë mjekësore nga mjek ndërkombëtar, me datë 16 dhjetor 2015, i cili ekspert i angazhuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, është paguar nga buxheti i Kosovës, por që rezultati i asaj ekspertize nuk është bërë asnjëherë i ditur për autoritetet e burgut dhe as për Drejtorinë e Shëndetësisë së Shërbimit Korrektues.

Në rastin tonë, për të realizuar të drejtën e trajtimit të duhur mjekësor, ankuesi ka hyrë në grevë urie dhe ka qëndruar në grevë nga data 14 janar deri më 25 janar 2016. Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, meqë gjykata përkundër rekomandimit të tre mjekëve për ekzaminim të mëtejshëm, ka marrë vendim me të cilin i është refuzuar të dënuarit hospitalizimi në institucion publik shëndetësor apo të burgut, i cili ofron kushtet për trajtim specialistik të domosdoshëm. Gjykata duhet të ketë parasysh për të vepruar në pajtim me parimet kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi duke i shqiptuar një masë proporcionale.

Gjithashtu, mos njoftimi i të dënuarit me rezultatin e ekspertizës nga ekspertë ndërkombëtarë, përben shkelje të nenit 3 të Kartës së të Drejtës së Pacientit, pasi pala asnjëherë nuk është njoftuar me rezultatet e ekspertizës së kryer me 16 dhjetor 2015. Andaj, veprimet e ndërmarra nga ana e gjykatës janë në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane, Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe Kartën e Pacientit.

KONKLUDIM

Mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e nenit 3. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

ANEX I

Faktet, të cilat deri tani kanë mund të vërtetohen, bazohen në Raportin kronologjik shëndetësor, të pranuar nga Stacionari i BSL; Njoftimi i Klinikës së Kardiologjisë, QKUK, drejtuar BSL, që z. Lushtaku është shtrirë në këtë repart nga data 11 janar 2016, me diagnozën Angina pectoris instabilis; Urdhëri i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të datës 13 janar 2016; Fletëlëshimin e Klinikës së Kardiologjisë, të datës 13 janar 2016, pas marrjes së z. Lushtaku, nga spitali; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të datës 18 janar 2016; Raportin e mjekëve të BSL, të datës 20 janar 2016, se gjendja e pacientit është e rëndë dhe atij i duhet përkujdesje mjekësore 24 orë; si dhe informatat e tjera që Avokati i Popullit i pati në dispozicion, mund të paraqiten si më poshtë:

- Më 23 shtator 2015, z. Lushtaku është pranuar në BSL, i cili është transferuar nga QK e Dubravës. Në anamnezë të pranimit shihet, se ai vuan nga sëmundja kronike *Angina pectoris* dhe është shënuar se “*pacienti është shtrirë në njësinë koronare ku i është bërë zgjerimi i aortës (nuk*

saktësohet koha se kur është bërë ky intervenim)". Peshë trupore (PT) 106 kg, Tensioni Arterial (TA) 130/85;

- Më 28 shtator 2015, nga Raporti i mjekëve të BSL, Jeton Shala dhe Salih Tovërlani, mund të shihet se, me kërkesë të pacientit, ai është vizituar nga mjeku i spitalit të burgut, për shkak të ankesave në frymëmarrje sidomos gjatë natës. Nuk ordinohej terapi;
- Më 29 shtator 2015, pacienti sërisht ka kërkuar vizitë mjekësore, për shkak të ankesave, shtrëngim në gjoks, frymëmarrje e vështirësuar dhe pacienti urgjentisht dërgohet në QKUK;
- Më 1 tetor 2015, pacienti ankohet në stenokardi me therje në drejtim të krahut të majtë dhe nofull, dërgohet urgjentisht te kardiologu në QKUK, rekomandohet ndërprerja e pirjes së duhanit;
- Më 2 tetor 2015, dyshohet në anksozilitet (dhimbje anksoze);
- Më 3 tetor 2015, ora 00:05, pacienti ka dhimbje gjoksi, djersitje, frymëmarrje e vështirësuar dhe urgjentisht dërgohet në QKUK, ordinohej terapi;
- Më 5 tetor 2015, në dokumentacion përshkruhet gjendja e datës 3 tetor 2015, të gjeturat te pacienti, si dhe ordinimi i terapisë dhe rekomandimet për tretman të mëtutjeshëm mjekësor. Gjendja përshkruhet me krizë hipertensive (tensioni i lartë), EKG-ja në rregull, ordinohej terapi dhe kërkohen analiza shtesë. Kërkohet t'i matet TA çdo ditë në BSL;
- Më 6 tetor 2015, raportohet për gjendjen e pacientit: tensioni jostabil, ankesa në dhembje të syve dhe të tjera, analizat nuk janë kryer akoma dhe nuk kanë filluar me terapinë e kardiologut sipas rekomandimit të tij;
- Më 7 tetor 2015, pacienti udhëzohet në QKUK për vizitë kontrolluese specialiste i pajisur me analiza sipas kërkesës së kardiologut;
- Më 8 tetor 2015, raportohet për tension të lartë dhe rritje e sheqerit. Rekomandohet matja e tensionit dy herë në ditë dhe sheqerit, në mëngjes dhe pas shujtës në ora 15:00, për dhjetë ditë rresht;
- Më 11 tetor 2015, pacienti refuzon vizitën sistematike;
- Më 15 tetor 2015, pacienti është i skuqur në fytyrë, i shqetësuar, pengesa në frymëmarrje, dhe përkundër refuzimit të tij ai rekomandohet të dërgohet te kardiologu me ç'rast edhe ordinohej terapi;
- Më 2 nëntor 2015, gjatë vizitës mjekësore pacienti shpreh shqetësimin e tij për gjendjen shëndetësore dhe kërkon të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të kardiologut, në të kundërtën paralajmëron se do të hyj në grevë urie;
- Më 16 nëntor 2015, mjeku realizon vizitën sistematike, pacienti refuzon matjen e tensionit;
- Më 17 nëntor 2015, pacientit i lejohej të posedoj preparatin për dhëmbë Pepermint, pasi kishte probleme me dhëmbë;
- Më 19 nëntor 2015, pacienti ankohet në dhimbje gjoksi (Angina Pectoris) dhe shtypje e lartë e gjakut, ordinohej terapi dhe përshkruhet se *"për të dhënë mendim për mjekim hospitalor duhet mendimi i kolegjiut Kardiologjik dhe drejtorit të Kardiologjisë"*.
- Më 21 nëntor 2015, pacienti vizitohet në pavijonin nr.2 dhe ordinohej terapi pasi kishte fituar dystorsion të nyjës së majtë të këmbës (përdredhje e nyjës);
- Më 23 nëntor 2015, raportohet lidhur me dystorsionin dhe rekomandimin e terapisë nga Reparti i Emergjencës dhe për nevojën e kontrollit nga Ortopedi;

- Më 24 nëntor 2015, raportohet se pacienti ka çrregullime anksiolitike, rekomandohet terapi. Po ashtu, raportohet për probleme me dhëmbë dhe stomatologu rekomandon vizitë dhe rtg në klinikë;
- Më 1 dhjetor 2015, mjeku i spitalit rekomandon vizitë te ortopedi;
- Më 4 dhjetor 2015, realizohet vizita te ortopedi, pacientit i heqet gipsi dhe rekomandohen terapi fizikale. Ditën e njëjtë vizitohet nga Fiziatri dhe rekomandohen terapi fizikale e përditshme në repart. Ditën e njëjtë nga vizita kardiologjike shihet se kardiologu dr. Imri Jashari ka rekomanduar që pacienti të shtrihet në Klinikën e Kardiologjisë dhe të bëhet diferencimi diagnostik i pacientit. Raportohet për Angina Pectoris dhe Hipertension Arterial;
- Më 7 dhjetor 2015, pacienti udhëzohet në repartin e Kardiologjisë dhe Terapisë Fizikale, sipas rekomandimeve të mjekëve specialist të fushave përkatëse;
- Më 9 dhjetor 2015, pacienti ankohet në dhimbje të padurueshme të këmbës dhe kufizim i lëvizjes. Po ashtu, ankesa në shtrëngime gjoksi dhe mpirje të dorës së majtë. Mjeku i burgut rekomandon që sa më parë të vizitohet nga kardiologu si dhe të fillohet me terapi fizikale;
- Më 10 dhjetor 2015, pacienti ka çrregullime anksioze, ordinoher terapi. Këmbe edematoze dhe me dhimbje në palpim, vendosen fasha elastike;
- Më 15 dhjetor 2015, vizitë sistematike, pesha 102 kg, tensioni 110/75, puls 63. Përshkruhet çrregullim anksioz, ipet psikoterapi. Po ashtu, raportohet për lodhje, plogështi, pamje të turbullt dhe dehidrim, ordinoher infuzione me vitamina;
- Më 23 dhjetor 2015, pacienti ankohet në dhembje gjoksi, frymëzënie, marramendje, tension jostabil. Rekomandohet vizitë te kardiologu;
- Më 24 dhjetor 2015, raportohet për frymëzënie, ankth, shqetësim, ordinoher terapi;
- Më 29 dhjetor 2015, përshkruhet gjendja e njëjtë me shqetësime të njëjta;
- Më 30 dhjetor 2015, raportohet për Cephalea (dhembje koke), pacienti dërgohet në QKUK për caktim të dioptrisë;
- Më 11 janar 2016, pacienti ankohet në dhembje të forta gjoksi me plogështi, frymëzënie dhe djersitje me ç' rast dërgohet urgjentisht në Repartin e Kardiologjisë në QKUK dhe hospitalizohet për ekzaminim të mëtutjeshëm;
- Më 12 janar 2016, u.d. i shefit të njësisë Koronare z. Kelmend Pallaska e njofton me shkresë (09/01, datë 12 janar 2016) drejtorin e BSL se: *“pacienti Sami Lushtaku është duke u mjekuar në Njësinë Koronare të Klinikës së Kardiologjisë në Prishtinë. Gjatë vizitës së mëngjesit konstatohet se i sëmurit është në gjendje stabile ndonëse gjatë natës ka patur dhimbje gjoksi dhe gjendja duhet të përcillet edhe më tej. Gjatë ditëve në vijim duhet të realizohen procedurat e parapara diagnostike që ngërthejnë; rtg.pulmo et cor,C-Th në dy drejtime, testi ergometrin, ekokardiografia, angiografia koronare dhe eventualisht angio CT e enëve koronare. Realizimi i këtyre procedurave, në kushte të funksionimit adekuat të aparaturave përkatëse, mund të realizohet deri në fund të javës së ardhshme”*.
- Më 12 janar 2016, nga Kl. e Kardiologjisë – Nj. Koronare, njoftohet Drejtoria e BSL (shkresa nr. protokollit 183), ku thuhet: *“Të nderuar ju informojmë se pacienti Sami Lushtaku është i shtrirë në Kl. e Kardiologjisë Nj. Koronare nga 11.01.2016 me Dg. Angina pectoris instabilis”*. Nënshkruar dhe vulosur nga Drejtori, Prof. assoc. Gani Bajraktari, Internist-Kardiolog, (Ko-02645-01-57), Shefi i repartit, Ass. dr. Kelmend Pallaska, Internist - Kardiolog (Ko-00220-61-04) dhe Mjeku i dhomës, Dr. Nexhmi Zeqiri, dr. sci., Specialist i sëmundjeve profesionale – Internist - Kardiolog (Ko-00359-01-04);
- Më 13 janar 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë, (P 938/13), lëshon Urdhër me të cilin, urdhërohet, *“1.Shërbimi Korrektues i Kosovës që ta shoqërojë Sami Lushtakun në Qendrën Klinike*

Universitare të Kosovës (QKUK) për kompletimin e testeve mjekësore, ekzaminimeve dhe trajtimin në pajtim me rekomandimin e U.D i Shefit të Njësisë Koronare të QKUK-së, Dr. Kelmend Pallaska, të datës 12 janar 2016, e shpjeguar nga ai si vijon: rtg.pulmo et cor, C-Th në dy drejtime, testi ergometrin, ekokardiografia, angiografia koronare dhe eventualisht angio CT të enëve koronare.

2. Çdo ditë pas përfundimit të testeve dhe ekzaminimeve mjekësore, i pandehuri Sami Lushtaku duhet të përcillet menjëherë për në qendrën e paraburgimit (Burgu i Sigurisë së Lartë – Gërdoc).

3. Policia e Kosovës URDHËROHET që bashkë me Shërbimin Korrektues të jenë të pranishëm në QKUK gjersa i pandehuri Sami Lushtaku është duke u trajtuar dhe të sigurojnë se nuk është bërë asnjë kontakt me askënd, përveç se me njësinë mjekësore të QKUK-së. Lidhur me këtë, Shërbimi Korrektues urdhërohet t’ia komunikojë Policisë së Kosovës kohën e nisjes dhe kohën e përafërt të mbërritjes në QKUK. Dhe 4. Me këtë urdhërohet QKUK që rezultatet e testeve mjekësore dhe ekzaminimeve pasi të jenë kompletuar të gjitha t’i dorëzojë në gjykatë brenda 3 ditë pune”.

- Më 13 janar 2016, Klinika e Kardiologjisë e QKUK-së lëshon fletëlëshim (Nr i protokollit:183) ku në përfundim thuhet se: *“Pacienti është marrë nga ana e policisë së EULEX-it pa pëlqimin e mjekut kujdestar në ora 17:00. Rekomandojmë që pacienti të jetë nën përcjellje të mjekut 24 orë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Kontroll në çdo kohë te kardiologu në rast nevojë.”*
- Më 14 janar 2016, mjekët e BSL rekomandojnë që pacienti të udhëzohet në QKUK, apo në ndonjë qendër tjetër shëndetësore sipas raportit mjekësor të cilët kërkojnë që pacienti të jetë në observim të kardiologut 24 orë pandërprerë;
- Më 14 janar 2016, drejtorja e BSL njoftohet se që nga mëngjesi pacienti fillon grevën e urisë, me pretendimin se atij nuk po i lejohet trajtimi shëndetësor nën mbikëqyrjen e kardiologut. Pacienti refuzon ta nënshkruaj dokumentin *“Forma e marrëveshjes - greva e urisë”*. Gjendja përshkruhet: Peshë 100,4 kg, Tensioni 100/80, pulsi 80, pacienti refuzon ushqimin por jo ujin. Staf i mjekësor e përcjell gjendjen e tij dhe mban evidencë të posaçme të quajtur *Protokolli i njoftimit ditor për grevën e urisë*;
- Më 15 janar 2016, nga dokumentacioni shihet se pacienti refuzon ushqimin, jo ujin, përcaktimi për ta vazhduar grevën i lartë, tensioni:100/80, pulsi:80, peshë: 100.4 kg, mukoza: lehtësisht e zbehur, gjendja momentale: i orientuar në kohë dhe hapësirë, konkluzioni: gjendja e mirë, tensioni i ulët, këshillohet ta ndërpresë grevën dhe njoftohet me rreziqet shëndetësore që mund t’ia sjell greva;
- Më 16 janar 2016, nga dokumentacioni shihet se pacienti refuzon ushqimin, jo ujin, përcaktimi për ta vazhduar grevën i lartë, tensioni:100/70, pulsi:85, peshë: 99.2 kg, mukoza lehtësisht e zbehur, gjendja momentale: i orientuar në kohë dhe hapësirë me ankesa në humbje të forcës, konkluzioni: gjendja e mirë, tensioni i ulët, këshillohet ta ndërpresë grevën;
- Më 17 janar 2016, nga dokumentacioni shihet se pacienti refuzon ushqimin, jo ujin, përcaktimi për ta vazhduar grevën: i lartë, tensioni:105/70, pulsi:75, peshë: 98.6 kg, mukoza: e zbehur, gjendja momentale: i orientuar në kohë dhe hapësirë, nuk ka të shkruar konkluzion nga mjeku;
- Më 18 janar 2016, nga dokumentacioni shihet se pacienti refuzon ushqimin, jo ujin, përcaktimi për ta vazhduar grevën i lartë, tensioni:110/70, pulsi:70, peshë: 98.1 kg, mukoza e zbehur, gjendja momentale: e ngarkuar psikologjike, konkluzioni: kokëdhimbje, plogështi, marramendje dhe pacienti duket i shqetësuar; Mjekët e BSL raportojnë me shkrim drejtorit të BSL lidhur me gjendjen e pacientit (Ref. raporti i MSH/DSHB, nr.48/2015, datë 18 janar 2016). Raportohet se gjendja e pacientit është përkeqësuar dhe i është rekomanduar ta ndërpresë grevën;
- Më 18 janar 2016, Gjykata Themelore e Mitrovicës, lëshon Aktvendim, me të cilin vendos se: 1. *”Me anë të së cilit peticioni për të të hospitalizuar Sami Lushtakun në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) i datës 18 janar 2016 REFUZOHET.* 2. *Çdo ditë, pas përfundimit të testeve dhe ekzaminimeve mjekësore, I pandehuri Sami Lushtaku duhet që menjëherë të shoqërohet prapa në qendrën e paraburgimit (Burgu I Sigurisë së Lartë - Gërdoc) siç theksohet në urdhrin e kryetarit të trupit gjykues të datës 13 janar 2016”.* Arsyetimi i këtij aktvendimi ishte, se: *“*

në disa raste të mëparshme Sami Lushtaku i ka përdorur vizitat spitalore që t'i shkelë kushtet e paraburgimit dhe të takojë persona të tjerë pa kurrfarë mbikëqyrje të zyrtarëve korrektues. Për këtë arsye ka qenë e nevojshme që ai të vendoset në Burgun e Sigurisë së Lartë”.

- Më 19 janar 2016, nga dokumentacioni shihet se pacienti refuzon ushqimin, jo ujin, përcaktimi për ta vazhduar grevën i lartë, tensioni: 110/75, pulsi: 75, pesha: 96.6 kg, mukoza e zbehur, gjendja momentale: e ngarkuar në funksion psikologjik, konkluzioni: kokëdhimbje, plogështi, dhembje gastrike dhe ankesa në funksionimin renal;
- Më 20 janar 2016, nga dokumentacioni shihet se pacienti refuzon ushqimin, jo ujin, përcaktimi për ta vazhduar grevën i lartë, tensioni: 90/60, pulsi: 70, pesha: 96 kg, mukoza: e zbehur, gjendja momentale: nuk është përshkruar konkluzioni: Paraqitet gjendje e përkeqësuar shëndetësore, pacienti manifeston plogështi, pagjumësi, humbje të fuqisë, dhembje koke, dhembje gastrike dhe ankesa të natyrës renale. Gjatë vizitës konstatohet, se ka humbje të koncentrimit dhe komunikim i ngadalësuar;
- Ditën e njëjtë mjekët e BSL raportojnë me shkrim drejtorit të BSL lidhur me gjendjen e pacientit (Ref. Raporti i MSH/DSHB, nr.48/2015, datë 20 janar 2016). Raportohet se gjendja e pacientit është e rëndë dhe atij i duhet përkujdesje mjekësore 24 orë, prandaj pasi ky institucion nuk mund të ofrojë një shërbim të tillë rekomandojnë që ky pacient të transferohet urgjentisht në ndonjë institucion shëndetësorë ku mund t'i ofrohet mbikëqyrje e mjekut 24 orë;
- Më 20 janar 2016, ekip i IAP-së ka biseduar me z. Sami Lushtaku, mjekët dhe stafin tjetër mjekësor dhe e vizitoi objektin e Stacionarit në BSL, me ç'rast u njoftua hollësisht lidhur me gjendjen e pacientit dhe kushtet të cilat i ofron Stacionari. Nga biseda me z. Lushtaku, shihet qartë se gjendja e tij shëndetësore ishte e rëndë si pasojë e dehidrimit të organizmit dhe gjatë komunikimit atij i ngjitej gjuha, kishte një të folur semisomnolente dhe shihej se organizmi i tij ishte i rraskapitur. Sa i përket kushteve që ofron Stacionari, shihej qartë se aty mund të ofrohen shërbime shëndetësore të përgjithshme mjekësore deri në ora 16:00 – 19:00, kurse pas kësaj kohe aty nuk ka mjek, por vetëm infermier. Stacionarit i mungonte laboranti (edhe pse kishte laborator), kishte pajisjet për intubime endotracheale, pajisje për ventilim mekanik (frymëmarrje artificiale), aparate për frymëmarrje mekanike dhe personeli i specializuar për këto pajisje, të cilat i posedojnë të gjitha Spitalet Rajonale në Republikën e Kosovës.
- Gjithashtu, ekipi i IAP u njoftua se z. Lushtaku, më 16 dhjetor 2015, i ishte bërë edhe një super – ekspertizë, nga mjekë ndërkombëtar, ndërkaq rezultati nuk është bërë i ditur për autoritetet e burgut dhe as për z. Lushtaku.

Me nderime,

Hilmi Jashar
Avokat i Popullit

Prishtinë, 8 shkurt 2016

Z. Sahit Sylejmani, kryetar
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
Pallati i Drejtësisë, Hajvali
10000 Prishtinë

Amicus Curiae nr. 440/2015

Asim Rexhepi

kundër

Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

**Mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me trajtimin e lëndës C-III-13/0514 nga
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme**

I nderuari z. Sylejmani,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 26 gusht 2015, ka pranuar ankesën e z. Asim Rexhepi, kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Ankuesi pohon se ai ka paraqitur padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) kundër KBI “Kosova Export” nga Fushë Kosova e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Numri i rastit në DHPGJS është C-III-13/0514 dhe nga informatat që Avokati i Popullit i ka pranuar nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit, më 18 dhjetor 2015, DHPGJS akoma nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me rastin.

Rasti ka të bëjë me privatizimin e pronës, e cila nga pronarët është marrë në vitin 1963 për themelimin e ndërmarrjes shoqërore. Në vitin 1997, ankuesi kishte iniciuar procedurat për kthimin e pronës dhe se sipas ankuesit gjykata ka vendosur për kthimin e pronës pronarëve por për shkak të rrethanave të atëhershme, ankuesi nuk e kishte pranuar vendimin e gjykatës.

Duke marrë parasysh kompleksitetin juridik të çështjes dhe duke marrë parasysh faktin që sipas informatave që Avokati i Popullit posedon, aktualisht është një rast i ngjashëm që pritet të vendoset nga Gjykata Kushtetuese (KI 76/2015), Avokati i Popullit rekomandon që DHPGJS-ja, të pezullojë përkohësisht shqyrtimin gjyqësor të lëndës C-III-13/0514, deri në vendosjen lidhur me lëndën KI 76/2015 në Gjykatën Kushtetuese, ngase ekzistojnë dyshime të bazuara që mund shkaktohen dëme të pariparueshme për palën.

Në pajtim me nenet 18.4, 18.6 dhe 25 pika 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, si dhe nenin 132, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ju lutem që përgjigjen tuaj, përkitazi me këtë çështje ta dërgoni në një afat të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më 19 shkurt 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Amicus Curiae nr. 406/ 2016, Nazmi Abazi dhe të tjerët

Gjykatës së Apelit në Prishtinë

Mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës lidhur me aktgjykimet e gjykatave për çështje të njëjta, por me përfundime të ndryshme

Në përputhje me Nenin 16, paragrafin 9 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Prishtinë, 16 shtator 2016

Fushëveprimi i rezymesë

Kjo *amicus curiae* (në tekstin e mëtejshëm: Rezyme) do të përqendrohet në sigurinë ligjore si parim themelor i sundimit të Ligjit, me fokus në aktgjykimet gjyqësore të lëshuara nga gjykatat në çështjet e gjykuara. Për më tepër, kjo Rezyme do të përqendrohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNJ) në lidhje me shkeljen e Nenit 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), të drejtën në gjykim të drejtë, në mënyrë që të vihet në pah sesi shkeljet e lartcekura pasqyrohen në sigurinë ligjore dhe besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor. Kjo Rezyme përfshin por nuk kufizohet vetëm në gjykimet vijuese: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 486/11 të 27 shkurtit 2015; dhe Aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 1522/10 të 2 nëntorit 2015.

Baza Ligjore për veprimin e Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës

1. Neni 132, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës autorizon Avokatin e Popullit të: *“mbikëqyr dhe mbron të drejtat e dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”*
2. Neni 16 i Ligjit për Ombudspersonin në paragrafin 4 parasheh që: *“Avokati i Popullit ka kompetenca të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio) nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me Rezyme ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat e liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe me akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.*
3. Për më tepër, vlen të ceket edhe paragrafi 8 i po këtij Neni 16, ku, pa prejjudikuar pavarësinë e gjykatësve, parashihet që: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.*
4. Në fund, nga sa u tha më lartë, duhet t’i kushtohet vëmendje edhe paragrafit 9 të Nenit 16, i cili autorizon: *Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.*
5. Pavarësisht dispozitave më lartë, duhet të merret parasysh që, me Nenin 18, paragrafi 1.1, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet në eliminimin e tyre”,* dhe, sipas paragrafit 1.2 të po këtij Neni: *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshëm të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla;*

Përmbledhje e fakteve

6. Më 6 korrik 2016, Avokati i Popullit incioi rastin bazuar në parashtrimin e palës, z. Nazmi Abazi dhe të tjerët, të cilët janë ankuar në aktgjykimet e lëshuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe të cilët shtjellonin të njëjtën çështje ligjore, por që dallohen në rezultatin e tyre. Këto aktgjykime janë si në vijim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës: C.nr. 486/11 të 27 shkurtit, 2015 dhe Aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prishtinës: C.nr. 1522/10 të 2 nëntorit, 2015.

Argumentet

7. Parimi i sigurisë juridike mishërohet në mënyrë taksative në Nenin 6 të KEDNj-së, gjegjësisht të drejtën në gjykim të drejtë. Ashtu siç argumentohet në *Brumarescu v Romania*, GjEDNj konstatoi se *“një prej elementeve themelore të sudnimit të ligjit është parimi i marrëdhënieve ligjore, i cili, ndër*

*të tjera, parashih që vendimi përfundimtar i lëshuar nga gjykatat të mos vihet sërish në pikëpyetje*⁹³.

8. Nga sa u tha më lartë dhe bazuar në gjendjen faktike të listuar, mund të arrihet në përfundim të lehtë se të gjitha rastet e cekura përfaqësojnë shkelje të Nenit 6 të KEDNj, gjegjësisht shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Zgjidhjet përfundimtare, konkretisht aktgjykimet përfundimtare sërish janë vënë në pikëpyetje, për të njëjtën çështje, ndërmjet palëve të ndryshme por me interes të njëjtë juridik. Është e qartë që nga fillimi se parimi i sigurisë ligjore vihet në pikëpyetje dhe, në këtë aspekt, edhe të drejtën e pakontestueshme në gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar e të gjithë qytetarëve të Kosovës me Kushtetutën e tyre.
9. Kur citohet Kushtetuta në kontestin e mbrojtjes së të drejtave të garantuara nga intsturmentet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, iu referohemi në veçanti Nenit 21, paragrafi 1: *“të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”*, Nenit 22, sipas të cilit: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”*, përfshirë Nenin 31, paragrafin 2, posaçërisht të aplikueshëm në këtë rast, sipas të cilit: *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngritët kundër tij/saj brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
10. Konstatohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se, duke vënë në pikëpyetje një aktgjykim me lëshimin e një aktgjykimi të ndryshëm për të njëjtën çështje, gjykatësi vë në pikëpyetje çështjen e sigurisë juridike dhe të drejtën e paraparë me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të paraparë me të. Në këtë aspekt, në mënyrë që të shpjgohet se në ç’ mënyrë është kërcënuar siguria juridike nga aktgjykimet e lartcekura, me synim të parandalimit të shkeljeve të tjera të Nenit 6 të KEDNj-së dhe pa ndërhyrë në pavarësinë e gjykatësve, kjo Rezyme do të përqendrohet si në vijim:
 - a) *Strukturën e Nenit 6 si një "gjymtyrë qytetare";*
 - b) *Të drejtën e kontestimit të vendimit përfundimtar;*
 - c) *Arsyetimin e vendimeve përfundimtare dhe*
 - d) *Shpalljen e vendimeve përfundimtare ligjore.*

Analiza ligjore

11. Neni 6 i KEDNj-së qartazi thotë që: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm...”*. Kështu, KEDNj aplikoi Nenin 6 në të gjitha çështjet e parashtruara para gjykatës, si ato civile ashtu edhe ato penale. Përkundër këtij fakti, është me rëndësi të theksohet se çështja civile varet, në rend të parë, nga ekzistimi i “kontestit”. Ashtu siç përcaktohet me *Alaverdyan v. Armenia*, neni 6 nuk vlen për procedurën jashtë-kontestimore dhe të njëanshme, e cila nuk ka palë kundërshtuese dhe e cila është në dispozicion vetëm kur nuk ka kontest rreth të drejtave. Në shtjellimin e definicionit të “kontestit”, GjEDNj konstatoi në *Bentham v. Holandë* se *“rezultati i procedurës duhet të jetë drejtpërdrejtë vendimtar për të drejtën në fjalë”*. Në fund, në *Konig v. Gjermania*, GjEDNj përcaktoi se: *“Nëse një e drejtë mund të konsiderohet si civile apo jo në kontekstin e Konventës përcaktohet duke shtjelluar materien përmbajtësore dhe efektet e të drejtës dhe jo klasifikimin e saj në ligjet vendore të Shtetit në fjalë. Në ushtrimin e funksionit të saj mbikëqyrës, Gjykata gjithashtu merr parasysh objektin dhe qëllimin e Konventës si dhe sistemet ligjore kombëtare të Shteteve të tjera Kontraktuese”*. Duke pasur parasysh këtë, qartazi Aktgjykimimi C.nr.486/11 dhe C.nr.1522/10 e cila merret me ligjin e punës, biejnë në kuadër të *“rastit civil”* dhe i

⁹³ Ion Predescu, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe Marieta Safta, Asistente e Kryegjykatësit; *Parimi i Sigurisë Juridike, baza e sundimit të ligjit, jurisprudence elementare*; fq. 25, gjendet në: www.ccr.ro/ccrold/publications/buletin/8/predescuen/pdf

përmbushin kërkesat e termit “kontest”. Për më tepër, ato prekin edhe statusin e punësimit të përhershëm dhe të drejtave të garantuara të punonjësve me Marrëveshjen Kolektive. Në këtë aspekt, të dy rastet biejnë në kuadër të Nenit 6 të KEDNj, konkretisht përkufizimit të rastit civil, e drejtë kjo e garantuar nga e drejta e mbrojtur në “grykim të drejtë”.

12. Ashtu si u tha më lartë, e drejta në grykim të drejtë gjithnjë interpretohet nga prizmi i sundimit të ligjit. Duke pasur parasysh se një aspekt shumë i rëndësishëm i sundimit të ligjit është siguria juridike duhet t’u referohemi rasteve të Brumarescu v. Rumania dhe Agrokompleks v. Ukraina, ku: “kur grykatat më në fund të kenë përcaktuar një çështje, vendimi i tyre nuk do të duhet të vihej në pikëpyetje”. Për më tepër, Grykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës konstatoi në Vendimin e saj mbi mos-përmbarimin e Aktgrykimit të Grykatës Kushtetuese të datës 17 dhjetor 2010 në Lëndën nr.KI 08/09 se: “sundimi i ligjit është një prej parimeve elementare të shoqërisë civile dhe presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, në veçanti në raport me vendimet gryqësore të cilat bëhen res judicata”, për të vazhduar më tutje, përfshirë: “Po të mos ishte kështu, rrezimi i vendimeve përfundimtare do të rezultonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë ligjore, uljen e besimit publik në sistemin gryqësor dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Prandaj, autoritetet kompetente kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem të përmbarimit të vendimeve i cili është efektiv si në ligj ashtu edhe në praktikë, dhe siguron përmbarimin e tyre pa vonesë”, duke cituar Pecevi v. Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Martinovska v ish Republikën e Maqedonisë. Për më tepër, sistemet gryqësore të karakterizuara nga aktgrykimet përfundimtare të cilat iu nënshtrohen shqyrtimit të pafund dhe rrezikojnë që vazhdimisht të shpërfillen, janë në kundërshtim me Nenin 6 të KEDNj-së.⁹⁴ Në fund, sipas Tregubenko v. Ukraina: “Vënia në pikëpyetje e vendimit për këtë çështje nuk është e pranueshme, qoftë nga grykatësit apo nga pjesëtarët e ekzekutivit”. Aktgrykimet C.nr.485/11 dhe C.nr.1522/10, përmes të cilëve një gryqtar vuri në pikëpyetje aktgrykimin e parë përmes këtij të dytit, duke krijuar kështu pasiguri ligjore, përbën shkelje të Nenit 6, dhe Grykatës duhet t’i bëhet me dije kjo çështje.
13. Arsyetimi i aktgrykimit përbën një pikë kthese të këtij rasti dhe të kësaj Parashprese, në kuadër të saj. Si në C.nr.486/11 ashtu edhe në C.nr. 1522/10, gryqtari jep arsyetim të ndryshëm për të njëjtën çështje ligjore. Padyshim që një shembull i këtillë i kontribuon mosbesimit të qytetarëve në sistemin gryqësor, i cili është në kundërshtim me synimin e përafrimit të sistemit juridik me qytetarët, duke inkurajuar dhe nxitur besim në gryqësor të drejtë, të pavarur dhe efikas. Duhet të mbajmë në mend pavarësinë e gryqtarit për të vendosur mbi meritat e rastit dhe interpretimit të ligjeve në fuqi. Me të thënë këtë, duhet gjithashtu të kemi parasysh se: “edhe pse grykata vendore ka një margjinë për vlerësim gjatë përzgjedhjes së argumenteve dhe pranimit të provave, ajo obligohet të arsyetohet veprimet e saj duke dhënë arsyetim për vendimet e saj”, ashtu siç mishërohet në Suomenen v. Finlanda. Për më tepër, me të pranuar faktin se gryqtarët kanë dhënë arsyetim, duhet gjithashtu të pranohet faktin se, ashtu siç përcaktohet me H. v. Belgjikës: “Garancat e mishëruara në Nenin 6 përfshijnë obligimin e grykatave që të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre”. Për më tepër, grykatat obligohet të ekzaminojnë, ashtu siç parshihet me Buzescu v. Romanisë dhe Donadze v. Gjorgjisë, “argumentet kryesore të palëve në kontest si dhe lutjet lidhur me të drejtat dhe liritë elementare të garantuara me Konventë dhe protokollin e saj”, të cilat grykatat vendore duhet t’i shqyrtojnë me rreptësi dhe kujdes të veçantë.⁹⁵
14. Gjithashtu, mund të konkludojmë se arsyetimi i aktgrykimit është thelbi i këtij vendimi përfundimtar dhe prandaj duhet të përmbajë elementet e lartcekura, duke i kushtuar në veçanti vëmendje shkeljes së të drejtave të garantuara të njeriut dhe “natyrën përfundimtare” të vendimit, i cili vihet në pikëpyetje vetëm nga grykata e instancës më të lartë. Në rastet e lartcekura, në veçanti C.nr. 486/11 dhe C.nr.1522/10, grykatësi ka dhënë dy arsyeime të ndryshme lidhur me të njëjtën gjendje faktike,

⁹⁴ Ion Predescu, Gryqtar i Grykatës Kushtetuese dhe Marieta, Asistente e Kryegrykatësit: *Parimi i sigurisë juridike, baza për sundimin e ligjit, jurisprudencë elementare*; fq 25, gendet në: www.ccr.ro/ccrold/publications/buletin/8/predescuen/pdf

⁹⁵ Ion Predescu, Gryqtar i Grykatës Kushtetuese dhe Marieta, Asistente e Kryegrykatësit: *Parimi i sigurisë juridike, baza për sundimin e ligjit, jurisprudencë elementare*; fq 45, gendet në: www.ccr.ro/ccrold/publications/buletin/8/predescuen/pdf

në kuadër të dy aktgjykimeve të ndryshme. Me sa u tha më lartë, dhe me qëllim të parandalimit të pasigurisë ligjore, gjykatës duhet t'i bëhet me dije kjo çështje dhe shkelja e Nenit 6, duke pasur parasysh vendimet gjyqësore në raport me vendimet përfundimtare gjyqësore, të cilat nuk mund të vihen në pikëpyetje.

15. Në fund, duhet t'i kushtohet vëmendje publikimit të vendimeve përfundimtare të gjykatave. Kur kemi parasysh se parandalimi i pasigurisë ligjore i kontribuon rritjes së besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor, avancimit të sundimit të ligjit dhe ndalesës së shkeljeve të të drejtave të njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare dhe Kushtetutë, duhet gjithnjë të mendojmë mbi domosdoshmërinë e bërjes publike të aktgjykimeve përfundimtare. Në këtë aspekt, është me rëndësi të theksohet Neni 2 i Ligjit nr. 05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, ku: *“Gjykatat publikojnë aktgjykimet përfundimtare në ueb faqen e tyre zyrtare, përbrenda afatit kohor prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita kur vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje ligjin në fuqi dhe rregullat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli), duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale”*. Po, kjo dispozitë nuk përfshin aktgjykimet e lëshuara në instancën e parë, prandaj Neni i cituar, në këtë rast, nuk nënkupton këtë. Pavarësisht kësaj, qëllimi i këtij paragrafi është të rrisë vetëdijen e Gjykatës së Apelit lidhur me obligimin e publikimit të aktgjykimeve përfundimtare, dhe kështu të përmbush obligimin e paraparë me ligjet në fuqi dhe t'i kontribuojë kështu parandalimit të pasigurisë ligjore. Me të thënë këtë, Gjykata gjithashtu duhet t'i kushtojë vëmendje Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me anonimizimin e aktgjykimeve përfundimtare.

Nga sa u tha më lart, Avokati i Popullit nxjerr këtë:

K O N K L U D I M

Me lëshimin e aktgjykimeve të ndryshme për të njëjtën çështje, përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në vënien në pikëpyetje të aktgjykimeve paraprake me dhënien e arsytimit të ndryshëm në aktgjykimin e dytë, gjykatat shkelin nenin 6, “E drejta në gjykim të drejtë”, të garantuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Për të parandaluar përsëritjen e kësaj gjendje dhe me synim të shmangies së pasigurisë së mëtejme juridike, duhet t'i kushtohet vëmendje praktikës së GjEDNj-së, e cila në rast të konfliktit është më meritorë se korniza vendore ligjore dhe e cila përcakton se garancat e parapara me Nenin 6 përfshijnë obligimin për gjykata që të japin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre dhe se aktgjykimet përfundimtare nuk mund të vihen në pikëpyetje nga aktgjykimet e tjera. Në fund, duhet t'i kushtohet rëndësi obligimit të gjykatave për të publikuar vendimet përfundimtare, të cilat ndikojnë në sigurinë ligjore.

Me nderime,

Hilmi Jashar
Avokat i Popullit

V. KËRKESAT PËR MASË TË PËRKOHSHME

Prishtinë, më 29 shtator 2016

Znj. Dhurata Hoxha, ministre
Ministria e Drejtësisë
Ndërtesa e ish Rilindje
10000 Prishtinë

Ankesa nr.568/2016 dhe nr. 569/2016

Kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për aplikimin e Masës së Përkohshme në zbatimin e vendimit me të cilin ish-in rikthyer në vuajtje të dënimit të gjithë personat që ishin në trajtim mjekësor jashtë ambienteve të burgut

E nderuara znj. Hoxha,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim (MKP) të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, i themeluar nga Avokati i Popullit sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 05/L-019, për Avokatin e Popullit, në kuadër të përgjegjësive ligjore, me datë 26 shtator 2016, ka realizuar vizitë në Qendrën Korrektuese (QK) në Dubravë, në pajtim me obligimet ligjore që burojnë nga paragrafi 2 i nenit 17 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit i cili përcakton : *“Në kuadër të përgjegjësive si MKP, Avokati i Popullit është i obliguar që të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”*. Gjatë kësaj vizite MKP ka qëndruar në Spitalin e Burgut të QK, me ç’rast ka takuar persona në vuajtje të dënimit, të moshave mbi 85 vjeç, të palëvizshëm, pa përkujdesje shëndetësore, me rrobe të lagura nga urina dhe fecesi, në shtretër pa çarçafë dhe batanije, nën ethe dhe të ftohtë, kurse stafi dhe të gjithë personat e tjerë të këtij objekti ishin të ekspozuar kundërmimit të rëndë të erës së urinës dhe fecesit që ndihej në të dy katet e objektit.

Gjatë kësaj kohe MKP kishte takuar personat përgjegjës të spitalit dhe kishte kuptuar se këta të burgosur ishin jashtë QK për më shumë se tri vite (*sepse u ishte pezulluar dënimi, duke marrë parasysh moshën e tyre dhe natyrën e sëmundjes*), por sipas tyre ata ishin rikthyer në vuajtje të dënimit në bazë të një vendimi të marrë para pak kohe nga Ministria e Drejtësisë. Ata e njoftuan MKP-në se rikthimi i këtyre personave në spital e ka bërë të pamundshëm trajtimin meritator të tyre. Pasi që spitali nuk u ofron as kushtet minimale në raport me nevojat e tyre, sidomos kur kemi parasysh faktin se disa nga ata gjinden në stadin terminal (*në ditët e fundit të jetës së tyre*), kurse disa të tjerë janë të moshuar (*mbi 85 vjeç*), të pandjeshëm në kryerjen e nevojave fiziologjike (*incontinentio alvi et urinae*) të paralizuar (*hemiparesis*) me gjendje pas gjakderdhjes në tru dhe sëmundje tjera (*st. post ICV, atrophia cerebri, car hypertofium etj*).

Lidhur me çështjen e lartshënuar, Avokati i Popullit është duke zhvilluar hetime, prandaj kërkon që të gjithë personat me gjendjen shëndetësore të lartshënuar të të dërgohen urgjentisht për trajtim shëndetësor nëpër institucionet e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (të nivelit dytësor ose tretësor), konform nevojave shëndetësore, në mënyrë që t’u mundësohet trajtimi shëndetësor adekuat.

Ky rekomandim për aplikimin e Masës së Përkohshme bazohet në paragrafin 5, të nenit 18, të Ligjit Nr.05/L-019, për Avokatin e Popullit i cili përcakton : *“Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit”*.

Nga ajo që u tha më lartë, shihet se kriteri substancial për rekomandimin e një pezullimi të tillë është përmbushur qartazi në këtë rast, për shkak se pamundësia e ofrimit të kujdesit të nevojshëm shëndetësor nga autoritetet përgjegjëse mund të konsiderohet si *shkelje e dinjitetit të njeriut, shkelje e të drejtës për jetën, mosrespektim i normave për ndalimit të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, shkelje e të drejtës shëndetësore si dhe mosrespektim të detyrimeve pozitive, të drejta këto të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës.*

Avokati i Popullit kërkon që masa e përkohshme të mbetet në fuqi derisa të përfundohet hetimi lidhur me këtë çështje dhe të publikohet Raporti me Rekomandime konkrete për masat që duhen ndërmarrë autoritet përgjegjëse.

Në pajtim me nenet 18.4, dhe 25, pika 1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, si dhe nenin 132, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ju lutem të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni, si përgjigje ndaj rekomandimit për masë të përkohshme, brenda një afati të arsyeshëm kohor por jo më vonë se deri më 12 tetor 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Imet Rrahmani, ministër, Ministria e Shëndetësisë

Prishtinë, më 29 janar 2016

George Karagutoff
Drejtor i përgjithshëm
Kompania kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a. (KEDS j.s.c)
Bulevardi Bill Klinton nr. 3
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Ankesa nr. 6/2016

Kërkesë drejtuar KEDS-it për aplikimin e Masës së Përkohshme në lidhje me kontrollet brenda pronave private të qytetarëve

I nderuar z. Karagutoff,

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019, ka pranuar ankesa të ndara lidhur me aktivitetet e KEDS-it për kontrollimin e pajisjeve elektrike nëpër banesa, shtëpi dhe hapësira private. Në bazë të pretendimeve të ankuesve, punëtorët e KEDS-it i kryejnë këto kontrolle pa autorizim nga organet kompetente përkatëse dhe se këto kontrolle kryhen në mënyrë kolektive nëpër lagje të caktuara.

Lidhur me këtë ju drejtohem, me rekomandim që të pezulloni aktivitetet e KEDS-it në kontrollimin e banesave, shtëpive dhe hapësirave private të cilat besohet se KEDS-i është duke i ndërmarrë. Ky rekomandim bazohet në nenin 18, para. 5, të Ligjit për Avokatin e Popullit, i cili përcakton se: *“Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.”*

Kriteri substancial për rekomandimin e një pezullimi të tillë është përmbushur qartazi në këtë rast, për shkak se kontrolli i paautorizuar i banesës mund të shkaktojë shkelje të së drejtës në privatësi dhe shkelje të së drejtës së pronës, të dyja këto të drejta të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë

drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutem që të na informoni për veprimet që do të ndërmerreni, si përgjigje ndaj rekomandimit për masë të përkohshme.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

CC: Z. Blerand Stavileci, ministër
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Enver Halimi, Kryesues i Bordit
Zyra e Rregullatorit për Energji
Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12
Prishtinë 1000, Kosovë

**VI. LETËR REKOMANDIMET DREJTUAR AUTORITETEVE
PËRGJEGJËSE**

Prishtinë, më 8 mars 2016

Z. Arsim Bajrami, Ministër
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Rr. "Agim Ramadani", p.n.
10000 Prishtinë

Ankesa nr. 33/2016

Mimoza Telaku
kundër
Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Letër rekomandim

I nderuari z. Bajrami,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 16 shkurt 2016, ka pranuar dhe shqyrtuar ankesën e znj. Mimoza Telaku, e cila ankohet kundër Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me refuzimin e kërkesës për përfitimin e grantit (bursë) për doktoratë.

Ankuesja pohon se është duke vazhduar studimet e doktoratës në universitetin Ben Gurion University of the Negev, dhe se ajo kishte aplikuar në konkursin e shpallur nga MASHT me datën 23.09.2015, sipas të cilit kriter bazë për përfitimin e grantit (bursës) ishte që universiteti ku aplikanti studion të rangohet ndër 500 më mirët në botë. Sipas konkursit rangimi do të merret parasysh sipas vlerësimit nga Times Higher Education apo ndonjë rangim tjetër zyrtar i njohur ndërkombëtarisht.

Znj. Telaku nuk ishte përzgjedhur si përfituese e grantit (bursës) Nga Këshilli Shkencor i MASHT-it me arsyetimin se universiteti ku ajo studion nuk i plotëson kushtet e përcaktuar me konkurs, ngase ai sipas vlerësimit të komisionit nuk rangohej në listën e 500 universiteteve më të mira në botë

Më 10 dhjetor 2015, ankuesja ka parashtruar ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duke e dëshmuar se i plotëson të gjitha kriteret për të qenë përfituese e bursës ndër to edhe kriterin se universiteti është i ranguar ndër 500 universitetet më të mirë në botë. Për më tepër ankuesja ka bashkëngjitur edhe linkun [www. Timeshighereducation.com/world-university-rankings/2016](http://www.Timeshighereducation.com/world-university-rankings/2016), ku vërtetohet se universiteti Ben Gurion University of the Negev, është në mesin e 500 universiteteve më të mira në botë, por ankesa e saj i është refuzuar nga ana e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Më 24 shkurt 2016, ne biseduam bashkë me Ju dhe bashkëpunëtorët Tuaj në mes tjerash edhe për ankesën e znj. Telaku dhe u dakorduam që nëpërmjet korrespondencave zyrtare ta trajtojmë këtë rast.

Avokati i Popullit vëren se znj. Telaku ka prezantuar të gjitha faktet dhe provat se i plotëson të kriteret e përcaktuara me konkurs për të qenë përfituese e grantit (bursës) për studimet e doktoraturës dhe se arsyetimi i dhënë në refuzimin e aplikacionit të saj nuk ka bazë të qëndrueshme. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe barabartë me rastin e vendosjes në lidhje me përfituesit e grantit (bursës) dhe trajtimi i tillë pabarabartë në situata të njëjta përbën diskriminim sipas nenit 3 paragrafit 2. Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi: "*Diskriminim është çdo*

dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”

Nisur nga kjo, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16 paragrafi 1 të ligjit nr. 05/L-019, për Avokatin e Popullit sipas së cilit “*Avokati i Popullit ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit*” dhe paragrafit 15 “*Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë*”, nenin 9, paragrafi 2.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi sipas të cilit “*Avokati i Popullit pranon dhe heton parashitjet e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit;*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin e trajtimit të kërkesave dhe ankesave për fitues të granteve (bursave) të doktoraturës në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë:

REKOMANDON

- 1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të ndërmarr masat e nevojshme që aplikimi i znj. Mimoza Telaku të rishqyrtohet dhe të vendoset drejt mbi bazën e fakteve, dëshmime dhe provave.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më 22 mars 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Prishtinë, 12 prill 2016

Z. Shpend Maxhuni
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës
Policia e Kosovës
10000 Prishtinë

Ankesa nr. 441/2015

Emir Tara

kundër

Policisë së Kosovës

Letër rekomandim

I nderuari z. Maxhuni,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L -019, më 31 gusht 2015, ka pranuar ankesën e z. Emir Tara, kundër Policisë së Republikës së Kosovës.

Në ankesën e tij z. Tara theksoi se në vitin 2014, Policia e Kosovës shpalli konkursin publik nr. 01/2014, për rekrutim të kandidatëve për pozitën zyrtar policor në Policinë e Kosovës. Aplikacioni për punësim i z. Tara evidentohet me numër 01-01144.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2012 për Marrëdhënie Pune në Policinë e Kosovës, kandidatët duhet të dorëzojnë vërtetimin nga gjykata se nuk janë të dënuar dhe nuk janë nën hetime.

Më 9 janar 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, i lëshoi ankuesit Certifikatë, me të cilën vërtetoi se kundër ankuesit nuk është ngritur aktakuzë e plotfuqishme dhe nuk është dënuar për veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim deri në tre (vjet).

Më 20 janar 2015, Policia e Kosovës, i lëshoi ankuesit vërtetim me të cilin vërtetoi se ankuesi nuk ka të kaluar kriminale të evidentuar në bazën e të dhënave SIPK. Përmes ueb faqes zyrtare të Policisë së Kosovës ankuesi u informua se nuk ishte pranuar në radhët e Policisë së Kosovës.

Ankuesi, pranë Komisionit Përzgjedhës për Procesin e Rekrutimit, parashtrroi ankesë lidhur me rezultatet e verifikimit të së kaluarës. Më 9 shtator 2016, Komisioni Përzgjedhës për Procesin e Rekrutimit konstatoi se verifikimi i së kaluarës së ankuesit kishte përfunduar më 8 korrik 2015 dhe se ankuesi nuk i plotëson standardet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2012 kapitulli III, neni 9, paragrafi 1 pika f. dhe neni 10 pika 3. Komisioni pas analizimit të shkesave materiale konstatoi se rekomandimi i dhënë nga Drejtoria e Standardeve Profesionale është i arsyeshëm dhe ankesa është e pabazuar.

Më 5 tetor 2015, Avokati i Popullit i drejtoi letër Policisë së Kosovës përmes së cilës kërkoi të informohet lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet lidhur me procesin e verifikimit të së kaluarës së ankuesit, të cilat ishin shkak për dështimin e tij. Avokati i Popullit u njoftua nga Policia e Kosovës se arsyeja e dështimit të ankuesit ishte se ai kishte paraqitur të dhëna jo të sakta në përgjigjen e tij në pyetjen e parashtruar në aplikacionin për punësim se a kishte qenë subjekt i hetimeve për veprë penale dhunë në familje/lëndim i

lehtë trupor lidhur me kallëzimin penal të Policisë së Kosovës 2006-AD-183 të ushtruar pranë Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë (tani Prokuroria Themelore në Prishtinë) më 23 janar 2006.

Nga dokumentet e pranuar rezulton se Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë më 22 tetor 2008 e kishte hedhur poshtë kallëzimin penal të Policisë së Kosovës të ushtruar më 23 janar 2006.

Më 15 tetor 2015, Avokati i Popullit, i drejtoi letër Prokurorisë Themelore në Prishtinë duke kërkuar të informohet lidhur me kallëzimin penal të lartpërmendur. Më 6 janar 2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë e njoftoi Avokatin e Popullit se kallëzimi penal 2006-AD-183 ishte hedhur poshtë nga prokurorja e çështjes më 22 tetor 2008. Më 11 shkurt 2016, Avokati i Popullit kërkoi nga Policia e Kosovës që t'i dërgohet faqja numër 6 e aplikacionit të ankuesit në të cilën gjenden pyetjet nëse kandidati ka qenë ndonjëherë i arrestuar dhe subjekt i hetimeve.

Më 16 shkurt 2016, Policia e Kosovës përmes postës elektronike zyrtare ia dërgoi Avokatit të Popullit dokumentin e kërkuar në të cilin vërehet se ankuesi gjatë plotësimit të aplikacionit në pyetjet e lartpërmendura është përgjigjur me "JO". Më 1 mars 2016, ankuesi në Institucionin e Avokatit të Popullit, prezantoi dokumentin e lëshuar nga Prokurori Publik me të cilin vërtetohet se nga shkesat e lëndës të kallëzimit penal 2006-AD-183 rezulton se pala e dëmtuar nuk ishte njoftuar se kallëzimi penal ishte hedhur poshtë.

Më 2 mars 2016, ankuesi i drejtoi kërkesë Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, që ta njoftojë me shkrim nëse bazuar në Aktvendimin e atëhershëm të Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë me numër PP.nr. 341-7/2006, PPM nr. 9-11/2006 të datës 22 tetor 2008, ai ka qenë i arrestuar dhe se a ekzistonte ndonjë procesverbal për arrestimin e tij.

Më 2 mars 2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë i lëshoi ankuesit njoftim me të cilin vërtetohet se pas analizimit të shkresave të lëndës në kallëzimin penal të lartpërmendur, rezulton se nuk ka asnjë vendim mbi ndalimin apo arrestimin e ankuesit. Më tej në njoftim thuhet se ky njoftim lëshohet me qëllim të vërtetimit se ankuesi në këtë rast nuk ka qenë i ndaluar dhe as i arrestuar.

Ankuesi ankohet se ai nuk ishte në dijeni se Policia e Kosovës kishte iniciuar kallëzim penal dhe se kjo ishte arsyeja përse ai në pyetjet e parashtruara në aplikacionin për punësim u përgjigj negativisht. Nga dokumentet e prezantuara vërehet se Prokuroria Publike Komunale, nuk e kishte njoftuar palën e dëmtuar për hedhjen poshtë të kallëzimit penal, gjë që bie në kundërshtim me nenin 208 paragrafi 2 të ish Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale i cili ishte fuqi në atë kohë.

Bazuar në njoftimin e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ankuesi nuk ishte as i ndaluar dhe as i arrestuar lidhur me kallëzimin penal bazuar në të cilin ankuesit iu refuzua mundësia për të nënshkruar kontratë pune me Policinë e Kosovës. Prandaj, bazuar në këtë njoftim të organit kompetent, nuk qëndron argumenti i Policisë së Kosovës se ankuesi ka dhënë të dhëna të pasakta kur u është përgjigjur negativisht pyetjeve nëse ka qenë i arrestuar dhe subjekt i hetimeve.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, shprehimisht thekson se hetimi fillon me aktvendim të Prokurorit Publik. Në rastin e ankuesit, kallëzimi penal i Policisë së Kosovës u hodh poshtë, rrjedhimisht, nuk pati aktvendim për fillim të hetimit. Prandaj, Avokati i Popullit, bazuar në dokumentet e prezantuara nga ankuesi dhe të lëshuara nga organi kompetent, konstaton se ankuesi nuk ishte subjekt i hetimeve dhe nuk ishte i arrestuar.

Avokati i Popullit, bazuar në faktet e rastit në fjalë dhe dokumentet e prezantuara, si dhe bazuar në pyetjet e parashtruara në aplikacionin për punësim në Policinë e Kosovës, është i mendimit se në aplikacion duhet të shtrohen edhe pyetje tjera shtesë të cilat do të përfshinin edhe situata të tjera të parapara me

Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet tjera relevante në fuqi, në të cilat mund të ndodhen qytetarët e Republikës së Kosovës kur ata për arsye të ndryshme paraqiten para organeve kompetente, sidomos para organeve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave.

Vetëm duke pasuruar me pyetje shitesë aplikacionin për punësim në Policinë e Kosovës, mund të shmangen shkeljet e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, që i përkasin kësaj fushe.

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura,

REKOMANDON

Policisë së Republikës së Kosovës

- *Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet tjera relevante, të përfshihen pyetje shitesë në aplikacionin për punë për kandidatë për pozitën e zyrtarit policor në Policinë e Kosovës, sidomos pyetjet të cilat ndërlidhen me çështjen e verifikimit të së kaluarës së kandidatëve.*
- *Pyetjet shitesë në aplikacion të përfshijnë edhe situata tjera në të cilët mund të gjenden aplikuesit, të cilët për arsye të ndryshme duhet të paraqiten para organeve të policisë, prokurorisë ose gjykatave.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerret Policia e Kosovës lidhur me këtë çështje si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Prishtinë, më 22 shkurt 2016

Z. Nehat Idrizi
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Rr. "Luan Haradinaj", p.n.
10000, Prishtinë

Ankesa nr. 557/2015

Nebojsha Vllajiq

kundër

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Letër rekomandim

Inderuari z. Idrizi,

Po Ju shkruaj, duke iu referuar letrave të mëparshme, të dërguara më 26 nëntor 2015 dhe 15 janar 2016 përmes së cilave ju kam informuar se z. Nebojsha Vllajiq ankohet në dështimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të përgjigjet në kërkesën e tij të parashtruar më 21.5.2015, që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike dhe lidhur me këtë kam kërkuar sqarime në rastin e ankuesit si dhe arsyet e mospërbushjes së procedurave të parapara me ligj në kuptim të nenit 7 të Ligjit për qasje në dokumente publike nr. 03/ L-215, e cila thekson obligimin që me pranimin e kërkesës së ankuesit të ndërmerrni veprimet e parapara dhe që brenda afatit të caktuar ta njoftoni me shkrim parashtruesin e ankesës lidhur me pyetjet e parashtruara.

Në fakt, më 18.1.2016, me keni njoftuar me shkrim mbi arsyet e parandalimit tuaj që brenda kohës së paraparë me ligj të përgjigjeni në kërkesën e z. Vllajiq për arsye se nuk posedoni me të dhëna sipas kërkesës së z. Vllajiq, sepse në raportet e gjykatave të dhënat e kërkuara nuk specifikohen në atë mënyrë dhe se në rastin konkret duhet të rishikohet çdo rast veç e veç për një periudhë kohore më të gjatë, siç është kërkuar, si dhe prezantimi i të dhënave mbi rastet në secilën gjykatë, gjë që merr shumë kohë dhe njëherësh potenconi nevojën që z. Vllajiq ta arsyetojë më konkretisht kërkesën e tij, për shkak të natyrës së ndjeshme të lëndëve penale dhe mbrojtjes së privatësisë në to.

Konkretisht më 21.5.2015 ankuesi iu drejtua me një kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës që në bazë të Ligjit për qasje në dokumente publike dhe në bazë të evidencës zyrtare, t'i jepen informacionet si në vijim: "Sa njerëz në Kosovë, nga përfundimi i luftës, më 10 qershor 1999, e deri më tani janë dënuar me vendim për vepra penale të dhënies së dëshmisë së rrejshme, dëshmi të rrejshme nën betim, paraqitje apo akuzë të rrejshme apo për vepra të ngjashme penale kundër gjyqësorit, për deklarata të rrejshme që kanë dhënë gjatë procedurave të zhvilluara lidhur me krimet më të rënda, konkretisht për veprat penale të krimeve të luftës dhe krimeve për vrasje, ku viktimat dhe autori i krimit janë pjesëtarë të kombësive të ndryshme?" (...) "pavarësisht nëse në lëndët e kësaj natyre kanë gjykuar gjyqtarët ndërkombëtarë të kolegjeve gjyqësore të UNMIK-ut të dikurshëm, kolegjeve të tanishme gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it, apo gjyqtarët vendor të Kosovës".

Prej asaj që u tha më lart, mendoj se kërkesa e ankuesit i referohet vetëm të dhënave statistikore, aktualisht numrit të personave të cilët prej 10 qershorit të vitit 1999 e gjerë më sot janë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të lartcekura, por që nuk kërkon qasje në të dhënat e këtyre lëndëve e as që ankuesi kërkon të dhënat personale të kryerësve të veprave të tilla penale, me çka do të mund të dëmtohej privatësia e tyre.

Në pajtim me të lartcekurat, me kalimin e periudhës kohore gjatë së cilës ankuesi nuk ka marr asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e tij, në pajtim me nenin 7 të Ligjit për qasje në dokumente publike No. 03/L-215:

REKOMANDOJ

- 1. Që si organ shtetëror të ndërmerri komunikim aktiv për sa i përket detyrave, obligimeve dhe përgjegjësive tuaja që dalin nga ligji i lartcekur dhe që në një afat sa më të shkurtër kohor ta njoftoni dhe arsyetoni me shkrim ankuesin mbi kërkesën e tij.**

Në pajtueshmëri me nenin 132, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit mbi Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju kisha lutur që mbi veprimet e ndërmarra nga ana e juaj, lidhur me këtë çështje, si përgjigje në rekomandimin e dhënë, të na informoni jo më vonë se deri më 4 mars 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i popullit

Bashkëngjitur - Kopja e letrës, të cilën Avokati i Popullit ia ka dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 1592/2015 më 26 nëntor 2015.

- Kopja e letrës, të cilën Avokati i Popullit ia ka dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 66/2016 e datës 15.1.2016

-Kopja e letrës dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 101/7 e datës 18.01.2016.

- Kopja e kërkesës e Nebojsha Vllajiqit e dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës me 21. 5.2015.

Prishtinë, më 24 tetor 2016

Znj. Hykmete Bajrami, ministre
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Rr. "Muharrem Fejza", p. n Lagjja e Spitalit
10000 Prishtinë

Ankesa nr. 320/2015

Esat Ibrahim

kundër

Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

Letër rekomandim

E nderuara znj. Bajrami,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L -019, më 24 qershor 2015, ka pranuar ankesën e z. Esat Ibrahim, kundër Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Në ankesën e tij z. Ibrahim theksoi se gjatë furnizimit me karburant (plin-gaz) në pikën shitëse të "AL-Petrol" në rrugën "Ahmet Krasniqi" në lagjen Arbëria në Prishtinë, është dëmtuar sepse rezervuari i veturës së tij ka një kapacitet maksimal prej 45 litra, ndërsa nga kompania në fjalë sipas aparaturave është furnizuar hiq më pak se 52.13 litra plin-gaz apo 16% më shumë se sa kapaciteti maksimal i rezervuarit, duke e dëmtuar kështu si për nga vlera monetare po ashtu edhe sasiore.

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-203 për Metrologji, parashihet që përmes Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK) të bëhet rregullimi i sistemit për verifikimin, testimin dhe kalibrimin e mjeteve matëse dhe kontrollimin e cilësisë në Kosovë nëpër pikat shitëse të karburanteve.

Më 23 qershor 2015, lidhur me këtë çështje ankuesi ka parashtruar një ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të MTI-së, mirëpo asnjëherë nuk ka pranuar përgjigje.

Më 20 korrik 2015, përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) bisedoi me zyrtarin e lartë në zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit në MTI, i cili deklaroi se kohëve të fundit ka pas disa ankesa nga qytetarë të ndryshëm për problemin me sasinë e litrës së karburanteve-gazit kundër disa operatorëve ekonomik dhe një ndër ta është e dhe kompania "Al Petrol", ndërsa sa i përket rastit të ankuesit, zyrtari i lartcekur na njoftoi se pas pranimit të ankesës menjëherë është lajmëruar Inspektorati i Tregut në MTI, të cilët së bashku me AMK-në janë duke u marrë me rastin.

Më 10 shtator 2015, përfaqësuesi i AP-së është njoftuar nga zyrtari i lartcekur në zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit në MTI, se nga AMK janë njoftuar se aparatura për matjen e sasisë së gazit është dëmtuar dhe nuk është funksionale. Ai gjithashtu është njoftuar se meqë aparati nuk ka qenë në funksion nuk ka qenë e mundur të kryhen matjet, të dilet me rezultate dhe si pasojë nuk ka pasur mundësi që palës t'i kthehet përgjigje.

Më 10 shkurt 2016, përfaqësuesi i AP-së bisedoi përsëri me drejtorin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në MTI, i cili po ashtu deklaroi se për një kohë të gjatë aparati për matjen e sasisë së gazit pranë AMK-së është dëmtuar dhe pasi që ky aparat është jofunksional nuk posedojnë me ndonjë rezultat të këtyre matjeve. Po ashtu, deklaroi se disa herë kanë kërkuar nga agjencia në fjalë që sa më parë të funksionalizohet aparatura ekzistuese ose të blihet një e re dhe të fillohet me matjet dhe verifikimin e pajisjeve të gazit nëpër kompanitë që tregtojnë me këtë artikull.

Më 19 prill 2016, Përfaqësuesi i AP-së u njoftua nga ankuesi se ende nuk kishte pranuar përgjigje nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ndërsa u këshillua që bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e

Konsumatorit, përmes Inspektoratit të Tregut të shfrytëzojë mjetet juridike dhe të vazhdojë rastin përmes gjykatës kompetente.

Më 18 gusht 2016, në një artikull në portalin “Telegrafi” me titull “Skandaloze: MTI-ja nuk ka pajisje, e as staf për verifikimin e mjeteve matëse të gazit⁹⁶”, thuhet se “MTI-ja nuk ka pajisje, e as staf për verifikimin e mjeteve matëse të gazit në Kosovë, janë shumë makina të cilat për lëndë djegëse përdorin gazin, por gjatë furnizimit të tyre nëpër pompa në vend, nuk dihet se a marrin aq sa paguajnë gaz dhe se Agjencia e Metrologjisë nuk bën verifikimin e mjeteve matëse të gazit, në mungesë të stafit profesional si dhe pajisjeve për verifikimin e tyre”.

AMK, sipas Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji, shprehimisht parasheh rregullimin e sistemit të njësisë matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse dhe zbatohet në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, mbrojtjen e konsumatorit, mjedisit dhe sigurisë së përgjithshme teknike, transaksionet e mallrave dhe shërbimeve. Prandaj, Avokati i Popullit, sipas hetimit të bërë bazuar në ankesën e z. Ibrahimit, konstaton se MTI, lëshon licenca pa bërë kalibrimin e agregateve të gazit, duke dëmtuar kështu padrejtësisht konsumatorët, sepse bazuar në informatat e siguruar dhe veprimet e ndërmarra nga AP, vërehet qartë se MTI nuk posedon me pajisje dhe as me staf për të kontrolluar sasinë dhe cilësinë e gazit, me të cilin furnizohen veturat dhe që përdoret në amvisëri.

Duke e nisur nga fakti se në Kosovë janë afërsisht rreth 390 pika të karburanteve që shesin gaz me pakicë, se MTI-ja tash e tre vite nuk e ka bërë kalibrimin e pajisjeve të gazit dhe se lëshon licenca pa kalibrim të këtyre pajisjeve, Avokati i Popullit, bazuar në nenin 4, të Ligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me të cilin parashihen të drejtat e konsumatorit, për të evituar cenimin e të drejtave të tyre, është i mendimit se në periudhën vijuese MTI-ja gjegjësisht AMK-ja, duhet të furnizohet me pajisje adekuate për verifikimin e mjeteve matëse si dhe të bëjë rekrutimin e stafit që merret me kalibrimin e pajisjeve të derivateve të naftës dhe gazit.

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, i

REKOMANDON

Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

- ***Në pajtim me ligjin nr. 03/L-203 për Metrologji dhe ligjet tjera relevante, që AMK, sa më parë të bëjë furnizimin me pajisjet adekuate për verifikimin e mjeteve matëse dhe të bëjë rekrutimin e stafit që të merret me kalibrimin e pajisjeve të derivateve të gazit,***
- ***Që MTI-ja, të ndërpres praktikën e kundërligjshme të licencimit të kompanive që tregtojnë me artikullin e gazit pa kalibruar agregatet e gazit.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë MTI-ja lidhur me këtë çështje si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura, në afat 30 ditor pas pranimit të shkresës.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

⁹⁶ [http://www.telegrafi.com/skandaloze-mti-ja-nuk-ka-pajisje-e-staf-per-verifikimin-mjeteve-matese-te-gazit/\(18.08.2016\)](http://www.telegrafi.com/skandaloze-mti-ja-nuk-ka-pajisje-e-staf-per-verifikimin-mjeteve-matese-te-gazit/(18.08.2016)).

Prishtinë, 24 nëntor 2016

Znj. Tonka Berishaj, u.d. kryetare
Gjykata e Apelit në Prishtinë
Pallati i drejtësisë, fshati Hajvali
10000 Prishtinë

Ankesa nr.398/2016

Kamer Ukaj

kundër

Gjykatës së Apelit në Prishtinë

Letër rekomandim

E nderuara znj. Berishaj,

Avokati i Popullit në përputhje me nenin 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, më 29.06.2016 e pranoi ankesën e z. Kamer Ukaj, i cili ankohet për kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në lëndën AC br.1159/13.

Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve, me të cilat disponon Avokati i Popullit, lënda e ankuesit ka të bëjë me ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punës, në procedurën gjyqësore para gjykatave në Kosovë, që nga viti 2010. Në lidhje me zvarritjen e procedurës, ankuesi ka parashtruar disa herë urgjencë në Gjykatën e Apelit për ta përshpejtuar shqyrtimin urgjent të lëndës së tij.

Në procesin e hetimeve sipas ankesës së ankuesit, këshilltarja ligjore e Avokatit të Popullit më 08.07.2016 dhe më 08.09.2016, gjatë takimit në Gjykatën e Apelit është informuar që rasti i ankuesit nga gjyqtari paraprak i është dhënë gjyqtarit Rafet Haxhaj, i cili ka marrë në punë lëndën më 01.09.2015 dhe e njëjta lëndë është ende në pritje t'u shqyrtuar, po ashtu se kjo gjykatë është duke i shqyrtuar lëndët e pranuar në vitin 2013.

Meqë lënda e ankuesit ka të bëjë me ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punës, ua përkujtoj se Ligji për Procedurën Civile Nr. 03/L-006, në pjesën që ka të bëjë me procedura të veçanta gjyqësore, në Kapitullin XVI për procedurën në kontestet që dalin nga marrëdhënia e punës, neni 475 parashikon, si më poshtë:

„Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës. „

Prandaj, në pajtim me të lartcekurat, në përputhje me nenin 132, pikën 3 të Kushtetutës së Kosovës dhe në kuptim të kompetencave dhe përgjegjësisë të Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 16, paragrafin 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor (...) në rastet kur ka zvarritje të procedurave.”

Meqë Gjykata e Apelit aktualisht po i shqyrton rastet e pranuar në vitin 2013, nga i cili vit daton edhe lënda e ankuesit AC br.1159/13, që në Gjykatën e Apelit është në pritje të shqyrtimit më se 3 vite, ndërsa natyra e të njëjtës kërkon urgjencë për zgjidhje, rekomandoj:

- ***Që Gjykata e Apelit, pa vonesa të mëtejshme, ta marrë rastin në fjalë në shqyrtim dhe vendosje, me qëllim të procedimit të lëndës brenda një kohe të arsyeshme, në përputhje me ligjin dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.***

Në përputhje me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019 dhe nenin 132, pikën 3 të Kushtetutës së Kosovës, Ju lutem që të më jepni përgjigje në rekomandim më së largu deri më 25 nëntor 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Prishtinë, më 10 nëntor 2016

Z. Shpend Maxhuni, Drejtor
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës
Z. Hilmi Mehmeti, Kryeshef
Inspektorati Policor i Kosovës

Ex officio 625/2016

Letër rekomandim

I nderuari z. Maxhuni,
I nderuari z. Mehmeti,

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, më 28 shtator 2016, rreth orës 17:00, përballë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në afërsi të Zyrrave të IAP-së në Prishtinë, kanë hasur rastësisht në një situatë komunikimi të ashpër në mes dy zyrtarëve policorë të trafikut, të shoqëruar nga dy policë civil dhe të një qytetareje, në cilësinë e këmbësore në trafik, e shoqëruar nga një person tjetër.

Meqenëse qytetarja ishte në gjendje të rëndë emocionale dhe dëgjohej me zë të lartë tek thirrej në të drejtat e saj dhe cenimin e tyre nga ana e njërit prej zyrtarëve policor të trafikut me numër identifikues #1260, përfaqësuesit e IAP e konsideruan të arsyeshme të monitoronin se si po zhvillohet më tutje ngjarja. Komunikimi ka qenë në vazhdimësi acarues dhe me përplasje verbale mes këtyre zyrtarëve policorë edhe qytetares në fjalë, deri në momentin kur policët e njoftuan atë se ajo duhet të shkonte me ta në Stacionin e Policisë “Qendra” në Prishtinë, me ç’rast u thirr edhe një patrollë tjetër policie.

Përfaqësuesit e IAP në vendin e ngjarjes, i njoftuan zyrtarët policor të pranishëm, se përfaqësojnë IAP-në dhe sipas kompetencave kushtetuese dhe ligjore, do të vijnë në Stacionin Policor “Qendra” që ta monitorojmë më tutje rastin. Në atë moment nuk kishte ndonjë kundërshtim nga ana e zyrtarëve policorë, mirëpo në zyrën hyrëse të Stacionit Policor, policja me numër identifikues #9309, pasi është njoftuar lidhur me arsyen e vizitës së përfaqësuesve të IAP-së, duke ia ofruar edhe ID-të zyrtare, ju drejtohet atyre duke kërkuar informata lidhur me marrëdhënien me këmbësoren në fjalë dhe duke pohuar se nuk ka nevojë të monitorohet rasti dhe se këmbësores do t’i shqiptohet një tiketë.

Përkundër faktit se përfaqësuesit e IAP-së sqaruan për arsyen e prezencës së tyre, bazuar në të drejtën kushtetuese dhe ligjore që IAP ka për të monitoruar qendrat e ndalimit, në çdo kohë dhe rrethanë, si dhe duke e ftuar tre herë radhazi, që ta lexojë Nenin e Kushtetutës, i cili është i shkruar në ID-të zyrtare të përfaqësuesve të IAP, që specifikon obligimin që autoritetet kanë për t’ju përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit, zyrtarja policore me nr. #9309 ka vazhduar me sjellje mospërfillëse dhe arrogante, duke refuzuar edhe kërkesën e përfaqësuesve të IAP-së që ta kontaktojmë ndonjërin prej eprorëve të saj dhe duke mos i lejuar të vazhdojnë me monitorimin.

Ndërkohë, një zyrtar policor tjetër që ka parë sjelljen e koleges së tij, kërkoi nga përfaqësuesit e IAP-së, ID kartelat dhe menjëherë kontaktoi me Togerin z.Eshref Beqiri, i cili më pas komunikoi me përfaqësuesit e IAP-së përmes telefonit, duke ia shpjeguar arsyen e vizitës në Stacionin Policor. Pas këtij komunikimi, përfaqësuesve të IAP iu lejua hyrja në zyrën ku po mbahej pala (këmbësorja), të cilës tashmë i ishte shqiptuar tiketa. Edhe aty, përfaqësuesve të IAP iu kërkua nga zyrtari policor z. Agim Cërrvadiku, me nr identifikimi #1260 (polici që kishte pasur përplasjen verbale me këmbësoren), që të sqarohet arsyeja e prezencës së përfaqësuesve të IAP, sepse ai nuk e dinte se çka përfaqësonte Avokati i Popullit. Atij iu dhanë shpjegimet përkatëse për mandatin e IAP-së dhe sqarimi se përfaqësuesit e IAP-së ishin aty për të monitoruar procesin nga këndvështrimi i kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore që kanë.

Gjithashtu, duhet theksuar faktin se, sipas vrojtimit të përfaqësuesve të IAP, komunikimi i ashpër mes policit dhe këmbësorës, ka vazhduar edhe në Stacionin Policor, të shoqëruar me gjendje tejet emocionale të këmbësorës. Këmbësorja është njoftuar nga ana e policisë se ajo mund të ankohet kundër shqiptimit të tiketës në Stacionin e Policisë në Dardani. Po ashtu, punëtorët e IAP-së kanë marrë informatën se këmbësorja quhej Mrika Sefaj, studente, si dhe është njoftuar se nëse e konsideron se të drejtat e saja janë shkelur, ajo mund të ankohet edhe në IAP.

Nisur nga kjo, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me *iniciativën e vet (ex officio)*, nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit konstaton se pengimi i përfaqësuesve të IAP-së në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore dhe refuzimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit, siç ishte rasti me policen me numër identifikues #9309, paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 132, paragrafi 3, në të cilën përcaktohet obligimi i çdo organi, institucioni ose autoriteti tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, që është i detyruar t'iu përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Avokati i Popullit konstaton se është shkelur Ligji 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2, pika 2.1, ku përcaktohet se IAP mund të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Pastaj shkelje ligjore ka edhe të nenit 18, paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të kufizuar të lëvizjes dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet. Gjithashtu, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, sipas detyrës zyrtare, mund të hyjnë në të gjitha hapësirat zyrtare të të gjitha autoriteteve.

Avokati i Popullit thekson se të gjitha autoritetet obligohen t'iu përgjigjen këtij institucioni në kërkesat për zhvillimin e hetimeve, ashtu siç është e përcaktuar në Ligjin Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, përkatësisht Neni 25, paragrafi 1, ku përcaktohet se *“Të gjitha autoritetet kanë për obligim t'iu përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'iu ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij”*, kurse paragrafi 2, përcakton se *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*.

Avokati i Popullit konstaton se zyrtarja policore me nr. #9309 ka kryer shkelje disiplinore dhe kërkon nga Inspektorati Policor i Kosovës që të bëjë hetime disiplinore, ashtu siç përcaktohet në Ligjin Nr.03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, përkatësisht Nenin 22, paragrafi 1, ku thuhet se *“Me përfundimin e hetimeve disiplinore, sipas nenit 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe 1.4 të këtij ligji, nëse IPK*

përcakton se është kryer një shkelje disiplinore e paraparë në Ligjin për Policinë apo aktet nënligjore për zbatim të tij, IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm masën disiplinore për punonjësin e Policisë”.

Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se zyrtarja policore në fjalë ka shkelur Kodin Etik të Policisë së Kosovës, në pjesën e cila ka të bëjë me hetimet e policisë, të cilat duhet të jenë objektive dhe të paanshme. Ata duhet t’i marrin parasysh dhe t’iu përshtaten nevojave të veçanta të personave si fëmijët, të rinjtë, gratë, pakicat duke përfshirë pakicat etnike dhe personat në rrezik.

Zyrtarja Policore me nr. #9309, ka shkelur nenet e Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura disiplinore në Policinë e Kosovës, duke kryer sjellje të rëndë diskredituese dhe duke u sjellur në mënyrë joprofesionale, ashtu siç është paraparë në nenin 14, paragrafi 1.14, ku flitet për punonjësit e Policisë së Kosovës, me ç’rast thuhet se ai *“Sillet në mënyrë të tillë duke i vënë hije të keqe apo të turpshme Policisë së Kosovës gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj”*, pastaj paragrafi 1.23 *“Sillet në mënyrë joprofesionale apo përdor shprehje banale, nënçmuese dhe paragjykuese gjatë detyrës dhe jashtë saj”*.

Po ashtu, zyrtarja policore me nr. #9309 ka shkelur rëndë edhe autorizimet policore, të përcaktuara në Nenin 18, paragrafi 1.8 të këtij udhëzimi administrative, ku përcaktohet se punonjësi i Policisë së Kosovës është fajtor për shkelje të rëndë të autorizimit nëse *“Vepron në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi në lidhje me autorizimet policore, në atë mënyrë që rëndë dëmton të drejtat e një personi tjetër”*.

Prandaj, Avokati i Popullit bazuar në shkeljet e bëra nga zyrtarja policore #9309, konstaton se ndaj saj duhet shqiptuar njëra nga masat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ në fjalë, sipas nenit 45, paragrafi 1, në të cilin përcaktohen masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore sikurse janë: *“1.1. ndërprerja e marrëdhënies së punës, 1.2. degradimi-jo më shumë se një gradë, 1.3. largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi më të ultë menaxhuese por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale, 1.4. ndalesën në pagë mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej 2 deri në gjashtë muaj*. Po ashtu, në Nenin 45, paragrafi 2 të këtij udhëzimi administrative theksohet se *“krahas masave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohen edhe masat plotësuese: 2.1.transfer administrativ, 2.2. trajnim obligativ, 2.3.këshillim mjekësor/psikologjik dhe 2.4. ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit”*. Gjithashtu, në Nenin 46 të këtij udhëzimi administrativ, autoriteti për trajtim, shqyrtim dhe shqiptim të masave disiplinore janë: *mbikëqyrësi i punonjësit, Komisioni i Brendshëm Disiplinor, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë të gjitha masat disiplinore sipas kompetencës nga ligji i IPK-së dhe Ministri i MPB si shkallë e dytë dhe Kryeministri sipas ligjit të Policisë dhe IPK-së*.

Avokati i Popullit konstaton se lidhur me rastin janë shkelur edhe nenet e Udhëzimit Nr.01/2015 për Obligimin e Njësive Organizative të Policisë për Bashkëpunim dhe Përkrahje të Avokatit të Popullit, në Kryerjen e Detyrave Zyrtare të Tij, të Policisë së Kosovës, përfshirë Nenin 2, në të cilin përcaktohet se *“Detyra e njësive organizative të Policisë, të të gjitha niveleve të organizimit që, në rast të kërkesës ligjore të parashtruar nga Avokati i Popullit, t’u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesin atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, në pajtim me ligjin”* dhe Neni 5 i këtij udhëzimi, i cili thekson se *“Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë të privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të kufizuar të lëvizjes dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seancë dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të policisë. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet”*.

Bazuar në analizën ligjore të mësipërme dhe duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, Avokati i Popullit konstaton se komunikimi mes autoriteteve dhe qytetarëve dhe mënyra se si ky komunikim zhvillohet, është thelbësor për të ruajtur besimin dhe imazhin që institucionet, e në rastin konkret Policia e Kosovës, reflektojnë në opinionin publik. Pa marrë parasysh anën ligjore dhe shkeljet eventuale që këmbësorja mund të ketë bërë në komunikacion, përplasja verbale, në stil grindjeje, e ndodhur në një ambient publik dhe pengimi i punës së përfaqësuesve të IAP, mbetet e papranueshme.

Nisur nga kjo, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16, paragrafi 1 të ligjit nr. 05/L-019, për Avokatin e Popullit, sipas së cilit “*Avokati i Popullit ka kompetenca për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit*”, paragrafit 15, i cili thekson se IAP “*Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë*”, nenin 9, paragrafi 2.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi sipas të cilit “*Avokati i Popullit pranon dhe heton parashtrësit e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit*”.

Prandaj, Avokati i Popullit:

REKOMANDON

Policinë e Kosovës:

1. *Ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të Policisë së Kosovës rreth komunikimit me qytetarët dhe me institucionet (përfaqësuesve të tyre), e në veçanti t’i informojë ata mbi rolin dhe mandatin që ka IAP si dhe me Udhëzimin Nr.01/2015 për Obligimin e Njësive Organizative të Policisë për Bashkëpunim dhe Përkrahje të Avokatit të Popullit, në Kryerjen e Detyrave Zyrtare të Tij, të Policisë së Kosovës.*

Inspektoratin Policor të Kosovës

2. *Ndërmarrjen e hetimeve disiplinore, me qëllim të shqiptimit të masave disiplinore të menjëhershme sipas ligjit në fuqi dhe akteve të tjera nënligjore ndaj zyrtares policore me nr. #9309, për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore, respektivisht Sjelljes së rëndë diskredituese si dhe Shkeljes së rëndë të autorizimit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Inspektorati Policor i Kosovës dhe Policia e Kosovës lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se më 12 dhjetor 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Prishtinë, 1 nëntor 2016

Z. Imer Beka, kryeprokuror
Prokuroria Themelore në Prishtinë
Pallati i Drejtësisë, Fshati Hajvali
10000 Prishtinë

Ankesa nr. 202/2016

Ratko Krivokapić

kundër

Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Letër rekomandim

I nderuari z. Beka,

Avokati i Popullit në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, më 18.04.2016, e pranoi një ankesë të z. Ratko Krivokapić, i cili ankohet në kohëzgjatjen e procedurës sipas kallëzimit penal të bërë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. (PP.8895/14, të datës 23.12.2014).

Nga informacionet që ka Avokati i Popullit, ankuesi ka parashtruar një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë për hyrjen me dhunë dhe uzurpimin e banesës së tij dhe falsifikimin e kontratës së shitblerjes së patundshmërisë - banesës nga ana e uzurpatorit dhe avokatit të tij. Lidhur me këtë, ankuesi i është drejtuar tri herë me kërkesat me shkrim Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për t'u informuar lidhur me statusin e kallëzimit të tij penal, por në të njëjtat nuk mori asnjë përgjigje.

Gjatë procedurës së hetimit sipas ankesës së ankuesit, këshilltarja ligjore e Avokatit të Popullit më 27.07.2016, në një takim me administratoren e Prokurorisë Themelore në Prishtinë është informuar, se lënda e ankuesit fillimisht i është dhënë në punë prokurores Besa Limani, pastaj prokurorit Enver Krasniqi, i cili në ndërkohë e ka ndërruar departamentin dhe më pas lënda PP 8895/2014 i është ndarë në punë prokurorit Remzush Latifi, të cili gjendet aktualisht. Pas marrjes së informacionit këshilltarja ligjore është takuar me prokurorin e lëndës, i cili e ka informuar se me lëndën e ankuesit është ngarkuar më 18.03.2016 dhe se ende nuk ka filluar të punojë në të, por që prokurori paraprak më 16.12.2015 i ka dërguar një autorizim për marrje në pyetje të të pandehurit Policisë së Kosovës – stacionit të policisë në qendër në Prishtinë, por në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë informatë kthyesë nga ana e policisë.

Më 08.07.2016, këshilltarja ligjore e Avokatit të Popullit, përsëri u takua me prokurorin e lëndës në rastin e ankuesit, z. Remzush Latifi, i rishikuan shkresat e lëndës dhe konstatuan, se ankuesi i ka dorëzuar të gjitha dëshmitë relevante bashkë me kallëzimin penal. Prokurori tha se për shkak të numrit të madh të lëndëve nuk ka arritur të ndërmarrë ndonjë veprim përkatës hetimor në këtë lëndë dhe gjatë takimit ai e ndërmori një veprim hetimor dhe i telefonoi hetuesit në Njësinë për hetime në Stacionin e policisë Qendra në Prishtinë dhe kërkoi nga ai të ndërmarrë një veprim tashmë të kërkuar në lëndën e ankuesit, sipas autorizimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ta informojë me shkrim për këtë. Pas kësaj, prokurori i lëndës e informoi Këshilltaren Ligjore se nëse nuk i merr informacionet e kërkuara nga policia, ai do ta përsërisë me shkrim kërkesën e Prokurorisë dhe do të urdhërojë të bëhen edhe veprime të tjera hetuese.

Më 27.09.2016 me qëllim që të informohet deri ku është arritur me hetime në lëndën e ankuesit, këshilltarja ligjore u takua me zyrtaren në Zyrën e administratores së Prokurorisë dhe me atë rast u informua se prokurori i lëndës në rastin e ankuesit ende nuk i ka përfunduar hetimet dhe se nuk ka mund të marrë informacione më të hollësishme, sepse prokurori momentalisht nuk ishte aty.

Lidhur me të lartcekurat, Jua rikujtoj se është imperativ i punës së secilës prokurori të kujdeset për detyrat dhe përgjegjësitë e prokurorëve, në kuptim të dispozitave ligjore përkatëse dhe të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme ligjore për zbulimin e veprave penale dhe zbulimin e autorëve, si dhe zbatimin me kohë të hetimeve të veprave penale. Gjithashtu nënvizoj që vëmendjen e veçantë ta përqendroni në afate, në kuptim të vjetërsimit të ndjekjes penale, për çfarë çdo institucion gjyqësor është i obliguar të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Prandaj, në pajtim me të lartcekurat, në përputhje me nenin 132, pikën 3 të Kushtetutës së Kosovës dhe në kuptim të kompetencave dhe përgjegjësisë të Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 16, paragrafin 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor (...) në rastet kur ka zvarritje të procedurave.”

Meqë në rastin konkret bëhet fjalë për kallëzimin penal PP.8895/14, të datës 23.12.2014, që ka të bëjë me uzurpimin e pronës, gjë që në vetvete kërkon urgjencë për trajtim, por që në Prokurorinë Themelore në Prishtinë është duke pritur shqyrtimin gati dy vjet, rekomandoj:

- ***Që Prokuroria Themelore në Prishtinë pa vonesa të mëtejshme, t'i kryej hetimet në lëndën PP.8895/14, të datës 23.12.2014 dhe të vendosë për të njëjtën, në përputhje me ligjin dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.***

Në përputhje me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019 dhe nenin 132, pikën 3 të Kushtetutës së Kosovës, Ju lutem që të më jepni përgjigje në rekomandim më së largu deri më 30 nëntor 2016.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Bashkëngjitur : Kopja e kallëzimit penal e parashtruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, më 23.12.2014. PP8895/14.
Kopja e shkresës drejtuar Prokurorisë Themelore në Prishtinë, më 24.11.2015.
Kopja e shkresës drejtuar Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, më 29.02.2016.

